





**Imam Ruhull'Ilah el Mùsavij el Khomeini**

Udhëheqësi i Revolucionit Islamik

# **ETIKA E NAMAZIT**

Tiranë, 2024

Titulli i librit: **Etika e namazit - Adabes salati**

Autori: **Imam Ruhull'Ilah el Mùsavij el Khomeini**

E përktheu: **Haxhi Selim Stafa (Allahu e mëshiroftë!)**

Recensent: **Vullnet Merja**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

E korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp dhe kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "Fladi"**



## FJALA E INSTITUTIT

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Librin “Etika e namazit”, Imam Khomeini e përfundoi ditën e shtunë, më datë 2 të muajit rebi’ul Eu’uel të vitit 1361 hixhri. Në këtë libër jepet një shpjegim i rregullave të zemrës së faljes së namazit dhe i sekreteve shpirtërore të namazit. Autori, tre vjet para datës së lartpërmendur, kishte shkruar një libër me vlera të larta, me titull “Sekretet e namazit”. Ky libër përmban të njëjtat kuptime, por më i përmbledhur dhe me një shprehje gjuhësore të veçantë, për ata që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul irfàn)<sup>1</sup>.

Më pas autori i nderuar filloi të shkruajë librin “Etika e namazit”, por me një mënyrë gjuhësore të thjeshtë, me qëllim që prej këtij libri të përfitojë një numër sa më i madh lexuesish, prandaj shikojmë që autori, në parathënien e librit të tij “Etika e

---

<sup>1</sup>Gjatë vitit 1993, Instituti botoi tekstin e plotë, të ripunuar të librit “Sekretet e namazit”, shoqëruar edhe me faksimilen e dorëshkrimit, të shpjegimeve dhe të përmbajtjes.



namazit”, thotë: “Para këtij libri shkrova një kumtesë me përmbajtje të sekreteve të namazit, por, meqenëse kjo kumtesë nuk është e përshtatshme për gjendjen e masës, mendova të shkruaj disa rreshta, në lidhje me edukatën e zemrës gjatë kryerjes së këtij “miraxhi” shpirtëror, duke shpresuar se vëllezërit e mi të besimit të arrijnë të marrin një këshillë prej këtyre rreshtave dhe me këto rreshta të zbutet zemra e ashpër”.

Libri “Etika e namazit” u botua me titullin “Tehlikun fij el melekuti”, që përmbante shpjegime të ndryshme. Pas këtij botimi, libri është ribotuar, por botimet e mëparshme nuk ishin ashtu siç duhet të ishin dhe, kjo për shkak se botuesit nuk e kishin kopjen e dorëshkrimit, atëherë Instituti i organizimit e i botimit të trashëgimisë së Imam Khomeinit e botoi librin sipas kopjeve që ishin në përputhje me dorëshkrimin origjinal. Më pas, librin, që lexuesi i nderuar e ka në dorë, Instituti e botoi me kujdesin më të madh, duke i qëndruar besnik dorëshkrimit origjinal.

Eminenca e tij, Imam Khomeini, shkroi në vitin 1984 dy letra, në të cilat shprehet se këtë libër ia kushton djalit të tij, eminecës Sej’jid Ahmed Khomeinit dhe zonjës Fatime et Tabatabaij, bashkëshortja e Sej’jid Ahmed Khomeinit. Në këtë botim i kemi vënë këto dy letra.

Gjithashtu, është me vlerë të theksohet se në këtë botim, kemi vënë edhe shënimet e shpjegimet, të cilat i kemi nxjerrë nga bisedat apo nga fjalët e Imamit, duke cituar burimet përkatëse. Kurse shpjegimet që ka dhënë vetë Imami në librat e tij, i kemi shënuar me yje (\*\*\*) . Këtë e kemi bërë, me qëllim që të dallohen prej shpjegimeve të përgatitura prej Institutit.



Në këtë botim, Instituti ka përdorur një mijë kopje të botuara, që përmbajnë tekstin e dorëshkrimit që gjenden në bibliotekat publike, si dhe shkrimet e studiuesve që kanë shkruar në lidhje me dorëshkrimet e Imamit. Kurse në pjesën tjetër prej kopjeve të botuara, është përfshirë vetëm një fotokopje prej dorëshkrimit.

Duke shfrytëzuar rastin, falënderojmë të gjithë personat, të gjithë punonjësit që dhanë ndihmesën e tyre të sinqertë për daljen e këtij libri në formën e tanishme. Gjithashtu, falënderojmë zotërinjtë përgjegjës dhe punonjësit e kompanisë së botimeve shkencore dhe kulturore, të cilët shtrinë dorën e ndihmës për daljen në dritë të këtij botimi.

Në fund, i drejtojmë përshëndetjet e nderimet tona Khomeinit të madh dhe i lutemi Allahut, të Lartit, të Fuqishmit të na mbarësojë, që të japim edhe më shumë në rrugën e shërbimit për Islamin.

*Instituti i organizimit dhe i botimit të trashëgimisë së Imam Khomeinit*

*Departamenti i Çështjeve Ndërkombëtare*







**LETRA E IMAM KHOMEINIT,  
DREJTUAR DJALIT TË TIJ,  
SEJ'JID AHMED KHOMEINIT**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Librin tim “Etika e namazit” ia dhuroj djalit tim të dashur, Ahmedit. Me keqardhje them se, personalisht, nuk kam justifikim tjetër përveç mangësisë sime për ato që kam lënë pa bërë gjatë ditëve të jetës sime, atëherë kur isha i fuqishëm për të ndërtuar veten dhe, për këtë tani, në periudhën e pleqërisë, nuk ndiej gjë tjetër përveçse brengë e pendim. Tani duart e mia janë bosh, barra është e rëndë, udhëtimi është i gjatë, sprovat janë të ashpra, në veshët e mi regëtin melodia e rrugëtimit. Për të gjitha këto, këtë libër ia dhuroj djalit tim të dashur, Ahmedit, duke shpresuar që, me dashjen e Allahut, të përfitojë prej këtij libri, tani që është në



moshën e rinisë, prej të gjithave nga sa unë kam tubuar prej Librit të Allahut, prej Sunetit të pastër dhe prej eulijave të mëdhenj.

Gjithashtu, shpresoj që ai të lartësohet në miraxhin e vërtetë, duke përfitur edhe prej udhëzimeve të atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul ma'rifeh) dhe të shpëtojë zemrën e tij prej errësirës dhe të ketë mbarësinë, që të arrijë qëllimin njerëzor, atij qëllimi, drejt të cilit janë drejtuar Profetët e mëdhenj të Allahut, eulijatë e Tij të respektuar dhe njerëzit e tjerë të Allahut.

Bir i dashur, përpigu të gjurmosh në veten tënde, të brumosur me cilësinë e pastër, me të cilën të ka krijuar Allahu dhe shpëtoje veten prej moçalit të rrugës së humbjes. Shpëtoje veten prej dallgëve të vetëpëlqimit e të egoizmit dhe hip në "anijen e Nuhut", e cila është "Vilajeti i Allahut"! *"Ai që hipën në këtë anije, ka shpëtuar dhe ai që nuk hipën në të, është i mbaruar."*

Bir i dashur! Përpigu shumë që rrugëtimi yt të jetë në rrugën e drejtë - në rrugën e Allahut - edhe nëse kjo është me hapa të ngadaltë! Përpigu që rrahjet e zemrës tënde dhe pushimet e saj, si dhe të gjitha gjymtyrët e tua të jenë në kuadrin e lartësimit e të lidhjes me Allahun! Bëj shumë kujdes, që të punosh shumë, për të qenë në shërbim të njerëzve, sepse ata janë krijesa të Allahut! Edhe pse Profetët e Allahut dhe të veçantët prej eulijave të të Lartit, kurrë nuk kanë pasur lidhje me këtë botë, përsëri ata kanë praktikuar ato punë që praktikonin edhe të tjerët, por praktikat e tyre dalloheshin, ngaqë ishin me të vërtetën dhe për hir të të Vërtetit.



Vula e Profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ka thënë: "...unë i kërkoj Allahut faljen e gjynaheve shtatëdhjetë herë çdo ditë".<sup>1</sup>

Bir i dashur! Pas meje përgatitu të përballosh ndjenjat e kota të mërisë, të fshehura në zemër prej meje, por që më vonë do të pasqyrohen te ty, por, kur llogaria jote me Zotin tënd do të jetë e shëndoshë dhe ti je i mbrojtur me përmendjen e Allahut, atëherë ti, pa dyshim, nuk mund të kesh frikë prej njerëzve, pasi puna e njerëzve dhe llogaria e tyre është diçka e lehtë, që shpërndalet shumë shpejt. E përjetshme është vetëm llogaria para të Vërtetit të Lartësuar.

Bir i dashur! Pas meje, ty mund të të ofrohen poste. Nëse qëllimi yt është t'i shërbesh Republikës Islamike e Islamit madhështor, mos refuzo, por, nëse qëllimi yt (*Allahu mos e dhëntë!*) është nënshtrimi ndaj dëshirave vetjake dhe kënaqja e epsheve, atëherë menjëherë qëndro sa më larg pranimit, sepse në postet e në pozitat e kësaj bote nuk ka asnjë vlerë, që ti të humbësh veten për to!

O Zoti im! Derdhe mirësinë Tënde mbi Muhamedin dhe mbi pasardhësit e familjes së tij (Ehli Bejt)! Ata janë robtë e Tu dhe prej trungut të Profetit Tënd më të respektuar, dhuro paqe e bekim për atë dhe për familjen e tij! Dhuro për ata lumturi në këtë botë e në Botën Tjetër dhe ruaji ata prej ligësisë së shejtanit, i përzënë prej mëshirës Tënde!

---

<sup>1</sup>"Mustedreku Uesàili", "Kitàbu salàti", K. "Dhikri" - 22, Hadithi 1.



O Zoti im, na merr përdore ne, të pafuqishmit, që s'kemi asnjë mundësi dhe që kemi mbetur prapa karvanit të atyre që ecin në rrugën Tënde! O Zoti im! Na trajto me mirësinë Tënde dhe mos na trajto me drejtësinë Tënde!

Paqja e bekimi qoftë mbi robtë e mirë të Allahut!

23 Rebi'ul Eu'uel 1405 hixhri

**Ruhull'Ilàh El Mùsauij Khomeini**



**LETRA E IMAM KHOMEINIT,  
DREJTUAR BASHKËSHORTES SË DJALIT TË TIJ,  
SEJ'JIDE FÂTIME ET TÂBÂTABÂIJ**

*Ç'hidhërim për mua, kjo jetë kaloi papunësi e fshehtë!*

*La prapa peshën e rëndë të saj...gjynahe të mëdha.*

*Sa kohë kaloi në bindje*

*për të shkuar nesër në sheshin e dënimit!*

*Dëgjoje kumtesën,*

*tanimë kaloi koha e pendimit.*

**Me emrin e lartë të Allahut!**

Librin tim “Etika e namazit” ia dhuroj bijës sime të shtrenjtë, Fatij<sup>1</sup>, të cilën Allahu i Lartësuar e ka bërë prej atyre që falin namaz. Unë, personalisht, nuk kam arritur t’i kuptoj sekretet e namazit e

---

<sup>1</sup> Përkthim në gjuhën perse i emrit Fatime, që shpreh dashurinë dhe simpatinë e thellë.



nuk kam arritur ta mësoj etikën e faljes së namazit, edhe pse kanë kaluar më shumë se dyzet vjet që e kam shkruar këtë libër, disa vite pasi kisha përfunduar së shkruari librin “Sekreti i namazit”.

Dhe kjo nuk është gjynah, pasi kuptimi i sekretit të faljes së namazit dhe stolisja me etikën e faljes së namazit, nuk qëndron në renditjen e veprimeve gjatë faljes së namazit, por edhe falja e namazit me caqet e tij, nuk është falje e zakonshme e namazit.

Në të vërtetë, këta libra janë argument i ndihmës së të Lartit për këtë rob të varfër, me pak furnizime udhëtimi e me pak mallra. Prandaj, vetëm Allahut i kërkoj mbrojtje, që unë të jem njëri prej atyre që vërtetojnë ajetin e nderuar, në të cilin theksohet shpresa, frika e tmerri:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ كَبُرَ مَثَلًا عِنْدَ اللَّهِ أَنْ تَقُولُوا مَا لَا تَفْعَلُونَ” -

**“O ju që keni besuar, përse thoni atë ç’ka nuk e punoni? Është shumë e rëndë tek Allahu të thoni atë ç’ka ju nuk e punoni”.**<sup>1</sup> Nuk ka strehë tjetër përveç mëshirës së Allahut, e cila ka përfshirë çdo send.

Shpresoj, o bija ime, që ti të stolisesh me etikën e këtij miraxhi hyjnor, të marrësh rrugën e emigrimit prej shtëpisë së shpirtit të errësuar dhe me udhëzimin e këtij “ndriçuesi hyjnor” të arrish te Filluesi i çdo gjëje. Gjithashtu, për ty kërkoj mbrojtjen e Allahut të Madhëruar prej teprimeve që vijnë nga varësia prej vetes tënde. Pas leximit të këtyre fletëve, të mos bëhesh lodër në dorën e shejtanit, siç është bërë autori i këtij libri, lodër për shejtanin.

---

<sup>1</sup>Sure “Es Saf”, ajetet 2-3.



Bijë e shtrenjtë!

Pavarësisht nga ato që unë theksova te ty, prej ndjenjave të larta që japin shpresë se ti do të arrish udhëzimin e Allahut dhe dashamirësinë e Tij, ti do të dalësh prej gropës së pusit të thepisur të natyrës dhe do të kapërcesh sfidën e rrugës për të ecur në Udhën e drejtë të njerëzimit. Por për ty mbetet detyrë, që të mos jesh e shkujdesur ndaj kurtheve të shejtanit, madje të bësh kujdesin më të madh ndaj tij, prandaj kërko vazhdimisht mbrojtjen e Allahut të Lartësuar, vetëm Ai është Mëshirëploti me robtë e Tij.

Bijë e shtrenjtë!

Nëse këto fletë do t'i lexosh vetëm për t'u dukur, për t'u lavdëruar e për t'u krenuar nëpër kuvende, atëherë për ty është më mirë që ta mënjanojsh leximin e këtyre fletëve, madje të bësh shumë kujdes dhe të qëndrosh sa më larg këtij lloj leximi, me qëllim që të mos e pësosh e të ndihesh ngushtë e të pendohesh, ashtu siç e pësova unë vetë.

Por, nëse, me dashjen e Allahut, je e përgatitur dhe e ke mprehur dëshminë e shpirtit, për të arritur kuptimet e studimeve të këtyre fletëve të mbledhura prej Librit të Allahut, prej Sunetit dhe prej haditheve të ardhura prej të ruajturve prej gjynaheve, Ehli Bejtit, si dhe prej prurjeve të atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe praktikisht fillon të përfitosh prej mirësive të mëdha që të ka dhënë Allahu i Lartësuar, i Cili me mirësinë e Tij të ka dhuruar dhuntinë e qartësisë, atëherë fillu t'i lexosh këto fletë me emrin e



Allahut të Lartësuar, pasi kjo është “koha e shtrëngesës, prandaj edhe ti shtrëngoje heshtjen”<sup>1</sup>.

Shpresoj që kjo të jetë në përputhje me zbrazjen e zemrës prej “dëshirave” të zjarra, kur ngjitesh në këtë miraxh njerëzor dhe kur hip në këtë anije të Mëshirëplotit, si dhe për ta pastruar zemrën me ujin e jetës e me “katër tekbiret”.<sup>2</sup> Gjithashtu, për ta shpëtuar veten tënde prej robërisë së vetëpëlqimit, derisa të arrish tek i Dashuri:

“وَمَنْ يَخْرُجْ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكُهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ” -

“...ue men jakhruxh min bejtihí muhàxhiren ila-ll’lilàhí ue resùlihi thum’me judrikhul meutu fekad veka’ exhruhù ala-ll’lilàhi...” - “**...dhe kush del prej shtëpisë së tij, për të emigruar tek Allahu dhe te Dërguari i Tij, por gjatë rrugës ai vdes, shpërblimi për atë është tek Allahu...**”<sup>3</sup>

O Zoti im, më bë prej atyre që emigrojnë te Ti dhe te i Dërguari Yt! Bëj që ne të arrijmë fundin në të vërtetën! Mbarësoje Fatijin dhe Ahmedin, që të arrijnë kënaqësinë Tënde dhe lumturinë!

O Zoti im! Mjeti i udhëtimit tonë është shumë i vogël, që ne të arrijmë në sheshin e pastërtisë Tënde; edhe dora jonë është e shkurtër, që të kërkojmë të arrijmë kënaqësinë Tënde... perdja e dëshirave dhe e shkujdesjes nuk i lejon sytë tanë të shikojnë bukurinë Tënde...; mbulesat e shejtanit dhe dashuria e tepruar dhe

---

<sup>1</sup> Në origjinalin persisht ka ardhur: “ky hero dhe ky shesh beteje”; kurse ne e kemi dhënë me ekuivalentin e proverbit arab origjinal.

<sup>2</sup> Shpjegimi i qëllimit me “katër tekbiret” do të jepet në vijim.

<sup>3</sup> Sure “En-Nisà”, ajeti 100.





shumë e rëndë për këtë botë i kanë zbratur zemrat tona për t'iu drejtuar madhësisë Tënde.

Rruga e Botës së Ardhshme është e ngushtë e shumë e hollë, por udha e njerëzimit është edhe më e hollë. Ne jemi të turbulluar e të pamundur dhe ashtu, të pafuqishëm, mbështillemi si merimanga me mendimet tona, i thurim fijet e dëshirave e të shpresave rreth vetes si krimbi i mëndafshit, duke u shkëputur me këtë mbyllje plotësisht prej botës së panjohur dhe prej shoqërisë njerëzore. Prandaj, nuk kemi gjë tjetër në dorë, përveç të shpresojmë në bujarinë Tënde. Me shkëlqimin Tënd të ndriçosh sytë e zemrat tona dhe me një thëngjill drite prej botës së panjohur bëj që ne të mos hutohemi prej vetvetes!

*“Zoti im, dhuro për mua, që përfundimi im të jetë vetëm në Ty! Ndriçoji sytë e zemrave tona me shkëlqimin e shikimit të syve tanë në Ty! Bëj që sytë e zemrave të grisën perden që pengon dritën e madhësitinë, deri sa shpirtrat tanë të bëhen të lidhur me madhësitinë e pastërtisë Tënde...!”<sup>1</sup>*

Para disa ditësh, me aq sa munda, shkrova një kumtesë në lidhje me sekretet e namazit<sup>2</sup>, por, meqenëse ajo kumtesë nuk ishte e përshtatshme për gjendjen e njerëzve të zakonshëm, mendova të shkruaj një pjesë prej etikës së këtij miraxhi shpirtëror, me shpresën që të jetë këshillë e kujtesë për vëllezërit e mi besimtarë, duke shpresuar që puna ime do të tronditë zemrën time të ashpër. Këtë radhë unë e kam vënë në parathënien e në mbylljen e çdo kumtese. Kërkoj mbrojtje te Allahu i Lartësuar! Vetëm Atij i kërkoj të më ruajë

<sup>1</sup> Pjesë prej “El Munâxhâtu Esh Sha’bâniy’jeh” – “Meditime në muajin shaban”, lexo “Bihârul Enuâr”, vëll. 91, f. 99, si dhe “Mefâtijhul Xhinân”, f. 156.

<sup>2</sup> E ka fjalën për librin “Sekretet e namazit”, shkrimin e të cilit e përfundoi më datë 21 të muajit rabij’ul Eu’uel të vitit 1358 hixhri.



## Etika e namazit

---

e të më mbrojë nga lënia në katër rrugët dhe nga sundimi i shejtanit!  
Pa dyshim, vetëm i Larti është Ndihmësi, Fuqiploti.

Selam!

2 Safer 1405 hixhri

**Rùhull'Ilàh El Musauij Khomeini**



## PARATHËNIE

Dije se për namazin ka një kuptim ndryshe nga forma e faljes së tij. Gjithashtu, dije se namazi, përveç anës së tij të jashtme, ka edhe anën e tij të brendshme.

Ka rregulla për anën e jashtme të faljes së namazit dhe shkelja e këtyre rregullave, ose çon në pavlefshmërinë e namazit, ose çon në faljen e namazit me mangësi. Gjithashtu, edhe për anën e brendshme të namazit ka rregulla, shkelja e të cilave çon në pavlefshmërinë morale të namazit, ose çon në mangësinë morale të namazit. Zbatimi i përpiktë i rregullave të faljes së namazit bën që për namazin të ketë një shpirt prej botës së padukshme. Për atë që fal namaz dhe tregon kujdes të madh në faljen e tij, ai ka pjesë prej “sekretit hyjnor” të namazit të atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul ma’rifeh), të zotëruesve të zemrave, pasi me këtë namaz kënaqen sytë e atyre që ecin në Rrugën e drejtë dhe ky namaz është e vërteta e miraxhit, që të çon pranë të Dashurit.

Për sa i përket fjalës që thamë më sipër, se namazi ka anën e tij të brendshme dhe një formë të panjohur shpirtërore, përveç të tjerave, kjo fjalë është në përputhje me një model prej modeleve të nxjerrjes së argumenteve. Gjithashtu, përputhet edhe me dëshmitë e atyre që ecin në rrugën e drejtë dhe të praktikuesve. Shumë ajete të Kur’anit Famëlartë dhe shumë prej haditheve të ardhura e



vërtetojnë këtë pohim në përgjithësi, ose e pohojnë atë në veçanti. Tani le t'i parafundojmë këto faqe me disa ajete kur'anore dhe hadithe të nderuara.

Allahu i Lartësuar thotë :

"يَوْمَ نَجِدُ كُلَّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُّحْضَرًا وَمَا عَمِلَتْ مِنْ سُوءٍ تَوَدُّ لَوْ أَنَّ بَيْنَهَا وَيَمِينَهُ أَمْدًا بَعِيدًا"

*"Jeume texhidu kul'lu nefsin mà amilet min khajrin muhdaren ue mà amilet min sùin teved'du leu en'ne bejnehà ue bejnehù emeden beijden..."*  
-**"Ditën kur çdo njeri gjen pranë vetes punën e mirë ose të keqe që ka bërë, atëherë do të dëshirojë që ndërmjet atyre (punëve) dhe ndërmjet tij të shtrihej një kohë sa më e largët..."**<sup>1</sup>

Ky ajet i nderuar argumenton shumë qartë, se çdo njeri do të shikojë pranë vetes punët e tij të mira e të këqija, madje do të dallojë edhe formën e brendshme të panjohur të punëve që ka bërë.

Allahu i Lartësuar thotë:

"وَوَجَدُوا مَا عَمِلُوا حَاضِرًا"

*"...ue uexhedù mà amilù hàdiren..."*-**"...dhe do t'i gjejnë pranë vetes punët që kanë bërë ..."**<sup>2</sup>

Gjithashtu, thotë:

"وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ. فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ حَيْرًا يَرَهُ"

<sup>1</sup> Sure "Àli Imràn", ajeti 30.

<sup>2</sup> Sure "El Kehf", ajeti 49.



*"Femen jaëmel mithkàle dherr'rretin khajren jerehù. Ue men jaëmel mithkale dherr'rretin sherr'rren jerehù" - "Dhe kush punoi një të mirë, që peshon sa një grimcë, atë do të gjejë. Dhe kush punoi një të keqe, që peshon sa një grimcë, atë do të gjejë."*<sup>1</sup>. Ka edhe shumë ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë, që flasin për këtë çështje.

Edhe hadithet që flasin për këtë çështje, janë shumë, madje janë aq shumë, sa nuk mund të futen në këto faqe, prandaj do të mjaftohemi të përmendim vetëm disa prej këtyre haditheve:

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Kush i fal namazet farz në fillim të kohës së caktuar për faljen e namazeve, duke zbatuar të gjitha rregullat e faljes së namazit, këtë namaz engjëlli e ngre lart në qiell të bardhë e të pastër dhe namazi thotë: 'Allahu të ruajttë! Ashtu siç pate kujdesin të më falësh në kohën e caktuar, edhe Allahu të dhëntë një rojë, ashtu siç më dorëzove ti mua te një engjëll i nderuar'. Por, kush e fal namazin, pas kohës së caktuar për faljen e atij namazi, pa pasur ndonjë pengesë dhe nuk ka zbatuar rregullat e faljes së namazit, engjëlli këtë namaz e ngre lart të zi e të errët dhe namazi i thërret falësit të namazit me përçmim: 'Ti më humbe mua, prandaj Allahu të humbtë, ashtu siç më humbe ti mua! Allahu mos të marrtë nën kujdesin e Tij, ashtu siç nuk pate ti kujdes për mua!'"*<sup>2</sup>

Ky hadith tregon se engjëjt e Allahut e ngrenë namazin lart në qiell, të pastër e të bardhë, kur namazi është falur në fillim të kohës së caktuar për faljen e atij namazi dhe kur janë ruajtur rregullat e faljes së tij. Në këtë gjendje, namazi lutet për mirësi për namazfalësin. Engjëjt e Allahut e ngrenë namazin lart në qiell, të errët, kur është vonuar falja e tij, pa pasur ndonjë pengesë dhe nuk

---

<sup>1</sup> Sure "Ez Zelzeleh", ajetet 7-8.

<sup>2</sup> "Uesàilu Shij'ah", vëll. 3, f. 90; "Kitàbu salàti", "Ebuàbul mevàkij", K. 3.



është falur sipas rregullave. Në këtë gjendje, namazi e mallkon namazfalësin.

Hadithi përmban një argument të qartë, që vërteton se për namazin ka forma shpirtërore të padukshme. Gjithashtu, ai tregon për ekzistencën e jetës për namazin. Pa dyshim që këtë çështje e vërtetojnë ajetet kur'anore dhe hadithet, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

"وَإِنَّ النَّارَ لَأَخْرَجَ لَهَا الْحَيَوَانَ"

"...ue in'ne-d'dàrel-àkhirete lehijel-hajevànu..." - "**...pa dyshim Bota Tjetër është jeta e vërtetë...**"<sup>1</sup>

Në lidhje me këtë çështje, ka edhe shumë hadithe të tjera, që përforcojnë kuptimin e hadithit të lartpërmendur dhe e lehtësojë punën për ne, që të mos zgjatem, duke përmendur edhe hadithe të tjera. Në një hadith tjetër të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë se ai ka thënë: "*Kur besimtari vihet në varr, namazi është në të djathtën e tij, zekati është në të majtën e tij, kurse punët e mira janë të shtrira mbi atë, ndërsa durimi qëndron mënjanë. Kur te i vdekuri vijne dy engjëjt, që do ta marrin atë në pyetje, durimi i thotë namazit e zekatit: 'Përgjigjuni ju për të dhe, nëse ju nuk keni mundësi të përgjigjeni, atëherë, në vend të tij, do të përgjigjem unë'*"<sup>2</sup>

Ky hadith, të cilin e ka transmetuar El Kulenij në librin "El Kàfi", me dy rrugë, si dhe Es Saduku (*Allahu e mëshiroftë!*), në librin "Theuàbul A'màli", argumenton qartë ekzistencën e formave të

---

<sup>1</sup> Sure "El Ankebüt", ajeti 64.

<sup>2</sup> "Usùlul Kàfi", Libri "Besimi dhe mohimi", K. "Durimi", Hadithi 8; "Theuàbul A'màli", f. 203.



fshehta të punëve në botën e Berzahut dhe që ato punë kanë jetë e ndjenja.

Janë të shumta hadithet që flasin rreth paraqitjes së Kur'anit e të namazit, në forma të njohura.

Për namazin dhe për të gjitha adhurimet e tjera ka edhe rregulla të zemrës, përveç rregullave klishe dhe namazi, pa këto rregulla të zemrës, mbetet i mangët, ose në thelb nuk pranohet te Filluesi i të gjitha krijesave. Me dashjen e Allahut, më poshtë do t'i shpalosim këto rregulla, kur të flasim për rregullat e zemrës.

Këtu duhet të theksohet se mjaftimi i faljes së namazit vetëm me rregullat sipërfaqësore dhe me "lëvozhgën" e tij dhe zhveshja e privimi prej begative e prej plotësimeve të brendshme të namazit, begati e plotësime që jo vetëm e bëjnë të detyrueshme lumturinë e përjetshme, por mundësojnë edhe arritjen e fqinjësisë pranë Zotit të Gjithëfuqishëm, këto rregulla janë shkallë për t'u ngjitur lart, për të arritur në praninë e të Dashurit Absolut. Pikërisht, ky është qëllimi i lartë i shpresave të eulijave dhe caku më i largët i dëshirës së atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të atyre që zotërojnë zemrat, madje është kënaqësia e syve të Zotërisë së të Dërguarve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nëse namazi do të jetë i bazuar vetëm në anën e jashtme, atëherë kjo është prej shkallëve më të thepisura të humbjes e të dëmit që i vjen njeriut, pasi ai të lërë këtë jetë dhe të ballafaqohet me llogaridhënien përpara Allahut dhe me forma të tjera mjerimi, të cilat ne s'kemi mundësi t'i perceptojmë se ç'ka në atë Botë, sepse vazhdojmë të jemi nën mbulesën e botës së pasurisë dhe nën anestezinë e natyrës, prandaj e gjitha ajo që ne kemi mundësi të bëjmë, është të shtrijmë duart drejt zjarrit dhe të ngrohemi nga larg.



Cila brengosje, pendim e humbje do të ishte më e rëndë e më ashpër se sa kur mjeti i plotësimit të lumturisë së njeriut dhe ilaçi i mjekimit të mangësive e sëmundjeve të zemrës së tij, që në të vërtetë është forma e plotësimit për njeriun, kur njeriu shikon se ky mjet, pas dyzet ose pas pesëdhjetë vjetësh kujdesi e mundi të pandërprerë, të mos çojë në arritjen e asnjë dobie shpirtërore në mënyrë absolute? A është punë e lehtë, që ky mjet të bëhet shkak për turbullirën e zemrës dhe një perde e errësuar, në një kohë që namazi ishte kënaqësia e syve të të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse për ne të bëhet shkak për të dobësuar vështrimin tonë?

"يَا حَسْرَتِي عَلَى مَا فَرَّطْتَنِي جُنْبَ اللَّهِ"

**"...jà hasretà alà mà ferr'rrat'tu fij xhenbi-l'làhi..." - "...i mjeri unë që kam lënë mangët respektin ndaj Allahut..."<sup>1</sup>**

Atëherë, o i dashur, shtrëngoje rripin e vendosmërisë dhe shtrije dorën e lyp, shpejto të përmirësosh gjendjen tënde, sado punë, mund e vështirësi që do të kërkojë ky përmirësim. Puno me zell për realizimin e kushteve shpirtërore të namazit, që edhe namazi yt të jetë si namazi i atyre që kanë arritur gradën e njohjes (*ehlul ma'rifeh*). Përfito prej këtij ilaçi hyjnor, që të mjekosh me të sëmundjet e shpirtit e mangësitë e tij.

Pastroje shpirtin dhe me të emigro prej shtëpisë së errësirës, brengosjes e pendimit dhe shpëtoje shpirtin prej kësaj humnere të thellë dhe të largët prej sheshit të pastër hyjnor. Këtë bëje, deri sa koha është e mjaftueshme dhe me shpirtin tënd vazhdoje miraxhin,

---

<sup>1</sup> Sure "EzZumer", ajeti 56.





deri sa të arrish pranë plotësimit. Por, nëse ky mjet të del nga dora, atëherë dije se ti vetë e ke ndërprerë rrugëtimin: “nëse është pranuar namazi, janë pranuar edhe punët e tjera dhe, nëse namazi është refuzuar, janë refuzuar edhe punët e tjera”.<sup>1</sup>

Më poshtë do të shpjegojmë rregullat e brendshme të kësaj rruge shpirtërore, patjetër, me aq sa do të kemi mundësi dhe me aq sa është e nevojshme, duke shpresuar se ky shpjegim të bëhet pjesë edhe për disa besimtarë. Gjithashtu, shpresojmë se vetë vëllai besimtar do të bëhet shkak për zbritjen e mëshirës hyjnore dhe të furnizimeve hyjnore mbi këtë person, që ka ngelur prapa në rrugën e lumturisë e të humanizmit, të këtij të vonuari, që rënkon nga pesha e rëndë e prangave në burgun e natyrës e të egoizmit. Pa dyshim, vetëm Allahu është Zotëruesi i mirësisë e i kujdesit.

---

<sup>1</sup> Lexo librin “Men lâ jahduruhul Fakijhu”, vëll. 1, K. “Mirësia e namazit”, Pjesa 30, Hadithi 15, në të cilin lexojmë: “Puna e parë, për të cilën do të merret në llogari njeriu, është namazi. Nëse namazi pranohet, pranohen edhe të gjitha punët e tjera të tij; nëse namazi nuk pranohet, atij nuk i pranohen as punët e tjera që ka bërë”.



## ARTIKULLI I PARË

# RREGULLA TË DOMOSDOSHME PËR TË GJITHA GJENDJET E NAMAZIT, PËR TË GJITHA RITUALET DHE PËR TË GJITHA ADHURIMET

### Ndarja e parë

## MADHËSHTIA E ZOTIT DHE PËRULJA E ROBËRISË

Njëri prej rregullave të zemrës, që kërkohet në adhurime dhe njëra nga detyrat e brendshme, për atë që ecën në rrugën e Botës Tjetër, është: të ketë në vëmendje madhësinë e Zotit dhe përuljen e robërisë. Pikërisht, pasja në vëmendje e kësaj të vërtete është prej pozitave shumë të rëndësishme për atë që ecën në rrugën e Botës Tjetër. Fuqia e veprimit të atij që ecën në rrugën e Botës Tjetër mbështetet mbi faktin se sa e fuqishme është kjo “vëmendje”, madje edhe plotësimi i humanizmit të njeriut, ose mangësia e humanizmit



të tij, është e lidhur me këtë fakt, se sa e plotë, ose sa e paktë është kjo vëmendje. Sa herë që te njeriu bëhet zotërues vetja e tij, orientimi e kthimi i vëmendjes te vetja, te egoizmi, te vetëpëlqimi e te mendjemadhësia, aq më larg është ai prej plotësismit njerëzor dhe aq më larg është ai prej pozitës së afrimit te Zoti.

Në të vërtetë, mbulesa e vetëpëlqimit dhe e mendjemadhësisë është mbulesa më e trashë e më e dendur, është mbulesa më e errët dhe më e vështirë për t'u grisur. Grisja e çartja e kësaj mbulesë numërohet parathënie. Gjithashtu, çarja e grisja e kësaj mbulesë, është çelësi i çelësave të së padukshmes dhe të së dukshmes, është njëra prej portave të ngritjes lart drejt plotësismit shpirtëror.

Deri sa njeriu, në vetvete, vazhdon të vështrojë nga të gjitha anët dhe është i përforcuar të shkojë drejt plotësismit e bukurisë iluzionare, ai njeri është i mbuluar dhe është larg plotësismit absolut, është larg plotësismit të mirëfilltë, prandaj dalja prej kësaj banese, është kushti i parë prej kushteve të rrugëtimit për tek Allahu i Lartësuar, madje si përkufizim, është kusht dallues ndërmjet praktikimit të së vërtetës dhe të së gabuarës.

Çdo rrugëtar i mbledh pozitat e veta me hapat e egoizmit, të vetëpëlqimit e të mendjemadhësisë dhe ecën me mbulesën e të tanishmes e të dashurisë për veten. Në këtë gjendje, ushtrimi është i gabuar, prandaj edhe rrugëtimi i tij nuk është rrugëtim për tek Allahu i Lartësuar. Në të kundërt, rrugëtimi i tij është rrugëtim te vetvetja<sup>1</sup>, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

---

<sup>1</sup> Përkthim në gjuhën arabe i një vargu të poetit Xhelaludin Rumi.



"وَمَنْ يَخْرُجْ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِمْ يُدْرِكُهُ الْوَيْثُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ"

"...ue men jakhruxh min bejtihî muhàxhiren ile-ll'Ilàhi ue resùlihi thum'me judrikhul-meutu fekad veka' exhruhù ale-ll'Ilàhi..." - "**...dhe ai që del prej shtëpisë së vet për të emigruar tek Allahu e tek i Dërguari i Tij, por vdes (gjatë rrugës), shpërblimi për atë është tek Allahu...**"<sup>1</sup> "Emigrimi formal" dhe "forma e emigrimit" janë emigrim me trup prej banesës materiale për në Qabe, ose për shembull edhe në varret e eulijave; kurse emigrimi moral është dalja prej "shtëpisë së vetes" dhe prej "banesës në këtë botë", me qëllimin e vetëm për të shkuar tek Allahu e tek i Dërguari i Tij. Në këtë kuadër, edhe emigrimi për të shkuar tek i Dërguari (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ose te një eulija, gjithashtu, është emigrim për tek Allahu i Lartësuar.

Për aq kohë sa rrugëtari është i lidhur me veten e tij, ai orientohet kah e tanishmja, prandaj ai nuk është udhëtar, deri sa sheh se ndikimet e egoizmit dhe muret e qytetit të vetes së tij janë më këmbë, prandaj ai dëgjon vetëm thirrjen e dashurisë për veten, domethënë, se ai është nën sundimin e të tanishmes, për rrjedhojë, ai nuk është as udhëtar e as emigrues. Në librin "Misbàhu Esh Sherij'ati", citohet se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Robëria është përmbajtja dhe thelbi i saj është hyjnorja. Ajo që humb në robëri, gjendet te hyjnorja dhe ajo që mbetet e fshehur te hyjnorja, është disfatë te robëria".<sup>2</sup>

Ai që ecën me hapin e robërisë dhe e djeg ballin me thëngjijtë e përlules së robërisë, arrin madhështinë e hyjnore, pasi arritja në

<sup>1</sup> Sure "En Nisà", ajeti 100.

<sup>2</sup> "Misbàhu Esh Sherij'ati", Pjesa "Fi hakikati el ubudijeh", K. 100.



të vërtetat e hyjnore, bëhet realitet vetëm me ecjen nëpër shkallët e robërisë. Ajo që humb te robëria, prej të tanishmes e prej egoizmit, arrihet nën hijen e mbrojtjes së hyjnore. Kur arrihet kjo pozitë, i Vërteti, i Lartësuarit është veshi, syri, dora e këmba e këtij rrugëtari, ashtu siç theksohet kjo e vërtetë në hadithin e mirënjohur në të dyja grupimet.<sup>1</sup>

Kur rrugëtari në rrugën e të Vërtetit, Fuqplotit, lartësohet në shkallën më të lartë, ai zhvishet prej kompetencave të veta, punën e trupin e tij ia dorëzon plotësisht qeverisjes së të Vërtetit të Lartësuar; punët e shtëpisë ia ngarkon të zotit të shtëpisë dhe asgjësohet në madhësinë e hyjnore, atëherë i zoti i shtëpisë së tij do të bëhet veprues në punët e tij. Pikërisht në këtë stad, veprimet e rrugëtarit për tek Allahu do të jenë hyjnore dhe syri i tij bëhet hyjnor, atëherë, ai sheh me syrin e të Vërtetit; edhe veshi i tij bëhet hyjnor dhe dëgjon me veshin e të Vërtetit.

Edhe e kundërta e këtij pohimi, gjithashtu, është e drejtë. Sa herë që hyjnizimi i vetes është i plotë dhe sa herë që madhështia e vetes merret në konsideratë, në të njëjtën masë pakësohet e mbetet e mangët edhe madhështia e robërisë për Zotin Krijues. Dhe, nga ky këndvështrim, këto të dyja janë dy kundërshti, ashtu siç thuhet në vargun: “dynjaja dhe Ahireti janë dy shemra”.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Tregon për hadithin kuds: “Afrimi me adhurime të vullnetshme”: “...ai do të afrohet te Unë me adhurimet e vullnetshme, deri sa Unë ta dua atë. Kur Unë ta dua atë, Unë jam veshi i tij, me të cilin ai dëgjon, jam syri i tij, me të cilin ai shikon, jam gjuha e tij, me të cilën flet dhe jam dora e tij, me të cilën kap. Nëse ai më thërret Mua, Unë i përgjigjem atij; nëse ai lyp prej Meje, Unë i jap atij...” Lexo librin “Usûlul Kâfi”; “El Imanu uel Kufuru”, vëll. 4, K. “Ai që i fyen e i urren myslimanët”, f. 53.

<sup>2</sup> “Nehxhul Belâga”, Fjalë të urta, Fjala 103, në të cilën thuhet: “...dynjaja dhe Ahireti janë armiq të barabartë, janë dy rrugë të ndryshme. Ai që e do dynjanë, e



Për të gjitha këto, për rrugëtarin për tek Allahu, mbetet domosdoshmëri, që ai ta kuptojë pozitën e përljes së vetes së tij. Gjithashtu, ai ka detyrë, që të mbajë gjithmonë parasysh “madhësinë e Zotit Krijues dhe përljen e robërisë” dhe të meditojë në lidhje me këtë. Sa herë që te rrugëtarin forcohet besimi në këtë parullë, aq më shumë shtohet shpirtërisht adhurimi i tij e aq më shumë forcohet fryma e adhurimit në të, deri sa me ndihmën e të Vërtetit të Lartësuar dhe me lutjet e eulijave të Tij të plotësuar, shtohet mundësia e rrugëtarit për të arritur në të vërtetën e robërisë e në esencën e saj. Pikërisht, atëherë rrugëtarin arrin një aromë prej parfumit të sekretit të adhurimit.

Të gjitha adhurimet, veçanërisht namazi, i cili ka cilësinë e përgjithësimin, në raport me të gjitha adhurimet dhe në dallim me adhurimet e tjera, namazi është pozita e plotë e njeriut, është pozita e emrit më të madh, madje është vetë emri më i madh që gjendet ndërmjet këtyre dy pozitave. Namazi është pozita e madhësisë e Zotit Krijues (dhe kjo është e vërteta), si dhe pozita e përljes së robërisë (e cila është robëresha e kësaj të vërtete dhe shërbëtorja e saj) – në mënyrë të veçantë me “*kunùtin*” në namazet e preferuara (*mustehab*) dhe në sexhdet, me namazet e detyrueshme (*farz*). Me dashjen e Allahut, më pas do të flasim, edhe për këtë çështje.

Këtu patjetër duhet të theksojmë se robëria absolute është prej gradave më të larta të plotësimin dhe prej pozitave më të larta të njerëzimit. Në këto pozita, asnjë njeri s’ka pjesë, përveç krijesës më të plotësuar të Allahut, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjithë eulijatë e plotësuar, që e kanë

---

merr atë për ndihmëse dhe e urren Ahiretin. Të dyja janë në pozitën e lindjes e të perëndimit dhe ai ecën ndërmjet të dyjave. Sa më shumë i afrohet njëres, po aq i largohet tjetrës. Ato të dyja janë dy shemra”.



ndjekur atë. Për sa u përket të tjerëve, përveç të lartpërmendurve, këmba e robërisë së tyre është e çalë, robëria e tyre është me sëmundje e pengesa për shkaqe të tjera. Është e pamundur të arrihet ngjitja në miraxhin e vërtetë e absolut, pa robërinë. Ne e dimë se robëria e plotë dhe tërheqja hyjnore ishin ato që e bënë të ecë atë shpirt të pastër dhe të ngjitet në lartësitë e afrimit e të arritjes, ashtu siç njofton për këtë Allahu i Lartësuar, me fjalën e Tij:

“سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَى بِعَبْدِهِ” - “*subhàne-l'ledhij esrà biabdihi...*” - **“Pa të meta e i madhëruar është Ai që e çoi robin e Vet...”**<sup>1</sup> Patjetër që robëria e tij ishte edhe para se ai të ngarkohej me detyrën e kumtimit të mesazhit. Robëria është në këndimin e “Tesh'shehudit” në namaz, i cili përfaqëson kthimin prej asgjësimit absolut, i realizuar në sexhde. Patjetër që në këtë gradë të robërisë theksohet edhe pozita e “Mesazhit”, me rezultatin e tij, që është fryti i thelbit të robërisë. Në lidhje me këtë, çështja ka shkoqitje të gjata, që dalin jashtë kuadrit të detyrës së veçantë të këtyre faqeve.

---

<sup>1</sup> Sure “El Isrà”, ajeti 1.



## Ndarja e dytë

# GRADËT E POZITAVE TË RRUGËTARËVE NË UDHËN E ALLAHUT

Mëso se rrugëtarët në udhën e Allahut, nisur nga pozita “e përluljes së robërisë dhe madhësisë së Zotit Krijues”, janë në gradë e në shkallë të panumërta, por këtu, në mënyrë të përmbledhur, do të përmendim vetëm disa prej këtyre gradëve e shkallëve. Njohja me të gjitha gradët dhe numërimi i këtyre gradëve e tejkalon mundësinë e këtij të varfëri, pasi “rrugët për tek Allahu janë sa numri i krijesave”.<sup>1</sup>

Njëra prej këtyre gradëve është grada e diturisë, pasi “përlulja e robërisë dhe madhështia e Zotit Krijues” vërtetohet me linjën e diturisë dhe të argumentimit filozofik. Njëra prej pjesëve më të mira të diturive, të cilat i ndriçojnë shkencat e larta dhe urtësia sipërore, tregojnë se: në mes të shtëpisë së vërtetimit dhe rrethit të ekzistencës, me tërësinë e tij, ka një lidhje të mirëfilltë, ashtu siç ka edhe varfëri e miratim, kurse madhështia, sundimi e pushteti, pa dyshim, i takojnë vetëm madhësisë së pastër të Allahut. Askush s’ka pjesë në këtë madhëri e madhështi. Me

---

<sup>1</sup> I atribuohet Profetit më të nderuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Lexo librin “Xhàmiul Esràri ue Menbeul Envuàri”, i autorit Sej’jid Hajdar El Àmulij, f. 8, 95 dhe f. 121.





përuljen e robërisë e me varfërinë emërtohen e përshkruhen të gjitha krijesat, pasi rrënjët e kësaj varfërie shtrihen në vetë thelbin e të vërtetës së njerëzve; ndërsa e vërteta e njohjes, dëshmitarët dhe rezultati i shpresuar prej ushtrimeve dhe prej rrugëtimit, është heqja e mbulesës prej fytyrës së të vërtetës, është shikimi i formësimit të “përuljes së robërisë”, është shikimi i formësimit të origjinës së “varfërisë”, është edhe “varësia” e njeriut me vetveten e në të gjitha qeniet. Në këtë kuadër, ka mundësi që lutja, e cila i atribuohet zotërisë së të gjitha qenieve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “O Zoti im, bëj që unë t’i shoh sendet siç ato janë.”<sup>1</sup> tregon pozitën e kërkesës së shikimit me sy të përuljes së robërisë, e cila, nga ana e saj, është dëshmitare e madhësisë së Zotit Krijues.

Atëherë, rrugëtari në udhën e vërtetë dhe udhëtari në rrugën e robërisë, i cili e njeh këtë pozitë, në saje të hapave të hedhura në rrugën e diturisë dhe për faktin se i ka hipur anijes së lundrimit mendor – ai, shumë shpejt, do të jetë nën mbulesën e diturisë dhe do të arrijë pozitën e parë të njerëzores. Por kjo mbulesë është prej mbulesave të trasha, ashtu siç kanë thënë: “dituria është mbulesa më e madhe”, prandaj rrugëtari në udhën e Allahut ka detyrë të mos qëndrojë nën hijen e mbulesës së diturisë, por ta grisë këtë mbulesë dhe, kur ai nuk është i kënaqur me këtë pozitë e me mbajtjen mbyllur të zemrës me këto pranga, shumë shpejt do të ballafaqohet me afrim e me lëvizje, hap pas hapi.

---

<sup>1</sup> Shih “Et Tefsijrul Kebijr” i Fakhru Raziut: vëll. 2, f. 26. Në të thuhet: Na bëj t’i shohim sendet ashtu siç janë. “’Auiliju El Lealij”: vëll. 4, f. 132: O Zot! Na bëj t’i shohim të vërtetat ashtu siç janë.



Afrimi e lëvizja, hap pas hapi, në këtë pozitë, është marrja me përkufizimet shkencore, është lëshimi i frerit të memories për sjelljen e argumenteve të shumta, në lidhje me këtë punë, megjithëse, me këtë mënyrë veprimi, rrugëtari privohet prej pozitave të tjera dhe zemra e tij mbetet e varur vetëm me këtë pozitë, për rrjedhojë, ai nuk interesohet dhe anashkalon objektivin e synuar për të arritur në “oborrin” e Allahut, duke e kaluar jetën e vet nën mbulesat e argumentit dhe degëzimeve të argumentit. Sa më shumë shtohen degët, aq më e madhe e më e fortë bëhet mbulesa para të vërtetës.

Atëherë për rrugëtarin në udhën e Allahut, që ka arritur në këtë pozitë, mbetet detyrë të mos mashtrohet prej kurtheve të shejtanit, ndryshe ai do të mbetet i mbuluar e nuk do të shikojë të Vërtetin dhe të vërtetën, as me anë të diturive të shumta, as me instinktin e tij, as me forcën e argumentit dhe, përfundimisht, do të mbetet prapa në përpjekjet e tij për të kërkuar. Për të gjitha këto, për rrugëtarin në udhën e Allahut mbetet detyrë të logjikojë me vullnet të plotë dhe të mos jetë i shkujdesur, por të synojë me seriozitet, që të arrijë të Kërkuarin e vërtetë dhe kështu të vazhdojë, deri sa të lartësohet në pozitën e dytë, pozitë që realizohet, kur rrugëtari në udhën e Allahut, me forcën e argumentit e me rrugët e diturive, të pasqyruara në faqen e zemrës së tij, shkruan me lapsin e logjikës gjithçka arrin ta kapë mendja e tij. Pa dyshim që me këtë ngulmim, rrugëtari në udhën e Allahut arrin të vërtetën e “përruljes së robërisë dhe madhëstisë e Zotit Krijues”. Pikërisht, kjo arritje e çliron atë prej prangave të diturisë e prej mbulesës së saj. Me dashjen e Allahut, në vijim do të trokasim mbi këtë pozitë.



Në këtë gjendje, fryti i pozitës së dytë, është arritja e besimit në të vërtetat, kurse pozita e tretë, që është pozita e sigurisë së zemrës dhe e qetësisë së zemrës, pa dyshim që kjo siguri e qetësi e zemrës është grada e besimit të plotë, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar, drejtuar Ibrahimit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*): “أَوَلَمْ نُؤْمِنُ قَالِ بَلَىٰ وَلَكِنْ لِيَطْمَئِنَّ قُلُوبِي”: “...evelem tuëmin kale belà ue lâkin lijetmein'ne kalbij ” - **“A nuk e beson? Ai (Ibrahimi) tha: ‘Patjetër, por dua që zemra ime të jetë e qetë...’”**<sup>1</sup>. Në një vend tjetër të këtij libri do ta theksojmë edhe këtë gradë.

Pozita e katërt është ajo e “shikimit me sy”. Kjo pozitë është dritë hyjnore dhe hijeshi e të Gjithëmëshirshmit, dritë e hijeshi që shfaqet në sekretin e rrugëtarit në udhën e Allahut. Ky shkëlqim është në vazhden e shkëlqimit të emrave dhe të cilësive. Me këtë shkëlqim, rrugëtari në udhën e Allahut ndriçon të gjitha anët e tij me dritën e formësuar, të cilën ai e shikon me sytë e vet. Pa dyshim që edhe për këtë pozitë ka shkallë të shumta, por vendi këtu nuk është i mjaftueshëm, që t’i përmendim. Gjithashtu, në këtë pozitë del në shesh njëra anë prej anëve të “afritit me adhurimet e vullnetshme”: “...Unë jam veshi i tij, syri i tij dhe dora e tij...” Në këtë pozitë, rrugëtari në udhën e Allahut e shikon veten të zhytur në një det pa anë e pa cak dhe pas këtij deti, ka një det tjetër, thellësia e të cilit nuk matet dot. Pikërisht në këtë det zbulohen disa prej sekreteve të “fuqisë”.

Në çdo njëren prej këtyre pozitave ka një lloj shkallëzimi të veçantë për shkallën përkatëse. Por kjo e ekspozon rrugëtarin për në udhën e Allahut para një shkatërrimi të madh. Prandaj detyra e

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 260.



tij është ta pastrojë veten prej të gjitha ngjyrave të egoizmit dhe të lidhjes së tij me të tanishmen. Gjithashtu, ai ka detyrë të mos jetë prej atyre që pëlqejnë veten e prej atyre që duan e mahniten me veten e tyre, pasi këto lloje dashurish e mahnitjesh janë burime për shumë shkatërrime dhe, në mënyrë të veçantë, për shkatërrimin e vetë rrugëtarit. Me dashjen e Allahut, më pas do të rikthehemi në këtë çështje.



## Ndarja e tretë

### NËNSHTRIMI

Prej punëve të domosdoshme për rrugëtarin në udhën e Allahut dhe për të gjitha adhurimet, veçanërisht për namazin, që është kreu i të gjitha adhurimeve dhe mbartës i cilësive për të gjitha adhurimet, është përlulja. Përlulje do të thotë nënshtrim i plotë, i përzier me dashuri e me frikë.

Në shkoqitje të kësaj: zemrat e rrugëtarëve në udhën e Allahut janë të ndryshme, sipas karakterit dhe cilësisë së pastër të krijimit. Disa zemra janë “të dashuruara” dhe përfaqësojnë një rëndësi prej dukurive të bukuri. Ato janë të brumosura e të krijuara me cilësinë që të priren kah bukuria e të Dashurit. Këto zemra, gjatë rrugëtimit për në udhën e Allahut, sapo të futen në hijen e bukuri, ose sapo të shikojnë origjinën e bukuri, menjëherë i shuan madhështia, që është brenda në sekretin e bukuri dhe i bën të tronditen. Çdo “bukuri” ka brenda “madhështi” dhe çdo “madhështi” është një “bukuri” e mbuluar.

Kjo është e qartë në fjalën e zotërisë së atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të rrugëtarëve në udhën e Allahut, Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut: *“Pa asnjë të metë e pa asnjë mangësi është Ai.*



*Mëshira e Allahut është shumë e madhe për miqtë e Tij, ashtu si edhe ashpërsia e ndëshkimit është e madhe për armiqtë e Tij*.<sup>1</sup>

Atëherë, nderimi i bukurisë e i madhështisë së Tij dhe fuqia e forca e Tij bëhen sunduese mbi ato zemra dhe i mbulojnë ato me një gjendje nënshtrimi, para bukurisë së të Dashurit. Kjo gjendje, në fillimin e punës, është turbullim e tronditje në zemër, por, pasi zemrat mblidhen, mundësohet që puna të merret në dorë dhe gjendja shndërrohet në një gjendje të atillë që jep “kënaqësi”, kurse frika e madhe e turbullimi, të ardhura prej forcës së madhështisë, shndërrohen në butësi e qetësi. Atëherë zemrat arrijnë gjendjen e sigurisë, plotësisht ashtu siç u qetësua edhe zemra e mikut të Gjithëmëshirshmit, Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në disa prej rrugëtarëve në udhën e Allahut, disa zemra janë “të frikësuara”, por ky frikësim përfaqëson njërën prej dukurive të madhështisë. Këto zemra janë në një gjendje të atillë, sa e kuptojnë në vijimësi madhështinë e madhërinë e të Lartit. Pikërisht në këtë gjendje, nënshtrimi i atyre është “frikë”, të cilën e fusin në zemrat e tyre shkëlqimet e emrave, që shprehin mposhtjen e madhështinë, siç ishte gjendja me Jahjanë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Nga sa u tha më sipër, rezulton se nënshtrimi, herë është i përzier me dashuri dhe herë tjetër është i përzier me frikë e me tmerr. Kjo do të thotë se në çdo dashuri ka frikë dhe në çdo frikë ka dashuri.

Për sa u përket gradëve të nënshtrimit, ato janë sipas shkallëve të kuptimit të madhështisë, mirësisë e bukurisë, ndërsa të

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belàga”, Hytbeja 89.



ngjashmit me gjendjen tonë të tanishme, janë të privuar prej dritës së shikimeve, prandaj për ne s'ka vendstrehim tjetër përveç arritjes së nënshtrimit ose me anën e rrugës së diturisë, ose me anën e besimit, ashtu siç njofton për këtë vetë Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij: "قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ" «*Kad eflëhal-muëminûne. El'ledhijne hum fij salâtihim khâshiûne*». - **“Me të vërtetë, besimtarët janë të shpëtuar ...të cilët në namazet e tyre janë në nënshtruar”**. Sure “Mu’minun”, ajetet 1-2.

Ajeti i nderuar e ka numëruar nënshtrimin në namaz prej shenjave dalluese të besimit dhe, bazuar në këtë fjalë të Allahut të Lartësuar, rezulton se ai që nuk është i nënshtruar, kur fal namazin, është jashtë grupit të besimtarëve të sinqertë. Kjo, gjithashtu, do të thotë se namazet tona, të falura pa nënshtrim, janë rezultat ose i besimit të paktë, ose i humbjes së besimit.

Nga sa u tha më sipër, rezulton se bindja e dituria nuk janë besimi, sepse dituria për të Vërtetin, për emrat e për cilësitë e Tij, te ne janë të fituara. Gjithashtu, te ne janë të fituara edhe të gjitha dituritë e tjera hyjnore. Por ky fitim i diturive nuk është besimi (ijman). Le të marrim për shembull shejtanin, i cili ka dituri, në lidhje me fillimin e krijimit dhe me Ringjalljen, ashtu siç e ka theksuar këtë të vërtetë Allahu i Lartësuar, megjithëkëtë, shejtani është mohues. Për më tepër, shejtani, edhe pse e njeh të Vërtetin e Lartësuar, përsëri ai e kundërshtoi, kur tha: “خَلَقْتَنِي مِنْ نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ” - **“...khalektenij min nàrin ue khalektehù min tijnin”** -“...mua më krijove nga Zjarri dhe atë e krijove nga balta”.<sup>1</sup> Kjo tregon që shejtani beson në Ringjalljen, beson në diturinë e të Vërtetit, beson edhe në

<sup>1</sup> Sure “El Arâf”, ajeti 12.



librat, në të Dërguarit e në engjëjt dhe këtë besim të shejtanit ne e shohim në fjalën e tij, kur i thotë Allahut të Lartësuar: “أَطْرُقِي إِلَى يَوْمِ يَمُوتُونَ” – “...endhirnij ilà jeumi jub'athùne”. - “...më jep afat deri ditën kur ata të ringjallen”.<sup>1</sup> Megjithëkëtë, Allahu i Lartësuar i drejtohet shejtanit me fjalën “kàfir” – “mohues” dhe e ka numëruar atë jashtë grupit të besimtarëve.

Nga sa u tha më sipër, rezulton se dijetarët dhe besimtarët dallojnë nga njëri-tjetri, domethënë se jo çdo dijetar patjetër duhet të jetë besimtar. Prandaj, për çdo rrugëtar në udhën e Allahut, pasi ka hyrë në rrugën e diturisë, për atë mbetet detyrë të jetë në grupin e besimtarëve dhe të bëjë që madhështia e të Vërtetit e bukuria e Tij të arrijë në zemrën e këtij rrugëtari, deri sa zemra e tij të jetë e nënshtruar, sepse vetëm dituria nuk çon në nënshtrim. Kjo e vërtetë është plotësisht ashtu siç e shikoni në veten tuaj: ju besoni në fillimin e krijimit, besoni në Ringjalljen dhe në madhësinë e të Vërtetit, megjithëkëtë zemrat tuaja nuk janë të nënshtruara.

Për sa i përket fjalës së Allahut të Lartësuar:

“أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ” – “E lem jeëni lil'ledhijne àmenù en takhshea kulùbuhum lidhikri-l'làhi ue mà nezele minel-hak'ki...” - “**A nuk është koha të nënshtrohen zemrat e atyre që besuan me këshillat e Allahut dhe me të vërtetën që zbriti...**”<sup>2</sup> - ka shumë mundësi që ky ajet i nderuar të tregojë për besimin e formësuar, të tregojë për besimin në Shpalljen, me të cilën erdhi Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), sepse besimi i vërtetë, detyrimisht, është i shoqëruar me një gradë prej

<sup>1</sup> Sure “El Aràf”, ajeti 14.

<sup>2</sup> Sure “El Hadid”, ajeti 16.





nënshtimit. Por ka mundësi që në ajetin e nderuar, qëllimi me nënshtimin të jetë nënshtimi në të gjitha gradët e tij të plota, ashtu siç ndodh në disa raste, kur “dijetar” cilësohet vetëm ai që ka tejkaluar cakun e diturisë së zakonshme dhe ka arritur kufirin e besimit. Gjithashtu, edhe ajeti tjetër i Kur’anit Famëlartë: “*الْعُلَمَاءُ إِذَا مَا يَتَّقِي*” – “...in’nemà jakhshe-ll’llàhe min ibàdihil-ulemàu...” - “...në të vërtetë ata që e kanë frikë Allahun nga robtë e Tij janë dijetarët...”<sup>1</sup>, thekson këtë shtresë prej dijetarëve.

Cilësitë e “diturisë”, “besimit” dhe “Islamit” thuhet në Librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), janë në shkallë të ndryshme për secilin. Shpjegimi i kësaj çështjeje është jashtë studimit tonë.

Rezultati: rrugëtari në udhën e Botës Tjetër, sidomos rrugëtari në “miraxhin” e namazit, duhet të jetë kërkues, që zemra e tij të bëhet e nënshtuar me dritën e diturisë dhe të besimit dhe kjo dhuratë hyjnore, me këtë rreze ndriçuese prej të Gjithëmëshirshmit, të ngulitet në zemrën e tij sa më shumë që të jetë e mundur, duke shpresuar se ai do ta ruajë këtë gjendje nënshtimi në të gjitha pjesët e namazit.

Kjo gjendje, për atë që i mundësohet nënshtimi dhe vijimi i këtij nënshtimi, pavarësisht se në fillim duket një punë e vështirë për të ngjashmit me ne, në të vërtetë, është qëllimi më i lartë që mundësohet me pak praktikë dhe me vaditjen e zemrës.

<sup>2</sup> Sure “El Fâtir”, ajeti 28.



Arritja e plotësimit dhe marrja e furnizimeve për udhëtimin në Botën e Ardhshme, kërkon dashuri, shpejtësi e shumë punë. Sa më i madh të jetë i kërkuari edhe serioziteti, edhe nxitimi në rrugën e këtij kërkimi është më i merituar.

S'ka dyshim se miraxhi i afrimit hyjnor dhe pozita e afrimit pranë Zotit të madhështisë, nuk arrihet as kur rrugëtari është në gjendje dobësimi, pakujdesie dhe as me lëshime e tolerancë. Në të kundërt, duhet qëndrim i vendosur e trimëri, për të arritur deri te i Krijuari. Ti që beson në Botën Tjetër, e di se ajo nuk mund të krahasohet me botën tonë, qoftë ky krahasim nga ana e lumturisë dhe e plotësimit, qoftë nga ana e vështirësive, që janë pasoja të punës së keqe të njeriut. Për sa i përket lumturisë dhe plotësimit, Bota e Ardhshme përfaqëson një botë të përhershme, në të cilën s'ka as vdekje e as asgjësim. I lumturi në Botën e Ardhshme është në qetësi, pushim e në madhësi, është në mesin e mirësive të përhershme dhe, të gjitha këto, nuk mund të kenë të ngjashëm në këtë botë tonë të tanishme, sepse Bota e Ardhshme është bota e madhështisë hyjnore, prandaj për Atë Botë nuk mund të gjendet shembull në botën tonë të tanishme, sepse në Botën e Ardhshme ka mirësi të atilla, që njeriut kurrë nuk i shkojnë as në mendje.

E këtillë është gjendja në Botën Tjetër, edhe nga ana e vështirësive, edhe nga ana e mjerimeve, prandaj për ashpërsinë e ndëshkimit e për vështirësitë e Botës së Ardhshme nuk mund të ketë shembull, që të krahasohet me ashpërsinë e vështirësive me botën tonë të tanishme.

Rruga për të arritur në lumturinë e përhershme, nuk mund të realizohet ndryshe, veçse me bindje ndaj Zotit Fuqiplotë dhe, nga tërësia e të gjitha bindjeve dhe e të gjitha adhurimeve, asgjë nuk



është i ngjashëm me namazin. Namazi është mjete ngjithës hyjnor e përgjithësues, që merr përsipër realizimin e lumturisë së përjetshme për njerëzit. Me fjalë të tjera, të gjitha punët janë peng për pranimin e namazit.

Për të gjitha këto, o i dashuri im, për ty mbetet detyrë stolisja me seriozitet të plotë, ashtu siç të bie detyrë të kryesh edhe shumë punë të tjera, pa humbur kohë, që ti ta arrish atë lumturi. Gjithashtu, në rrugën e arritjes së lumturisë së përjetshme kërkohet vazhdimësi në punë dhe përballim të vështirësive. Në të njëjtën kohë, dije mirë se në namaz s'ka vështirësi, kur ti e fal atë vazhdimisht, por mbaj në mendje se me namaz arrin edhe butësinë e zemrës. Gjithashtu, në këtë botë, me namazin, shumë shpejt do të arrish kënaqësinë e veçantë që ndien nga bisedimi intim me të Vërtetin. Kënaqësia që ti ndien prej kësaj bisede intime, s'mund të krahasohet me asnjë kënaqësi tjetër prej kënaqësive të Botës së Ardhshme. Pikërisht kjo është ajo që ndrit me qartësi prej leximit të gjendjeve të atyre që bisedojnë në vetmi me të Vërtetin e Lartësuar.

Thelbi i kësaj fjale është: Njeriu ka për detyrë ta kuptojë madhësinë e të Vërtetit, ta kuptojë bukurinë dhe madhësinë e pushtetit të Tij, qoftë me rrugën e argumentit, qoftë në saje të rrugës së asaj që kanë lënë trashëgim Profetët. Gjithashtu, njeriu ka për detyrë ta përgatisë zemrën, që të jetë e gatshme për kapjen e këtyre të vërtetave. Për njeriun, mbetet detyrë e vazhdueshme, që ai t'i mësojë zemrës nënshtrimin, hap pas hapi, me këshillë, duke e orientuar dhe duke vazhduar të përmendë madhësinë e madhërinë e të Vërtetit të Lartësuar, me qëllim që me këtë punë të arrihet rezultati i shpresuar.



Në përgjithësi themi: rrugëtari në udhën e të Vërtetit ka për detyrë të mos kënaqet me pozitën në të cilën është, pasi çdo pozitë e arritur prej të ngjashmëve me ne, te ata që kanë arritur gradën e njohjes, konsiderohet e barabartë sikur nuk ke asgjë, madje edhe te ata që i zotërojnë zemrat nuk mund të mblidhet as edhe një farëz e vogël.

Rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë, që, në të gjitha gjendjet, të mbajë në mendje e të kujtojë mangësitë e të metat e veta dhe të shpresojë se me këtë kujtesë për atë do të hapet rruga drejt lumturisë.

Falënderimi është vetëm për Allahun!



## Ndarja e katërt

### SIGURIA E ZEMRËS

Prej rregullave të rëndësishme të zemrës në adhurime, veçanërisht ato rregulla që dallohen me “dhiarin”, është që adhurimet të bëhen me besim të plotë e me sigurinë e zemrës. Por kjo siguri e zemrës është tjetër nga siguria që përmendin juristët e ligjit të fesë (*Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!*), sidomos për namazin, pasi kjo siguri tregon se rrugëtari në udhën e kryerjes së adhurimeve, i kryen ato me zemër të qetë dhe të sigurt.

Edhe pse udhëtari në udhën e Allahut i kryen të gjitha këto punë, përsëri ai është në një gjendje turbullimi të zemrës dhe nuk ka qëndrueshmëri. Në të vërtetë, zemra e tij kurrë nuk bashkëvepron me adhurimet dhe ai kurrë nuk arrin prej atyre adhurimeve asnjë ndikim në cilësitë e tij. Gjithashtu, në brendësi të zemrës së tij kurrë nuk do të pasqyrohet e vërteta dhe forma e brendshme e adhurimit. Në këtë gjendje, njëri prej synimeve të pritshme është përsëritja e adhurimit, bërja sa më shumë dhikër dhe ta bësh zemrën që të ndikohet me këto adhurime e dhikre dhe zemra të bashkëveprojë me to, deri sa e vërteta e dhikrit dhe e ibadetit të marrë formë, hap pas hapi, në brendësi të rrugëtarit në udhën e Allahut, atëherë zemra e tij bëhet njësh me shpirtin e adhurimit. Por, deri sa zemra nuk ka arritur cilësinë e sigurisë, të



qetësisë, të fortësisë e të seriozitetit, as dhikret nuk ndikojnë në atë zemër, prandaj ajo zemër kurrë nuk del prej kufijve të dukshëm dhe prej pronësisë së trupit, për të kaluar me cilësitë e shpirtit e të brendshmes së shpirtit. Gjithashtu, kjo zemër kurrë nuk do të arrijë pjesën e saj prej së vërtetës së adhurimit. Kjo çështje s'ka nevojë as për shkoqitje e as për qartësim, pasi, për të kuptuar këtë çështje, mjafton vetëm pak meditim.

Kur adhurimi është i atillë, që s'ka asnjë ndikim në zemër, edhe ndikimi i këtij adhurimi nuk është i dukshëm në brendësi, për rrjedhojë, ky adhurim kurrë nuk ruhet në botët e tjera dhe kurrë nuk do të lartësohet në botën e sundimit e të cilësive hyjnore. Në të kundërt, forma e këtij adhurimi (Allahu mos e lejoftë!) do të shuhet prej faqes së zemrës dhe do të zhduket në mënyrë të plotë në çastet e vështirësive të mëdha të vdekjes, në çastet e frikshme të agonisë dhe të vështirësive të rënda pas vdekjes. Rezultati do të jetë: në këtë gjendje, njeriu shkon në prani të të Vërtetit pa asgjë në dorë.

Kur dikush e përsërit dhikrin: “Là ilàhe il’le-ll’làh Muhamedun resùlu-ll’làh” - “S’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut”, ky njeri e ka mësuar zemrën e vet, që ajo të jetë e qetë dhe e siguruar, atëherë edhe gjuha e zemrës, gradualisht do ta përsërisë këtë dhikër, deri sa bëhet që edhe gjuha e jashtme e përsërit dhikrin e madhëruar, duke ndjekur gjuhën e zemrës. Kështu, zemra është e para që e përmend Allahun dhe pas saj e përsërit gjuha. Për këtë kuptim tregon edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*): “Menjëherë bëje zemrën tënde Kible për rrugëtarin në udhën e Allahut dhe



*mos e lëviz gjuhën pa shenjë prej zemrës, pa miratimin e mendjes dhe pa kënaqësinë e besimit”.<sup>1</sup>*

Në fillim të punës, kur gjuha e zemrës është e lidhur, atëherë rrugëtari në udhën e Botës së Ardhshme ka për detyrë ta mësojë zemrën e tij dhe le t'i diktojë asaj dhikrin, me bindje të plotë e me qetësi, deri sa zemra të bëhet zemër që bën dhikër, deri sa ajo zemër të zbukurohet me dhikrin madhor të lartpërmendur, deri sa nyja e gjuhës së tij të bëhet Kible jo vetëm për gjuhën, por për të gjitha gjymtyrët. Atëherë e gjithë mbretëria e ekzistencës njerëzore bën dhikrin e nderuar në ndjekje të dhikrit së kësaj zemre.

Nëse dhikri përsëritet pa qetësinë e pa sigurinë e zemrës, ose, kur ai dhikër përsëritet me nxitim, me turbullim dhe me shpërqendrim në ndjenja, kurrë nuk arrin në zemër ndonjë ndikim prej këtij dhikri, madje ky dhikër nuk e kapërcen kufirin e jashtëm të gjuhës e të dëgjimit kafshëror. Gjithashtu, ky dhikër nuk arrin as në të brendshmen e aparatit të dëgjimit njerëzor, për rrjedhojë, kurrë nuk arrihet e vërteta e dhikrit në brendësi të zemrës dhe as nuk bëhet për zemrën një formë e plotësuar, e qëndrueshme, me pamundësi që të zhduket. Bazuar mbi këtë që u tha, kur vjen koha e vështirësive të mëdha, veçanërisht vështirësitë e tronditjet në çastet e agonisë e në pragun e vdekjes, deri me daljen e shpirtit, në atë kohë shpirti njerëzor e harron plotësisht këtë dhikër të nderuar. Ky dhikër shuhet prej faqes së zemrës, madje shumë shpejt do të harrohet edhe emri i të Vërtetit të Lartësuar dhe emri i të Dërguarit të fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjithashtu, do të shuhet edhe të gjitha dituritë që s'janë çuar në

---

<sup>1</sup> “Misbàhu-sh'sherij'ati”, K. 5, “Dhikri”; “Mustedrekul-Vesàili”, vëll. “Namazi”, Pjesa “Dhikri, K. “En'nevàdir”, Hadithi 2.



zemër. Në këtë gjendje, njeriu do të jetë i hutuar në varrin e tij, ku do të merret në pyetje, prandaj atij nuk i sjell dobi as porosia (telkijni), që i bëhet mbi varr për të shqiptuar dhikrin madhor të sipërpërmendur, për pasojë, ky njeri kurrë nuk do të gjejë në veten e tij ndonjë ndikim as prej së vërtetës së natyrës hyjnore krijuese, as prej të vërtetës së mesazhit dhe as prej të gjitha diturive. Kjo për shkak se ai e ka shqiptuar dhikrin madhor vetëm duke e lakuar me gjuhë, pa e vërtetuar atë me zemër, prandaj prej kujtesës së këtij njeriu, dhikri madhor shuhet dhe për atë kurrë nuk do të ketë pjesë prej dëshmisë që pohon se vetëm Allahu është Zoti Një e i Vetëm, ashtu siç nuk do të ketë pjesë për atë as prej vërtetimit të mesazhit dhe as prej diturive të tjera.

Në një hadith sherifi thuhet se një grup prej umetit të të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do të futet në Xhehenem dhe e harron emrin e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur do të ndeshet me tmerrin e madh që e zë, kur të shikojnë Malikun - përgjegjës in e zjarrit, pavarësisht se ishin prej besimtarëve. Gjithashtu, prej këtij hadithi mësohet se zemrat e këtij grupi dhe fytyrat e tyre, do të shkëlqejnë me dritën e besimit.<sup>1</sup>

Dijetari i madh i hadithit, El-Mexhlisij (*Allahu e mëshiroftë!*), duke shpjeguar frazën e hadithit sherifi: "*Unë jam veshi dhe syri i tij...*", në mënyrë të përmbledhur thotë: "...ai i shpenzon fuqitë që Allahu ka depozitar në atë në bindje të dëshirave të vetes e të shejtanit dhe nuk i ka kushtuar kujdes këshillave të zbritura prej të Gjithëmëshirshmit, prandaj shpirtërorja prej atyre këshillave tek ai bëhet pa asnjë vlerë, kurse truporja do të jetë e ekspozuar për t'u

---

<sup>1</sup> Referoju librit "Ilmul-jekijn", El-Fejd El-Kàshànij, vëll. 2, f. 1039.





asgjësuar... të këtillë janë të shurdhër e memecë në këtë botë e në Botën Tjetër... por gjithçka, nga ajo që Allahu u ka dhënë atyre, prej dëgjimit shpirtëror, ai dëgjim as nuk dobësohet për shkak të dobësimit të trupit dhe as nuk largohet me vdekjen. Me atë dëgjim, ai do të dëgjojë në varr fjalët që i drejtohen dhe në saje të atij dëgjimi, edhe do të përgjigjet”.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, hadithet e nderuara, që e theksojnë sigurinë e zemrës, tregojnë se ndikimet e sigurisë së zemrës janë të shumta. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që Kur’ani Famëlartë të këndohet me rregullat që kërkon këndimi i Kur’anit Famëlartë. Në hadithin sherifi lexojmë: *“...ai që e harron një sure të Kur’anit, ajo sure në Xhenet formësohet në formë të bukur e me një gradë të lartë. Kur harruesi do ta shohë atë bukuri, do të pyesë: ‘Cila je ti? Sa e bukur qenke! Ah, sikur të ishe për mua!’ Ajo i thotë: ‘A nuk më njeh, se cila jam? Jam aksh sure dhe, sikur ti të mos më harroje, patjetër që unë ty do të të lartësoja’”*.<sup>2</sup> Gjithashtu, në hadithin sherifi thuhet: *“Ai që e lexon Kur’anin, kur është besimtar i ri, Kur’ani përziehet me mishin e me gjakun e tij...”*<sup>3</sup>

Sekreti në këtë ndikim është se zemra, në moshën e rinisë, është më pak e shqetësuar dhe më pak e turbulluar, prandaj ndikimi i Kur’anit në atë zemër është më i madh e më i shpejtë. Gjithashtu, edhe leximi i Kur’anit do të qëndrojë më gjatë në të.

Në një tjetër hadith sherifi thuhet: *“S’ka ndonjë gjë më të dashur tek Allahu i Gjithëfuqishëm, se sa një punë që vazhdohet, edhe pse*

<sup>1</sup> “Mir’atul-Ukûl”, vëll. 10, f. 392.

<sup>2</sup> “Usûlul - Kâfi”, vëll. 4, Libri: “Fadlul - Kur’ani”, K. “Ai që e mëson Kur’anin përmendsh dhe pastaj e harron atë”, Hadithi 2, f. 410.

<sup>3</sup> Burimi i mësipërm; vëll. 4, K. “Mbartësi i Kur’anit”, Hadithi 4, f. 405.



*është pak*".<sup>1</sup> Ka mundësi që sekreti bazë dhe kryesor në këtë hadith të jetë: vijimësia e bën punën formë të brendshme për zemrën, ashtu siç u theksua edhe më sipër.

Ka edhe shumë hadithe të tjera, që flasin për këtë çështje, por këtu s'ka vend që ato të përmenden.

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 3, Libri "El - iman uel - kufriu", K. "Lartësimi i punës dhe vazhdimi në atë punë", Hadithi 3, f. 129.



## Ndarja e pestë

### RUAJTJA E PUNËVE PREJ VEPRIMIT TË SHEJTANIT

Një prej rregullave të rëndësishme të edukatës së faljes së namazit dhe të të gjitha adhurimeve, madje ndër rregullat më të rëndësishme prej rregullave të zemrës në kryerjen e adhurimeve, është “ruajtja e punëve prej veprimeve djallëzore”, sepse kujdesi për zbatimin e këtij rregulli numërohet prej punëve më të vështira dhe prej problemeve më komplekse. Mbase fjala e Allahut të Lartësuar, kur përshkruan cilësitë e besimtarëve:

“وَالَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ” – “*uel'ledhijne alà salevâtihim juhâfidhûne*” - “...**të cilët e ruajnë kohën e namazeve të tyre**”<sup>1</sup>, tregon të gjitha gradat e ruajtjes së punëve. Në të vërtetë, ruajtja e punëve prej veprimit të shejtanit përfaqëson një rëndësi prej atyre gradave, përfaqëson gradën më të rëndësishme të ruajtjes së punëve prej veprimit të shejtanit.

Në shkoqitje të kësaj përmbledhjeje, themi: tek ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe të kërkesave të atyre që i zotërojnë zemrat, është e qartë se zemrat, shpirtat dhe trupat kanë nevojë që të ushqehen me ushqimin që është në përshtatje me gjendjen e zemrave, shpirtave dhe trupave, ushqim që është në përputhje me kërkesat për ndërtimin e zemrave, shpirtave e trupave dhe me të

---

<sup>2</sup> Sure “El Meàrixh”, ajeti 34 dhe sure “El Mu’minùn”, ajeti 9.



cilin realizohet orientimi trupor dhe rritja bimore, pra, duhet një ushqim që të jetë i përshtatshëm për gjendjen e zemrave, shpirtrave dhe trupave, njëkohësisht të jetë në përshtatje me përbërjen e zemrave, shpirtrave e trupave, pasi me ushqimin që ato marrin, do të realizohet rritja e tyre morale dhe lartësimi i brendshëm.

Ushqimi i përshtatshëm për formimin e shpirtrave janë njohuritë hyjnore, me kuptimin e përgjithshëm të këtij termi, duke filluar prej fillesave të ekzistencës dhe duke përfunduar me mbarimin e këtij sistemi, ashtu siç kanë bërë të ditur filozofët më të mëdhenj me fjalët e tyre, se kjo qëndron në “bërjen e njeriut dijetar, të mençur të përshtatshëm me botën e dukshme, në formën e në plotësimin e tij”.<sup>1</sup> Ky term tregon për këtë ushqim moral, domethënë ushqimin e zemrave me virtytet shpirtërore dhe me adhurimet hyjnore.

Pa dyshim, çdo lloj ushqimi, kur është i pastër prej veprimit të shejtanit dhe i përgatitur me dorën e kujdestarit më të madh, të Dërguarit të fundit dhe mikut më të madh të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nëse zemra e shpirti ushqehen me këtë ushqim, me siguri që me miraxhin e afrimit tek Allahu i Lartësuar realizohet fitorja e plotë, e merituar për pozitën njerëzore. Patjetër që shpëtimi e pastërtia prej veprimit të shejtanit numërohet si parathënie për arritjen e sinqeritetit, por sinqeriteti kurrë nuk vjen në formën e tij të plotë, deri sa rrugëtari në udhën e Allahut të bëhet shpirtëror në rrugëtimin e tij e të shkelë me të dyja këmbët vetëpëlqimin dhe egoizmin, që janë burimi i të gjitha

---

<sup>1</sup> Përkufizim për filozofinë, siç e ka sjellë Sadrud’ dijn Esh’ shijràzi dhe të tjerët që e ndjekin atë, si dhe shprehjen “në formën e në plotësimin e tij”, duke shtuar në këtë përkufizim edhe disa të tjerë.



prishjeve dhe nëna e sëmundje të brendshme. Kjo mirësi, në kuptimin e saj më të plotë, i është dhënë vetëm njeriut më të plotësuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pastaj i është dhënë më të sinqertit të eulijave. Në të gjitha gjendjet, rrugëtari në udhën e Allahut nuk duhet ta humbë shpresën prej butësisë së padukshme të të Vërtetit. Në të vërtetë, humbja e shpresës prej mëshirës së Allahut, është baza e rënies poshtë dhe e dobësimit, më pas humbja e shpresës vjen e bëhet prej gjynaheve më të mëdha.

Atij që i është dhënë kujdestaria, ai është kënaqësia e syve të atyre që kanë arritur gradën e njohjes. Prandaj për rrugëtarin në rrugën e Botës së Ardhshme mbetet për detyrë të përpiqet, me të gjitha mundësitë, që të meditojë në thellësi dhe me kujdesin më të madh gjendjen e tij, kur është në lëvizje e në qetësi. Gjithashtu, për këtë, rrugëtarit i mbetet detyrë e përhershme të bëjë kujdes të madh në punën e tij e në kërkesat e tij, me synimin që të arrijë qëllimin, në saje të rrugëtimit të tij, të punës së tij, parimeve të lëvizjeve të tij të brendshme dhe patjetër edhe në saje të ushqimit shpirtëror që ai merr. Nëse ai ruhet prej kurtheve të dëshirave vetjake dhe bën kujdes të madh, që të mos bjerë as në rrjetën e shpirtit urdhëruar për të keqen e as në pritrat që i vë shejtani, por bashkëpunon me paramendim me veten, në të gjitha lëvizjet e në të gjitha punët e tij, asnjëherë nuk lejon që ato të jenë jashtë kontrollit. Sa herë ka ndodhur që njeriu e ka rrëzuar veten përtokë, thjesht se ka bashkëpunuar me dëshirat e me shpirtin lakmues, qoftë edhe me fare pak tolerancë, por dëshirat e shpirti lakmues shumë shpejt e kanë çuar në disfatë e në humbje.



Rrugëtari në udhën e Botës Tjetër ka për detyrë të zbukurohet me këtë kujdes të madh, sepse, kur ushqimet shpirtërore nuk janë të pastra prej veprimit të shejtanit dhe, kur shejtani ka dorë në përgatitjen e ushqimeve që ai merr, patjetër që ato ushqime, jo vetëm që nuk do t'i ndihmojnë shpirtat e zemrat të zhvillohen e të arrijnë plotësimin që meritojnë, por ky ushqim do të bëjë që shpirtat e zemrat të preken nga dobësia e gjynaheve të mëdha dhe bërësit e atyre gjynaheve, shumë shpejt, do të bëhen rrugëtarë në udhën e shejtanit, ose të kafshëve, deri edhe në rrugën e bishave. Prandaj rrugëtari në udhën e Botës së Ardhshme vazhdimisht ka për detyrë të bëjë ato punë që i mundësojnë atij realizimin e lumturisë dhe të arrijë deri në shkallët e larta të plotësimit njerëzor. Kurse një rezultat i kundërt, patjetër që do ta çojë njeriun drejt greminës së vështirësive të errëta. Më sipër kemi parë se ku i çoi thellimi në terminologjitë disa prej atyre që kishin arritur gradën e njohjes, të cilët, për këtë shkak, ranë në rrugën e humbjes. Gjithashtu, pamë se zemrat e tyre u bënë me kthesa, deri sa e brendshmjia e zemrave të tyre u bë errësirë; pamë se praktikimi në dituritë u shndërrua në shkak, që te ata të forcohet egoizmi, duke bërë që ata të priren vetëm pas të tanishmes, për rrjedhojë ata filluan të mbahen me të madh e të lëshojnë thirrje të gabuara, madje shkuan aq larg, sa kaluan në veprime të këqija; pamë se në disa prej krerëve të praktikueseve të ushtrimeve shpirtërore u shtua shqetësimi për të zhdukur zemrat e disa dijetarëve, me ashpërsinë më të madhe dhe për të paraqitur të brendshmen e tyre në mënyrën më të zezë. E gjitha kjo, sepse ata kurrë nuk e ruajtën as rrugëtimin moral hyjnor dhe as nuk emigruan për tek Allahu. Në të kundërt, rrugëtimi i tyre shkencor dhe kënaqësitë jo të pastra, të servirura prej veprimit të shejtanit e prej interesave vetjake, bënë që ata, në



ecurinë e tyre, të priren kah rruga e shejtanit dhe e interesave të kësaj bote.

Gjithashtu, pamë si ishte ndikimi i keq i diturisë të disa studentëve të shkencave juridike, të bazuara vetëm në tekstet e cituara; pamë se si kjo rrugë e shtoi ndikimin e vet për keq edhe në moralin e tyre. Në një kohë që këto ndikime duhet të ishin shkak për shpëtimin e për përmirësimin e tyre, në fakt u bënë shkak për shkatërrimin e tyre dhe për t'i tërhequr ata zvarrë drejt injorancës, drejt dyshimeve, drejt mbajtjes me të madh dhe drejt mashtrimeve e të trillimit të gënjeshtreve nga frika.

Kështu qëndron puna edhe me disa adhurues, të cilët i kryejnë adhurimet e ritualet e caktuara dhe janë edukuar të veprojnë sipas Sunetit, mirëpo për shkak se zemrat e disa prej tyre u bënë të errëta, kjo errësi e zemrave, pavarësisht se adhurimet e ritualet që janë baza e përmirësimit të shpirtit dhe e gjendjeve, i çoi ata deri aty, sa të pëlqejnë veten, të mashtrojnë, të tregohen mendjemëdhenj, të krekosen, të vënë në lojë të tjerët, të shfaqin moral të keq e të kenë paragjykime ndaj robëve të Allahut. Patjetër që edhe kjo e keqe, në këtë kategori adhuruesish, erdhi për shkak të mosruajtjes së ushqimeve hyjnore.

S'ka asgjë për t'u çuditur, kur ushqimi është përgatitur me dorën e Iblisit të lig, me shpirtin djallëzor, të mos vijë asgjë tjetër përveç moralit djallëzor, për më tepër, kur zemra ushqehet me një ushqim të këtillë, ky ushqim do të bëhet forma e brendshme e shpirtit dhe njeriu që ka vazhduar ta marrë këtë ushqim për një kohë të gjatë, do të bëhet një prej thjeshtërve të shejtanit, do të bëhet prej atyre që u edukuan prej dorës së shejtanit dhe u rritën e u forcuan nën pushtetin e nën veprimin e tij. Por, kur të mbyllen sytë



e tij të botës së pushtetit dhe, kur për atë do të hapen sytë e hyjnore, ai shumë shpejt do ta shikojë veten se është në bandën e shejtanëve, për pasojë, në atë kohë, ai nuk do të korrë gjë tjetër, përveçse humbje e pendim, por, në atë kohë, atij nuk do t'i sjellë dobi as hidhërimi e as pendimi.

Atëherë, për rrugëtarin në udhën e Botës së Ardhshme, pavarësisht se në cilën rrugë fetare ose rrugë hyjnore është, në radhë të parë, ka për detyrë të tregojë kujdes të madh ndaj vetes, madje duhet të tregojë kujdesin më të madh e më të mprehtë, të ketë kujdesin e një mjeku të dhimbshëm, ose kujdesin e një infermieri të mëshirshëm dhe me kujdesin më të madh të studiojë të metat e sjelljes së tij dhe të rrugës që ai ndjek.

Në radhë të dytë, gjatë kësaj pune, në çastet e vetmisë së plotë, ai të mos e anashkalojë kërkimin e strehimit me të Vërtetin e Lartësuar dhe të jetë i përulur e i nënshtruar ndaj Zotëruesit të madhështisë së pastër.

O Zoti im! Ti e di gjendjen tonë të dobësisë! Vetëm Ti ke dijeni të plotë sa pak janë rrugëdaljet për ne. Vetëm Ti, me pastërtinë Tënde, e di se s'ka rrugë shpëtimi prej këtij armiku, fuqia e ashpërsia e të cilit shkon deri aty, sa ai lakmon të mashtrojë deri Profetët Tuaj të mëdhenj dhe eulijatë Tuaj të plotësuar e me grada të larta. Nëse Ti nuk na merr për dore, patjetër që jemi të privuar prej butësisë e prej mëshirës Tënde dhe patjetër, që në këtë rrugë, ne do të jemi të asfiksuar e të vdekur para këtij armiku të egër e do të rrëzohemi në honin e errësirës e të vështirësive.

O Zoti im! Betohe me në Ty, me ata që janë veçuar me afrimin në oborrin e mëshirës Tënde! Betohe me në Ty, me ata që Ti i bërë





mbajtës të besueshëm të sekreteve të Tua! Të lutemi, o Allah, na merr për dore, ne që endemi të hutuar në luginën e rrugës së humbjes dhe të mbaruar prej mashtrimeve! Na i pastro zemrat tona prej mashtrimit, prej idhujtarisë e prej dyshimit! Vetëm Ti e ke në dorë udhëzimin në Rrugën e Drejtë!



## Ndarja e gjashtë

### AFRIMI

Prej rregullave të tjera të zemrës, të domosdoshme në faljen e namazit dhe në kryerjen e të gjitha adhurimeve, stolisja me këto rregulla çon në rezultate të mira, çon në hapjen e bravave të disa portave dhe në zbulimin e disa sekreteve të adhurimeve. Rregulli kryesor që kërkohet prej rrugëtarit në udhën e Allahut, është që ai të kryejë adhurimin me afrim të zemrës, të ndiejë gëzim nga kryerja e adhurimit dhe të ruhet shumë nga përtacia, pasi përtacia gjatë kryerjes së adhurimit, shumë shpejt, çon në lënien e adhurimeve.

Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të zgjedhë për kryerjen e adhurimit një kohë, në të cilën shpirti është i afruar ndaj adhurimit, ndien kënaqësi nga adhurimi që plotëson, për rrjedhojë ai njeri e kryen adhurimin në mënyrë aktive e me gjallëri, larg lodhjes e ftohjes prej namazit. Kur shpirti e bën adhurimin pa dëshirë, ai namaz, për atë shpirt, është lodhje, është ftohje ndaj adhurimit dhe, mbase kjo çon në ndikime të këqija, si për shembull, njeriu, pas kryerjes së adhurimit në një gjendje shpirtërore të këtillë, ndien prej adhurimit irritim e pakënaqësi, ndien se me atë adhurim i dyfishohet e i shtohet detyrimi. Pikërisht kjo gjendje, dalëngadalë, fut ftohje në karakterin e njeriut ndaj adhurimeve. Kjo gjendje ftohjeje ka mundësi të bëjë që ai të mos e



përmendë Allahun përfundimisht. Për rrjedhojë, njeriu do të mbajë barrën e ndëshkimit, duke qenë në pozitën e robërisë, pozitë që numërohet burimi i të gjitha llojeve të lumturive. Prej një adhurimi të këtillë, jo vetëm që nuk arrihet ndriçimi i zemrës, por edhe e brendshmja e shpirtit kurrë nuk do të ndikohet nga kryeja e adhurimit. Gjithashtu, as forma e robërisë kurrë nuk do të bëhet formë për të brendshmen e zemrës. Në këtë gjendje, ashtu siç e kemi përmendur më sipër, objektivi më madhor qëndron në praktikimin e adhurimeve.

Gjithashtu, prej sekreteve të adhurimeve, ushtrimeve të shpirtit dhe prej rezultateve të adhurimeve është bërja e këtyre cilësive të adhurimit vullnet depërtues të shpirtit në mbretërinë e trupit, pasi adhurimet e nënshtrajnë ekzistencën e njeriut, e fuqizojnë atë të rezistojë ndaj pushtetit të mendjemadhësisë së shpirtit dhe bëjnë që njeriu të jetë i nënshtruar e i dorëzuar plotësisht, e bëjnë të atillë që do të ndalojë fuqitë e shpërndara e ushtritë e përhapura në anët e mbretërisë së trupit, si: mosbindjen, egoizmin e tiraninë dhe e shtyn atë të dorëzohet para pushtetit të së brendshmes së zemrës, madje këto fuqi, dalëngadalë, asgjësohen në këtë pushtet, ose puna e pushtetit të brendshëm bëhet linjë rrjedhëse në këtë sundim. Me këtë punë aktive, vullneti i njeriut forcohet, punët e pushtetit shpirtëror hiqen prej duarve të shejtanit e të shpirtit urdhërues për të keqen. Edhe ushtritë e shpirtit urdhërues për të keqen i çon prej besimit drejt dorëzimit, prej dorëzimit i çon ato drejt miratimit dhe prej miratimit i çon drejt asgjësimit.

Në këtë stad, shpirti arrin diçka prej aromës së sekreteve të adhurimeve dhe adhurimet bëhen një vezullim ndriçues prej



shkëlqimeve të dukshme të punëve.<sup>1</sup> Por kjo s' mund të realizohet, nëse adhurimi nuk kryhet me afrim e me gëzim dhe, nëse nuk tregohet kujdes për të mos rënë në mendimin se jam rënduar nga barra e detyrimeve. Gjithashtu, gjatë kryerjes së adhurimeve të mos ndihet dobësim e përtaci, por të duket sheshit gjendja e dashurisë për të përmendur të Vërtetin e Lartësuar dhe të mbahet parasysh pozita e robërisë. Vetëm në këtë gjendje realizohet prehja<sup>2</sup> dhe fuqizimi<sup>3</sup>.

Prehja me të Vërtetin e Lartësuar dhe me përmendjen e Tij, është prej punëve më të larta, punë të cilat i kryejnë, me kujdesin e duhur, ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe, në këtë gradë konkurrojnë me ata që e kanë në zotërim ecjen dhe me rrugëtarët në udhën e Allahut.

Në të gjitha gjendjet, ashtu siç kanë bindjen mjekët se ushqimi që merr njeriu, me dëshirë e me gëzim, do të tretet më me

---

<sup>1</sup> Shkëlqim – në arabisht "النجلي": ajo që bëhet e qartë për zemrat, prej dritave të panjohura.

Shkëlqimi i punëve: është shkëlqimi i parë që arrin rrugëtari në udhën e Allahut, në fazat e rrugëtimit e të shenjave të tij; është ndërprerja e shikimit prej punëve të njerëzve dhe me këto hedhja poshtë e shtimit të së mirës e të keqes, dobisë e dëmit, si dhe sheshimi i lavdërimit, përruljes, pranimit e refuzimit nga ana e njerëzve.

<sup>2</sup> Prehje – në arabisht "الأنس" do të thotë: kënaqësia që ndien e brendshmja nga shikimi i plotësimit të të Vërtetit.

<sup>3</sup> Fuqizimi – në arabisht "التمكُن" është: pozita e fundit e kujdestarisë (vilajetit) dhe fillimi i udhëtimit të dytë. Fuqizimi është në tri gradë: fuqizimi i dashamirësit dhe përfshin qëllimin e mirë, takimin me dëshmitarët dhe rrugën e gjerë; pastaj vjen fuqizimi i rrugëtarit në udhën e Allahut, që përfshin: vërtetësinë e ndërprerjes, shkëlqimin e zbulimit dhe kthjelltësinë e gjendjes; pastaj vjen fuqizimi i atij që ka arritur gradën e njohjes: do të thotë arritja në praninë e shumicës.



lehtësi, po kështu edhe mjekët psikologë mendojnë se marrja e ushqimeve morale me kënaqësi e me dëshirë, pa përtaci e pa u ndier të rënduar nga barra e marrjes së këtyre ushqimeve morale, bën që ndikimet e këtyre ushqimeve shpirtërore të arrijnë më shpejt në zemër dhe çështja e pastrimit të zemrës të plotësohet në mënyrën më të shpejtë.

Kjo lloj edukate e ky rregull theksohet edhe në Librin hyjnor Famëlartë, ku Allahu i Lartësuar, duke përshkruar gënjeshttrat e mohuesve dhe të hipokritëve, thotë:

“وَلَا يَأْتُونَ الصَّلَاةَ إِلَّا وَهُمْ كُسَالَىٰ وَلَا يُنْفِقُونَ إِلَّا وَهُمْ كَارِهُونَ” - “...ue là jeëtùne-s’selàte il’là ue hum kusàlà ue là junfikùne il’là ue hum kàrihùne...” - “...edhe namazin ata e falin me përtaci; gjithashtu ata kanë urrejtje për zekatin që japin...”<sup>1</sup> Edhe në disa hadithe, fjala “dehje”, e përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar: “لَا تَقْرُبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَارَىٰ” - “...ue là takrebu-s’salàte ue entum sukàrà...” - “...mos u afroni të falni namaz, kur jeni të dehur...”<sup>2</sup> shpjegohet me përtacinë.

Ky rregull në kryerjen e adhurimeve theksohet edhe në hadithet e nderuara. Tani le t’i parfumojmë këto faqe, duke përmendur disa prej këtyre haditheve:

Nga Muhamed bin Jakubi, me përcjellës deri te Ebu Abdullahu, lexojmë: “...mos e rëndoni veten tuaj, duke i kryer adhurimet me përtaci”<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Sure “Et Teube”, ajeti 54.

<sup>2</sup> Sure “En Nisà”, ajeti 43.

<sup>3</sup> “Usûlul Kâfi”, vëll. 2, Libri “El-Imanu uel-Kufuru”, K. “Ekonomia në adhurim”, Hadithet 2 - 3, f. 129 dhe f. 137.



Muhamed bin Jakubi, me përcjellës prej Ebu Abdullahut, tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“O Ali, kjo fe është e fortë, prandaj hyr në brendësi të saj me butësi dhe në veten tënde të mos kesh plogështi e përtaci për të adhuruar Zotin tënd!”*<sup>1</sup>

Imam Askeriu ka thënë: *“Kur zemrat bëhen aktive, ruajini ato dhe, kur zemrat shfaqin përtaci, menjëherë ndahuni me to!”*<sup>2</sup>

Çështja e depozitimit të adhurimeve në zemër, kur është aktive dhe e gëzuar dhe lënia e zemrës, kur shfaq përtaci, te imamët e nderuar është një orientim i përgjithshëm e gjithëpërfshirës, prandaj kujdesi për ruajtjen e kësaj edukate në kryerjen e adhurimeve qëndron në fitimin e njohurive e të diturive dhe nuk ka përse të detyrohet zemra përtace, që të fitojë dituri e të marrë njohuri.

Prej haditheve të mësipërme dhe prej haditheve të tjera mësohet ekzistenca e një rregulli tjetër, i cili numërohet si puna e fundit e rëndësishme në ushtrime. Kjo punë është “rregulli i marrjes nën kujdes”. Për rrugëtarin në udhën e Allahut, është e domosdoshme, në mënyrë të barabartë, nga pozita në të cilën ai është, qoftë në pozitën e ushtrimeve, qoftë në pozitën e hulumtimeve shkencore, qoftë në pozitën e diturive shpirtërore apo në pozitën e praktikës, të marrë nën mbrojtje gjendjen e tij dhe ta trajtojë veten me butësi e me falje, duke mos e ngarkuar më shumë nga sa ai ka fuqi të mbajë, ose duke e ngarkuar me punë që nuk janë në përshtatje me gjendjen e tij. Në mënyrë të veçantë, kjo normë të

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 6.



mbahet parasysh me të rinjtë e me fillestarët në këtë rrugëtim, sepse mostrajtimi i njeriut me falje e me butësi dhe mosplotësimi me masën e duhur të nevojave njerëzore me rrugë të ligjshme, bën që të rinjtë të vihen para një rreziku aq të madh, sa ata nuk kanë fuqi të përballen me të, prandaj shtrëngimi jo i ekuilibruar dhe presioni mbi veten, pa asnjë vlerësim, bën që frerët e këtij shpirti të jenë të lëshuar në zgjedhjen, kur në të do të shpërthejnë nevojat e natyrshme të instinkteve, nevoja të grumbulluara e të mbajtura të mbyllura, atëherë te i riu do të përshkallëzohen gjuhët e flakëve të epsheve, të mbajtura nën fre me rrugën e trysnisë së ushtrimeve të pallogaritura mirë. Në këtë gjendje, ato flakë do të djegin mbretërinë e ekzistencës së njeriut. Allahu mos e lejoftë! Por sikur kjo të ndodhë, pasi njeriu nga rrugëtar në udhën e Allahut të kthehet në një njeri të atillë, që i ka lëshuar frerët e vetes së tij dhe ka humbur kontrollin e nuk e ka më veten në zotërim? Ky njeri, patjetër që do të rrëzohet në humnerë, nga ku kurrë nuk do të ketë më shpresë, se do të shpëtojë e do të dalë prej saj. Gjithashtu, ai nuk do të ketë më shpresë, se do të rikthehet prej humnerës në rrugën e lumturisë e të përmirësimit.

Për të gjitha këto, rrugëtarin në udhën e Allahut ka për detyrë që ndaj vetes së tij të jetë si ai mjeku i mirë, i cili mat rrahjet e pulsit të zemrës së tij gjatë ditëve të rrugëtimit dhe pastaj bashkëpunon me zemrën e me shpirtin e vet, në përputhje me kërkesat e gjendjes së tij gjatë ditëve të ndryshme të rrugëtimit. Prandaj rrugëtarin në udhën e Allahut nuk duhet t'i ndrydhë plotësisht nevojat e tij natyrore gjatë ditëve të vlimit të epsheve në periudhën e rinisë, por të përpiqet të shuajë zjarrin e epsheve me rrugët e lejuara në ligjin e fesë. Patjetër që kjo mënyrë veprimi është ndihmë për atë në rrugëtimin e tij në udhën e të Vërtetit.



Natyrisht që martesë është prej rrugëve hyjnore të mëdha, duke shtuar edhe faktin që martesë është baza për vijimësinë ligjore të specit njerëzore. Në të njëjtën kohë, martesë ka një rol të madh në ecurinë e njeriut në rrugën e Botës së Ardhshme. Nga ky këndvështrim, ka ardhur edhe fjala e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Ai që martohet, në të vërtetë, ka ruajtur gjysmën e fesës së tij...”<sup>1</sup>, si dhe fjala tjetër e tij: “Ai që dëshiron të afrohet i pastër tek Allahu, le të martohet sa më shpejt me një grua”.<sup>2</sup> “...Shumica e atyre që do të jenë në Zjarr, janë beqarë”.<sup>3</sup>

Të mosharrojmë edhe hadithin e përcjellë prej Prijësit të besimtarëve. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u flet disa shokëve të tij, të cilët ia kishin ndaluar vetes të shkonin me gratë e tyre, të mos hanin ditën dhe të mos flinin natën. Kur Umu Seleme e njoftoi të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për këtë vendim të tyre, ai u tha: “Ju do të hiqni dorë nga gratë?! Ja, unë shkoj me gratë, ha ditën dhe fle natën. Ai që largohet prej rrugës sime, nuk është me mua”. Allahu i Lartësuar zbriti ajetet e nderuara:

“لَا تَحْرَمُوا طَيِّبَاتِ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ تَوَكَّلُوا وَمَا زَرَّكُمْ اللَّهُمَّ لَا طَيِّبَاتٍ وَأَتُوا اللَّهَ الَّذِي أَنْتُمْ بِهِ مُؤْمِنُونَ”

**“...mos ia ndaloni vetes ato që Allahu lejoi për ju dhe mos e teproni, pasi Allahu nuk i do ata që e teprojnë. Dhe hani nga**

<sup>1</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 75, Libri “Err’ reudatu”, K. 29, Hadithi 3, f. 377.

<sup>2</sup> “Emàlij Et’ túsij”, vëll. 2, f. 132; “Bihàrul Enuàr”, vëll. 100, Hadithi 14, f. 220.

<sup>3</sup> “Nevàdiru-rr’ rràvendij”, f. 12; “Reudatul-Vàidhijn”, f. 373 dhe prej të dyve “Bihàrul Enuàr”, vëll. 100, Hadithi 18 dhe 35, f. 220.





**ushqimi i lejuar e i mirë, me të cilin ju furnizoi Allahu, por kijeni frikë dënimin e Allahut, të Cilit ju i besoni!”<sup>1</sup>**

Në përgjithësi, rrugëtari në udhën e Botës së Ardhshme ka për detyrë të kujdeset dhe të mbrojë gjendjet e vetes e të shpirtit të tij, përfshirë afrimin e kthimin e shpinës. Gjithashtu, ka për detyrë të kujdeset, që të mos i frenojë nevojat e natyrshme të trupit, në mënyrë absolute, pasi kjo lloj ndalesë, patjetër çon në imoralitete të rënda. Nga ana tjetër, në rrugëtimin e tij, nuk duhet të ushtrojë presion të madh mbi veten e ta ndrydhë shpirtin me adhurime të gjata e me ushtrime të shumta, sidomos kjo duhet të kihet parasysh gjatë ditëve të rinisë dhe në fillimet e rrugëtimit, pasi ky presion çon në neveritjen e shpirtit e në dobësimin e tij. Ka shumë të ngjarë që nga kjo neveri e nga kjo lodhje e tepërt, njeriu arrin deri aty sa i kthen shpinën përmendjes së Allahut.

Ka edhe shumë hadithe të tjera, që flasin për kujdesin ndaj vetes. Në librin “El-Kâfi”, El-Keleni transmeton fjalën e Imam Sadikut: *“Kur isha i ri, jam lodhur shumë duke bërë adhurime. Babai im më tha: ‘I shoh ato që ti bën më shumë, por Allahu Fuqiplotë, kur e do robin, mbetet i kënaqur prej tij edhe me pak’.”*<sup>2</sup>

Në librin “El-Kâfi” është edhe një hadith tjetër, që ka afërsisht të njëjtën përmbajtje.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Sure “El Mâide”, ajeti 87; kurse hadithi është marrë prej librit “El Vesâil”, Libri “En’nikâhu”, K. 2, Hadithi 8.

<sup>2</sup> “Usûlul-Kâfi”, vëll. 3, Libri “El-Imanu uel-Kufru”, K. “Ekonomia në adhurim”, Hadithi 5, f. 138.

<sup>3</sup> “Usûlul-Kâfi”, vëll. 3, Libri “El-Imanu uel-Kufru”, K. “Ekonomia në adhurim”, Hadithi 4, f. 138.



Gjithnjë në librin “El-Kâfi”, prej Ebu Xhaferit përcillet fjala e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kjo fe është e fortë, prandaj hyni në të me butësi dhe adhurim për Allahun; mos ua bëni të pështirë apo të vështirë robëve të Allahut!”<sup>1</sup> Në një hadith tjetër, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mos e bëj të urryer në shpirt adhurimin për Zotin tënd!”<sup>2</sup>

Në tërësi, peshorja në marrjen nën mbrojtje e kujdesi për vetveten, kërkon që njeriu të jetë korrekt me gjendjet e vetes dhe rrugëtimi i tij të jetë në përshtatje me fuqinë e pafuqinë e tij. Kur njeriu shikon se është i fuqishëm të rezistojë në kryerjen e adhurimeve e të ushtrimeve, ka për detyrë t’i plotësojë adhurimet me seriozitet. Gjithashtu, nëse njeriu, gjatë ditëve të rinisë së tij, ndien uri dhe në saje të adhurimeve e ushtrimeve, te ai shuhet zjarri i epsheve një farë mase, ai ka detyrim të studiojë rrugët si të shtojë pak ushtrimet shpirtërore dhe të hyjë në sheshin e rrugëtimit e në fushën e praktikimit të ushtrimeve shpirtërore me seriozitet, të hyjë me më shumë punë e me trimëri. Sa herë ia bën zakon vetes një ushtrim, me këtë ushtrim, për të, hapet një portë tjetër, nga e cila ai, dalëngadalë e sundon veten mbi fuqitë e natyrës dhe i mposht fuqitë e natyrës e të mendjemadhësisë së vetes së tij.

Në transmetimet e nderuara theksohet fuqishëm puna me seriozitet, që duhet bërë në adhurimet. Gjithashtu, hadithet e vënë theksin edhe mbi lavdërimin e atyre që ngulmojnë në adhurime e në ushtrime. Hadithet e nderuara, të ardhura në lidhje me adhurimet, prej imamëve orientues në rrugën e drejtë, në krahasim

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm, Hadithi 1.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, shkëputur prej hadithit 6.



me hadithet që lavdërojnë ekonomizimin gjatë adhurimit, janë të ndërtuara sipas gjendjeve të ndryshme, sipas gradëve të rrugëtarëve në udhën e Botës së Ardhshme, sipas gradëve e sipas gjendjeve të shpirtrave; janë të ndërtuara sipas peshores së përgjithshme. Në këtë drejtim, mbetet me rëndësi të madhe marrja nën mbrojtje e kujdesi për aktivitetin e vetvetes e të shpirtit, për fuqinë, për pafuqinë e tij e për neverinë.



## Ndarja e shtatë

### TË KUPTUARIT

Sqarimi është një prej rregullave të zemrës në kryerjen e adhurimeve, sidomos në adhurimet që dallohen për dhikrin. Sqarimi qëndron në faktin se njeriu, në fillim të punës, e përfytyron zemrën e vet si një fëmijë të vogël, që akoma nuk ka filluar të flasë dhe detyra e tij është që ta mësojë zemrën të flasë dhe, për të mësuar zemrën të flasë, i mëson asaj, me kujdesin më të madh, çdo dhikër e çdo frazë dhikri, i mëson çdo të vërtetë prej të vërtetave të adhurimit e çdo sekret prej sekreteve të adhurimit. Gjatë këtij procesi mësimor, ai përpiqet që t'ia sqarojë këto zemrës e ta bëjë atë që t'i kuptojë të gjitha çfarë ai i mëson asaj, në të gjitha pozitat e plotësimit që ajo është.

Kur njeriu nuk është prej atyre që dinë kuptimet e Kur'anit Famëlartë e të frazave të dhikrit, si dhe kur nuk është prej atyre që kanë pjesën e tyre në sekretet e adhurimeve, atëherë detyra e tij është që t'i mësojë zemrës së tij kuptimet e përgjithshme. Gjatë këtij procesi mësimor, ai ka në vëmendje se Kur'ani Famëlartë është fjala e Allahut të Lartësuar dhe se frazat e dhikrit janë përmendje e të Vërtetit. Gjithashtu, ai mban parasysh se adhurimet janë bindje e ndjekje e rrugës së Zotit të botëve. Të gjitha këto ai ia sqaron e ia shpjegon zemrës me durim, deri sa e bën zemrën që t'i kuptojë të



gjitha. Nëse ai është prej atyre që i shpjegojnë kuptimet e jashtme të Kur'anit e frazat e dhikrit, detyra e tij është që t'i mësojë zemrës së tij, që ajo t'i marrë këto kuptime të jashtme me rrugën e premtimit e të kërcënimit, me urdhrin për veprim dhe me urdhrin për ndalim, me diturinë për fillimin e krijimit e për Ringjalljen, në atë masë sa ai vetë i kupton këto të vërteta.

Kur për atë zbulohet njëra prej të vërtetave të njohurive, ose për atë zbulohet një sekret prej sekreteve të adhurimeve, atëherë, pa humbur kohë, le t'ia mësojë edhe zemrës ato që ai arriti.

Rezultati i synuar prej këtij sqarimi është se gjuha e zemrës shumë shpejt do ta zgjidhë nyjën e saj, pasi të ketë vazhduar t'i marrë këto mësimë për një farë kohe, atëherë zemra arrin të mësojë e të ruajë atë çka mësoi.

Në fillim, zemra do të jetë nxënësi dhe gjuha do të jetë mësuesi; zemra mëson atë çka i mëson gjuha, domethënë që zemra ndjek gjuhën, por gjendja do të jetë e kundërt pas zgjidhjes së nyjës së zemrës. Atëherë zemra bëhet mësuesi dhe gjuha përsërit atë çka i mëson zemra, gjuha lëviz në ndjekje të zemrës, madje, herë-herë, ndodh që gjuha i lakon frazat e dhikrit në ndjekje të dhikrit të zemrës. Siç dihet, dhikri i zemrës nuk është i veçantë vetëm për gjendjen, kur njeriu është zgjuar, pasi gjuha i lakon frazat e dhikrit, edhe kur njeriu është në gjumë. Kjo është periudha, kur gjuha bëhet ndjekëse e zemrës. Në këtë periudhë, gjuha i lakon frazat e dhikrit në ndjekje të dhikrit të zemrës dhe pastaj dhikri lëviz prej mbretërisë së zemrës, për të dalë në mjedisin e dukshëm, ashtu siç



e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar: “كُلُّ يَوْمٍ عَلَى شَاكِلَتِهِ” “...kul’lun jaëmelu alà shàkiletih...” -“...secili vepron sipas rrugës së vet...”<sup>1</sup>

Në përgjithësi, njeriu, në fillimin e punës, ka për detyrë të kujdeset, që të përvetësojë etikën e sqarimit, me qëllim që të hapet gjuha e zemrës. Pikërisht ky është qëllimi i vërtetë për hapjen e zemrës dhe, shenja që tregon se zemra është hapur, dallohet nga fakti se tanimë është larguar lodhja e vështirësia, që shkaktoheshin në zemër prej dhikrit, se në këtë zemër ka hyrë aktiviteti e gëzimi dhe s’ka më vend për lodhje e vështirësi të ardhura prej dhikrit. Kjo gjendje e mësimit të zemrës është plotësisht si gjendja e mësimit të fëmijës, kur njeriu i vë vetes qëllim që ta mësojë fëmijën si të shqiptojë fjalët dhe, vetëkuptohet që në këtë punë mësuesi do të lodhet e do të ketë vështirësi, por, kur gjuha e fëmijës fillon të shqiptojë fjalët, për të cilat mësuesi është munduar t’ia mësojë fëmijës, atëherë mësuesit i largohet lodhja dhe ai vetë fillon të shqiptojë fjalët që thotë fëmija, pa ndier asnjë lodhje e vështirësi.

Në fillim të punës, zemra është një fëmijë me gjuhë të lidhur, prandaj është detyrë që ajo të mësohet e t’i thuhet frazat e dhikrit në gojën e tij dhe, kur gjuha zgjidhet, njeriu bëhet vartës i gjuhës, prej tij largohet lodhja e mundimi i ardhur nga mësimdhënia e nga ngulmimi i tij për t’i mësuar zemrës frazat e dhikrit.

Kjo punë është një prej rregullave shumë të domosdoshme për fillestarin dhe dihet se pas këtij fillimi, njëri prej synimeve, me përsëritjen e frazave të dhikrit, mbetet vazhdimi i dhikrit dhe plotësimi i adhurimeve. Në këtë etapë të mësimit bëhet realitet gjendja e zgjidhjes së gjuhës së zemrës dhe vetë zemra bën dhikër,

---

<sup>1</sup> Sure “El Isrà”, ajeti 84.



lutet e kryen adhurim. Por, nëse rregulli dhe edukata e sqarimit nuk mbahet parasysh, gjuha e zemrës nuk do të fillojë të flasë.

Hadithet e nderuara e theksojnë këtë kuptim: për shembull në librin “El Kâfi” tregohet prej Imam Sadikut se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, në vijim të shpjegimit të disa rregullave të këndimit të Kur’anit, ka thënë: “...por me atë të trokisni në zemrat tuaja të ashpra dhe për asnjërin prej jush të mos jetë qëllim arritja në fundin e sures”.<sup>1</sup> Gjithashtu, në librin “El-Kâfi” lexojmë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë Ebu Usames: “O Ebu Usame, kujdesuni për zemrat tuaja, duke përmendur Allahun dhe ruhuni nga të thumbuarit me fjalë”.<sup>2</sup>

Edhe eulijatë më të plotësuar kishin kujdesin më të madh, që ta zbatonin këtë edukatë kaq të rëndësishme. Në hadithin e ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë se gjatë faljes së namazit, ai humbi vetëdijen. Kur u ndërgjegjësua, u pyet për shkakun e asaj që i ndodhi. Midis të tjerash, ka thënë: “Vazhdoj ta përmend këtë ajet në zemrën time, deri sa e dëgjova atë prej atij që flet me këtë ajet, por trupi im s’ka fuqi të qëndrojë para kuptimeve të këtij ajeti”.<sup>3</sup>

Ebu Dherri (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), një natë u ngrit më këmbë dhe përsëriti fjalën e të Lartit Fuqiplotë:

<sup>1</sup> “El-Usûlu” prej “El-Kâfi”, Libri “Fadlul-Kur’ani”, vëll. 4, K. “Këndimi i Kur’anit me zë të bukur”, Hadithi 1, f. 418.

<sup>2</sup> “Err’rreudatu”, prej “El-Kâfi”, vëll. 8, f. 167 dhe prej tij “Bihârul-Enuâr”, vëll. 67, f. 59.

<sup>3</sup> “El-mehaxh’xhetul-Bejdâ”, Libri “Esrâru-S’alâti”, vëll. 1, K. “Mirësia e nënshtrimit”, f. 625.



"إِنَّمَعْدِيهِمْ فَأَيُّهُمْ عِبَادُكَ وَأَنْ تَغْفِرَ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ"

**"Nëse Ti i ndëshkon, ata janë robtë Tuaj; nëse Ti i fal ata, Ti je i Gjithëmëshirshmi, i Urti".<sup>1</sup>**

Në përmbledhje, dhikri i zemrës është e vërteta e dhikrit dhe pa dhikrin e zemrës, dhikri që lakon gjuha, është i zbrazët dhe s'ka asnjë vlerë. Më sipër kemi thënë se ky kuptim theksohet në shumë hadithe, ndër të cilat sjellim hadithin e ardhur prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ai i tha Ebu Dherrit: *"O Ebu Dherr, falja e dy rekateve namaz të shkurtra në gjendje meditimi është më me vlerë se sa namazi që falet gjatë gjithë natës dhe zemra s'ka kujdes".<sup>2</sup>*

Gjithnjë prej tij, lexojmë se ai ka thënë: *"Pa dyshim që Allahu nuk shikon si i keni fytyrat, por Ai shikon në zemrat tuaja..."<sup>3</sup>*

Në vijim do të njihemi me hadithe që flasin për praninë e zemrës dhe do të shikojmë se ajo që pranohet prej namazit, është në përpjesëtim të drejtë me praninë e zemrës gjatë faljes së namazit, domethënë se, kur zemra është e shkujdesur, ai namaz nuk pranohet.

Nëse nuk ruhet etika e "s qarimit", nuk realizohet as dhikri i zemrës e as zemra nuk del nga gjendja e shkujdesjes.

---

<sup>1</sup> Ajeti 118 i sures "El Maide". Hadithi është marrë prej tefsirit të Kur'anit "Rùhul-Meàni", autori, dijetari i madh, El-Àlusi, vëll. 7, f. 70. Hadithi është cituar prej "Sunenit" të En'nisàij'jit dhe prej "Sunenit" të El Nejhekij'jit.

<sup>3</sup> "Mekàrimul-Akhlàk", f. 465 dhe prej tij "Bihàrul Enuàr", vëll. 74, f. 82.

<sup>3</sup> "Xhàmiul-Akhhbàr", f. 117 dhe prej tij "Bihàrul Enuàr", vëll. 67, f. 248.





Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “...prandaj bëje zemrën tënde Kible për gjuhën tënde dhe mos e lëviz gjuhën pa marrë shenjë prej zemrës!”<sup>1</sup> Por, bërja e zemrës Kible dhe bërja e gjuhës së bashku me të gjitha gjymtyrët ndjekëse të zemrës, nuk mund të realizohet pa një angazhim të përpiktë në zbatimin e rregullit të sqarimit. Nëse ndodh që kjo të arrihet pa ndihmën e këtij rregulli, patjetër që kjo është prej punëve të rralla, me të cilat njeriu nuk duhet të mburret.

---

<sup>1</sup> Lexo shënimin 1 të tekstit në gjuhën arabe, faqe 38.



## Ndarja e tetë

### PRANIA E ZEMRËS

Shumë prej rregullave të zemrës janë parathënie edhe për praninë e zemrës në kryerjen e adhurimit. Pa praninë e zemrës, adhurimi e humb shpirtin dhe kuptimin e tij.

Prania e zemrës në adhurime është çelësi i plotësimeve dhe porta kryesore për arritjen e llojeve të lumturive. Në hadithet e nderuara, fare pak përmendet dhikri, në krahasimin me sa shumë është përmendur në çështjen e pranisë së zemrës. Janë të pakta rregullat që e kanë arritur një interesim kaq të madh.

Jemi zgjatur shumë për të shpjeguar me hollësi këtë anë të kësaj çështjeje në kumtesën “Sirr’ rru-s’ salati”<sup>1</sup> – “Sekreti i namazit”, si dhe në librin “El - Erbeijne”<sup>2</sup>– “Dyzet hadithe”. Në këta dy libra kemi shpjeguar qartë gradët e shkallët e pranisë së zemrës, por këtu do të trokasim përsëri në përmendjen e dhikrit, me qëllim që lexuesi të përfitojë dhe të mos lodhet të lexojë dy librat e sipërpërmendur.

---

<sup>1</sup> Lexo shënimin 2 të tekstit në gjuhën arabe, faqe 14.

<sup>2</sup> Libri “Dyzet hadithe” është libri “Sherhun lieerbeijne hadijthen”, shpjegim për dyzet hadithe. Këta libra janë prej veprave të autorit të librit tonë, i cili i përfundoi dy librat në fjalë në muajin Muharrem të vitit 1358 hixhri.



Më sipër është thënë se adhurimet, ritualet dhe frazat e dhikreve i japin rezultatet të plota, kur bëhen fytyrë e brendshme për zemrën, sepse me ato është gatuar brumi i njeriut dhe, kur zemra fiton fytyrën e robërisë, ajo del prej gjendjes së renegatizmit e të kryengritjes.

Më përpara kemi shpjeguar se njëri prej qëllimeve për dobitë e adhurimeve është forcimi i vullnetit të shpirtit, shtrirja e pushtetit të shpirtit mbi natyrën dhe vënia e forcave të kësaj natyre në shërbim të fuqisë e të pushtetit të shpirtit, deri në atë cak sa vullneti hyjnor i shpirtit bëhet ndikues në mbretërinë e trupit dhe mbretëria e shpirtit bëhet si engjëjt ndaj Filluesit të krijimit, të cilët: “ لا يُضَوِّنُ اللَّهُ مَا يَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ” - “...là jaësùne-ll'للàhe mà emerehum ue jef'alùne mà juëmerùne” - “...nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe bëjnë atë që janë urdhëruar”.<sup>1</sup>

Tani do të shtojnë fjalët vijuese: njëri prej sekreteve dhe prej dobive shumë të rëndësishme të adhurimeve, që numërohet parathënie për atë adhurim, është: e brendshmja e njeriut dhe punët e dukshme që bën, të jenë të nënshtruara ndaj vullnetit të Allahut, të lëvizin me urdhrin e të Lartit. Bërja e cilësive shpirtërore dhe e cilësive të trupit të jenë ushtri në dispozicion të Allahut të Lartësuar, ushtri që, në raport me të Vërtetin e Lartësuar, janë të pajisura me cilësitë që kanë engjëjt ndaj Allahut të Lartësuar. Kjo gjendje, në vetvete, është njëra prej gradave të kësaj bote të asgjësimit të fuqive e të vullnetit të robit në vullnetin e të Vërtetit të Gjithëfuqishëm dhe, mbi këto cilësi, dalëngadalë, renditen rezultate të mëdha, deri sa njeriu i zakonshëm bëhet njeri hyjnor,

<sup>1</sup> Sure “Et Tahrim”, ajeti 6.



shpirti i të cilit kënaqet me adhurimin e Allahut Fuqiptotë. Gjithashtu, në këtë gjendje, edhe ushtritë e Iblisit janë para një disfate të pashmangshme, aq sa asnjërit prej ushtarëve të Iblisit nuk i mbetet ndonjë gjurmë në mbretërinë e ekzistencës së njeriut. Në këtë gjendje, zemra dhe fuqitë e ndryshme të njeriut janë të nënshtrua ndaj vullnetit të të Vërtetit të Lartësuar dhe te njeriu shkëlqen Islami, me disa prej gradëve të tij të brendshme. Për sa i përket frytit të këtij dorëzimi, para vullnetit të të Vërtetit të Lartësuar në Botën e Ardhshme, ky fryt do të konkretizohet me faktin se i Vërteti i Lartësuar e bën vullnetin e këtij robi mysliman një dritare nga e cila ai shikon botët e panjohura, për shembull e bën atë model për të Lartin Fuqiptotë. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar, i Pastërti, në Botën e Ardhshme, bën që, kur ky rob dëshiron një send, ai send është pranë robit, sapo robi të shfaqë dëshirën për atë send. Gjithashtu, i Larti i Gjithëfuqishëm, në të njëjtën mënyrë e bën të fuqishëm edhe vullnetin e robit.

Prej disave që kanë arritur gradën e njohjes është përcjellë fjala e të Dërguarit më të nderuar, në lidhje me banorët e Xhenetit, në të cilën ai njofton se një engjëll do të vijë te banorët e Xhenetit e do të kërkojë leje për të hyrë. Pastaj ky engjëll u jep banorëve të Xhenetit një letër. Me këtë letër, Allahu i Lartësuar u drejtohet atyre me fjalët: “Prej të Gjallit, të Përjetshmit, i Cili kurrë nuk vdes, drejtuar të gjallëve, të përjetshmëve që nuk vdesin.

Në vijim, Unë i them sendit “**bëhu**” dhe ai send menjëherë bëhet; Unë kam bërë që, edhe kur ju të shfaqni dëshirën për një send, ai send menjëherë do të jetë pranë kërkuarit. S’ka asnjë prej



banorëve të Xhenetit, që kërkon një send dhe ai send të mos jetë para tij”.<sup>1</sup>

Ky pushtet hyjnor, në të vërtetë, i jepet robit, pasi ai e ka lënë vullnetin e tij dhe, pasi e ka pastruar atë jo vetëm prej dëshirave vetjake, por edhe prej pushtetit të Iblisit e ushtarëve të Iblisit. Megjithëkëtë, asnjëri prej këtyre rezultateve nuk mund të realizohet pa praninë e plotë të zemrës dhe, nëse zemra është e shkujdesur, adhurimi i tij nuk bëhet i vërtetë dhe nuk është më shumë se një punë e ngjashme me eglendisjen e me lojën.

Pa dyshim që një adhurim i këtillë, ashtu siç theksohet në disa transmetime, nuk ndikon fare në shpirt dhe kurrë nuk lartësohet prej formës së dukshme për në formën e brendshme të cilësive shpirtërore. Gjithashtu, edhe fuqitë e shpirtit, me këtë adhurim, nuk ia dorëzojnë drejtimin shpirtit, por as pushteti i shpirtit nuk do të jetë i dukshëm në këtë adhurim. Dhe, rezultati: fuqitë e jashtme e të brendshme kurrë nuk do të jenë të dorëzuara para vullnetit të Allahut Fuqplotë dhe vullneti i njeriut kurrë nuk do të nënshtrohet para madhësisë së të Vërtetit të Gjithëfuqishëm. Kjo çështje është aq e qartë, sa nuk mund të jetë më qartë se kaq.

Për të gjitha këto shikojmë se në shpirtin tonë adhurimi që bëjmë, s’ka asnjë ndikim edhe pas dyzet ose edhe pas pesëdhjetë vjetësh adhurimi të vazhdueshëm. Me këtë lloj adhurimi, në zemrat tona nuk shtohet drita, përkundrazi, zemrat tona, nga dita në ditë, do të bëhen më të errëta, në zemrat tona kundërshtimi i forcave të shpirtit do të ashpërsohet dhe do të shumëfishohet dashuria jonë

---

<sup>1</sup> “Ilmul-Jekijn”, vëll. 2, f. 1061, me fare pak ndryshim.



për këtë botë. Njëkohësisht do të rrënjohet edhe më shumë nënshtrimi ynë ndaj dëshirave vetjake e ndaj cytjeve të shejtanit.

Pa dyshim që gjendja do të jetë e këfillë, nëse adhurimet tona janë të zbrazura nga brenda dhe, kur ne i kemi lënë kushtet e brendshme e rregullat e zemrës në kryerjen e adhurimeve. Kurse një namaz i falur me edukatën e plotësuar, ndalon prej gjynaheve të rënda dhe prej punëve të urryera, ashtu siç lexojmë në ajetin e nderuar: “وَالْمُنْكَرَانَ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ” - “...in’ne-s’salàte tenhà anil-fahshàì uel munkeri...” - “**...sigurisht që namazi ndalon prej gjynaheve të rënda e prej punëve të urryera...**”<sup>1</sup>

Është e qartë se ndalimi që bën namazi, nuk është vetëm ndalim i jashtëm, pasi namazi ndez në zemër një fanar dhe në brendësi shkëlqen një dritë, e cila e udhëzon njeriun drejt botës së panjohur dhe në brendësi të njeriut është një mburojë hyjnore, e cila e mbron atë nga kryengritja e nga kundërshtimi. Në këtë gjendje, ne e llogarisim veten tonë prej grupit të atyre që falin namaz dhe e kryejmë këtë adhurim madhor për shumë vite, megjithëkëtë në veten tonë ne nuk e shohim këtë dritë dhe nuk e prekim atë mburojë, prandaj, të mjerët ne atë ditë, kur punët tona do të formësohen dhe kur do të na jepen në dorë regjistrat e punëve tona dhe pastaj të na thuhet: “كَمْ يَتَفَسِّكُ الْيَوْمَ عَلَيْكَ حَسِبِيَا” - “...kefà binefsikel-jeume hasijben” - “**...mjafton që sot ia bën llogarinë vetes tënde**”.<sup>2</sup> Mendohu! Punë të këtilla, a janë të pranuar te Filluesi i krijimit, që ka emrat më të pastër? A mund të të afrojë ty te prania e madhështisë hyjnore një namaz i shtrembëruar e i kryer me këtë formë të errët? A mund të jetë në përshtatje me mënyrën me të cilën

---

<sup>1</sup> Sure “El Ankebüt”, ajeti 45.

<sup>2</sup> Sure “El Isrà”, ajeti 14.



ti e ke kryer këtë amanet madhor hyjnor dhe porosi të Profetëve e të eulijave, duke lënë kaq fushë të lirë para dorës tradhtare të shejtanit, i përzënë si armik i Allahut, që ti të ringjallesh me një namaz të këtillë? Përse namazi, që është “miraxhi i besimtarit”<sup>1</sup> dhe “kurbani i të devotshmëve”<sup>2</sup> të largoi ty prej hapësirës së afrimit tek Allahu i Lartësuar?

Në atë ditë, a nuk do të jetë pjesa jonë veçse brengosje, pendim, trysni, vështirësi e turpërim?

Në të vërtetë, jeta ime është brengosje e pendim, që s’kanë të ngjashëm në këtë botë. Jeta jonë është hidhërim e turpërim i atillë, që ne nuk mund të përfytyrojnë të ngjashme me ato. Brengosjet në këtë botë, edhe pse mund të jenë të përziera me shpresa mijëra formash, përsëri llogariten se kalojnë shumë shpejt, por është e kundërta me gjendjen e brengosjes e të pendimit, për të cilën njofton i Larti me fjalën e Tij: “وَأَنْزَلْنَاهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ إِذْ قُضِيَ الْأَمْرُ” - **“Paralajmëroji ata për ditën e brengosjes kur të përfundojë çështja (e gjykimit)....”**<sup>3</sup> Në atë kohë, çështja ka përfunduar dhe është e pamundur ndreqja e saj. Jeta kalon me humbje dhe s’ka mundësi të kthehet:

**“يَا حَسْرَتَىٰ عَلَىٰ مَا فَرَّطْتُ فِي جَنْبِ اللَّهِ” - “...i mjeri unë që lashë mangët respektin ndaj Allahut...”**<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Lexo “El-furû’u” min El-Kâfi”, vëll. 3, Libri: “Namazi”, K. “Mirësia e namazit”, f. 265.

<sup>2</sup> Lexo “El-furû’u” min El-Kâfi”, vëll. 3, Libri: “Namazi”, K. “Mirësia e namazit”, f. 265.

<sup>3</sup> Sure “Merjem”, ajeti 39.

<sup>4</sup> Sure “Ez - Zumer”, ajeti 56.



I nderuar lexues! Sot është dita që kemi kohë për të punuar. Mbaje në kujtesë se Profetët u dërguan me libra qiellorë. Ata bënë thirrje me zë të lartë dhe bënë gjithçka që kishin mundësi të bënin, për të kumtuar mesazhin, me të cilin kishin ardhur. Duruan fyerje e vështirësi të shumta, për të na zgjuar prej gjumit të shkujdesjes, që ne të jemi të vëmendshëm ndaj dehjes prej natyrës. U munduan të na çojnë në botën e dritës e të gëzimit dhe, së bashku, me ne, të arrijnë Jetën e Përherëshme e mirësitë e kënaqësitë e përjetshme. Ata punuan shumë për të na shpëtuar prej shkatërrimit, prej vështirësive, prej zjarrit, prej errësirës, prej brengosjes e prej pendimit.

Të gjitha këto ata i bënë për të mirën tonë, pa pasur në veten e tyre asnjë lakmi, që me thirrjen e tyre të arrinin ndonjë përfitim, për më tepër, ata nuk kishin as nevojën më të vogël për besimin e për punët tona.

Megjithëkëtë, ne nuk jemi ndikuar fare nga thirrja e tyre, sepse shejtani na i ka zënë veshët dhe ai është bërë sundues në të brendshmen e në të jashtmen tonë, deri në atë kufi sa te ne nuk ndikon asnjë fjalë prej këshillave të tyre, sepse në veshët dhe në zemrat tona s'ka arritur asnjë ajet i Kur'anit Famëlartë e asnjë hadith i nderuar dhe asgjë nga këto nuk e ka kaluar kufirin e veshëve kafshërorë.

I nderuar lexues, në përgjithësi, gjendja jote nuk është gjendja e shkruarit të këtyre radhëve. Ti je i privuar prej të gjitha dritave dhe del prej kësaj bote pa asnjë punë të mirë, del rob i dëshirave të vetes tënde, prandaj mëshiroje veten tënde dhe vili frutat e jetës tënde, orientohu me gjendjet e Profetëve e të eulijave; dërrmoji me këmbët tua dëshirat e rreme dhe premtimet e shejtanit;





mos u mashtro as prej dredhivë të shejtanit e as prej kurtheve të shpirtit urdhërues për të keqen; thyeji të gjithë këta vargoj dhe, me punën tënde, bëj që ata të fundosen thellë e më thellë, pasi shejtani e shpirti urdhërues për të keqen ngrenë vetëm kurthe e thurin dredhi dhe çdo punë të gabuar e të keqe e veshin me rrobën e të vërtetës, me qëllim që, me këtë veshje të rremë, ta mashtrojnë njeriun. Shejtani e shpirti urdhërues për të keqen, me mashtrime e me dredhi e tërheqin njeriun drejt vështirësive të mëdha dhe e mbajnë atë me shpresa të rreme, duke i thënë se mund të bëjë teube në fundin e jetës, por teubeja në fundin e jetës është një punë shumë e vështirë, për faktin se në moshën e pleqërisë errësirat e gjynaheve janë grumbulluar njëra mbi tjetrën, janë shtuar shumë shkeljet e të drejtave të njerëzve dhe mbi njerëzit kanë rënë shumë padrejtësi. Qysh do të realizohet kjo teube në këtë moshë, kur shejtani e shpirti urdhërues për të keqen e penguan vullnetin e njeriut, kur ai akoma ishte i fuqishëm, e penguan atëherë kur ai kishte fuqi që i vinin prej vrullit të rinisë dhe kur pema e gjynahut akoma nuk e kishte forcuar trungun e saj, madje në moshën e rinisë së njeriut qeveria e shejtanit akoma nuk i kishte forcuar kolonat e saj për të sunduar mbi të riun, pasi shpirtin ai e kishte të ri dhe ishte në moshën, kur cilësitë e njeriut janë më afër me cilësinë e pastër të krijimit të Allahut, duke shtuar se mosha e rinisë është koha kur kushtet për të bërë teube janë të shumta e të mjaftueshme. Në këtë moshë njeriu ka më shumë mundësi të shkulë nga rrënjët pemën e mëkateve, sepse trungu i kësaj peme akoma është i dobët. Mosha e rinisë është koha që njeriu ka më shumë mundësi t'i shkatërrojë kolonat e qeverisjes së shejtanit, sepse në këtë moshë, mosqeverisja e shejtanit mbi njeriun akoma nuk është forcuar. Por edhe pas kësaj pune të njeriut, përsëri shejtani e shpirti urdhërues për të keqen vazhdojnë ta mbajnë njeriun me shpresë, deri në moshën e pleqërisë, duke i



pëshpëritur se ai ka akoma kohë për të bërë teube. Mirëpo moshë e pleqërisë është e kundërta e moshës së rinisë. Në moshën e pleqërisë vullneti është dobësuar, njeriu s'ka më fuqi dhe rrënjët e pemës së gjynaheve të shumta janë forcuar. Gjithashtu, në moshën e pleqërisë, edhe qeveria e shejtanit është forcuar dhe ka arritur të vendosë sundimin e saj të plotë në të jashtmen e në të brendshmen e njeriut. Për më tepër, dëshira për të qenë i përjetshëm në natyrën e kësaj bote është shumë e fuqishme, por edhe largimi prej hyjnore është shtrirë në gjerësi, drita e pastër e krijimit është shuar dhe, në këtë moshë, kushtet për të bërë teube janë të vështira e të rënda. Patjetër që të gjitha këto shpresa s'janë gjë tjetër veçse mashtrim.

Shejtani e shpirti urdhërues për të keqen e mashtrojnë njeriun me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesve dhe me këtë mashtrim jo vetëm që e largojnë njeriun prej mjedisit të pastër të ndërmjetësuesve, por edhe e privojnë atë prej ndërmjetësimit të tyre. Veç kësaj, zhytja në gjynahe e bën zemrën të zezë e të kërrusur. Të gjitha këto e çojnë njeriun në përfundimin më të keq.

Qëllimi kryesor i shejtanit është që t'i heqë njeriut besimin dhe njeriu të bjerë në gjynahe, pasi gjynahet që bën njeriu, janë parathënia për realizimin e këtij qëllimi të shejtanit. Edhe kur njeriu shpreson në ndërmjetësimin, përsëri ai ka për detyrë të punojë me seriozitet dhe të përpiqet të ruajë lidhjen me ndërmjetësuesit e tij. Gjithashtu, ka për detyrë të mendojë pak edhe në gjendjet e atyre që do të ndërmjetësojnë në sheshin e Gjykimit të Madh, ashtu siç ka detyrë të mendojë edhe rreth kohës së gjatë që ka kaluar në adhurime e në ushtrime shpirtërore. Supozo se u largove nga kjo botë duke qenë besimtar, por, nëse barra e gjynaheve të tua dhe e padrejtësive që ke bërë, është e rëndë, patjetër që për ty nuk do të



ndërmjetësohet që të shpëtosh prej ndëshkimit të varrit dhe prej ndëshkimit në botën e Berzahut. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se Berzahu është në dorën e vetë njerëzve<sup>1</sup> dhe ndëshkimi në botën e Berzahut nuk krahasohet me llojet e ndëshkimit në këtë botë. Gjithashtu, askush përveç Allahut të Lartësuar nuk e di sa e gjatë do të jetë koha në botën e Berzahut, pasi kjo kohë mund të zgjasë me miliarda vite. Jo vetëm kaq, por edhe në Ditën e Kiametit, ndërmjetësimi do të arrihet vetëm pas një kohe të gjatë dhe pas vënies para formave të shumta të ndëshkimit, që nuk përballohen. Për të gjitha këto flasin hadithet e nderuara.<sup>2</sup>

Shpresat, me të cilat shejtani e josh njeriun, janë prita para tij, që ai të mos bëjë punë të mira, madje shpresat mashtruese të shejtanit bëjnë që njeriu ta lërë këtë botë ose me iman të grabitur, ose i ngarkuar rëndë me barra të ndryshme, për rrjedhojë do të bjerë në vështirësi të mëdha e trysni që njeriut nuk mund t'i shkojnë në mendje.

Herë tjetër, shejtani e privon njeriun prej mëshirës, duke i dhënë atij shpresa me mëshirën e Mëshirëplotit, për rrjedhojë njeriu anashkalon e shpërfill faktin që janë dërguar Profetë, janë zbritur libra qiellorë, janë dërguar engjëj, s'ka kujdes as ndaj shpalljes që

<sup>1</sup> Është fjala për hadithin e përcjellë prej Amr bin Jezjedit, i cili tregon bisedën që ka bërë me Ebu Abdullahun. E ka pyetur rreth asaj që kishte dëgjuar prej tij, se të gjithë pasuesit e tyre janë në Xhenet, edhe me ato që rëndojnë mbi ta. Ai është përgjigjur: "*Të vërtetën po thua. Pasha Allahun! Të gjithë ata janë në Xhenet*". Përcjellësi vazhdon: "*Kurban t'u bëfsha, por ja që fajet janë të shumta e të rënda*". Ai tha: "*Në Ditën e Gjykimit, ju të gjithë do të hyni në Xhenet me ndërmjetësimin e Profetit, të cilit i jeni bindur, ose të porositurit të Profetit. Por unë kam frikë për ju në botën e Berzahut*". E pyeta se ç'është Berzahu. Ai tha: "*Varri, që nga koha kur besimtari vdes, deri në Ditën e Kiametit*". Referoju "*El-Furû'u*", prej librit "*El-Kâfi*", vëll. 3, f. 242, si dhe librit "*Ilmul-Jekijn*", vëll. 2, f. 1051.

<sup>2</sup> Referoju "*Bihârul Enuâr*", vëll. 8, f. 362.



kanë marrë Profetët e as ndaj frymëzimit që marrin udhëzuesit e rrugës së vërtetë. Të gjitha këto përfaqësojnë mëshirën e Mëshirëplotit, përfaqësojnë mëshirën e më të Mëshirshmit. Mëshira e të Vërtetit të Lartësuar përfshin të gjithë botën dhe ne jemi në bregun e burimit të jetës, megjithëkëtë ne e lëmë veten të vdesim nga etja. Për këtë mëshirë e për këto gjendje, udhëzuesi më i besueshëm e më i madh është Kur'ani Famëlartë. Besimtari lakmon të arrijë mëshirën e të Gjithëmëshirshmit dhe shpreson të arrijë mëshirën e Tij të gjerë, me qëllim që të ketë dobi me këtë mëshirë të zbritur, me Kur'anin Famëlartë, me këtë Libër madhor, që hapi rrugën për të arritur lumturinë dhe shpjegon qartë edhe punët që ndalojnë rrëzimin në greminë, punë që mundësojnë ecjen në rrugën e qartë. Por ti, o njeri, e rrëzon veten tënde në greminë, ngaqë ecën nëpër rrugë të thepisura. Si mund të thuhet se mëshira është e paktë, kur shikon punët e tua? Jo, është vetë njeriu ai që nuk e spraps veten, për të mos rënë në greminë. Njeriu bie në greminë, ngaqë nuk është i vëmendshëm ndaj rolit të Profetëve.

Sikur udhëzimi në rrugën e punëve të mira dhe lumturisë të kishte mundësi të realizohej me ndonjë mënyrë tjetër, patjetër që Profetët e të Dërguarit do ta kishin shpjeguar këtë rrugë, duke u bazuar në mëshirën e gjerë, në mëshirën e pamatur të Filluesit të krijimit, i lartë e i respektuar është emri i Tij. Gjithashtu, sikur të ishte e mundur që njerëzit të çoheshin drejt lumturisë, pa dashjen e tyre, me siguri që Profetët e të Dërguarit do ta kishin bërë edhe këtë punë. Por, sa larg është kjo punë! Rruga e Botës Tjetër, është rrugë që as nuk mund të futet në shportën e zgjedhjeve të njeriut e as nuk matet me hapat që ai hedh. As lumturia nuk realizohet me imponim, as virtyti nuk është virtyt e as puna e mirë nuk është punë e mirë, kur ato zhvishen prej zgjedhjes së njeriut. Mbase këtë



kuptim e thekson ajeti i nderuar: “لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ” - “...là ikràhe fi-d' dijni...”  
- “...s'ka imponim në fe...”<sup>1</sup>

Po! Nëse është mundur që dikush të detyrohet, në të vërtetë, kjo mënyrë veprimi është forma e fesë hyjnore, por nuk është e vërteta e fesë. Gjithashtu, edhe Profetët ishin të ngarkuar, që ta bënin detyrim këtë fe mbi njerëzit, me të gjitha rrugët e mundshme, me qëllim që të mundësohet që forma e botës të jetë forma e drejtësisë hyjnore dhe kjo drejtësi hyjnore të jetë orientuese e të depërtojë në brendësi të njerëzve dhe pastaj njerëzit të ecin në rrugën e kësaj feje me zgjedhjen e tyre e me synimin për të arritur lumturinë.

Në përgjithësi, mashtrimet e shejtanit e privojnë njeriun prej mëshirës dhe për të synuar mëshirën.

---

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 256.



## Ndarja e nëntë

# HADITHE TË ARDHURA PREJ EHLI BEJTTI, QË SHTOJNË DËSHIRËN PËR PRANINË E ZEMRËS

Në këtë pjesë do të mjaftohemi të sjellim disa prej këtyre haditheve:

- I Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Adhuroje Allahun, sikur e sheh me sy! Edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai ty të sheh*”.<sup>1</sup>

Prej këtij hadithi të nderuar mësohen dy gradë prej gradëve të pranisë së zemrës:

*E para:* rrugëtari në udhën e adhurimit e sheh bukurinë e të Bukurit dhe është i mbuluar në brendësi prej shkëlqimeve të pranisë së të Dashurit, aq shumë, sa organi i dëgjimit, zemra e tij janë të shurdhra, që të dëgjojnë qeniet e tjera; syri i vëzhgimit të tij të brendshëm hapet për të parë bukurinë e pastër të Zotëruesit të madhështisë dhe ai sy nuk sheh asgjë tjetër përveç Atij. Në tërësi,

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 74, f. 74 dhe “Mekàrimul Akhlàk”, f. 459.



ai ka në mendje vetëm faktin se është para të Lartit dhe nuk i shkon në mendje vendi ku ndodhet.

*E dyta:* kjo gradë është më e ulët se grada e parë. Në këtë gradë rrugëtari në udhën e adhurimit e sheh veten të pranishëm në kuvendin hyjnor dhe bën kujdes të respektojë edukatën e pranisë e të kuvendit.

I Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse ke mundësi, bëhu prej atyre të gradës së parë. Adhurimin për Allahun kryeje me këtë mënyrë dhe mos harro që je në kuvendin hyjnor, mos harro edukatën që je para të Vërtetit të Lartësuar, sepse shkujdesja nga kjo edukatë numërohet largim prej pozitës së robërisë”.

Ky kuptim theksohet në hadithin e nderuar, i përcjellë prej Ebu Hamza Et' themaliut (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) i cili tregon: “Pashë Ali bin Hysenin duke falur namaz. Gjatë faljes, rroba e sipërme i rrëshqiti prej supeve, por ai nuk e ngriti rrobën, deri sa përfundoi faljen e namazit. Unë e pyeta për këtë dhe ai më tha: “I mjeri ti, a e di se para kujt isha?”<sup>1</sup>

I Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Dy burra prej umetit tim falin namaz dhe rukuja e sexhdeja e tyre është një, por largësia mes namazeve të atyre të dyve është sa largësia mes qiellit e tokës”.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> “Vesàilu-sh'shij'ah”, vëll. 4, Libri “Es'salātu”, Pjesa “Ef'alu-s'salāti”, K. 3, Hadithi 6, f. 688.

<sup>2</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 81, f. 249.



Gjithnjë prej tij lexojmë: *“A nuk ka frikë ai që e kthen kokën gjatë faljes së namazit se Allahu do t’ia kthejë kokën drejt kokës së gomarit?”*<sup>1</sup> Përsëri, prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: *“Ai që fal dy rekate namaz dhe gjatë faljes së namazit nuk i flet vetes për asnjë send prej sendeve të kësaj bote, Allahu i Lartësuar ia fal fajet”*.<sup>2</sup> *“Në të vërtetë, prej namazit pranohet gjysma e tij, ose një e treta, ose një e katërta, ose një e pesta deri në një të dhjetën. Ka edhe namaz që pështillet si një rreckë e ndyrë dhe me atë i bihet në kokë atij që fali këtë namaz. Prej namazit tënd do të kesh vetëm aq sa e ke afruar zemrën tënde tek ai namaz”*.<sup>3</sup>

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kur robi besimtar është duke falur namaz, Allahu hedh shikimin mbi të. Allahu afrohet tek ai dhe, deri sa ai të përfundojë faljen e namazit, atij i bën hije mëshira sipër kokës deri në horizontet e qiellit. Edhe engjëjt mbliidhen rreth tij, deri në horizontin e qiellit. Allahu i Lartësuar ngarkon një engjëll të qëndrojë mbi kokën e tij e t’i thotë: ‘Ti që fale namazin, sikur ta dije se Cili po të shikonte, sikur ta dije se me Cilin po bisedoje në intimitet dhe se kush të ka rrethuar, ti kurrë nuk do të ngriheshe prej vendit ku je’”*.<sup>4</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Në një zemër, në të cilën bëhen së bashku dëshira dhe frika, nuk ndodh ndryshe veçse për atë njeri bëhet detyrim që ai të jetë në Xhenet. Kur të falësh namaz, dil para Allahut Fuqiptotë me zemrën tënde. S’ka ndonjë rob, i cili në namazin e*

---

<sup>1</sup> “Mustedrekul-Vesàil”, Libri “Es’ salātu”; Pjesa “Ebvàbu-S’ salàti”, K. 2, Hadithi 20.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, Hadithi 13.

<sup>3</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 81, f. 260.

<sup>4</sup> “Mustedrekul-Vesàil”; Libri “Es’ salātu”, Pjesa “Ef’ àlu-s’ salàti”, K. 2, Hadithi 22.





*në lutjet e tij i afrohet Allahut Fuqiplotë me zemrën e tij, që Allahu të mos i afrohet atij me zemrat e besimtarëve e të mos e mbështesë atë me dashurinë e tyre dhe atë vetë me Xhenetin”.<sup>1</sup>*

Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë thënë: *“Në namazin që ti fal, do të kesh prej tij vetëm aq sa t’i i je afruar atij. Nëse namazi për ty është iluzion, ose ti je i shkujdesur dhe nuk respekton edukatën e faljes së namazit, ai namaz mbështillet shuk dhe me atë rrihet fytyra e atij që fali këtë namaz”.<sup>2</sup>*

Prej të zgjeruarit në dituri, Imam Zejnel Abidinit, lexojmë: *“Prej namazit të robit, pa dyshim që ngrihet lart gjysma e namazit, ose një e treta, ose një e katërta, ose një e pesta; por prej namazit të tij ngrihet lart vetëm aq sa ai i ishte afruar namazit me zemrën e tij gjatë faljes së namazit. Në të vërtetë, ne kemi urdhëruar faljen e namazeve nafile, që me ato të plotësohen ato që janë lënë mangët në faljen e namazeve farz”.<sup>3</sup>*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur të ngrihesh për të falur namaz, afrohu te namazi me zemër. Kur t’i i afrohesh namazit me zemër, Allahu afrohet te ti, por, nëse ti i kthen shpinën namazit, edhe Allahu ta kthen shpinën ty. Mbase prej namazit nuk ngrihet lart veçse një e treta, ose një e katërta, ose një e gjashta e namazit, sipas masës që falësi i namazit i është afruar namazit të tij. Allahu nuk i jep asgjë të shkujdesurit ...”<sup>4</sup>*

<sup>1</sup> “Vesàilu-sh’shij’ah”, vëll. 4, Libri “Es’salàtu”, Pjesa “Ef’alu-s’salàti”, K. 3, Hadithi 3, f. 687.

<sup>2</sup> “Vesàilu-sh’shij’ah”, vëll. 4, Libri “Es’salàtu”, Pjesa “Ef’alu-s’salàti”, K. 3, Hadithi 1, f. 687.

<sup>3</sup> “Ilelu-sh’sherà’i”, vëll. 2, f. 327, K. 24, Hadithi 2.

<sup>4</sup> “Mustedrekul-Vesàil”; Libri “Es’salàtu”, Pjesa “Ef’alu-s’salàti”, K. 3, Hadithi 7.



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “O Ebu Dherr, dy rekate të shkurtra namaz, duke medituar, janë më të vlerësuara se falja gjithë natën dhe zemra është e shkujdesur”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> “Mekàrimu-Akhlàk”, f. 465 dhe prej tij “Bihàrul Enuàr”, vëll. 74, f. 82.



## Ndarja e dhjetë

### FORCIMI I PRANISË SË ZEMRËS

Tani që u njohë me mirësinë e pranisë së zemrës e me karakteristikat e këtij afrimi me rrugën e logjikës e me rrugën e tekstit dhe, pasi mësove edhe pasojat e këqija që vijnë nga mungesa e pranisë së zemrës, dije mirë se vetëm dituria nuk mjafton. Madje dituria plotëson argumentin kundër teje, prandaj përvish krahët e punës, me vullnet të plotë dhe përpiqu të arrish atë çka njohë dhe konkretizojë atë çka mësove, pasi vetëm kështu do të përfitosh prej diturisë dhe të marrësh edhe frutat e saj.

Mendo pak rreth haditheve të ardhura prej Ehli Bejt, prej të ruajturve prej gjynaheve, fjalët e dituritë e të cilëve bazohen vetëm në shpalljen që i erdhi Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Le t'i shikojmë këto hadithe, që theksojnë se pranimi i namazit është kusht për pranimin e punëve të tjera dhe është kusht i atillë, saqë, kur nuk pranohet namazi, nuk shikohet fare në punët e tjera. Por pranimi i namazit qëndron në praninë e zemrës në namazin që falet, prandaj pa praninë e zemrës, namazi s'ka asnjë vlerë. Një namaz i këtillë nuk meriton të jetë as në praninë e të Vërtetit të Lartësuar dhe nuk e ka as shansin të pranohet prej Tij.



Kur ti arrin të kuptosh se prania e zemrës është çelësi i thesarit të punëve, se prania e zemrës është porta nga hyhet për të arritur të gjitha lumturitë, atëherë ti ndërgjegjësohesh, se me praninë e zemrës, për njeriun, hapet porta e lumturisë dhe pa praninë e zemrës, të gjitha adhurimet s'kanë asnjë vlerë.

Mendo pak dhe mundohu të nxjerrësh mësim, njëkohësisht, mendo me syrin vëzhgues të brendshëm, për rëndësinë e madhe të pozitës e për gjerësinë e vendqëndrimit, pastaj fillo të punosh me seriozitet. Atëherë, çelësi i portës së lumturisë, çelësat e portave të Xhenetit, çelësi i portave të vështirësive dhe çelësat e portave të Xhehenemit janë në dorën tënde. Për aq kohë sa je në këtë botë, ke mundësi të hapësh për veten tënde portat e Xhenetit dhe portat e lumturisë, ose të hapësh portat e Xhehenemit dhe të ndëshkimit. Në këtë botë, frerët e punëve janë në dorën tënde, por mos harro se Allahu i Lartësuar e ka plotësuar argumentin kundër teje dhe për këtë të ka shpjeguar qartë rrugët e lumturisë e të vështirësive. Allahu i Lartësuar të ka dhënë forma të dukshme të suksesit dhe për ty e ka bërë realitet rolin me të cilin i Larti lidhet me eulijatë e Tij. Tani ka mbetur roli i nismave tona. Ata, eulijatë, janë udhëzues, kurse ne jemi rrugëtarët. Eulijatë e realizuan misionin e tyre në mënyrën më të mirë, aq sa për ne s'ka rrugë të justifikohemi, madje për ne s'ka rrugë për justifikim, as sa të luajmë qerpikun. Ti që je në gjumin e shkujdesjes, zgjohu dhe fillo të ecësh në rrugën e lumturisë tënde, përfito prej jetës e prej fuqisë tënde, sepse koha kalon dhe ti e humb atë pjesë të jetës, që të është dhënë prej vrullit të rinisë e prej rezervave të fuqisë e të mundësive, prandaj mos harro se ti s'ke asnjë mundësi ta kompensosh këtë humbje. Nëse je i ri, mos e ushqe veten me iluzione, se do të punosh, kur të vijë pleqëria. Në moshën e pleqërisë, para teje janë vështirësitë, të cilat



i njeh i moshuari dhe tani që t'î që je i ri, s'ke asnjë njohuri si janë vështirësitë e pleqërisë. Për më tepër, përmirësimi në kohën e pleqërisë, në kohën kur njeriu bëhet i pafuqishëm, patjetër që është prej punëve shumë të vështira.

Por edhe në moshën e pleqërisë, mos lejo që të shkojë kot edhe ajo pjesë e jetës, që të ka mbetur. Sido që të jetë gjendja, ti vazhdo të bësh edhe atë që quhet më pak. Deri sa je në këtë botë, para teje, rruga e lumturisë është e hapur dhe, Allahu mos e lejoftë, sikur kjo rrugë të mbyllet para teje, atëherë ti do të humbësh zgjedhjen tënde të punëve dhe pas teje nuk do të mbetet gjë tjetër përveç brengosjes e pendimit për të kaluarën.

Atëherë, kur ti i nderuar beson në ato që u përmendën më sipër, domethënë beson në mesazhin që kumtuan profetët dhe e ke përgatitur veten për të arritur lumturinë e për të udhëtuar për në Botën e Ardhsme, gjithashtu, ke besuar edhe për domosdoshmërinë e "pranisë së zemrës", që është çelësi i thesarit të lumturisë, dije mirë se rruga për realizimin e pranisë së zemrës është si më poshtë:

Në radhë të parë, ke detyrë të zhdukësh të gjitha pengesat ndarëse që e ndalojnë praninë e zemrës, të heqësh idhujtarinë prej udhës tënde dhe pastaj bëj përpara, që të arrish praninë e zemrës.

Për sa i përket pengesës që e ndalon praninë e zemrës në adhurimet, ajo pengesë vjen për shkak të shpërqendrimit e të mendimeve dhe të gjërave të shumta që vijnë në zemër. Kjo gjendje mund të jetë për shkak të faktorëve natyrorë, që merren me anë të shqisave të jashtme. Janë këta faktorë, që e bëjnë sikur veshi i njeriut dëgjon ndonjë gjë gjatë kryerjes së adhurimit, për rrjedhojë mendja



lidhet me atë që i duket se dëgjoji dhe ajo bëhet burim për përfytyrime e për mendime që vijnë nga brendësia dhe me këto përfytyrime e mendime njeriu fluturon nga njëra degë në degën tjetër.

Ose syri i njeriut shikon një send dhe sendi që ai pa, bëhet shkak që t'i shpërqendrojë atij mendjen dhe, rezultati: njeriu nuk e ka më përqendrimin në adhurimin që kryen; ose shqisat e tjera të njeriut ndiejnë e kapin një send, i cili bëhet shkak që ai send të krijojë përfytyrime boshe në mendjen e njeriut.

Nëse thuhet se ilaçi për mjekimin e këtyre gjendjeve plotësohet me zhdukjen e këtyre shkaqeve, sikur për shembull njeriu që fal namaz në një shtëpi të errët, ose e fal namazin në një vend, në të cilin realizohet vetmia e plotë, ose ai i lidh sytë gjatë faljes së namazit, ose ka kujdes dhe e fal namazin në një vend larg gjërave që mund t'ia tërheqin vëmendjen e shikimin e tij, ashtu siç është përcjellë prej dëshmorit Sejid (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) dhe që e ka dëgjuar prej disa adhuruesve të përkushtuar, të cilët i kryenin adhurimet e tyre në një vend të errët e aq të vogël, saqë mjaftonte vetëm sa për të falur namazin.<sup>1</sup> Për të gjitha këto, ne themi se pamjaftueshmëria, në tërësinë e të gjitha shkaqeve që u përmendën, nuk është e panjohur për zhdukjen e pengesës dhe për asgjësimin e shkakut kryesor, sepse baza për këtë qëndron në largimin e përfytyrimit sa më shumë dhe, dihet se përfytyrimi lëviz edhe për shkakun më të vogël, por përfytyrimi, sado i vogël e i vagulluar të jetë, shtohet edhe më shumë, kur njeriu e fal namazin në vetmi, në një dhomë të vogël e të errët. Për më tepër, në një

---

<sup>1</sup> "Et'tenbijhàul-alij'jetu alà vedhàifi-s' salàtil-kalbij'jeh", f. 110; (botuar së bashku me një tubë raportesh të dëshmorit të dytë, botim litografik).



mjedis të këitillë shtohen edhe shkaqe të tjera, që e shqetësojnë mendjen e njeriut dhe e largojnë atë nga përqendrimi në namazin që po fal.

Atëherë, largimi plotësisht i pengesës kryesore, patjetër që duhet bërë me rrugën e përmirësimit të përfytyrimeve të vagulluara. Për këtë çështje do të flasim në vijim.

Patjetër që ky lloj ilaçi mund të ndikojë te disa njerëz dhe jep ndihmesën e vet për ta, por ne do të kërkojmë për gjetjen e ilaçit përfundimtar dhe do të punojmë për çrrënjosjen e shkaktarit të vërtetë. Përmirësimi i gjendjes nuk arrihet me ilaçin e lartpërmendur.

Ndodh që shpërqendrimi i vëmendjes dhe pengesa që ndalon praninë e zemrës të vijnë prej çështjeve të brendshme dhe, kjo, në mënyrë të përgjithshme, vjen prej dy shkaqeve kryesore, shkaqe që kanë lidhje me shumicën e punëve të tjera.

Njëri prej këtyre dy shkaqeve është lëshimi i frerëve të përfytyrimit, kotësia e përfytyrimit dhe paqëndrueshmëria e përfytyrimit. Përfytyrimi, në natyrën e tij, është një fuqi shqetësuese dhe gjithmonë ngjason me shpendin fluturues, që kalon nga një degë në tjetrën e nga një çati në tjetrën. Kjo gjendje e përfytyrimit, që kalon në mendjen e njeriut, gjatë kohës kur ai kryen adhurim, s'ka lidhje as me dashurinë për këtë botë, as me nxitimin pas punëve të saj, ose me pasurinë e as me dukuritë e tjera të kësaj bote. Pa dyshim që fluturimi i përfytyrimeve është një pësim i rëndë, nga i cili mund të preken deri edhe ata që kanë hequr dorë prej kësaj bote.



Fitimi i gjendjes së qëndrueshme të mendjes, siguria e qetësia e shpirtit dhe qetësimi i përfytyrimeve, janë prej punëve të rëndësishme, me të cilat mundësohet arritja e ilaçit përfundimtar. Edhe këtë çështje, gjithashtu, do ta trajtojmë në vijim.

Shkaku tjetër është dashuria për këtë botë dhe lidhja që kanë mendimet ndaj kësaj bote. Kjo gjendje është nëna e të gjitha sëmundjeve të brendshme jopatologjike, është një ferrë në rrugën e rrugëtarëve në udhën e adhurimit dhe është një burim për shumë vështirësi e pësime të rënda. Përderisa zemra është e lidhur me këtë botë dhe është e zhytur në dashurinë për këtë botë, patjetër që rruga për përmirësimin e zemrave është e mbyllur dhe, për rrjedhojë, para njeriut është e mbyllur edhe porta e të gjitha lumturive.

Me dashjen e Allahut Fuqiptotë, në dy ndarjet vijuese do të flasim për largimin e këtyre dy shkaqeve, që, në të vërtetë, janë dy pengesa të forta.





**Ndarja e njëmbëdhjetë**

## **ILAÇI PËR SHMANGIEN E ABSURDITETIT**

### **TË PËRFYTYRIMIT, PËR TË FORCUAR PRANINË E ZEMRËS**

Dije se secila prej fuqive të dukshme e të brendshme të shpirtit mund të disiplinohet dhe mund t'u mësohet të tjerëve me rrugën e një edukimi të veçantë. Për shembull, syri i njeriut e ka të pamundur të përqendrohet në një pikë të caktuar, ose të shikojë në një dritë të fortë, siç mund të jetë shikimi në diskun e diellit për një kohë të gjatë pa i mbyllur sytë, madje edhe duke i shtrënguar fort kapakët e syve. Por, kur njeriu e mëson syrin e tij, ashtu siç bëjnë disa praktikues ushtrimesh të gabuara për të arritur qëllime të caktuara, ky mësim i jep mundësi atij të përqendrojë shikimin në diskun e diellit me orë të gjata, pa i mbyllur sytë e pa ndier asnjë lodhje, ose i mundëson atij të shikojë në një pikë të caktuar për shumë orë, pa e hequr fare shikimin nga pika mbi të cilën ka përqendruar shikimin.

Kështu qëndron puna edhe me të gjitha fuqitë e tjera të depozituara te njeriu, deri në ndalimin e frymëmarrjes. Prej praktikuesve të ushtrimeve të gabuara, tregohet se ka prej atyre që e ndalojnë frymëmarrjen për një kohë më të gjatë nga ajo që njihet në specien njerëzore.



Gjithashtu, prej fuqive që mund të disiplinohen janë edhe fuqia e përfytyrimit dhe fuqia e iluzioneve. Këto dy fuqi, para se të disiplinohen, përshkruhen me cilësinë e një shpendi, që bën lëvizje të shumta dhe kalime të shpejta nga njëri vend në tjetrin, madje lëvizjet e kalimet e këtij shpendi janë aq të shpejta, sa, kur njeriu dëshiron t'i numërojë të gjitha lëvizjet e kalimet që bën ky shpend vetëm brenda një minute, me siguri do të gjejë disa kalime të njëpasnjëshme të shpejta, njëkohësisht gjen edhe një lidhje të dobët ndërmjet objekteve në të cilat ai shpend kalon, pa pasur ndonjë bazë të caktuar për këto kalime. Pikërisht ky fakt, i ka shtyrë shumë vetë të besojnë në pamundësinë e ruajtjes dhe edukimit të përfytyrimit, prandaj janë shprehur se kjo punë hyn në kuadrin e punëve të njohura si pamundësi dhe, e gjitha kjo, në një kohë kur çështja nuk është aspak e këtillë, sepse dihet që, në saje të ushtrimeve, arrihet që fluturimi i përfytyrimit të bëhet në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu, në saje të edukimit me ushtrime të shumta, bëhet e mundur që shpendi të lëvizë e të kalojë nga njëri vend në një tjetër, në përputhje me zgjedhjen e njeriut e me vullnetin e tij, i cili, në saje të edukimit me ushtrime të veçanta, mund ta ndalojë përfytyrimin edhe për disa orë, për të realizuar një qëllim të caktuar, ose për të plotësuar një kërkesë konkrete.

Rruga bazë për të nënshtruar përfytyrimin kërkon që njeriu të veprojë në kundërshtim me punën e vet. Për ta konkretizuar këtë, le të marrim si shembull rastin kur njeriu e përgatit veten për të falur namaz, me qëllimin që ta mbajë përfytyrimin brenda kufijve normalë dhe praktikisht ai e ndalon përfytyrimin, por ai e liron atë, sapo përfytyrimi përpiqet të shpëtojë prej dorës së tij. Për ta arritur këtë gjendje, ai që fal namaz, është plotësisht i vëmendshëm në çdo lëvizje që bën, në çdonjërin prej veprimeve që kërkon falja e



namazit dhe në të gjitha lutjet e namazit. Në këtë gjendje, ai e mban përfytyrimin të shtrënguar dhe nuk e lë përfytyrimin të fluturojë sipas dëshirës.

Në fillim kjo punë duket shumë e vështirë, por pas një kohe këmbënguljeje dhe duke e vazhduar ushtrimin me korrektësi, bëhet e mundur që fluturimi i përfytyrimit të nënshtrohet dhe të edukohet.

Mos kujto se ti ke mundësi të mbërthesh fluturimin e përfytyrimit gjatë kohës që fal namazin, që në fillim të përpjekjes. Jo, kjo punë është e pamundur të ndodhë dhe natyrisht që është prej punëve që nuk mund të bëhet. Ka mundësi që pretendimi i atyre që thonë se ndalimi i përfytyrimit është i pamundur të arrihet, vjen për shkak se në fillim të punës për edukimin e përfytyrimit me ata ndodh kjo gjë, sepse kjo punë nuk mund të realizohet ndryshe, veçse gradualisht, me maturi, me durim dhe duke përballuar edhe barrën e këtyre ushtrimeve.

Në fillim të punës, është e mundur që përfytyrimi të ndalohet vetëm në të dhjetën e namazit, ose edhe më pak, por falësi i namazit e arrin praninë e zezës edhe brenda kësaj pjese kohe të vogël dhe më pas, për njeriun vjen një rezultat më i mirë, kur ai vazhdon të mendojë rreth kësaj pune. Atëherë ai shikon se, me të vërtetë, ka nevojë për praninë e zezës gjatë faljes së namazit. Me këtë rrugë njeriu, pak e nga pak, sundon mbi iluzionin djallëzor e mbi fluturimet e përfytyrimit dhe, në kohën më të madhe të faljes së namazit, ai ka në dorën e vet frerët e iluzionit e të përfytyrimit.

Njeriu kurrë nuk duhet të dëshpërohet e të humbë shpresën, pasi nga humbja e shpresës e nga dëshpërimi vijnë të gjitha llojet e



dobësive e të pamundësive, në një kohë që shpresa e çon njeriun drejt plotësimit të lumturisë për veten e vet.

Çështja më e rëndësishme në këtë punë është që njeriu të ndiejë se ka nevojë për këtë edukim dhe, kjo është më e pakta që ne mund të arrijmë, sepse zemrat tona nuk besojnë se namazi është kapitali për të siguruar lumturinë në Botën e Ardhshme, zemrat tona nuk besojnë se namazi është mjeti për të arritur gjallërinë e përhershme e të përjetshme. Në të kundërt, ne e shikojmë namazin si një taksë, që duhet ta paguajmë kundrejt jetës sonë, ose e konsiderojmë namazin si një punë, që na është dhënë me detyrim. Është normale që dashuria për një send të lindë, pasi të arrihen rezultatet e atij sendi. Ne kemi dashuri për këtë botë dhe, është fakt, që ne ndiejmë gjithçka që është në botën tonë. Veç kësaj, zemrat tona janë të lidhura me këtë botë, prandaj ne nuk kemi nevojë të rendim për të shkuar pas atij që na bën thirrje e na nxit për dashuri ndaj kësaj bote. Ata që pandehnin se thirrja e Vulës së Profetëve, thirrja e të Dërguarit hashimi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka dy anë, anën e kësaj bote dhe anën e Botës Tjetër. Ata mendojnë se këtu qëndron edhe shkaku që Sjellësi i ligjit të fesë islame është lartësuar në gradën e plotësuar të profetësisë. Por në të vërtetë, ata nuk kanë asnjë dituri për punët e fesë, prandaj kanë shumë nevojë të njihen me thirrjen islame dhe me objektivin e profetësisë.

Thirrja për dashuri ndaj kësaj bote është tërësisht jashtë objektivit të thirrjeve që kanë bërë profetët e mëdhenj, ashtu siç është jashtë objektivit të profetëve edhe thirrja për të vepruar sipas instinkteve, për të plotësuar dëshirat, epshin e për të mos e përmbajtur zemërimin dhe për të dëgjuar shejtanin e dukshëm e



shejtanin e padukshëm. Është fakt se thirrjet për dashurinë ndaj kësaj bote janë të shumta. Për thirrjet për dashurinë ndaj kësaj bote s'ka nevojë që të dërgohen profetë. Gjithashtu, edhe ngopja e epsheve, plotësimi i dëshirave dhe mospërmbajtja e zemërimit nuk kërkojnë që të zbriste Kur'ani ose të vinte një profet. Pa dyshim që profetët janë dërguar për të ndaluar njerëzit nga dashuria për këtë botë dhe që njerëzit të frenojnë dëshirat, të mos i lëshojnë frerët e dëshirave e as frerët e zemërimit, por detyra e njerëzve është që t'u vënë kufi burimeve të përfitimit prej dëshirave dhe prej zemërimit. Vetëm të shkujdesurit pandehin se profetët kanë bërë thirrje për dashurinë për këtë botë, madje janë po kaq të shkujdesur, kur thonë: "Nuk mund të bëhet pasuri me rrugë të tjera, përveçse me rrugën e tregtisë, industrisë dhe bujqësisë". Flakët e epshit nuk shuhën me asnjërën prej rrugëve, prandaj bëj kujdes që kjo punë të plotësohet me rrugën e martesës, edhe pse në origjinë, në punën e epshit e të zemërimit është lëshimi i frerëve.

Profetët e kanë ndaluar lëshimin e frerëve të epshit e të zemërimit dhe s'kanë bërë thirrje për dashurinë ndaj kësaj bote, prandaj fryma e thirrjes së profetëve për tregti është kufizim për realizimin e fitimit me rrugë haram. Gjithashtu, edhe fryma e thirrjes për martesë është kufizimi i natyrës së instinkteve njerëzore, me qëllimin e lartë, për të ndaluar imoralitetin dhe për të mos iu nënshtruar fuqisë së epsheve.

Po, profetët nuk janë kundërshtarë të ndalimit të dëshirave dhe epsheve në mënyrë absolute, sepse një kërkesë e këtillë është në kontradiktë me udhëzimin për të arritur sistemin më të plotësuar.



Në përgjithësi, pa dyshim që ne e ndiejmë nevojën për këtë botë, ne e kuptojmë se kjo botë është kapitali i jetës dhe burimi i kënaqësive. Ne, njerëzit, jemi të përgatitur për t'iu afruar kësaj bote dhe për të punuar me dëshirë e me ngulm, për të arritur kënaqësitë e mirësitë e kësaj bote dhe për realizimin e këtyre qëllimeve do të bëjmë atë që është më e shtrenjtë e më e dobishme.

Për sa i përket dobësisë e fishkjes që gjendet ndër ne, kjo vjen për shkak të uljes së nxehtësisë së shkëndijës së besimit (imanit) dhe dobësimin të bazës së besimit në brendinë tonë. Por ndryshe do të ishte gjendja jonë sikur ajo që na kanë njoftuar profetët dhe eulijatë dhe ajo që kanë argumentuar filozofët e të mëdhenjtë, patjetër që ndër ne do të kishte pozitivitet në një farë shkalle dhe patjetër që ne do ta ndienim si detyrë të domosdoshme zbatimin e urdhrave të tyre dhe do të punonim për të arritur një jetë shumë më të mirë nga jeta që bëjmë tani.

Por, o mjerim, një mijë herë mjerim! Të brendshmen tonë e ka vënë shejtani nën sundimin e tij, madje shejtani ka vënë nën sundimin e tij jo vetëm thellësitë e zemrave tona, por edhe veshët e të brendshmes sonë dhe, në sja të këtij sundimi, shejtani ndalon që te ne të arrijë fjala e të Vërtetit të Lartësuar, fjala e të dërguarve të Tij dhe fjala e filozofëve dhe e dijetarëve. Me sundimin që ka arritur shejtani mbi ne, bën që në veshët tanë të mos arrijnë as këshillat e librave hyjnorë, pasi veshët tanë, nën sundimin e shejtanit, janë veshë kafshërorë të kësaj bote. Gjithashtu, nën ndikimin e sundimit të shejtanit mbi ne, as këshillat e të Vërtetit nuk e kapërcejnë kufirin e të dukshmes dhe kufirin e veshit kafshëror, për rrjedhojë, këto këshilla nuk arrijnë në brendësinë tonë, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar:



“لَمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْفٌ السَّمْعِ وَهُوَ شَهِيدٌ”  
*...limen kàne lehù kalbun eu elka-s'sem'a*  
*ue huve shehijidun*” -“... për atë që ka zemër, ose ka dëgjuar me  
vëmendje dhe ka argumente”.<sup>1</sup>

Puna më e rëndësishme, që duhet të bëjë rrugëtari në udhën e arritjes tek Allahu i Lartësuar dhe luftëtari në rrugën e Tij, është që të fillojnë rrugëtimin dhe gjatë rrugëtimit, në asnjë mënyrë, të mos mbështeten te shkaqet, por të kthejnë fytyrën vetëm kah Bërësi i shkaqeve. Gjithashtu, nisur nga cilësia e pastër e krijimit, të lidhen vetëm me Filluesin e parimeve, duke i kërkuar të Lartit jo vetëm mbrojtjen prej fajeve e ruajtje, por në kërkesën e tyre, të mos mbështeten në ndihmën e ndonjë tjetri, përveçse në ndihmën e të Gjithëfuqishmit dhe, lutjet që ata i bëjnë në vetmi të plotë, me nënshtrim të plotë, të jenë të çiltra, të pastra, vetëm për Allahun Fuqiplotë, duke pasur parasysh se nuk ka vendstrehim tek asnjë tjetër përveçse tek Ai.

---

<sup>1</sup> Sure “Kàf”, ajeti 37.



## Ndarja e dymbëdhjetë

### DASHURIA PËR KËTË BOTË I LËSHON FRERIN FANTAZISË

Dashuria për këtë botë është burimi i lëshimit të frerëve të fantazisë dhe ndalon praninë e zemrës. Në këtë ndarje do të mundohemi që këtë çështje jo vetëm ta shtjellojmë, por, në një farë mase, të cekim edhe rrugët për trajtimin e saj.

Nuk është e panjohur që zemra është e krijuar të bëhet Kible e orientimit dhe e interesimit të njeriut, si dhe për çdo send që ai dashuron. Por, kur shqetësimi i njeriut për një punë të çfarëdozshme e pengon të mendojë në kohën kur duhet të mendojë dhe i bëhet pengesë të kujtojë të Dashurin, në këtë gjendje, zemra fluturon menjëherë për tek i Dashuri i tij dhe sillet rrotull Tij, qoftë edhe atëherë kur shqetësimi i tij për këtë dashuri është fare i vogël. Njëkohësisht, me këtë shqetësim të vogël zhduket edhe penguesi. Kur ata që kanë arritur gradën e njohjes, si dhe ata që kanë aftësinë e tërheqjes hyjnore janë me zemra të fuqishme dhe janë të kapur ngushtësisht në tërheqjen e në dashurinë hyjnore, ata e shohin bukurinë e të Dashurit të tyre në çdo gjë, e shikojnë të Kërkuarin e tyre në çdo send që ekziston dhe thonë: “Në çdo send që kam hedhur shikimin, në atë send dhe, së bashku me sendin, kam parë





vetëm Allahun”.<sup>1</sup> Kur është “zotëria” i tyre, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ata thonë: “Le të hipë shkujdesja mbi zemrën time, por unë do t’i kërkoj Allahut shtatëdhjetë herë në ditë të më falë fajet”.<sup>2</sup> Pa dyshim që kjo gjendje i vjen atij, për shkak se ai sheh bukurinë e të Dashurit në ëndërr, sidomos në ëndrra jo të qarta, si ëndrra e Ebu Xhehlit, e cila, në raport me të plotësuarit, si ëndërr, në vetvete, konsiderohet paqartësi.

Por, nëse ata nuk kanë zemër të fortë dhe shqetësimi për të pasur sa më shumë u ndalon atyre praninë e zemrës, menjëherë, sapo ky shqetësim që ata kanë, të zvogëlohet fare pak, brendësia e zemrave të tyre shumë shpejt do të fluturojë për në follenë e pastër dhe do të lidhet me bukurinë e më të Bukurit.

E njëjta gjë ndodh edhe me ata që nuk e kërkojnë të Vërtetin dhe këta janë kërkuesit e kësaj bote. Por, në këndvështrimin e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, ata që kërkojnë diçka tjetër dhe nuk kërkojnë të Vërtetin, janë të orientuar kah i kërkuari i tyre dhe janë të lidhur me atë që kërkojnë, cilido qoftë i kërkuari i tyre.

Gjithashtu, kur ata e teprojnë me kërkesat e tyre dhe, kur dashuria për këtë botë është bërë sunduese e plotë e zemrave të tyre, ata kurrë nuk e lënë pas dore orientimin kah i dashuri i tyre. Ata, në çdo çast e në të gjitha gjendjet, janë të shqetësuar vetëm për bukurinë e të dashurit të tyre. Por, edhe nëse kjo dashuri e tyre është më pak se kaq, zemrat e tyre në kohë pushimi fluturojnë drejt

---

<sup>1</sup> Fjalë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*); lexo librin “Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 49.

<sup>2</sup> “Mustedrekul-Vesâili”, Libri “Es’salâtu”, Pjesa “Dhikri”, K. 22, Hadithi 1.



asaj që ata duan. Këta janë prej atyre personave, zemrat të cilëve janë të lidhura me dashurinë për pasuri, për kryesi e për famë. Të dashurin e tyre ata e shikojnë jo vetëm kur janë në gjumë, por edhe kur janë zgjuar. Përsëri ata janë të shqetësuar për të dashurin e tyre. Ata e përqafojnë të dashurin dhe vazhdojnë të jenë të shqetësuar për këtë botë. Pastaj, kur hyn koha e faljes së namazit, do të gjesh se zemrat e tyre nuk shqetësohen për asgjë, përveç dëshirës që kanë për t'u lidhur menjëherë me të Dashurin (Allahun) e tyre. Pavarësisht se tekberi i fillimit të namazit (tekbijrul-iftitâhi), që është çelësi për të hapur një portë, ose është një thirrje për të hequr mbulesën që ekziston mes zemrave të tyre dhe mes asaj që duan zemrat e tyre, kjo e vërtetë madhore nuk ua tërheq vëmendjen këtyre njerëzve, që të vështrojnë brenda vetes së tyre. Ata vazhdojnë në gjendjen e tyre, deri sa vjen koha që japin selamin e fundit në namazin e tyre, namaz të cilin ata e falën pa orientimin më të vogël kah namazi. Në të vërtetë, mendimi i tyre i faljes së namazit ishte i përqendruar vetëm në dashurinë për këtë botë, megjithëse ata njerëz kanë falur namaz, vazhdimisht, për dyzet ose për pesëdhjetë vjet me radhë, namazi në zemrën e tyre nuk ka lënë gjë tjetër përveçse errësirë dhe turbullirë. Një namaz i këtillë na fshin prej sheshit të afrimit hyjnor dhe na largon me kilometra nga ngjitja lart në pozitën e njerëzores dhe, kjo, kur dihet që namazi është miraxh për të na afruar tek i Vërteti Fuqiptotë dhe kjo pozitë e shenjtë është një shkak për realizimin e gjendjes njeri.

Patjetër do të ishte ndryshe, sikur namazi ynë të kishte edhe fare pak prej robërisë, atëherë namazi me siguri do të na shtynte të stoliseshim me kryeultësi e me uljen përdhe dhe jo me vetëpëlqim apo me mburrje, me krenari e me mendjemadhësi, kur dihet se është e mjaftueshme, që edhe vetëm njëra prej këtyre veseve të ulëta



bëhet shkak e faktor për ta çuar njeriun në shkatërrim e në vështirësi.

Në përmbledhje, zemrat tona janë të gatuar me brumin e dashurisë për këtë botë. Për zemrat tona s'ka objektiv e qëllim më të lartë se sa për ta gëzuar këtë botë, prandaj dashuria për këtë botë kurrë nuk duhet ta zbrazë zemrën tonë nga dëshira për të qenë në rrethin e shenjtërisë. Për këtë sëmundje kaq shkatërruese dhe kaq degjeneruese, për dashurinë për këtë botë, s'ka ilaç tjetër përveç diturisë e punës dobisjellëse.

Për sa i përket diturisë dobisjellëse, për shërimin e sëmundjes së dashurisë për këtë botë, ky ilaç është përqendrimi i mendimit në frutat e në rezultatet që sjell (dashuria për këtë botë) dhe krahasimi i atyre frutave e rezultateve me dëmet e mëdha e me shkatërrimet që vijnë nga dashuria për këtë botë. Në lidhje me këtë çështje, kemi dhënë një shpjegim të qartë në librin tonë "El-Erbeijne" – "Dyzet hadithe", në të cilin, sipas mundësive tona, kemi shpjeguar disa anë të sëmundjes së dashurisë për këtë botë. Këtu do të mjaftohemi të shpjegojmë disa hadithe, që kanë të bëjnë me subjektin, hadithe të ardhura prej Ehli Bejtit, prej të ruajturve prej gjynaheve.

Në librin "El-Kâfi", Ebu Abdullahu ka thënë: "*Kryet e çdo gabimi është dashuria për këtë botë*".<sup>1</sup> Në këtë kuptim kanë ardhur edhe shumë hadithe të tjera, me pak ndryshime në fjalë.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> "El-Kâfi", vëll. "El-Usûlu", Pjesa "El-Imanu uelkufu", K. "Dashuria për këtë botë dhe ruajtja prej kësaj dashurie", Hadithi 1.

<sup>2</sup>Lexo hadithet nga 1-18 prej kapitullit të përmendur në burimin e mësipërm.



Njeriu i ndërgjegjësuar mjafton të mendojë vetëm në këtë hadith të nderuar dhe në këtë gabim shkatërrues, që numërohet burimi i të gjitha gabimeve dhe origjina e të gjitha degjenerimeve.

Të gjitha degjenerimet morale e të gjitha sjelljet e neveritshme, afërsisht janë prej frutave të kësaj peme të keqe, prej pemës së dashurisë për këtë botë. S'ka asnjë fe e asnjë sekt të gabuar, të stisur në këtë botë dhe s'ka asnjë shkatërrim e asnjë degjenerim që ndodh në këtë botë, që të mos jetë rezultat i kësaj sëmundjeje shkatërruese shumë të rrezikshme: vrasja, grabitja, padrejtësia, mizoria e agresioni, të gjitha këto janë rezultate të këtij gabimi, kurse veprimet joligjore: prostitucioni, jeta e korruptuar, degjenerimi, veprat e pamoralshme, vjedhja, grabitja dhe veset e tjera shkatërruese, të gjitha janë pjellë e mikrobit të këtij imoraliteti e të këtij degjenerimi, dashurisë për këtë botë. Njeriu skllav i dashurisë për këtë botë është i privuar prej të gjitha virtyteve morale. Ai është i privuar prej trimërisë, ruajtjes së nderit, bujarisë e drejtësisë, cilësi këto që numërohen burim për të gjitha cilësitë e larta shpirtërore, të cilat, në asnjë mënyrë, nuk mund të jenë së bashku me dashurinë për këtë botë. Gjithashtu, edhe dituritë hyjnore, në lidhje me besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), me emrat, me cilësitë, me punët e me të Lartin, si dhe puna për orientimin drejt të Vërtetit Fuqiplotë, përfshirë edhe dituritë në lidhje me shikimin e të Vërtetit, të gjitha këto janë e kundërta e dashurisë për këtë botë, janë e kundërta e sigurisë dhe e qetësisë shpirtërore, janë e kundërta me qetësimin e mendjes dhe me sigurinë e zemrës. Të gjitha këto cilësi të larta morale janë bërthama e lumturisë në të dyja botët dhe kurrë nuk mund të jenë në pajtim me dashurinë për këtë botë. Edhe liria, fisnikëria, zemra e kënaqur me aq sa ka dhe shpirtlartësia, të gjitha këto veti të larta shpirtërore



e largojnë njeriun nga dashuria për këtë botë. Nga ana tjetër varfëria, poshtërsia, lakmia, kujdesi e dëshira për të pasur sa më shumë dhe lajkat, janë shoqëruese të dashurisë për këtë botë, kurse dhembshuria, mëshira, mbajtja e lidhjeve të ndërsjella, dashuria me zemër dhe dashuria në përgjithësi, janë në kundërshtim të plotë me dashurinë për këtë botë. Urrejtja, përçmimi, veprat joligjore, prostitucioni, shkreputja e lidhjeve me të afërmit, hipokrizia, degjenerimi dhe të gjitha veset e tjera shkatërruese, janë pjellë e nënës së sëmundjeve, janë pjellë e dashurisë për këtë botë.

Në librin “Misbâhu-sh’sherij’ati” lexojmë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kjo botë është si një fotografi: koka e saj është mendjemadhësia, syri i saj është dëshira e madhe, veshi i saj është lakmia, gjuha e saj është hipokrizia, dora e saj është epshi, këmba e saj është vetëpëlqimi, zemra e saj është shkujdesja. Kjo botë do të zhduket, me këtë botë arrihet asgjësimi. Kush ka dashuri për këtë botë, ajo i lë atij trashëgim mendjemadhësinë; kush e konsideron të mirë këtë botë, ajo i lë atij trashëgim dëshirat e shumta; kush e kërkon këtë botë, ajo i sjell atij lakminë; kush e lavdëron këtë botë, ajo i vesh atij hipokrizinë; kush e bën këtë botë qëllim për veten e tij, ajo i mundëson atij vetëpëlqimin; kush ndihet i sigurt me këtë botë, ajo e vë atë nën sundimin e shkujdesjes; kush mahnitet me kënaqësitë e kësaj bote, ajo e asgjëson atë; kush mbledh në këtë botë dhe tregohet koprrac me ato që mblodhi prej saj, ajo e çon atë në vendin që meriton, e çon në zjarr”.<sup>1</sup>

Në librin “Irshâdul-Kulûbi”, i autorit Ed’dejlemij, prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë hadithin kudsî, që Allahu i Gjithëfuqishëm i flet të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “O

<sup>1</sup> Ed’dejlemij, “Irshâdul-Kulûbi”, vëll. 1, f. 206.



*Ahmed, sikur robi të falë namazin e banorëve të qiellit e të tokës, sikur ai të mbajë agjërimin e banorëve të qiellit e të tokës, sikur ai të mbledhë ushqimin si engjëjt dhe të veshë rrobën e adhuruesve, pastaj Unë të shoh në zemrën e tij edhe një grimcë nga dashuria për këtë botë, ose që ai kërkon famë prej saj, ose kërkon prej saj të jetë i pari, ose kërkon veshjet e stolitë e kësaj bote, ai nuk do të jetë pranë Meje në shtëpinë Time dhe Unë patjetër do ta zhvosh zemrën e tij nga dashuria Imë”.<sup>1</sup>*

Është e qartë se dashuria për këtë botë dhe dashuria për Allahun Fuqiplotë kurrë nuk mund të jenë së bashku. Hadithet e nderuara, që flasin për këtë çështje, janë aq shumë, sa nuk mund të përmbliidhen në këto faqe.

Dashuria për këtë botë është themeli i të gjitha punëve të liga, prandaj njeriu i mençur bën kujdesin më të madh të arrijë lumturinë për veten e vet, bën kujdes të shkulë prej zemrës së tij pemën e dashurisë për këtë botë. Rruga e punës për të realizuar të gjitha këto qëllime qëndron në atë që njeriu të bashkëpunojë me shpirtin e tij me të kundërtën. Kur njeriu dëshiron pasuri e pozitë, detyra e tij e menjëhershme është që të shkulë rrënjët e kësaj dëshire, duke u bërë dorëhapur në sadakatë e detyrueshme e në sadakatë e vullnetshme, pasi njëra prej dobive të sadakave është: sadakaja e pakëson lidhjen dhe dashurinë për këtë botë.

Për të gjitha këto, njeriu nxitet të japë sadaka, aq sa dëshiron dhe në veten e tij të ndihet i nderuar me sadakanë që jep, ashtu siç e thekson këtë Allahu i Lartësuar në ajetin 92 të sures “Àli Imràn: “لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ” - “Len tenàlul-birr’rre hat’tà tunfikù mim’mà

---

<sup>1</sup> “Misbàhu-sh’sherij’ati”, K. 32 - “Cilësitë e kësaj bote”.



*tuhib'bùne...*" - **"Kurrë nuk do të arrini sinqeritetin e plotë, deri sa të jepni atë që ju e doni më shumë..."**

Kur njeriu dëshiron të ketë reputacion, të ecë përpara e të jetë i pari dhe për të arritur këto shkel mbi qafat e njerëzve, ai ka detyrë të menjëhershme të veprojë në të kundërtën e punëve të mësipërme dhe të zhgërryjejë në llucë hundën e shpirtit urdhërues për të keqen, me qëllim që të përmirësojë sa më shpejt gjendjen e shpirtit.

Gjithashtu, njeriu ka për detyrë të kuptojë se sa më shumë që të rendë pas kësaj bote, po aq shumë do të shtohet edhe dëshira e tij për ta arritur atë që dëshiron të arrijë dhe po aq shumë do të shtohet edhe dashuria e tij për këtë botë. Nga ana tjetër, do të shumëfishohet keqardhja që ai do të ndiejë, kur do të humbë ato që ai i dëshironte aq shumë në këtë botë. Për shembull: njeriu në këtë botë përpiket shumë të arrijë një send, të cilin ai nuk e ka, prandaj ai përfytyron, sikur ai kërkon vetëm atë send dhe turret drejt atij sendi, deri sa nuk e ka sendin e kërkuar në dorën e vet dhe në rrugën e kërkimit të atij sendi ai përballon vështirësi të shumta, aq sa e çon veten drejt shkatërrimeve të ndryshme, por, sapo të arrijë ta marrë sendin e kërkuar, ai send i duket si të ishte për atë një gjë e zakonshme, atëherë ai e lë mënjandë sendin e parë dhe i lind dëshira për një send tjetër, që është më i lartë në shkallë se sendi i parë dhe, për ta pasur edhe këtë send, ai nuk nguron ta hedhë veten në vështirësi të tjera dhe të lodhet shumë që të arrijë ta ketë edhe atë send. Ja kështu, dashuria e tij për sendet e kësaj bote asnjëherë nuk do të pakësohet, madje nga dita në ditë dashuria e tij për këtë botë bëhet edhe më e zjarrtë dhe patjetër që krahas kësaj dashurie, për atë shtohet lodhja e shumëfishohen vështirësitë. Është e qartë



se kjo cilësi, me të cilën është krijuar njeriu, nuk do të ndalojë në asnjë kufi. Ata që kanë arritur gradën e njohjes, janë zgjeruar shumë në fushën e kësaj cilësie, me të cilën është krijuar njeriu dhe, me dituritë e tyre të shumta, e kanë vërtetuar këtë fakt. Këtu nuk është vendi të përmendin fjalët e tyre. Gjithashtu, edhe në hadithet e nderuara theksohen disa prej punëve të këtilla: për shembull në librin “El-Kâfi”, lexojmë prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Shembulli i atij që ka dashuri për këtë botë, është si shembulli i krimbit të mëndafshit. Sa më shumë që ky krimb i pështjell fijet e fshikëzës rreth vetes, aq më e largët do të jetë edhe mundësia e tij për të dalë prej fshikëzës, deri sa të vdesë i dëshpëruar brenda saj”*.<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Shembulli i kësaj bote është si shembulli i ujit të detit. Sa herë që i eturi pi prej atij uji, etja i shtohet edhe më shumë deri sa e vret”*.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> “El-Kâfi”, “El-Usûlu”, vëll. 3, Libri “El-Imanu uelkufu”, K. “Poshtërimi i kësaj bote dhe përkohshmëria në të”, Hadithi 20, f. 202; si dhe kapitulli “Dashuria për këtë botë dhe kujdesi i madh për atë”, Hadithi 7.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm; K. “Poshtërimi i kësaj bote dhe përkohshmëria në të”, Hadithi 24.





## PARFUMI (MISKU) IMBYLLJES

Ti kërkues i të Vërtetit dhe rrugëtar për tek Allahu, kur qëndron për të edukuar fluturimin e përfytyrimit, kur ke lidhur djallëzitë e iluzioneve, kur dashurinë për gruan, për fëmijët e për të gjitha gjërat e kësaj bote i ke vënë nën këmbët e tua dhe, kur ke parë një thëngjill prej zjarrit të dashurisë hyjnore, me të cilin ti je krijuar dhe, kur ti flet me: “لَيْلِي أَكْشُ نَارًا” - “...in'nij ànestu nàren...” - “...unë pashë një zjarr...”<sup>1</sup>, kur shikon se para teje s'ka pengesa që të ndalojnë ecjen dhe mendon se i ke bërë gati mjetet e udhëtimit, atëherë ngrihu nga vendi ku je, braktise shtëpinë e errët të natyrës, braktise shtegun e ngushtë pa dritë të kësaj bote dhe shpëto prej prangave të kohës, çliroje veten prej këtij burgu dhe lëshoje shpendin e pastër të fluturojë drejt podiumit të njerëzores.

“Ty të thërrasin prej stafit të Arshit: Ne nuk e dimë, përse ti ke mbetur në këtë kurth!”<sup>2</sup>

Menjëherë forcoje vendosmërinë tënde, forcoje vullnetin tënd, sepse vendosmëria është kushti i parë për rrugëtarin në udhën e adhurimit për Allahun e Lartësuar. Pa këtë kusht, rrugëtari as nuk e ndërmerr këtë rrugëtim dhe as nuk e arrin plotësimin. Shehu i nderuar, Shah Abadi<sup>3</sup> e ka përshkruar vendosmërinë me

---

<sup>1</sup> Sure “Tà Hà” ajeti 10; sure “En Neml” ajeti 7 dhe sure “ElKasa” ajeti 29.

<sup>2</sup> Përmbajtja e një poezie në gjuhën perse, e poetit Hafiz Shirazi.

<sup>3</sup> Ky është Ajetu-ll'lah Mirzà Muhamed Ali El-Esfehànij Esh'shàh Àbàdij, biri i të ndjerit Ajetu-llah Mirzà Muhamed Xhevàd Hysejn Àbàdij El-Esfehànij. Ka



shprehjen: “Ajo është thelbi i njerëzores”. Madje mund të thuhet se njëra prej kërkesave më të rëndësishme të devotshmërisë, të ruajtjes prej dëshirave dhe kundërshtimit të zbritjeve shpirtërore, praktikimit të ushtrimeve të ligjëruara dhe adhurimeve e ritualeve hyjnore, të gjitha këto forcojnë vendosmërinë dhe nënshtrojnë

---

lindur në Esfehan, në vitin 1292 hixhri. Në këtë qytet përfundoi studimet e tij dhe më pas mori mësim prej babait të tij, i cili konsiderohej prej nxënësve të mëdhenj të autorit të librit “Sâhibul-Xhevâhiri”, i cili ishte prej atyre dijetarëve të mëdhenj që kanë arritur statusin për të bërë interpretime mbi ligjin e fesë. Më pas iu bashkëngjiti rrethit shkencor “Hysen Âbâdij El-Esfehânij”, të vëllait të tij më të madh, shehut Ahmed, i cili, gjithashtu, ishte prej dijetarëve të njohur, që kanë arritur statusin për të bërë interpretime mbi ligjin e fesë. Para se të arrinte moshën e pubertetit, studioi në rrethin shkencor të Ajetullah haxhi Mirzâ Hâshim Xhîhârsûkij. Më pas u shpërngul në Teheran, për të ndjekur studimet e tij pranë Mirzâ Hasen El-Ishtijânij dhe Mirzâ Hâshim El-Xhijlânij. Pasi përfundoi studimet e tij në Teheran, udhëtoi për në Nexhefi El-Eshref, ku mori pjesë në mësimin e El-Âkhâvend El-Khorosânij, të Mirzâ Hysejn El-Khalijlij dhe të Mirzâ Muhamed Tekij Esh Shirâzij. Në këtë qytet u njoh me dijetarët e mëdhenj, që kishin arritur statusin për të bërë interpretime mbi ligjin e fesë. Më pas u rikthye në Iran dhe banoi në Teheran, në rrugën “Shah Âbâd”. Prej kësaj adrese erdhi edhe emërtimi i tij Shâh Âbâdij. Në vitin 1347 hixhri udhëtoi për në Kum, ku do të ushtrojë mësimdhënien në fushën e fik’hut e të filozofisë. Prej dorës së tij kanë dalë shumë dijetarë të mëdhenj bashkëkohorë, që kanë arritur statusin për të bërë interpretime mbi ligjin e fesë. Në Kum qëndroi deri në vitin 1354 hixhri dhe pastaj u kthye në Teheran, për të ushtruar rolin e përgjegjësitetë e tij në propagandimin e strukturave të ligjit të fesë, duke mos lënë pas dore edhe shkrimin e librave. Prej dorës së tij dolën disa vepra, ndër të cilat: “El-Insânu uel-fitretu”, “El-Imanu uerr’rrexh’atu”, “El-Kur’ânu uel-itretu”, “Khâshijetul-Kifâjeti”, “Harâmun islâmij” dhe “Menâzilu-s’sâlikijne”, libër në fushën e njohjes, si dhe shumë libra të tjerë në fushën e fik’hut, bazave të fik’hut, logjikës, injorancës dhe profetësisë.

Vdiq në vitin 1369 hixhri. Në varrimin e tij morën pjesë mijëra njerëz, të cilët e kishin ndjekur atë në xhaminë e madhe. Është varrosur në qytetin Rej, në varrezën “Ebul-hutûh Err’rrâzij”.

Imam Khomeini (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) kishte një respekt të veçantë për të, për shkak të mësimave që kishte marrë prej tij në fushën e diturive të njohjes dhe të ngritjes në shkallët e plotësimeve shpirtërore.



fuqitë e cilësive të shpirtit, ashtu siç kemi thënë për këtë çështje në faqet e mëparshme.

E mbyllim këtë artikull duke falënderuar e duke lavdëruar Zotëruesin e madhështisë së pastër, duke e dëlirur Atë nga çdo e metë e nga çdo nevojë, duke kërkuar paqe e shpëtim për zotërinë tonë Mustafanë, për Profetin e zgjedhur e për familjen e tij dhe duke shtrirë dorën drejt Qenies së Pastër, për të kërkuar ndihmë vetëm prej Tij në këtë rrugëtim shpirtëror e në këtë miraxh, që na vjen prej besimit.



## ARTIKULLI I DYTË

### VEPRIMET PARAPRAKE TË NAMAZIT DHE DISA ETIKA ZEMRE TË NAMAZIT

#### Qëllimi i parë

#### PASTRIMI (TAHÀRETI)

#### Ndarja e parë

#### PASTRIMI NË PËRGJITHËSI

Më sipër thamë se namazi, prapa formës së tij të njohur, fsheh në brendësinë e vet një të vërtetë, domethënë që kjo e vërtetë e namazit është e brendshme dhe nuk është e dukshme. Gjithashtu, për faljen e namazit ka rregulla e kushte, për të cilat duhet të tregohet kujdes i veçantë, me qëllim që namazi të jetë sa më i plotësuar nga forma e tij e jashtme. Por edhe për të brendshmen e namazit, gjithashtu, ka rregulla, të cilat rrugëtarë në udhën e Allahut ka detyrë t'i ruajë ato me kujdes të madh.



Patjetër që edhe për pastrimin ka një formë dhe rregulla të jashtme, shpjegimi i të cilave është vënë detyrë të bëhet në libra të tjerë. Kurse për pastruesit e brendshëm të namazit, fukahatë e medh'hebit Xha'feri (*Allahu e lartësoftë fjalën dhe gradat e tyre!*) kanë shpjeguar rregulla të tjera, të cilat do të mundohemi t'i shpjegojmë në mënyrë të përgjithshme.

Mëso se, përderisa e vërteta e namazit është ngritja në pozitën e afrimit dhe arritja në pozitën e pranisë tek i Vërteti Fuqplotë, vetëkuptohet që bërja realitet e këtij objektivi dhe arritja e këtij qëllimi të lartë kërkon një pastrim shumë më të lartë se pastrimi i jashtëm, sepse ferrat që janë në rrugën e namazit dhe pengesat që janë para këtij miraxhi, janë ndyrësira, të cilat, nëse rrugëtari në udhën e Allahut s'ka mundësi t'i largojë, ai kurrë nuk do të ketë mundësi as të ngjitet nëpër këto shkallë dhe as nuk mund të ngrihet lart në këtë miraxh. Të gjitha pengesat që ndalojnë lartësimin me namazin dhe të gjitha veprimet e poshtra të shejtanit vijnë prej këtyre ndyrësirave, në një kohë që kushtet e të vërtetës së namazit janë gjithçka që e ndihmon rrugëtarin në rrugën e Allahut në udhëtimin e tij, prandaj edhe konsiderohen prej edukatës së pranisë hyjnore.

Së pari, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë t'i largojë këto pengesa e këto ndyrësi, pasi vetëm kështu ai mund të cilësohet i pastër dhe ka gjetur pastruesin që lidhet me botën e dritës. Rrugëtari në udhën e Allahut nuk e ka mundësinë të jetë në vendmbledhjen e pastër, ose të shohë atë vend të lartë, përderisa nuk është pastruar prej të gjitha ndyrësirave të jashtme e të brendshme, ndyrësi që shihen me sy dhe ndyrësi që nuk duken.



Kategoria e parë e ndyrësive janë ndyrësitë që ndotin mjetet e shpirtit e fuqitë shpirtërore, të dukshme, me pisllekun e fajeve, me ndyrësitë e gjynaheve, me zhulin e kundërshtimit të hapur të urdhrave të Pronarit të mirësive, duke shtuar këtu edhe ndyrësi të tjera të dukshme, të ardhura prej kurtheve të shejtanit. Të gjitha këto ndyrësi e privojnë njeriun, duke rënë kështu në llumin e tyre.

Askush të mos pandehë se ka mundësi të jetë triumfues me pozitën e të vërtetës së njerëzore, ose me pastrimin e brendshëm të zemrës, pa pastruar cilësitë e jashtme njerëzore dhe, nëse njeriu mendon që e ka arritur këtë pastrim, le të dijë se ky mendim i tij është prej mashtrimeve të shejtanit dhe prej kurtheve më të mëdha të Iblisit. Dihet që turbullirat dhe errësitat e zemrës shtohen me shtimin e gjynaheve, të përfaqësuara në gjendjen e sundimit të natyrës mbi gjendjen shpirtërore dhe, përderisa rrugëtari në udhën e Allahut është i pafuqishëm të vërë nën sundimin e tij cilësitë e jashtme, ai do të vazhdojë të jetë i privuar plotësisht edhe nga ndërmarrja e fushatave të brendshme çlirimtare, të cilat numërohen si objektivi më i madh, për rrjedhojë për atë rrugëtar kurrë nuk do të hapet rruga e lumturisë.

Mëso se njëra prej pengesave më të mëdha në këtë rrugëtim janë ndyrësitë e gjynahet, prej të cilave njeriu ka detyrë të pastrohet me ujin e pendimit (teubes) të sinqertë, me pendimin e pastër dhe pastrues.

Dije se të gjitha fuqitë e jashtme e të brendshme, që na i ka dhënë i Vërteti Fuqiplotë, fuqi të cilat Ai i zbriti për ne prej botës së padukshme, janë amanete hyjnore, që duhet t'i ruajmë me kujdes të veçantë, sa më larg errësirës e turbullirës së sundimit të Iblisit. Por këto mirësi mund të ndoten, nëse mbi to do të bjerë doza e



iluzioneve mashtruese të shejtanit dhe nëse ato do të zbresin në errësirën e botës së natyrës. Në këtë gjendje, prej atyre fuqive është larguar pastërtia origjinale dhe cilësia e pastër e krijimit. Ato janë ndotur me lloje të shumta ndyrësirash e me veprimet e poshtra të shejtanit.

Nëse rrugëtari në udhën e Allahut kapet fuqishëm pas butësisë së mikut të Allahut dhe cilësitë e tij të jashtme i ruan të pastra e i mban larg pushtetit të shejtanit, njëkohësisht plotëson të gjitha detyrimet, të cilat për ne, gjithashtu, janë amanete hyjnore, të cilat ai i ruan në gjendjen siç na i ka lënë i Vërteti i Gjithëfuqishëm, pa lënë asgjë mangët në kryerjen e këtyre amaneteve dhe pa e tradhtuar amanetin. Me këtë plotësim të këtyre amaneteve detyrim, rrugëtarin në udhën e Allahut e ka përfshirë falja e mbulimi i gjynaheve, e brendshmja e tij është e sigurt, gjithashtu, edhe e jashtme e tij është në paqe. Në këtë fazë të pastrimit, rrugëtari në udhën e Allahut fillon të heqë prej brendësisë së tij punët e poshtra e moralet e liga. Kjo është kategoria e dytë e ndyrësirave. Shkatërrimi që ato sjellin, është shumë më i madh, gjithashtu, edhe mjekimi i këtyre ndyrësirave është shumë më i vështirë dhe patjetër që edhe rëndësia që ato kanë, është shumë më e madhe tek ata që janë të kënaqur. Përderisa morali i brendshëm shpirtëror është i shkatërruar e i degjeneruar dhe, përderisa vetë shpirti është i rrethuar me ndyrësitë morale, ai shpirt kurrë nuk do të jetë në përshtatje me pozitën e shenjtërisë së pastër dhe me vetminë e plotë të prehjes. Në të kundërt, do të jetë burim për shkatërrimin e cilësive të jashtme, të cilat, në fakt, janë e brendshmja e shpirtit, janë moralet e prishura shpirtërore dhe janë të gjitha cilësitë e këqija të shpirtit. Nëse rrugëtari në udhën e Allahut nuk i zëvendëson këto vese të këqija me cilësi të mira, ai kurrë nuk është i sigurt nga e



keqja e punëve, madje edhe nëse ka në mendje të pendohet, për atë kurrë nuk do të jetë punë e lehtë të vërë në vijë të drejtë punët që konsiderohen prej punëve më të rëndësishme.

Atëherë, pastrimi i cilësive të jashtme, është peng i pastrimit të cilësive të brendshme, duke shtuar se pikërisht ndyrësitë e brendshme janë shkak për privimin e njeriut prej lumturisë. Gjithashtu, ato janë një burim i xhehenemit të moraleve, madje ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se ndyrësitë e brendshme, jo vetëm që janë më të rrezikshme se (Xhehenemi i punëve), por janë edhe shumë më të devijuara. Ky kuptim theksohet në shumë njoftime të ardhura prej Ehli Bejtit, prej të ruajturve prej gjynaheve. Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut, pasi të pastrojë faqen e shpirtit prej veseve shkatërruese me ujin e diturisë dobisjellëse dhe me ushtrime të pastra e pastruese, të lejuara në ligjin e fesë për të pastruar zemrën, e cila konsiderohet kryeqyteti i mbretërisë së trupit, përmirësohen të gjitha cilësitë morale. Por, edhe cilësitë morale prishen me prishjen e zemrës. Ndyrësitë e botës së zemrës, janë burimi për të gjitha ndyrësitë, si: lidhja me ndonjë tjetër dhe jo me Allahun, orientimi kah vetja e kah kjo botë, punë këto që konsiderohen rezultate të dashurisë për këtë botë. Dashuria për këtë botë është koka e të gjitha gabimeve. Por edhe dashuria për vetveten është nëna e të gjitha sëmundjeve. Kur rrënjët e këtyre dy dashurive kanë hyrë në brendësi të zemrës së rrugëtarit në udhën e Allahut, në zemrën e tij kurrë nuk do të arrijë ndikimi i dashurisë për Allahun dhe ai kurrë nuk do të gjejë rrugën për të arritur as qëllimin e as atë që ka vënë qëllim. Gjithashtu, ekzistenca e mbetjeve të këtyre dy dashurive në zemrën e rrugëtarit në udhën e Allahut, bën që udhëtimi i këtij rrugëtarit të jetë udhëtim





për veten e tij, të jetë udhëtim për në këtë botë dhe udhëtim për te shejtani, por nuk është udhëtim për tek Allahu.

Atëherë, pastrimi nga dashuria për këtë botë e nga dashuria për veten, në të vërtetë, është shkalla e parë e pastrimit të udhëtimit për tek Allahu, prandaj udhëtimi para këtij pastrimi nuk numërohet udhëtim për tek Allahu dhe, vetëm për zemërgjerësi mund të thuhet fjalët “rrugëtar” e “udhëtim”.

Pas kësaj pozite ka pozita të tjera, të cilat duhet t'i kapërcejmë, ndryshe nuk do të nuhasim freskinë e qyteteve të shtatë dashurive të At'tarit<sup>1</sup>, këtij burri që thotë se e sheh veten duke rrugëtuar në një rën kthesë të rrugicave, në një kohë që ne vazhdojmë të jemi prapa mureve e prapa perdeve të trasha, të cilat janë edhe shkaku që ne pandehim se ato qytete dhe njerëzit e shquar në to nuk janë më shumë se endje të fantazisë. Unë nuk mund të barazohem me sheh At'tarin, ose me Mejthemu - T'tem'marin. Gjithashtu, unë nuk e mohoj origjinën e pozitave, por nga thellësitë e shpirtit e të zemrës dua të jem prej shokëve të tyre dhe shpresoj që kjo dëshirë të më ndihmojë për të arritur në ndonjë gradë; kurse ti, o i dashuri im, bëhu si të duash dhe bashkohu me cilin të dëshirosh:

*“Pretenduesi desh të hynte në praninë e të Dashurit.*

*Dora e panjohur erdhi menjëherë dhe goditi gjoksin e të huajit”.*<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Është poeti i njohur Xhelaludin Rumi, i cili, në këtë poezi, në gjuhën perse, thekson se ai e shikon veten në një rën prej rrugicave. Shtëpia botuese “Shtatë qytetet e dashurisë”.

<sup>2</sup> Përmbajtja e një poezie të poetit Hafiz Shirazi.



Prandaj unë as nuk mungoj të jem në vëllazërinë e besimit, së bashku me të dashurit që kanë arritur gradën e njohjes dhe as nuk e rezervoj këshillën, e cila, në mesin e besimtarëve, konsiderohet e drejtë e ndërsjellë. Në të njëjtën kohë, unë them se ndyrësia më e madhe shpirtërore, të cilën nuk e pastrojnë as shtatë detet, madje para saj kanë qëndruar të pafuqishëm edhe profetët e mëdhenj, është ndyrësia e injorancës, që është burimi i sëmundjes së muskolorëve, e përfaqësuar në pozitave të njerëzve të Allahut e në krerët e dijetarëve dhe është fillimi i paragjykitimit ndaj atyre që i zotërojnë zemrat. Përderisa njeriu vazhdon të jetë i ndotur me këtë ndyrësi, ai kurrë nuk hedh asnjë hap përpara drejt diturive. Në të kundërt, kjo turbullirë fik te ai dritën e cilësisë së pastër të krijimit, cilësi që përfaqëson fanarin e rrugës së udhëzimit. Kjo ndyrësi shuan zjarrin e dashurisë, që konsiderohet mjeti që çon në miraxhin e drejtë të pozitave. Është kjo ndyrësi që e bën njeriun të dëshirojë të jetë i përjetshëm në tokën e natyrës.

Në këtë gjendje, njeriu ka për detyrë ta pastrojë të brendshmen e zemrës së tij prej këtyre ndyrësive. Pa dyshim që pastrimi arrihet duke menduar mbi gjendjen e profetëve e të eulijave të plotësuar dhe duke marrë këshillë prej pozitave të tyre, prandaj rrugëtari në udhën e Allahut asnjëherë të mos mjaftohet vetëm me pozitën në të cilën ai është. Qëndrimi në një pozitë të caktuar dhe kënaqja me njëren gradë të diturive, është prej veshjeve të rrezikshme, me të cilat merret Iblisi dhe shpirti urdhëruar për të keqen.

Me kaq po e ndërpres bisedën rreth (tri pastrimeve) të eulijave dhe, ashtu siç i kishim vënë qëllim vetes për shkrimin e



këtij libri, të mjaftohemi me aq sa është në harmoni me shijen e masës. Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun!



## Ndarja e dytë

### GRADAT E PASTRIMIT

Mëso se, deri sa njeriu do të vazhdojë të jetë në botën e natyrës e në pozitën e lëndores, ai është i ekspozuar ndaj sundimit të ushtrive hyjnore dhe të ushtrive të Iblisit.

Ushtritë hyjnore janë ushtritë e mëshirës, paqes, lumturisë, dritës, pastërtisë dhe plotësimit, kurse ushtritë e Iblisit janë gjithçka që është e kundërta e ushtrive hyjnore.

Kur anët hyjnore i mposhtin anët djallëzore, në fillim cilësia e pastër e krijimit të njeriut është dritë, paqe e lumturi. Për këtë të vërtetë flasin qartë hadithet e nderuara. Gjithashtu, për këtë të vërtetë flet edhe Libri hyjnor Famëlargtë.

Për aq kohë sa njeriu do të vazhdojë të jetë në këtë botë, ai ka fuqi të bëjë zgjedhjen për t'iu nënshtruar njëres prej këtyre dy lloje ushtrish. Nëse Iblisi s'ka pushtet mbi njeriun, që në fillimin e krijimit të tij dhe deri në fundin e jetës së tij, është hyjnor, nuk është materialist, ecën me kokën lart në një fushë drite, pastërtie e lumturie, zemra e tij ngryset e kënaqur me dritën e të Vërtetit dhe nga fakti se ajo nuk i është drejtuar askujt përveç të Vërtetit të Lartësuar. Në fushën e tij s'ka pjesë as për vetë Iblisin e as për ushtritë e Iblisit. Në këtë gjendje, kjo qenie e nderuar është



absolutisht e pastër, është e gjitha dritë, atij i janë falur të gjitha fajet, atij i janë falur fajet e mëparshme e të mëvonshme që ka bërë. Në origjinë, ai është zotëruesi i hapjes absolute, është në pozitën më të madhe të pagabueshmërisë, po kështu janë edhe ndjekësit e tij, të ruajturit prej gjynaheve. Ai zotëri dallohet me pozitën e vulosjes dhe kjo është pozita absolute. Në pozitë të lartë janë edhe të porositurit e tij, sepse ata janë prej baltës së tij, lidhen me atë në cilësinë e pastër të krijimit. Ata janë të ruajtur prej gabimeve dhe janë ndjekës të tij, ndjekja prej tyre e rrugës së tij është e plotë dhe e plotësuar.

Për sa u përket disa profetëve dhe disa eulijave të ruajtur nga fajet, ata as nuk janë absolutisht të ruajtur prej gabimeve e as nuk janë jashtë pushtetit të shejtanit, ashtu siç i ndodhi Ademit me pemën e ndaluar. Ajo që ngjau me babain e njerëzimit, konsiderohet prej dukurive të sundimit të Iblisit më të madh – Iblisit të Iblisëve – pasi pema, edhe pse ishte pemë hyjnore prej pemëve të Xhenetit, në të vërtetë, ajo pemë kishte në brendinë e saj shumë lëndë helmuese, që ishin në kundërshtim me pozitën e plotë të njerëzores. Ky është njëri prej kuptimeve, ose është njëra prej gradëve të pemës së ndaluar.

Por, kur drita e cilësisë së pastër e krijimit ndotet me ndyrësi të dukshme e me ndyrësi morale, në këtë gjendje, adhurimi i njeriut pranë oborrit të afrimit dhe pranisë së njerëzores, është me të njëjtën masë sa ai është prekur nga ndotja, deri sa puna arrin në shuarjen e plotë të dritës së cilësisë së pastër të krijimit. Në këtë gjendje, mbretëria e ekzistencës njerëzore shndërrohet në mbretëri djallëzore, në të cilën e jashtmjja dhe e brendshmjja e saj, e fshehta dhe e dukshmjja, të gjitha i janë nënshtruar pushtetit të shejtanit. Në



këtë fazë (Allahu na ruajttë!) shejtani bëhet zemra, veshi, dora, këmba dhe të gjitha gjymtyrët e njeriut. Në këtë fazë, njeriu i nënshtrohet sundimit të shejtanit. Ai bëhet shumë i keq dhe i privuar një herë e përgjithmonë që të shohë lumturinë.

Në mes këtyre dy gradëve ka pozita e gradë të shumta, të cilat i numërojnë e i dinë vetëm ata që quhen robtë e të Vërtetit (ehlul-Hak). I afërmi me këto pozita është prej horizonteve të profetësisë, janë ata që në Kur'anin Famëlartë janë quajtur "ata të krahut të djathtë (as'hàbul-jemijn)", kurse "ata të krahut të majtë (as'hbàu-sh'shimàl)" janë afër horizonteve të shejtanit.

Këtu patjetër duhet të theksohet se cilësia e pastër e krijimit, pavarësisht nga sa është e mundur që ajo të pastrohet nga ndotja gjatë kohës që njeriu është në këtë botë, në të vërtetë, dalja e saj prej pushtetit të shejtanit është plotësisht e mundur të realizohet shumë lehtë. Po kështu qëndron puna, edhe me gjendjen e hyrjes nën pushtetin e ushtrive të engjëjve të Allahut, të ushtrive të mëshirës hyjnore. I Dërguari më i nderuar, Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në lidhje me daljen prej pushtetit të ushtrive të Iblisit dhe rreshtimit nën pushtetin e ushtrive të Allahut, tha se kjo punë është lufta më e madhe për lartësimin e fjalës së Allahut (xihadi i madh) dhe është më e lavdëruar se lufta me armë kundër armiqve të fesë.

Atëherë, grada e parë e pastrimit është kapja pas rrugëve hyjnore dhe bindja ndaj urdhrave të të Vërtetit të Lartësuar; kurse grada e dytë e pastrimit është stolisja me virtytet morale e të cilësive dhe, grada e tretë e pastrimit është pastrimi i zemrës, që do të thotë dorëzimi i zemrës tek i Vërteti i Lartësuar. Pas këtij dorëzimi, ajo zemër bëhet ndriçuese, madje i gjithë personi i tij bëhet prej botës



së dritës dhe prej gradëve të dritës hyjnore. Drita hyjnore lëviz në të gjitha gjymtyrët e njeriut e në të gjitha fuqitë e tij të brendshme; mbretëria e ekzistencës njerëzore bëhet e gjitha dritë, madje bëhet dritë mbi dritat dhe vazhdon kështu, deri sa zemra të bëhet hyjnore. Prania e hyjnores në zemrën e dorëzuar shkëlqen në të gjitha gradët e të brendshmes dhe të jashtmes. Në këtë gjendje, robëria zhduket e fshihet plotësisht dhe shfaqet e shkëlqen vetëm hyjnorja, zemra e rrugëtarit në udhën e Allahut mbushet me siguri e me qetësi, e gjithë bota për atë bëhet e dashur, për atë arrihen të gjitha tërheqjet hyjnore, në shikimin e tij të gjitha gabimet e shkarjet që ai ka bërë janë të falura. Ai mbulohet krejtësisht prej hijes së shkëlqimeve të dashurisë dhe për atë realizohen fillimet e shenjave se do të jetë prej eulijave. Ai arrin të shikojë edhe korrektësinë e delegacioneve që shkojnë në vendmbledhjen e qetësisë. Ja kështu ai vazhdon të lartësohet drejt pozitave të tjera. Por, përmendja e këtyre pozitave është jashtë kufijve të çështjes sonë në këto fletë.



## Ndarja e tretë

# EDUKATA E ZEMRËS SË RRUGËTARIT NË UDHËN E ALLAHUT, KUR SHKON TË PASTROHET ME UJË

Le ta hapim këtë ndarje me citimin e hadithit sherifi, i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i transmetuar në librin “Misbàhu - sh’sherijati”. Me këtë hadith të ndriçojmë zemrat e pastra të besimtarëve.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ke qëllim të bësh pastrimin e madh, ose të marrësh abdes, shko drejt ujit, pasi kështu ti shkon drejt mëshirës së Allahut. Allahu e ka bërë ujin çelës për afrimin tek Ai, për bashkëbisedimin në vetmi me Atë dhe argument për shërbimin tënd të madh. Ashtu siç i pastron mëshira e Allahut fajet e robëve, po kështu papastërtitë e dukshme i pastron uji dhe asgjë tjetër përveç ujit. Allahu i Lartësuar thotë: “وَهُوَ الَّذِي أَرْسَلَ الرِّيحَ بُشْرًا لِّبَنِّ يَدِّي رَحْمَةً” - “Uhuve-l’ledhij ersele-rr’rrijàha bushren fejne jedej rahmetihi...” - “**Ai i dërgon erërat përgëzuese para dhurimit të mëshirës së Tij...**”<sup>1</sup>

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë: “...ue الخهالنà minel-mài kul’le shej’in haj’jin...” - “...dhe prej ujit Ne kemi

---

<sup>1</sup> Sure “El Furkàn”, ajeti 48.





**bërë të gjitha gjallesat...**<sup>1</sup> *Ashtu siç Unë u jap jetë të gjitha sendeve prej mirësive të kësaj bote, po ashtu, me mëshirën e me mirësinë Time, kam bërë që adhurimet të jenë jetë për zemrat*".

Në këtë hadith sherifi ka shenja, hollësi e të vërteta, që i japin gjallëri zemrave të atyre që kanë arritur gradën e njohjes. Gjithashtu, çojnë gjallëri edhe në shpirtrat e pastër të atyre që quhen zotërues të zemrave.

Njëra prej sekreteve të përngjasimit të ujit në këtë hadith sherifi, është fakti se uji është prej dukurive më të mëdha të mëshirës së Allahut Fuqiplotë. Ujin që Allahu e zbret prej botës së natyrës, e ka bërë bazën e jetës së qenieve, madje ata që kanë arritur gradën e njohjes, shprehen se uji është prej mëshirës së madhe hyjnore, i zbritur prej qiellit me gradën e lartë të pranisë së emrave e të cilësive për t'i dhënë gjallëri tokave të njerëzve.<sup>2</sup>

I Vërteti i Lartësuar ka bërë që mëshira e gjerë hyjnore të shkëlqejë në ujin e botës së dukshme më shumë se në të gjitha trupat e tjerë të botës së tokës. Ai e ka bërë ujin pastrues të të gjitha papastërtive të dukshme, por jo vetëm kaq, sepse shkëlqimi i ujit, si dukuri e mëshirës së të Vërtetit Fuqiplotë, kur zbret dhe shfaqet

---

<sup>1</sup> Sure "El Enbijà", ajeti 30.

<sup>2</sup> Shprehja "tokave të njerëzve", tek ata që kanë arritur gradën e njohjes, shpreh një veçori. Në lidhje me këtë shprehje, El-Kajseri thotë: "Me fjalën "tokave" karakterizohen të gjitha sendet, me përjashtim të Allahut. Procesi i veçimit, herë ndodh që i veçuari është vetë personi, siç është veçoria e Atij që detyrimisht ekziston (vaxhibul-vuxhüd), i Cili dallohet me fjalën "ذات" - "Dhât" - "Qenia e lartë", herë vjen si veçori e të vërtetave solide, në lidhje me diturinë e të Vërtetit, që është Vetë Ai; herë tjetër veçimi vjen me atë që është shtuar mbi vetë veçimin, siç është dallimi i shkrimtarit prej jo shkrimtarit; herë tjetër veçimi është me dallimin që shpreh mosarritjen e një punë, domethënë se ajo punë është e pamundur të jetë, si për shembull: nuk mund të ketë shkrimtar pa shkruar.



në çdo krijesë të ekzistencës dhe në çdo dukuri prej dukurive të botës së fshehtë e të dukshme, pastron fajet e robëve të Allahut, në përputhje të plotë me atë krijesë dhe ashtu siç është i përshtatshëm për këtë botë.

Atëherë, uji i mëshirës së gjerë, që zbret prej qiellit, pastron fajet konkrete të njerëzve; uji i mëshirës së gjerë, që zbret prej qiellit të Krijuesit, pastron fajet e jashtme, që akoma nuk janë bërë dhe puna e pastrimit vijon me të njëjtën mënyrë, në përshtatje me gradën përkatëse për çdo gradë të ekzistencës.

Uji i mëshirës, në gradat e krijesave njerëzore, pastron në mënyrë të diferencuar, uji i zbritur prej fushës së të Lartit është për të specifikuarit e botës së Berzahut. Ky ujë pastron fajet e “sekretit të ekzistencës” (es’ sirr’ rrul-vuxhùdij), pastron fajin që nuk mund të matet me asnjë faj. Me ujin e zbritur prej fushës së emrave, të cilësive dhe prej fushës së shkëlqimit të punëve, plotësohet pastrimi i shikimit të cilësisë e të punës. Me ujin e zbritur prej fushës së sundimit e të drejtësisë, plotësohet pastrimi i ndyrësive morale të brendshme. Me ujin e zbritur prej qiellit të faljes së gjynaheve, plotësohet pastrimi i fajeve të robëve. Me ujin e zbritur prej qiellit të cilësive, plotësohet pastrimi prej papastërtive të formësuara. Të gjitha këto tregojnë qartë se i Vërteti i Gjithëfuqishëm e ka bërë ujin çelësin e afrimit tek Ai dhe argument që vërteton sa e gjerë është mëshira e Tij.

Veç kësaj që u tha, hadithi sherifi shpjegon edhe një punë tjetër e hap një udhë tjetër për rrugëtarët në udhën e Allahut dhe ata mbajnë nën kontroll veten... Në vijim Imami shton: “Mendo sa i pastër është uji; mendo se uji nuk është i fortë; mendo se uji është pastrues; mendo në begatitë e ujit, në mëshirën e depozituar te uji dhe mendo se uji



*përzihet me të gjitha sendet. Këtë ujë ti përdore për të pastruar gjymtyrët, ashtu siç të ka urdhëruar Allahu t'i pastrosh ato, por bëj shumë kujdes, që të zbatosh rregullat e pastrimit në pastrimin farz e në pastrimin sunet, sepse në çdonjërin prej dy llojeve të pastrimit, ka dobi të shumta dhe, kur ti i trajton këto mirësi me respektin që ato meritojnë, për ty shpërthejnë nga afër burimet e dobive të pastrimit..."*

Këtu hadithi tregon gradët e pastrimit në përgjithësi. Më sipër janë shpjeguar qartë katër gradët e përgjithshme të pastrimit, madje njëra prej këtyre gradëve u përmend edhe në paragrafin e mësipërm të hadithit, që fliste për gradën e pastrimit të gjymtyrëve.

Hadithi tregon se rrugëtarët në udhën e Allahut kanë detyrë të mos ndalojnë vetëm në format e jashtme të punëve. Në të kundërt, ata kanë detyrë ta konsiderojnë të jashtmen pasqyrë të së brendshmes dhe të vërtetat t'i zbulojnë nëpërmjet formave. Ata kanë detyrë të mos mjaftohen vetëm me pastrimin formal, sepse vetëm pastrimi formal është kurthi që përgatit shejtani.

Veç kësaj, ata kanë detyrë të mendojnë edhe për pastrimin e gjymtyrëve nëpërmjet mendimit mbi cilësinë pastruese të ujit dhe të bazohen në shkëlqimin e gjymtyrëve, në shtimin e pastërtisë mbi gjymtyrët, duke i plotësuar të gjitha farzet e sunetet hyjnore dhe të bëjnë që edhe veprimet farz e sunet të kenë qartësinë, butësinë e kthjelltësinë e ujit; t'i nxjerrin gjymtyrët prej trashësisë së llumit të gjynaheve. Nga plotësimi i veprimeve farz e sunet, mundësohet që pastrimi e begatia të lëvizin nëpër të gjitha gjymtyrët.

Gjithashtu, ata kanë për detyrë që të punojnë shumë e shpejt nëpërmjet meditimit në mëshirën e përzierjes së ujit me sendet. Në saje të kësaj mënyre të menduari, ata do të kuptojnë mënyrën e



përzierjes se fuqive e të cilësive hyjnore me botën e natyrës. Në të njëjtën kohë, ata kanë detyrë të mos lejojnë që ndyrësitë e botës së natyrës të ndikojnë te gjymtyrët. Nëse gjymtyrët do të merren seriozisht me zbatimin e farzeve e të suneteve hyjnore dhe do t'i plotësojnë ato me etikën e me edukatën që kërkohet në plotësimin e farzeve dhe të suneteve, patjetër që dalëngadalë do të fillojnë të shfaqen ndikimet e brendshme të farzeve e të suneteve, do të shpërthejnë burimet e sekreteve hyjnore dhe për njeriun do të shfaqet një vezullim prej sekreteve të adhurimit e të pastrimit.

Në vijim Imami, pasi ka shpjeguar qartë gradën e parë të pastrimit dhe mënyrën e pastrimit, kalon në çështjen e dytë dhe thotë: *"...pastaj bashkëpunohet me njerëzit, ashtu siç përzihet uji me sendet, pa u tjetërsuar prej kuptimit të tij, duke marrë këshillë fjalën e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): 'Shembulli i besimtarit të singërtë është si shembulli i ujit'".*

Çështja e parë ka lidhje me bashkëpunimin e rrugëtarit në udhën e Allahut me fuqitë e tij të brendshme dhe me gjymtyrët e veta; kurse çështja e dytë, domethënë çështja që u përmend në paragrafin e mësipërm të hadithit sherifi, ka lidhje me bashkëpunimin e njeriut me robtë e Allahut. Ky bashkëpunim përfaqëson një program pune gjithëpërfshirës dhe shpjegon qartë mënyrën e bashkëpunimit të rrugëtarit në udhën e Allahut me njerëzit. Gjithashtu, nga brendia e këtij paragrafi të hadithit sherifi mësohet edhe e vërteta e vetmisë, e cila arrihet, kur rrugëtari në udhën e Allahut nuk i lë pa i plotësuar të drejtat hyjnore dhe nuk e humb kuptimin e këtyre të drejtave, të përfaqësuar në adhurimin për të Vërtetin e në orientimin drejt Tij, e në të njëjtën kohë, ai bashkëpunon me çdo grup njerëzish, duke urdhëruar të mirën dhe



duke kryer detyrimet e tij ndaj njerëzve, domethënë ai i trajton të gjithë njerëzit sipas asaj mënyre që është në përshtatje me secilin prej tyre. Në këtë gjendje, personi mbi të cilin ka rënë “turbullirë”, përjeton “vetminë” me të Vërtetin. Në zemrën e tij s’ka fare mendjemadhësi dhe ajo zemër është e zbrazur nga çdo figurë e vizatim.

Më pas Imami shpjegon çështjen e tretë, e cila përfaqësohet në mënyrën e bashkëpunimit të rrugëtarit në udhën e Allahut me vetë Allahun e Lartësuar dhe thotë: “...por pastërtia e sinqeriteti yt me Allahun e Lartësuar, në të gjitha adhurimet që ti kryen, është si pastërtia e ujit, kur Ai e zbret prej qiellit dhe të cilin Ai e ka emërtuar i pastër...”

Kjo do të thotë se rrugëtari në udhën e Allahut është çliruar prej pushtetit të natyrës dhe nuk lejon që turbullira dhe errësira e natyrës të gjejë rrugë për në zemrën e tij. Prandaj adhurimet ai i ka të pastra prej çdo lloj shirku të jashtëm e të brendshëm, ashtu siç është i pastër e i kulluar uji, kur zbret prej qiellit dhe është i paprekur prej papastërtive. Veç kësaj, rrugëtari në udhën e Allahut nuk e lë zemrën e vet, pastërtia e të cilës ka zbritur prej qiellit të cilësive të botës së panjohur, që të ndotet nga papastërtitë. Ai nuk lejon që zemra e tij të bjerë nën pushtetin e shejtanit e nën pushtetin e natyrës.

Imami shpjegon edhe çështjen e fundit, e cila përfaqëson një program përgjithësues për praktikuesit e ushtrimeve e për rrugëtimin dhe thotë: “Pastroje zemrën tënde me devotshmëri e me siguri, kur je duke pastruar gjymtyrët e tua me ujë”.<sup>1</sup> Në këtë frazë të hadithit, Imami e vë theksin mbi dy pozita të larta, për ata që kanë

---

<sup>1</sup> Hadithi i plotë gjendet në librin “Misbàhu-sh’sherij’atí”, K. 10 – “Pastrimi”.



arritur gradën e njohjes dhe pozitën e devotshmërisë. Plotësimi i kësaj pozitë është heqja dorë prej çdo gjëje tjetër, përveç Allahut të Lartësuar, kurse pozita e dytë është pozita e vetëbindjes dhe plotësimi i kësaj pozite është shikimi i pranisë së të Dashurit.



## Ndarja e katërt

### PASTRIMI

Pastrimi bëhet me ujë, që është bazë për pastrimin. Gjithashtu, pastrimi bëhet edhe me dhe (tokë).

Në përgjithësi, para rrugëtarit në udhën e Allahut ka dy rrugë, që të arrijë qëllimin e tij më të lartë dhe pozitën e afrimit tek Allahu. Njëra prej këtyre dy rrugëve, që është pozitë parësore, është udhëtimi për tek Allahu, duke u bazuar mbi pozitën e mëshirës së pakushtëzuar dhe, në mënyrë të veçantë, duke u mbështetur në “mëshirën gjithëpërfshirëse” - “err’rrahmetu-rr’rrahimij’jeh”, mëshirë që çdo qenie e çon drejt atij plotësimi, që është në përshtatje me qenien përkatëse.

Prej degëve dhe prej dukurive të mëshirës gjithëpërfshirëse është dërgimi i profetëve. Ata janë udhëheqës të rrugës së drejtë dhe ndihmë për të prapambeturit, madje ashtu siç shprehen zotëruesit e zemrave dhe ata që kanë arritur gradën e njohjes, ata janë “shtëpia e vërtetimit”, njëra prej dukurive të mëshirës hyjnore, me të cilën të gjitha krijesat gjithmonë janë të mbuluara tërësisht nga detet e mëshirës së të Vërtetit, pavarësisht se ata nuk e shfrytëzojnë këtë mirësi të madhe. Ja edhe Kur’ani Famëlartë, ky Libër madhor hyjnor, i zbritur prej botës hyjnore të panjohur, për afrimin te Zoti i botëve në formën e fjalëve e të fjalive, që të



përfitojmë ne, të prapambeturit. Ky Libër qiellor është zbritur me gjithçka, ndihmon për çlirimin tonë prej vuajtjeve që pësojmë në burgun e natyrës, për të na çliruar ne, të lidhurve me prangat e dëshirave dhe të shpresave tona absurde. Në të vërtetë, e gjitha kjo është prej dukurive absolute të mëshirës hyjnore edhe për ne të verbrit e shurdhët, që kurrë s’jemi munduar të përfitojmë prej kësaj mëshire hyjnore.

Ja edhe i Dërguari i fundit, ndihmuesi absolut e më bujar, i cili e nderoi botën duke zbritur prej pranisë së pastër të Zotit të botëve dhe shoqërisë së afrimit të gëzimit hyjnor në pozitën e një mërgimtari, në një vend të huaj e të egër si kjo bota jonë, ku do të ishte i detyruar të shtrydhej prej sëmundjeve e vuajtjeve, për shkak se ishte i detyruar të bashkëpunonte me dhjetëra njerëz të tipit të Ebu Xhehlit, madje të bashkëpunonte edhe me njerëz më të këqij si Ebu Xhehlët. Ai erdhi me Libër Famëlartë, që i bën të regëtojnë zemrat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe eulijave, prej të mëparshmëve e të mëvonshmëve, zemrat e të cilëve digjen me gjynahun, kur ata e dëgjojnë atë të thotë: “...le të këndojë mbi zemrën time...”<sup>1</sup> Pa dyshim që ai është mëshira e bujaria e madhe hyjnore, absolute, që erdhi në këto kolibe të shkatërruara. Ai erdhi mëshirë për të gjitha qeniet e botës më të ulët dhe punoi shumë për t’i nxjerrë ato prej kësaj shtëpie të huaj e barbare, ashtu si pëllumbesha e egër e rrethuar, që e hedh veten në grackën e të keqes për të shpëtuar shoqet e saj.<sup>2</sup>

Rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të kuptojë se pastrimi me ujin e mëshirës, është njëra prej formave të përfitimit

---

<sup>1</sup> Lexo shënimin 2, faqe 83.

<sup>2</sup> Hakemi, “Kelia dhe Demna”, K. “Pëllumbesha e rrethuar”.





prej mëshirës hyjnore, e zbritur për të mirën e tij dhe, përderisa ai e ka mundësinë ta marrë këtë mëshirë, në të njëjtën kohë, detyra e tij është që të përfitojë prej kësaj mëshire dhe të pastrohet me këtë mëshirë. Por, kur dora e tij nuk arrin deri tek ajo mëshirë, për atë është shumë e vështirë të arrijë që të ketë në dorën e tij ujin e mëshirës, sepse nuk ka plotësuar detyrat, ose për shkak të mangësisë së tij vetjake, prandaj për atë nuk mbetet rrugë tjetër veçse të zhytet së bashku me poshtërsinë, mjerimin e me varfërinë e tij dhe, kur për atë të shkëlqejë përulja e robërisë së tij, atëherë ai do të kuptojë sa shumë nevojë ka për këtë mëshirë, patjetër do të arrijë të kuptojë edhe të vërtetën e mundësive të tij. Në këtë gjendje, ai e hedh për tokë mendjemadhësinë, krekosjen dhe egoizmin tij. Në këtë gjendje, për të hapet një portë prej mëshirës. Gjithashtu, edhe toka e natyrës për atë bëhet tokë e mëshirës, bëhet e bardhë, pa pësuar asnjë të keqe dhe pluhuri i kësaj toke bëhet “njëri prej dy pastruesve”. Në këtë gjendje, njeriun e përfshin edhe një herë tjetër mëshira e butësia e të Vërtetit.

Sa më shumë të rrënjoset ky kuptim te njeriu, domethënë, sa më shumë forcohet te ai kuptimi se është i përulur, aq më shumë do të jetë i përfshirë nga mëshira hyjnore. Por, nëse ai ka qëllim ta përshkojë këtë rrugë, duke u bazuar te vetja e vet e te puna e tij, për të s’ka asnjë mundësi që mund të ndihmohet në rrugëtimin e tij, sepse, në këtë gjendje, ai përngjan me një foshnjë, që merr guximin të ecë vetë dhe kërkon të mbahet me dy këmbët e saj, duke u mbështetur në fuqinë e saj. Foshnja e ka të pamundur të ketë ndihmën e prindit të vet, prandaj mbetet në gjendjen që është. Por, kur foshnja e ndërpret mashtrimin e vetes dhe sheh se ka nevojë për ndihmën e babait dhe e kupton pamundësinë e vet, shkakton te babai ndjenjën e dashurisë e të butësisë ndaj saj. Në këtë gjendje,



babai menjëherë e ndihmon, e merr në krah dhe e mban, që foshnja të ecë vetë e të bëjë përpara në rrugën e tij.

Atëherë rrugëtari në udhën e Allahut vëzhgon dhe ka kujdesin më të madh, që gjatë rrugëtimit të mos mbështetet te këmbët e veta dhe kurrë të mos jetë i sigurt as te vetja e tij, as te ushtrimet që bën dhe as te puna e tij, por të vëzhgojë për të gjetur mënyrat se si të shërohet plotësisht prej vetes së tij, prej ndjenjës se nuk është as i fuqishëm e as i fortë, por vazhdimisht mban parasysh se është i pafuqishëm dhe ka hequr dorë prej dredhive. Në këtë gjendje, atë e përfshin kujdesi, në saje të të cilit rrugën e njëqind vjetëve e përshkon brenda një nate. Por kjo arrihet vetëm në saje të forcës tërheqëse hyjnore, duke ditur se kjo tërheqje arrihet vetëm atëherë kur ai lë gjuhën e të brendshmes së vet dhe gjendjet e tij të shprehin pafuqinë dhe nevojën e ngutshme që ai ka për praninë e Allahut të Gjithëfuqishëm, ashtu siç njofton Allahu i Lartësuar me Fjalën e Tij: “أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ” - “*Em'men juxhijbul-mudtarr'rre idhà deàhu ue jekshifu-s'sue...*” - **“A nuk është Ai që i përgjigjet nevojtarit kur ai e thërret duke ia larguar të keqen...”**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure “EnNeml”, ajeti 62.



## Ndarja e pestë

### TUBË RREGULLASH PËR ABDESIN

Imam Rizai ka thënë: *“Abdesi u urdhërua, që robi të jetë i pastër, kur ngrihet për të dalë para të Gjithëfuqishmit. Kur të jetë duke biseduar në intimitet me Fuqplotin, robi të jetë i pastruar prej ndyrësive e papastërtive, krahas largimit të përtacisë, dëbimit të përgjumjes, kështu që të dalë para të Gjithëfuqishmit me zemër të pastruar. Abdesi u bë detyrim, që të pastrohet fytyra, dy duart, koka dhe dy këmbët, sepse robi, kur të dalë para të Gjithëfuqishmit, patjetër që i zbulon gjymtyrët e veta dhe nxjerr në shesh pikërisht ato gjymtyrë për të cilat është bërë detyrim të pastrohen gjatë marrjes abdes. Me fytyrën e tij, robi bën sexhde e ruku; me dorën e tij ai lutet, dëshiron, frikësohet dhe veçon; me kokën e tij robi përulet para Allahut në ruku e në sexhde dhe me këmbët e tij robi qëndron në këmbë dhe ndenjuri...”<sup>1</sup>*

Deri këtu, Imami, me fjalën e tij, shpjegoi anën më të rëndësishme të abdesit. Gjithashtu, u tërheq vëmendjen edhe atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të rrugëtarëve në udhën e Allahut, duke shpjeguar se abdesi ka edhe rregulla të tjera, që duhet të zbatohen, kur robi ngrihet për të hyrë në praninë e afrimit të pastër të të Vërtetit Fuqplotë dhe për të biseduar në vetmi me Kryerësin e nevojave. Vetëkuptohet se nuk mund të shkohet në këtë

---

<sup>1</sup> “Ujûnu akhbâri-rr’ rridâ”, vëll. 2, K. 34, Hadithi 1, f. 104.



prani me papastërti të dukshme e me ndyrësi të jashtme, nuk mund të shkohet me sy të përgjumur, prandaj, sido të jetë puna me ty, zemra jote është e mbushur me llumra dhe e përlyer me poshtërsi morale të tilla, që në të vërtetë përfaqësojnë të gjitha llojet e llumrave.

Te hadithi sherifi lexojmë: *“Allahu i Lartësuar nuk sheh në fytyrat tuaja, por Ai sheh në zemrat tuaja”*.<sup>1</sup> Përveç kësaj, është shumë e rëndësishme edhe mënyra se si i drejtohet njeriu të Vërtetit të Lartësuar. Patjetër që ai i drejtohet Atij me atë që është më e merituar ndër të gjitha gjymtyrët e organet, njeriu i drejtohet të Lartit me më të rëndësishmen që i ka dhënë atij Madhështori, i drejtohet me zemrën e tij. Prandaj, në këtë shikim, s’kanë pjesë gjymtyrët e organet e tjera të tij. Por edhe pastrimi formal dhe pastrimi i jashtëm nuk mund të anashkalohen. Pikërisht për këtë, njeriu është urdhëruar jo vetëm të bëjë pastrimin e jashtëm të gjymtyrëve të tij të dukshme, por është urdhëruar të bëjë edhe pastrimin e brendshëm të së brendshmes së tij.

Shihet qartë se hadithi sherifi e vë theksin mbi “pastrimin e zemrave” dhe shpjegon se ky pastrim është vetëm njëra prej dobive të abdesit, por abdesi ka edhe të brendshmen e tij, prandaj abdesi plotësohet vetëm atëherë, kur njeriu pastron edhe të brendshmen. Në hadithin sherifi shpjegohet qartë natyra e lidhjes mes të jashtëmes e të brendshmes dhe mes të panjohurës e asaj që dihet.

Gjithashtu, mësohet se pastrimi i jashtëm dhe abdesi formal, është prej adhurimeve e prej formave të bindjes ndaj Zotit të botëve. Pikërisht për këtë, pastrimi i jashtëm është bërë shkak për pastrimin

---

<sup>1</sup> Lexo shënimin 2, faqe 58.



e të brendshmes, por edhe pastrimi i zemrave bëhet nëpërmjet pastrimit të jashtëm.

Në përgjithësi, rrugëtari në udhën e Allahut, kur ngrihet për të marrë abdes, ka parasysh se me pastrimin, ka qëllim të jetë i pranishëm pranë Madhështorit, por ai nuk ka arritur ta meritojë, që të orientohet për te kjo prani, për shkak se zemra e tij mbart probleme. Mbase për këtë, ai është prej të larguarve prej pranisë së Zotit të botëve. Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut, ka për detyrë të përveshë krahët dhe të kryejë atë që është më e rëndësishme, me qëllim që pastrimi i jashtëm të arrijë në brendësi dhe atij t'i pastrohet zemra, sepse zemra është organi në të cilin shikon i Vërteti i Lartësuar, madje ndër të gjitha organet e gjymtyrët e tij vetëm zemra është banesa e pranisë së Tij të Pastër. Kur zemra është e pastruar, atëherë njeriu dëbon prej kokës së tij çdo gjë e çdo send prej të cilit ka neveri shpirti. Kjo do të thotë se njeriu zhvishet prej egoizmit, i cili numërohet origjina e origjinave të papastërtive, prandaj rrugëtari në udhën e Allahut do të vazhdojë të pastrohet, deri sa të bëhet i merituar për të qenë pranë Zotit të botëve.

Më pas Imami shpjegon shkakun se përse, kur merret abdes, janë veçuar të pastrohen vetëm disa gjymtyrë: *“Abdesi u bë detyrim, që të pastrohet fytyra, dy duart, koka dhe dy këmbët, sepse robi, kur të dalë para të Gjithëfuqishmit, patjetër që i zbulon gjymtyrët e tij dhe nxjerr në shesh pikërisht ato gjymtyrë për të cilat është bërë detyrim të pastrohen gjatë marrjes abdes; me fytyrën e tij robi bën sexhde e ruku; me dorën e tij ai lutet, dëshiron, frikësohet dhe veçon; me kokën e tij robi përulet para Allahut në ruku e në sexhde dhe me këmbët e tij robi qëndron në këmbë dhe ndenjuri...”*



Kjo thënie do të thotë: pastrimi i këtyre gjymtyrëve është urdhëruar, për shkak se ato marrin pjesë në praktikimin e robërisë për të Vërtetin e Lartësuar dhe, për shkak të asaj që duket në këtë robëri. Më pas, Imami shpjegon pjesët e detyrave të jashtme, që kryhen me këto gjymtyrë. Njëkohësisht shpjegon edhe hapjen e rrugëve para atyre që jo vetëm marrin mësim, por edhe përfitojnë prej mësimave që marrin. Përveç kësaj, edhe ata që kanë arritur gradën e njohjes, kanë bërë të njohur sekretet e pastrimit të këtyre gjymtyrëve. Imami shpjegon qartë atë që është e dukshme prej robërisë në praninë e bekuar të të Lartit Fuqiplotë. Prandaj njeriu patjetër duhet të jetë i pastër, madje plotësisht i pastër, sepse gjymtyrët e organet e tij të jashtme kanë pjesën më të ulët prej këtyre kuptimeve. Është e qartë se këto gjymtyrë nuk janë të merituarat të jenë në këtë pozitë, nëse nuk do të jenë të pastruara. Megjithatë nënshtrimi, në të vërtetë, nuk është prej cilësive të fytyrës, gjithashtu, edhe kërkimi, dëshirat, frikësimi, veçimi e dalja përpara, nuk janë prej punëve të gjymtyrëve shqisa, megjithëkëtë, pastrimi i këtyre gjymtyrëve u bë detyrim, sepse ato përfaqësojnë dukuri të atyre kuptimeve.

Atëherë, përparësi ka pastrimi i zemrës, për shkak se zemra është vendi i robërisë së vërtetë dhe qendra konkrete e atyre kuptimeve. Pa pastrimin e zemrës, kurrë nuk do të jenë të pastra gjymtyrët e dukshme, edhe sikur ato të lahen me ujë e shtatë deteve dhe kurrë nuk do të jenë të merituarat për këtë pozitë. Madje shejtani do të jetë ai që do të veprojë në ato gjymtyrë dhe kështu rrugëtari në udhën e Allahut është i përzënë prej pranisë së pastër të madhështisë.



Në librin “El-Ilelu” transmetohet se disa jehudi shkuan tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i drejtuan atij disa pyetje. Ndër pyetjet që i drejtuan, ishte: “O Muhamed, na thuaj, se cila është arsyeja, që për abdesin janë urdhëruar të lahen vetëm katër gjymtyrë, në një kohë që ato janë pjesët më të pastra të trupit?”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Kur shejtani e joshi Ademin dhe ai iu afrua pemës, e shikoi pemën, ndërkaq atij menjëherë iu largua uji i fytyrës. Më pas ai eci drejt pemës. Ky ishte hapi i parë që ai hodhi drejt gabimit. Më pas, ai mori me dorën e tij frytin e asaj peme dhe e hëngri. Pasi ai e hëngri frytin e asaj peme, menjëherë prej trupit të tij fluturuan stolitë e veshjet. Ademi menjëherë vuri dorën mbi kokën e tij dhe qau. Kur Allahu ia pranoi pendimin, e detyroi atë dhe pasardhësit e tij me pastrimin e këtyre katër gjymtyrëve: e urdhëroi të lajë fytyrën, sepse pa në drejtim të pemës, e urdhëroi të lajë dy duart deri te bërrylat, sepse me duart mori frytin, e urdhëroi t’i japë mes’h kokës, sepse ai e vuri dorën mbi kokë dhe e urdhëroi t’i japë mes’h dy këmbëve, sepse me dy këmbët ai eci drejt gabimit”.<sup>1</sup>

Gjithnjë në librin “El-Ilelu” transmetohet se jehuditët e pyetën të Dërguarin më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Cili është shkaku, që Allahu i Madhëruar bëri detyrim për umetin tënd të agjërojnë tridhjetë ditë?”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) utha: “Kur Ademi hëngri frytin e pemës, ai fryt mbeti në barkun e tij tridhjetë ditë dhe gjatë këtyre ditëve ai qe i uritur dhe i etur

---

<sup>1</sup> “Ilelu-Sh’sherà’i”, vëll. 1, K. 191, Hadithi 1, f. 280.



*dhe, për sa i përket asaj që ata hanë natën, për ata ajo është mirësi prej Allahut të Lartësuar...*<sup>1</sup>

Ata që dinë të kuptojnë dhe zotëruesit e zemrave marrin prej këtyre haditheve të nderuara disa përfitime, të cilat janë: Në të vërtetë, gabimi i Ademit, pavarësisht se nuk qe si gabimet e njerëzve të tjerë, në fakt, ishte një gabim i natyrshëm, ose ishte gabim i natyrës së shqetësimit për shumëllojshmërinë e emrave të sendeve dhe në tërheqjen pas asgjësimit vetjak. Ishte një gabim që përfaqësohet me pemët e natyrës. Por ai gabim nuk ishte as i parashikueshëm e as i pranueshëm prej një njeriu si Ademi, sepse Ademi ishte i zgjedhuri i Allahut dhe i veçuar me afrimin e me asgjësimin e vetvetes.

Sipas kërkesave të “instinktit të dashurisë”, i Vërteti shpall mëkatin dhe gabimin e Ademit në të gjithë botët, me fjalën e të gjithë profetëve dhe Allahu i Lartësuar njofton: “وَعَصَىٰ آدَمُ رَبَّهُ فَغَوَىٰ” - “...ue asà Àdemu rab'behù fegavà” - “...Ademi e kundërshtoi Zotin e tij dhe gaboi...”<sup>2</sup>Për të pastruar Ademin e pasardhësit e tij, ata që ishin të depozituar në palcën e tij, si dhe ata që do të dilnin prej palcës së tij, i Vërteti i detyroi ata të pastroheshin me ujë, për shkak se, që nga ky çast, të gjithë njerëzit do të kenë pjesën e tyre në gabimin e atëhershëm.

Por, për gabimin e Ademit e të pasardhësve të tij, ka shkallë e dukuri, që fillojnë me vëmendjen ndaj emrave të shumtë të sendeve. Kjo është shkalla e parë e gabimit, që përfundon me shkallën e fundit, e përfaqësuar me ngrënien e frytit të pemës së ndaluar, pemë, në të cilën janë llojet e frutave në botën e cilësive, në

---

<sup>1</sup> “Ilelu-Sh’sherà’i”, vëll. 2, K. 109, Hadithi 1, f. 378.

<sup>2</sup> Sure “Tà Hà”, ajeti 121.





botën e natyrës dhe në çdo gjë që ka lidhje me botën e pasurisë. Dashuria për këtë botë dhe dashuria për veten, që gjenden te pasardhësit e Ademit, kanë lidhje me prirjen që ka njeriu ndaj kësaj bote, por kanë lidhje edhe me prirjen e njeriut për të ngrënë prej frutave të kësaj bote. Kështu qëndron puna në pastrimin e jashtëm e të brendshëm. Edhe për namazin e për agjërimin, gjithashtu, ka shkallë të shumta, që janë vënë në ligjin e fesë, me qëllim për të nxjerrë pasardhësit e Ademit prej gabimit të babait. Këto shkallë janë në përshtatje me shkallët e atij gabimi.

Nga ajo që u tha më sipër, bëhet e qartë se të gjitha llojet e gjynaheve formale, janë gjynahe të trupit të bijve të Ademit, janë gjynahe që kanë lidhje me ngrënien e frytit të asaj peme, prandaj edhe pastrimi prej atij gabimi bëhet me një mënyrë të veçantë. Edhe të gjitha llojet e gjynaheve të zemrës kanë lidhje me atë pemë, por pastrimi i këtyre gjynaheve bëhet me një mënyrë tjetër, ashtu siç është gjendja edhe me të gjitha gjynahet e tjera shpirtërore, por pastrimi i gjynaheve shpirtërore plotësohet me një mënyrë të veçantë. Tek ata që kanë arritur gradën e plotësimit, pastrimi i gjymtyrëve të jashtme përfaqëson hijen e pastrimit të zemrës dhe të pastrimit shpirtëror, kurse te rrugëtarët në udhën e Allahut pastrimi i gjymtyrëve të jashtme është një rrugë për të shkuar drejt pastrimit të zemrës dhe pastrimit shpirtëror.

Nuk ka ndonjë prej rrugëtarëve në udhën e Allahut që të ketë mbetur nën mbulesën e caktimit të gjymtyrëve dhe të pastrimit të gjymtyrëve, asnjëri prej tyre s'ka ndaluar në këtë cak dhe s'ka asnjë prej atyre që të mos ketë dalë jashtë "gabimit". Sa më shumë që ai shqetësohet me shkallët e pastrimeve të jashtme e të brendshme, aq më shumë kupton se pastrimet e jashtme janë mjete



për pastrimet morale, prandaj ai ka interesimin në shkallën më të lartë, që në të gjitha adhurimet e rituallet të ketë sa më shumë pjesë të zemrës, madje ai stoliset me pastrimin e zemrës dhe, kur ai arrin të interesohet që anët e brendshme të jenë sa më shumë dhe i konsideron ato si qëllimin më të rëndësishëm e më të lartë, patjetër që me këtë interesim ai hyn në rrethin e rrugëtimeve njerëzore, ashtu siç e thekson këtë kuptim hadithi sherifi: “...dhe pastroje zemrën tënde me devotshmëri e me bindje të thellë, kur shkon të pastrosh gjymtyrët e tua me ujë”.<sup>1</sup>

Atëherë, rrugëtari në udhën e Allahut, kur fillon rrugëtimin në fushën e diturisë, në radhë të parë, duhet që, me mirësinë e të përkushtuarve në përmendjen e Allahut (ehlu-dh’ hikri), patjetër të përcaktojë gradat e adhurimeve dhe të dijë se adhurimet formale janë grada më e ulët e adhurimeve të zemrës dhe e adhurimeve shpirtërore. Pas kësaj të fillojë rrugëtimin praktik, që përfaqëson të vërtetën e rrugëtimit, me synimin e qartë, për të pastruar mirë shpirtin, në atë mënyrë që në shpirt të mos ketë asgjë tjetër përveç të Vërtetit dhe ta zbukurojë shpirtin me shkëlqimet e Emrave të bukur. Kur rrugëtari në udhën e Allahun arrin në këtë pozitë, pa dyshim që rrugëtimi i tij ka arritur në fund dhe për rrugëtarin është bërë realitet udhëtimi i plotësuar. Në këtë pozitë, ai triumfon me sekretet e ritualeve e të adhurimeve dhe imtësitë e punëve të rrugëtimit, të cilat janë prej shkëlqimeve të Madhështorit, të përfaqësuar në sekretet e pastrimeve. Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut arrin edhe shkëlqimet e bukurive, të cilat përfaqësojnë qëllimin më të lartë të adhurimeve të tjera. Shkoqitja e kësaj çështjeje është jashtë caqeve të këtij studimi.

---

<sup>1</sup> “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 10-“Pastrimi”.



## Ndarja e gjashtë

### GUSULI DHE RREGULLAT PËR GUSULIN

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se papastërtia qëndron në mërgimin prej vendit të robërisë të hyrja në fushën e vënies në dukje të natyrës hyjnore krijuese dhe thirrjes së të tanishmes, si dhe të hyrja në kufijtë e eulijave dhe të përcaktimit me cilësinë e sovranitetit, kurse gusuli është pastrimi prej këtyre papastërtive dhe për të pohuar mosplotësimin e detyrimeve.

Disa prej shehëve të mëdhenj të fesë<sup>1</sup>, në dhjetë tema kanë shpjeguar se rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të bëjë gusul në njëqind e pesëdhjetë raste dhe se gjysma e këtyre rasteve, madje të gjitha rastet kanë lidhje me mbajtjen e vetes për të madh, me tiraninë, mendjemadhësinë, me egoizmin dhe me vetëpëlqimin.

Autori thotë se afrimi është zhdukja në natyrën dhe shkujdesja ndaj shpirtërores, shpreh qëllimin më të lartë të plotësimit të kafshërores dhe rënien në fundin më të thellë. Fjala “gusul” shpreh pastrimin prej atij gabimi e kthimin prej sundimit të natyrës dhe hyrjen nën pushtetin e mëshirës së plotë, ose hyrjen nën pushtetin hyjnor, por kjo hyrje realizohet, kur bëhet larja e

---

<sup>1</sup> Qëllimi me fjalën “shehët” është për shehun Muhji-d’ dijn bin Arebi; lexo librin “El Futütul-Mek’kij’jetu”, vëll. 1, f. 362.



mbretërisë së shpirtit, i kënaqur me natyrën dhe i vënë në sprovë me mendjemadhësinë e shejtanit.

Bazuar mbi këtë që u shpjegua, rregullat e gusulit përfaqësohen në faktin se rrugëtari në udhën e Allahut, kur bën gusul, nuk qëndron në pastrimin e jashtëm dhe në larjen e trupit, i cili numërohet si korja më e afërme dhe pjesa që i bie njeriut prej kësaj bote. Në të kundërt, rrugëtari në udhën e Allahut e kapërcen këtë cak dhe interesohet të kalojë në pastërtinë e zemrës e në sekretin e shpirtit. Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut e kupton se larja e trupit dhe pastrimi i të brendshmes së zemrës, është domosdoshmëri e ngutshme dhe detyrim taksativ. Kur rrugëtari në udhën e Allahut arrin ta kuptojë këtë domosdoshmëri të ngutshme për pastrim, detyra e tij e menjëhershme është që ai ta largojë sa më larg sundimin e shpirtit kafshëror dhe anën shtazarake mbi shpirtin njerëzor, ta largojë sundimin e kafshërores mbi anët mëshiruese. Në këtë gjendje, ai ka për detyrë të pendohet, për shkak të ndyrësisë së shejtanit e prej mendjemadhësisë së tij dhe menjëherë të pastrojë të brendshmen e shpirtit, i cili është fryrje hyjnore. Me këtë fryrje të shpirtit, te njeriu, te ai, njëkohësisht është fryrë shpirti mëshirues. Këtë shpirt të pastër ai duhet ta ruajë patjetër prej ndikimeve të shejtanit, i përfaqësuar në drejtimin kah të tjerët, por orientimi kah të tjerët konsiderohet origjina e pemës së ndaluar dhe, vetëm me heqjen dorë prej orientimit kah të tjerët, ai bëhet i atillë, që të meritojë Xhenetin e babait të tij Ademit.

Gjithashtu, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të dijë se ngrënia prej frutave të kësaj peme të natyrës, afrimi te kjo botë dhe orientimi kah shumica, të gjitha këto janë origjina e origjinave të papastërtisë dhe, deri sa ai nuk është pastruar prej këtij llumi dhe



prej këtij inflamacioni me ujin e mëshirës së të Vërtetit Fuqiplotë, me këtë ujë të pastër mëshire që vjen prej Arshit mëshirues, krejtësisht i pastër prej veprimit të shejtanit, ai kurrë nuk mund të bëhet i meritueshëm, që të falë namaz me të vërtetën e miraxhit të afrimit, sepse: “S’ka namaz pa pastrim”.<sup>1</sup>

Kjo çështje theksohet edhe në hadithin sherifi, i përmendur më lart, i ardhur prej Profetit më të nderuar. Këtë hadith do ta citojmë këtu, ashtu siç e ka transmetuar autori i librit “El-Vesàil”, prej shehut Es Saduk (*Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!*), i cili, bazuar në përcjellësit e tij, tregon se disa jehudi shkuan tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Më i dituri prej atyre jehudive i drejtoi disa pyetje. Njëra prej pyetjeve, që ai i drejtoi, ishte: “Cili është shkaku që Allahu ka urdhëruar bërjen e gusulit, kur njeriu është xhunub dhe nuk ka urdhëruar larjen e trupit për shkak të jashtëqitjes e të urinimit?” I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)u tha: “Kur Ademi hëngri prej frytit të asaj peme, ai fryt depërtoi në damarët e tij, në flokët e tij dhe në lëkurën e tij dhe, kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan e vet, uji del prej çdo damari e prej çdo qimeje të trupit të tij dhe, për këtë shkak, Allahu i Lartësuar ua bëri detyrim pasardhësve të Ademit, deri në Ditën e Kiametit, larjen e të gjithë trupit prej xhunubllëkut...”<sup>2</sup>

Ky kuptim theksohet edhe në hadithin e ardhur prej Imam Rizait, i cili ka thënë: “...ata janë urdhëruar të bëjnë gusul për xhunubllëkun dhe nuk janë urdhëruar të lahen, kur bëjnë jashtëqitjen, megjithëse jashtëqitja është më ndyrësirë se xhunubllëku. Ky urdhërim

<sup>1</sup> “Vesàilu-Sh’shij’ati”, vëll. 1, Libri “Pastrimi”, K. 4 – “Abdesi”, Hadithi 1, f. 261.

<sup>2</sup> “Vesàilu-Sh’shij’ati”, K. “Et’tahàretu”, Nënkapituli 2 –“Xhunubllëku”, Hadithi 2 dhe 5.



*është bërë për shkak se xhunubllëku shkaktohet prej vetë njeriut dhe është një send që del prej gjithë trupit të tij, kurse jashtëqitja nuk shkaktohet prej vetë njeriut, por është një ushqim që hyn nga njëra portë dhe del nga një portë tjetër”.<sup>1</sup>*

Megjithëkëtë *dhahiritë* – ata që shikojnë vetëm anën e jashtme të kuptimit që shprehin hadithet – mendojnë se detyrimi për të larë gjithë trupin, në rastin e xhunubllëkut, është për shkak se sperma del prej gjithë trupit. Ky mendim i tyre përputhet me mendimin e të gjithë mjekëve dhe natyralistëve.

Por, në të vërtetë, shkakui i bërjes detyrim i gusulit ka lidhje me ngrënien e frytit të pemës, ashtu siç e pamë në hadithin e parë dhe lidhjes që ka xhunubllëku me vetë njeriun, ashtu siç e pamë në hadithin e dytë. Për ata që kanë arritur gradën e njohjes e të kuptimit, të dy hadithet e mësipërme hapin një rrugë tjetër drejt njohurive, se çështja e pemës dhe ngrënia e frytit të asaj peme prej Ademit është njëra prej sekreteve të diturive të Kur’anit dhe patjetër që këto sekrete përmbajnë dituri të fshehta, të shumta. Ky është shkakui që shumë hadithe të nderura ia referojnë ligjërimin e shumë adhurimeve çështjes së ngrënies së frytit të asaj peme prej Ademit, siç është edhe shkakui i urdhërimit për të marrë abdes, për të bërë gusul, për të agjëruar në muajin e Ramazanit dhe përse agjërimi i Ramazanit është tridhjetë ditë, përfshirë edhe shumë veprime që bëhen në vende të caktuara gjatë kryerjes së Haxhit. Prej kohësh, i kisha venë vetes qëllim, që të shkruaja një kumtesë për këtë çështje, por angazhimet e tjera më kanë penguar ta bëj realitet qëllimin tim. I kërkoj Allahut të Lartësuar mbarësi e lumturi!

---

<sup>1</sup>“Ilelu-sh’sherai’I”, vëll. 1, f. 281; “Ujûnu akhbâru-Rr’rridâ”, f. 291.



Në përgjithësi, ti, o bir i Ademit, ti që je krijuar për të marrë dituri; ti që je bërë prej një takimi të farëzës, ty të ka zgjedhur Allahu i Lartësuar për veten e Tij! Ai të gatoi ty, me duart e bukurisë e të madhështisë së Tij. Ai i urdhëroi engjëjt të të bëjnë ty sexhde dhe për këtë, ty të ka zili Iblisi. Kur ti, o bir i Ademit, ke qëllim të dalësh prej asaj që sjell xhunubllëkun e babës tënd, por që është origjina jote, kur ti, o bir i Ademit, ke qëllim të lartësohesh në nivelet e meritës, për të takuar të Dashurin dhe, kur të kesh gatishmërinë për të arritur në pozitën e njerëzores e në pozitën e pranisë në vendin e pastër, ke detyrë parësore të pastrosh të brendshmen tënde me ujin e mëshirës së të Vërtetit, të bësh teube për afrimin tënd ndaj kësaj bote, e cila përfaqëson njërën prej dukurive të pemës së ndaluar. Ke për detyrë ta pastrosh zemrën tënde, që është vendi i pranisë me më të Bukurin dhe me bukuritë e madhështisë. Kur ti, o bir i Ademit, e pastron zemrën tënde prej dashurisë për këtë botë dhe prej gjithçkaje të keqe, që ka lidhje me këtë botë, e përfaqësuar me ndyrësitë e shejtanit, dije se Xheneti për takimin e të Vërtetit është mjedisi i të pastruarve: “Në Xhenet nuk hyn askush përveç të mirit”.<sup>1</sup> dhe “Pastrohu dhe pastaj shko drejt rrënojave!”<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> “El-Kâfi”, Libri “El-Usûlu”, vëll 3, Pjesa “El-Imanu uelkufuru”, K. “Fajet”, Hadithi 7, f. 371.

<sup>2</sup> Përmbajtja e një strofe të një vjershe në gjuhën perse, e poetit dijetar Hafiz Shirazi.



## Ndarja e shtatë

### DISA RREGULLA TË BRENDSHME, QË KANË LIDHJE ME HEQJEN E PAPANASTËRTIVETË DHE ME PASTRIMIN PREJ LIGËSIVETË

Dije se largimi i papastërtisë është dalje prej të tanishmes, është dalje prej egoizmit dhe asgjësimit të vetes, ashtu siç e kemi theksuar më sipër, madje pastrimi është dalje e plotë prej shtëpisë së vetvetes. Përderisa njeriu është në mbetjet e vetes së tij, ai është i ndotur me papastërtinë më të madhe. Me këtë papastërti adhuruesi e i adhuruari janë shejtani dhe vetvetja. Madje tek ata që ndjekin tarikatin dhe të rrugëtarët në udhën e Allahut, deri vetë ecja, kur qëllimi është arritja e pozitave, ngjitja në lartësi dhe nëpër shkallë, të gjitha këto nuk janë jashtë pushtetit të vetes e të shejtanit, pasi veprimi e rrugëtimi në këtë gjendje mbështeten mbi qëllime të tjera. Në këtë gjendje, rrugëtimi është jo vetëm për të vajtur në shtëpinë e vetvetes, por edhe për të hyrë në brendësi të shtëpisë së vetvetes. Prandaj ky rrugëtar nuk udhëton për të shkuar tek Allahu e nuk është emigrant, që dëshiron të arrijë tek Allahu e tek i Dërguari i Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse ai akoma nuk e ka bërë pastrimin e madh, i përfaqësuar te vetë njeriu.

Vetëm atëherë kur adhuruesi pastrohet plotësisht prej papastërtisë së madhe, i Adhuruari, i Vërteti i Lartësuar bëhet:





“...dhe Unë jam veshi me të cilin ai dëgjon dhe syri me të cilin ai shikon”.<sup>1</sup> Vetëm me këtë pastrim, adhuruesi shumë shpejt do të arrijë rezultatin e afrimit me rrugën e adhurimeve të vullnetshme dhe, prej këtu, pastrimi i madh bëhet i domosdoshëm, bëhet detyrim larja e të gjithë trupit. Por, nëse uni i njeriut vazhdon të ekzistojë në një formë ose në një formë tjetër, rezulton se pastrimi akoma nuk është bërë: “...nën çdo qime të trupit ka xhunubllëk”.<sup>2</sup>

Atëherë heqja e papastërtisë është pastrim nga ajo që ngjau, është asgjësim në detin e përjetësisë. Plotësimi i këtij pastrimi realizohet me daljen prej shumicës së emrave, që përfaqësojnë të brendshmen e pemës. Me këtë dalje, njeriu del prej gabimit lëvizës te Ademi, që është origjina e pasardhësve.

Bazuar mbi këto që u shpjeguan, ndotja prej papastërtive morale dhe pastrimi prej kësaj ndotjeje, është prej punëve të panjohura të brendshme, prandaj ky pastrim është dritë, por është dritë e kufizuar në gjendjen e abdesit dhe është dritë absolute në gjendjen e gusulit: “...dhe cili abdes është më pastrues se gusuli”?<sup>3</sup>

Por nuk është kështu çështja e largimit të ndyrësirave e papastërtive të dukshme, sepse largimi i papastërtive e ndyrësive është formal, domethënë se edhe pastrimi i tyre është pastrim vetëm për të jashtmen. Në të vërtetë, rregullat morale të pastrimit, ose përfaqësohen në njohjen që ka rrugëtari, që synon të jetë pranë të Vërtetit, se për atë nuk mund të ketë rrugë që ai ta arrijë këtë prani, kur në të gjenden papastërtitë e ndyrësitë e shejtanit. Por ai

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 78, f. 51.

<sup>2</sup> “Bihàrul Enuàr”, vëll. 78, f. 51.

<sup>3</sup> “Xhàmiu Ehàdijthi-sh’shij’ati”, Libri “Et’tahàretu”, K. 12- “Ahkàmul-gusli dhe dispoziatat e tij”.



e di mirë, se për atë s'ka rrugë, që ai të arrijë qëllimin që i kishte vënë vetes, deri sa nuk ka dalë plotësisht prej "nënës" së poshtërsive morale, që janë fillimi i shkatërrimit të qytetit të virtytshëm njerëzor dhe burimi i gabimeve të jashtme e të brendshme. Gjithashtu, ai nuk arrin as udhën për te qëllimi i tij e as nuk do ta gjejë rrugën për të arritur qëllimin që kishte. Në këtë kuptim, shembulli i shejtanit është një argument i qartë, sepse shejtani ishte në fqinjësi të botës së pastër dhe konsiderohej prej "të afruarve". Prandaj rrugëtari, në të vërtetë, është shumë larg shenjës që njofton fundin e rrugëtimit, ashtu siç njofton për këtë gjendje të tij vetë shejtani, kur pohon se ai nuk është më në pozitën e afrimit dhe as fqinj me të Vërtetin, për faktin se shejtani u qëllua me Fjalën e të Lartit: "فَاخْرُجْ مِنْهَا فَإِنَّكَ رَجِيمٌ" - "...*fakhruxh minhà fein'neke rexhiymun*" - "**...dil prej aty, ti je i përzënë!**"<sup>1</sup> Po ne, që kemi mbetur prapa karvanit të botës së panjohur, ne që jemi të zhytur në pusin e thellë të natyrës dhe të renditur nga më të fundit, si mund të jemi të denjë, sa të meritojmë të marrim pjesë në vendmbledhjen e pastër, të jemi fqinjë të atyre që dinë kuptimet dhe të jemi shoqërues të të afruarve, në një kohë, kur mbi ne rëndon pesha e cilësive të këqija të shejtanit?!

Shejtani u mahnit nga vetja e tij, kur pa "zjarrin e tij" dhe tha: "قَالَ أَنَا حَيْرٌ مِنْهُ" - "...*kàle ene khajrun minhu...*" - "**...Ai (shejtani) tha: 'Unë jam më i mirë se ky'**".<sup>2</sup> Vetëpëlqimi e çoi shejtantin në mendjemadhësi. Shejtani e vështroi Ademin me përçmim dhe tha: "حَلَّاهُ مِنْ طِينٍ" - "...*khalaktehù min tijnin*" - "**...atë Ti e krijove prej baltës**".<sup>3</sup> Shejtani bëri një vlerësim e krahasim të gabuar, sepse

---

<sup>1</sup> Sure "Sād", ajeti 77; sure "El Hixhr", ajeti 34.

<sup>2</sup> Sure "Sād", ajeti 76.

<sup>3</sup> Sure "Sād", ajeti 76.



shejtani nuk pa as bukurinë e Ademit e as plotësimin e tij shpirtëror, por shikoi vetëm anën e jashtme të Ademit, shikoi vetëm se ai ishte krijuar prej baltës, në një kohë që veten e konsideronte prej zjarri. Nga mendjemadhësia e pëlqimi i vetes, shejtani ishte i shkujdesur ndaj domosdoshmërisë, që të zhvishej nga dashuria për veten e nga egoizmi. Dashuria për veten u bë një perde për shejtanin, që e pengonte të shikonte mangësitë e veta, madje ajo perde ishte aq e trashë para syve të tij, sa nuk e linte të shihte të metat e veta, kurse vetëpëlqimi për shejtanin u bë shkak që ai të mbahej me të madh, të krekosej, të tregonte mendjemadhësi. Gjithashtu, vetëpëlqimi bëri që shejtani të dilte hapur si hipokrit, që ka qëllim të imponojë mendimin e tij dhe të rebelohet. Të gjitha këto u bënë shkak që shejtani u largua prej miraxhit të shenjtërisë së pastër dhe të flakej në shkretëtirën e natyrës së errët.

Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut ka detyrë ta pastrojë veten nga dashuria për këtë botë, që është “nëna” e të gjitha poshtërsive dhe e të gjitha ndyrësive të brendshme djallëzore, prandaj, kur ai ngrihet të pastrohet prej papastërtive të dukshme, njëkohësisht ka për detyrë ta lajë “qytetin e virtyteve” – zemrën, me ujin e mëshirës së të Vërtetit dhe me ushtrime ligjore. Ai ka për detyrë ta pastrojë zemrën e vet, vendin ku shkëlqen i Vërteti i Lartësuar, nga çdo gjë që e ndyn dhe e njollos atë. Gjithashtu, ai ka për detyrë të zhvishet nga mania për autoritet e për prestigj, pasi vetëm kështu do të meritojë të hyjë në luginën e “sigurisë” së pastër dhe të meritojë shkëlqimin e Zotit të botëve.

Përderisa nuk është arritur vetëpastrimi prej ndyrësive të këqija, s’ka rrugë për pastrimin prej nevojave njerëzore. Në të vërtetë, pastrimi i të jashtmes është parathënie për pastrimin e të brendshmes dhe, derisa nuk është realizuar devotshmëria në botën



e mbretërisë së kësaj bote, në mënyrën më të plotë dhe ashtu siç e urdhëron devotshmërinë ligji i pastër i fesë, kurrë nuk mund të realizohet devotshmëria e zemrës dhe, nëse nuk arrihet devotshmëria e zemrës në punët që u përmendën më sipër, kurrë nuk do të dalë në shesh devotshmëria shpirtërore e vërtetë e padukshme. Vetëm me një pastrim të plotë të jashtëm e të brendshëm mund të mblidhen së bashku gradat e devotshmërisë, që të bëhen parathënie për gradën e devotshmërisë së plotë, e cila bëhet realitet vetëm atëherë kur në të hiqet çdo gjë, përveç të Vërtetit, sepse i Vërteti kurrë nuk shkëlqen në sekretin e rrugëtarit në udhën e Allahut, deri sa në të ka mbeturina të egoizmit.

Po, disa herë ndodh që rrugëtari në udhën e Allahut të ndihmohet sipas kërkesave të rregullit, që mëshira dhe tërheqja hyjnore kanë përparësi dhe bëhen sunduese, çka i mundëson rrugëtarit në udhën e Allahut që vetëm në saje të një thëngjilli hyjnor të djegë edhe ato mbeturina të egoizmit që mund të gjenden në të. Shfaqja e shkëlqimit të të Vërtetit Fuqiplotë mbi malin, thërrmimi i malit dhe alivanosja e Musait ka mundësi të tregojnë edhe këtë kuptim. Gjithashtu, ky fakt ka mundësi të tregojë edhe dallimin mes rrugëtarit të tërhequr dhe të tërhequrit rrugëtar. Nga sa u theksua, rezulton se ata që, me diturinë, kanë arritur gradën e të vërtetës (ehlul-hakijkah), kanë kuptuar një shprehje shumë domethënëse e shumë të lartë; kanë kuptuar edhe një punë shumë të rëndësishme, e cila e konsideron injorancën burimin e shumë prej formave të shkarjes në rrugën e humbjes, të mashtrimit e të mbetjes prapa në rrugën e të Vërtetit, punë këto që asnjë rrugëtar në udhën e Allahut jo vetëm që nuk duhet t'i injorojë, por duhet të dijë se atij nuk i lejohet të jetë i shkujdesur ndaj këtyre punëve të gabuara. Përveç kësaj, rrugëtari në udhën e Allahut dhe kërkuesi i të Vërtetit



ka për detyrë ta pastrojë veten jo vetëm prej veprimeve të tepruara, por edhe prej mosplotësimit të punëve. Me fjalë të tjera, ai ka detyrë të mos veprojë ashtu siç thonë disa të shkujdesur injorantë, prej atyre që kapen vetëm pas kuptimit të jashtëm të fjalëve. Vetëm kështu ai do ta ketë të lehtë udhëtimin për tek Allahu. Disa prej grupit të parë besojnë se dituria dhe puna e atyre që kapen vetëm pas anës së jashtme të fjalëve (formalistëve), është thjesht një mbushje e veçantë për injorantët dhe për njerëzit e zakonshëm, ndërsa ata që dinë sekrete dhe të vërteta (ehlu-s'sirr'rri uel hakijkati), si dhe zotëruesit e zemrave dhe krerët e dijetarëve të mëparshëm, të dalluar për punë të mira, nuk kanë nevojë për këto punë klishe, me të cilat synohet të arrihen të vërtetat e zemrës dhe qëllimi. Kur rrugëtari në udhën e Allahut e arrin qëllimin e tij, atëherë puna për atë, në këto pozita, numërohet një lloj largimi prej qëllimit të tij, por edhe shqetësimi i madh numërohet perde.

Për sa u përket disave prej grupit të dytë, ata i kanë të gatshme fjalët për t'ju kundërvënë grupit të parë, por me këtë veprim, në të vërtetë, ata kanë hyrë në rrugën e shkujdesjes, kanë mohuar të gjitha pozitat morale e sekretet hyjnore, sepse ata nuk pranojnë asgjë përveç asaj që është e dukshme, asaj që ka formë e lëvore. Gjithçka që pretendon grupi i parë, ata ia adresojnë fantazisë e përfytyrimit. Grindja, polemika e armiqësia është e pranishme ndërmjet këtyre grupeve dhe çdo grup thotë për grupin tjetër se ai grup kundërshton ligjin e fesë.

Në të vërtetë, të dy grupet, në një farë mase, e kanë tejkalluar kufirin, të dy grupet kanë rënë në teprim e në lënien mangët të punëve. Këtë temë e kemi theksuar në kumtesën "Sirr'rru-s' salati" - "Sekreti i namazit", prandaj këtu do të shpjegojmë vetëm aq sa mundëson përfaqësimin në rrugën e drejtë.



Mëso se me ritualet që kryhen në vende të caktuara dhe me adhurimet klishe nuk është qëllimi që me ato të arrihen, si tërësi, vetëm cilësitë shpirtërore të plotësuara dhe të vërtetat e zemrës. Pa dyshim që këto rituale e adhurime janë mbartja e diturive hyjnore nga e brendshmjia për në të jashtmen dhe prej sekretit në nxjerrjen sheshit. Kështu është edhe mirësia e mëshirës gjithëpërfshirëse, madje e mëshirës së plotë, e cila përfshin të gjitha botët e njerëzores, ato që kanë të bëjnë me zemrën dhe ato që janë klishe. Çdo gradë e këtyre botëve njerëzore ka pjesën e vet prej mirësive hyjnore të përgjithshme. Gjithashtu, në çdo gradë ka pjesë për të madhëruar të Vërtetin dhe për të falënderuar për mirësinë e madhe të mëshirës gjithëpërfshirëse dhe të mëshirës së plotë të Absolutit. Edhe për shpirtin ka pjesë prej rritjes formale të kësaj bote, ka pjesë edhe prej jetës në botën e cilësive. Qilimi i shumicës akoma nuk është palosur plotësisht, por as pjesët e natyrës akoma nuk janë mbaruar, prandaj rrugëtarit në udhën e Allahut i mbetet detyrë të mos e ngarkojë zemrën e tij me asgjë tjetër përveçse me të Vërtetin. Gjithashtu, ai ka për detyrë të mos e humbë shpirtin, fantazinë e pasurinë e natyrës në rrugë të tjera, përveçse në rrugën e të Vërtetit, me qëllim që besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) dhe dëlirja e të Vërtetit nga nevojat e mangësitë të jetë i qëndrueshëm në të gjitha rritjet. Veç kësaj, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të tregojë kujdes, që frutat e tërheqjes hyjnore të mos jenë rezultat i mosadhurimit e mosnënshtrimit ndaj të Vërtetit në mbretërinë e natyrës, sepse kjo tregon se mbetjet e egoizmit vazhdojnë të jenë të pranishme te ai dhe udhëtimi i këtij rrugëtari, në të vërtetë, është për në zbrazëtirën e shtëpisë së vetes dhe nuk është udhëtim për tek Allahu. Qëllimi më i lartë i atyre që udhëtojnë për tek Allahu, është që natyra e trupit e cilësitë e tyre të jenë të ngjyrosura me ngjyrën e Allahut, me fenë e Allahut. Ka shumë mundësi që njëri



prej sekreteve të hadithit kudsî: *“Unë jam Allahu, Unë jam i Gjithëmëshirshmi, Unë e krijova mëshirën dhe prej saj Unë ndava një emër prej Emrit Tim. Kush e arrin mëshirën, Unë kam arritur tek ai dhe, kush e ndërpret mëshirën, Unë jam ndarë prej tij”*<sup>1</sup>, domethënë ndërprerja prej kësaj natyre, e cila është nëna e shpirtave – është ndërprerja e saj prej vendit të origjinës, pastaj rritja e kësaj që u pre prej natyrës, duhet të jetë me rrugën e vaditjes së saj e me kthimin e saj në vendin e robërisë.

Në përgjithësi, nxjerrja jashtë e mbretërisë së të dukshmes prej vendeve të robërisë dhe lëshimi i frerëve të së jashtmes, në pozitat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, numërohet prej gjendjeve të injorancës më të madhe dhe prej rrafshimeve të shejtanit të dëbuar, i cili, me një mënyrë a me një tjetër, çdo grupi i zë rrugën, për të arritur tek i Vërteti Fuqiplotë, plotësisht ashtu siç ishte edhe mohimi i pozitave dhe mbyllja e rrugës së diturisë, e cila është bebja e syrit të eulijave të Allahut. Kështu qëndron puna edhe me zvogëlimin e rolit të ligjeve hyjnore dhe me lartësimin e diturive të dukshme, të cilat nuk janë më shumë se thjesht pjesë e kësaj bote, janë cilësi të njeriut në pozitën e kafshërisë, por edhe shkujdesja e lënia pas dore e sekreteve të adhurimeve dhe e rregullave morale të adhurimeve, sepse këto rregulla çojnë në pastrimin e sekretit, në përmirësimin e zemrës dhe në lartësimin e të brendshmes, përsëri numërohen prej dukurive të injorancës më të ashpër dhe shkujdesje e plotë. Të dy grupet anashkalojnë e i largohen rrugës së lumturisë dhe rrugës së drejtë njerëzore, por me këto veprime, në fakt, ata kanë braktisur pozitat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes.

<sup>1</sup>“Meànij-Akhbâr”, f. 302; “Bihàrul Enuar”, vëll. 71, f. 95.



Bazuar mbi këto që u thanë, ai që ka dituri për Allahun dhe dijetari që ka dijani për pozitën e ruajtjes në mënyrë të barabartë të të gjitha të drejtave, qofshin nga ato të drejta që kanë lidhje me të brendshmen, qofshin nga ato të drejta që kanë lidhje me të jashtmen, dhënia e të drejtës në mënyrë të barabartë atij që i takon, pastrimi i vetes prej teprimit e prej lënies mangët, por edhe zhdukja e rolit të dukshëm të ligjit të fesë e i të vërtetës së këtij ligji, pa dyshim që është minimizim i rolit të ligjit të fesë. Kurse të këqijat që vijnë prej mohimit të së brendshmes të ligjit të fesë dhe i të vërtetës së tij, është prangosje e rolit të brendshëm të ligjit të fesë. Të dyja këto veprime janë prej cytjeve e prej ligësive të shejtanit të mallkuar, ligësi që kanë si qëllim zënien e rrugës për tek Allahu i Lartësuar dhe që rrugëtari në udhën e Allahut të mos arrijë pozitën morale.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se njëra prej gradëve të largimit të iluzioneve shkatërruese, pengon realizimin e afrimit tek Allahu dhe ndalon ngritjen lart në miraxhin e besimtarëve. Pikërisht mbi këto bazohet njëra prej kuptimeve të përmbledhjes së profecisë mbyllëse, madje është njëra prej argumenteve, që vërtetojnë se ajo është profetësia mbyllëse, do të thotë se kjo profetësi i kreu plotësisht të gjitha detyrimet deri në pjesët më të vogla, që kanë të bëjnë me çështjet e ligjit të fesë, njëkohësisht kjo profetësi i plotësoi edhe të gjitha pozitën shpirtërore. Edhe në pozitën e njohjes së çështjeve hyjnore, kjo profetësi mbyllëse bëri të njohur të Vërtetin e Lartësuar, në mënyrë të përgjithshme, nga lartësitë më të mëdha deri në ultësirat më të thella. Për këtë, Allahu i Lartësuar njofton: “هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ” - “Huvel-ev’velu uel-âkhiru uedh’dhâhiru uel-bâtinu...” - **“Ai është i pari pa fillim, Ai është i**





**fundit pa mbarim, Ai është i dukshmi, Ai është i padukshmi...<sup>1</sup>, “السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَاللَّهُ نُورٌ” - “All’lâhu nûru-s’semâvâti uel-erdi...” - “Allahu është drita e qiejve dhe e tokës...<sup>2</sup>, “...sikur ju të lëshoheshit deri në dy tokat më të poshtme<sup>3</sup>, “فَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا وَجْهَ اللَّهِ” - “...fe ejnemâ tuvel’lû fethem’me vexh’hu-ll’lâhi...” - “...ngado që të ktheheni, aty është Allahu...<sup>4</sup>, pa sjellë ajete të tjera nga ato që te dijetari që ka njohuri për dituritë hyjnore dhe i tërhequr me tërheqjen e mëshirës gjithëpërfshirëse, shkaktojnë “vallëzimin e cilësive” dhe “ekzistencën hyjnore”. Veç kësaj (profetësia mbyllëse) e bëri të ecë besimin praktik dhe besimin e zemrës në pohimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (et’teuhjidel-amelij uel-kalbij) deri në gradën më të fundit të horizontit të natyrës dhe të mbretërimit të trupit. Kjo mëshirë s’ka lënë pa pjesë asnjë qenie prej diturisë e njohjes së Allahut.**

Në përgjithësi, themi: Sufitë përsërisin urtësinë e Isait. Ata që kapen pas së jashtmes së fjalëve, përsërisin urtësinë e Musait dhe këtë përsëritje ata e bëjnë nga ato anë, që ata nuk i ndiejnë.<sup>5</sup> Për sa u përket ndjekësve të Muhamedit, ata janë të pastër nga të dyja gjendjet e mësipërme. Hollësitë, në lidhje me këtë çështje, në këtë ndarje, le të themi, në mënyrë të përmbajtur, janë jashtë kuadrit të studimit tonë në këtë libër.

<sup>1</sup> Sure “El Hadid”, ajeti 3.

<sup>2</sup> Sure “En Nûr”, ajeti 35.

<sup>3</sup> Lexo librin “Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 54.

<sup>4</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 115.

<sup>5</sup> Me sa duket, vihet theksi mbi zotërimin e murgjërës dhe të rrymës drejt cilësive në ligjin e fesë së Isait, që ishte e kundërta e asaj që ndodhi në ligjin e fesë së Musait.



## Vijim

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” lexojmë se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nevojtorja është quajtur vendpushimi, sepse në nevojtoare njeriu qetësohet nga pesha e papastërtive dhe aty zbraz sendet e ndyra, të shumta që ka në trupin e tij. Me pastrimin prej kësaj bote, besimtari ka parasysh që edhe fundi i tij të jetë i pastër, prandaj ai qetësohet, duke hequr dorë prej kësaj bote dhe duke zbrazur shpirtin e zemrën nga shqetësimi për këtë botë. Ai heq dorë nga mendimi, që të grumbullojë sa më shumë prej kësaj bote, ashtu siç heq dorë prej papastërtive e prej ndyrësive. Ai mendon për veten e tij se është i nderuar, në një gjendje kur mund të jetë i poshtëruar. Ai e di se kapja pas kënaqësisë, me aq sa ka dhe pas devotshmërisë, sjellin për atë qetësinë në të dyja botët. E di se qetësia në poshtëritë e kësaj bote qëndron në zbrazjen e vetes prej kënaqësive të kësaj bote dhe në largimin e papastërtisë haram dhe të dyshimtë. Ai e mbyll para vetes portën e mendjemadhësisë, pasi më parë e ka njohur mendjemadhësinë, prandaj largohet me vrap prej fajeve e prej gjynaheve. Hap për veten e tij portën e përruljes, portën e pendimit dhe portën e turpits. Mundohet shumë të kryejë urdhrat e Allahut të Lartësuar dhe të shmangë plotësisht dhuntitë që i janë dhënë. Për vendin e bukur, ku do të kthehet dhe për afrimin e mirë që do të ketë, ai e burgos veten në burgun e frikës e të durimit dhe heq dorë prej dëshirave, deri sa të bashkohet me sigurinë e Allahut, në shtëpinë e qëndrueshme dhe të shijojë ëmbëlsinë e kënaqësisë së Tij. Kjo është shpresa dhe, pas kësaj shprese s’ka asnjë send”.<sup>1</sup>

Në këtë fjalë, të nderuar, ka një platformë e program përgjithësues për ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe për

---

<sup>1</sup> “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 9 - “Vënia në dukje”.



rrugëtarët në udhën e Allahut. Njeriu që nuk është i shkujdesur ndaj rrugëtimit për në Botën Tjetër dhe, në bazë të kërkesave të kësaj fjale, në të gjitha gjendjet morale, të lumtura e të gëzueshme, ka kujdesin më të madh të mbajë në mendje se te Cili do të kthehet e vendin që e pret. Pikërisht për këtë, dijetarët e mëdhenj kanë thënë se “Profeti është shërbëtori i vendimit, ashtu siç është mjeku shërbëtori i trupit”. Profetët e mëdhenj dhe eulijatë e nderuar (*Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!*), nuk shikojnë asgjë tjetër përveçse vendimin e Allahut e anën hyjnore, prandaj pushteti i vendimit hyjnor është mbizotërues mbi zemrat e tyre. Ata e kuptojnë mirë dhe kujdesen si t’i drejtojnë të gjitha punët me duart e engjëjve të Allahut, që janë ushtarët hyjnorë, në një kohë që mjeku i botës së natyrës, ngaqë është shumë larg prej kësaj grade, madje nuk është fare në këtë luginë, lëvizjen e punëve natyrore ia atashon fuqive të natyrës.

Njeriu hyjnor shikon pjesën e hyjnores në të gjitha sendet. Aftësia për të kuptuar njohjen e Allahut dhe për të dalluar të Vërtetin, bën që çdo qenie të shohë dritën e të Vërtetit. Prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), transmetohet: “*S’kam parë ndonjë send veçse para atij sendi, pas atij sendi dhe së bashku me atë send, kam parë Allahun*”.

Si përfundim: Rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të përfitojë prej të gjitha gjendjeve e nga të gjitha anët e gëzimeve të rrugëtimit që ka ndërmarrë, prandaj, kur ai shikon në mbeturinat e kësaj bote dhe në kënaqësitë e botës së pasurisë, vë re se kjo botë priret kah zhdukja e ndryshimi, prandaj edhe të gjitha pasojat e punëve të kësaj bote, patjetër janë shkatërrim e zhdukje. Atëherë, nuk është për t’u çuditur që për atë është shumë më e lehtë të tregojë sa më pak kujdes, për të marrë nga kjo botë, madje të heqë



dorë plotësisht prej saj, ashtu siç heq dorë prej ndyrësive, sepse e brendshmjia e botës së natyrës është ndyrësirë, prandaj edhe papastërtitë e ndyrësitë që shihen në ëndërr, gjatë gjumit, janë shpjeguar me këtë botë dhe me ato që gjenden në këtë botë, megjithëse gjumi përfaqëson njërin prej portave të zbulimit të sendeve. Duhet theksuar se zbulimi për të cilin deklarohet, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), këtë botë e ka quajtur “cofëtinë dhe ngordhësirë”.<sup>1</sup>

Bazuar mbi këto që u thanë, besimtari kërkues ka për detyrë ta qetësojë zemrën e tij nga varësia prej kësaj bote dhe nga merakun për këtë botë. Gjithashtu, ai ka për detyrë të heqë nga shpatullat e zemrës së tij peshën e rëndë të dashurisë për këtë botë dhe peshën e reputacionit që dëshiron të ketë në këtë botë. Ai ka për detyrë t’i largojë krejtësisht prej “qytetit të moraleve” të lavdëruara këto ndyrësi dhe ta qetësojë zemrën e vet, plotësisht ashtu siç heq peshat e rënda të natyrës e mbetjet e saj. Me këtë heqje peshash, në të njëjtën kohë, ai qetëson edhe “qytetin e natyrës” nga mundimi që ka prej papastërtive.

Ai ka për detyrë të mendojë se si merakun për këtë botë e dëmton atë, i cili, për shkak të këtij merakun, pas një kohe të shkurtër, mund të bëhet i poshtër e shumë i ulët dhe të kalojë nëpër gjendjet më të këqija e më të rënda.

Ai ka për detyrë të kuptojë, se edhe merakun me zemër për këtë botë, shumë shpejt do të bëjë që ai të poshtërohet dhe brenda një kohe shumë të shkurtër do ta vërë atë para llogaridhënies më të ashpër dhe të dënimit të rëndë. Kjo do të ndodhë me të, kur do të

---

<sup>1</sup> Tregon fjalën e Prijësit të besimtarëve: “Gjetën përpara një cofëtinë dhe u turpëruan, që e hëngrën atë...”; lexo “Nehxhul Belàga”, Hytbeja 108.



ngrihet perdja e pasurisë dhe kur do të largohen mbulesat e natyrës. Vetëm atëherë ai e kupton domethënien e fjalëve të hadithit: *“Të kapurit pas kënaqjes, bindjes dhe devotshmërisë, do të sjellin për atë qetësi në të dyja botët...”* Prandaj, detyra e tij e menjëhershme është që ta pastrojë veten prej ndyrësirave haram, madje të heqë dore edhe nga gjërat e nga punët e dyshimta, ashtu siç e pastron veten prej papastërtive të dukshme.

Dhe, kur ai e njeh veten dhe ndërgjegjësohet sa të ulëta janë nevojat e mangësitë e tij, atëherë ai e mbyll para vetes portën e mendjemadhësisë, të cilën më parë e ka njohur. Në këtë gjendje, ai nxiton të largohet prej fajeve e prej gjynaheve dhe hap për veten e tij portën e përruljes, portën e pendimit dhe portën e turpfit. Ai mundohet shumë të kryejë urdhrat e të Lartit dhe të shmangë plotësisht dhuntitë që i janë dhënë; për vendin e bukur, ku do të kthehet dhe për afrimin e mirë që do të ketë. Ai e burgos veten në burgun e frikës e të durimit dhe heq dorë prej dëshirave, deri sa të bashkohet me sigurinë e Allahut, në shtëpinë e qëndrueshme dhe të shijojë ëmbëlsinë e kënaqësisë së Tij. Kjo është shpresa dhe, pas kësaj shprese s’ka asnjë send.



## Qëllimi i dytë

# ETIKA E VESHJES

## Pozita e parë

### ETIKA E VESHJES, NË PËRGGJITHËSI

Mëso se shpirti folës njerëzor është një e vërtetë e brendshme që, përveç unitetit e plotësisimit, ka disa zhvillime. Më kryesoret ndër këto zhvillime, janë tri:

*I pari:* zhvillimi i mbretërisë së dukshme e kësaj bote, që shfaqet në ndijimet e jashtme, mbulesa e të cilave është trupi.

*I dyti:* zhvillimi i mesëm në Berzah, që shfaqet në ndijimet e brendshme në trupin e botës së Berzahut dhe në shabllonin e shëmbëllimit.

*I treti:* zhvillimi i fshehtë, i brendshëm. Vendi ku shfaqet ky zhvillim, është zemra dhe punët e saj.

Lidhja mes çdo zhvillimi prej këtyre zhvillimeve me zhvillimin tjetër, është si lidhja mes të dukshmes e të padukshmes, mes shkëlqimit e të shkëlqyerit. Pikërisht për këtë, shenjat, veçantitë e reagimet e çdo zhvillimi kalojnë në zhvillimin tjetër. Për



shembull, kur shqisa e të parit sheh një send, në të vërtetë, një gjurmë prej këtij ndijimi ndodh edhe në ndijimin e Berzahut, me atë mënyrë që është në përshtatje me zhvillimin e botës së Berzahut. Por edhe një gjurmë tjetër e këtij ndijimi bie në shikimin e zemrës, në shikimin e brendshëm, që, gjithashtu, është në përshtatje me zhvillimin e zemrës.

Kështu qëndron puna edhe me gjurmët e zemrës, të cilat, gjithashtu, shfaqen në dy zhvillimet e fundit. Kjo punë, përveç faktit që përputhet me një argument të fuqishëm, përputhet edhe me ndjenjën e ekzistencës. Bazuar mbi këtë fakt, të gjitha format e etikës ligjore të dukshme lënë një gjurmë, madje lënë gjurmë të shumta në brendësi. Gjithashtu, edhe për të gjitha moralet e bukura, disa prej të cilave janë prej pjesëve shpirtërore të pozitive të Berzahut, të gjitha lënë gjurmë jashtë e brenda. Edhe për çdo dituri hyjnore dhe për dituritë në fushën e doktrinës së vërtetë ka gjurmë zhvillimi në botën e Berzahut dhe në botën e dukshme. Për shembull, besimi çon në pohimin se pushtetmbajtësi absolut, në mbretërinë e ekzistencës, në botët e panjohura dhe në botët e njohura, është vetëm i Vërteti, i Lartësuar dhe të gjitha qeniet e tjera nuk kanë as pushtetin më të ulët përveç atij pushteti hije të lejuar. Ky besim çon në shumë plotësime shpirtërore e morale njerëzore të lavdëruara, siç janë mbështetja te Allahu i Lartësuar, mendimi i mirë për të Vërtetin Fuqiplotë dhe zhveshja prej dëshirës për gjërat që janë te krijesat. Të gjitha këto cilësi numërohen si “nëna” e plotësimeve, që çojnë në lloje të ndryshme punësh të mira, çojnë në praktikat e bujarisë dhe në heqjen dore prej shumë punëve të këqija.

Kështu qëndron puna me të gjitha dituritë dhe, sikur ne të duan t'i numërojmë ato e të shpjegojmë ndikimet e tyre një e nga një, fjala jonë do të zgjatej shumë, prandaj po e shkurtoj këtë punë,



duke përmendur vetëm një libër të madh, të pavarur, i shkruar prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe me shpirta të pastër, të afruarit tek Allahu i Lartësuar. Kurse ne, “dorën e kemi të shkurtër dhe hurma është në majën e pemës”.<sup>1</sup>

Megjithëkëtë s’ka asnjë problem, nëse i shikojmë disa prej këtyre punëve. Për shembull, morali i Imam Rizait është prej moraleve të plotësuara njerëzore, prandaj ai ka ndikime të shumta në pastrimin e në shkëlqimin e shpirtit. Ky moral bën që zemra të jetë pasqyrë e shkëlqimeve të veçanta hyjnore. Gjithashtu, ky moral, me besimin (imanin), lartësohet në besimin e plotësuar (el-ijànul-kàmil), që është siguria e zemrës (et’umànijneh). Pastaj, me sigurinë lartësohet në plotësimin e saj, që është shikimi me sy (el mushàhedeh). Me shikimin me sy lartësohet në plotësimin e tij, që është dashuria (el muàshekah). Me dashurinë lartësohet në plotësimin e saj, që është qëndrimi me Allahun (el muràvedeh). Me qëndrimin me Allahun lartësohet me plotësimin e saj, që është vijueshmëria (el muvàsaleh) dhe... kështu, o i shtrenjti im, deri atje sa nuk na shkon mendja, as mua e as ty.

Veç kësaj, morali i Imam Rizait ka ndikime të fshehta në mbretërinë e trupit dhe në shenjat e punëve të dukshme, të cilat përfaqësojnë degët e gjethet. Ky moral e bën hyjnor veshin e syrin dhe të gjitha gjymtyrët. Gjithashtu, ndihmon në zbulimin e një ane prej sekretit: “Unë jam veshi, me të cilin ai dëgjon dhe syri, me të cilin ai shikon”.<sup>2</sup>

Këto gradë të brendshme kanë ndikime, madje kanë shumë ndikime mbi të jashtmen dhe gjendja qartësohet, kur ne marrim të

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e shkurtuar e një vargu në gjuhën perse e poetit Hafiz Shirazi.

<sup>2</sup> Lexo shënimin 1, faqe 25.





kundërtën e punës. Atëherë do të shikojmë se forma e jashtme dhe çdo gjë ka lidhje me formën e jashtme, përfshirë lëvizjet e gjendjet e qetësisë, gjendjet e zakonshme e të jashtëzakonshme, të gjitha punët e të gjitha gjendjet e heqjes dorë prej gjynaheve. Të gjitha këto kanë një ndikim shumë të çuditshëm. Disa herë ndodh që edhe një shikim i vetëm përçmues i rrugëtarit në udhën e Allahut, që ai e hedh mbi ndonjërin prej robëve të Allahut, mjafton ta rrëzojë atë prej majës së lartësisë në honin më të thellë dhe pastaj ai s'ka mundësi të kthehet në gjendjen e tij të parë, qoftë edhe pas shumë e shumë vitesh vazhdimi me këmbëngulje të ushtrimeve shpirtërore.

Zemrat tona janë të dobëta e të hutuara, aq sa lëkunden si gjethet e plepit edhe nga era më e lehtë që mund të fryjë; zemrat tona e humbin vendosmërinë shumë shpejt, prandaj detyra jonë është që të kujdesemi e ta ruajmë gjendjen e zemrës, edhe në punët e zakonshme, siç është për shembull çështja e rrobave që veshim. Duhet të shtojmë këtu se kurthet e pritat që vë vetja jonë e shejtani, kanë një ndikim aq të madh e janë aq të errëta, sa i tejkalojnë fuqitë e mundësitë tona. Prandaj, detyra jonë është të ngrihemi me të gjitha mundësitë që kemi dhe menjëherë të ballafaqohemi me këto kurthe e prita, patjetër, duke iu lutur të Vërtetit, të na japë mbarësi e përkrahje në të gjitha gjendjet.

Është e qartë se në mes të jashtmes e të brendshmes ka ndikim të ndërsjellë dhe, bazuar mbi këtë fakt, njeriu kërkues i të Vërtetit që nxiton për lartësimin moral ka detyrë të bëjë kujdes të madh në zgjedhjen e veshjes e të formës së veshjes; sepse veshjet mund të kenë ndikime negative mbi shpirtin, madje aq ndikim sa e nxjerrin zemrën prej qëndrimit të drejtë; veç kësaj, veshjet kanë



ndikime të atilla që mund të sjellin deri shkujdesjen ndaj të Vërtetit të Lartësuar dhe orientimet e shpirtit i bëjnë orientime për këtë botë.

Askujt të mos i shkojë në mendje se ngasjet e shejtanit e miklimet e shpirtit urdhërues për të keqen reduktohen vetëm në veshjen e rrobave luksoze, rroba të kushtueshme e të bukura apo në rrobat e stolisura me zbukurime, pasi njeriu ndodh që disa herë mund të rrëzohet, edhe kur është veshur me rroba jo të mira e pa ndonjë vlerë.

Gjithsesi, duhet bërë kujdes nga veshjet luksoze, madje duhet të tregohet kujdes deri edhe në paraqitjen me rroba, që janë në kundërshtim me traditën e me moralin e qytetëruar, prandaj të heqim dorë nga veshjet firmato, të punuara me tekstile të kushtueshme, të mos veshim rroba të atilla që tërheqin shikimin e të tjerëve dhe personin që e ka veshur një rrobë të këtillë e bëjnë të dallohet nga të tjerët. Zemrat tona janë shumë të dobëta dhe lëkundën e devijojnë nga rruga e maturisë, edhe për privilegjin më të vogël, ose edhe nga mania për t'u dukur. Sa shumë shikime urryese, mendjemadhësie e përçmuese hedh njeriu i pafuqishëm mbi robtë e Allahut, megjithëse vetë nuk ka as gradën më të ulët të lartësisë njerëzore e të dinjitetit personal, pa folur për plotësimin njerëzor të tij dhe, e gjitha kjo, vetëm e vetëm, se ka veshur një rrobë apo edhe dy apo tri rroba të mëndafshta, ose ka veshur një rrobë të punuar prej leshi sipas traditave të të huajve, apo ka veshur rroba të zbukuruara me qëndisma dhe mendon se me rrobat që ka veshur, ka arritur disa praktika. Në të vërtetë, ato rroba atij ia kanë bërë shumë të ngushtë fushën e dinjitetit e të nderimit.

Por gjendja bëhet më e rëndë, kur shpirti dobësohet, kur horizonti ngushtohet dhe kur vullneti humb. Në këtë gjendje, njeriu



pandeh se ndjekja e modës dhe veshja e rrobave luksoze do të bëhen shkak që për atë të shtohen konsideratat dhe do të lartësohet në pozitë!

O njeri, ti je vetëm një krijesë e pafuqishme e mendjelehtë.

Ti duhet të jesh krenaria e botës së ekzistencës, duhet të jesh esenca e gjithësisë dhe e vendit. Ti, o bir i Ademit, duhet të jesh mësues i emrave e i cilësive, ti që je biri i zbatuesit të pushtetit të Allahut në tokë dhe ke detyrë të jesh prej argumenteve të shkëlqyera! Të gjitha këto: “Të ftojnë ty të jesh në mbledhjen e Arshit...”<sup>1</sup>

Sa i keq e sa i prapambetur që je, o njeri! Ke rrëmbyer një grusht cilësish kafshërore dhe veshjet e kafshëve, pastaj me to krenohesh, në një kohë, kur duhet të krenohet krimbi i mëndafshit, delja, deveja, ketri e dhelpra. Përse kapardisesh me rrobat e të tjerëve?! Përse tregohesh mendjemadh e mbahesh shumë lart, me atë çka është krenari për të tjerët?!

Sido që të jetë, dije se te njerëzit ndikon deri edhe materiali me të cilin është punuar veshja, cilësia e veshjes e çmimi i lartë i rrobave, por mos harro se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kush vesh rroba luksoze, ai patjetër do të tregojë mendjemadhësi. Por mendjemadhësia, patjetër është në Zjarr”.<sup>2</sup> Te shpirti i të tjerëve ndikojnë edhe qëndisja e mënyra e qepjes së rrobave, madje ndodh që prej rrobave të kushtueshme të dalë në shesh fanatizmi i kohës së injorancës para Islamit. Gjithashtu, kur

<sup>1</sup> Përmbajtja e një pjese të një vjershe të poetit Hafiz Shirazi.

<sup>2</sup> “Mustedreku-Vesàili”, Libri “Es’salàtu” - “Namazi”, K. 16 -“ Dispozitat e veshjeve”, Hadithi 5.



njeriu vesh rroba të ngjashme me rrobat e të huajve, mund të ndodhë që rrobat që ai ka veshur, e bëjnë atë të largohet me vrap e të ketë neveri ndaj atyre që i do Allahu e i Dërguari i Tij, sepse ai ndien dashuri për armiqtë e tyre. Në hadithin e ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë se Allahu i Lartësuar i shpalli njërit prej profetëve të Tij: ***“U thuaj besimtarëve: ‘Mos vishni rrobat e armiqve të Mi, mos hani si armiqtë e Mi dhe mos ecni si armiqtë e Mi! Ndryshe, edhe ju do të jini armiqtë e Mi, ashtu siç janë ata armiqtë e Mi’”***.<sup>1</sup>

Ashtu siç ndikojnë në shpirt rrobat luksoze që vishen, me qëllim për të fituar famë, po kështu ndikojnë edhe rrobat e vjetra e rrobat e grisura, qoftë për shkak të materialit me të cilin janë punuar, qoftë nga ana e cilësisë, qoftë për qëndisjet e nga forma që ato rroba kanë, madje ndikimet shkatërruese që kanë këto lloje rrobash jo serioze do të jenë disafish më shumë nga ndikimi që lënë rrobat luksoze. Kjo vjen për shkak të kurtheve të ngritura nga vetja e njeriut. Më sipër kemi thënë se ky ndikim është shumë kompleks e tepër i errët. Njeriu, sapo të vërejë se dallohet, ngaqë është veshur me rroba të punuara trashë, prej atyre që janë veshur me rroba të punuara me finesë, me hijeshi, patjetër që nuk do të ketë kujdesin, që të shikojë të metat e vetes, pikërisht për shkak të dëshirës së madhe që ka për veshjet e bukura. Por ai, këtë dëshirë të vetes, e shikon si të dorës së dytë, që nuk mund të plotësohet pa një etikë të veçantë, që ato veshje të jenë shkak për krenari e për rrjedhojë, ai mund të preket nga mahnitja me veten dhe të sillet me mendjemadhësi ndaj robëve të Allahut, madje mund t’i konsiderojë të tjerët se janë larg sheshit të pastër të të Vërtetit, kurse veten e

---

<sup>1</sup> “El Xhevähiru-S’ senij’jetu”, K. “Ebù Abdullah bin Muhamed Es Sàdik”, Hadithi 60.



numëron ndër të afruarit dhe prej robëve më të sinqertë të Allahut. Ka shumë mundësi, që ai të jetë vënë në provë me këtë mendjemadhësi për shkak të hipokrizisë dhe për shkak të ligësive të tjera të mëdha. Ishte i varfër, por ishte i kënaqur me rrobat e trasha e të vjetra që vishte, por ishte i shkujdesur ndaj të gjitha gradave të njohjes, të devotshmërisë, të plotësimeve shpirtërore dhe prej mijëra mangësish e të metash të përfaqësuar në vragat që kanë lënë mbi trupin e tij rrobat e ashpra. Por ato rroba lanë mbi të rrezikun më të madh, rrezikun se ai e konsideron veten prej robëve të Allahut dhe, nga ana tjetër, e minimizon punën e robëve të Allahut e ka neveri ndaj tyre. Në këtë gjendje, ai është prej ndihmësve e prej miqve të shejtanit.

Ja kështu ndodh që rrobat luksoze e vënë njeriun para sprovash shumë shkatërruese. E njëjta gjë ndodh edhe me atë që vesh rroba të thjeshta, por mendon se rrobat që ai vesh, e bëjnë atë të dallohet për maturi e për devotshmëri.

Në përgjithësi, rrobat që vishen për të fituar famë, në raste teprimi e minimizimi, janë prej faktorëve që shkaktojnë lëkundjen e zemrave të dobëta dhe i largojnë ato prej moraleve të nderuara. Rrobat që vesh njeriu, mund të bëhen prej elementeve që sjellin vetëpëlqimin, hipokrizinë, mendjemadhësinë e krenarinë, por çdo njëra prej këtyre punëve numërohet si nëna e të gjitha poshtërsive shpirtërore dhe bëhet shkak kryesor për të kërkuar strehim në këtë botë dhe për t'u lidhur me këtë botë e për të qenë i varur prej saj, por lidhja me këtë botë e varësia prej saj, është kryet e çdo gabimi dhe burimi i çdo ligësie e i çdo pune të keqe.

Shumë prej këtyre punëve tregohen në hadithet e nderuara, prej të cilave do të sjellim vetëm disa:



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “...kush vesh rroba për të fituar famë në këtë botë, në Botën Tjetër Allahu do t’i veshë atij rrobën e poshtërimet...”<sup>1</sup>

Imam Sadiku ka thënë: “Allahu e urren rendjen pas famës.<sup>2</sup> E mira dhe e keqja e rendjes pas famës janë në zjarr.<sup>3</sup> Allahu i urren dy famat: famën e arritur me veshjet dhe famën e arritur me namazin”.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm, K. 8, Hadithi 1.

<sup>2</sup> “Vesàilu-Sh’shij’atî”, Libri “Es’salàtu” – “Namazi”. K. “Dispozita e veshjes”. K. 12, Hadithi 1.

<sup>3</sup> Burimi i mësipërm, Hadithi 3.

<sup>4</sup> Burimi i mësipërm, K. 8, Hadithi 2.



## Pozita e dytë

# ETIKA E VESHJES SË ATIJ QË FAL NAMAZ

## Kapitulli parë

### SEKRETI I PASTËRTISË SË VESHJES

Dije se namazi është rruga e ngjitjes lart për në pozitën e afrimit dhe të pranisë në vendmbledhjen e gëzimit, prandaj rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të ruajë etikën e paraqitjes në praninë e pastër të Mbretit të mbretërve. Kur njeriu paraqitet pranë të Vërtetit, të Pastrit, me gradët e ndryshme të pranisë dhe me të gjitha nivelet e saj të dukshme, duke filluar nga grada më e ulët, e cila është korja e koreve të jashtme të trupit e të mbretërisë së përfytyrimit dhe lartësohet deri në gradat më të larta, në pozitat e në të vërtetat më të larta të pranisë. Kjo pozitë është dhe sekreti i zemrës. Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë që në këtë afri, të jenë të pranishme të gjitha ushtritë e jashtme e të brendshme të mbretërive të tij të padukshme e të dukshme dhe t'i ekspozojë ato para të Vërtetit Fuqiptotë. Gjithashtu, në këtë afri të pastër, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të shpalosë të gjitha detyrimet që atij ia ka bërë detyrim



mëshira e Qenies së Pastër dhe që atij i jep mirësi dora e fuqisë së të Bukurit, Madhështorit. Kjo fuqi vjen vetëm nëpërmjet pastrimit të plotë, deri sa në atë zemër të mos ketë pushtet asnjëra prej qenieve. Kjo është fuqia e plotësimit të detyrimeve, që i janë vënë prej dhembshurisë së të Vërtetit të Lartësuar.

Vetëm me një mendim të thjeshtë, bëhet e qartë se edukata e paraqitjes, në praninë e pastër, është para rreziqeve të shumta, të cilat rrugëtari në udhën Allahut nuk duhet t'i lërë jashtë vëmendjes, qoftë edhe për një çast të vetëm, prandaj, si rregull bazë, për atë, mbetet që ai ta veshë trupin me rroba të pastra, madje patjetër duhet të mbulojë edhe koren e koreve, që veshin trupin e tij. Këto rroba të pastra, të jashtme, ai duhet t'i bëjë mbulesë për mbretërinë e jashtme të trupit, por edhe trupi, nga ana e tij, formon një mbulesë për trupin e botës së Berzahut, i cili, faktikisht, ekziston i mbuluar nga mbulesa e trupit në këtë botë. Edhe trupi i kësaj bote është mbulesë për trupin e botës së Berzahut, kurse ky i fundit është mbulesë për shpirtin dhe rroba e shpirtit formon një mbulesë për shpirtin dhe pastaj shpirti, nga ana e tij, është mbulesë për zemrën, por edhe zemra është mbulesë për shpirtin. Kështu vijon kjo mëshirë e fshehtë, deri sa arrin në disa prej gradave të tjera, por edhe çdo gradë e ulët është mbulim për një gradë më të lartë, të cilat janë gradat që shkëlqejnë vetëm te personat më të pastër, të emërtuar me epitetin “njerëz të Allahut” (ehlu-ll’läh), kurse të tjerët janë të privuar prej këtij shkëlqimi.

Megjithëkëtë, të gjithë kanë pak pjesë në këtë shkëlqim të madh. Në vijim do të tregojmë dhe do të flasim vetëm për disa nga pjesët që ata kanë të përbashkët prej këtij shkëlqimi.





Mëso se namazi klishe nuk mund të realizohet pa pastrimin e rrobave e të trupit. Po kështu edhe papastërtitë, që janë ndyrësi të shejtanit, i dëbuar prej rrethit të mëshirës, janë pengesë për të shkuar pranë të Pastrit. Edhe vetë falësi i namazit është i penguar për të qenë pranë të Pastrit, për shkak të mangësive që ka lënë pa plotësuar, prandaj ai patjetër është i ndaluar të hyjë në pozitën e kënaqësisë, kur rrobat dhe trupi i tij janë të ndotura me ndyrësitë e shejtanit; gjithashtu, atë e pengon edhe ndyrësia e fajeve, edhe e gjynaheve, të cilat janë shfaqje të pushtetit të shejtanit të lig dhe shfaqje e ndyrësive të tij, të cilat, patjetër, që numërohen ndalues për të hyrë pranë të Pastrit. Ai që është veshur me gjynahe, patjetër që e ka të ndotur me llumin e gjynaheve edhe mbulesën e trupit të tij të botës së Berzahut, por pa pastrimin e kësaj rrobe, ai kurrë nuk do të ketë mundësi të shkojë pranë të Pastrit, të Vërtetit, kur dihet se çështja e pastërtisë numërohet prej kushteve me të cilat realizohet namazi i brendshëm dhe ai namaz konsiderohet i vlefshëm.

Por njeriu s'ka dijani as për këtë trup të padukshëm, as për papastërtinë e rrobave të këtij trupi të padukshëm e as për llojin e papastërtive që e prekin këtë trup të padukshëm. Për aq kohë sa njeriu vazhdon të jetë në mbulesën e kësaj bote, tek ai s'ka dijani as për pastërtinë e këtij trupi e as për pengesën që sjellin këto papastërti për të shkuar pranë të Pastrit. Por, kur vjen dita e daljes prej kësaj mbulese, Dita e Kiametit, dita kur pushteti i të brendshmes e ka palosur qilimin e ndarjes me të jashtmen, atë ditë shkëlqen dielli i të vërtetës dhe i shpërndan retë e errëta të mbulesës së kësaj bote, në atë ditë do të hapet syri i mbretërisë së brendshme e do të mbyllet syri i mbretërisë së kafshërores, atëherë njeriu, me syrin vëzhgues të zemrës, do të kuptojë se namazi që ai ka falur deri



në fundin e jetës së tij, ishte pa pastrim dhe se ai vetë ishte i rrethuar nga mijëra ndalues të atillë, sa edhe vetëm njëri prej atyre ndaluesve do të mjaftonte për ta larguar atë prej të Pastrit. Pikërisht ata ndalues, në kohën e vet, do ta çojnë atë në mijëra dëshpërime, ditën kur s'ka asnjë dredhi e asnjë rrugë për të përmirësuar punët që kanë mbetur pa u plotësuar e për të rregulluar e për të drejtuar atë që është thyer. Në atë ditë nuk do të ketë asgjë tjetër përveç dëshpërimeve që s'mbarojnë. Ajo është dita, në të cilën do të rrafshohen të gjitha ndjenjat e pendimit: *“وَأَلْدِرْهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ إِذْ فُضِيَ الْأَمْرُ...”* - *“Ue endhirhum jeumel-hasreti idh kudijel-emru...”* - **“dhe paralajmëroi ata për Ditën e dëshpërimit, kur të përfundojë puna (grykimit të tij)...”**<sup>1</sup>

Pasi është realizuar pastrimi i rrobave të brendshme, atëherë bëhet detyrim pastrimi i vetë mbretërisë së trupit prej ndyrësisë së shejtanit. Ky pastrim arrihet me pastrimin e trupit prej ndyrësive të moraleve të ulëta, të atilla që do të mjaftonte vetëm njëra prej atyre ndyrësive për të ndotur të brendshmen e për të larguar njeriun nga prania e të Pastrit, të Vërtetit e prej sheshit të afrimit. Patjetër ky largim vjen për shkak të ndyrësisë së shejtanit të dëbuar prej mëshirës. Në origjinë, i larguari prej sheshit të afrimit te i Vërteti e ka bërë zakon të mahnitet me veten e të ketë dashuri të madhe për veten e vet, të ketë dashuri për këtë botë, të krekoset, të tregojë mendjemadhësi dhe të mundohet që t'u imponojë të tjerëve mendimin e tij. Është e qartë se çdo njëri prej këtyre veseve të përçmuara është një burim për shumë gjynahe të ulëta dhe për shumë gabime.

---

<sup>1</sup> Sure “Merjem”, ajeti 39.



Kur rrugëtari në udhën e Allahut e ka përfunduar këtë pastrim, në të vërtetë, ai ka pastruar rrobën e devotshmërisë me ujin e pendimit të sinqertë dhe me ushtrime shpirtërore të veçanta, por ky pastrim e detyron atë të merret me pastrimin e zemrës, të merret me mbulimin e saj të vërtetë, sepse mbi zemrën përplasen furishëm valët e pushtetit të shejtanit, i cili i vë në lëvizje ndyrësitë e veta, që me ato të ndotë të gjitha veshjet e të gjitha mbulesat. Nuk mund të realizohen të gjitha pastrimet, deri sa zemra nuk është pastruar, por edhe për pastrimin e zemrës ka disa gradë, disa prej të cilave do t'i përmendim këtu, me aq sa është në përshtatje me studimin tonë.

Njëra prej gradëve të pastrimit të zemrës, është pastrimi i saj nga dashuria për këtë botë, që numërohet kryet e çdo gabimi e vendalja e të gjitha degjenerimeve. Për aq kohë sa këto punë të këqija do të vazhdojnë në jenë në zemrën e njeriut, ato e pengojnë paraqitjen e tij pranë të Pastrit, të Vërtetit; gjithashtu, ato pengojnë edhe realizimin e dashurisë hyjnore. Kjo e fundit është “nëna” e të gjitha pastrimeve, pastrime që kurrë nuk mund të realizohen, kur kjo ndyrësi gjendet në zemër. Është e qartë se kujdesi me përparësi që shpreh Libri Famëlartë i Allahut, si dhe porositë e profetëve e të euiljave, përfshirë edhe porositë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), për të hequr dorë prej kësaj bote, për të qenë i përkorë në këtë botë dhe për t'u ruajtur prej kësaj bote, janë prej punëve që përfaqësojnë të vërtetën e devotshmërisë (takvâ). Këtij kujdesi nuk i gjendet një i ngjashëm, në lidhje me ndonjë punë tjetër.

Kjo gradë e pastrimit realizohet vetëm me dituri dobisjellëse, me ushtrime zemre të vendosura, me kujdesin e përhershëm për të menduar, në lidhje me fillimin e krijimit dhe me kthimin në Botën



Tjetër dhe duke e bërë që rrahjet e zemrës të mësojnë mësimet që nxirren prej zhdukjes e prej shkatërrimit së kësaj bote, si dhe duke menduar në punët e jashtëzakonshme të botëve të panjohura e në lumturinë në ato botë: “Allahu e mëshiroftë burimin që e di nga erdhi! Ku është? Dhe ku do të shkojë”.<sup>1</sup>

Gradë tjetër e pastrimit është pastrimi i zemrës prej sigurisë ndaj njerëzve e ndaj atyre që kanë njerëzit. Kjo siguri në zemër është idhujtari (shirk), madje te ata që kanë arritur gradën e njohjes (marifetit) është idhujtari e mirëfilltë.

Ky pastrim realizohet me besimin konkret në të Vërtetin e Lartësuar, se Ai është Zoti Një e i Vetëm (et’teuhijdul-fiëlij). Gjithashtu, ky besim numërohet burimi i të gjitha pastrimeve të zemrës. Këtu nuk është e panjohur se vetëm dituria deduktive dhe spektri i mendimit nuk e realizojnë dot rezultatin e shpresuar, në lidhje me besimin konkret se Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Më sipër kemi shpjeguar se meraku vetëm për dituritë argumentuese, disa herë mund të bëhet shkak për errësimin e për turbullimin e zemrës, por kjo errësimë e turbullirë i pret njeriut rrugën për të arritur qëllimin e tij më të lartë, prandaj kanë thënë: “Dituria është mbulesa më e trashë”.

Unë besoj se të gjitha dituritë janë praktike, madje edhe ditura në fushën e teologjisë (ilmu-t’teuhijd), e cila mësohet që është dituri praktike nga vetë fjala “teuhid”, e cila, sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe, është në masën “tef’ijl”, që është rrënjë e foljes katërshkronjëshe, e shtuar mbi foljen bazë trishkronjëshe, në kuptimin “aktivizon”. Bazuar mbi këtë shpjegim, fjala “teuhid”

---

<sup>1</sup> Esh’ shijràzij Sadru-D’ dij, “Mefâtijhul-Gajbi”, f. 50.



tregon prirjen e shumicës ndaj Njëshit dhe zhdukjen e anëve të shumicës në vetë shumësin. Këtë kuptim nuk e vërteton argumenti, por ai arrihet në saje të ushtrimeve shpirtërore dhe orientimit instinktiv ndaj Mbretit të zemrave, njëkohësisht edhe në saje të informimit të zemrës me ato që nuk i vërteton argumenti, me qëllimin që të kuptohet e vërteta e “teuhidit”, që të shpjegohet qartë e vërteta e besimit se i Vërteti është Zoti një e i Vetëm.

Po, argumenti vërteton për ne se “s’ka ndikues tjetër në gjithësi përveç Allahut”<sup>1</sup> dhe që është njëri prej kuptimeve të

“لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ” – “lailàhe il’lell’lilàh” – “S’ka zot tjetër përveç Allahut!”. Prandaj, duke u mbështetur mbi këtë argument, ne e përjashtojmë shtrirjen e dorës së pushtetit të qenieve në sheshin e madhësisë së ekzistencës dhe ia atashojmë të gjitha cilësitë dhe pronësinë mbi të gjitha botët Zotëruesit të tyre Absolut. Me këtë del qartë e vërteta e kuptimit të ajetit: “وَاللهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ” – “*Ue lehù mà fis’semàuàti uel-erdi...*” – “**Vetëm e Atij është çka në qiej e në tokë....**”<sup>2</sup> dhe “يَبْدُوهُ مَلَكُوتٌ” – “...bijedihi melekùtu kul’li shej’in...” – “...në dorën e Tij është pushteti mbi të gjitha sendet...”<sup>3</sup> dhe

“وَفِي الْأَرْضِ إِلَهًا لَهُ هُوَ الَّذِي فِي السَّمَاءِ” – “*Ue huve-l’ledhij fis’semài ilàhun, ue fil-erdi ilàhun...*” – “**Vetëm Ai është në qiell i Adhuruar dhe në tokë i Adhuruar...**”<sup>4</sup>

<sup>1</sup>Kjo shprehje i adresohet dijetarëve të mëdhenj në fushën e teologjisë; lexo parathënien e librit “Esràrul-Hukmi” të autorit Mirzà Ebù Hasen Esh’shaërànij, f. 32.

<sup>2</sup> Sure “En Nahl”, ajeti 52.

<sup>3</sup> Sure “Jà Sin”, ajeti 83.

<sup>4</sup> Sure “Ez Zukhruf”, ajeti 84.



Por, përderisa kjo punë e argumentit nuk ka arritur në zemër dhe, përderisa kjo punë nuk është bërë një figurë e brendshme për zemrën, kjo do të thotë se ne akoma nuk e kemi braktisur kufirin e diturisë, për të kaluar në kufirin e besimit (imanit). Gjithashtu, tregon se ne nuk kemi përfituar asgjë me dritën e besimit, në një kohë, kur kjo dritë, patjetër duhet të ndriçojë të gjitha cilësitë e brendshme e të jashtme.

Dhe ja, kështu ne shikojmë se, pavarësisht që kemi në dorë argumentin për këtë të vërtetë hyjnore, kaq e pastër e kaq e lartë, ne jemi mendjemëdhenj dhe, për rrjedhojë, jemi të shkujdesur ndaj “teuhidit”, ndaj besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, jemi të shkujdesur ndaj besimit, i cili përfaqëson beben e syrit për ata që quhen “ehlu-ll’illah” - “njerëz të Allahut”. Prandaj për ne nuk mbetet rrugë tjetër veç të përsërisim thënien: “S’ka ndikues në ekzistencë përveç Allahut!” Në këtë gjendje, ne shikojmë me syrin e dëshirës të shtrijmë dorën për të kërkuar drejt kujtdo që dhuron dhe ecën.

*“E nxehtë është këmba e argumentimit.*

*Këmba prej druri s’ka fuqi të arrijë qëllimin e lartë”.<sup>1</sup>*

Ky pastrim numërohet prej pozitave të larta të rrugëtarëve në udhën e Allahut, por pas këtyre pozitave vijnë pozita të tjera, të cilat janë mbi fuqinë tonë. Me dashjen e Allahut, brenda këtij studimi do ta shpalosim këtë çështje, me aq sa është në përshtatje me pozitën e studimit tonë.

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e një vjershe në gjuhën perse, e poetit Xhelaludin Rumi.



## KAPITULLI I DYTË

### LIDHJET E ZEMRËS ME MBULMIN E PJESËVE TË TRUPIT

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Shpirti i besimtarit është i lidhur me Allahun më shumë nga sa janë të lidhura rrezet e diellit me diellin*”.<sup>1</sup> Me argumente të fuqishme të diturive të larta është vërtetuar se në të gjithë rrethin e ekzistencës, duke filluar nga grada më e lartë e botës së fshehur dhe deri te pozita më e ulët e botës së dukshme, ka lidhje me të Përrjetshmin Absolut. Gjithashtu, ka lidhje me varfërinë e madhe tonën. Ajeti i nderuar i Kur’anit Famëlartë: “*الْعَبِيُّ الْحَمِيدُ وَاللَّهُ هُوَ أَعْيَا النَّاسِ أَنْتُمْ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ*” - “*Jà ej’juhe-n’ nâsu entumul-fukarâu ile-ll’lâhi uell’lâhu huvel-ganij’jul-hamijdu*” - **“O njerëz, ju keni nevojë për Allahun dhe Allahu s’ka nevojë për ju; vetëm Ai është i Falënderuari”**<sup>2</sup>, e thekson këtë lidhje e varësi. Sikur të ishte që për çdonjërin prej qenieve, në çdo gjendje e në çdo kohë, ose bazuar mbi ndonjërin prej vlerësimeve, ajo qenie të mos kishte një lidhje me madhësitinë e pastërtisë hyjnore, rrjedhimisht del jashtë rrethit të varfërisë e të mundësisë personale dhe hyn në sferën e mospasjes nevojë. Pikërisht nga ky deduksion vërtetohet se Qenia e Tij ekziston.

Por, që të shkëlqejë e vërteta dhe drita e besimit në zemrën e atij që e njeh Allahun dhe rrugëtarit në udhën e Allahut, duhet që

<sup>1</sup>“El-Usûlu min El-Kâfi”, vëll. 3 -, Libri “El-Imanu uelkufru”, K. “Vëllazëria e besimtarëve me njëri-tjetrit”, Hadithi 4, f. 242.

<sup>2</sup> Sure “Fâtir”, ajeti 15.



këto t'i ngrejë prej rrethit të logjikës e të argumentit dhe t'i çojë drejt zemrës. Pastaj këtë të vërtetë ta shkruajë në sipërfaqen e zemrës, me anën e ushtrimeve të zemrës dhe ta fusë brenda kufirit të njohjes. Zotëruesit e zemrave dhe njerëzit e Allahut e kanë vizatuar rrethin e besimit në rrethin e zbulimit, të shikimit e të dëshmisë, jo vetëm duke luftuar ashpër për të lartësuar Fjalën e Allahut, por edhe duke medituar me Allahun, për hir të dashurisë për Allahun.

Në librin "Misbàhu-Sh'sherij'ati", tregohet se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Dijetari është së bashku me njerëzit dhe zemra e tij është vetëm me Allahun. Sikur zemra e tij të ishte e shkujdesur ndaj Allahut, qoftë edhe sa një lëvizje e qerpikut, me siguri që ajo zemër do të vdiste nga dashuria për Allahun. Dijetari është besnik i gjërave që Allahu ia ka dhënë atij për t'i ruajtur, është thesar i sekreteve të Allahut, është mademi i dritës së Allahut dhe argumenti i mëshirës së Allahut ndaj krijesave të Tij, është mbartësi i diturive të Allahut, është peshorja e mirësisë dhe e drejtësisë së Allahut. Dijetari mund të mos ketë nevojë për njerëzit, pasi ai nuk e ka qëllim këtë botë, prandaj ai s'ka shoqërues tjetër përveç Allahut; s'ka fjalë, s'ka shenjë e s'ka frymëmarrje, përveçse me Allahun, për Allahun, prej Allahut dhe së bashku me Allahun".<sup>1</sup>

Kur rrugëtari në udhën e Allahut e shikon veten pranë të Vërtetit Fuqiplotë dhe e kupton se e brendshmja dhe e jashtmjja e tij, e fshehta dhe e dukshmja, është vetë prania afër të Pastrit, ai e kupton se këtë afri e ka realizuar për veten e tij, me të gjitha punët që ka bërë. Atëherë ai, shumë shpejt, do të mbulojë pjesët e trupit, të dukshme e të brendshme, që nuk lejohen të shihen. Këtë mbulim ai e bën vetëm nga kujdesi dhe edukata, që të jetë sa më i rregullt para të Vërtetit. Më pas, ai do ta kuptojë se zbulimi i pjesëve të

---

<sup>1</sup>"Misbàhu-Sh'sherij'ati", K. 95 - "Dituria".





brendshme, që nuk lejohen të shikohen në prani të të Vërtetit, është shumë më i rëndë e shumë më diskreditues se zbulimi i pjesëve të jashtme, që nuk lejohet të shikohen: “Allahu nuk shikon në figurën tuaj, por ai shikon në zemrat tuaja”.

Pjesët e brendshme, që nuk lejohen të shikohen, janë veset e ulëta dhe zakonet e këqija, janë gjendjet e këqija morale. Për shkak të këtyre cilësive të këqija, njeriu humb etikën dhe edukatën në sheshin e pastërtisë hyjnore. Kjo është grada e parë e grisjes së perdeve dhe e zbulimit të pjesëve, që nuk lejohen të shihen.

Kur njeriu nuk e mbulon veten me mbulesën e të Vërtetit Fuqplotë e me faljen e gjynaheve prej Tij dhe nuk kapet me “mbulesën” më të lartë e me “faljen e gjynaheve”, duke kërkuar faljen e gjynaheve e mbulimin, atëherë, pa dyshim se atij i janë grisur veshjet në praninë e engjëjve të afërm, të Profetëve dhe të Dërguarve (*Paqja e mëshira i Allahut qoftë mbi ta!*). Por, kur të ngrihet perdja e botës së cilësive dhe të zhduket perdja e kësaj bote, dije mirë se Allahu ka dijeni të plotë se atëherë, këtë rrobagrishur do ta ndjekë turpi e diskreditimi për shkak të pjesëve të jashtme të trupit, që atij i janë zbuluar, si dhe për shkak të zbulimit të pjesëve të brendshme, që nuk lejohen të shikohen.

I dashur, dëgjo me vëmendje! Mos i krahaso gjendjet e Botës Tjetër me gjendjet e kësaj bote. Kjo botë, edhe pse është kaq e gjerë, përsëri është e ngushtë për të përvetësuar qoftë vetëm njërën mirësi prej mirësive, që do të të jepen në Botën Tjetër. Po kështu, kjo botë nuk e përballon qoftë edhe një dënim të vetëm prej dënimeve të Botës Tjetër, që mund të bjerë mbi të. Madje kjo botë, me të gjitha gjerësitë e qiejve e të botëve të saj, nuk është e gjerë për të nxjerrë në shesh as edhe një perde të vetme prej perdeve të mbretërive të



ulëta. Kur edhe bota e varrit është vetëm njëra anë e atyre mbretërive, pa mendo si do të jenë mbretëritë më të larta në modelin e botës së Ditës së Kiametit.

Që të bëhet e qartë, o i dashuri im, ajo që ne synojmë, mendo pak në hadithin e cituar prej shehut, Dëshmorit të dytë (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) në librin “Min’jetul-Murijd” prej shoqes së tij më të madhe, Fatimes (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila në këtë hadith ka thënë: “Kam dëgjuar babain tim, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të thotë: ‘Atyre u vishen rroba prej veprave të jashtëzakonshme, sipas masës së diturive e sipas punës që kanë bërë për të orientuar robtë e Allahut. Madje, vetëm njërit prej tyre i vishen një milion rroba drite... Vetëm një fije prej atyre rrobave, është më e mirë se rrobat mbi të cilat ka lindur dielli një milion herë’<sup>1</sup>.”

Kjo është vetëm për disa çështje, që kanë lidhje me mirësitë.

Për sa u përket punëve që kanë lidhje me dënimin e me ndëshkimin, le të përfytyrojmë vetëm njërën anë prej kësaj lidhjeje dhe për këtë eja të mendojmë rreth hadithit të cituar prej El Fejd el Kashani (*Allahu e mëshiroftë!*). Këtë hadith ai e ka marrë prej të ndjerit Es Saduk, i cili ka transmetuar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) fjalët që Xhibrili i ka thënë të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “...sikur vetëm njëra verigë e zinxhirit me gjatësi shtatëdhjetë krahë të vihej mbi banorët e kësaj bote, me siguri që kjo botë do të shkrihej nga nxehtësia e asaj verige dhe, sikur vetëm një pikë nga lëngu i hidhur i pemës së zekumit të hidhej në

---

<sup>1</sup> “Munjetul-Murijd”, f. 24.



*ujin që pinë banorët e kësaj bote, të gjithë banorët e kësaj bote do të vdisnin prej erës së keqe të atij lëngu*".<sup>1</sup> Allahu na ruajt prej zemërimit të Tij!

Atëherë, për rrugëtarin në udhën e Allahut s'ka rrugë tjetër veçse të fillojë të ndërrojë vesevet e këqija, me cilësi të lavdëruara, të plotësuara dhe të nxitojë të pastrohet në detin e dallgëzuar, pa anë e pa fund, të cilësive të plotësuara të të Vërtetit Fuqiplotë. Gjithashtu, ai ka për detyrë të ndërrojë truallin e errët djallëzor të dashurisë për këtë botë me truallin e bardhë e të ndritshëm të prezencës së Pastër, pasi vetëm kështu do të arrijë të prekë në horizontet e vetes së tij kuptimin e ajetit të nderuar:

“وَأَشْرَقَتِ الْأَرْضُ بِنُورِ رَبِّهَا” - “*Ue eshrekatil-erdu binûri rab'bihà...*” - “**Dhe toka është e ndriçuar me dritën e Zotit të vet...**”<sup>2</sup> Atëherë, në mbretërinë e trupit të tij do të ndërtohen pozitat e bukurisë e të madhështisë së Qenies së Pastër dhe vetëm atëherë ai i bashkëngjitet Atij nën mbulojën e bukurisë e të madhështisë. Me këtë bashkëngjitje, ai realizon pajisjen me moralet e Allahut të Lartësuar dhe i lëshon perdet, që të mbulojë plotësisht cilësitë e këqija shpirtërore dhe errësitat e iluzioneve.

Kur rrugëtarin në udhën e Allahut arrin në këtë pozitë, përfshihet në butësitë e të të Vërtetit Fuqiplotë, që me butësinë e Tij të padukshme, e ndihmon atë dhe e vesh me rrobën e madhështisë së Tij, në atë mënyrë, sa që me këtë veshje, rrugëtarin në udhën e Allahut nuk e njih askush, përveç të Lartit, por edhe ai nuk njih

---

<sup>1</sup>“Ilmul-Jekijn”, vëll. 2, f. 1033.

<sup>2</sup> Sure “Ez Zumer”, ajeti 69.



askënd tjetër përveç të Lartit: “...miqtë e Mi janë nën kubenë Time dhe askush tjetër veç Meje nuk i njeh ata”.<sup>1</sup>

Vetëm dijetarët e mirëfilltë i kuptojnë shenjat e shumta që gjenden në Librin hyjnor Famëlartë, si për shembull fjalën e Allahut të Lartësuar: “اللَّهُ وَلِيُّ الَّذِينَ آمَنُوا يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ” - “All’lilàhu velij’ju-l’ledhijne àmenù jukhrixhuhum mine-dh’dhulumàti ile-n’nùr...” - “Allahu është kujdestari i atyre që besuan dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë...”<sup>2</sup> Ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe të mëparshmit e nderuar, e dinë se të gjitha cilësitë morale dhe shumicat e caktuara janë errësira. Gjithashtu, ata e dinë se drita absolute realizohet vetëm me zhdukjen e shtesave dhe me shkatërrimin e veseve të liga, të cilat përfaqësojnë idhujt në rrugën e rrugëtarit drejt Allahut. Vetëm kur të zhduken errësitat e shumta të punëve e të cilësive dhe vetëm kur ato të bëhen të venitura në syrin e të gjithëve, atëherë vendet e trupit, që nuk lejohen të shikohen, janë mbuluar me të vërtetë, vetëm atëherë është realizuar prania absolute dhe arritja e plotë. Kur ai që fal namaz, është i mbuluar në këtë pozitë, pa dyshim që është duke falur namazin e të Vërtetit dhe shpresohet që namazi, miraxhi i Vulës së të Dërguarve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte sipas këtij shembulli në disa pozita e në disa ngjitje. Por këtë, vetëm Allahu e di më mirë.

---

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 7.

<sup>2</sup> Sure “EIA’ràf”, ajeti 26.



## Vijim

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” citohet fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Rroba më e hijshme për besimtarin është rroba e devotshmërisë dhe mirësia më e madhe që i është dhënë atij, është besimi”. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: “وَلْيَأْسَأِ النَّفْسُ ذَلِكَ خَيْرٌ” – “...ue libàsut’ takvâ dhàlike khajrun...” – “...por rroba e devotshmërisë është më e mira...”<sup>1</sup>

Edhe rroba e jashtme është mirësi prej Allahut të Gjithëfuqishëm. Me rrobat që vesh njeriu, mbulon pjesët e trupit që nuk lejohen të shikohen dhe veshja e rrobave është respekti me të cilin Allahu i Lartësuar ka nderuar robtë e Tij – pasardhësit e Ademit. Madje me këtë respekt, Allahu i Lartësuar nuk i ka nderuar krijesat e tjera. Përveç kësaj, veshjet janë mjet me të cilin besimtarët kryejnë detyrimet, me të cilat janë ngarkuar prej Allahut Fuqiptotë.

Rroba më e mirë për ty është rroba që nuk të sjell asnjë lloj largimi prej Allahut Fuqiptotë, madje ajo rrobë është një rrugë për ty, që të falënderosh Allahun, ta kujtosh Atë dhe të jesh i nënshtruar ndaj urdhrimit të Tij; rroba që ti vesh të mos të bëjë, që të të pëlqejë vetja ose të bëhesh hipokrit, ose të krenohesh, që je veshur me rroba të stolisura apo nga mendjemadhësia ta lëshosh rrobën aq të gjatë, sa e tërheq zvarrë nëpër tokë. Të gjitha këto që u thanë, janë prej sëmundjeve të fesë dhe zemrën e bëjnë të ashpër.

Kur të veshësh rrobën, mbaje në mendje se Allahu i Lartësuar t’i ka mbuluar gjynahet me mëshirën e Tij, prandaj vishe

---

<sup>1</sup>Sure “A’raf”, ajeti 26.



të brendshmen tënde me rrobën e sinqeritetit, ashtu siç vesh me rroba të jashtmen tënde.

Le të jetë e brendshmjia jote në mbulesën hyjnore dhe e jashtmjia jote le të jetë në mbulesën e nënshtrimit. Kije parasysh mirësinë e Allahut të Gjithëfuqishëm, që Ai i krijoi shkaqet e veshjeve, që ti të mbulosh pjesët e jashtme të trupit, që nuk lejohen t'i shikojnë të tjerët, prandaj mbaje hapur portën e teubes dhe të mbështetjes te Allahu. Me këto dy të fundit, të mbulosh fajet e veset e këqija, pjesët e brendshme, që nuk duhet të shihen.

Mos diskredito asnjë njeri, sepse Allahu ty të mbulon punë edhe më të mëdha, por merru me të metat e tua, tregohu tolerant ndaj gjendjes së tjetrit, kur puna e tij nuk ka të bëjë me ty dhe bëj kujdes, të mos e kalosh jetën duke punuar për të tjerët. Mos bëj tregti me kapitalin tënd për tjetrin, sepse kështu do të shkatërrosh veten tënde. Në të gjitha gjendjet, harrimi i fajeve jo vetëm që sjell dënimin më të rëndë të Allahut të Lartësuar në këtë botë, por shton edhe shkaqet për dënim në Botën Tjetër.

Nëse merakuri i vetëm i robit është të jetë i nënshtruar e i bindur ndaj Allahut të Lartësuar, nëse robi merret me njohjen e mangësive të vetes dhe heq dorë nga çdo punë që e turpëron fenë, ai është i imunizuar prej sëmundjeve dhe është në mesin e mëshirës së Allahut të Gjithëfuqishëm, prandaj ai triumfon me diamantet e dobive të urtësisë e të shpjegimit. Por, nëse njeriu i harron fajet e veta, nëse nuk i njeh të metat që ka, nëse ai e kthen kryet kah ata që ka rreth vetes dhe mbështetet në fuqinë e vet, ai njeri kurrë nuk shpëton".<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>"Misbàhu-Sh'sherij'ati", K. 7 - "Veshja".



Pavarësisht se qëllimet e hadithit e shpjegojnë qartë çështjen deri në caqe shumë të largëta, por në saje të leximit e të mendimit, do të duket se disa pjesë të hadithit tregojnë diçka që është e ngjashme me hamendësimin, përsëri nuk është pa dobi në fushën e realizimit të pastrimit të zemrës.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Autori këtu sjell një përkthim të hadithit në gjuhën perse, duke i bashkëngjitur disa tregues shpjegues, që ne po i vëmë këtu, me qëllim që përfitimi të jetë i plotë: "...kur zgjedh materialin e rrobës dhe të qëndisjes së saj, ruhu nga shkujdesja ndaj të Vërtetit dhe largimit prej sheshit të pastër me këtë botë. Dije mirë se te veshjet, madje te të gjitha punët e jetës së zakonshme ka fjalë aq të holla, sa të bëjnë të jesh i shkujdesur ndaj të Vërtetit dhe të merakosesh vetëm për këtë botë. Ato fjalë të holla lënë gjurmë të këqija në zemër dhe çojnë që njeriu të vihet në sprovë me vetëpëlqimin, hipokrizinë, me përpjekjet për t'u zbukuruar dhe për t'u krekosur. Të gjitha këto janë sëmundje të zemrës, që çojnë në gjymtimin e zemrës...

...merakosu për të metat e vetes tënde, që para teje të hapen portat e përmirësimit...

...ruhu, që të mos e harxhosh jetën tënde në punë që nuk janë të tuat dhe t'i regjistros punët e tua në regjistrin e të tjerëve....

...harresa e fajeve të veta, numërohet prej ndëshkimeve më të ashpra, që i Vërteti i Gjithëfuqishëm i zbrit në këtë botë, por këto ndëshkime kanë lidhje me përmirësimin e vetvetes.



## Qëllimi i tretë

# EDUKATA E ZEMRËS, NË LIDHJE ME VENDIN E ATIJ QË FAL NAMAZ

## Ndarja e parë

### NJOHJA E VENDIT

Mëso se, sipas kërkesave të zhvillimeve të ekzistencës, rrugëtari në udhën e Allahut është në disa vende. Gjithashtu, mëso se, për çdonjërin prej këtyre vendeve, ka një edukatë të veçantë. Është detyrë që edukata e çdo vendi, të ruhet me kujdes, pasi rrugëtari në udhën e Allahut kurrë nuk triumfon me namazin e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, nëse ai nuk stoliset me këto edukata, që siç u tha, janë të veçanta për çdo vend.

Dhe, i pari prej atyre zhvillimeve është zhvillimi i natyrës e i pozitës së dukshme të kësaj bote. Vendi i këtij zhvillimi është toka e natyrës, për të cilën i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Për mua, toka është bërë vend për faljen e namazit dhe e pastër”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>“Vesàilu-Sh’shij’ati”, vëll. 3, Libri “Es’salātu” – “Namazi”, K. 1 - “Vendet mbi të cilat bëhet sexhde”, Hadithi 8, f. 593.





Edukatat, me të cilën duhet të stoliset rrugëtari në udhën e Allahut, konsistojnë në faktin se ai ka për detyrë t'i japë zemrës të kuptojë se zbritja prej zhvillimit të fshehtë dhe zbritja e njeriut prej vendit më të lartë në natyrën e ulët, si dhe kthimi i tij prej

“أحسن ثوبيم” - “*ehseni takuijmin*” - “**formës më të bukur**” në më të ulëtën e të ultëve, patjetër është për ta shtyrë njeriun, që të zgjedhë rrugëtimin e tij për tek Allahu, të zgjedhë ngjitjen në lartësitë e afrimit dhe të arritjes në oborrin e Allahut e të hyjë nën mbrojtjen e Zotit të botëve. Ky është qëllimi më i lartë i krijimit dhe synimi i njerëzve të Allahut: “Allahu e mëshiroftë atë që e di prej nga vjen, ku është dhe ku do të shkojë!”

Kur rrugëtari në udhën e Allahut e kupton se shtëpia e tij e natyrës është xhamia ku ai kryen adhurimin dhe se ai është brenda saj, patjetër ai duhet të pajiset me edukatat e domosdoshme për tokën e natyrës dhe të ketë kujdesin më të madh, që të mos përmendë ndonjë tjetër përveç të Vërtetit. Ai duhet të kujdeset vazhdimisht, që të mos e braktisë faltoren, në të cilën ai shpreh robërinë e tij ndaj të Vërtetit, kur e vë ballin në tokë, vetëkuptohet me përjashtim të ndonjë rasti të nevojshëm. Rrugëtari në udhën e Allahut, në xhaminë e tij të natyrës, nuk gëzohet me asnjë tjetër përveçse me Allahun dhe nuk e lidh zemrën e tij me ndonjë tjetër, ndryshe do të vepronte në kundërshtim me edukatat e qëndrimit në portën e Allahut. Kurse për njohësit e Allahut në këtë pozitë ka të atilla gjendje, sa edhe lapsi nuk i shpjegon dot.

Kur ti je jashtë cilësisë së pastër njerëzore, me të cilën je krijuar dhe je i zhytur në detin e errët e të egërsuar të natyrës, patjetër që je larg të Vërtetit, je larg të vërtetës dhe nuk je në asnjërin prej pozitave të rrugëtarëve në udhën e Allahut e të dijetarëve.



Patjetër duhet të nxitosh, që të mos e diskreditosh veten edhe më shumë në praninë e të Vërtetit të Gjithëfuqishëm dhe në praninë e të veçantëve të Tij. Gjithashtu, të kesh kujdes, që të mos e kapërcesh bisedën prej kësaj pozite dhe të parashtrosh ankesat e dala prej shpirtit urdhërues për të keqen në praninë e Pastër të Zotëruesit të madhësisë, sepse duhet të shpresosh që Allahu të të marrë për dore dhe, me butësinë e Tij përgjithësuese e me mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse, të të ndreqë ato që humbe gjatë asaj pjese të jetës që kalove, prandaj për këtë pjesë të jetës që të ka mbetur, do të lutesh me Fjalën e Tij të nderuar:

“رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ” - “...rab’benà dhalemna enfusenà ue in lem tegfir lenà ue terhamna lenekunen’ne minel-khàsirijne” - “...Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes sonë dhe, nëse Ti nuk na fal gjynahun e nuk na mëshiron, patjetër që jemi prej atyre që pësuan humbje”.<sup>1</sup>

Grada e dytë e zhvillimeve është grada e fuqive të jashtme e të brendshme, fuqi që përfaqësojnë ushtrinë e shpirtit të pasurisë e të cilësive, vendi i të cilave është toka, natyra e njeriut dhe strukturë është ky trup.

Edukatat, me të cilat rrugëtari në udhën e Allahut duhet të stoliset në këtë pozitë, kërkon që e brendshmja e zemrës së tij të kuptojë se toka e natyrës është xhamia ku ai i shpreh robërinë e tij Zotit të botëve dhe robërinë e tij ai e shpreh në tokë, e cila është xhamia e ushtrive të mëshirës gjithëpërfshirëse, prandaj ai s’duhet të lejojë ndotjen e kësaj xhamie as me ndyrësitë që shpërndan shejtani i lig dhe as me nënshtrimin ndaj ushtrive të pushtetit të

---

<sup>1</sup> Sure “El A’áf”, ajeti 23.



Iblisit, me qëllimin e lartë, që toka e natyrës të shkëlqejë me ditën e Zotit të botëve dhe në tokën e natyrës ai të dalë prej errësirës e prej turbullirës që e largojnë atë prej sheshit të Krijuesit.

Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut duhet të ketë parasysh fuqitë e tij lëndore e morale në xhaminë e trupit dhe të bashkëpunojë me trupin ashtu siç bashkëpunon me xhaminë, njëkohësisht ai vepron me këto fuqi, me të cilat është brenda në oborrin e Allahut.

Përgjegjësitë e rrugëtarit në udhën e Allahut, në këtë pozitë, janë të shumta dhe, në radhë të parë, pastrimi i xhamisë është detyrë e tij, përveç përgjegjësisë që ai ka për të ruajtur me kujdesin më të madh edukatën e atyre që janë në këtë xhami.

Për sa i përket zhvillimit të tretë, ky është zhvillimi i padukshëm i rrugëtarit në udhën e Allahut dhe vendi i këtij zhvillimi është trupi i padukshëm në botën e Berzahut, i cili bëhet i dukshëm si rezultat i ndërtimit moral të këtij shpirti.

Edukata, me të cilën duhet të stoliset rrugëtari në udhën e Allahut, në këtë pozitë, është që shpirti i tij të shijojë dallimin mes kësaj pozite e mes pozitave të tjera, por ruajtja e kësaj pozite është prej detyrave më të rëndësishme të rrugëtarit në udhën e Allahut dhe kjo për faktin se zemra, në këtë tokë, është imami i atyre që janë futur brenda në këtë xhami, për të bërë adhurim dhe, me prishjen e zemrës, prishen të gjithë: “Kur prishet dijetari, është prishur bota”.<sup>1</sup> Në këtë botë të vogël, zemra është dijetari dhe dijetari është zemra e kësaj bote të madhe.

Përgjegjësia e rrugëtarit në udhën e Allahut në këtë gradë është shumë më e rëndë se në dy gradat e mëparshme. Pikërisht në



këtë gradë, atij i ngarkohet edhe detyra e ndërtimit të xhamive. Allahu mos e lejoftë të ndodhë, që xhamia e ndërtuar prej tij, mund të jetë xhami “dirar”, xhami kufri e xhami përçarje në mesin e myslimanëve. Në një xhami të tillë nuk lejohet të kryhet adhurim për Allahun. Në të kundërt, është detyrë e prerë, që një xhami e tillë të shembet e të shkatërrohet plotësisht.

Kur rrugëtari në udhën e Allahut ndërton një xhami me cilësi hyjnore, ai është nën pushtetin e mëshirës gjithëpërfshirëse, me të cilën, për veten e tij, ai e ka pastruar këtë xhami prej ndyrësirave e prej të gjitha pushteteve të shejtanit, prandaj ai nxiton të hyjë brenda në këtë xhami. Në këtë gjendje, ai ka për detyrë të shpejtojë për të qëndruar brenda oborrit të Zotëruesit të xhamisë, në të cilën mund të futet vetëm atëherë kur e ka pastruar veten nga vetëpëlqimi dhe është çliruar prej prangave të “unit”. Në këtë gjendje, kjo xhami është bërë shtëpi për të Vërtetin, për Krijuesin e botëve. Në këtë xhami, ai do të lavdërojë të Vërtetin me shkëlqimet e punëve, pastaj me shkëlqimet e emrave dhe më pas me shkëlqimet e vetë Qenies së Allahut. Pikërisht ky është namazi i Zotit, kur thotë: “سُبْحٌ قُدُوسٌ، رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ” - “Sub’bùhun, Kud’dùsun, Rab’bul-melàiketi uerr’rrùh” - **“vetëm Allahu është pa asnjë të metë e s’ka asnjë nevojë, i Pastërti, Zoti i engjejve dhe i Ruhut”**.<sup>1</sup>

Në të gjitha këto grada, para rrugëtarit në udhën e Allahut qëndron një punë, ndaj të cilës ai kurrë nuk duhet të jetë i shkujdesur, pavarësisht nga gjendja që mund të jetë. Kjo punë përfaqëson qëllimin më të lartë të rrugëtimit dhe është kuintesenca

---

<sup>1</sup> “...Zoti yt lutet...” ai thotë: “Sub’bùhun, Kud’dùsun, Rab’bul-Melàiketi uerr’rrùh”; “El- Uslu min El-Kâfi”, vëll. 2 , Libri “ElHuxh’xhetu”, K. “Historia e jetës së Profetit Muhamed (s.a.v.s.), lindja dhe vdekja e tij”, Hadithi 13, f. 329.



e këtij rrugëtimi. Kjo punë kërkon që rrugëtari në udhën e Allahut t'i kërkojë vetes, se, pavarësisht nga të gjitha gjendjet e nga të gjitha pozitat që mund të kalojë, ai nuk mund t'i lejojë vetes të jetë i shkujdesur ndaj përmendjes së të Vërtetit. Ai duhet të nxitojë të mësojë dituritë, në lidhje me njohjen e Allahut, nëpërmjet të gjitha ritualeve e adhurimeve. Duhet të studiojë të Lartin, në të gjitha dukuritë. Atij, në asnjë rast, të mos ia zënë rrugën mirësitë e bujaritë e Allahut dhe ta ndalojnë atë për të medituar e për të qëndruar në vetmi me të Lartin Fuqplotë. Dije se ky rrugëtim është i ngadaltë dhe shkallë-shkallë.

Në përgjithësi, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të kuptojë se shpirti, e brendshmja e adhurimit dhe e ritualeve, është njohja e Allahut. Gjithashtu, ai ka për detyrë, që në fushën e njohjes së Allahut, të studiojë rreth të Dashurit të tij, pasi kështu shpresohet që në zemrën e tij të rrënjohet e të forcohet "lidhja e dashurisë me të Favorizuarin", për rrjedhojë atë e përfshijnë butësitë e pakufishme dhe tërheqjet sekrete.



## Vijim

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” lexojmë se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur të arrish në derën e xhamisë, dije se qëllimi yt ishte të trokisje në portën e Mbretit të Madh; dije se qilimin e asaj xhamie e shkelin vetëm ata që janë të pastër dhe në atë xhami nuk lejohet të ulet askush përveç të sinqertëve, prandaj ngrihu e shkel në qilimin e shërbimit të Mbretit madhështor. Por, nëse ti je i shkujdesur ndaj Tij, pa dyshim që je para një rreziku shumë të madh.

Dije mirë se me ty është i Fuqishmi për çdo gjë; për ty Ai dëshiron drejtësinë e mirësinë. Nëse Ai derdh butësinë e Tij mbi ty, këtë e bën me mëshirën e me bujarinë e Tij dhe, në saje të kësaj mëshire, Ai ta bën të lehtë bindjen, madje Ai, edhe për bindjen tënde kaq të pakët, të jep shpërblime të shumta.

Nëse Ai të kërkon të zbatosh drejtësinë, këtë drejtësi Ai e jep me sinqeritetin e drejtësinë tënde, por, kur Ai të ka mbuluar dhe nuk e ka pranuar bindjen Tënde, edhe sikur ajo të jetë me shumicë nga ana jote, atëherë dije se vetëm Ai vepron sipas asaj që ka qëllim.

Pohoje para Tij pamundësinë tënde, mangësitë e thyerjet e tua, varfërinë tënde. Në të vërtetë, ti je drejtuar për të bërë adhurim e për të qenë në shoqërinë e Tij, prandaj shpalosja Atij sekretet e tua, që të mësosh se asgjë prej punëve të fshehta e prej punëve që bëjnë sheshit krijesat e Tij, as edhe një punë e vetme e tyre nuk mbetet e panjohur për Të.

Para tij të jesh më nevojtari i robëve të Tij, zbraze zemrën tënde prej çdo merakut që të mbulon ty, që të mos e shohësh Zotin tënd, por dije mirë se Ai pranon vetëm prej atij që është më i pastër e më i sinqertë.



*Shiko se nga cili regjistër del emri yt. Nëse ti shijon ëmbëlsinë e bashkëbisedimit intim me Të, si dhe kënaqësinë e bashkëbisedimit të drejtpërdrejtë me Të, atëherë ti ke pirë me kupën e mëshirës e të bujarisë së Tij, për shkak se Ai është afruar te ti e i është përgjigjur thirrjes tënde dhe, për shkak se shërbimin ndaj Tij e ke kryer shumë mirë, Ai të futi ty në orbitën e lejimit e të sigurisë, ndryshe, ndalo ashtu siç ndalon ai që është shkëputur prej fuqisë, si ai që ka shpresa të pakta dhe si ai që i është sosur jeta.*

*Dituria për Allahun Fuqplotë në zemrën tënde, është sinqeriteti i strehimit tek Ai. Allahu të shikon ty me syrin e butësisë, të mëshirës e të dashamirësisë. Për ty, Ai sjell mbarësinë vetëm në punët që Ai do dhe është i kënaqur me ato punë. Ai është Bujari dhe e do bujarinë për robtë e Tij. Të gjithë ia kanë nevojën Allahun, prandaj vijnë të djegur në portën e Tij, për të kërkuar kënaqësinë e Tij”.*

Allahu i Lartësuar thotë: “أَمَّنْ يُجِيبُ الْفُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ” - “Em'men juxhijbul-mudtarr'rre idhà deàhu ue jekshifu-s'sùe...” - **“Ai i përgjigjet nevojtarit, kur ai e thërret dhe Ai ua largon të keqen...”**<sup>1</sup>

Këtë hadith të nderuar e sollëm të plotë, sepse është program gjithëpërfshirës për ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe për krerët e rrugëtarëve në udhën e Allahut. Me siguri, vetëm të menduarit me kujdes në këtë hadith, e bën rrugëtarin në udhën e Allahut të kuptojë gjendjen në të cilën ndodhet. Por në këtë gjendje, ai ka për detyrë të ndalojë, sapo të arrijë te porta e xhamisë dhe të pyesë veten: cilën prani arrite dhe cilën kishe qëllim? Ajo është prania e Mbretit të Madh, por në qilimin e afrimit tek Ai shkelin vetëm ata që janë të pastruar prej pastërtive të botës së natyrës dhe

<sup>1</sup> “Misbàhu-Sh'sherij'ati”, K. 12 - “Hyrja në xhami”; ajeti në fundin e hadithit është ajeti 62 i sures “En Neml”.



i kanë të pastra gjymtyrët e tyre prej ligësive të shejtanit. Edhe ulja në kuvendin e Tij lejohet vetëm për ata që ecin së bashku me Të, me të vërtetën, me sinqeritet e që janë pastruar plotësisht prej të gjitha llojeve të idhujtarisë, së dukshme e të padukshme.

Atëherë, o rrugëtar në udhën e Allahut, kur ke qëllim të hysh në vendin e Tij të pastër e të shkelësh mbi qilimin e miqësisë me Atë, shkruaje në llogarinë tënde madhështinë e vendqëndrimit dhe autoritetin e madhështinë e të fuqisë hyjnore, prandaj dije mirë, se ti, në të vërtetë, je para një rreziku të madh dhe “dije se muri i saj të çan kokën”.<sup>1</sup> Ti shkon me hapa të ngadalta pranë të Fuqishmit Absolut, i Cili bën në mbretërinë e Tij punët që Ai dëshiron. Mbaje parasysh se Ai të trajton ty me drejtësinë e Tij dhe të kërkon llogari deri në imtësi, dhe kërkon prej teje të vërtetën. Në këtë kohë, ti je i mbuluar prej pranisë së Tij. Por, gjithashtu, dije mirë se edhe bindja jote mund të përplasët në fytyrë, sado e madhe që të jetë.

Nëse Ai drejtohet kah ti, me butësinë e me dashamirësinë e Tij, dije se Ai të pranon, me mirësinë e me mëshirën e Vet. Gjithashtu, dije se, me mirësinë e Tij, Ai të jep shpërblime të shumta, edhe për atë pak bindjen tënde të thjeshtë.

Tani që u njohë me rrezikun e vendqëndrimit, menjëherë pohoje pamundësinë tënde, varfërinë tënde dhe mangësitë e tua. Kur të ngrihesh për të adhuruar Allahun, me synimin që të jesh në shoqërinë e Tij, detyra jote është ta zbrazësh zemrën prej merakeve për ndonjë tjetër, sepse ai tjetri të mbulon, që të mos e shohësh bukurinë e më të Bukurit. Mos harro se meraku për dikë tjetër është

---

<sup>1</sup> Përmbajtja e gjysmës së vargut të një vjershe, e poetit Hafiz Shirazi.





ndyrësi e idhujtari, por i Larti Fuqiplotë pranon vetëm zemrën e pastër e të sinqertë.

Pastaj, kur të gjesh në veten tënde ëmbëlsinë e meditimit me të Vërtetin dhe ti vetë e shijon kënaqësinë e përmendjes së Allahut, atëherë ti ke pirë me kupën e mëshirës e të bujarisë së Tij, në veten tënde ke prekur mirësinë e përgjigjes nga ana e Tij dhe afrimin e Tij te ti, prandaj dije se ti, me të vërtetë, je i përshtatshëm për të qenë në shërbimin e Tij të pastër dhe ke hyrë në orbitën e lejimit e të sigurisë.

Por, kur këto gjendje, mungojnë te ty, menjëherë ndalo para portës së mëshirës së Allahut, siç qëndron personi që i kanë zënë rrugët e i janë prerë fuqitë. Kur në punën tënde ka sinqeritet e pastërti, Ai të sheh ty me syrin e mëshirës e me syrin e butësisë dhe të ndihmon. Kur Ai është i kënaqur me punën tënde, sjell mbarësi për ty, sepse vetëm Ai është "Bujari dhe Ai e do bujarinë për robtë e Vet nevojtarë...".

Allahu i Lartësuar thotë: "أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاَهُ وَكَشِفُ السُّوءِ" - "Em'men juxhijbul-mudtarr'rre idhà deàhu ue jekshifu-s'sùe..." - "Ai i përgjigjet nevojtarit, kur ai e thërret dhe Ai ia largon të keqen..."



## Ndarja e dytë

### ETIKA E LEJIMIT TË VENDIT

Kur rrugëtari në udhën e Allahut i kupton gradat e vendit sipas pozitive të tij dhe zhvillimeve të ekzistencës, menjëherë për të bëhet detyrim të pajiset me edukatat e zemrës, të kërkuara në fushën e lejimit, që ai, me namazin e tij, të largohet prej pushtetit grabitës që ushtron Iblisi i lig mbi namazin.

Pikërisht për këtë shkak, në radhë të parë, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të stoliset me edukatat e robërisë, që shihen nga të tjerët, të qëndrojnë besnik në premtimet që i ka bërë vetes në të kaluarën, ditën e besëlidhjes, kur ishte në botën e grimcës dhe e largon dorën e pushtetit të Iblisit prej mbretërisë së trupit të vet e prej karakterit të tij, me synimin e lartë, që të ketë mundësi të arrijë gjendjen e dashurisë së Allahut, me synimin që pushteti i tij në botën e natyrës të mos jetë pushtet i rrëmbyer.

Disa estetistë, duke u bazuar te e brendshmja e ajetit:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ أَحَلَّتْ لَكُمْ بَيْعَتُكُمْ أَيْمَانُكُمْ” - “Ja ej’juhe-l’ledhijne àmenù eufù bil’ukùdi, uhil’let lekum behijmetul-en’âmi...” - **“O ju që keni besuar, mbajeni besën për premtimet dhe për ju janë lejuar kafshët shtëpiake”**,<sup>1</sup> thonë se kuptimi i tij është: lejimi i kafshëve shtëpiake qëndron mbi mbajtjen e besës për kujdestarinë e sundimin.

---

<sup>1</sup> Sure “El Mâide”, ajeti 1.



Në disa hadithe thuhet se e gjithë toka i takon imamit dhe të tjerët janë grabitës së tokës<sup>1</sup>. Edhe ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se pushtetmbajtësi është pronari i të gjitha mbretërive të ekzistencës dhe i të gjitha shkallëve të botës së panjohur e të botës që shihet me sy dhe, ngaqë ata bazohen mbi këtë shpjegim, nuk e konsiderojnë të lejuar veprimin me tokën, pa lejen e imamit.

Unë them: Meqenëse armiku i Allahut, Iblisi i mallkuar dhe, meqenëse të gjitha veprimet e tij, madje të gjitha veprimet e spektrit të Iblisit, janë lëvizëse e grabitëse në botën e natyrës, por, kur rrugëtari në udhën e Allahut e ka nxjerrë veten prej pushtetit të këtij të ligu dhe veprimet e tij i ka bërë veprime mëshire gjithëpërfshirëse, atëherë patjetër edhe veshjet, ushqimi që ai merr dhe martesat e tij, janë të lejuara e të mira. Nëse është e kundërta, të gjitha praktikatat e rrugëtarit në udhën e Allahut do ta mbajnë atë larg stolisjes me cilësitë e mira të lartpërmendura dhe do ta bëjnë të kërkojë idhujtarinë djallëzore, me të njëjtin raport që ai është i nënshtruar ndaj pushtetit të Iblisit.

Kur gjymtyrët e dukshme të njeriut kanë rënë nën pushtetin e Iblisit, ato bëhen gjymtyrë djallëzore e grabitëse të mbretërisë së të Vërtetit. Edhe adhurimi që bëjnë fuqitë shpirtërore në xhaminë e trupit, do të jenë të lejuara e të drejta, vetëm nëse këto fuqi janë prej ushtrive të mëshirës gjithëpërfshirëse. Por dihet se ushtria e Iblisit nuk ka të drejtë të lëvizë në mbretërinë e trupit të njeriut, sepse trupi i njeriut është pronë e të Vërtetit Fuqplotë.

---

<sup>1</sup>"El-Usûlu fil-kâfij", "Kitâbul-Huxh'xheti".



Kur rrugëtari në udhën e Allahut e heq pushtetin e shejtanit prej mbretërisë së zemrës - kjo është një pozitë e veçantë me të Vërtetin - dhe, kur ai e pastron zemrën për shkëlqimet e të Vërtetit e nuk lejon që në zemrën e tij të hyjë askush tjetër përveç të Vërtetit, domethënë se nuk lejon që në zemrën e tij të futet Iblisi, atëherë xhamitë e dukshme e xhamitë e brendshme dhe vendet e mbretërisë e të cilësive bëhen të lejuara, për rrjedhojë edhe namazi i tij është si namazi i atyre që kanë arritur gradën e njohjes. Bazuar mbi këtë kriter, del qartë edhe kuptimi i përgjithshëm për pastërtinë e xhamisë.



## Qëllimi i katërt

# ETIKA E ZEMRËS PËR KOHËN

### Ndarja e parë

## SHTRESAT E ATYRE QË KANË ARRITUR GRADËN E NJOHJES, NË LIDHJE ME RUAJTJEN E KOHËVE TË NAMAZIT

Mëso se ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe ata që praktikojnë ushtrime shpirtërore të lejuara në ligjin e fesë, janë të përkushtuar të kontrollojnë e të vazhdojnë respektimin e kohëve të namazit, kohët e bisedimit intim dhe vendin e takimit me të Vërtetin, por vetëkuptohet se ky përkushtim, nga ana e tyre, është në raport të drejtë me njohjen që ata kanë për pozitën e Pastër të Zotit krijues, si dhe me dëshirën e tyre të zjarrtë për të meditaruar në praninë e Filluesit të çdo krijese. I lartë është vetëm emri i Tij!

Prej kësaj shtrese ka të tërhequr prej bukurisë së më të Bukurit, ka të dashuruar marrëzisht me mirësinë e përjetshme, ka të dehur me kupën e dashurisë, ka të hutuar nga të dyja botët me



zjarrin e pyetjes: “ألست” - “elestu” - “**A nuk jam Unë?**”<sup>1</sup>, ka që nuk shikojnë fare në anësitë e gjithësisë. Këta janë të lidhurit me madhësitinë e pastër të bukurisë së Allahut. Ata janë në një gjendje prezence të përhershme, për asnjë çast ata nuk ndahen prej përmendjes së të Vërtetit, prej shikimit me sy dhe prej kontrollit.

Prej kësaj shtrese ka njerëz të virtytshëm, të cilët zotërojnë dituri. Ata janë krerët e të moralshmëve me shpirta të lartë. Nuk i japin përparësi asnjë gjëje tjetër përveç bashkëbisedimit në intimitet me të Vërtetin; nuk kërkojnë gjë tjetër përveçse të lidhen me të Lartin dhe të bisedojnë me Atë në vetmi. Ata besojnë se madhështia, nderimi, virtyti e njohja, të gjitha këto qëndrojnë në përmendjen e të Vërtetit e në bashkëbisedimin intim me Të. Kur ata mbështillen rreth botës dhe hedhin qoftë edhe shikim të shpejtë mbi dy ekzistencat, padyshim që shikimi i tyre është shikim njohës. Në këtë botë, ata janë studiues dhe nxitojnë për te i Vërteti i Gjithëfuqishëm. Shohin se të gjitha qeniet janë dukuri të të Vërtetit dhe shkëlqime të bukurisë së Tij: “I Dashuri për të gjithë botën dhe e gjithë bota është prej Tij”<sup>2</sup>.

Ata vazhdimisht përpiqen, me aq sa mund të jenë të përpiktë, për ta falur namazin në kohën e vet. E presin me padurim hyrjen e kohës për të biseduar në intimitet me të Vërtetin. E kanë përgatitur veten dhe janë pajisur për ta takuar Allahun. Zemrat e

<sup>1</sup>Thekson fjalën e Allahut të Lartësuar, në ajetin 172 të sures “El A’râf”:

“وَإِذْ أَخَذَ رَبُّكَ مِنْ بَنِي آدَمَ مِنْ ظُهُورِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَأَشْهَدَهُمْ عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ قَالُوا بَلَىٰ سَوَّيْنَا  
- “**Ue idh ekhadhe rab'buke min benij Àdeme min dhuhùrihim dhurr'rrijetehum ue esh'hedehum alà enfusihim elstu birab'bukum kâlù belà shehidnà...**” - “**Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: 'A nuk jam Unë Zoti juaj?' Ata u përgjigjën: 'Po, dëshmojmë se Ti je'.**”

<sup>2</sup>Përmbajtja e gjysmës së një strofe prej poezisë së poetit Sadi Shirazi.



tyre janë prezent. Ata nxitojnë t'i afrohen të Pranishmit. E regjistrojnë vendmbledhjen për hir të të Pranishmit. Ata mendojnë se robëria qëndron në dashurinë e ndërsjellë e në bashkëpunimin me të Plotësuarin Absolut, prandaj dëshira e tyre e madhe për adhurim bazohet mbi të gjitha këto që u thanë.

Si besimtarë, ata besojnë në të panjohurën dhe janë të dashuruar marrëzisht me veprat e jashtëzakonshme të së Vërtetit Fuqplotë. Ata nuk janë prej atyre që i ndërrojnë mirësitë e përhershme të Xhenetit dhe kënaqësitë e bukuritë e vijueshme të Xhenetit me gërmadhat e zhdukshme e me kënaqësitë e deformuara e të pakta të kësaj bote, që shumë shpejt do të asgjësohet. Kur hyn koha e adhurimit, zemrat e tyre janë të gatshme. Ata mendojnë se adhurimet janë farërat e mirësive të Botës Tjetër. Si persona që nuk preferojnë asgjë tjetër mbi mirësitë e Përjetshme, patjetër që janë të parët që ngrihen me dëshirën më të madhe dhe e presin me padurim hyrjen e kohës për faljen e namazeve. Ata besojnë se kohët për faljen e namazit janë stina për vjeljen e frutave dhe për ngarkimin e pajisjeve para udhëtimit.

Zemrat e tyre kuptojnë atë çka është në botën e padukshme, zemrat e tyre besojnë në mirësitë e Përjetshme e në kënaqësitë e vijueshme të Botës Tjetër. Ata nuk e humbin kohën e tyre për faljen e namazit, prandaj e fillojnë punën përgatitore pa hyrë akoma koha për faljen e namazit. Të këtillë janë banorët e Xhenetit dhe njohësit e mirësive, në të cilat ata do të jenë përjetësisht.

Vetëkuptohet se kënaqësitë e arritura nga kryerja e adhurimeve në disa prej këtyre që ne përmendëm, janë të ndryshme, sipas gradëve, në të cilat janë ata dhe sipas njohurive që



ata kanë. Ata kurrë nuk ndiejnë peshën e rëndë të detyrimit nga kryerja e adhurimit.

Për sa na përket ne të mjeruarve, ne që jemi vënë në sprovë me shpresat, ne të kënaqurve me prangat e dëshirave e të epsheve, ne që jemi të zhytur në detin e errët e të egërsuar të botës së natyrës, shqisa e nuhatjes së shpirtrave tanë nuk e ndien aromën e dashurisë. Zemrat tona nuk shijojnë asnjë kënaqësi nga njohja e nga virtyti. Për më tepër, ne nuk jemi prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes e të kujdesit. Gjithashtu, nuk jemi as prej atyre që thirren me epitelin “ehlul-imani” - “besimtarë të sinqertë” e as prej atyre që kanë siguri në zemër. Në mendimin tonë, adhurimet hyjnore janë detyrime e vështirësi. Bisedimi intim me Kryerësin e nevojave është një barrë e diferencuar dhe një punë shumë e rëndë. Për ne s’ka mbështetje tjetër përveç kësaj bote – ku hanë bar kafshët - ne s’kemi lidhje tjetër përveçse me shtëpinë e natyrës, me vendin e adhurimit të idhujtarëve. Syri vëzhgues i zemrave tona s’ka mundësi të shohë bukurinë dhe shpirtrat tanë janë shumë larg, që të shijojnë njohjen.

Por, zotëria e udhëheqësi i atyre që kanë arritur gradën e njohjes, esenca e të dashuruarve dhe të vërtetës (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “E kaloj natën te Zoti im. Ai më ushqen e me jep të pi”.<sup>1</sup> O Zoti im! Çfarë bujtje është kjo për Muhamedin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në shtëpinë e vetmisë në shoqërinë Tënde? Çfarë ushqimi ishte tek ai, me të cilin Ti e ushqeve dhe si ishte pija që Ti i dhe atij me dorën Tënde?! Ti e çlirove atë prej prangave të të gjitha botëve,

---

<sup>1</sup> “Vesàilu-Sh’shij’ati”, vëll. 7, f. 388; “Sahijhu” i Bukhàriut, vëll. 4, (Kitàbu-T’temen’nij), f. 251.





deri sa ai arriti të thotë: “Me Allahun unë kaloj aq kohë sa nuk e kalon asnjë engjëll i afërm dhe nuk e ka kaluar me Atë ndonjë profet e i dërguar”.<sup>1</sup> A ishte ajo kohë prej kohëve të kësaj bote e të Botës Tjetër apo ishte koha e vetmisë së plotë me Ty?

“قَاب قَوْسَيْنِ” - “kàbe kausejni” - “ishte afër sa dy harqe”<sup>2</sup>

Biseduesi me Allahun, Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), agjëroi dyzet ditë, që ne sot i quajmë “agjërimi i Musait”. Kjo kohë atij iu komunikua prej të Vërtetit, i Cili njofton: “فَتَمَّ مِيقَاتُ رَبِّهِ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً” - “fetem’me mijkàtu rab’bihi erbeijne lejleten” - “u plotësua koha e Zotit të tij dyzet net”.<sup>3</sup> Megjithëkëtë, Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) as nuk e arriti kohën e caktuar për Muhamedin dhe as nuk u lartësua në nivelin e etikës Ahmediane. Në çastin e takimit, Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) iu tha: “فَاخْلَعْ ثَمَلِيكَ” - “fakhleë neëlejke” - “hiqi këpucët”.<sup>4</sup> Kjo frazë e ajetit është interpretuar me thirrjen për të hequr dorë prej “dashurisë për familjen”. Por ti sheh se Vula e Profetëve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u urdhërua për dashuri ndaj njerëzve. Pa dyshim që ky urdhër ishte një sekret prej të Vërtetit, i hedhur në zemrën vezulluese, që nuk mund të ketë më të qartë se ajo asnjë send, prandaj edhe ti ke detyrë ta provosh këtë përmbledhje që ne shpalosëm, me qëllim që edhe ti të arrish diçka prej thellësive të kësaj përmbledhjeje.

<sup>1</sup> “Avàlij El’leàlij” vëll. 4, f. 7, Hadithi 7; “Bihàrul Enuàr”, vëll. 18, f. 360.

<sup>2</sup> Sure “EnNexhm”, ajeti 9.

<sup>3</sup> Sure “El A’ràf”, ajeti 142.

<sup>4</sup> Sure “Tà Hà”, ajeti 12.



## Ndarja e dytë

### KUJDESI PËR RUAJTJEN E KOHËVE TË NAMAZIT

I dashur, shfrytëzoje kohën e bashkëbisedimit intim sipas mundësisë e sipas fuqisë! Stolisu me edukatat e zemrës, bëje zemrën tënde të kuptojë se baza e jetës në Botën Tjetër të Përjetshme, në burimin e pashtershëm të virtyeteve shpirtërore e të bujarisë, qëndron në “lutjen e vazhdueshme” (el muràvedeh) dhe në “bashkëbisedimin në vetmi” (el muàneseh) me të Vërtetin, qëndron në bisedimet në vetmi me Zotin, sidomos në namaz, që është jo vetëm adhurimi më përgjithësues dhe më i plotë ndër të gjitha adhurimet, por është edhe pasuria e patundshme shpirtërore, e përgatitur me dorën e bukurisë së të Vërtetit Fuqiplotë.

Me aq sa është e mundur për ty, ruaji kohët e namazit. Për kohën e faljes së namazit zgjidh kohën që ka më shumë mirësi, sepse, pikërisht, në atë kohë, ka një dritë, e cila nuk gjendet në kohët e tjera. Gjithashtu, pakëso, madje në kohët e faljes së namazit largoi fare shqetësimet e zemrës, por dije se kjo kurrë nuk realizohet për ty, pa i ndarë e pa i sistemuar kohët dhe pa caktuar një kohë të veçantë për faljen e namazit, kohë në të cilën të mos ketë vend për ndonjë punë tjetër prej punëve të tua. Në kohën e faljes së namazit mos e lidh zemrën tënde me ndonjë send tjetër, prandaj të mbetet detyrë, që të mos e falësh namazin në një kohë, në të cilin marrin pjesë edhe punë të tjera dhe, kjo, me qëllim që ti të qetësosh zemrën tënde dhe të bësh që zemra jote të jetë e pranishme në namazin që



ti fal. Dije se namazi është garantuesi i përmirësimit të punëve të jetës tënde të Përhershme.

Tani është rasti i përshtatshëm të sjellim këtu disa hadithe, që flasin për gjendjet e të ruajturve prej gjynaheve, me qëllim që mendimi mbi gjendjet e atyre të mëdhenjve të çojë në ndërgjegjësimin tënd dhe të mbeten në qendër të vëmendjes tënde, madje mund të bëjnë që edhe zemra të kuptojë rëndësinë e vendit, rëndësinë, madhështinë dhe pozitën e faljes së namazit, duke e zgjuar atë prej gjumit të shkujdesjes.

Prej disa grave të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregohet: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)bisedonte me ne, por, sapo hynte koha për faljen e namazit, ai sikur nuk na njihnte. Por edhe ne e dinim se në këtë kohë ai nuk shqetësohej me ndonjë send tjetër përveçse me Allahun”.<sup>1</sup>

Transmetohet se Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur hynte koha për faljen e namazit, shqetësohej, i dridhej trupi e i ndërronte ngjyra e fytyrës. Kur e pyesnin, se çfarë kishte, ai përgjigjej: “Erdhi koha e amanetit, që Allahu i Lartësuar ia paraqiti qiejve, tokës e maleve, por ato nuk pranuan ta mbajnë dhe u frikësuan prej tij”.<sup>2</sup>

Es’sej’jid Et’tàùs, në librin “Felàhu-s’sàili” citon se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), kur merrte abdes, i ndryshonte ngjyra e fytyrës e i dridheshin duart. Kur e pyetën për këtë që i ndodhte, tha: “Është e drejta e atij që qëndron para Zotëruesit të Arshit, të zverdhet

<sup>1</sup> “Mustedrekul-Vesàili”, Libri “Es’salàtu”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 17.

<sup>2</sup> “Mustedrekul-Vesàili”, Libri “Es’salàtu”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 5 dhe 14.



dhe t'i dridhen duart".<sup>1</sup> Po kështu citohet, që edhe Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë të njëjtën gjë.<sup>2</sup>

Transmetohet se Imam Sexhadi (Paqja qoftë mbi të!) (Zejnë Abedini), kur bëhej gati për të marrë abdes, zverdhej. Kur e pyesnin, se çfarë i ndodhte, kur merret abes, përgjigjej: "Ju nuk e dini se para kujt jam".<sup>3</sup>

Sikur edhe ne të mendojmë, sikur edhe ne t'i bëjmë zemrat tona boshe, që ato të kuptojnë se kohët për faljen e namazit janë kohët për të qenë afër të Pastrit, Zotëruesit të madhështisë dhe në ato kohë, i Vërteti Fuqiptotë, thërret robin e tij të pafuqishëm e të përbuzur për të bashkëbiseduar me Të dhe i jep atij leje të hyjë në shtëpinë e Tij të bujarisë, që ai të fitojë lumturinë e Përjetshme. Por gëzimi e kënaqësia në të brendshmen tonë do të jetë në atë masë sa është njohja jonë, që na çon tek Ai, kur hyn koha për faljen e namazit.

Kur zemrat tona e ndiejnë madhësinë dhe rëndësinë e pozitës së thirrjes së kohës për faljen e namazit, në brendësinë tonë krijohet një gjendje frike e tmërri, që është në raport të drejtë me masën e asaj që ne kemi kuptuar prej asaj madhësie.

Edhe zemrat e eulijave jo vetëm që janë të ndryshme nga njëra-tjetra, por kanë diferencime edhe nga aftësia për të dalluar atë çka ato ndiejnë prej madhështisë e prej mëshirës, kurse gjendja e gëzimit që krijohet te eulijatë, vjen si rezultat i dashurisë së tyre të zjarrtë për takimin dhe nga mëshira e nga bukuria që ata ndienin,

---

<sup>1</sup> "Felâhu-S' sâili", prej librit "El'luëluj'jât" në lidhje me gjendjet e Imamet Hysen bin Ali (a.s)".

<sup>2</sup> Lexo librin "Bihârul Enuâr", vëll. 77, f. 346.

<sup>3</sup> "Mustedreku-Vesâili", Libri "Es' salâtu", K. 2- "Punët e namazit", Hadithi 35.



prandaj thoshin: “O Bilal, na qetëso!”<sup>1</sup>, pasi shkëlqimet e madhështisë dhe të imponimit disa herë i çonin ata në një gjendje të atillë, sa e humbnin vetëdijen dhe te ata krijohej një gjendje pështjellimi e tronditjeje.

Në përgjithësi, mëso, o i pafuqishëm, se edukatat e zemrës për kohët e namazit përmblihen në të vërtetën, se ti fillove të përgatitesh për të shkuar pranë Mbretit të kësaj bote e të Botës Tjetër, jo vetëm për të dëgjuar fjalën e të Vërtetit të Gjithëfuqishëm, por edhe për të biseduar me Të. Kur ti, nga njëra anë, krahason pafuqinë e varfërinë tënde, kur krahason se sa i ulët e se sa i pafuqishëm je dhe, nga ana tjetër, vë madhësinë e Qenies së Pastër të të Vërtetit, nga kjo madhësi në forumin e pranisë humbnin ndjenjat profetët, të dërguarit dhe engjëjt e afërm dhe jo ti, kur njihesh me pamundësinë e me poshtërimin tënd. Vetëm në këtë gjendje, ti e ke bërë zemrën tënde që ajo ta kuptojë këtë dallim, prandaj zemra jote, në këtë gjendje, nuk ndien frikë. Gjithashtu, edhe adhurimi që ti kryen, nuk të duket pa rëndësi.

Kur ti mendon sa e gjerë është mëshira e Qenies së dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, sa e plotësuar është dhembshuria e Tij, sa gjithëpërfshirëse është mëshira e Tij dhe sa tolerues është Ai ndaj një robi të pafuqishëm për të hyrë në praninë e të Pastrit, pavarësisht nga rënia e tij shpirtërore e nga papastërtitë që ai mbart, përsëri Ai e thërret robin e demoralizuar, që të jetë i pranishëm në kuvendin e qetësisë e të gëzimit me format e manifestimeve e të praktikave që shprehin dashamirësi e respekt që ka kjo ftesë, për të marrë pjesë në atë forum dhe që fillon me zbritjen e engjëjve, me zbritjen e Librave qiellorë e me dërgimin e profetëve dhe të

<sup>1</sup>Shprehje e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me të cilën ai i drejtohej Bilal Habeshiut, që të thërriste ezanin. Lexo “El Mehaxh’xhetul-Bejdâ”, vëll. 1, f. 377.



dërguarve. Pavarësisht të gjitha mangësive që ky rob ka, ky “i mundshëm” (i brengosur), pa pasur asnjë të kaluar, ose aftësi, për më tepër, kur prej pranisë së këtij të pafuqishmi – Allahu na ruajttë! – Ai nuk do të ketë as edhe një dobi të vetme nga thirrja që i drejton atij, ftohet të jetë i pranishëm në kuvendin e pastër të të Lartit, në të cilën nuk është askush përveç engjëjve e profetëve. Pa dyshim që ky meditim do të ngjallë një gjendje kënaqësie e qetësie në zemër dhe në këtë gjendje zemra fillon të shpresojë.

Kur ti e përgatit veten për të shkuar drejt këtij qëllimi me hapat e frikës, shpresës, dëshirës e druajtjes, njëkohësisht ambalazhon edhe furnizimet që të duhen për këtë udhëtim dhe, patjetër që furnizimet më të rëndësishme janë: hyrja në praninë e të Lartit, me zemër që turpërohet e ndruhet, me ndjenjën se je i ulët, je i thyer e i ke ndërprerë mashtrimet, por ruaju shumë që, nga asnjë anë, të mos e mendosh veten se meriton të jesh pranë të Pastrit, ose ta llogarisësh veten se je i përshtatshëm për adhurim e për robëri. Edhe leja që të është dhënë, për të kryer adhurim e për të shfaqur robërinë, mbaje gjithmonë parasysh se të është dhënë nga mirësia e mëshirës gjithëpërfshirëse të Atij që është Një e i Vetëm dhe nga butësia e të Vërtetit të Gjithëfuqishëm.

Gjithashtu, mëso, se, kur ti e mban parasysh se je i ulët dhe plotësisht i nënshtruar ndaj të Vërtetit Fuqplotë, atëherë e kupton qartë, se ti vetë dhe adhurimi që ti kryen, nuk është diçka që vlen të përmendet dhe nuk ka ndonjë vlerë, pikërisht, në këtë gjendje, i Vërteti Fuqplotë do të të rrethojë ty me butësinë e Tij e do të të lartësojë dhe mbi ty Ai do të hedhë rrobën e bujarive të Tij.



## Qëllimi i pestë

# VËSHTRIM MBI ETIKËN E KTHIMIT NË DREJTIM TË KIBLES

### Ndarja e parë

## SEKRETI I KTHIMIT KAH NJË DREJTIM, NË PËRGGJITHËSI

Është e qartë se kthimi kah një drejtim qëndron në dy aspekte: është kthim “paraprak”, në kthimin e fytyrës drejt një ane të caktuar dhe në asnjërën prej anëve të tjera; por është edhe kthim “shpirtëror”, në kthimin e fytyrës në drejtim të Qabes, e cila ndodhet në vendin e quajtur Um’ul-Kurà - Nëna e fshatrave - drejt qendrës së gravitetit të tokës. Kthimi i fytyrës kah ky drejtim ka edhe anën e tij të brendshme. Edhe ana e brendshme e këtij kthimi ka një sekret, madje ka disa sekrete.

Zotëruesit e sekreteve e largojnë të brendshmen e shpirtit prej anëve të shumta të së panjohurës e prej anëve të shpërndara që shihen me sy. Anën e sekretit të shpirtit ata e lidhin vetëm me një drejtim. Ata e shkrijnë shumicën në sekretin e asaj që quhet “Njëjësi në shumësin”. Kur ky sekret shpirtëror zbret në zemër, në atë



zemër shfaqet i Vërteti. Me shfaqjen e emrit më të madh, i cili përfaqëson “pozitën e shumësit emëror”, janë zhdukur e janë bërë të padukshme shumicat emërore. Në këtë pozitë, ana e zemrës është bërë gati të jetë në praninë e emrit më të madh dhe ka filluar të kryejë rolin e saj, prej brendësisë së zemrës, e cila del në shesh me shfaqjen e Sunduesit, në asgjësimin e tjetrit e në largimin prej perëndimit të botës e prej lindjes së saj. Roli i zemrës, në këtë orientim drejt Zotërisë së shumësit, është duke u kthyer në drejtim të qendrës së shtrirjes së tokës. Por, kthimi i fytyrës në këtë drejtim është dora e Allahut në tokë.

Për sa i përket rrugëtarit për tek Allahu, ai ecën nga e jashtëmja drejt të brendshmes dhe ngjitet lart nga ajo që është sheshit drejt sekretit. Në këtë gjendje, detyra e tij është që orientimin ta bëjë figurativ e të kthyer drejt qendrës së begative tokësore, prandaj ai heq dorë prej të gjitha anëve të shpërndara. Pikërisht, këtë orientim ai e bën mjet për lartësimin e gjendjes së zemrës. Por ai nuk mjaftohet vetëm me formën, e cila përfaqëson idhuj të vërtetë, prandaj orientimi i tij është orientim drejt zemrës së tij të vërtetë, drejt origjinës së bazave e begative të qiejve e të tokës. Ai kurrë nuk e orienton atë as në drejtim të ndonjë tjetri e as në drejtim të egoizmit, por e shpëton atë prej ndikimeve të këtyre dy të fundit, që të arrijë një gradë prej sekretit të

“وَجَعَلْنَا لِكُلِّ شَيْءٍ مِّنْهَا مَخْرَجًا وَإِلَىٰ نَاحِيَّتِنَا أَنزَالًا وَأَنزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً طَهُورًا” - “...vexh'xhehtu vexh'hij lil'ledhij fetare-s'semàuàti uel-erda...”<sup>1</sup> - “**personalisht unë i drejtohen Atij që krijoj qiejt e tokën...**”<sup>1</sup>, që në zemrën e tij të vezullojnë rreze prej shkëlqimeve dhe rreze prej botës së panjohur të emrave, me qëllim që anët e tjera e shumicat e shpërndara të digjen me rrezet hyjnore.

---

<sup>1</sup> Sure “El En’àm”, ajeti 79.





Në këtë gjendje, i Vërteti Fuqiplotë e merr atë për dore dhe dy idhujt, më të voglin e më të madhin, me dorën e prijësit të eulijave, që të dy i flak jashtë brendësisë së zemrës...

Ky është një tregim që nuk mbaron, prandaj më lër ta shkruaj atë në një studim tjetër.



## Ndarja e dytë

### DISA RREGULLA TË KTHIMIT NË DREJTIM TË KIBLES

Ti rrugëtar në udhën e Allahut, mëso se, kur e largon fytyrën tënde prej anëve të shpërndara të botës së natyrës dhe e drejton atë vetëm në drejtim të një pike të vetme, me këtë veprim ti ke shprehur hapur dy gjendje prej cilësisë së Pastër hyjnore, me të cilën je krijuar, dy gjendje të depozituara te ty me dorën e padukshme, që në brumin e krijimit, në brumin, baltën tënde, që i Vërteti Fuqiplotë e fermentoi me dorën e bukurisë e të madhështisë. Më pas ti i shfaqe ato dy gjendje në formën e dukshme të kësaj bote dhe bëre që ato të shihen, por me këtë solle argumentin se ti nuk je i mbuluar prej këtyre dy gjendjeve të cilësisë hyjnore të pastër të krijimit dhe këtë argument ti e paraqite sheshit, duke i kthyer shpinën tjetrit dhe çdo ane tjetër dhe duke e kthyer fytyrën tënde në drejtim të Kibles, e cila është vendi i shfaqjes së dorës së Allahut dhe i fuqisë së Tij.

E para prej atyre dy gjendjeve të cilësisë hyjnore të krijimit, është neveria e natyrshme ndaj mangësisë e ndaj pamjaftueshmërisë. Gjendja e dytë është dashuria për plotësimin e për plotësimin përfundimtar. Njëra prej këtyre dy gjendjeve është origjinale, kurse tjetra është e varur, është hije. Me këto dy gjendje të cilësisë së krijimit janë krijuar të gjithë individët e familjes njerëzore, pa asnjë përjashtim. Të gjithë individët e familjes njerëzore, pavarësisht nga ndryshimet që kanë në besim, në moral, në karakter, në temperament, në vendet ku jetojnë e në zakonet e



tyre, janë nomadë apo banojnë në një vend të caktuar, janë të prapambetur apo janë të qytetëruar, janë të ditur apo injorantë, janë besimtarët apo ateistë, të gjithë janë të brumosur me këto dy gjendje. Edhe pse ata vetë janë të mbuluar nga këto dy gjendje, nuk i shohin, madje janë të ndryshëm edhe nga ana e specifikimit të plotësimit e mangësisë, plotësimit përfundimtar e pamjaftueshmërisë.

Ky është shkaku që vrasësi barbar gjakpirës e mendon plotësimin në realizimin e sundimit mbi shpirtat e njerëzve e mbi nderin e tyre. Gjithashtu, ai e konsideron gjakpirjen e vrasjen kriter për plotësim dhe me këtë kriter ai e kalon të gjithë jetën e vet.

Po kështu është edhe kërkuesi i kësaj bote, që rend pas pozitës së lartë shoqërore e pas pasurisë. Në të vërtetë, kërkuesi i kësaj bote ka dashuri të madhe për pasurinë e për pozitën e lartë shoqërore, sepse edhe ky mendon se plotësimi qëndron pikërisht në pasurinë e në pozitën e lartë shoqërore, për rrjedhojë, dashuria e tij për këtë botë i kthehet në qëllim, prandaj ai mendon se plotësimi qëndron vetëm në realizimin e qëllimit të tij dhe e konsideron të plotësuar cilindo që e ka arritur këtë qëllim. Veç kësaj, ai është i dashuruar me këtë qëllim aq shumë, sa ka neveri për qëllimet e tjera.

Roli i profetëve, roli i atyre që kanë dituri për Allahun dhe roli i atyre që kanë arritur gradën e njohjes, është që t'i nxjerrin njerëzit prej mbulesave dhe të pastrojnë dritën e cilësisë së pastër të krijimit të tyre prej errësirave të injorancës dhe t'u bëjnë njerëzve të njohur plotësimin përfundimtar. Kur ky rol plotësohet, atëherë orientimi kah plotësimi dhe heqja dorë prej çdo gjëje tjetër, kurrë s'ka nevojë për thirrje e për nxitje. Në këtë gjendje, drita e cilësisë



së pastër e krijimit, që gjendet te individët e mbarë familjes njerëzore, në vetvete, konsiderohet prej argumenteve më të mëdha hyjnore.

Në namaz, që është pasuria e patundshme tek Allahu dhe miraxhi i afrimit të i Vërteti, kthimi në drejtim të Kibles, orientimi kah pika qendrore dhe largimi prej anëve të shpërndara, numërohet zgjim për cilësinë e pastër të krijimit dhe nisje e dritës së kësaj cilësie prej drynit të mbulimeve. Kjo gjendje vërtetohet te të plotësuarit dhe te ata që kanë arritur gradën e njohjes. Për sa na përket neve, të mbuluarve, ne kemi nevojë të ngutshme të stolisemi me etikën e kthimit të plotë, për të realizuar orientimin në drejtim të Kibles. Ky kthim arrihet duke e bërë zemrën të kuptojë se, në të gjithë shtëpinë e vërtetimit, s'ka as plotësim e as plotësim përfundimtar, përveç të Plotësuarit Absolut. Vetëm i Plotësuarit i pastër është plotësim pa mangësi, prandaj bukurinë e tij nuk e deformon asnjë mangësi, as veprën e Tij faktike s'ka fuqi që e shtrembëron. Ai është mirësia, me të cilën nuk përzihet e keqja, Ai është drita që nuk e mbulon dot errësira. Çdo gjë që gjendet në shtëpinë e vërtetimit prej plotësimit, bukurisë, të mirës, fuqisë, madhështisë, dritës, punë efektive dhe lumturi, është vetëm prej dritës së bukurisë së Qenies së Pastër dhe Ai s'ka asnjë ortak në plotësimin personal. Për asnjë qenie s'ka bukuri, plotësim, dritë e zbukurim pa bukurinë e Qenies së Pastër dhe pa plotësimin e dritës e të zbukurimit të Saj.

Në përgjithësi, shkëlqimi i dritës së bukurisë së Tij të Pastër, tregon se Ai e bëri botën dritë dhe i dha asaj jetë, dituri e fuqi, ndryshe çdo gjë në shtëpinë e vërtetimit do të ishte në errësirën e hiçit, do të ishte në të fshehtën e asgjëje dhe në brendësi të falsitetit. Prandaj, prej ndriçimeve të diturisë, zemra e rrugëtarit në udhën e



Allahut sheh se, përveç dritës së bukurisë së më të Bukurit, çdo gjë tjetër është e gënjeshtërt, nuk është asgjë dhe asnjëherë s'ka ekzistuar.

Në një hadith tregohet se, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëgjoi fjalën e Lebidit: "Dëgjoni me kujdes, të gjitha sendet, përveç Allahut, janë të rreme dhe çdo mirësi patjetër do të zhduket", tha: "Vjersha më e vërtetë që ka thënë ndonjë poet, është fjala e Lebidit: 'Dëgjoni me kujdes...'"<sup>1</sup>

Kur ti e bën zemrën tënde që ajo të kuptojë falsitetin e shtëpisë së vërtetimit dhe plotësimin e Qenies së Pastër, në këtë gjendje, ti s'ke nevojë për të menduar e as detyrim që të orientosh zemrën drejt Kibles dhe drejt dashurisë për bukurinë e më të Bukurit Absolut. Me këtë orientim ti e bërë zemrën tënde, që ajo të ketë neveri prej gjithçkaje që gjendet në shtëpinë e vërtetimit, përveç dukurisë së shkëlqimit të Qenies së Pastër. Është cilësia e pastër e krijimit ajo që e shtyn njeriun drejt këtij orientimi, në mënyrë të natyrshme dhe më pas gjuha e njeriut, zemra dhe gjendja e tij bëhen: "وَجِئْتُ وَجْهِي لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ" - "...vexh'xhehtu vexh'hij lil'ledhij fetare-s'semàvâti uel-erda..." - **"Personalisht unë i drejtohen Atij që krijoi qiejt e tokën..."**<sup>2</sup> Gjithashtu, bëhen:

"لَا أُحِبُّ الْإِنْسَانَ" - "...là uhib'bul-àfilijne" - **"...unë nuk i dua ato që shuhen"**<sup>3</sup> Kjo është gjuha e natyrshme e njeriut.

Ti nevojtar, mësoje se bota do të zhduket e do të asgjësohet, nuk do të jetë më ashtu siç ishte, e rreme. Çdo gjë që gjendet në këtë

<sup>1</sup> "Ilmul-Jekijn", vëll. 1, f. 106.

<sup>2</sup> Sure "El En'àm", ajeti 79.

<sup>3</sup> Sure "El En'àm", ajeti 76.



botë, do të asgjësohet, me përjashtim të Atij. Asnjëra prej qenieve nuk ka asgjë nga vetja e saj. Në vetë qeniet nuk ka as bukuri, as zbulurim, as dritë e as vezullim, pasi bukuria, zbulurimi e plotësimi janë të veçanta vetëm në të Vërtetin Fuqiplotë. Vetëm Personi i Tij i Pastër është unik në cilësinë e bukurisë, zbulurimit e plotësimit, madje vetëm Ai është unik në ekzistencë, ashtu siç është unik në të qenit i Adhuruari dhe detyrimisht Ekzistuesi. Kurse poshtërimi e mosekzistenca personale janë të skalitura mbi ata që s'kanë mundësi të shmangin poshtërimin e mosekzistencën, por jo për të Lartin.

Atëherë, largoje zemrën, qendrën e dritës së cilësisë, me të cilën të ka krijuar Allahu, prej të gjitha anëve të shpërndara te kotësitë, në sende që nuk ekzistojnë, në mangësitë dhe orientoje atë drejt qendrës së bukurisë e të plotësimit, që ajo të bëhet ashtu siç thotë poeti Shirazi: “Gjuha jote e natyrshme të jetë në ndërgjegjen tënde të pastër”.

*“Në ndërgjegjen tonë s'ka vend për asnjë tjetër përveç të Dashurit.  
Jepja të dyja botët armikut, pasi ne na mjafton i Dashuri”.<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Përmbajtja e një vjershe e poetit iranian Hafiz Shirazi.



## Vijim

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ti kthehesh në drejtim të Kibles, menjëherë priti shpresat prej kësaj bote dhe prej gjithçkaje që ka në këtë botë, zbraze zemrën tënde prej çdo merakut që të pengon të merakosesh vetëm për Allahun e Lartësuar! Me veten tënde, vëzhgoje madhështinë e Allahut të Lartësuar dhe mbaje në mendje ditën kur do të qëndrosh para Tij”: “وَرُدُّوْا إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمْ الْحَقَّ بِكُلِّ نَفْسٍ مَّا أَسْلَمْتُمْ” - “...teblu kul’lu nefsin mà eslefet ue rud’dù ile-ll’lilàhi meulàhumul-hak’ku” - “...çdo njeri vihet në provë me ato që ka bërë më parë dhe kthehen tek Allahu, ndihmësi i tyre i vërtetë...”<sup>1</sup>

Në këtë hadith sherifi ka një program pune për të ngjashmit me ne, të mbuluarit, për ne që s’kemi mundësi as ta ruajmë vazhdimisht gjendjen tonë të zemrës, as të mbledhin së bashku njëshin me shumicën dhe as të bëjmë dallimin mes orientimit kah i Vërteti e mes orientimit kah njerëzit.

Në kohën kur kthehemi në drejtim të Kibles, detyra jonë është: prerja e shpresës prej kësaj bote dhe të orientohemi vetëm kah i Vërteti, shkëlqja prej shpirtave tanë e rrënjëve të dëshirave që kemi për njerëzit, çrrënjësja e merakeve të zemrës dhe e shqetësimeve shpirtërore prej thellësive të shpirtit e të zemrës, që me këto veprime të jemi të merituar për të qenë të pranishëm pranë të Vërtetit dhe në brendësi të shpirtave tanë të shkëlqejë njëra prej shkëlqimeve të madhështisë. Kur ne arrijmë dritën e madhështisë, në raport të drejtë me përgatitjen tonë, atëherë detyra jonë është: të

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 13- “Fillimi i namazit”; “Mustedrekul-Vesàili”, “Kitàbu-S’alàti”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 9; ajeti 30 i sures “Jùnus”.



sjellim në mendje kthimin tonë te i Vërteti dhe qëndrimin tonë pranë të Pastrit, ditën kur së bashku me njeriun do të dalin sheshit edhe punët e tij “وَرُدُّوْا إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمُ الْحَقُّ” - “ue rud’dù ile-ll’lilàhi meulàhumul-hak’k” - **“dhe kthehen tek Allahu, Kujdestari i tyre i vërtetë...”**<sup>1</sup> Në atë vendqëndrim njeriu do të fshijë jo vetëm rreshtin e falsifikimit të çdo të adhuruari të rremë, por edhe të gjitha dëshirat personale.

Kur ne e mbajmë në mendje ditën kur do të qëndrojmë para madhësisë së të Vërtetit, ditën kur do të bëjmë përpara, për të qëndruar në tubimin më të madh, ndaj të cilit e gjithë shtëpia e vërtetimit nuk mund të jetë as edhe një shkëlqim i vetëm prej shkëlqimeve efektive, pa dyshim që do të sorollatemi mes frikës e shpresës. Kur ne do të shikojmë pafuqinë tonë dhe, kur të bindemi sa delikatë jemi, kur të shikojmë se mashtrimi e poshtërsia jonë është ndërprerë dhe, kur të shikojmë madhësinë e Qenies së Pastër nga mangësitë e nga nevojat, atëherë do të shikojmë dhe do të kuptojmë madhësinë dhe fuqinë e Qenies së Pastër. Pa dyshim që atë ditë do të jemi të frikësuar e të tmerruar prej madhësisë së pozitës. Nëse ne e arrijmë mëshirën e Qenies së Pastër prej mangësive e prej nevojave, nëse arrijmë butësinë e dhembshurinë e Saj, pa fillim e pa mbarim dhe, kur shikojmë edhe bujaritë e pakufizuara, patjetër që kjo do të na ngjallë shpresë.

---

<sup>1</sup> Sure “Jünus”, ajeti 30.





## **ATIKULLI I TRETË**

# **BASHKËSHOQËRUESIT E NAMAZIT**

## **Kapitulli i parë**

### **DISA ETIKA TË EZANIT DHE IKAMETIT**

#### **Ndarja e parë**

### **SEKRETI I EZANIT E IKAMETIT DHE DISA RREGULLA**

#### **TË PËRGJITHSHMETË EZANIT E IKAMETIT**

Mëso se rrugëtari në udhën e Allahut në kohën e thirrjes së ezanit ka për detyrë të lëshojë në zemrën e tij – që është pushteti i fuqive hyjnore e sunduese - si dhe në të gjitha ushtritë e shpërndara në mbarë anët e mbretërisë e të sundimit, thirrjen për të qenë i pranishëm në vendmbledhjen dhe ta përgatisë veten, pasi po afrohet koha e pranisë dhe e takimit. Me këto veprime, ai kurrë nuk tronditet me shkëlqimin e befasishëm dhe, nëse është prej të



dashuruarve apo edhe, nëse është prej të mbuluarve, ai kurrë nuk shkon në vendgrumbullimin e pastër pa u përgatitur.

Atëherë sekreti përgjithësues i ezanit qëndron në faktin se ezani është një thirrje që bëhet prej fuqive hyjnore dhe prej ushtrive hyjnore, me qëllim që rrugëtari në udhën e Allahut të shkojë sa më parë aty ku duhet të jetë i pranishëm.

Etika përgjithësuese e ezanit është tërheqja e vëmendjes ndaj madhësisë e rëndësisë së madhe të pozitës, madhësisë së vendmbledhjes dhe pjesëmarrjes në atë vendmbledhje. Njëkohësisht, ezani i kujton atij poshtërimin (e atij që mund të ekzistojë), i kujton nevojën e varfërinë e tij, i kujton se ai e ka të pamundur për të kryer punën dhe është i paaftë për të asistuar në vendin e mbledhjes, nëse atë nuk e ndihmon i Vërteti Fuqiplotë, me butësinë, me mëshirën e Tij dhe me ndreqjen e mangësive që ai ka.

Për sa i përket ikametit, ai është ngritja më këmbë e fuqive autoritare në vendmbledhjen dhe sjellja e këtyre fuqive në këtë prani.

Etika e ikametit është: frika, strukja, turpi dhe shpresa e sigurt në mëshirën pa anë e pa fund e të Vërtetit. Rrugëtari kërkues në udhën e Allahut, në të gjitha pjesët e ezanit e të ikametit e bën zemrën e vet që ajo, nga njëra anë, të kuptojë madhësinë e vendmbledhjes dhe, nga ana tjetër, të kuptojë rëndësinë e pranisë e të pjesëmarrjes. Gjithnjë ai mban parasysh se është shumë i ulët, nuk ka mundësi dhe është me të meta e mangësi. Vetëm në këtë gjendje, te rrugëtari në udhën e Allahut, nga njëra anë, arrihet gjendja e frikës dhe e strukjes dhe, nga ana tjetër, me zemrën e tij ai



formëson mëshirën e madhe e dhembshurinë bujare, të cilat bëjnë që te ai të lindë shpresa e dashuria.

Bazuar mbi këtë shpjegim, te ata me zemra të dashuruara mbizotëron dëshira e zjarrtë dhe tërheqja. Ata shkojnë në vendmbledhjen e kënaqësisë me këmbët e dashurisë e të pasionit. Zemrat e tyre janë të shqetësuara dhe, në saje të kësaj tërheqjeje të fshehtë, ato zemra janë të mbushura me dashuri e përqafim nëpërmjet rrugës së përmendjes (dhikrit) e mendimit në të Vërtetin, prandaj zemrat e tyre janë të mbushura me dashurinë e vendmbledhjes dhe të pranisë, deri në fundin e namazit.

Në një hadith, i ardhur prej Ali bin ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë se ai ka thënë: “Njeriu me më shumë merita është ai që e dashuron adhurimin dhe e përqafon atë. Ai e dashuron adhurimin me zemrën e tij, e fillon adhurimin me trupin e tij, është i përkushtuar në adhurimin që kryen dhe nuk interesohet fare se ç'bëhet në këtë botë, qoftë kur është në gjendje të mirë, qoftë kur është në gjendje të vështirë”.<sup>1</sup>

Kurse te ato me zemra të frikësuara, shkëlqen pushteti i madhështisë. Te ata mbizotëron tërheqja, duke i marrë më vete ata, ndërkaq zemrat e tyre i shkrin frika e strukja. Kështu që neglizhenca e tyre vetjake dhe ndjenja e tyre se janë të ulët e të pafuqishëm, hyn mes tyre e mes të gjitha sendeve.

Musa bin Xhaferi (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Për Allahun,

---

<sup>1</sup> “Vesàilu-Sh’shi’ati”, Libri “Es’salàtu”, K. 19 - “Punët paraprake të adhurimeve”, Hadithi 2, ardhur prej të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).



*ka robër zemrat e të cilëve i ka thyer frika ndaj Allahut dhe kjo frikë i ka bërë ata të mos flasin...<sup>1</sup>*

Kurse te eulijatë dhe te të plotësuarit, i Vërteti Fuqiplotë herë shkëlqen me shkëlqimin e butësisë dhe, në këtë gjendje, udhërrëfyesi i tyre është dashuria e tërheqja drejt dashurisë. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e priste hyrjen e kohës së namazit me padurim. Më pas atij i shtohet dashuria e madhe për namazin, deri sa i thoshte muezin Bilalit: *“Na qetëso, o Bilal!”<sup>2</sup>*

Herë tjetër, i Vërteti Fuqiplotë shkëlqen për ata me shkëlqimin e madhështisë e të pushtetit, atëherë te ata arrihet një gjendje frike e strukje, e ngjashme me gjendjen e frikës që kapte të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët udhëzues në rrugën e drejtë.

Herë tjetër, Ai shkëlqen te ata me shkëlqimin e mbledhjes me Njëshin, por ky shkëlqim, patjetër është sipas fuqisë së zemrave të tyre dhe sipas ndërgjegjësimit të tyre.

Kurse ne të mbuluarit, të shqetësuarit për këtë botë, ne të mbyllurit në burgun e natyrës, ne të lidhurit me prangat e dëshirave e të shpresave, ne të privuarit prej lumturive logjike hyjnore, ne që jemi të dehur nga natyra aq shumë, sa nuk dalim nga dehja që na ka zënë, deri sa të hyjë mëngjesi i përhershëm, ne kurrë nuk do të zgjohemi prej gjumit tonë të thellë, prandaj edhe jemi të veçuar prej rrethit të këtij hadithi të nderuar.

---

<sup>1</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 75, f. 309.

<sup>2</sup>“El Mehaxh’xhetul-Bejdà”, vëll. 1, f. 377.



Atëherë, edukatat me të cilat ne duhet të stolisemi, për të qenë të pranishëm te Allahu, janë të një lloji tjetër. Gjithashtu, edhe kryerja e detyrave të urdhëruara do të jetë në një mënyrë tjetër. Detyra më e rëndësishme që kemi në këtë gjendje, është të nxjerrim prej zemrave tona dëshpërimin që na vjen prej mendimit tonë, se do të na ndërpriten mirësitë e Allahut; të nxjerrim prej zemrave tona humbjen e shpresës prej mëshirës së të Vërtetit të Gjithëfuqishëm, duke ditur se këto dy gjendje janë prej ushtrive të Iblisit dhe prej cytjeve të shejtanëve njerëz e xhin.

Gjithashtu, kemi për detyrë të mos kemi iluzione të kota, se këto pozita janë të veçanta për njerëz të caktuar dhe se për ne s'ka asnjë shpresë, që të arrijmë te ato pozita, ose që këmba e njeriut s'ka fuqi të ecë në këtë rrugë, ndryshe ne do të jemi të mbuluar për shkak të këtij iluzioni të rremë dhe nuk do të lëvizim, që të arrijmë atë pozitë, për rrjedhojë, do të jemi në një gjendje asfiksie e vyshkjeje. Por, pavarësisht nga pesha e rëndë e asfiksies dhe e vyshkjes, për ne mbetet detyrë të vazhdojmë të ecim në tokën e natyrës. Patjetër që çështja nuk është e tillë, nëse unë nuk e mohoj pozitën e veçantë që kanë të plotësuarit prej njerëzve të Allahut, sepse pozitën që ata kanë, asnjë tjetër s'ka mundësi ta arrijë. Gjithashtu, edhe pozitrat morale e dituritë hyjnore janë me shkallë e me gradë të shumta, sa nuk mund të numërohen. Megjithëkëtë, për njerëzit është e mundur që ata të arrijnë shumë nga këto pozita e gradë, me kusht që të braktisin gjendjen e amullisë e të mosveprimit dhe të largojnë prej zemrave të tyre kokëfortësinë e injorantëve, fanatizmin dhe këmbënguljen e injorantëve në gabimin, por kjo të mos bëhet shejtan në rrugën që ata ndjekin.

Etika e pranisë në vendmbledhjen e takimit me të Vërtetin kërkon që ne të stolisemi me këtë etikë, që do të thotë, të kemi në



qendër të vëmendjes se prania jonë në vendmbledhjen me të Vërtetin Fuqiplotë, është prania në audiencën e Mbretit më të madh, madhështinë e të Cilit e kupton vetëm zemra, sepse ne akoma nuk jemi lartësuar as në gradën e ndijimit dhe as në gradën e asaj që është e dukshme, për shkak se ne shikojmë vetëm madhështinë e kësaj bote dhe nuk kemi asnjë dituri për format e madhësisë hyjnore të padukshme.

Këtu qëndron edhe detyra jonë për t'i bërë zemrat tona të kuptojnë, se format e madhësisë janë dukuri të botës së Mbretërimit e të Pushtetit që zbret në këtë botë. Meqenëse botën e mbretërimit dhe të pushtetit nuk e kapin ndjenjat, ajo krahasohet me botën e padukshme, prandaj detyra jonë mbetet, që t'i bëjmë zemrat tona të kuptojnë se bota është vendmbledhja me të Vërtetin e pastër, i Cili është i pranishëm në çdo vend e në çdo mjedis dhe në mënyrë të veçantë në namaz, i Cili numërohet si një leje e veçantë dhe një premtim special për takimin dhe për të bërë diçka për hir të pranisë të Njëshi.

Veç kësaj, kur zemra e ndien këtë madhësi e këtë prani, edhe pse kjo në fillim mund të jetë detyrim, shumë shpejt dhe në mënyrë graduale rrugëtari në udhën e Allahut do të gjejë gëzim në namaz. Më pas kjo ndjenjë metaforike do të shndërrohet në një realizim të qëndrueshëm.

Kur ne stolisemi me etikën e jashtme të bashkëpunimit me Mbretin e mbretërve, me Pushtetarin e pushtetarëve dhe, kur ne bëjmë kujdes të angazhohemi me etikën e jashtme të pranisë, patjetër që kjo etikë shumë shpejt do të ndikojë në zemër, atëherë zemra e ndien madhështinë dhe me këtë, njeriu dalëngadalë arrin rezultatet e vëllazërimit.



Patjetër që kjo vërtetohet në gjendjen e zotërimit të dashurisë, e cila është cilësi që arrihet me praktikimin e vazhdueshëm të ushtrimeve shpirtërore.

Kur ne, që në fillim, e mësojmë zemrën me format e mëshirës figurative dhe me butësitë e ndjeshme të të Vërtetit Fuqiplotë, kur ne e çojmë tek Ai pozitën e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe mëshirën e plotë të mirësive të veçanta, atëherë zemra dalëngadalë do të gëzohet, ndikimi i kësaj ndjenje do të kalojë nga jashtë në brendësi dhe menjëherë mbretëria jonë e brendshme do të bëhet dritë, si rezultat i ndikimit të Bukurisë në mbretërinë tonë të brendshme. Gjithashtu, do të vërtetohen edhe ndikimet e kërkuara.

Kur njeriu i plotëson urdhrat, punon e përpiqet në rrugën e Allahut, atëherë i Vërteti Fuqiplotë e merr atë për dore, e ndihmon dhe e nxjerr prej errësirave të botës së natyrës me një shkak të panjohur, duke ndriçuar truallin e zemrës së tij të errësuar me dritën e bukurisë së Tij dhe duke e shndërruar errësirën e zemrës në lartësitë shpirtërore:

“لَإِنَّ اللَّهَ عُفُورٌ شَكُورٌ حَسَنَةٌ تُرَدُّ لَهُ فِيهَا حَسَنَاتُ مَنْ يَتَّقِي” - “...ue men jekterif haseneten nezid lehù fijhà husnen, in'ne-ll'lähe gafûrun shekûrun” - “...dhe kush bën ndonjë të mirë, në atë të mirë Ne atij ia shtojmë të mirat; me të vërtetë Allahu është Falësi i madh i gjynaheve dhe Mirënjohësi”.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Sure “Esh Shùrà”, ajeti 23.



## Ndarja e dytë

# DISA RREGULLA DHE SEKRETE TË TEKBIREVE TË EZANIT E TË IKAMETTIT

Mëso se ezani është thirrja drejtuar fuqive të jashtme e të brendshme të njeriut për të qenë i pranishëm në vendmbledhjen e Zotit të botëve, me qëllimin e pastër, për të madhëruar Qenien e dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, sipas kërkesave të të gjithë emrave, cilësive, punëve e argumenteve dhe duke e mbështetur këtë madhërim në namazin – i cili, ashtu siç u theksua më sipër – është madhërimi përgjithësues i Qenies së dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, sipas kërkesës së shkëlqimit, me emrin më të madh që përfaqëson Njëshin e mbledhjes së emrave në praninë e Njëshit e të pozitës së shkëlqimit në mbledhjen, ndarjen, të jashtmen e të brendshmen dhe në prani të të gjithëve, emër për emër. Për të gjitha këto, rrugëtarit në udhën e Allahut, që në fillim i tërheq vëmendjen madhështia e Qenies së dëlirë nga mangësitë e nga nevojat. Bazuar mbi këtë pastrim të përgjithshëm, rrugëtari në udhën e Allahut, në fillim, deklaron madhështinë e Qenies së pastër për fuqitë e mbretërisë së cilësive të vetes së tij morale e materiale; në radhë të dytë, e deklaron këtë madhështi për engjëjt e Allahut, të ngarkuar me administrimin e fuqive të shpërndara në mbretërinë e cilësive të tij morale e materiale; së treti, ai e deklaron madhështinë e Qenies së pastër para qenieve të botës së panjohur e të botës që shihet me sy; së katërti, ai e deklaron madhështinë e Qenies së dëlirë nga





mangësitë e nevojat për engjëjt e Allahut, të ngarkuar në mbretërinë e qiejve e të tokave.

Dhe këtë madhërim ai e bën me katër tekbiret - madhështinë e emrit më të madh (el-ismul-a' dham) për të gjithë banorët e botëve, të padukshme e të dukshme, në mbretërinë e tij, të brendshme e të jashtme. Ky deklaram, në vetvete, është deklaram i pamundësisë së tij për të falënderuar Qenien e dëlirë nga mangësitë e nga nevojat. Gjithashtu, është edhe pohim për mangësinë e tij në faljen e namazit.

Katër tekbiret janë prej punëve të përgjithshme në rrugëtimin dhe në etikën që rrethojnë lavdërimin, falënderimin e adhurimet, por që rrugëtari në udhën e Allahut ka detyrë t'i mbajë parasysh gjatë kryerjes së namazit. Ky është edhe shkaku që ne shikojmë se tekbiret te ezani e te ikameti përsëriten gjatë kalimit nga njëri pozicion i namazit në një pozicion tjetër, me qëllim që në zemrën e rrugëtarit në udhën e Allahut të zërë vend mirë ndjenja e mangësisë së tij personale dhe ndjenja e madhërimit e Qenies së dëlirë nga të metat e nga nevojat.

Nga këtu bëhet e qartë edhe etika e tekbireve, prandaj rrugëtari, kërkuesi në udhën e Allahut, ka për detyrë që në çdo tekbir, nga njëra anë, t'i kujtojë zemrës së vet e fuqive të tij të ndryshme pamundësinë e tij dhe, nga ana tjetër, t'i bëjë të njohur zemrës madhështinë e të Vërtetit Fuqiplotë.

Gjithashtu, mundësohet të mbahet parasysh se çdo njëri prej katër tekbireve të para tregon vetëm njërin prej pozitave:

*Tekbiri i parë:* tregon se Allahu është tepër i lartë për ta përshkruar Atë me fjalën "person" (dhàt).



*Tekbiri i dytë:* tregon se Allahu është tepër i lartë për ta përshkruar me Atë fjalën “cilësi”.

*Tekbiri i tretë:* tregon se Allahu është tepër i lartë për ta përshkruar Atë me fjalën “emër”.

*Tekbiri i katërt:* tregon se Allahu është tepër i lartë për ta përshkruar Atë me fjalën “punë”.

Në këto katër tekbiere, rrugëtari në udhën e Allahut thotë: Allahu është më i madh, që të përshkruhet si Ai dhe shkëlqimet e Tij; Allahu është më i madh, që të përshkruhen cilësitë, emrat, punët e shkëlqimet e Tij, që kanë lidhje me këto tri përshkrime.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “... ana tjetër e tekbitit: (All’lâhu ekber) – Allahu është më i madhi – tregon mohimin e përshtatshmërisë së tij dhe është sikur muezini thotë: Allahun, edhe vetë përshkruetit, nuk arrijnë ta kuptojnë madhështinë e cilësive të Tij, ashtu siç është Ai, i përshkruar me ato cilësi. Në të vërtetë, përshkruetit e cilësojnë Atë me cilësi sipas fuqisë së tyre dhe jo ashtu siç është në të vërtetë madhështia e madhëria e Tij. Allahu është tepër i lartë që përshkruetit të arrijnë ta përshkruajnë Atë me cilësi...”<sup>1</sup> (hadithi vijon)

Gjithashtu, prej rregullave të rëndësishme të tekbiereve është edhe lufta e rrugëtarit në udhën e Allahut me veten e tij, për ta bërë zemrën e tij – me anën e ushtrimeve shpirtërore të zemrës - një mjedis për madhështinë e të Vërtetit Fuqiplotë. Ai ka për detyrë ta zhveshë zemrën e vet prej të gjitha qenieve dhe, nëse në zemrën e tij ka gjurmë të madhësisë së ndonjë tjetri, përveç madhësisë së

---

<sup>1</sup> “Bihârul Enuâr”, vëll. 81, f. 131.



të Vërtetit Fuqiplotë dhe ai nuk e mendon këtë gjurmë madhështie si rreze prej madhështisë së të Vërtetit Fuqiplotë, madje këtë ai as nuk e di, në këtë gjendje, ai duhet ta dijë se zemra e tij është e sëmurë, është me defekt dhe realisht ka rënë nën veprimin e shejtanit, madje veprimet e shejtanit në zemrën e tij janë aq shumë, sa kanë bërë që madhështia e atij tjetrit i duket më e madhe se madhështia e Allahut, për rrjedhojë, zemra mendon se ai tjetri është më i madh se i Vërteti. Pikërisht, në këtë gjendje, njeriu hyn në grupin e hipokritëve (munafikëve).

Shenja treguese e këtij të sëmuri të pashërueshëm është se i prekuri me këtë sëmundje i jep përparësi kënaqësisë së të krijuarit mbi kënaqësinë e të Vërtetit Fuqiplotë. Shenjë tjetër treguese është se ai pranon ta zemërojë Krijuesin, për të fituar kënaqësinë e të krijuarit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur merr tekbirin (kur thua Allahu Ekber), quaji pa rëndësi ç’ka në lartësi e nën tokë, por jo madhështinë e të Vërtetit, sepse, kur Allahu hyn në zemrën e robit që merr tekbir dhe në zemrën e tij ka një pengues që e ndalon robin të arrijë të vërtetën e tekbirit, i Vërteti Fuqiplotë thotë: “O gënjeshtar, Mua do të më mashtrosh?! Pasha madhërinë e madhështinë Time, patjetër që Unë ty do të të privoj prej ëmbëlsisë së përmendjes Sime dhe patjetër që ty do të të mbuloj nga afrimi tek Unë dhe nga kënaqësia e bashkëbisedimit në vetmi me Mua!”<sup>1</sup>

I dashur, sekreti është se zemrat tona të mbrapshta janë të privuara për të shijuar ëmbëlsinë e përmendjes së Allahut, prandaj shpirtrat tanë kurrë nuk e kanë shijuar kënaqësinë e bisedimit në

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 13 - “Përfundimi i namazit”; “El-Mehaxh’xhetul-Bejdà”, vëll. 1, f. 385.



vetmi me Qenien e pastër nga mangësitë e nga nevojat. Veç kësaj, ne jemi të mbuluar, për të arritur deri në afërsi të Qenies, jemi të privuar prej shkëlqimeve të bukurisë e të madhësisë. Kjo vjen, ngaqë zemrat tona janë të sëmura, janë me defekte. Në të vërtetë, mbulimi që ka rënë mbi ne, është meraku i madh që kemi për këtë botë dhe dëshira që të bëhemi të përjetshëm në këtë tokë. Ne jemi të mbuluar me mbulesat e errëta të natyrës. Janë këto mbulesa që na pengojnë të njohim madhësinë e të Vërtetit Fuqiplotë dhe të shohim dritat e bukurisë e të madhësisë.

Për aq kohë sa ne do të vazhdojmë t'i shikojmë qeniet me syrin e Iblisit, ky shikim e asgjëson pavarësinë e vet, prandaj ne kurrë nuk do të shijojmë asgjë prej pijes së vendmbledhjes dhe kurrë nuk do të gjejmë kënaqësinë e bisedimit intim në vetmi; për aq kohë sa ne do të vazhdojmë të shikojmë diçka prej madhësisë në ndonjërin prej qenieve që janë në botën e ekzistencës, në këtë gjendje, ne jemi nën mbulesën e idhujve të kufizimeve morale, prandaj në zemrat tona kurrë nuk do të shkëlqejë pushteti i madhësisë së të Vërtetit Fuqiplotë.

Prej rregullave të tjera të tekbireve, është përpjekja e rrugëtarit në udhën e Allahut për të mos qëndruar vetëm në anën e jashtme të tekbireve. Gjithashtu, ai nuk mjaftohet thjesht me shqiptimin e me lakimin e tekbireve me fjalë. Detyra e tij është ta kapërcejë këtë cak dhe të merret me mësimin e zemrës – me fuqinë e argumentit e me dritën e diturive hyjnore, në radhë të parë, me madhësinë e të Vërtetit dhe me kufizimin e madhësisë vetëm në Personin e pastër të të Vërtetit të gjithëfuqishëm, njëkohësisht duke theksuar nevojat e shumta, poshtërimin e mjerimin e banorëve të botës së mundësisë dhe të gjitha qenieve trupore e shpirtërore.



Më pas, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë ta ringjallë zemrën – në saje të fuqisë së ushtrimeve, lutjeve të shumta dhe kënaqësisë së plotë që ai arrin me këtë fjalë të mençur hyjnore, fjalë e cila i jep atij lumturinë e jetës mendore-shpirtërore.

Kur mbahet parasysh varfëria e të “mundshmit” e poshtërimi i tij, si dhe madhështia e të Vërtetit – e lartë është fuqia e madhështia e Tij – si dhe mendimi rreth të Lartit, atëherë përmendja e të Gjithëfuqishmit arrin cakun, në të cilin realizohet kënaqësia e qetësia në zemrën e rrugëtarit në udhën e Allahut, për rrjedhojë ai, në të gjitha qeniet, me syrin e vëzhgimit, sheh shenjat e madhësisë së të Vërtetit të Lartësuar dhe më pas për atë do të plotësohet shërimi i defekteve e i sëmundjeve të zemrës, çka i mundëson atij të shijojë kënaqësinë e bisedimit intim dhe ëmbëlsinë e përmendjes së Allahut. Në këtë gjendje, zemra e tij bëhet vendqëndrim për pushtetin e madhësisë së të Vërtetit të lartësuar. Në të brendshmen e në të jashtmen e mbretërisë së tij shfaqen gjurmët e madhësisë dhe harmonizohen e akordohen zemra me gjuhën dhe e fshehura me të dukshmen. Kur forcohet e jashtëmja dhe e brendshëmja, atëherë zotërimi e mbretërimi, të gjitha fuqitë thonë: “الله أكبر” - “Allahu Ekber” - “Allahu është më i madhi!”, atëherë ngrihet njëra mbulesë e rëndë dhe rrugëtari në udhën e Allahut afrohet në njëren etapë prej të vërtetës së namazit, që është miraxhi i afrimit.

Çështjet që u përmendën, theksohen në një hadith, i transmetuar në librin “Ilelu-Sh’sherà’i”. Në këtë hadith të gjatë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), midis të tjerash, ka thënë: “...Allahu i Lartësuar zbriti një ngarkesë me dritë. Në atë ngarkesë kishte dyzet lloje dritash, që ishin rreth e qark Arshit të Tij, Të Lartit,



Mirësidhënësit. Ato drita vezullonin si sytë e atyre që shikojnë me sy hapur.

Njëra prej atyre dritave ishte e verdhë dhe, për këtë shkak, ajo zverdhet edhe më shumë; një dritë tjetër prej atyre dritave ishte e kuqe dhe, për këtë shkak, ajo skuqet edhe më shumë.... Ai qëndroi mbi atë dritë, pastaj u ngjit lart në qiellin e kësaj bote. Menjëherë engjëjt, deri në anët e largëta të qiellit, u frikësuan dhe pastaj ranë në sexhde, duke thënë: “شُبُوحُ قُدُوسٌ رَبُّنَا وَرَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ” – “sub’bùhun, kud’dùsun, rab’bunà ue rab’bul-melàiketi uerr’rrùhi” – “I Larti mbi gjithçka, i Shenjti, Zoti ynë, Zoti i engjëjve e i Ruhut – sa e ngjashme është kjo dritë me dritën e Zotit tonë”.

Atëherë Xhibrili tha: “الله أكبر الله أكبر” - “All’lilàhu Ekber” - “Allahu Ekber!”. Engjëjt heshtën dhe qielli u hap. Engjëjt u mblodhën, pastaj erdhën dhe grupe-grupe ranë në salavat për Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).<sup>1</sup>(hadithi vijon)

Në hadithin e nderuar ka sekrete të mëdha të atilla, që shpresat tona nuk i arrijnë, megjithëkëtë, prej këtyre sekreteve mund të përmenden: sekreti i zbritjes së ngarkesës së madhe të dritës, sekreti i dritave të shumta, sekreti i llojeve të shumta të dritave, sekreti i numrit dyzet, sekreti i zbritjes së Allahut për atë, sekreti që dritat janë rreth e qark Arshit, e vërteta e Arshit në këtë pozitë, sekreti i tejzverdhjes së të verdhës e i tejskuqjes së të kuqes dhe sekreti i frikësimit të engjëjve. Pastaj sexhdeja, tesbihatet, e pastrimi i engjëjve për të Lartin, si dhe përngjasimi i atyre dritave nga ana e engjëjve me dritën e Zotit. Natyrisht që nuk kemi mundësi t’i përmendim sekretet e tjera, të shumta, që janë në

<sup>1</sup> “Illu-Sh’sherà’i”, vëll. 2, f. 312.



brendinë e hadithit të mësipërm. Për më tepër, kjo është jashtë kuadrit të studimit tonë.

Ajo që është në përshtatje me këtë pozitë dhe shërben si dëshmitar në lidhje me ato që u thamë, është heshtja e engjëjve të Allahut dhe siguria që patën prej tekbirit të Xhibrilit, grumbullimi i tyre rreth e qark pishtarit të mbledhjes e të Ndihmësit Absolut, hapja e qiellit të parë me tekbirin dhe mënjanimi i njërës mbulesë, që kishte prerë rrugën e ngjitjes lart për tek Allahu.

Këtu meriton të theksohet se mbulesat që grisen e hiqen me tekbiret e ezanit, nuk janë mbulesat që grisen me tekbiret e fillimit të namazeve. Këtë çështje, me dashjen e Allahut, do të trokasim në vijim.

Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa thënë se shkurtimi i tekbireve në ikametin vetëm me dy tekbire, ka mundësi të jetë për shkak se rrugëtari në udhën e Allahut i ka konsumuar fuqitë e tij në vendin e mbledhjes dhe deri në një farë kufiri ka kaluar prej shumësit në Njëjës, sepse rrugëtari në udhën e Allahut thotë:

“الله أكبر” - “Allahu Ekber” për Qenien e gjithëfuqishme, për emrat, për punët dhe për cilësitë, por mbase tekbiri për cilësitë e për punët është në brendësi të tekbirit për Qenien e gjithëfuqishme dhe për emrat.



## Ndarja e tretë

### DISA NGA RREGULLAT E DËSHMISË:

#### “SKA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT!”

- ” لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ” – “LÀ ILÀHE ILLE-LL’LLÀH”

### DHE SHPJEGIMI I LIDHJES SË TYRE ME EZANIN E IKAMETIN

Mëso se për hyjninë, Perëndinë, të Adhuruarin e vetëm (Uluhij’jeh), ka disa pozita, të cilat mund të mblidhen në dy pozita kryesore: njëra është pozita e asaj që në terminologjinë islame quhet “el-ulùhij’jetu-dh’ dhàtij’jeh” – “detyrimisht i adhurar” dhe tjetra është pozita “el-ulùhij’jetul-fiëlij’jeh” – “punët janë hyjnore”.

Kur qëllimi me dëshminë reduktohet në të Vërtetin, kjo është dëshmi për “el-ulùhij’jetu-dh’ dhàtij’jeh” – “detyrimisht i adhurar”. E vërteta e kësaj dëshmie është e afërt me tekbiret, edhe pse nga ana gjuhësore, si fjalë, është marrë nga rrënja e foljes: “أَلَّهَ فِي الشَّيْءِ” - “el’lehe fi-sh’shj’i” - “u hutua (në sendin)”, ose është marrë prej rrënjës “لَاهَ” - “làhe” - “u lartësua”, ose është marrë prej rrënjës së foljes “لَاهُ يُلْهُو” - “làhe jelùhu” - “u mbulua”. Në këtë gjendje, nëse do t’i referohemi studimit mbi tekbiret, bëhet e qartë lidhja e kësaj dëshmie me ezanin e me namazin. Gjithashtu, bëhet e qartë edhe etika e





dëshmisë. Por, nëse do të riktheheshim në këtë bisedë, edhe pse nuk është pa dobi, biseda do të rezultonte në kundërshtim me trajtimin e përmbledhur.

Nëse fjala është marrë nga folja “*أشهد*” – “*el'lehe*” në kuptimin “adhuroi, hyjnizoi” dhe qëllimi është për Perëndinë, për të Adhuruarin, në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë që dëshminë e tij të dukshme ta reduktojë në robërinë vetëm për të Vërtetin e lartësuar dhe patjetër që dëshmia e tij e jashtme, është në përputhje të plotë me dëshminë e brendshme, me dëshminë e zemrës. Por, nëse ai gjen në zemrën e tij ndonjë të adhuruar tjetër, atëherë ai, në dëshminë e tij, është hipokrit (munâfik).

Detyra e rrugëtarit në udhën e Allahut është që dëshminë ta çojë në zemër, me të gjitha ushtrimet e mundshme; gjithashtu, ai ka për detyrë të shkatërrojë idhujt e mëdhenj e të vegjël, që kanë skalitur duart e shejtanit dhe shpirti urdhërues për të keqen në Qaben e zemrës dhe i kanë vënë ato stivë-stivë. Me këto veprime, rrugëtari bëhet i merituar të jetë i pranishëm pranë të Pastrit, por rrugëtari në udhën e Allahut është larg rrugës që e çon atë në arritjen e qëllimit, derisa idhujt e dashurisë për këtë botë e për punët e kësaj bote vazhdojnë të jenë brenda në Qaben e zemrës së tij.

Dëshmia është një thirrje për fuqitë mbretërore e morale që ato të fillojnë të bëjnë pluhur e hi çdo të adhuruar të rremë dhe çdo qëllim të devijuar nga rruga e drejtë, pasi vetëm kështu ai do të ketë mundësi të ngjitet lart në miraxhin e afrimit.



Kur qëllimi me dëshminë reduktohet vetëm në Zotin, ajo dëshmi tregon dhe vërteton se punët janë hyjnore, janë prej Qenies së dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, domethënë se veprimi, sistemimi e ndikimi janë vetëm prej Qenies së pastër, atëherë kuptimi i dëshmisë është: pohimi se në shtëpinë e vërtetimit nuk ekziston ndonjë veprues e ndonjë ndikues tjetër në të panjohurën e në atë që shihet me sy, përveç të Vërtetit Fuqiplotë. Por, nëse në zemrën e rrugëtarit ka besim në ndonjërin prej qenieve dhe në zemrën e tij ka siguri prej ndonjë tjetri përveç të Vërtetit, në këtë gjendje, zemra e tij jo vetëm që është e sëmurë, por edhe dëshmia e tij është e stisur e mashtrim.

Në radhë të parë, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të forcojë besimin në të vërtetën se “në në gjithësi s’ka ndikues tjetër përveç Allahut”. Ky deklaram është i mbështetur me argument filozofik. Ai ka për detyrë të mos u kthejë shpinën diturive hyjnore, që janë qëllimi më i lartë për të cilin janë dërguar profetët. Gjithashtu, ai nuk duhet të largohet nga përmendja e të Vërtetit dhe e cilësive të Tij, pasi kjo është burimi i të gjitha lumturive: “ وَمَنْ أَعْرَضَ عَنْ ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا ” - “*Ue men aëreda an dhikrij fein’ne lehù meijsheten danken...*” - **“Ai që i kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë...”**<sup>1</sup>

Kur rrugëtari në udhën e Allahut, me anë të mendimit e të argumentit, arrin të vërtetën e dëshmisë, të kësaj shprehjeje të ëmbël hyjnore, që është burimi i diturive hyjnore dhe porta e portave e të vërtetave të fshehura, detyra e tij është që me këtë ai të kënaqë zemrën e vet duke vazhduar meditimin e ushtrimet, deri sa zemra të besojë në këto të vërteta. Kjo është pozita e parë për

---

<sup>1</sup> Sure “Tà Hà”, ajeti 124.



vërtetimin e dëshmisë. Shenjat e këtij vërtetimi janë: përfundimi te i Vërteti dhe prerja e shpresave për plotësimin e dëshirave prej krijesave, prej të gjitha krijesave. Nga kjo rezulton ajo që, në terminologjinë islame, quhet “et’teuhijdul-ef’âlij” - “punët janë vetëm prej të Vërtetit”. Ky besim numërohet prej pozitave më të mëdha të atyre që kanë arritur gradën e njohjes.

Kur rrugëtari në udhën e Allahun i përqendron të gjitha format e ndikimit në të Vërtetin dhe i mbyll sytë për shpresë prej të gjitha qenieve, me përjashtim të Qenies së dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, në këtë gjendje, ai bëhet i merituar për të qenë pranë të Pastrit, madje edhe zemra e tij, në saje të cilësisë së pastër të krijimit, është pranë Tij. Në të vërtetë, përsëritja e dëshmisë është për miratim dhe për të theksuar njërin prej dy dëshmimeve, dëshmi e të qenit hyjni dhe dëshmisë se punët janë prej hyjnisë. Por, çështja ka mundësi të mos qëndrojë te përsëritja, sepse njëra prej dy dëshmimeve është dëshmia e pohimit të hyjnisë dhe tjetra është pohimi se punët vijnë prej hyjnisë. Në këtë gjendje, përsëritja e dëshmisë në fundin e ezanit ka si qëllim miratimin, prandaj shikojmë se dëshmia në fundin e ezanit nuk përsëritet në formën e saj të parë.

## **Njoftim njohës**

Mëso se dëshmia ka disa gradë. Më poshtë do të përmendim vetëm disa prej atyre gradëve, që janë në përshtatje me studimin tonë.

*E para:* kuptimi i kësaj dëshmie është plotësisht i qartë. Por, nëse dëshmia me fjalë nuk shoqërohet me dëshminë e zemrës, qoftë edhe në disa prej gradëve të saj fillestare, kurrë nuk mund të jetë



dëshmi, në të kundërt është mashtrim. Këtë çështje e ka trajtuar edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në hadithin që pamë më sipër, në studimin e tekbirove.

*E dyta:* dëshmia e punëve realizohet nëpërmjet punëve të gjymtyrëve, që njeriu të pasqyrojë të vërtetën e frazës “s’ka ndikues në ekzistencë përveç Allahut”. Këtë dëshmi njeriu e pasqyron nëpërmjet praktikave e nëpërmjet punëve të tij. Por edhe dëshmia me fjalë kërkon që njeriu të mos shohë ndikues tjetër në mbarë ekzistencën përveç të Vërtetit të gjithëfuqishëm. Kështu qëndron çështja, edhe me të gjitha punët, prandaj njeriu nuk ia shtrin dorën për të plotësuar nevojat që ka, askujt tjetër përveçse të Vërtetit Fuqplotë. Gjithashtu, njeriu nuk e var shpresën në ndonjë prej qenieve, prandaj ai, para robëve të pafuqishëm, jo vetëm që nuk e shfaq nevojën, por, me qëndrimin e tij, thotë hapur se nuk ua ka nevojën të tjerëve dhe për këtë, ai nuk nxjerr sheshit, para tyre, pafuqinë e pamundësinë e vet. Kjo çështje theksohet shpeshherë në hadithet e nderuara.

Në librin “El-Kafi” lexojmë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Dinjiteti i besimtarit është kur ai nuk ua ka nevojën njerëzve*”.<sup>1</sup>

Në të gjitha gjendjet, shfaqja e mirësive dhe mospasja nevojë për asnjë njeri, janë prej moraleve të lavdëruara në ligjin e fesë, kurse lypja për plotësimin e nevojave prej njerëzve është prej veprimeve të urryera.

---

<sup>1</sup> “El - Kàfi”, vëll. 3-“El-Usûlu”, Libri “El-Imanu uel - kufriu”, K. “Mospasja nevojë për njerëzit”, Hadithi 1, f. 218.



Në përgjithësi, njeriu ka për detyrë ta konkretizojë siglën hyjnore: “s’ka ndikues në gjithësi përveç Allahut” në mbretërinë e tij të dukshme.

*E treta:* dëshmia e zemrës është burimi i dëshmimeve me vepra e me fjalë. Pa dëshminë e zemrës nuk mund të konkretizohen këto dy dëshmi. Dëshmia është dëshmi e zemrës, kur “e’teuhijdul-e’âlij” – “punët janë vetëm prej Allahut”, shkëlqen në zemrën e njeriut dhe zemra, me sekretin e saj të brendshëm, e kupton të vërtetën e thënies së mësipërme, atëherë ajo zemër ndërpret lidhjen me të gjitha qeniet dhe qëndron larg tyre. Pjesa më e madhe e haditheve të nderuara, që flasin për prerjen e shpresës prej sendeve e prej punëve që janë në dorën e njerëzve, madje prerja e shpresës prej çdo robi, besimi vetëm në Allahun e Lartësuar dhe mbështetja vetëm në Allahun e Gjithëfuqishëm, të gjitha këto, kanë lidhje me këtë pozitë.

Në librin “El-Kafi”, lexojmë se Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E kam parë të mirën të mbledhur, e gjitha në një pjesë të dëshirave të mëdha, nga ato që janë në duart e njerëzve, prandaj ai nuk shpreson prej njerëzve asnjë send, por e shtron çështjen e tij tek Allahu i Lartësuar, në të gjitha punët që ai ka dhe Allahu i Lartësuar i përgjigjet atij për të gjitha sendet”. Hadithet me përmbajtje të ngjashme janë të shumta.

*E katërta:* dëshmia personale dhe qëllimi me këtë dëshmi është ekzistenca. Kjo dëshmi është vërtetuar në të gjithë eulijatë, të cilët e shohin se kjo dëshmi gjendet te të gjitha qeniet me një rrugë apo me një rrugë tjetër.



Dëshmia e vetë të Lartit theksohet qartë në ajetin e nderuar: “هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ شَهِدُوا أَنَّ اللَّهَ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ” - “Shehide-ll’llàhu en’nehù là ilàhe il’là huve uelmelàiketi ue ulul-ilmi...” - **“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë”**.<sup>1</sup> I Vërteti i Lartësuar dëshmon – nga njëjësi në shumës - qenien e Tij Një e i Vetëm se për ekzistencën e mirëfilltë ka vetëm Një, se Ai është i qenësishëm dhe, vetëm atëherë kur të bëhet Kiameti, Ai do të shfaqet plotësisht Një e i Vetëm. Ky Një e i Vetëm, në radhë të parë, shfaqet në pasqyrën e shumësit dhe pastaj në pasqyrën e shkoqitjes. Pikërisht, për këtë Allahu i Lartësuar thotë **“engjëjt e njerëzit e dijes”**.

Këtu ka pozita prej diturish, që dalin jashtë kuadrit të studimit tonë.

## Vijim

Muhamed bin Mes’ud El-Ijashi, në tefsirin e tij, ka transmetuar prej Abdu-Samed bin Beshir: “Te Ebu Abdullahu (Paqja qoftë mbi të!) u përmend fillimi i ezanit. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) po flinte nën hijen e Qabes, ndërkaq tek ai erdhi Xhibrili me një tas me ujë prej Xheneti, e zgjoi dhe e urdhëroi të lahej me atë ujë. Pastaj Xhibrili për të vuri një milion ngjyra prej drite, pastaj me atë u ngrit në lartësi, deri sa arriti në portat e qiellit. Kur engjëjt e panë atë, u larguan me shpejtësi prej portave të qiellit

---

<sup>1</sup>Sure “Àli Imràn”, ajeti 18.



*dhe thanë: 'Dy Zota, një Zot në tokë dhe një Zot në qiell!' Menjëherë Allahu urdhëroi Xhibrilin, i cili tha: 'Allahu Ekber, Allahu Ekber!' Engjëjt menjëherë u kthyen te portat e Xhenetit. Porta u hap, ai hyri dhe vazhdoi, deri sa arriti në qiellin e dytë. Engjëjt u larguan me shpejtësi prej portave të qiellit. Atëherë ai tha: 'Esh'hedu en là ilàhe il'le-ll'illàh, Esh'hedu en là ilàhe il'le-ll'illàh' – 'Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç Allahut!' Engjëjt u kthyen dhe e mësuuan se ai ishte krijesë. Pastaj u hap porta dhe ai hyri...'”*  
Hadithi vijon.<sup>1</sup>

Në librin “El-Ilelu” ka ardhur një hadith i afërt më kuptimin e hadithit të mësipërm.

Prej këtij hadithi dhe prej haditheve të ngjashme me hadithin e mësipërm shpjegohet qartë se dëshmia: “S’ka zot tjetër përveç Allahut!”, çon në hapjen portave të qiellit, çon në grisjen e mbulesës dhe në mbledhjen e engjëjve të Allahut.

Mbulesa që u gris me dëshminë: “S’ka zot tjetër përveç Allahut!”, do të thotë grisja e mbulesës së errët e të dendur, e cila bën që rrugëtari në udhën e Allahut të qëndrojë brenda asaj mbulesë dhe të mos arrijë të jetë pranë të Pastrit. Gjithashtu, edhe moshapja e kësaj porte bën që rrugëtari të mos e gjejë rrugën nëpër të cilën ai duhet të ecë. Pikërisht kjo mbulesë është mbulesa e shumicës së punëve.

Rezultati i rënies nën mbulimin e shumtë mund të jetë mendimi se veprimi e ndikimi janë te vetë qeniet. Por ky mendim çon në mendimin se qeniet, në vetvete, janë të pavarura në veprimin e tyre, çon në delegimin e punës për shkak të pamundësisë, çon në rënien në shirkun më të madh, në një kohë që

---

<sup>1</sup>“Tefsiri El-Ijâshij”, vëll. 1, Transmetimi 530, f. 157.



dëshmia: “S’ka Zot tjetër përveç Allahut!” dhe kufizimi i kësaj dëshmie vetëm në të Vërtetin Fuqiptotë, çon në dëshminë se të gjitha punët janë prej të Vërtetit Fuqiptotë, çon në mohimin e ndikimit e të veprimit prej ndonjë tjetri dhe heqjen e pavarësisë për veprim prej të gjitha qenieve, me përjashtim të të Vërtetit të gjithëfuqishëm. Me këtë dëshmi, adhuruesit e Allahut dalin jashtë mbulesës së shumicës “një Zot në tokë dhe një Zot në qiell”. Gjithashtu, me këtë dëshmi, edhe engjëjt që ishin shpërndarë të frikësuar, u kthyen të kënaqur e u mblodhën dhe para tyre u hapën portat e qiellit.

Atëherë, për rrugëtarin në udhën e Allahut mbetet detyrë që ai, me këtë dëshmi, patjetër të grisë mbulesën e tij të errët, të hapë portat e qiellit që ka përpara dhe të hedhë hapat jashtë mbulesës së madhe, që t’i afrohet rrugës së ngjitjes në lartësi, ngjitjes në miraxhin e afrimit.

Por kjo nuk arrihet vetëm me lëvizjen e gjuhës, duke përmendur të Vërtetin vetëm me fjalë. Pikërisht, ky është shkaku që ne shikojmë se adhurimet tona nuk e kapërcejnë kufirin e të dukshmes dhe kufirin e kësaj bote, prandaj adhurimet tona nuk hapin para nesh asnjë portë e nuk grisin asnjë mbulesë.





## Ndarja e katërt

# DISA NGA ETIKAT QË LIDHEN ME DËSHMINË PËR MESAZHIN, TREGOJNË DËSHMINË PËR NJËTIMIN E ALLAHUT

Mësoje se udhëtimi shpirtëror dhe miraxhi i besimit është i pamundur të bëhet me këmbë të thyer, me frerë të këputur, me shikim të verbër dhe me zemër të errët: “يَجْعَلُ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُورٍ وَمَنْ لَمْ” - “...ue men lem jexh'ali-l'làhu lehù nùren femà lehù min nùrin” - “...atij që Allahu nuk i ka dhënë dritë, për atë nuk mund të ketë dritë”.<sup>1</sup>

Patjetër që për këtë rrugëtim shpirtëror dhe për këtë ngjitje në këtë miraxh mirënjohjeje, duhet ndjekur me këmbëngulje pozita shpirtërore e udhëzuesve në rrugën e diturisë. Këta udhëzues janë dritat në rrugën e udhëzimit dhe ndërmjetësues për të arritur tek Allahu i Lartësuar. Për këtë, patjetër, duhet të ndiqen këta udhëzues të përkushtuar në adhurimin e të Vërtetit Fuqiplotë.

Kush e ndërmerr këtë rrugë me këmbët e egoizmit, pa u bazuar në ndihmën e në kujdestarinë e udhëzuesve, rrugëtimi i tij është rrugëtim për te shejtani, është rrugëtim që çon në greminë. Me një gjuhë shkencore, themi: ashtu siç ka lidhje e reja me të vjetrën, e ndryshueshmja me të qëndrueshmen, po kështu ka

---

<sup>1</sup>Sure “En Nur”, ajeti 40.



nevojë për një ndërmjetësim dhe për një verigë lidhëse ana e të qëndrueshmes, të ndryshueshmes, të vjetrës dhe të resë. Gjithashtu, edhe ligji hyjnor kërkon moskalimin e shtimit të së vjetrës të qëndrueshme në të ndryshueshmen e re. Mosarritja e lidhjes kozmike ekzistuese në mes tyre pa ekzistuar kjo lidhje e pikëpamjet e dijetarëve që kanë arritur gradën e njohjes, pasi ato anë janë të ndryshme me këtë lidhje – por nga këndvështrimi i kësaj pune, edhe spektri i njohjes ka metodën e tij të veçantë. Gjithsesi, shkoqitja e kësaj çështjeje është jashtë kuadrit të këtij studimi. Megjithëkëtë, në përgjithësi, mund të themi se njohja në këtë (lidhje) shikohet se ajo është vërshimi i pastër dhe ekzistenca e shtrirë, që përfaqësohet me pozitën e madhe të Berzahut dhe me ndërmjetësimin e madh. Bisedën rreth kësaj çështjeje e kemi trajtuar në mënyrë të detajuar në kumtesën “Fanari i udhëzimit në rrugën e drejtë”.<sup>1</sup>

Kështu qëndron puna edhe me lidhjen ngjitëse në lartësi në botën e Berzahut, që është e kundërta e lidhjes kozmike zbritëse.

Me fjalë të tjera, kapja pas ekzistencës dhe kthimi në “çka filloi”, ka nevojë për një ndërmjetësim, ndryshe nuk mund të realizohet, domethënë se pa ndërmjetësues shpirtërorë dhe pa lidhjen e fshehtë, nuk mund të realizohet lidhja e zemrave të mangëta e të prangosura dhe e shpirtrave zbritës e të kufizuar me të Plotin dhe Absolutin nga të gjitha anët.

Për të gjitha këto, sinjalizimi i ardhur në ajetin e nderuar:

---

<sup>1</sup>“Misbàhul-hidàjeti ile-khilàfeti uelvilàjeti”, shkruar prej autorit në gjuhën arabe. Në këtë libër autori shpjegon të vërtetat dhe dituritë që kanë lidhje me kalifatin e me vilajetin. Këtë libër autori e përfundoi së shkruari në muajin Shev’vâl të vitit 1349 hixhri.



“مَا مِنْ دَابَّةٍ إِلَّا هُوَ آخِذٌ بِئِصْبَاتِهَا” - “...mà min dàb'betin il'là huve àkhidhun binàsijetiha...” - “...s'ka asnjë gjallesë që Ai (Allahu) të mos e ketë nën sundim...”,<sup>1</sup> domethënë se i Vërteti Fuqiplotë është i Përjetshmi mbi çdo qenie dhe për secilën qenie Ai ka dijeni të plotë, pa asnjë ndërmjetësim. Megjithëkëtë, njeriu bie në vorbullën e përzierjes e të përngjasimeve mes pozitive dhe konsideratave, madje arrin deri aty sa ai përzien pozitativat e shumta të gradëve të pozitës së asgjësimit të specifikimeve. Ky është një studim që s'ka lidhje të fortë me këtë kumtesë, madje edhe aq sa u tha rreth kësaj çështjeje, në të vërtetë është një lëshim i frerëve të lapsit dhe gjykimeve të kuptimeve.

Në përgjithësi, prej kërkesave të rrugëtimit për tek Allahu, është domosdoshmëri ndjekja e eulijave të mirësisë, të cilët vetë kanë bërë rrugën e ngjitjes në lartësitë e shkallëve dhe e kanë përfunduar rrugëtimitin e tyre tek Allahu. Në hadithet e nderuara ka shumë sinjalizime, që e theksojnë këtë kuptim.

El-Hurr El-Àmilij në librin e tij “El-Uesàil” ka shkruar një kapitull, në të cilin ka mbledhur materiale që theksojnë pavlefshmërinë e adhurimit të pambështetur në mësimet e imamëve.

Gjithashtu, edhe El-Kulijnij, në librin e tij “El-Kâfi”, me përcjellës prej Muhamed bin Myslimit, prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë se ky i fundit, ka thënë: “O Muhamed dije mirë se imamët e larguar nga rruga e drejtë dhe ata që i ndjekin këta imamë, janë të izoluar prej fesë së Allahut. Ata jo vetëm që kanë rënë vetë në

---

<sup>1</sup>Sure “Hùd”, ajeti 56.



*rrugën e humbjes, por çojnë edhe të tjerët në rrugën e humbjes dhe punët që ata bëjnë, janë si hiri që e shpërndan era në një ditë me stuhi”<sup>1</sup>*

Në një hadith tjetër, i ardhur prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë: *“Sikur një burrë të falë namaz gjithë natën, të agjërojë çdo ditë, të japë sadaka të gjithë pasurinë e tij, të bëjë Haxh gjatë gjithë jetës së tij, por nuk pohon kujdestarinë e mikut të Allahut dhe nuk e ndjek kujdestarin, për të gjitha punët që ai ka bërë me argument, Allahu i Lartësuar atë njeri nuk e shpërblen dhe ai nuk është prej besimtarëve”<sup>2</sup>*

Ebu Hamza Eth’themàlij ka transmetuar prej Sheh Sadukut se, kur Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka pyetur se cili truall ishte më i mirë, ai është përgjigjur: *“Allahu, i Dërguari i Tij dhe biri i të Dërguarit të Tij e di më mirë”*.

Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: *“Trualli më i mirë s’është sinori që shtrihet ndërmjet qoshes (rukn) dhe vendit të faljes (mekam). Sikur një burrë të jetojë aq sa jetoi Nuhu, në mesin e popullit të tij, nëntëqind e pesëdhjetë vjet dhe të agjërojë ditën e të falë namaz natën në këtë vendfalje, por, kur ai takohet me Allahun e Gjithëfuqishëm, pa kujdestarin, nuk do të ketë asnjë përfitim prej adhurimit që ka bërë”<sup>3</sup>*

Në këtë kapitull, njoftimet janë më shumë nga sa mund të përvetësohen prej kësaj pune të bërë me nxitim.

---

<sup>1</sup>“Vesàilu-Sh’shuj’ati”, K. 29 -“Veprimet paraprake të adhurimeve”, Hadithi 1; “El-Usùlu minel-Kàfi”, vëll. 1, f.259.

<sup>2</sup>“El-Usùlu minel-Kàfi”, Libri “El-Imanu uelkufuru”, K. “Kolonat e Islamit”, Hadithi 5.

<sup>3</sup>“Ikàbul-Amàli”, K. “Men xehile hak’ku ehlil-bejti”, Hadithi 2; “Vesàilu-Sh’shij’ati”, vëll. 1, K. 29 - “Veprimet paraprake të adhurimeve”, Hadithi 12, f. 93.



Për sa i përket dëshmisë për mesazhin e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kjo dëshmi reduktohet në faktin se rrugëtari në udhën e Allahut patjetër duhet të nxitojë, që të fusë në zemrën e tij kuptimin e dëshmisë për mesazhin e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ai është dërguar prej Allahut Fuqiplotë. Njëkohësisht, rrugëtari ka për detyrë ta bëjë zemrën e tij të kuptojë pozitën e veçantë të mbajtjes së mesazhit, veçanërisht të mesazhit të fundit, këtij mesazhi që është i lidhur me mirësinë e me virtytin e tij, i cili u ngarkua të formojë një strukturë dhe një legjislacion dhe të udhëzojë në rrugën e drejtë. Të gjitha këto detyra t'i realizojë brenda rrethit të ekzistencës së botëve të panjohura e të botëve të njohura. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është ndërmjetësuesi i bujarisë së të Vërtetit dhe lidhësi mes të Vërtetit e njerëzve. Sikur të mos ekzistonte pozita shpirtërore dhe kujdestaria e tij e pakushtëzuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), asnjëra prej qenieve nuk mund të kalonte prej pozitës së fshehtë të Njëshit dhe bujaria e të Vërtetit nuk do të shtrihej në asnjërin prej qenieve. Por, kur rrezaton drita e udhëzimit në rrugën e drejtë në ndonjërin prej botëve të dukshme e të padukshme, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është drita (udhëzimi), të cilën i Larti e ka përmendur në ajetin 35 të sures "En Nûr": "السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَالشَّمْسِ وَالْقَمَرِ وَالسَّيْرِ وَالْبُرُوجِ وَالنُّجُومِ وَالسَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَالشَّمْسِ وَالْقَمَرِ وَالسَّيْرِ وَالْبُرُوجِ وَالنُّجُومِ" - "All'llàhu nùru-s'semàvàti uel-erdi..." - "**Allahu është Drita (udhëzuesi) e qiejve dhe e tokës...**"

Sapo zemra e rrugëtarit në udhën e Allahut të arrijë të kuptojë madhësitinë e mesazhit të të Dërguarit prej Zotit të botëve, në atë zemër menjëherë hyn besimi mbi rëndësinë e madhe e mbi lartësinë e dispozitave të ligjeve. Kur e gjitha kjo bëhet e plotë për



zemrën, nënshtrohen para Tij të gjitha fuqitë e cilësitë e mbretërisë së trupit e të shpirtit dhe ligji i pastër i fesë depërton, ndikon dhe është veprues në të gjithë anët e mbretërisë së trupit të njeriut. Shenja dalluese e vërtetësisë së dëshmisë, është dalja në dukje e ndikimit të kësaj madhështie mbi të gjitha fuqitë e brendshme e të jashtme dhe mosmbetja prapa e këtyre fuqive për të mësuar përmbajtjen e këtyre ndikimeve, ashtu siç e kemi theksuar këtë edhe më përpara.

Nga sa u tha, bëhet e qartë lidhja mes dëshmisë për mesazhin dhe mes ezanit e ikametit. Rrugëtari në udhën e Allahut ka nevojë të kapet fuqishëm pas këtij personi të pastër, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Me këtë kapje, rrugëtari, me udhëtim e tij shpirtëror, ngjitet në këtë miraxh, duke u bazuar se do të jetë i shoqëruar prej Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe se do të udhëtojë sipas orientimit të tij.

Ana tjetër e dëshmisë për mesazhin, është deklarimi për fuqitë e për cilësitë e mbretërisë së trupit të njeriut se namazi është miraxhi i besimtarit dhe burimi i diturive të atyre që kanë arritur gradën e njohjes (*ma'rifetit*) dhe të dijetarëve të ndërgjegjësuar. Kjo ngjitje me shoqërues është rezultat i zbulimit të plotë të cilësive të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse ai i zbuloi ato cilësi me sjelljen e tij shpirtërore, me tërheqjet hyjnore dhe me prushin e ndezur të mëshirës gjithëpërfshirëse, që e çuan atë në pozitën “فَكَانَ قَابَ قَوْسَيْنِ” - “*fekàne kàbe kausejni..*” - “**ishte afër dy harqe**”<sup>1</sup> ose “أَذَى ” - “*ednà*” - “**dhe më**

---

<sup>1</sup>Sure “En’Nexhm”, ajeti 9.



afër".<sup>1</sup> Këto, në ndjekje të shkëlqimeve personale, të cilësive e të frymëzimeve të këndshme në praninë e Njëshit të padukshëm.

Namazi është udhëzimi në rrugën e drejtë, me të cilën Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u kthye prej atij udhëtimit moralo -shpirtëror te umeti i vet, te më i miri i umeteve – dhe për të cilin namazi u bë përgjithësues me mirësi e virtyte në mesin e mirësive hyjnore.

Kur ky besim zë vend në zemër dhe pastaj prej tij, si rezultat i përsëritjes, është e kuptueshme që rrugëtarin në udhën e Allahut shumë shpjet dhe patjetër, me dashjen e Allahut, ky udhëheqës i madh, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), do ta marrë rrugëtarin për dore, kur ai ka bërë gjithçka në bindje të urdhrave të të Vërtetit Fuqiplotë dhe shumë shpjet do ta çojë atë në pozitën e afrimit te Njëshi. Në të vërtetë, ky afrim është qëllimi origjinal dhe qëllimi për të cilin është krijuar njeriu. Dituritë teologjike kanë vërtetuar se shpresat dhe kthimi i të gjitha qenieve bëhen realitet rreth një boshti të vetëm dhe ky bosht është njeriu më i plotësuar, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **تَعَوَّدُوا كَمَا بَدَأَكُمْ**

- "kemà bed'e'ekum teùdùne..." - **"ashtu siç u filloi (u krijoi), do të ktheheni..."**<sup>2</sup>

"بِكُمْ فَحَاحَ اللَّهُ وَبِكُمْ يَجْتَمِعُ وَإِيَابَ الْخَلْقِ إِلَيْكُمْ" - *"bikum feteha-ll'llàhu ue bikum jakhtimu ue ijàbul - khalki ilejkum"* - "me ju e hapi Allahu, me ju do ta mbyllë dhe kthimi i njerëzve është te ju".<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Sure "En' nexhm", ajeti 9.

<sup>2</sup>Sure "El Arâf", ajeti 29.

<sup>3</sup>Frazë prej "Ez' zijâretul-xhâmiatu", lexo "Ujûnu-Rr' rridâ", vëll. 2, f. 272.



## Shprehje e hollë njohëse

Në librin “El-Ilelu” lexojmë: “I Dërguari i Allahut u ngjit në qiell me ndihmën e Xhibrilit dhe (me mbartës drite). Këtë dritë e zbriti Zotëruesi i madhështisë dhe me këtë dritë ata të dy, Xhibrili e i Dërguari arritën në qiellin e tretë. Engjëjt u frikësuan, ranë në sexhde dhe thanë: ‘Subhàne-ll’lilàh’ – ‘I dëlirë nga mangësitë e nevojat është vetëm Allahu!’ Xhibrili tha:

‘أشهد ان نحمدا رسول الله، أشهد ان نحمدا رسول الله’ – ‘Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!’ Engjëjt u mblodhën dhe hapën portat e qiellit dhe thanë: ‘Mirë se erdhe me të parin, mirë se erdhe me të fundit, mirë se erdhe me mbledhësin dhe mirë se erdhe me shpërndarësin, Muhamedin, vulën e profetëve!’ Atëherë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: ‘Lutuni për mua dhe më pyesni për vëllain tim, Aliun... Pastaj u ngjit me mua në qiellin e katërt, ku engjëjt nuk thanë asnjë fjalë. Unë dëgjova një gjëmim, si të ishte në kraharor dhe engjëjt u mblodhën e u hapën portat e qiellit...’<sup>1</sup>

El-Ajashi në tefsirin e tij ka sjellë një hadith të afërt me hadithin e lartpërmendur.

---

<sup>1</sup>Pjesë nga një hadith. Hadithin e plotë mund ta lexoni në librin “Ilelu-Sh’sherà’i”, vëll. 2, f. 312.





Në hadithin e mësipërm bëhet e qartë se engjëjt, në njërin prej qiejve, nuk kishin fuqi të shihnin bukurinë e Muhamedit dhe për këtë arsye ata ranë në sexhde dhe u shpërndanë të frikësuar, kur panë dritën e tij të pastër, duke llogaritur se kjo dritë, në të vërtetë, ishte drita e të Vërtetit absolut. Pastaj engjëjt u kthyen në gjendjen e njerëzve me këndimin e Xhibrilit të frazave të ezanit e të ikametit. Menjëherë u hapën portat e qiejve e u ngritën mbulesat.

Duke u nisur nga ky hadith, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të dalë jashtë mbulesave, me ndërmjetësinë e këtyre dëshmimeve, në mënyrë të veçantë, të dalë jashtë prej mbulesës së përcaktimit moral. Atëherë pozita e mbajtësit të “mesazhit”, pozita e më të nderuarit ndër njerëzit, është pozita e asgjësimit absolut, është pozita e pavarësisë së plotë dhe kjo për shkak se mesazhi mbyllës absolut, është kalifati hyjnor i Berzahut të madh, është kalifat në shfaqje, në shkëlqim, në ndërtim e në legjislacionin, prandaj kalifi nuk duhet të ketë pavarësi dhe të vetëmërohet, në çfarëdo forme qoftë. Por kjo është e pamundur të realizohet për asnjërën prej qenieve.

Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të çojë pozitën e kalifatit madhor Ahmedian në thellësi të zemrës e të shpirtit të tij dhe, me ndërmjetësinë e kësaj pozite, të heqë mbulesat, të grisë perdet dhe të dalë plotësisht jashtë mbulesave, sjelljeve të dukshme. Kur kjo plotësohet për rrugëtarin, atëherë për të hapen të gjitha portat e qiejve dhe ai bëhet së bashku me qëllimin e tij, pa asnjë mbulesë.



## Ndarja e pestë

### DISA NGA ETIKAT E THIRRJES: “EJA NË NAMAZI” DHE “EJA NË SHPËTIM”

Rrugëtari në udhën e Allahut me tekbiret shpall madhësinë e të Vërtetit Fuqplotë dhe, kur e përshkruan me cilësinë “më i Madh”, në fakt, ai e falënderon të Vërtetin dhe pohon se çdo ndikim vjen vetëm prej të Vërtetit të lartësuar. Pas tekbireve, ai dëshmon se Zot është vetëm Allahu. Me këtë dëshmi ai e ul poshtë veten nga aftësia për të bërë punë, ndërkaq zgjedh shokun e shoqëruesin për udhëtimin e tij dhe, këtë zgjedhje ai e bën me dëshminë për mesazhin e ndihmën, duke u kapur fort pas pozitës së pastër të kalifit e të kujdestarisë, ashtu siç thuhet “shokun para rrugës”.<sup>1</sup> Në këtë gjendje, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë t’i përgatisë fuqitë e veta morale e fizike për namazin. U bën thirrje fuqive të tij, që edhe ato të përgatiten për namazin e të jenë të pranishme në namaz. Pikërisht, për këtë, ai thotë “حِي عَلَى الصَّلَاةِ” - “haj’je ale-s’ salàt” - “Eja në namaz!”. Përsëritja e kësaj thirrjeje bëhet për të plotësuar tërheqjen e plotë të vëmendjes e të ndërgjegjësimit, ose njëra thirrje është thirrje për fuqitë e tij të brendshme, kurse thirrja tjetër është për fuqitë e tij të jashtme, pasi këto fuqi e

---

<sup>1</sup>“Vesàilu-Shij’ati”, vëll. 8, Libri “Haxhi”, K. 30 - “Edukata e udhëtimit”, Hadithi 11, f. 299.



shoqërojnë njeriun në rrugëtimin e tij, ashtu siç e kemi theksuar këtë fakt më përpara dhe ashtu siç do ta theksojmë edhe në vijim.

Në këtë pozitë, rrugëtari ka për detyrë, që fuqive të veta, zemrës, të brendshmes së zemrës t'i bëjë të kuptojnë se janë afër të Pastrit dhe për këtë ato duhet të përgatiten, duke shkatërruar e duke shembur, në mënyrën më të plotë, të gjitha përfytyrimet figurative e morale.

Pastaj ai shpall sekretin e namazit në mënyrë të përgjithshme me thirrjen: “حي على الفلاح” - “haj'je alet-felâh” - “Eja në shpëtim!” dhe “حي على خير العمل” - “haj'je alâ khajril-amel” - “Eja në punën më të mirë!”. Me këtë thirrje, rrugëtari në udhën e Allahut zgjon e ndërgjegjëson cilësinë e pastër, me të cilën është krijuar. Shpëtimi e fitorja, në të vërtetë, theksojnë lumturinë absolute, për më tepër, vetë cilësia e pastër e krijimit të çdo njeri e dashuron lumturinë absolute, madje vetë cilësia e pastër e krijimit nxiton drejt plotësisimit e qetësisë, duke theksuar se e vërteta e lumturisë është plotësimi absolut dhe qetësia absolute.

Me këtë thirrje, rrugëtari në udhën e Allahut shpall afërsinë pranë të Pastrit, duke theksuar se namazi, sipas formës dhe sipas asaj që shihet, është dhikri më i madh i plotësuar dhe është lavdërimi me emrin më të madh gjithëpërfshirës, për të gjitha punët hyjnore. Për të gjitha këto, ezani dhe ikameti fillojnë e përfundojnë me fjalën “الله” - “Allah”. Gjithashtu, për këtë shkak është edhe përmendja e Allahut me frazën “الله أكبر” - “Allahu Ekber” - “Allahu është më i madhi!”, në të gjitha fazat e pjesëte namazit. Pikërisht, ky është edhe shkaku që dëshmitë (dëshmitë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut) janë



kënaqësia e syve të eulijave, kënaqësi që realizohet me namazin. Me këtë kënaqësi përzihet forma e asgjësimit absolut dhe kthimi i plotë.

Gjithashtu, sipas së brendshmes dhe së vërtetës, namazi është miraxhi, është ngjitja në lartësi për t'u afruar pranë Qenies së pastër. Pikërisht këtë afrim e dashuron aq shumë cilësia e pastër e krijimit. Por me namazin arrihet edhe qetësia e siguria e plotë e zemrës, arrihet qetësia absolute dhe lumturia mendore:

“أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ” - “...elà bidhikri-l'làhi tatmein'nul-kulùbu” - “...me përmendjen e Allahut qetësohen e sigurohen zemrat”.<sup>1</sup>

Pra, plotësimi absolut është afrimi në oborin e Allahut dhe lidhja me detin pa anë e pa fund me detyrën për të parë Bukurinë e përjetshme dhe për t'u zhytur në detin e Dritës absolute. Të gjitha këto realizohen në namaz. Gjithashtu, namazi çon në arritjen e qetësisë absolute dhe në pushimin e plotë, çon edhe në sigurinë e qetësinë e plotë të zemrës. Kjo do të thotë se dy kolonat e lumturisë bëhen realitet në namaz, atëherë rezulton se namazi është shpëtimi absolut dhe puna më e mirë.

Rrugëtari në udhën e Allahut e bën zemrën e tij ta kuptojë këtë shprehje hyjnore të bukur, duke e përsëritur atë, duke menduar thellë për kuptimin e saj dhe duke zgjuar e duke ndërgjegjësuar cilësinë e pastër, me të cilën është krijuar. Pasi kjo shprehje e bukur hyn në zemër, shumë shpejt për këtë shprehje do të interesohet edhe cilësia e pastër e krijimit, për faktin se vetë cilësia e pastër e krijimit punon me ngulm për plotësimin e për lumturinë. Me këtë shprehje, ai që fal namaz, e ruan cilësinë e pastër

---

<sup>1</sup>Sure “Er Rrad”, ajeti 28.



të krijimit dhe e mban atë nën kontroll. Urtësinë e përsëritjes së kësaj shprehjeje e kemi theksuar edhe më përpara.

Kur rrugëtari në udhën e Allahut arrin në këtë pozitë, ai e shpall realizimin e pranisë me frazën: “قد قامت الصلاة” - “*kad kàmeti-s'salât*” - “namazi filloi”. Në këtë pozitë, ai ka detyrë ta shohë veten se është në audiencën e Mbretit të mbretërve, është para Mbretit të botëve të ekzistencës, është para Pushtetarit të pushtetarëve dhe para të Madhit absolut. Rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë t'i bëjë të njohur zemrës së vet rëndësinë e madhe të kësaj pranie, e cila, e gjitha, kthehet në “mangësinë e mundshme e në lënien mangët të mundshme”. Pastaj ai bën përpara plotësisht i turpëruar, për shkak se nuk është i përshtatshëm për të punuar. Në këtë gjendje, ai hyn në audiencën e pastër, me hapat e frikës e të shpresës, duke dalë para Bujarit absolut dhe nuk sheh se pranë tij janë furnizimet e mjeti i udhëtimit. Zemrën e tij ai e konsideron të sëmurë. Gjithashtu, ai mendon se puna e tij nuk është prej punëve të mira dhe se puna e tij është pa asnjë vlerë. Shpresohet shumë që atë e përfshijnë butësitë hyjnore, nëse ky kuptim mundësohet prej zemrës së tij, e cila gjen siguri me Atë: “أمنٌ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ” - “*Em'men juxhijbul-mundhtarr'rre idhà deàhu ue jekshifu-s'sùe...*” - “**Aii përgjigjet nevojtarit, kur ai e thërret (i kërkon ndihmë) dhe Ai ia largon atij të keqen...**”<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Sure “En-Neml”, ajeti 62.



## Vijim e plotësim

Muhamed bin Jakubi me përcjellës prej Ebu Abdullahut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se ai ka thënë: “Kur ti thërret ezanin dhe këndon ikametin, prapa teje falin namaz dy safë engjëjsh dhe, kur këndon vetëm ikametin, prapa teje fal namaz një safë engjëjsh”.<sup>1</sup>

Hadithet me këtë përmbajtje janë të shumta dhe në disa nga këto hadithe thuhet se safi i engjëjve është i gjatë sa largësia ndërmjet lindjes e perëndimit.<sup>2</sup>

Në librin “Thevàbul-Amàl” citohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që fal namaz me ezan e me ikamet, prapa tij falin namaz dy safë engjëjsh dhe, ai që e fal namazin me ikamet pa ezan, prapa tij fal namaz një saf me engjëj”. Përcjellësi e ka pyetur sa i gjatë është çdo saf dhe ai është përgjigjur se safi më i shkurtër është sa largësia ndërmjet lindjes e perëndimit dhe safi më i gjatë është sa largësia ndërmjet qiellit e tokës”.<sup>3</sup>

Në transmetime të tjera theksohet se ai që këndon ikametn dhe nuk thërret ezanin, në anën e djathtë të tij qëndron një engjëll dhe në anën e tij të majtë qëndron një engjëll tjetër.<sup>4</sup> Mbase ky ndryshim në numrin e engjëjve është për shkak të ndryshimit të nivelit të diturive dhe të sinjeritetit të çdo njeriu që fal namaz. Gjithashtu, për këtë tregojnë edhe transmetimet e ardhura në lidhje

---

<sup>1</sup>“Elfurùë minel - Kàfi”, vëll. 3, Libri “Namazi”, K. “Ezani dhe ikameti”, Hadithi 8, f. 303.

<sup>2</sup>Thevàbul - Amàl”, “K. “Shpërblimi i atij që e fal namazin me ezan e me ikamet”, Hadithi 2, f. 54.

<sup>3</sup>Po aty.

<sup>4</sup>Vesàilu-Sh’shij’ati”, Libri “Namazi”, K. 4 - “Ezanit e ikameti”, Hadithi 4.



me namazin që falet me ezan dhe me ikamet në shkretëtirë, ose në toka të pabanuara.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, kur rrugëtari në udhën e Allahut e kupton se ai është imami i engjëjve, njëkohësisht mendon se zemra e tij është imam për fuqitë morale e fizike dhe se falë këtyre fuqive, ai ka bërë që, me ezanin e me ikametin, tek ai të mblidhen engjëjt e Allahut, prandaj detyra e tij është që ta bëjë zemrën, si fuqia më e lartë e dukshme dhe e brendshme, ta bëjë zemrën ndërmjetësuese e imam për të gjitha fuqitë.

Zemra është garantuesi i vlefshmërisë së leximit të besimtarëve. Gjithashtu, zemra mban edhe barrën e të tjerëve, prandaj rrugëtari ka për detyrë t'i ruajë dhe t'i kontrollojë sa më mirë të gjitha këto fuqi. Por që ai ta ruajë shenjtërinë e pranisë, duhet të stoliset me etikën e pozitës së pastër dhe këtë mbledhje të shenjtë ta konsiderojë një rast prej të cilit duhet të përfitojë. Në këtë rast, ai jo vetëm që përvetëson madhësinë e orientimit të engjëjve të Allahut, por arrin edhe mbështetjen e tyre. Njëkohësisht, ai njih madhësinë e Mirësidhënësit të vërtetë. Në këtë gjendje, ai bën përpara për në pozitën e pastër, duke pohuar pamundësinë dhe mangësinë e tij me falënderimin për këto mirësi të mëdha dhe kujdesi për dhënien e mirësive është vetëm në dorën e Allahut të Lartësuar.

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm, Hadithi 9.



## KAPITULLI I DYTË

### QËNDRIMI NË KËMBË

#### Ndarja e parë

#### SEKRETI I QËNDRIMIT NË KËMBË

Mëso se ata që kanë arritur gradën e njohjes, qëndrimin në këmbë e numërojnë tregues të Njëtimit të punëve, rukunë e numërojnë tregues të Njëtimit të cilësive dhe sexhden e numërojnë tregues të Njëtimit të Qenies. Më poshtë, në vendin përkatës, do të vijë shpjegimi për gjithçka që lidhet me rukunë e me sexhden.

Pse themi se qëndrimi në këmbë është tregues për Njëtimin e punëve? Them i kështu, sepse vetë qëndrimi në këmbë, nga ana e gjendjes, nga ana e leximit dhe nga ana e fjalës, të gjitha këto janë tregues të kësaj pozite.

Për sa i përket treguesit se qëndrimi në këmbë është gjendje në këtë pozitë, sepse në këtë gjendje theksohet qëndrimi në këmbë i robit para të Vërtetit, gjithashtu theksohet edhe pozita e “përvetshmerisë” së të Vërtetit. Në këtë shkëlqim shfaqet pozita vepruese e të Vërtetit, asgjësimi i të gjitha qenieve në shkëlqimin dhe shkrirja e qenieve nën fuqinë e madhështinë së dukshme.





Etika njohëse për rrugëtarin në udhën e Allahut, në këtë pozitë, përfaqësohet në punën e madhe, për ta bërë zemrën që ajo ta përmendë këtë shprehje të thellë hyjnore, duke hequr dorë prej cilësive vetjake me aq sa është e mundur, duke e bërë zemrën që ajo të përmendë të vërtetën e vërsimit të pastër, si dhe duke çuar në thellësi të zemrës lidhjen e përjetshmërisë së të Vërtetit dhe vënien e njerëzimit në rrugë të drejtë me të Vërtetin.

Kur kjo e vërtetë fiksohet në zemrën e rrugëtarit në udhën e Allahut, leximi i tij bëhet me gjuhën e të Vërtetit, përmendësi e i përmenduri bëhet vetë i Vërteti dhe për zemrën e dijetarit zbulohen disa sekrete, disa cilësi e disa gradë: *“Ti je ashtu siç e lavdërove veten Tënde”*<sup>1</sup>. Zemra e dijetarit kupton disa prej sekreteve të namazit. Edhe shikimi në vendin e sexhdes, që është toka, venddalja origjinale dhe ulja e kokës, tregon përluljen e madhe, nevojën e mundshme dhe asgjësimin nën fuqinë e pushtetit të madhështisë: *“النَّبِيُّ الْحَمِيدُ وَاللَّهُ هُوَ يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَسْمُ الْفُقَرَاءِ إِلَى اللَّهِ”* - *“Jà ej'juhe-n'nàsu entumul-fukaràu ile-ll'Ilàhi uell'Ilàhu huvel-ganij'jul-hamijdu”* - **“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë te Allahu, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd”**.<sup>2</sup>

Leximi është fjalë dhe kjo tregon pozitën e Njëtitimit të punëve. Me dashjen e Allahut, shumë shpejt do të shpjegohet gjatë interpretimit të sures “El Fàtiha”.

<sup>1</sup>Pjesë nga lutja e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në sexhde; Lexo “EIFurù'u minel-Kâfi”, vëll. 3, f. 324.

<sup>2</sup> Sure “El Fatir”, ajeti 15.



## Ndarja e dytë

### ETIKA E QËNDRIMIT NË KËMBË

Etika e qëndrimit në këmbë përmbledhet në domosdoshmërinë e besimit nga ana e rrugëtarit në udhën e Allahut, se ai është i pranishëm pranë të Vërtetit dhe bota është vendmbledhja e hyjnisë. Gjithashtu, ai e konsideron veten prej të pranishmëve në kuvendin e Allahut dhe prej atyre që qëndrojnë në këmbë para Tij. Njëkohësisht, ai beson se zemra e tij e përvetëson madhështinë e qëndrimit pranë të Vërtetit. Ai punon shumë shpejt, që t'i japë zemrës të kuptojë rëndësinë e madhe të bashkëbisedimit në vetmi me të Vërtetin e lartësuar, që ajo ta ndiejë këtë bashkëbisedim intim. Veç kësaj, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të punojë shumë, që ta përgatisë zemrën para se ai të hyjë në namaz dhe, këtë përgatitje të zemrës, ai e bën nëpërmjet mendimit e meditimit, duke e bërë zemrën të kuptojë rëndësinë e madhe të pozitës dhe duke e mbushur atë me përlujtje, me nënshtrim, me siguri, me frikë, me shpresë, me poshtërim dhe me mjerim deri në fundin e namazit, njëkohësisht i vë zemrës kusht që jetë korrekte në mbikëqyrje e në ruajtjen e këtyre punëve.

Në të njëjtën kohë, rrugëtarit në udhën e Allahut i kërkohet të mendojë e të meditojë rreth gjendjeve të krerëve të fesë e të udhërrëfyesve, atij i kërkohet të mendojë rreth gjendjeve që ata kalonin gjatë faljes së namazit dhe rreth mënyrës së bashkëpunimit të tyre me Mbretin e mbretërve, prandaj rrugëtari i merr imamët



udhëzues në rrugën e drejtë shembull për t'i ndjekur dhe punon shumë, që të shoqërohet me ta. Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të mos mjaftohet vetëm me mësimin e historisë së udhëheqësve të fesë dhe të imamëve të ruajtur prej gjynaheve, thjesht duke ditur datat e vdekjes e të lindjes së tyre, sa vjet kanë jetuar dhe të tjera gjëra të ngjashme, që nuk numërohen prej punëve që nuk i sjellin ndonjë përfitim në rrugëtimin e tij. Gjithashtu, ai ka për detyrë të marrë mësim e këshillë prej jetëshkrimit të tyre dhe prej sjelljeve të tyre në fushën e besimit e të diturisë. Veç kësaj, ai ka për detyrë të njihet edhe me rrugët nëpërmjet të cilave ata kanë shprehur robërinë dhe patjetër të njihet me rrugëtimin e tyre për tek Allahu dhe me pozitave të tyre të diturisë, të njihet me punët e tyre e me fjalët e lavdërueshme që kanë ardhur prej tyre, sepse fjalët e punët e tyre janë argumente me rëndësi të madhe. Të gjitha këto ai i merr si bazë në rrugëtimin e tij për tek Allahu.

Por, mjerim i madh për ne të shkujdesurit, mjerim për ne të dehurit me narkozën e natyrës, ne mendjemëdhenjtë, mendjelehtët, që u bindemi urdhrave të shejtanit në të gjitha punët, urdhra që shejtani i përplas në veshët tanë, ne që nuk zgjohemi prej gjumit tonë të rëndë. Për ne kurrë s'ka dalje prej luginës së harrimit, që asnjëherë nuk qetësohet. Ne përfitojmë fare pak prej pozitive e prej diturive të imamëve udhëzues në rrugën e drejtë, ose ne përfitojmë prej tyre aq pak, sa nuk vlen të përmendet. Ne mjaftohemi duke u njohur vetëm me lëvoren e jetëshkrimit të tyre, mjaftohemi vetëm me anën e jashtme të jetës së tyre dhe nuk shikojmë fare qëllimin e lartë për të cilin u dërguan profetët. Në fakt dhe realisht, për ne vërtetohet plotësisht shprehja proverbiale e njohur: "U shëndosh i traumatizuar".



Në vijim do të shpalosim disa transmetime që kanë ardhur në lidhje me këtë kapitull, duke shpresuar se këto transmetime do të jenë këshillë për disa vëllezër besimtarë. Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun!

Muhamed bin Jakubi ka transmetuar prej Ebu Abdullahut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndronte në këmbë në namaz i ndryshonte ngjyra dhe, kur binte në sexhde, nuk e ngrinte kokën, deri sa djersinte”.<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Babai im thoshte se, kur Ali bin Hyseni qëndronte në këmbë në namaz, dukej si trangu i një peme prej të cilës nuk lëviz asnjë send, me përjashtim të gjërave që i lëvizte era”.<sup>2</sup>

Në librin “El-Ilelu”, me përcjellës prej Eban bin Taglebit, lexojmë: “Kur i thashë Ebu Abdullahut (*Paqja qoftë mbi të!*) se kisha parë Ali bin Hysenin, se gjatë qëndrimit në këmbë në namaz i ndryshonte ngjyra e fytyrës, ai më tha: ‘Pasha Allahun! Ali bin Hyseni e dinte mirë para kujt qëndronte në këmbë’”.<sup>3</sup>

Në një hadith të gjatë, që e citon Ibn Tausi në librin “Felâhu-S’sàili”, lexojmë se Ebu Abdullahu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazi plotësohet vetëm për një të pastër, i plotë, i pjekur, që nuk është as ngatërrestar e as mashtrues. Ai mëson dhe ndalon; ai e mëson ligësinë dhe i reziston asaj; qëndron në mes dëshpërimit, dëshirës, durimit e padurimit, sikur premtimi për të realizohet dhe sikur kërcënimi bie mbi të; ai e ul poshtë nderin e vet dhe përfaqëson ndodhitë e rastësishme; për hir

---

<sup>1</sup>“ElFurû’u minel-Kâfi”, vëll. 3, Libri “Namazi”, K. “Nënshtrimi në namaz dhe neveria prej lëvizjeve të kota”, Hadithi 5, f. 300.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 4.

<sup>3</sup>“Vesâilu-Sh’shij’ah”, Libri: “Namazi”, K. 2- “Punët e namazit”, Hadithi 4.



të Allahut, ai e poshtëron zemrën e gjënë më të mirë që ka; merr rrugën që çon në Haxh, pa u turpëruar prej asgjëje që mund të ndërpresë lidhjet e interesimit ndaj Atij që ai ka qëllim dhe te i Cili do të shkojë dhe prej të Cilit i vjen vdekja. Dhe, kur ai arrin në këtë pozitë, namazi është namazi i urdhëruar dhe për të cilin ai është njoftuar; është namazi që ndalon nga punët e turpshme e nga punët e urryera...<sup>1</sup>

Muhamed bin Jakubi ka transmetuar prej zotërisë sonë, Zejnel Abedinit (Paqja qoftë mbi të!): “Në namaz, ti, pa dyshim, je para Allahut dhe, kur ti e di këtë, e di se je krijuar që në namaz të qëndrosh në këmbë siç qëndron skllavi i poshtëruar, i cili shpreson i frikësuar e i tmerruar; edhe pse i mjeruar e i nënshtruar, ai e njeh madhësinë e pozitës së personit para të cilit qëndron në këmbë në heshtje të plotë, me dinjitet e me gjymtyrë të nënshtruara, me krenari të zbutur, me bisedim të bukur intim në shpirtin e tij dhe duke kërkuar tek Ai hapësin e prangave, me të cilat ia ka rrethuar qafën gjynahu i vet. Ai e di se e kanë konsumuar fajet që ka bërë, por e di se s’ka fuqi tjetër përveçse me Allahun”.<sup>2</sup>

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Adhuroje Zotin tënd, sikur e ke para syve, edhe pse ti nuk e sheh Atë! Të jesh i sigurt se Ai të shikon ty”.<sup>3</sup>

Prej fik’hut të Imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: “Kur të ngrihesh për të falur namaz, mos u ngri me përtaci, jo duke dremitur, ngrihu pa u nxituar dhe jo i shkujdesur. Shko në namaz me qetësi të plotë, me dinjitet e me dashuri. Ke detyrë të dalësh para Allahut i nënshtruar dhe kryeulët, gjithnjë i frikësuar dhe duke shpresuar me sigurinë e zemrës, pa druajtje e me kujdes. Qëndro

<sup>1</sup>“Felâhu-S’âili”, Ndarja e dytë “Cilësia e namazit”, f. 23. (hadithi vijon)

<sup>2</sup>“Mustedreku Vesâili-Sh’shij’ati”, Libri “Namazi”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 3.

<sup>3</sup>“Mekârimul-Akhlâk”, f. 459; “Bihârul Enuâr”, vëll. 74, f. 74.



para Tij siç qëndron skllavi i arratisur e fajtor para pronarit të vet. Pastroi këmbët, përqendroje veten, mos e kthe kokën djathtas e majtas dhe llogarit sikur ti je duke e parë Atë, edhe pse në të vërtetë nuk e shikon, por Ai patjetër ty të shikon...<sup>1</sup>

Në librin “Ud’detu-D’dàij”, transmetohet se rënkimi i Ibrahimit dëgjohej një milje larg dhe për këtë, atë e lavdëron Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij: “لَنْ يُرَاهِمَ أَحَدٌ أُوَاءَ مُنِيبٌ” - “in’ne Ibràhijme le halijmun ev’vâhun munijbun” - **“Vërtet, Ibrahim i ishte i butë, i dhembshur e vazhdimisht i kthyer (tek Allahu)”**<sup>2</sup>. Në namazin e Ibrahimit dëgjohej një gumëzhinë si gumëzhima e bolierit. Një gumëzhinë e këtillë dëgjohej edhe prej gjoksit të Profetit tonë, të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Edhe Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*), në namaz, merrte frymë me zor nga frika e Allahut<sup>3</sup>.

Ka edhe njoftime të tjera që kanë ardhur për këtë çështje, por janë aq shumë, sa ne nuk mund t’i shkruajmë ato një për një, prandaj burrat që përmendin Allahun, ata që mendohen mirë e ata që studiojnë, janë mjaftuar vetëm me hadithet që sollëm më sipër, me qëllim që të mësojnë gjithçka që lidhet me etikën formale e të dukshme, me etikën morale të zemrës dhe me mënyrën e qëndrimit në këmbë para Allahut të Lartësuar.

Mendo pak për gjendjen e Ali bin Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) dhe për lutjet e tij të holla, nga të cilat robtë e Allahut mësojnë etikën e robërisë. Me këtë fjalë nuk kam qëllim bisedimin intim të

---

<sup>1</sup>Mustedreku Vesàili-Sh’shij’ati”, Libri “Namazi”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 7. (hadithi vijon)

<sup>2</sup> Sure “Hud”, ajeti 75.

<sup>3</sup>Burimi i mësipërm, K. 2, Hadithi 15.



atyre të mëdhenjve, të cilët, me veprimet e tyre, kishin për qëllim të mësonin njerëzit. Kjo nuk është fjalë boshe, as fjalë e gabuar, e dalë prej injorancës, por është fjalë që shpjegon pozitën e afrimit të Zotit krijues dhe e përcjellë prej dijetarëve të Ehli Bejtit, të cilët ishin njerëzit që kishin më shumë frikë dhe ishin njerëzit më të nënshtruar ndaj të Vërtetit të lartësuar. Kjo, për faktin se madhështia e të Vërtetit Fuqiptotë kishte shkëlqyer në zemrat e tyre më shumë nga sa kishte shkëlqyer në ndonjë zemër tjetër. Për këtë, unë them se robtë e Allahut kanë për detyrë të mësojnë prej tyre robërinë dhe rrugëtimin për tek Allahu. Gjithashtu, kanë për detyrë që, kur të këndojnë lutjet dhe, kur të bisedojnë në vetmi me frazat e njohura, të ardhura prej tyre, të mos i reduktojnë lutjet e frazat e meditimit në lakime të gjuhës, por këto duhet të shoqërohen me mendimin e thellë. Lutjen dhe bisedën intime ta bëjnë mbi bazën e mënyrave të bashkëpunimit të tyre me të Vërtetin dhe të shfaqin si ata përlulen deri në shkallën më të ulët, të shfaqin pamundësinë e nevojën e madhe që kanë, si dhe mënyrën për t'iu përkushtuar vetëm Qenies së pastër.

Patjetër që jeta e të dashurit, Ali bin Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte prej mirësive më të mëdha, që i Vërteti u ka dhuruar robërve të Allahut. Allahu i Lartësuar e zbriti këtë zotëri të nderuar prej botës së afrimit të pastër, me qëllim që t'iu bënte robëve të Tij të kuptojnë rrugët e robërisë: "مِمَّ لِنَسْأَلُ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ" - "*thum'me letus'elun'ne jeumeidhin ani-n'nejmi*" - "**pastaj në atë ditë do të pyeteni për të mirat**".<sup>1</sup> Kur ne do të pyetemi për shkakun që nuk kemi dijani, për vlerën e kësaj mirësie të madhe dhe cili ishte shkakun që nuk na la të përfitonim prej ekzistencës së këtij të madhi, si do të përgjigjemi?!

<sup>1</sup>Sure "Tekathur", ajeti 8.



A nuk është kjo një djegie me zjarrin e pendimit e të keqardhjes? Por, atë ditë koha e pendimit ka përfunduar.

### **Këshillë e mirë**

I dashur, përveshi krahët e vullnetit dhe mbushe veten me vendosmëri, meqenëse ke rastin të udhëtosh dhe je në këtë jetë, që është pasuria jote më e çmuar. Përpara teje shtrihet rruga e udhëtimit, por edhe portat e mëshirës së të Vërtetit janë të hapura para teje. Shfrytëzoi gjymtyrët, deri sa ato të jenë të shëndetshme e të fuqishme; deri sa ferma e botës së mbretërimit akoma nuk i ka mbledhur prodhimet e veta. Detyra jote është të njohësh vlerën e këtyre mirësive hyjnore dhe të përfitosh nga mirësitë e shumta që të janë dhënë, për të arritur plotësimet shpirtërore dhe lumturitë e përhershme e të përjetshme. Mbaje parasysh se detyra jote është të përfitosh prej të gjitha diturive, që shpalos para teje në qilimin e tokës së natyrës së errët Kur’ani Famëlartë dhe i shpjegojnë qartë për ty imamët e ruajtur prej gjynaheve; mbaje gjithmonë parasysh se janë pikërisht këto dituri që kanë ndriçuar botën me dritat vezulluese hyjnore.

Që të ndriçohet toka e natyrës tënde të errët, gjithashtu, që të ndriçohesh edhe ti vetë, që të ndriçohet syri yt, veshi yt, gjuha jote dhe të gjitha fuqitë e tua të dukshme e të brendshme, me dritën e të Vërtetit Fuqiplotë dhe që kjo tokë e errët të shndërrohet në “tokë e ndriçuar”, madje të shndërrohet në qiellin logjik, dije se ka një ditë: “يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ” - “jeume tubed’delul-erdu gajrul-erdi...” -





“Ditën kur toka shndërrohet në tokë tjetër jo si kjo tokë...”<sup>1</sup>, وَأَشْرَقَتْ  
 الْأَرْضُ بِنُورِ رَبِّهَا - “ue eshrekatil-erdu binûri rab'bihà...” - “Dhe toka është  
 ndriçuar me dritën e Zotit të saj...”<sup>2</sup>. Nëse në atë ditë toka jote nuk  
 është shndërruar në “tokë tjetër jo si kjo tokë” dhe, nëse ajo nuk  
 është ndriçuar me dritën e Zotit të saj, patjetër që para teje janë  
 errësitat, gjendjet e vështira dhe format e ndryshme të frikës,  
 presionit, poshtërimit e ndëshkimit.

Tani fuqitë tona të dukshme e të brendshme janë të errësuara  
 me errësitat djallëzore, janë të rrethuara edhe me frikë. Sikur ne të  
 qëndrojmë në këtë gjendje, toka ranore, e ndriçuar me dritën e  
 cilësisë së pastër të krijimit, gradualisht shndërrohet në një tokë  
 “burg”, në një tokë të errët dhe e zhveshur nga drita e cilësisë së  
 pastër e krijimit. Në tokën që ishte e mbuluar nga të gjitha  
 dispozitat hyjnore të cilësisë së pastër të krijimit, pas shndërrimit,  
 ka vetëm vështirësi, vuajtje, errësi dhe s’ka dritë që të shkëlqejë  
 në të. Kjo tokë është bërë panik e frikë. Në të s’ka siguri e qetësi, por  
 ka vetëm ndëshkim, pas të cilit nuk vjen qetësi e pushim: *يَجْعَلُ اللَّهُ لَهُ*  
*”ثَوْرًا فَمَا لَهُ مِنْ نُورٍ وَمِنْ لَمْ* - “...ue men lem jexh’ali-l’lâh lehù nùren femà lehù min  
 nûrin” - “Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më  
 dritë”.<sup>3</sup> Allahu i Lartësuar na ruajttë prej formave të  
 mendjemadhësisë djallëzore dhe prej shpirtit urdhërues për të  
 keqen!

Si bazë, qëllimi i profetëve të mëdhenj, zbritja e  
 legjislacioneve, vënia e dispozitave dhe zbritja e librave qiellorë,  
 veçanërisht e Kur’anit Famëlartë, zbritja e këtij Libri përgjithësues,

<sup>1</sup>Sure “Ibrahim”, ajeti 8.

<sup>2</sup>Sure “EzZumer”, ajeti 69.

<sup>3</sup>Sure “En Nûr”, ajeti 40.



me të cilin ka vërshuar e është zbuluar drita e pastër e të Dërguarit të fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si bazë për të gjitha këto, është përhapja e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), është përhapja e diturive hyjnore, është shkulja e rrënjëve të mohimit e idhujtarisë dhe shkulja e rrënjëve të dualizmit në mendim e në adhurim. Sekretin që lëviz në të gjitha adhurimet e zemrës e në të gjitha adhurimet klishe, pa dyshim që është teuhidi e texhridi – besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe zhveshja prej çdo lloj besimi tjetër, madje “qëllimi i të gjitha adhurimeve është që besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, të rrjedhë nga brendësia e zemrës në të gjithë mbretërinë e trupit”, ashtu siç ka thënë shehu e dijetari i plotësuar Shah Abadj (Kurban ia bëfsha shpirtin tim!).

Në përgjithësi, rezultati i dukshëm prej adhurimeve përfaqësohet në arritjen e diturive dhe futjen në zemër e teuhidit (besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe të diturive të tjera. Por kjo nuk mund të realizohet, nëse rrugëtari nuk e ka pjesën e tij të zemrës prej adhurimeve dhe, deri sa ai nuk kalon prej figurës dhe rrethit të vërteta dhe të thelbi. Vetëm në këtë gjendje, ai e kapërcen kufirin e kësaj bote dhe ecën mbi koren e saj. Por qëndrimi në koren e tokës, është pengesë në rrugëtimin e njerëzimit. Në të vërtetë, thirrësit që e reduktojnë thirrjen vetëm në anën e jashtme, janë prej atyre që u vënë pengesa njerëzve, që të mos arrijnë etikën e brendshme. Për më tepër, këta pseudothirrës pretendojnë se ligji i fesë s’ka të vërtetë tjetër përveç asaj të jashtmes që shihet dhe përveç kores së studimit. Në të vërtetë, ata janë shejtanë që presin rrugën për të shkuar tek Allahu, janë ferra të shpërndara në rrugën e njerëzimit, prandaj është detyrë të kërkohet mbrojtja e Allahut të Lartësuar nga e keqja e këtyre shejtanëve, ndryshe këta shejtanë do



të fikin te njeriu dritën e cilësisë së pastër me të cilën Allahu e ka krijuar njeriun, do të shuajnë dritën e diturisë, do të shuajnë dritën e Njëtimin të Allahut, që është drita e të gjitha diturive hyjnore. Këta shejtanë punojnë, që të hedhin mbi rrugëtarin mbulesat e traditës së verbër, të hedhin mbulesat e injorancës, mbulesat e zakoneve e iluzioneve. Këta shejtanë i pengojnë robtë e Allahut të mos arrijnë në portën e Tij dhe vënë para tyre ndalesa, që ata të mos e arrijnë bukurinë e bukurive të Tij. Ata u zënë atyre rrugën e fitimit të diturive. Punojë që të errësojnë zemrat e pastra. Por, i Vërteti Fuqplotë, me dorën e bukurisë e me madhështinë e Tij, ka hedhur farën e diturive në thellësi të zemrave. Më pas, i Vërteti i Lartësuar dërgoi profetët e mëdhenj dhe zbriti librat qiellorë, për t'i bërë ata fara që të mbijnë, si mirësi e kujdes ndaj bimëve të mbira. Por ata shejtanë vazhdojnë t'i orientojnë njerëzit kah kjo botë, kah gjërat e bukura të saj, kah punët lëndore e trupore dhe kah gjithçka që lidhet me punët e kësaj bote, njëkohësisht fjalët e tyre i largojnë njerëzit prej shpirtërores, prej të moralshmes dhe prej lumturive logjike. Ata i reduktojnë botët e panjohura dhe Xhenetet e premtuara me kënaqësitë kafshërore që ndien njeriu prej shijimit të ushqimit, prej pijes, prej martesës dhe prej gjërave të tjera që sjellin thjesht kënaqësi të mirëfillta kafshërore.

Ata pandehin se i Vërteti i Lartësuar parapëlqen shpërndarjen e të gjithë mëshirës dhe për këtë Ai ka zbritur librat, ka dërguar engjëjt, ka çuar te njerëzit profetët e mëdhenj dhe për çdo punë që ka lidhje me këto që thamë, ka vënë ceremoni e sisteme që shërbejnë për të drejtuar punët e ushqimit e të plotësimin të epshit. Qëllimi më i lartë që ata shejtanë kanë arritur prej diturive në këtë botë, është vetëm ruajtja nga e keqja, ngopjen e barkut e kënaqjen e epshit, me synimin që ngopja e barkut dhe kënaqja e



epshit do të arrihen në Botën Tjetër. Në disa hadithe theksohet se ata, në radhë të parë, vënë interesimin për marrëdhëniet intime mashkull - femër, që sipas tyre, në Xhenet vazhdojnë pesëqind vjet. Madje një interesim kaq të madh ata nuk ia kanë kushtuar as çështjes së teuhidit – besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe as çështjes së profetësive. Ata mendojnë se të gjitha dituritë janë, thjesht, një parathënie për sigurimin e kënaqjes së barkut e të epshit në Botën Tjetër. Sikur një filozof hyjnor, ose ndonjë teolog i ditur të dëshironte të hapte një portë prej mëshirës para robërve të Allahut, ose të kishte dëshirë që t’u lexonte atyre një faqe prej Librit të urtësisë hyjnore, ata nuk do të vonin ta etiketonin atë mohues (kàfir), ose do ta përgojonin atë me emrat më përçmues, ose do të hidhnin mbi të akuzat më monstruoze.

Të këtillët janë të mbytur në detin e kësaj bote, por ata as nuk e kuptojnë e as nuk e ndiejnë se janë mbytur. Ata e kanë tejkaluar masën e interesimit për çështjet e dëshirave të barkut e të epshit, deri në atë gradë sa kanë refuzuar të pranojnë çdo mendim që flet për ekzistencën e një lumturie tjetër përveç dëshirave kafshërore (në shtëpinë e realizimit e të vërtetimit), megjithëse lumturia logjike - sikur ajo të kishte trup - kurrë nuk do të dëmtohej me barqet e me epshet e këtyre shejtanëve.

Të ngjashmit me ne, që nuk e kapërcejmë cakun e kafshërores, këta shejtanë, nga këndvështrimi i tyre, na thonë se s’ka gjë tjetër përveç Xhenetit trupor dhe plotësimit të nevojave të barkut e të epshit, madje edhe arritja e këtij objekti nuk është ndryshe veçse me mirësinë e Allahut Fuqiplotë e me mëshirën e Tij. Por, nuk duhet menduar se lumturia reduktohet vetëm në pandehmat e këtyre shejtanëve, të cilët thonë se Xheneti i të Vërtetit nuk e kalon rrethin e përfytyrimit për Xhenetin kafshëror. Por i



Vërteti ka botë, të cilat asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar, pasi ato janë të atilla, që nuk mund të kalojnë në mendjen e ndonjë njeriu. Ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe ata që zotërojnë dituritë hyjnore, s'kanë asnjë interesim për Xhenete të tilla, pasi ajo që i orienton ata drejt botës së fshehtë, drejt botës së dukshme dhe drejt Xhenetit të tyre, është vetëm takimi me të Vërtetin.

Nëse ke dëshirë, mund të ndjekësh ajetet e Kur'anit dhe hadithet e ardhura prej imamëve të ruajtur prej gjynaheve. Por, edhe sikur të duam të njihemi me këto ajete e me këto hadithe, në të cilat trajtohet kjo çështje, do të dilte jashtë rrethit që ne kemi vënë për këtë studim. Por më duhet të them se ato që unë kam përmendur deri tani, nuk janë më shumë se pasioni e lëshimi i frerëve të lapsit. Veç kësaj, ky nuk është qëllimi ynë, sepse, si bazë, ne nuk synojmë gjë tjetër veçse t'u kujtojmë zemrave të robërve të Allahut qëllimin për të cilin janë krijuar dhe t'u themi qartë se janë krijuar që të njohin Allahun e Lartësuar dhe t'u bëjmë atyre të ditur se njohja e Allahut qëndron më lart se të gjitha lumturitë dhe më lart se çdo send tjetër përveç Atij.

Këtu duhet të theksoj se ne "me ata që konsiderohen ferra në udhën e rrugëtimit" nuk kemi qëllim as dijetarët e mëdhenj islamë e as juristët e ligjit të fesë sipas medh'hebit Xhaferi. Jo, qëllimi ynë është të vëmë në dukje injorantët që kanë veshur kostumin e diturisë, të cilët lënë mangët punët me qëllim dhe jo ata që i kanë këto mangësi, ose ata që janë kokëfortë. Pseudodijetarët injorantë janë, thjesht, kusarë që presin rrugën robërve të Allahut.

Vetëm Allahut të Lartësuar i kërkoj të më ruajë prej dhunës së lapsit, prej nijetit të keq e prej objektivave të gabuara! Falënderimi e lavdërimi i takon vetëm Allahut, fillim e mbarim, sheshit e në brendësi!



## KAPITULLI I TRETË

### SEKRETI I NIJETIT DHE ETIKA E NIJETIT

#### Ndarja e parë

#### E VËRTETA E NIJETIT NË ADHURIME

Mëso se nijeti shpreh vendosmërinë për të bërë një punë dhe për të mbledhur veten për kryerjen e asaj pune, pasi më parë e ke përfytyruar dhe ke besuar në dobitë e asaj pune. Gjithashtu, ke gjuvuar se njeriu duhet ta bëjë atë punë. Nijeti është një gjendje shpirtërore unike, që shfaqet, pasi realizohet puna, sipas përshkrimit të mësipërm. Nijeti shpreh vullnetin, vendosmërinë dhe qëllimin. Nijeti, pa përjashtim, gjendet në të gjitha punët që njeriu i bën me zgjedhjen e vet, domethënë se nijeti ekziston në çdo punë dhe përfshin punën e plotë, në formën e saj konkrete. Por në shprehjen e nijetit s'ka asnjë përdorim metaforik. Nuk është domosdoshmëri sjellja e kësaj gjendjeje në mendje në formë të detajuar gjatë kryerjes së punës, ose të përfytyrohet qëllimi e vendosmëria në formë të shkoqitur, sepse, disa herë, ndodh që njeriu e bën një punë me të njëjtën shkallë vendosmërie, por është krejtësisht i hutuar e i shkujdesur ndaj hollësive të punës dhe ndaj



qëllimit për të cilin kryhet ajo punë, megjithëkëtë, nijeti ekziston dhe puna, nga jashtë, realizohet nën shtytjen e kësaj të vërtete. Pa dyshim që kjo gjendje arrihet emocionalisht në punët e bëra me zgjedhjen e vetë njeriut.

Në përgjithësi, qëndrueshmëria e kësaj vendosmërie është ajo që kanë shprehur juristët e ligjit të fesë, në lidhje me nijetin. Ata kanë thënë se nijeti ekziston në mënyrë absolute në të gjitha punët dhe është e pamundur që njeriu, pa nijet, e pa u bazuar në këtë nijet, të kryejë një punë që e ka zgjedhur vetë ta kryejë. Pavarësisht se kjo punë është shumë e qartë, përsëri vërejmë se mendja i nënshtrohet cytjeve të shejtanit të keq dhe janë këto cytje dhe lojërat e iluzioneve ato që ia fshehin të varfrit faktin se nijeti patjetër duhet të ekzistojë dhe, kështu, ti e shikon njeriun të shkojë kot më shumë se gjysmën e jetës së tij - si rezultat i cytjeve të shejtanit të lig - për të vërtetuar një punë të vërtetë, e cila patjetër ekziston, në vend që ta kalojë jetën e tij të paçmueshme në zhveshjen e punës prej gjembave e ferrave, në njohjen e të Vërtetit dhe në punën për të shkuar tek Ai.

Por shejtani, për realizimin e këtij rezultati, përdor lloje të shumta kurthesh e mashtrimesh: dikë e shtyn të heqë dorë krejtësisht nga puna dhe, nëse këtë e ka të pamundur me ndonjë njeri tjetër, atëherë këtë tjetrin e shtyn drejt hipokrizisë, vetëpëlqimit dhe punëve të shthurura. Nëse edhe më këtë dështon, ai e fillon punën me një tjetër, duke ia prishur punën, duke e shtyrë të shikojë vetëm anën e jashtme të çështjes, ose e shtyn të maskohet me shenjtërinë boshe, kurse adhurimet që bëjnë njerëzit, ia paraqit si objekt tallje. Më pas e nxit që t'i akuzojë adhuruesit si njerëz që nuk i kushtojnë rëndësi adhurimeve dhe, atëherë i mashtruar fillon ta harxhojë jetën e vet, për shembull, në sjelljen e nijetit, në një kohë që sjellja e nijetit është një punë e domosdoshme për kryerjen e



adhurimit, ose për të marrë tekbiret, ose për të lexuar, veprime që, në të vërtetë, janë prej punëve të zakonshme e të thjeshta.

Në të gjitha gjendjet, shejtani nuk heq dorë prej njeriut dhe, në një mënyrë apo në një tjetër, ai rikthehet te njeriu dhe punon me ngulm me të gjitha rrugët, mënyrat e mjetet që njeriut t'ia bëjë punën plotësisht të kotë e të gabuar, domethënë se cytja e shejtanit është një proces i komplikuar, i rrethuar me shumë gjemba e ferra. Rrugët e mënyrat e cytjeve të shejtanit janë aq të shumta, sa nuk numërohen. Këtu ne e kemi të pamundur të bëjmë një studim të detajuar rreth kësaj teme ose të zbulojmë të gjitha punët që lidhen me këtë çështje, megjithëkëtë ne mund të themi se shumica e formave të cytjeve të shejtanit nxisin dëshirën për të vënë të tjerët në lojë e për vetëpëlqim hedhin dyshim mbi nijetin. Nëse dikush, me zgjedhjen e vet, ka qëllim të bëjë një punë të çfarëdoshme pa nijet, ai kurrë nuk do të ketë mundësi ta kryejë atë punë, edhe sikur të mobilizonte të gjitha fuqitë e tij, madje edhe nëse do ta kalonte të gjithë jetën e tij në atë punë. Megjithatë ne shikojmë se si një person i varfër, me shpirt të sëmurë e mendjelehtë e bllokon veten në çdo namaz për një kohë të gjatë, me qëllim që të falë namazin me nijet e me vullnet. Gjendja e këtij njeriu është si gjendja e atij që mohon për një kohë të gjatë, me pretendimin për të sjellë në veten e tij nijetin e vullnetin, por kjo i ngjet rastit të atij që thotë se do të shkojë në treg për të blerë ushqimet.

Dhe ai i varfëri është i shkujdesur ndaj detyrës që ka për të falur namaz dhe për ta bërë namazin miraxh për afrim, për ta bërë namazin çelës për lumturinë. Është i shkujdesur ndaj domosdoshmërisë së kryerjes së namazit në mënyrë të vazhdueshme, edhe me zemër. Gjithashtu, është i shkujdesur edhe ndaj detyrës për zbulimin e sekreteve të namazit. Ai është





shkujdesur të mësojë se këto sekrete të namazit janë dhurata hyjnore, të cilat i sjellin atij dobi në realizimin e plotësimit dhe i sigurojnë atij konstruktimin e jetës së tij në Botën Tjetër. Por, më e habitshme dhe më e hidhur është se jeta e tij nuk mbetet vetëm në mosinteresimin që ai ka ndaj këtyre punëve, megjithëse kjo është një punë fare e thjeshtë, por ai, të gjitha punët i konsideron të gabuara dhe jetën e tij, kapitalin e pasurinë e shpëtimit të tij, e kalon me punë të kota dhe në shërbim të shejtanit, duke iu bindur cytjeve të hedhësit të dyshimeve. Madje ai, edhe mendjen që është dhunti hyjnore dhe drita e udhëzimit në rrugën e drejtë, ai e nënshtron para sundimit të shejtanit.

Abdullah bin Sinani ka thënë: “I fola Ebu Abdullahut (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që është vënë në sprovë me abdesin e me namazin: ‘Ai është një burrë i mençur’. Ebu Abdullahu tha: ‘Çfarë mendje ka ai që i bindet shejtanit? Kërkoji atij të bëjë ndonjë send dhe ai do të thotë ty një punë prej punëve të shejtanit’”.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, njeriu ka për detyrë t’i shkulë nga rrënjët të gjitha këto punë, pavarësisht nga ushtrimet shpirtërore që duhet të praktikojë e nga vështirësitë që do të hasë, sepse ato i zënë atij rrugën dhe e mënjanojnë nga të gjitha format e lumturisë dhe të mirësisë. Mbase e çojnë të humbë deri adhurimet që ai ka kryer, për shembull, dyzet vjet me radhë, edhe pse i ka kryer ato adhurime sipas kushteve të kërkuara deri edhe nga ana e jashtme, madje edhe nga ana e pjesëve të adhurimeve që kanë lidhje me ligjin e fesë, pa folur për etikën e brendshme dhe ligjore të kryerjes së adhurimeve.

---

<sup>1</sup>“El-Usûlu minel-Kâfi”, vëll. 1, Libri “El Aklu uel Xhehlu dhe injoranca”, Hadithi 10, f. 12.



Por është për të qeshur, kur shikon se disa prej të sprovuarve me dyshimet e shejtanit gjykojnë se të gjitha punët e njerëzve janë pa asnjë vlerë e janë të gabuara, ndërkaq akuzojnë të tjerët se nuk interesohen për punët e fesë. Në një kohë që i akuzuari ndjek shembullin e një tjetri dhe, bazuar në këtë imitim, ai i kryen adhurimet sipas rrugës së njohur ndër të gjithë njerëzit, prandaj, nëse ai është prej njerëzve të virtytshëm, le të lexojë hadithet, në të cilat do të gjejë se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët udhëzues në rrugën e drejtë i kanë kryer punët e tyre sipas asaj që njihet e dihet në mesin e të gjithë njerëzve, kurse punët e atyre që veprojnë sipas cytjeve të shejtanit, janë në kundërshtim me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe me imamët udhëzues në rrugën e drejtë. Ata veprojnë në kundërshtim edhe me fjalën e juristëve të medh'hebit dhe në kundërshtim me orientimin e dijetarëve të umetit islam. Vetëm ata që i nënshtrohen dyshimeve e cytjeve të shejtanit, i konsiderojnë punët e të gjithë njerëzve të dobëta dhe thonë se punët e tyre janë miratim me rezervë, ndërsa për fenë interesohen vetëm ata dhe askush tjetër përveç këtyre të sprovuarve me cytjet e shejtanit.

Për shembull, janë të shumta hadithet e ardhura për mënyrën si merrte abdes i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në këto hadithe tregohet se ai e lante fytyrën me një grusht ujë dhe dorën e djathtë e lante me një grusht ujë, po kështu me një grusht ujë lante edhe dorën e majtë.<sup>1</sup> Fukahatë – juristët e ligjit të fesë – të medh'hebit Imami ndajnë një fjalë të përbashkët për vlefshmërinë e abdesit që theksohet qartë në

---

<sup>1</sup>Lexo "El-Furû'u minel-Kâfi", vëll. 3, Libri "Pastrimi", K. "Përshkrimi i abdesit", f. 24.



Librin e Allahut. Madje disa fukaha e kanë parë të vështirë larjen e fytyrës dhe të duarve për herë të dytë, megjithëkëtë s'ka asnjë dëm prej një grushti ujë për herë të dytë hedhur mbi dorën e djathtë, madje edhe për larjen e fytyrës për herë të dytë, edhe pse larja e dytë është konsideruar veprim i lavdërueshëm (mustehab).

Dhe tani mendo në punën e këtij të mjeri të sprovuar me cytjet e shejtanit, i cili nuk mjaftohet as me njëzet grushte ujë, duke e larë dorën ashtu siç mendon ai dhe thotë se vetëm kështu dora e tij është pastruar plotësisht, por pa asnjë ekuivok abdesi i tij është prishur. Pavarësisht nga kjo, ky njeri mendjelehtë vazhdon të mendojë se puna e tij është e vlefshme dhe është në përputhje me *el ihtijatu*.<sup>1</sup> Është e qartë se në këtë gjendje ai ka vepruar në bindje të shejtanit dhe sipas dyshimeve që shejtani ka hedhur në të dhe, mbi të gjitha, ai punën e të tjerëve e konsideron të gabuar.

Nga këtu bëhet e qartë sa të vërteta janë fjalët e hadithit të nderuar, që e konsideron një person të këtillë mendjelehtë. Ai mendjelehtë, që mendon se është e drejtë puna e bërë në kundërshtim me atë që ka bërë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose ajo punë është plotësisht ashtu siç e ka bërë ai, por në mendjen e tij ajo punë, padyshim, është e gabuar, një njeri i tillë ose ka dalë jashtë fesë, ose nuk e ka mendjen në kokë. Nëse ky i mjerë nuk është jashtë fesë, ai patjetër s'ka mendje, i bindet shejtanit dhe kundërshton të Gjithëmëshirshmin.

S'ka asnjë rrugë tjetër as për mjekimin e këtij të sëmuri kronik dhe as për ta përballuar këtë katastrofë të madhe, përveçse duke menduar në punët që u thanë më sipër dhe duke e krahasuar

---

<sup>1</sup>Masa paraprake të rekomanduara



punën e këtij të sprovuari me cytjet e shejtanit me punën e njerëzve të përkushtuar në zbatimin e urdhrave të fesë, me punën e dijetarëve e me punën e juristëve të ligjit të fesë së Allahut dhe, kur ai të shohë se është në kundërshtim me ata, atëherë detyra e tij është që t'ia shtypë hundën shejtanit dhe të mos i kushtojë asnjë rëndësi cytjeve e dyshimeve që i keqi hedh në zemrën e tij dhe t'i përgjigjet të ligut duke i thënë: "Ti më fryn në vesh dyshime dhe me cytjet e tua më thua se puna jote është e gabuar. Nëse puna e të gjithë fukahave të umetit qenka e gabuar, atëherë edhe puna ime është e gabuar". Ka shumë mundësi që me këtë rrugë, ai mund të shërohet prej kësaj sëmundjeje dhe disfatën do t'ia hedhë shejtanit, nëse me të vërtetë do të vazhdojë të kundërshtojë shejtanin për një farë kohë dhe gjatë kësaj kohe kërkon mbrojtjen e të Vërtetit prej të keqes së shejtanit. Vetëkuptohet që këtë kërkesë ai e bën në kuadrin e nënshtrimit e të përluljes ndaj të Vërtetit të Lartësuar. E njëjta gjendje është edhe për shërimin prej dyshimeve të shumta, që pa dyshim janë prej cytjeve të shejtanit. Për këto cytje e dyshime flasin qartë njoftimet e ardhura dhe hadithet e nderuara. Po përmendim disa prej tyre:

Në librin "El-Kâfi", lexojmë fjalët e Ebu Xhafer Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): "Kur harresa e shpërqendrimi në ty shtohen, vazhdo ta falësh namazin tënd, sepse dyshimi të thotë sikur ai të ka lënë ty, por në të vërtetë ky dyshim është prej shejtanit".<sup>1</sup>

Gjithnjë, në këtë libër lexojmë se Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë thënë: "Mos merrni zakonin e të keqit, duke lënë mangët namazin, pasi kështu e kënaqni atë. Dihet se shejtani

---

<sup>1</sup>"El-Furû'u minel-Kâfi", vëll. 3, Libri : "Namazi", K. "Ai që dyshon në të gjithë namazin e tij", Hadithi 8, f. 359.



*është i lig e i përshtatet zakonit, prandaj asnjë prej jush të mos mendojë se e ka lënë namazin të mangët. Nëse këtë e bën disa herë, shejtani kurrë nuk kthehet më te ti me dyshime. Në të vërtetë, i ligu do që ju t'i bindeni atij, por, kur i ligu kundërshtohet, ai nuk mund të jetë më njëri prej jush".<sup>1</sup>*

Siç e shikoni, të gjitha ilaçet shkaktojnë dhembje në të gjitha punët që numërohen prej hedhjeve të shejtanit dhe prej lodrave të iluzioneve djallëzore. Në librat e haditheve kanë ardhur lutje për t'u mbrojtur prej hedhjeve të shejtanit. Kush dëshiron, le të lexojë librin "El-Vesàil" dhe "Mustedrekul-Vesàil", në fundin e kapitullit: "Ç'është e lejuar në namaz?".

---

<sup>1</sup>"El-Furù'u minel-Kàfi", vëll. 3, Libri "Namazi", K. "Ai që dyshon në të gjithë namazin e tij", Hadithi 2, f. 358.



## Ndarja e dytë

### DISA ETIKA TË NIJETIT

Prej etikave të rëndësishme të nijetit, madje prej etikave më të rëndësishme të të gjitha adhurimeve dhe të programeve e rrugëve gjithëpërfshirëse, është sinqeriteti, e vërteta e të cilit qëndron në pastrimin e punës prej çdo gjëje që e largon adhurimin te ndonjë tjetër dhe jo për Allahun. Gjithashtu, e vërteta e sinqeritetit qëndron edhe në pastrimin e sekretit, për të parë ndonjë tjetër dhe jo të Vërtetin e Lartësuar në të gjitha punët që shikohen me sy, në punët thelbësore, në punët e jashtme e të brendshme, domethënë, se plotësimi i sinqeritetit qëndron në heqjen dorë, në mënyrë absolute, prej çdo gjëje, përveç Allahut, duke mohuar të tanishmen, egoizmin, tjetrin dhe ndryshueshmërinë. Allahu i Lartësuar thotë: “الْحَالِضَالُ لِلَّهِ التَّيْمُ” - “*elà lil'làhi-d'dijnul-khàlisu*” - “**Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë**”.<sup>1</sup> Allahu i Lartësuar ka zgjedhur për Vetën e Tij besimin e sinqertë, ka zgjedhur besimin në të cilin s'ka asgjë personale e djallëzore, ndryshe ai besim kurrë nuk është besim i sinqertë për Allahun, sepse i Vërteti Fuqplotë nuk e do besimin që nuk është plotësisht i sinqertë vetëm për Të. Çdo deformim, çdo tjetërsim dhe çdo gjë vetjake, që përzihet me besimin, është jashtë kufijve të besimit të sinqertë në të Vërtetin, ashtu siç njoftohet në ajetin 5 të sures “El Bejjine”:

---

<sup>1</sup>Sure “Ez Zumer”, ajeti 3.



“وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ” - “*ue mà umirù il'là lijaëbudu-ll'làhe mukhlisijne lehu-d'dijn*” - “**E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë**”.

“وَمَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ شَيْءٍ” - “*...ue men kàne jurijdu harthe-d'dun'jà nuëtihi minhà ue mà lehù fil-àkhireti min nesijbin*” - “**Atij që dëshiron shpërblim në Jetën Tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t'i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në Jetën Tjetër**”.<sup>1</sup>

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Pa dyshim se çdo njeri do të ketë atë çka ai kishte qëllim. Nëse emigrimi i tij është tek Allahu e tek i Dërguari i Tij, atëherë emigrimi i tij është tek Allahu e tek i Dërguari i Tij. Nëse emigrimi i tij është për interesat e kësaj bote, ose për një grua me të cilën ka dëshirë të martohet, emigrimi i tij është për qëllimin për të cilin ai emigroi*”.<sup>2</sup>

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَمَنْ يَخْرُجْ مِنْ بَيْتِهِ مَهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكْهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ”

- “*...ue men jakhruxh min bejtihì muhàxhiren ile-ll'làhi ue resùlihi thum'me judrikhul-meutu fekad veka'a exhruhù ale-ll'làhi*” - “**Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë**”.<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Sure “Esh Shùrà”, ajeti 20.

<sup>2</sup>“Mustedrekul-Vesàili”, K. 5 -“Veprimet paraprake në adhurime”, Hadithi 5.

<sup>3</sup>Sure “EnNisà”, ajeti 100.



Në këtë ajet të nderuar shpjegohen të gjitha gradët e sinqeritetit. Njëra prej këtyre gradëve është emigrimi formal, që është emigrimi i trupit. Ky emigrim nuk është emigrim tek Allahu e te i Dërguari i Tij, nëse nuk është i pastruar krejtësisht prej interesave vetjake, prandaj edhe grada e sinqeritetit, e realizuar në këtë emigrim, është grada e sinqeritetit juridik formal.

Grada tjetër është emigrimi moral, është udhëtimi i brendshëm, që fillon me daljen prej shtëpisë së errët të trupit dhe përfundon tek Allahu i Lartësuar e te i Dërguari i Tij, i cili, me rezultatin, gjithashtu, kthehet te i Vërteti, pasi i Dërguari, edhe pse është i dërguar, në veten e tij nuk ka pavarësi, por është argument, pasqyrë e zëvendës, për rrjedhojë edhe emigrimi te i Dërguari është emigrim te i Vërteti. Gjithashtu, edhe dashuria për të zgjedhurit e Allahut është dashuri për Allahun.

Atëherë kuptimi i ajetit të nderuar është: Ai që del prej shtëpisë së vetvetes e prej banesës së egoizmit dhe nisat për emigrimin moral e për udhëtimin njohës të zemrës, me synimin që të emigrojë për tek Allahu, pa asnjë shqetësim në veten e në shpirtin e tij, dhe ka në konsideratë vetëm këtë emigrim, pa dyshim që i Vërteti dhe askush tjetër është garantues për shpërblimin e këtij emigruesi. Por, kur emigruesi, në udhëtimin e tij për tek Allahu, ka qëllim edhe realizimin e ndonjë objektivi vetjak, pavarësisht se ajo që kërkohet është arritja e pozitave, madje edhe sikur përpjekja e tij të jetë që të arrijë afër të Vërtetit, ose udhëtimi i tij të jetë mjeti që e çon atë afër të Vërtetit, ky udhëtim nuk është rrugëtim për tek Allahu. Për më tepër, ky rrugëtar akoma nuk e ka lënë shtëpinë. Ai vazhdon të jetë brenda shtëpisë dhe lëviz nga njëra anë në tjetrën dhe nga njëra qoshe në qoshen tjetër të shtëpisë.





Atëherë udhëtimi brenda gradëve të shpirtit, për të arritur plotësimet vetjake, nuk është rrugëtim për tek Allahu, por është udhëtim nga vetja për veten. Megjithëkëtë, rrugëtari e ka për detyrë ta ndërmarrë këtë udhëtim si parapërgatitje për udhëtimin për te Allahu. Asnjë njeri s'ka mundësi – me përjashtim të eulijave të plotësuar – që të ndërmarrë udhëtimin hyjnor, pa bërë më përpara udhëtimin e vet shpirtëror, pasi udhëtimi për tek Allahu është çështje që u takon vetëm të zgjedhurve të plotësuar. Mbase ajeti i nderuar: *“الْفَجْرِ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ”* - *“...selâmun hije hat'tà matleil-fexhri”* - **“Paqe është ajo deri në lindjen e agimit”**<sup>1</sup>, është një tregues për këtë shpëtim prej veprimeve të shejtanit dhe prej veprimeve të vetë njeriut, në të gjitha etapat e udhëtimit, në netët e errëta të natyrës, e cila, për të plotësuarit, përfaqëson Natën e Kadrit. Kjo natë për ata mbaron me agimin e ditës së Kiametit dhe me shikimin e bukurisë së të Vetmit. Për sa u përket të tjerëve, veç të plotësuarve, nuk është shpëtim në udhëtimin e tyre në të gjitha gradët, sepse asnjë rrugëtar nuk shpëton dot prej veprimeve djallëzore në fillim të rrugëtimit të tij.

Është e qartë se kjo gradë prej sinqeritetit shoqërohet me shpëtim, që në etapën e parë të rrugëtimit për tek Allahu dhe deri në fundin e kësaj etape, në të cilën është edhe vdekja reale, madje edhe pas “jetës së dytë të vërtetë” - ndërgjegjësimit pas shuarjes – nuk bëhet realitet as për rrugëtarët, as për ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe as për ata që praktikojnë ushtrime shpirtërore të njohura.

Shenjë dalluese e një sinqeriteti të këtillë është mungesa e ndikimit të mashtrimeve të shejtanit në të sinqertët, pasi shejtani te

---

<sup>1</sup>Sure “El Kadr”, ajeti 5.



ata ndihet plotësisht i dëshpëruar. Kjo me vetë dëshminë e këtij të ligu, për ligësinë e të cilit tregon ajeti i nderuar:

"فِعْرَتِكَ لِأَعْوَابِهِمْ أَجْمَعِينَ إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ"

- "...febi'iz'zetike leugvij'en'nehum exhmeijne. Il'là ibàdeke minhumul-mukhlisijne" - **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robëve të Tu të sinqertë!'"**<sup>1</sup>

Është e qartë se sinqeriteti për të cilin flet ajeti ka lidhje me vetë robin dhe jo me punën e tij. Veç kësaj, kjo pozitë është sipër pozitës së sinqeritetit në punë. Edhe hadithi profetik mjaft i përhapur: *"Ai që shpreh sinqeritet për Allahun dyzet mëngjese, burimet e urtësisë rrjedhin prej zemrës së tij në gjuhën e tij"*<sup>2</sup>, thekson të gjitha gradët e sinqeritetit: sinqeritetin në punë, sinqeritetin në cilësi dhe sinqeritetin personal. Gjithashtu, edhe shfaqjen e sinqeritetit personal, ku gradët e tjera të sinqeritetit mund të jenë prej domosdoshmërive të sinqeritetit.

Shpjegimi i qëllimit të shprehjes "burimet e urtësisë" dhe mënyra e rrjedhjes së atyre burimeve prej zemrës në gjuhë, si dhe roli i sinqeritetit në këtë rrjedhje, gjithashtu, edhe veçoria e sinqeritetit "dyzet mëngjese", të gjitha këto janë prej çështjeve që dalin jashtë kuadrit të kësaj kumtese, madje është e nevojshme të trajtohen në një kumtesë të veçantë.

Meriton të theksohet se boshti kryesor rreth të cilit rrotullohet kumtesa e njohur me titull "Tuhfetul-mulûk fis'sejri ues'sulûk", autorësia e të cilës i atribuohet të ndjerit, njohësit të

---

<sup>1</sup>Sure "Sàd", ajetet 82-83.

<sup>2</sup>"Ujûnu Akhbàru-Rr'rridà", vëll. 2, f. 249 dhe prej tij me pak ndryshime në fjalë "Bihàrul Enuàr", vëll. 61, f. 242.



Allahut, detit të diturive, është një shpjegues i këtij hadithi. Është kumtesë më e plotë, edhe pse nuk është pa disa diskutime. Pikërisht për këtë, disa e mohojnë që autor i kësaj kumtese të jetë zotëria i nderuar, që në vërtetë as nuk mund të përjashtohet.



## Ndarja e tretë

### FRAGMENT SQARIMI, NË LIDHJE ME GRADËT E SINQERITETIT

Në kuadrin e kësaj kumtese, po shpalosim në përgjithësi disa gradë të sinqeritetit.

*Grada e parë* - pastrimi i punës, qofshin punë të zemrës, qofshin punë klishe, nga çdo gjë që e trazon dhe e përzien pastërtinë e punës, si dëshira për të arritur miratimin e të krijuarve e për të tërhequr zemrat e tyre, ose me një lavdërim, ose për një përfitim, ose për ndonjë gjë tjetër.

Përballë kësaj gjendjeje qëndron puna e bërë për hipokrizi, ajo që quhet "hipokrizi juridike", e cila numërohet prej shkallëve më të këqija të hipokrizisë. Për rrjedhojë, i sprovuari me këtë shkallë hipokrizie konsiderohet prej hipokritëve, është njeriu më i poshtër, me gjendjen më të keqe.

*Grada e dytë* - pastrimi i punës nga ceni i nxitimit, për të arritur qëllime e nevoja të zhdukshme të kësaj bote, edhe sikur motivi për këto qëllime të jetë arritja e mirësisë hyjnore, e pritshme si rezultat i kryerjes së asaj pune, si për shembull, falja namaz natën, me nijet për shtimin e furnizimit në mjetet e jetesës; ose falja namaz në fillim të ndonjë muaji, me nijetin për shëndet, prej sëmundjeve,



ose dhënia sadaka për të sprapsur pësimet e rënda, ose për të tjera qëllime të tjera të kësaj bote.

Disa fukaha e kanë konsideruar këtë gradë të sinqeritetit kusht për vlefshmërinë e adhurimeve dhe kanë thënë se puna e bërë është për të arritur realizmin e qëllimit. Por kjo është një punë që e kundërshton realizimin, sipas rregullave të fik'hut. Gjithashtu, edhe ata që kanë arritur gradën e njohjes, mendojnë se namaze të tilla s'kanë asnjë vlerë dhe jo vetëm që i numërojnë si të gjitha llojet e fitimeve të lejuara, por i numërojnë në gradën më të ulët.

*Grada e tretë* - pastrimi i punës nga hijet e cenet e dëshirës për të arritur Xhenetet trupore, huritë, pallatet e të tjera të ngjashme prej kënaqësive trupore. Përballë kësaj gjendjeje qëndron "adhurimi i pjesëve", për të cilin tregohet në disa hadithe të nderuara. Por kjo gjendje fitimi, te ata që quhen njerëz të Allahut, është si të gjitha llojet e tjera të fitimit, por me një dallim, se shpërblimi i punës së këtij fituesi, është më shumë dhe më i lartë, sepse ai e bëri punën dhe e pastroi atë prej prishësve formalë.

*Grada e katërt* - pastrimi i punës nga njolla e ndjenjës së frikës prej dënimit e prej formave të dënimit të trupit, me të cilin jemi kërcënuar. Përballë kësaj gjendjeje, qëndron i quajturi "adhurimi i robëve", që theksohet në hadithet e nderuara. Por edhe ky adhurim, te zotëruesit e zemrave është pa vlerë dhe numërohet adhurim jashtë kuadrit të robërisë për Allahun. Madje, ata që kanë arritur gradën e njohjes, nuk bëjnë dallim mes këtij adhurimi dhe adhurimit që njeriu bën nga frika, se mbi të do të zbatohet në këtë botë vendimi për ndëshkime fizike apo qortime të urdhëruara me vendimin e gjykatës, si dhe adhurimet e bëra nga frika e dënimit dhe e ndëshkimit në Botën Tjetër; ose adhurimet që njeriu i kryen



me nijetin, që të ketë sukses në përpjekjet e veta, për të marrë gra në këtë botë, ose të gëzojë gratë e Xhenetit. Është e qartë se çdo njëri prej motivuesve të mësipërm nuk është përpjekje për afrim tek Allahu, por përpjekje që e nxjerrin punën nga vlefshmëria, sepse puna është bërë në përputhje të plotë me rregullat e fik'hut, kurse në tregun e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, këto adhurime, të kryera nën shtysën e motiveve të mësipërme, janë thjesht mallra stoqe.

Kjo gradë, edhe pse është një gradë shumë e madhe dhe një qëllim shumë i rëndësishëm, që filozofët e studiuesit i kushtojnë rëndësi të madhe, përsëri, ky adhurim në Botën Tjetër, në rrugëtimin e njerëzve të Allahut, numërohet prej mangësive të rrugëtimit dhe të vetë rrugëtarit, i cili te ata, gjithashtu, numërohet prej mëditësve, edhe pse dallohet prej të tjerëve në tregtinë që bën dhe në fitimin që arrin.

*Grada e pestë* është e barabartë me dy gradët e mëparshme, është pastrimi i punës nga ndjenja e frikës për mosarritjen e kënaqësive dhe për privimin nga lumturitë. Përballë kësaj pune qëndron puna e kryer nën motivet e kësaj grade të frikës.

Madje, edhe sikur grada e adhurimit të jetë e lartë, madje aq e lartë sa e tejkalon edhe dëshirën ideale, përsëri ai adhurim, në shikimin e njerëzve të Allahut, është adhurim i sëmurë dhe adhurim skllëvërish.

*Grada e gjashtë* - pastrimi i punës prej hijeve e njollave të dëshirës, për të arritur kënaqësitë e bukurisë hyjnore dhe gëzimin me dritat e fluturimeve, pa anë e pa fund, që reduktohen në Xhenetin e takimit. Kjo gradë, grada e takimit, është prej gjërave të



rëndësishme të atyre që kanë arritur gradën e njohjes, të cilët janë respektuar me gëzimin e kësaj lumturie, si dhe të plotësuarit prej njerëzve të Allahut dhe të zgjedhurve të Tij, përfshirë edhe të dashuruarit, edhe të lavdëruarit. Nëse kjo gradë numërohet plotësim i gradës së të plotësuarve prej njerëzve të Allahut dhe prej të zgjedhurve të Tij, në fakt, kjo gradë është prej pozitave të tyre të shumta, të zakonshme. Në njoftimet e ardhura në lidhje me këtë përpjekje e me këtë shtytje, për arritjen e kësaj grade, theksohet rruga e lutjeve, të bëra prej imamëve të pastër, siç janë lutjet “Munàxhat shaëbanij’jeh”. Por kjo nuk do të thotë se pozitat e tyre reduktohen vetëm në këtë nivel. Një gjendje e tillë është plotësisht edhe në *gradën e shtatë*, e cila është në ekuilibër me këtë gradë, e përfaqësuar në pastrimin e punës nga ndjenja e frikës prej ndarjes, por, gjithashtu, nuk është prej plotësimit të pozitave të të plotësuarve, as ajo frikë për të cilën flet Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “Si do ta duroj ndarjen prej Teje!”<sup>1</sup>

Në të vërtetë, kjo gjendje tek ai dhe te të ngjashmit me të, është prej pozitave të shumta, të zakonshme.

Në përgjithësi, pastrimi i punës, në përputhje me këto dy gradë, te njerëzit e Allahut, është një punë e detyrueshme, kurse puna, edhe në këto dy gradë, është me mangësi dhe me cene të unit, prandaj pastrimi i punës, bazuar mbi këto dy gradë, numërohet plotësim i sinqeritetit.

Këtu ka edhe gradë të tjera, që qëndrojnë sipër këtyre gradëve, por ato janë gradë që dalin jashtë kuadrit të sinqeritetit

---

<sup>1</sup>Frazë prej duasë së Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), përcjellë prej Kumejl bin Zijadit. Kjo lutje njihet me emrin Lutja e Kumejlit; lexo librin “Misbàhul-Muxhtehidi”, f. 778.



dhe jashtë kuadrit të kriterit për besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid). Gjithashtu, janë jashtë kriterit të zhveshjes e të kujdestarisë. Shpjegimi i këtyre çështjeve nuk është në përshtatje me këtë pozitë.





## Ndarja e katërt

### MOHUESIT E POZITAVE DHE GRUPET E TYRE

Tani që u njohe, deri në njëfarë mase, me gradët e sinqeritetit dhe me pozitat e adhurimeve, menjëherë përgatite veten për arritjen e këtyre gradëve, por dije se dituria pa punën sipas ditorisë, s'ka asnjë vlerë. Gjithashtu, dije se argumenti kundër dijetarit është më i plotë nga sa është kundër të tjerëve. Mos harro se llogaridhënia për dijetarin do të jetë shumë më e rëndë nga llogaridhënia e një tjetri.

Por, fakti që sjell më shumë hidhërim, tregon se ne jemi të privuar plotësisht prej diturive hyjnore dhe prej pozitave morale të njerëzve të Allahut, ashtu siç jemi të privuar edhe prej gradave të larta të zotëruesve të zemrave. Njëri grup i mohon krejtësisht pozitat. Njerëzit e këtij grupi gabojnë rëndë, kur interesohen për punë të gabuara e për punë që nuk sjellin asnjë dobi, prandaj ti sheh se, kur dikush u bën atyre thirrje për të arritur pozitat e veta, ky thirrës, për ata, është i matufepsur dhe thirrja e tij s'është më shumë se fjalë në kllapi. S'ka asnjë shpresë për të tërhequr vëmendjen e këtij grupi, në lidhje me të metat e mangësitë e tyre, ose për t'i zgjuar ata prej gjumit të thellë: "إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ" - "*in'neke là tehdij men ahbebte...*" - **"Pa dyshim ti nuk e udhëzon dot atë që**



dëshiron..."<sup>1</sup>; "أَنْتَ بِمُسْمَعٍ مَنْ فِي النَّبِيِّ وَمَا" - "...ue mà ente bimusmi'in men fil-kubùr" - "...kurse ti (Muhamed) nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre".<sup>2</sup>

Pa dyshim që të ngjashmit me mua të mjerin jemi nga injorantët, zemrat e të cilëve nuk gjallërojnë me jetën e njohjes dhe me dashurinë hyjnore. Ata vetë janë të vdekur dhe zemrat e tyre nuk përfaqësojnë gjë tjetër përveç varreve të kockave të tyre të ronitura. Ata janë të mbuluar me pluhurin e trupit e me errësirën e ngushticës së varrit prej të gjitha botëve të dritës dhe të Dritës mbi të gjitha dritat: "يَجْعَلُ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُورٍ" "وَمَنْ لَمْ يَجْعَلِ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُورٍ" - "...ue men lem jehxh'ali-l'làhu lehù nùren femà lehù min nùrin" - "...**Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë**".<sup>3</sup>

Ky grup synon që, sa herë që atyre u lexohen hadithet e nderuara dhe ajetet e Kur'anit Famëlartë, që flasin për dashurinë në përgjithësi e për dashurinë hyjnore, për dashurinë e takimit dhe ndërprerjen e rrugëtimit të i Vërteti, sa të gjitha këto i interpretojnë, i justifikojnë e i shpjegojnë sipas asaj që është në përshtatje me mendimet e tyre. Ajetet e Kur'anit, që flasin për takimin me Allahun dhe dashurinë e Tij, ata i interpretojnë me jetën mes pemëve të Xhenetit dhe grave të bukura.

Unë nuk e di si është interpretimi që ky grup u bën frazave të "Munàxhàt Shaëbànij'jeh" - "Duatë e muajit shaban", në të cilat thuhet: "Zoti im, më dhuro ndalimin e plotë të Ti! Ndriçoji sytë e zemrave tona me shkëlqimin e shikimit që ata hedhin mbi Ty, deri sa sytë e zemrave tona të grisnin mbulesat e dritës dhe të arrijnë në

<sup>1</sup>Sure "ElKasas", ajeti 56.

<sup>2</sup>Sure "Fàtir", ajeti 22.

<sup>3</sup>Sure "EnNür", ajeti 40.



madhështi, deri sa shpirtrat tanë të bëhen të varur në madhështinë Tënde të pastër! Zoti im, më bëj prej atyre që, kur Ti u drejtove thirrjen, ata iu përgjigjën thirrjes Tënde dhe, kur Ti hodhe mbi ta shikimin Tënd, ata u asfiksuan nga madhështia Jote!"<sup>1</sup>

Sipas mendimit të tyre, vallë ç'janë këto "mbulesa drite"? A janë këto mbulesa "shikimi në të Vërtetin", shikimi i frutave të Xhenetit? Apo "mademi i madhështisë" janë pallatet e Xhenetit? Dhe, a është "varja e shpirtrave në madhështinë e pastër" lutja për bashkimin me bukuroshet e Xhenetit, për të plotësuar epshin? Ose mos vallë "asfiksia e shuarja për madhështinë" do të thotë mahnitje deri në asfiksi prej bukurisë së grave të Xhenetit? Vallë, këto tërheqje e mbulesa, që mbuluan të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) natën e Miraxhit, kur atë e mbuluan dritat e madhështisë, si dhe ato që ishin sipër atyre dritave nga ato që ai pa në atë vendmbledhje, ku nuk i lejohej as Xhibrilit besnik, engjëllit më të madh të Allahut, të ishte i pranishëm, madje as vetë Xhibrili nuk kishte guxuar të afrohej pranë atij vendi as edhe një fije floku, mos vallë edhe ky afrim ishte për shkak të ndonjërës prej grave me bukuri fantastike? Apo i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pa drita si drita e diellit e si drita e hënës, ose ai pa drita edhe më të fuqishme se drita e diellit e drita e hënës? Cili ishte qëllimi i përgjigjes së imamit të ruajtur prej gjynaheve, kur e pyetën për interpretimin e fjalës së Allahut të Lartësuar:

---

<sup>1</sup>Disa fraza prej lutjeve që bëhen në vetmi, drejtuar Allahut. Është e pëlqyeshme, që këto lutje të bëhen gjatë muajit shaban. Lexo "Biharul Enuar", vëll. 91, f. 99.



“إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ” - “il’là men ete-ll’làhe bikalbin selijmin” -  
**“Vetëm ai që paraqitet tek Allahu me zemër të shëndoshë”**<sup>1</sup>, ai u përgjigj: “Zemra e shëndoshë është zemra që e takon Zotin e vet dhe në të cilën s’ka asnjë tjetër përveç Atij...”

Por te ata është në kuptimin e zbrazjes së zemrës prej “nderimit të të Vërtetit”, madje me interpretimet e tyre ata shkojnë deri aty sa thonë se zbrazja e zemrës prej frutave të ndryshme të Xhenetit është si heqja e dardhave dhe e pjeshkave nga koshi i frutave.

Sa keq vepra! Qysh më dolën nga dora frerët e lapsit dhe fillova të vij vërdallë si të isha në kllapi? Por, betohem në të Dashurin, me këto fjalë s’kam pasur qëllim tjetër, përveçse t’u tërheq vëmendjen vëllezërve besimtarë, veçanërisht besimtarëve dijetarë, që më e pakta, të mos mohojnë pozitën e njerëzve të Allahut (ehlu-ll’làh), pasi ky mohim është baza e të gjitha formave të fatkeqësive e vështirësive.

Në asnjë mënyrë nuk kemi qëllim të specifikojmë njerëzit e Allahut, por duam vetëm të nxisim, që të mënjanojmë mohimin e pozitivave. Por, cilët janë njerëzit në këto pozita? Këtë vetëm Allahu

---

<sup>1</sup>Sufjan bin Ujejnehi ka thënë: “Kur e pyeta për fjalën e Allahut të Gjithëfuqishëm: “إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ” - “il’là men ete-ll’làhe bikalbin selijmin” - “**Vetëm ai që paraqitet tek Allahu me zemër të shëndoshë**”, ai u përgjigj: ‘Zemra e shëndoshë është zemra që e takon Zotin e vet dhe në të cilën s’ka asnjë tjetër përveç Atij’. Pas pak shtoi: ‘Çdo zemër, në të cilën ka idhujtari (shirk), ose dyshim, është e sëmurë. Ai njeri është i rrënuar, megjithëse kishte qëllim të ishte i përkorë në këtë botë, që të zbrazte zemrën e vet për Botën Tjetër’”. Lexo “El-Usùlu minel-Kâfi”, Libri “El-Imanu uel Kufriu”, K. “Sinqeriteti”, Hadithi 5.



e di më mirë dhe është një punë që askush nuk e di, “ai që është furnizuar me njoftime, ai kurrë nuk është furnizuar...”<sup>1</sup>

Një grup tjetër nuk i mohon pozitat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe nuk i kundërshtojnë njerëzit e Allahut, por shqetësimi i këtij grupi për këtë botë dhe nxitimi që ata kanë për ta fituar këtë botë, si dhe qëllimi i tyre për të qenë të përjetshëm në kënaqësitë e zhdukshme të kësaj bote, atyre u është zënë rruga për realizmin e fitimit në fushën e diturisë, punës, “shijimit” dhe fitimit “rrethanor”. Ata janë të sëmurë. Gjendja e tyre, pa dyshim, është si gjendja e një të sëmuri, por dëshira e barkut e ndalon atë të pijë lëngje të nxehta ose të marrë ndonjë ilaç. Gjendja e këtij dietari, prej këtij grupi, është plotësisht si gjendja e një të sëmuri, që nuk beson se ekziston një sëmundje e këtillë, ose që i sëmuri është në shtëpinë e vërtetimit. Në të vërtetë, ai e mohon se kjo sëmundje ekziston, pavarësisht se vetë është prekur nga kjo sëmundje.

Një grup tjetër bazohet në fitimin e diturisë. Individu i këtij grupi merakoset se si të fitojë dituritë shkencore dhe në lidhje me njohuritë e pozitat e njerëzve të Allahut, ai mjaftohet vetëm me të vërtetat e njohurive të shprehura me terma, me fjalë e me shprehje të holla. Individët e këtij grupi dhe disa të tjerë të varfër si ata, kanë lidhur veten me prangat e parullave të termave. Ata janë të kënaqur prej të gjitha pozitave vetëm me fjalë e me shprehje.

Prej këtij grupi ka disa që e njohin të vërtetën e vetes së tyre, por me ato terma të zbrazëta që deklarohen, kanë për qëllim të arrijnë kryesinë mbi një grusht të mjeruarish dhe t’i përdorin ata si mjet për të fituar mjetet e jetesës. Në këtë drejtim, ata janë gjahtarë

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e gjysmës së një vargu të një vjershe e poetit Sadi Shirazi.



të zemrave të pastra të robërve të Allahut kundër të cilëve ata, me fjalë të sheqerosura mashtruese, ngrehin kurthe për të gjuajtur zemrat e tyre. Të këtillë janë shejtanët njerëz. Dëmi që bëjnë këta shejtanë mbi robtë e varfër të Allahut nuk është as më pak e as i më i vogël se dëmi i Iblisit të mallkuar. Këta shejtanë, me mashtrimet e veta, në zemrat e robërve të Allahut fusin shkujdesjen. Ato zemra, që janë banesa e të Vërtetit, askush s'ka të drejtë t'i vërë ato nën pushtetin e vet. Në gjendjen që janë individët e këtij grupi, në të vërtetë, ata janë grabitës të njëres prej banesave të të Vërtetit, janë shkatërrues të Qabes së vërtetë. Me idhujt që gdhendin, mbushin galeritë e zemrave të robërve të Allahut, zemrat e të cilëve përfaqësojnë imazhin e Qabesë në qiell, imazhin e asaj që quhet "Bejti Mamur". Ata vetë janë prekur nga sëmundje infektive dhe pretendojnë mjekimin prej sëmundjes, por, në të vërtetë, i infektojnë robtë e Allahut me lloje të shumta epidemish shumë të rrezikshme.

Shenja dalluese e individëve të këtij grupi është prirja e tyre për të orientuar njerëzit e pasur dhe njerëzit me autoritet. Ata nuk merren me njerëzit e varfër dhe me dervishët. Prandaj edhe ti shikon se shumica e pasuesve të tyre janë prej atyre që kanë autoritet e pasuri. Gjithashtu, shikon se ata vishen me rroba luksi si të pasurit e njerëzit autoritarë.

Gjithashtu, ti nuk e ke të vështirë të dallosh se edhe fjala e tyre arrin majat e mashtrimit e të trulllosjes. Para ndjekësve të tyre ata tregohen krejtësisht të pastër dhe hiqen sikur janë prej njerëzve të Allahut, megjithëse janë të ndotur me mijëra ndyrësish të kësaj bote. Ndjekësit e tyre të varfër nuk i kushtojnë rëndësi gjendjes së prijesve të tyre, por kujdesen për ta dhe nuk i shohin të metat e atyre mashtruesve, megjithëse hilet e tyre janë më se të ndjeshme



dhe me termat e fjalët e zbrazëta që lëshojnë individët e këtij grupi dijetarësh, hutohen e trullosen zemrat e buta të njerëzve të Allahut.

S'ka problem që e tjerrim pak bisedën rreth kësaj çështjeje dhe të citojmë disa transmetime të nderuara, që kanë ardhur në lidhje me këtë çështje, edhe pse kjo mund të jetë një dalje jashtë rrethit të bisedës, por është plotësisht i përshtatshëm bekimi me fjalët e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Es'Sadûku (*Allahu e mëshiroftë!*), në librin "El-Khisâl", ka transmetuar fjalën e Ebu Abdullahut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Ka dijetarë, që për vete mbledhin dituri, por nuk duan që të tjerët të marrin prej tyre. Këta dijetarë janë në shkallën e parë të zjarrit.

Ka dijetarë, që, kur këshillojnë, ngrefosen dhe, kur u kërkohet këshillë, tregohen të ashpër. Të këtillë dijetarë janë në shkallën e dytë të zjarrit.

Ka dijetarë, që me diturinë që zotërojnë, shkojnë në rrugën e tiranëve e të mbretërve dhe, nëse puna e tyre refuzohet, ose vlerësohet më pak, zemërohen. Këta janë në shkallën e katërt të zjarrit.

Ka dijetarë, që kërkojnë hadithet e jehudive dhe hadithet e kristianëve, që me ato të shtojnë e të forcojnë hadithin e tyre. Këta janë në shkallën e pestë të zjarrit.

Ka dijetarë, të cilët e vënë veten të shërbim të shërbyesve dhe u thonë atyre: "Na pyesni, mbase nuk ju prek asnjë germë e vetme". Allahu nuk i do artificialët. Këta janë në shkallën e gjashtë të zjarrit.

Ka dijetarë, që e marrin diturinë për forcë e për logjikë. Këta janë në shkallën e shtatë të zjarrit".<sup>1</sup>

El Kulejnj (*Allahu e mëshiroftë!*), në librin "Xhâmiatul-Kâfij", nëpërmjet përcjellësve, ka dhënë fjalët e Imam Bakirit (*Paqja qoftë*

---

<sup>1</sup>"El-Khisâl", vëll. 2, Hadithi 33, f. 352.



*mbi të!): “Kush e kërkon diturinë, që me diturinë t’u mburret dijetarëve, ose me të hiqet si i zgjuar, ose kërkon të tërheqë vëmendjen e njerëzve, ky kërkuar, le ta dijë mirë për ndenjësën e tij në zjarr, sepse kryesia nuk ka vlerë për dijetarët e vërtetë”.<sup>1</sup>*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur të shihni që një dijetar ka dashuri për këtë botë, akuzojeni për fenë tuaj, sepse ai që do një send, është i rrethuar prej sendit që ai do. Allahu Fuqiplotë i shpalli Daudit: “Mes Meje e mes teje mos bëj një dijetar të sprovuar me dashurinë për këtë botë, sepse ai të pret rrugën e dashurisë Sime. Njerëz të tillë janë kusarë që plaçkitin në rrugë robtë e dashuruar me Mua. Më e vogla që Unë bëj kundër këtyre kusarëve, është që zemrave të tyre t’ua heq ëmbëlsinë e bisedës intime me Mua”.<sup>2</sup>

Individë të tjerë të këtij grupi, të cilët nuk janë as mashtrues as spekulues, por janë rrugëtar në udhën e Botës Tjetër dhe përpiqen të fitojnë dituri e pozita, por ndonjëherë ndodh që bien pre e shejtanit, i cili u zë atyre rrugën dhe i bën të mendojnë se e vërteta e diturive dhe e pozitave qëndron pikërisht në termat shkencore që ata kanë endur vetë, ose i kanë marrë prej asaj që kanë endur të tjerët, të këtillët e kalojnë jetën në kërkim të shtimit të termave dhe në mësimin përmendësh të librave e të faqeve. Në këtë gjendje janë edhe disa dijetarë, interpretues të Kur’anit Famëlartë, të cilët e reduktojnë përfitimin prej Kur’anit Famëlartë në disiplinimin e mënyrave të leximit të Kur’anit, në nxjerrjen e kuptimeve të fjalëve dhe zbukurimit të fjalëve e të moraleve, duke përdorur gojëtarinë e bukur të Kur’anit, kuptimet konvencionale dhe mënyrat e ndryshme si i kuptojnë njerëzit ajetet e Kur’anit

---

<sup>1</sup>“El-Usùlu minel-Kâfi”, Libri “Mirësia e diturisë”, K. “Ngrënësi i pasurisë së tjetrit me diturinë e tij”, Hadithi 6.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 4.





Famëlartë. Në një kohë, kur këta individë janë krejtësisht të shkujdesur ndaj të vërtetës së thirrjeve të Kur'anit, ndaj anëve morale dhe ndaj diturive hyjnore. Gjendja e tyre është si gjendja e një të sëmuri, i cili interesohet vetëm të shkojë të mjeku dhe të ruajë recetën që ka shkruar mjeku për të, ku lexon përbërësit e ilaçeve që merr. Pa dyshim që sëmundja te ky i sëmurë shumë shpejt do të përkeqësohet dhe për rrjedhojë, këtij të sëmuri, më pas, nuk i bën dobi as dituria, as receta e mjekut e as shkuarja përsëri te mjeku.

Eh, i dashur, të gjitha shkencat, shkencat praktike, deri edhe dituritë në fushën e teologjisë, të gjitha janë praktika zemre dhe praktika klishe. Fjala “teuhid”, e analizuar nga pikëpamja e gramatikës së gjuhës arabe shpreh kthimin e shumicës te njëshi dhe është prej praktikave shpirtërore e prej praktikave të zemrës, që vazhdojnë të jenë realitet në shumicën e punëve, por ata s’kanë asnjë dijeni për Shkaktuesin e vërtetë të punëve. Unë nuk jam aq i vetëdijshëm, sa të të aftësoj ty për të parë të Vërtetin, por edhe ti, me punën tënde, kurrë nuk do ta shohësh Allahun në natyrë dhe kurrë nuk do të kuptosh se shumica e natyrës dhe shumica jashtë natyrës vërtet zhduken te i Vërteti e te punët e Tij. Përderisa në zemrën tënde nuk valëvitet pushteti i unitetit të veprimit të të Vërtetit, ti je shumë larg pastërtisë, sinqeritetit, qartësisë, eliminimit, madje je edhe larg besimit në Allahun, Zoti Një e i Vetëm (teuhid). Të gjitha llojet e hipokrizisë në punët dhe shumica e formave të hipokrizisë së zemrës, të gjitha e kanë burimin prej dobësisë së besimit në punët se Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Kush i konsideron këta njerëz të pafuqishëm e të mjeruar dhe me ndikim në shtëpinë e vërtetimit, ata kanë pushtet në mbretërinë e të Vërtetit. Atëherë, si është e mundur që ai s’ka nevojë të nxitojë, që të arrijë tërheqjen e zemrave dhe si e ndreq ai çështjen e zhdukjes



së punës së tij, ose çështjen e pastrimit të vetes prej idhujtarisë së shejtanit!? Detyra jote, i dashur, mbetet të punosh për zhdukjen e burimit, që të arrish në ujin e freskët e të pastër dhe pyete veten, a mund të bëjë i mallkuari i errët të rrjedhë ujë i pastër? Sikur ti të besosh që zemrat e robëve të Allahut janë të sunduara nga pushteti i të Vërtetit të Lartësuar dhe se me zemrën tënde ti e shijove kuptimin e shprehjes “يا مقلب القلوب” - “*jà mukal’libel-kulùb*” - “O Përmbysës i zemrave”, pastaj këtë kuptim e çon në veshin e zemrës, përsëri nuk ke punuar për tërheqjen e zemrave, sepse me këtë pafuqi e pamundësi nuk e bën dot zemrën tënde të kuptojë të vërtetën e frazës: “بيده ملكوت كل شيء وله الملك ويده الملك” - “*bijedihî melekùtu kul’li shej’inue lehul-mulku ue bijedihîl-mulk*” - “Në dorën e Tij janë mbretëritë e të gjitha sendeve, për Atë është sundimi dhe në dorën e Tij është mbretërimi”. Ti kurrë nuk do ta ndiesh nevojën për tërheqjen e zemrave dhe kurrë nuk do ta konsiderosh veten se ke nevojë për tërheqjen e zemrave të krijesave të pafuqishme, deri sa për ty të realizohet “pasuria e zemrës”. Vetëm atëherë do të ndiesh se je nevojtar. Kur ti të sjell në mendje fuqinë e njerëzve, për të përmbushur këtë nevojë, atëherë ti e ndien sa nevojë ke, që t’i tërheqësh zemrat dhe, kur ti mendon se je i veshur me shenjtëri, atëherë të mundësohet ndikimi mbi zemrat, por pikërisht atëherë mendon se ke nevojë për hipokrizinë. Sikur të mendosh se i Vërteti është ndikuesi i vërtetë dhe se ti s’ke asnjë pushtet në gjithësinë, vetëm në këtë pozitë ti nuk do të gjesh në brendësi të vetes tënde se nuk ke nevojë për ato modele të idhujtarisë.

O idhujtar, me një emër tjetër pretendo që ti beson se Allahu është Zoti Një e i Vetëm! O bir i Ademit, të gjitha këto ti i ke trashëgim prej Iblisit të mallkuar, i cili e mendon veten të veshur me shumë pushtete, deri sa nga mendjemadhësia shpalli me



mburrje të madhe: “لَا أُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ” - “...leugvijen'nehum exhme'ijne” - **“patjetër të gjithë do t'i mashtroj”**.<sup>1</sup> Në këtë gjendje, Iblisi është i mjeruar e i keq dhe ka rënë nën mbulesat e idhujtarisë e të vetëpëlqimit.

Të gjithë ata që mendojnë për botën e për veten e tyre, se vetë ata ekzistojnë në mënyrë të pavarur dhe jo nën protektorat, ky individ mendon se është zotërues i punës së vet, megjithëkëtë ai nuk mund të jetë zotërues i dinjitetit të tij mbretëror, të gjitha këto, i ka trashëgim prej djallëzive të Iblisit, prandaj zgjohu menjëherë nga përgjumja e thellë dhe bëj që në zemrën tënde të arrijnë ajetet e Librit hyjnor dhe shpjegimet e fletores hyjnore ndriçuese. Këto ajete të nderuara, pa dyshim, janë dërguar për të më zgjuar mua edhe ty; janë dërguar për të na zgjuar ne që e reduktojmë përfitim e dobive për veten tonë vetëm në leximin e Kur'anit sipas rregullave të caktuara për leximin e tij, por pa menduar rreth diturve që përmbajnë këto ajete. Kështu shejtani është bërë sundimtar mbi ne dhe ne jemi bërë robër të pushtetit të tij.

Po mjaftohem vetëm me kaq fjalë, sa u thanë, në lidhje me këtë çështje. Me dashjen e Allahut, do të rikthehem në këtë temë në një pozitë tjetër, në të cilën do të shpalos një anë tjetër të çështjes së etikës së leximit të ajeteve të Librit të Allahut. Me lejen e Allahut e me mbarësinë e Tij, do të shtroj rrugën për veten time dhe për robtë e Allahut, që të përfitojmë prej Kur'anit Famëlartë. Selam!

---

<sup>1</sup>Sure “Sàd”, ajeti 82.



## Ndarja e pestë

### DISA GRADË TË TJERA TË SINQERITETIT

Nëse e shtrijmë bisedën edhe më tej, duhet të përmendim disa gradë të tjera të sinqeritetit, që janë në përshtatje me pozitën.

*Njëra prej gradëve të sinqeritetit është pastrimi i punës prej ndjenjës se e meriton shpërblimin. Përballë pastrimit të punës qëndron ekzistenca e cenit të kërkimit të shpërblimit dhe besimi se e meriton shpërblimin për punën e bërë. Është e qartë se kjo gjendje nuk është pa një farë vetëpëlqimi për punën e bërë, prandaj rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë ta pastrojë veten prej kësaj ndjenje.*

Besimit se e meriton shpërblimin buron prej mangësive që janë te rrugëtari, në lidhje me njohjen e gjendjes dhe me njohjen e të drejtës së të Vërtetit të Gjithëfuqishëm. Gjithashtu, kjo mangësi është prej degëve të pemës së keqe të shejtanit, për shkak të së cilës rrugëtari shikon në veten e tij, në punën e tij, në të tanishmen e tij dhe në egoizmin e tij.

Përderisa njeriu i mjerë vazhdon të jetë nën mbulesën e shikimit të punëve të tij, punët që ai kryen, i konsideron si të vetat. Gjithashtu, ai e mbivlerëson veten, duke menduar që puna e kryer prej tij, do të ndikojë te të tjerët. Në këtë gjendje, ai kurrë nuk do të



shpëtojë prej sëmundjes së vetëpëlqimit dhe kurrë nuk do të ketë sukses në pastrimin e punëve që bën prej mangësive e prej ceneve.

Për të gjitha këto, rrugëtari në udhën e Allahut ka për detyrë të përpiqet që sa më shpjet të fillojë praktikimin e ushtrimeve të zemrës dhe të nisë udhëtimin logjik e njohës, me qëllim që ta bëjë zemrën e tij të kuptojë se të gjitha punët janë prej dhuntive e prej mirësive hyjnore dhe se i Vërteti i Lartësuar ka bërë që punët të dalin prej dorës së robit. Kur rrugëtari arrin të zgjidhë në zemrën e tij besimin se punët janë vetëm prej Allahut, Zotit Një e të Vetëm, ai kurrë nuk do të mendojë se puna del prej tij. Gjithashtu, nuk do të nxitojë të kërkojë shpërblimin, por, në radhë të parë, shpërblimin do ta shikojë si privilegj e si mirësi që i jepet prej Allahut Fuqiplotë.

Kjo fjalë e bukur hyjnore përmendet shpesh në fjalët e imamëve të ruajtur prej gjynaheve, sidomos në veprën “Es’ sahij fetu - S’sexhàdij’jetu”. Ky regjistër hyjnor e dritë e zbritur prej horizonteve të diturive të njohësit të Allahut, kjo fjalë e bukur ka dalë prej mendjes së ndritur të zotërisë së adhuruesve me sexhde të gjata, Imam Zejnel Abedinit. Duatë e shquara që janë përmbledhur në këtë libër, shërbejnë për të shpëtuar robtë e Allahut prej burgut të natyrës dhe për t’i bërë ata të kuptojnë etikën e robërisë dhe të qëndrimit në këmbë, në shërbim të Krijuesit të të gjitha sendeve.

Në lutjen (duanë) e tridhjetë e dytë ka ardhur fjala e tij:  
*“Lavdërimi të takon vetëm Ty, që fillove me mirësitë e mëdha! Falënderimi të takon vetëm Ty, për frymëzimin Tënd e për bamirësinë Tënde!”*



Në një vend tjetër lexojmë fjalën e tij: “Mirësia Jote është fillim dhe bamirësia Jote është favor”.<sup>1</sup>

Gjithashtu, në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” thuhet: “Kufiri më i afërm i sinqeritetit është shpenzimi i fuqisë nga ana e robit, pastaj për punën e tij tek Allahu ai nuk thotë se ka pjesë në punën e tij, atëherë Zoti i tij e shpërblen atë për punën e bërë”.<sup>2</sup>

Përballë kësaj gjendjeje e punëve të rrezikshme gjatë rrugëtimit, në raport me rrugëtarin, është se kjo gjendje i zë atij rrugën për të qenë së bashku me karvanin e rrugëtarëve në udhëtimin e tyre për tek Allahu dhe e mbyll atë në burgun e errët të natyrës.

Gjithashtu, kjo gjendje krijohet edhe prej penës së keqe të shejtanit dhe prej vetëpëlqimit, e trashëguar prej shejtanit, i cili ka thënë: “حَلَمْتِي مِنْ نَارٍ وَحَلَمْتُهُ مِنْ طِينٍ” - “...khalaktenij min n’nàrin ue khalaktehù min tijnin” - “...mua më krijove nga zjarri dhe atë e krijove nga balta”.<sup>3</sup> Kjo gjendje përfaqëson gjendjen e injorancës së njeriut për pozitën e të adhuruarit të Gjithëfuqishëm. Sikur ky i mjerë e i varfër të kishte kuptuar pozitën e mangësisë, të pamundësisë, të pafuqisë e të mbarimit të mashtrimit të tij dhe, sikur të njihete pozitën e madhësisë, të lartësisë e plotësimin e të Vërtetit Fuqiplotë, ai kurrë nuk do ta ngrinte aq lart punën e vet dhe kurrë nuk do ta llogariste veten se e kryen përgjegjësinë që ka. Këtu të tërheq vëmendjen fakti se ky njeri i mjerë parashikon një shpërblim kaq të madh, sa nuk mund të matet dhe këtë shpërblim ai e kërkon vetëm për faljen e dy rekateve namaz, në një kohë që namazi i tij është

---

<sup>1</sup> “Es’ahijetus’sexhàdij’jeh”, Duaja 12.

<sup>2</sup> “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 76 - “Sinqeriteti”.

<sup>3</sup> Sure “El Aràf”, ajeti 12; sure “Sàd”, ajeti 76.



namaz sunet dhe për ta falur këtë namaz kaza për të vdekurin ti paguan vetëm disa dinarë, por edhe kjo, kur jeni të sigurt plotësisht se ai namaz është falur me të gjitha kushtet.

Vetëpëlqimi dhe kënaqësia me punën, si dhe kërkimi sa më shumë, çon në degjenerime morale të panumërta dhe në shpërfytyrime të punëve. Do të zgjateshim shumë, nëse do t'i përmendim të gjitha këto lloje degjenerimesh. Hadithet e nderuara, në shumë raste, e vënë theksin mbi këtë çështje. Për shembull, në librin "El-Kâfi" lexojmë se Imam Musa bin Xhaferri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha njërit prej djemve të tij: *"O bir, ke për detyrë të jesh serioz dhe të mos kesh asgjë mangët në adhurimin e Allahut të Gjithëfuqishëm dhe t'i bindesh Atij, sepse Allahu asnjëherë nuk adhurohet ashtu siç është detyrë të adhurohet"*.<sup>1</sup>

Në një hadith tjetër, ai ka thënë: *"Me çdo punë, në të cilën qëllimi yt është Allahu Fuqplotë, dije se në atë punë, ti dhe vetja jote, jeni me mangësi. Jo vetëm kaq, por edhe të gjithë njerëzit, për punët që janë mes tyre e mes Allahut, nuk e kryejnë punën me kujdesin e duhur, me përjashtim të atyre që i ka ruajtur Allahu"*.<sup>2</sup>

Gjithashtu, në një moment tjetër, ai ka thënë: *"Mos e konsideroni se e mira është shumë"*.<sup>3</sup>

Në veprën "Es' sahijfetu-S' sexhàdij'jeh", gjatë përshkrimit të engjëjve të Allahut, ai ka thënë: *"Kur ata shohin Xhehenemin, rënkojnë në drejtim të atyre që të kundërshtojnë Ty dhe thonë: 'Ti je krejtësisht i*

---

<sup>1</sup>"El-Usùlu fil-Kâfi", Libri "Besimi e mohimi", K. "Pohimi i lënies mangët", Hadithi 1.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 4.

<sup>3</sup>"El-Usùlu minel-Kâfi", Libri "Besimi dhe mohimi", K. "Zvogëlimi i fajit", Hadithi 2 dhe K. "Llogaridhënia për punën", Hadithi 17.



*pastër nga të metat e nevojat, por ne Ty nuk të kemi adhuruar ashtu siç është detyra të të adhurojmë”.*<sup>1</sup>

Vetë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), më i dituri ndër krijesat e Allahut, puna e të cilit është me më shumë dritë e madhështi se puna e kujtdo tjetri, pohonte për veten e tij pamundësi e mangësi në punë: *“Nuk të kemi njohur ashtu siç është e drejta të të njohim dhe nuk të kemi adhuruar ashtu siç e meriton të të adhurojmë”.*<sup>2</sup> Edhe imamët e ruajtur prej gjynaheve kanë pohuar për veten e tyre mangësi dhe lënien mangët të punëve, atëherë ç’ duhet të bësh ti, o njeri i pafuqishëm në këtë pozitë?!

Imamët e ruajtur prej gjynahut, kanë qenë të ndërgjegjshëm në lidhje me pozitën e pohimit të pamundësisë nga ana e atij, “me mundësi ekzistence” dhe në lidhje me madhësinë e “Atij që ekziston detyrimisht”. Pikërisht kjo i shtyn ata të shprehen në këtë mënyrë. Kurse ne, të mjerët, pretendojmë pavarësi, krekosemi dhe kalojmë në hipokrizi. Të gjitha këto na çojnë drejt injorancës e drejt mbulimeve të ndryshme. O Allah, vetëm Ti je pa të meta e i dëlirë nga nevojat! Sa e drejtë është fjala e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Vetëpëlqimi është prej smirëzinjve më të mëdhenj”.*<sup>3</sup>

A nuk është mendje e shkurtër, që shejtani na e bën të errët një punë kaq madhështore dhe na pengon ta ndreqim punën me peshoren e mendjes?! Ne dimë se punët tona dhe punët e të gjithë njerëzve të zakonshëm, si dhe punët e të gjithë engjëjve shpirtërorë të Allahut s’kanë absolutisht asnjë vlerë, në krahasim me punët e të

---

<sup>1</sup>“Es’ sahifetu-S’sexhadij’jeh”, Duaja 3.

<sup>2</sup>“Mir’atul-Ukùl”, vëll. 8, Libri “Besimi”, K. “Falënderimi”, f. 146.

<sup>3</sup>“Nehxhul-Belàga”, (Fejdul-Islàm), f. 1172, Fjala e urtë 203.





Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) apo edhe me punët e imamëve udhëzues në rrugën e drejtë. Nga njëra anë, punët tona kundrejt punëve të tyre as duhet të përmenden dhe, nga ana tjetër, njohja e mangësisë dhe deklarimi i pamundësisë për të kryer punën ashtu siç duhet, është përmendur në mënyrë të vazhdueshme prej atyre burrave të pastër. Këto dy çështje të qarta na çojnë në rezultatin e qartë: nuk duhet të mburremi me asnjërin prej punëve që bëjmë, madje duhet të na vijë turp të përmendim punët që bëjmë, edhe sikur të kryejmë adhurim e t'i bindemi Allahut gjatë gjithë kohës që jemi në këtë botë. Jo vetëm kaq, por duhet të kërrusim kokën prej turp. Megjithëkëtë, ti i dashur, dije mirë, se përderisa shejtani është bërë sundues dhe ushtron pushtetin e vet mbi mendjet tona deri në atë shkallë, sa edhe pse i kemi mendjet, përsëri e kemi të pamundur ta kuptojmë këtë rezultat të nxjerrë prej premisave madhështore, për të mos thënë që zemrat tona përjetojnë një gjendje krejtësisht të kundërt.

Ja, Ali bin ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilin i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëshmoi përparësinë e një goditjeje të vetme nga ana e Aliut, ditën e luftës së Hendekut ndaj të gjitha adhurimeve të xhindeve e të njerëzve.<sup>1</sup> Pavarësisht nga kjo, ai vazhdoi të kryente adhurimet dhe të praktikonte ushtrime shpirtërore, çka bënë që Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe pse ishte prej adhuruesve më të mëdhenj të Allahut, përsëri deklaronte hapur pamundësinë e tij se ishte i ngjashëm me Imam Aliun<sup>2</sup>, pavarësisht se kryente aq shumë

<sup>1</sup>Goditja me shpatë e Aliut, ditën e betejës së Hendekut është më e mirë se adhurimi i xhindeve e i njerëzve, "Bihàrul Enuàr", vëll. 39, f. 2, (Historia e Prijësit të besimtarëve).

<sup>2</sup>"...kush është më i fuqishëm se adhurimi i Ali bin ebu Talibit..." , prej Imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*), "Bihàrul Enuàr", vëll. 46, f. 75.



adhurime dhe dallohej për përvuljen e thellë. Megjithëkëtë, ai vazhdimisht pohonte mangësitë personale më shumë nga sa mund të themi ne për të. Akoma më shumë se kaq, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili e ngriti aq lart Aliun, përsëri mbeti thjesht njëri prej robëve, që në praninë e tij dëshironte të merrte ato që tepronin nga tryeza e mirësive të diturive të tij dhe të përfitonte prej mësimëve e prej direktivave të tij. Vetë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse ishte aq i bindur, edhe pse kryente aq shumë adhurime, madje edhe pasi u vesh me rrobën e profetësisë së fundit, e cila përfaqëson të gjithë udhëtimin në rrethin e plotësimit dhe tullën e fundit në murin e diturisë dhe të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, përsëri vazhdoi të ngjitej në shpellën e malit Hira dhjetë vjet me radhë, për të kryer adhurim në vetmi, edhe pse këmbët e tij të uruara i bëheshin me plagë, kur ngjitej nëpër shkëmbinjte. Nga e gjithë kjo situatë, Allahu i Lartësuar i zbriti ajetin e nderuar: “مَا أُنزِلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ لِتَشْقَىٰ” - “TàHâ. Mâenzelnâ alejkel-kur’âne liteshkâ” - “**Tâ, Hâ. Ne nuk ta kemi shpallur Kur’anin ty (o Muhamed), për të të munduar**”.<sup>1</sup> Me këtë ajet, Allahu i Lartësuar i thotë Profetit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se nuk ta shpallëm Kur’anin, që ti të mundosh veten tënde. Ti je i pastër dhe udhëzues në rrugën e drejtë. Nëse njerëzit të kundërshtojnë, kundërshtimi i tyre vjen për shkak të mangësisë e të ligësisë së tyre dhe kurrë nuk vjen për shkak të mangësisë në rrugën tënde dhe në udhëzimin tënd. Megjithëkëtë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me fjalën e tij, shpreh pamundësinë e mangësinë e tij në lidhje me të drejtën që i takon adhurimit që të plotësohet.

---

<sup>1</sup> Sure “Ta Ha”, ajetet 1 - 2.



Es'sej'jid Ibni Tàùs ka transmetuar prej Imam Ali bin Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) një hadith, me të cilin ne i bekojmë këto faqe duke e cituar këtë hadith, edhe pse është një hadith i gjatë. Hadithi shpjegon disa gjendje të këtij zotërie të lavdëruar. Duke e cituar këtë hadith këtu, do t'i lehtësojmë shpirtrat, kur ata të nuhasin aromën e parfumit dhe do t'i zbusim zemrat, kur të shijojnë kënaqësinë.

Në librin e tij "Fet'hul-Ebvàb" me përcjellës prej Ez'zehrit, lexojmë: "Së bashku me Ali bin Hysenin hymë te Abdul Melik bin Merani. Abdul Meliku, kur pa shenjat e sexhdes në mes syve të Ali bin Hysenit, tha: 'O Ebu Muhamed, ti e ke të qartë se ç' do të thotë ixhtihad - e drejta për të shpjeguar çështjet nga ana juridike! Ti, që në fillim i ke mirësitë më të mëdha prej Allahut; ti je pjesë prej gjakut dhe mishit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*); je i afërm në fisin e tij dhe je shqetësimi i shkakut; ndër pjesëtarët e familjes tënde dhe ndër bashkëkohësit e tu ti je me virtyt shumë të lartë; ty të është dhënë prej mirësisë, diturisë, fesë dhe devocionit, aq sa nuk i është dhënë asnjërit prej të ngjashmëve me ty, prej atyre që kaluan para teje'.

Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) doli para tij dhe tha: 'Sa herë që e përmendja emrin e Allahut, sa herë përmendja cilësitë dhe mirësitë që kisha prej Allahut të Gjithëfuqishëm, mendoja se ku qëndron falënderimi i Allahut për mirësitë që më ka dhënë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndronte në këmbë në namaz aq gjatë, sa i ënjteshin këmbët; gjatë agjërimit kishte aq etje, sa i acarohesh goja. Kur atij i thuhej: 'O i Dërguar i Allahut, a nuk të ka falur Allahu fajet e mëparshme dhe të mëvonshmet?!', ai thoshte: 'A nuk jam unë rob falënderues?!'



Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun, për të gjitha të mirat që më ka dhënë e për të gjitha sprovat që më ka hedhur! Pasha Allahun! Sikur të më pritëshin gjymtyrët dhe sikur sytë të më rridhnin deri mbi gjoks, unë do të qëndroj në këmbë për Allahun e Gjithëfuqishëm, për ta falënderuar Atë, vetëm për njërën prej mirësive të Tij, të cilën njerëzit e zakonshëm nuk e numërojnë dot. Megjithëkëtë, për ta falënderuar Allahun Fuqiplotë, qoftë edhe për një mirësi të vetme, nuk mjafton falënderimi i të gjithë falënderuesve (atyre që thonë “elhamdu lil’läh”). Pasha Allahun! Mua nuk më ndalon asgjë që shihet e asnjë gjë që është e fshehtë, që të mos e falënderoj Allahun dhe të mos e përmend Atë ditën ose natën, në fshehtësi dhe sheshit.

Sikur unë të kem detyrim ndaj njerëzve të familjes sime, ose edhe ndaj të gjithë njerëzve, prej të përveçmëve e prej të zakonshmëve, unë kurrë nuk do të mungoja ta kryeja këtë detyrim ndaj tyre, sipas mundësisë e sipas fuqisë që kam. Por, për kryerjen e këtij detyrimi patjetër që do të hidhja shikimin në qiell dhe me zemrën time do të vështroja Allahun Fuqiplotë. Madje kurrë nuk do ta largoja shikimin tim prej andej, deri sa Allahu të ma marrë shpirtin. Ai është gjykatësi më i mirë’. Pastaj Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qau. Qau edhe Abdul Meliku...’’<sup>1</sup>

Po mjaftohemi me këtë pjesë të këtij transmetimi, prandaj nuk do të përmendim edhe disa gradë të tjera të sinqeritetit, pasi kjo do të bënte që të zgjateshim, njëkohësisht me këtë mënjanojmë lodhjen e mendjes e të trupit.

---

<sup>1</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 46, f. 57.



## KAPITULLI I KATËRT

### DISA RREGULLA TË LEXIMIT DHE NJË FLLAD PREJ SEKRETEVE TË LEXIMIT

*Në këtë kapitull do të mundohemi të japim një interpretim të sures së bekuar “El Hamd – El Fàtiha” dhe një kundërmim prej dy sureve: “Et Teuhid - El-Ikhlàs” dhe “El Kadr”.*

*Ky është prej kapitujve më të rëndësishëm të kësaj kumtese, të cilën ne e kemi vënë në disa “llamba”.*



## ***Llamba e parë***

# ***RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR KËNDIMIN E KUR'ANIT FISNIK***

## **Ndarja e parë**

### **ETIKA E MADHËRIMIT**

Për zbatimin me korrektësi të rregullave të rëndësishme gjatë këndimit të Librit hyjnor, janë të barabartë i dituri e i zakonshmi. Qëllimi i zbatimit të këtyre rregullave është që, nga këndimi i Librit të Allahut, të arrihen rezultatet më të mira. Patjetër që kjo e bën detyrim ndriçimin e zemrës dhe jetën e brendshme. Prej këtyre rregullave, në radhë të parë, qëndron (madhërimi) i Librit të Allahut. Madhërimi qëndron në të kuptuarit e madhështisë së Librit hyjnor.

Ky kuptim, me të vërtetën e tij, është jashtë kuadrit të shpjegimit, është mbi fuqinë e njerëzve, që të kuptojnë madhështinë e çdo pune, që të arrijnë në të vërtetën e saj, që të kuptojnë të vërtetën e Kur'anit Famëlartë, para zbritjes së tij në rangun moral



dhe para veshjes së tij me rrobat e veprimit prej punëve personale, të vërtetave shkencore në pozitën e “pranisë së të Vetmit”, në të vërtetën e “fjalës psikike logjike”, e përfaqësuar në “krahasimin e Vetes”, në “praninë personale” dhe në “praninë e emrave”. Pikërisht kjo është e vërteta, të cilën askush nuk e arrin dot, pavarësisht diturive që qarkullojnë. Nuk e arrin dot as me diturinë e cituar me tekst, as me zbulimet e të panjohurës. Kjo e vërtetë arrihet vetëm në saje të zbulimit të plotë hyjnor nga Profeti i fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*); realizohet në panelin e kënaqësisë së afrimit “قاب فوسين” - “kàbe kausejni” - **“sa madhësia e dy harqeve”**; realizohet në panelin e ëmbëlsisë së sekretit të pozitës “أُو أدنى” - “eu ednà” - **“ose edhe shumë më afër”**. Shpresat e familjes njerëzore janë të shkurtra për të arritur në këtë pozitë, me përjashtim të të sinqertëve prej miqve të Allahut, të cilët kanë pjesë në shpirtëroren e pastër të Profetit të fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Sipas dritave morale dhe të vërtetave hyjnore, ata u asgjësuan në atë prezencë, në saje të varësisë së plotë. Por këto dituri të zbuluara, ata i marrin me trashëgimi prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në zemrat e tyre pasqyrohet e vërteta e Kur’anit, me të njëjtën dritë e plotësim që shkëlqyen në zemrën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pa zbritur në pozicionet e pa u veshur me rrobat e etapave. Ky është Kur’ani i mirëfilltë, pa asnjë devijim e pa asnjë ndryshim; ky është Kur’ani i mirëfilltë i marrë prej Librit të revelatës hyjnore.

Ajetet e nderuara të Kur’anit Fisnik janë vënë të plota në duart e njerëzve dhe patjetër që janë disa etapa në përshtatje me



rrugëtimin për në praninë e emrave deri edhe në vendin më të ulët të botës së dëshmisë e të sundimit.

Patjetër që gradët e etapave janë në përputhje të plotë me brendinë e Kur'anit Famëlartë, janë në përputhje hap pas hapi me dallimin se etapata zbresin prej të panjohurës absolute në të qartat absolute sipas botëve. Bazuar mbi këtë, parimi i etapave dhe parimi i të brendshmeve, nga njëra anë, janë të pasqyruara dhe rrugëtari në udhën e Allahut pastrohet me arritjen e çdonjërës prej gradëve të së brendshmeve dhe prej çdo grade të etapave, deri sa arrin në të brendshmen absolute, që është e brendshmja e shtatë e përgjithshme, e cila është krejtësisht e pastër prej etapave.

Në raport me ndonjë person, Kur'ani Famëlartë ka kaluar nëpër të gjitha llojet e etapave, kurse në raport me një tjetër, gradët e etapave, në origjinë, nuk janë etapa dhe kështu me radhë.

S'ka asnjë problem që e theksuam këtë çështje, megjithëse më sipër shpjeguar se kuptimi i madhësisë së Kur'anit Famëlartë është jashtë kuadrit të kuptimit në formë të përgjithshme të madhësisë së këtij Libri të zbritur dhe që është në qarkullim në mesin e të gjithë njerëzve. Në të vërtetë, në shpjegimin e kuptimit të madhësisë së Kur'anit Famëlartë ka përfitime të shumta.

I dashur, mëso se madhështia e çdo fjale dhe e çdo libri buron ose nga madhështia e atij që e ka thënë atë fjalë, ose nga madhështia e atij që e ka shkruar atë fjalë, ose nga madhështia e personit, te i cili është dërguar dhe e mbart atë, ose nga madhështia e atij që e ruan librin në mendje dhe punon shumë për ta ruajtur atë, ose prej madhësisë së shpjeguesit e interpretuesit të tij, ose edhe prej madhësisë së kohës dhe formatit të të dërguarit.





Disa prej këtyre punëve kanë rol në formimin e kësaj madhështie si person dhe në esencë, të tjera punë janë të ardhura me ndërmjetësim (direkt dhe indirekt), disa prej këtyre etapave luajnë rolin e zbuluesit të kësaj madhështie, që më pas janë të realizuara në anën më të plotë në Kur'anin Famëlartë, në këtë fletë dritë. Prej veçantive të këtij Libri është se ky libër, në mënyrë absolute, nuk ka pjesë nga asnjë libër tjetër, ashtu siç nuk ka shoqërues nëpër këto etapa në të gjitha gradët.

Madhështia e Kur'anit, nga ana e thënësit, burimit dhe zotëruesit të tij: Ky është i Larti, është Madhështori Absolut, prandaj çdo formë përfytyrimi e madhësisë në mbretërim e në cilësi, në të gjitha fuqitë e zbritura në botën e panjohur dhe në botën e njohur, të gjitha këto nuk përfaqësojnë asgjë më shumë se vezullime prej shkëlqimeve të madhësisë së veprës së të Gjithëfuqishmit, prandaj shkëlqimet e madhësisë së Tij, mund të arrihen vetëm pas mijëra mbulesave e perdeve, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar: *“Për Allahun ka shtatëdhjetë mbulesa (prej drite e prej errësire dhe, sikur ato të zbuloheshin, pa dyshim do të digjeshin fluturimet e mendimeve të atyre që janë nën Të)”*.<sup>1</sup>

Sipas mendimit të atyre që kanë arritur gradën e njohjes, i Vërteti i Lartësuar është fillesa e të gjitha punëve personale, cilësive, punëve, me të gjitha shkëlqimet e bukurisë e të madhësisë, prandaj Kur'ani Fisnik është në pozitën më të lartë ndër të gjithë librat qiellorë.

---

<sup>1</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 58, f. 44. Në këtë libër lexojmë: *“Poshtë Allahut ka një mijë mbulesa prej drite dhe errësire. Kushdo që dëgjon prej këtyre mbulesave, patjetër që do të vdiste”*. Në faqen 45, lexojmë se Xhibrili (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Për Allahun, nën Arsh, ka shtatëdhjetë mbulesa. Sikur ne të afroheshin te ndonjëra prej këtyre mbulesave, patjetër që do të na digjnin fluturimet e mendimit në Zotin tonë”*.



Madhështia e Kur'anit qëndron në madhësinë e përmbajtjes, qëllimeve dhe objektivave të tij. Kjo çështje kërkon një studim të detajuar e të pavarur, madje kërkon një studim të ndarë në kapituj, në kumtesa e në libra të pavarur. Por edhe me këto, bëhet e qartë vetëm njëra anë e madhësisë së tij. Më pas do të vëmë një ndarje të veçantë për ta theksuar këtë çështje në përgjithësi, në të cilën do të vëmë në dukje madhësinë e Kur'anit, nga këndvështrimi i rezultateve dhe i frutave të tij.

Për sa i përket madhësisë së Kur'anit, nga këndvështrimi i lajmëtarit të shpalljes dhe ndërmjetësimit të prurjes së shpalljes, ky lajmëtar është Xhibrili i nderuar, pasi Kur'ani doli jashtë veshjes njerëzore dhe orientimit të tij drejt zemrës për në prezencën e fuqisë e të madhësisë. Xhibrili është njëri prej katër kolonave të "shtëpisë së vërtetimit" dhe është më i madhi e më i nderuari i llojit të këtyre kolonave. Ai është dritë, është engjëlli i ngarkuar me diturinë e urtësinë, është zotëruesi i furnizimeve morale e i ushqimeve shpirtërore. Një shikim i vetëm në ajetet e ardhura në Librin e Allahut dhe në njoftimet që vijnë prej haditheve të nderuara, mjafton për të kuptuar dimensionin e madhësisë e të madhërisë së shpalljes që solli Xhibrili, duke shtuar se ai është mbi të gjithë engjëjt.

Madhështia e Kur'anit, nga këndvështrimi i madhësisë së personit që iu dërgua Kur'ani dhe mbartësi i Kur'anit, është zemra e pastër e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në atë zemër shkëlqen i Vërteti i Lartësuar, me të gjitha veprat e qenësishme: me cilësitë, me emrat e me punët. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është mbyllësi i profetësisë e i kujdestarisë absolute, është më i nderuari e më i madhi i krijesave, është esenca e ekzistencës, është



ekstrakti i shtëpisë së vërtetimit, është tulla e fundit, është zotëruesi i Berzahut më të madh e i kalifatit madhështor.

Për sa i përket madhësisë së Kur'anit, nga këndvështrimi i ruajtësit të tij, ky ruajtës është Qenia e pastër e të Vërtetit të Gjithëfuqishëm, ashtu siç njoftohet në këtë ajet:

“إِنَّا نَحْنُ نُزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ” - “In'nà nahnu nez'zelne-dh'dhikre ue in'nà lehù lehâfidhùn” - **“Ne e zbritëm Kur'anin dhe Ne e ruajmë atë”**.<sup>1</sup>

Për sa i përket madhësisë së Kur'anit, për nga këndvështrimi i shpjeguesit e interpretuesit të tij, ata janë të ruajturit prej fajeve e gjynaheve, duke filluar me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe duke përfunduar me argumentin e shekullit (*Allahu e shpejtoftë shfaqjen e tij!*). Ata janë çelësat e gjithësisë, janë depot e madhësisë, janë mademi i urtësisë së shpalljes, janë origjinat e diturive e talenteve dhe janë zotërues të pozitës së mbledhjes e të shkoqitjes.

Për sa i përket kohës së zbritjes së shpalljes, kjo kohë është Nata e Kadrit, më e madhja e netëve. Kjo natë është: “حَجْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ” - “...khajrun min elfi shehrin” - **“më e rëndësishme se një mijë muaj”**.<sup>2</sup> Është nata me më shumë dritë. Në të vërtetë, është mbërritja e kujdestarit absolut dhe e vulës së të dërguarve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Për të shpjeguar mënyrën e shpalljes dhe protokollimit të saj, kjo çështje është shumë e gjerë dhe studimi rreth saj do të rezultonte i gjatë dhe do të dilte me shumë degë.

<sup>1</sup>Sure “El Hixhr”, ajeti 9.

<sup>2</sup>Sure “El Kadr”, ajeti 2.



## Ndarja e dytë

# SHPJEGIMI NË VIJA TË PËRGJITHSHME I QËLLIMEVE, KËRKESA VEDHE BRENDISË SË LIBRIT HYJNOR

Mëso se ky Libër madhor, ashtu siç shkëlqen me shprehjet e tij, është Libër i udhëzimit në rrugën e drejtë, është orientues i rrugëtimit të njerëzimit, është edukues i shpirtrave, është shërues i sëmundjeve të zemrës dhe pishtar në udhën për tek Allahu i Lartësuar.

Allahu Fuqiplotë është Mëshirëgjërë ndaj robëve të Vet dhe për këtë Ai e zbriti këtë Libër prej pozitës së afrimit e të pastërtisë së Tij në atë ç'ka është në përshtatje me botët e ndryshme, deri sa arriti në burgun e natyrës së kësaj bote të errët dhe e veshi atë me kallëpet e fjalëve dhe me shkronjat më të qarta, me synimin për të shpëtuar të burgosurit në burgun e errët të kësaj bote dhe për t'i liruar ata deri edhe nga prangat e shpresave më të mëdha. Me këtë Libër, Ai i ngre robtë e Tij prej humnerës së mangësisë, pafuqisë e kafshërores dhe i lartëson në majën më të lartë të plotësimit e të fuqisë njerëzore; i largon nga fqinjësia me shejtanin dhe i lartëson në shoqërimin e shpirtërorëve, madje i lartëson ata në pozitën e afrimit dhe realizimit të gradës "së takimit me Allahun", gradë që te njerëzit e Allahut përfaqëson qëllimet e kërkesat më të mëdha.



Ky është Libër i thirrjes për te e vërteta dhe lumturia. Gjithashtu, në këtë Libër shpjegohet rruga për arritjen e kësaj pozite. Në përgjithësi, përmbajtjet e këtij Libri përfaqësohen në çdo gjë që ka ndikim në këtë udhëtim e në këtë rrugëtim hyjnor dhe çdo gjë që e ndihmon rrugëtarin e udhëtarin që ka marrë rrugën për tek Allahu.

Njëri prej qëllimeve kryesore të këtij Libri është thirrja për të njohur Allahun, për të shpjeguar dituritë hyjnore, për të shpjeguar punët e qenësishme personale të Qenies së pastër, të emrave të Tij, të cilësive të Tij. Por më e rëndësishme nga të gjitha këto, në rrugën e realizimit të këtij objekti, është fakti që Kur'ani zbulon unitetin e Qenies, emrave dhe punëve. Disa nga këto çështje përmenden qartë në Kur'an, në një kohë që disa të tjera janë përmendur me aludim dhe për rrjedhojë, kanë nevojë për studim dhe për shpjegim.

Meriton të dihet se këto dituri – duke filluar nga dituria për Qenien e pastër dhe duke përfunduar me njohjen e punëve - në këtë Libër hyjnor gjithëpërfshirës, të gjitha kanë ardhur në një mënyrë të atillë që i mundëson çdo shtrese të kuptojë prej këtij Libri aq sa e ka mundësinë: siç është gjendja me ajetet që kanë ardhur në lidhje me besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), sidomos në lidhje me unitetin e punëve. Dijetarët e anës së jashtme (dhadhiritë), dijetarët në fushën e hadithit dhe fukahatë (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*), të gjitha këto i kanë interpretuar dhe i kanë shpjeguar në mënyra të ndryshme dhe me dallime plotësisht të qarta nga interpretimi e nga orientimi i atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe dijetarëve të së brendshmes (bâtinitë).



Dhe, unë, robi i Allahut, besoj se të dy llojet e interpretimeve janë të sakta dhe çdo interpretim është në vendin e vet. Unë besoj se Kur'ani Famëlartë është ilaç për shërimin e sëmundjeve të brendshme. Çdo sëmundje, Kur'ani e mjekon me një rrugë të veçantë, ashtu siç njoftojnë këto ajete: “هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ” - “*huvel-ev'velu uel-àkhiru uedh'dhàhiru uelbàtinu*” - “**Ai është i pari (pa fillim), Ai është i fundit (që s'ka mbarim), Ai është i dukshmi dhe i padukshmi**”.<sup>1</sup>

“السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّيْلِ وَالنَّجْمِ” - “*All'llàhu nùru-s'semàvòati uel-erdi*” - “**Allahu është dritë e qiejve dhe e tokës**”.<sup>2</sup>

“وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِلَّذِينَ يُرَوِّدُونَ فِي السَّمَاءِ” - “*ue huve-l'lehij fi-s'semài ilàhu ue fil-erdi ilàhun*” - “**Në qiell Ai është i Adhuruari dhe në tokë Ai është i Adhuruari**”.<sup>3</sup>

“وَهُوَ مَعَكُمْ” - “*ue huve meakum*” - “**Ai është me ju (kudo që të jeni)**”.<sup>4</sup>

“فَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قَدْ جَاءَكُمْ آيَاتٌ مِنَ اللَّهِ” - “*fe'ejnemà tevel'lù fethem'me vexh'hu-ll'làhi*” - “**në çdo anë që të ktheheni, ajo është anë e Allahut**”.<sup>5</sup>

Mund të shtojmë edhe ajete të tjera që kanë ardhur në lidhje me Njëtimin e Allahut, ose ajetet e nderuara që kanë ardhur në lidhje me unitetin e cilësive, siç është ajeti i fundit i sures “El Hashr”, si dhe ajetet: “وَمَيِّتٌ إِذْ رَمَيْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَمًا” - “*u mà remejte idh remejte*”

---

<sup>1</sup>Sure “El Hadid”, ajeti 3.

<sup>2</sup>Sure “En Nùr”, ajeti 35.

<sup>3</sup>Sure “Ez Zukhruf”, ajeti 84.

<sup>4</sup>Sure “El Hadid”, ajeti 4.

<sup>5</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 15.



*ue lakin'ne-ll'lahe remà*” - **“Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante”**.<sup>1</sup>

“*الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ*” - *“elhamdu lil'làhi rab'bil-àlemijne”* - **“Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun, Zotin e botëve”**.<sup>2</sup>

“*يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ*” - *“juseb'bihu lil'làhi mà fis'semàvàti ue mà fil-erdi”* - **“Allahun e përlëvdon gjithçka, që gjendet në qiej dhe në Tokë. Atij i takon pushteti epror dhe lavdia. Ai është i Fuqishëm për çdo gjë!”**<sup>3</sup>

Ka dhe shumë ajete të tjera që tregojnë se të gjitha punët janë prej Allahut, Zotit Një e të Vetëm (teuhjdul-ef'âl). Disa nga këto ajete tregojnë në mënyrë të hollësishme për një lloj Njëtimi të Allahut. Ajete të tjera tregojnë për këtë lloj Teuhidi në mënyrë njohëse. Të gjitha këto ajete janë shëruese për sëmundjet, në raport me secilën shtresë prej shtresave të dijetarëve dhahiri e bätini. Disa ajete të tjera të Kur'anit, si ajetet e para të sures “El Hadid” dhe ajetet e bekuara të sures “El Ikhlàs”, siç theksohet në hadithin e cituar në librin “El-Kâfi”<sup>4</sup>, këto ajete janë për “të thelluarit”, që do të jetojnë në kohën e fundit. Megjithëkëtë, dhahiritë kanë marrë prej këtyre ajeteve gjithçka që u sjell atyre dobi. Kjo është njëra prej mrekullive të këtij Libri universal.

Prej qëllimeve e prej objektivave të tjera të Kur'anit Famëlartë është: edukimi i shpirttrave, pastrimi i të brendshmeve prej ndyrësive të natyrës, arritja e lumturisë dhe shpjegimi në

---

<sup>1</sup>Sure “El Enfâl”, ajeti 17.

<sup>2</sup>Sure “El Xhumua”, ajeti 1.

<sup>3</sup>Sure “Et Tegàbun”, ajeti 1.

<sup>4</sup>Lexo “Usûlul-Kâfi”, “Kapitulli i Njëtimimit”, kreu “Relativiteti”, Hadithi 3.



përgjithësi i punës madhore rreth mënyrës së ecjes në udhëtimin për tek Allahu. Kjo punë madhore ndahet në dy pjesë të rëndësishme: *e para*: devotshmëria (takva), me të gjitha gradat e saj; devotshmëri vetëm ndaj Allahut dhe jo ndaj ndonjë tjetri, si dhe largim absolut prej çdo gjëje përveç të Vërtetit Fuqplotë; *e dyta*: besimi në të gjitha gradët dhe punët selektive të besimit, siç është afrimi te i Vërteti dhe kthimi te Qenia e pastër. Pikërisht, afrimi e kthimi te i Vërteti është prej qëllimeve të rëndësishme të këtij Libri Famëlartë, te i cili referohen direkt dhe indirekt shumica e kërkesave.

Prej kërkesave të tjera në këto “Fletë hyjnore” janë tregimet e profetëve, eulijave, të urtëve, mënyra si i ka edukuar ata i Vërteti dhe mënyra si ata edukuan njerëzit. Në të gjitha këto ka aq dobi, sa nuk mund të numërohen. Njëkohësisht në këto tregime ka shumë orientime e direktiva prej diturive hyjnore-edukuese. Të gjitha këto, në këtë Libër Famëlartë janë të deklaruara qartë ose me aludim, për çdo çështje që mund të ngatërrojë mendjen. Vetëm Allahu, i Plotpushtetshmi është pa asnjë të metë, vetëm Ai s’ka asnjë nevojë! Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun!

Në tregimin e Ademit, ku urdhërohen engjëjt që t’i bëjnë sexhde Ademit, mësimi i emrave prej Ademit dhe të tjera ndodhi që ndodhën mes Iblisit e Ademit - janë prej ndodhive të përmendura shpesh në Librin e Allahut. Në të gjitha tregimet e ardhura në Kur’anin Famëlartë ka shumë mësim e çështje edukative, dituri e njoftime, madje ka aq shumë, sa në të vërtetë njeriu trulloset: “لَمَّا كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْفَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ” - “...limen kàne lehù kalbun





*eu elka-s'sem'a ue huve shehijdun*" - "**...për atë që ka mendje të shëndoshë, ka dëgjuar me vëmendje dhe është i drejtë**".<sup>1</sup>

Për sa i përket shkakut të përsëritjes së tregimeve kur'anore, si tregimi i Ademit, i Musait dhe i të gjithë profetëve të tjerë, është se ky Libër nuk është as libër historie e as libër tregimesh, por është libër rrugëtimi e udhëtimi për tek Allahu, është libër që shpjegon se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, është libër i diturive, është këshillë e urtësi, për rrjedhojë përsëritja e këtyre temave duhet bërë patjetër, që të ndikojnë sa më shumë në shpirtrat e ashpër e të fortë të atyre që i lexojnë. Gjithashtu, përsëritja është edhe me qëllim që këshilla të arrijë në zemër. Me fjalë të tjera, çdo njeri që ka qëllim të edukohet, të mësojë, të paralajmërohet e të përgëzohet, ai ka detyrë të thotë qëllimin e tij me shprehje të shumëllojshme e me forma të ndryshme shpjegimi, të marra nga këto tregime, herë nga fjalët e urta, herë tjetër nga historia dhe herë tjetër nga leximi i teksteve. Të gjitha këto shprehje në Kur'anin Famëlartë kanë ardhur me deklaram të drejtpërdrejtë dhe me forma të zgjeruara; herë tjetër kanë ardhur me aludim. Qëllimi i të gjitha këtyre është që zemrat e ndryshme dhe shpirtrat e shumtë të përfitojnë prej këtyre tregimeve, njëkohësisht edhe të tjerët të marrin njoftime rreth ndodhive që shpalosen në tregimet e Librit të Allahut. Ky Libër Fisnik ka si objektiv realizimin e lumturisë për të gjitha shtresat e njerëzimit. Por, meqenëse shtresat e njerëzve janë të ndryshme, nga ana e gjendjes së zemrave të tyre, nga ana e zakoneve e nga ana e moraleve të tyre, vetëkuptohet që edhe nga gjendjet e tyre, sipas kohës e sipas vendit, vështirësohet shumë realizmi i qëllimit të këtij Libri, që të mjaftohet vetëm me një thirrje drejtuar njerëzve. Patjetër që ka persona që s'kanë mundësi t'i përgjigjen thirrjes drejtpërdrejt,

<sup>1</sup>Sure "Kâf", ajeti 37.



ose është e pamundur që njerëzve t'u drejtohen kërkesat drejtpërdrejt. Veç kësaj, një kërkesë e drejtuar me këtë mënyrë nuk do të kishte ndikim, prandaj mbetet detyrë që duhet të ndiqet rruga e thirrjes, drejtuar një kategorie të këtyllë njerëzish, me një mënyrë tjetër dhe ata, nëpërmjet asaj mënyre, do të kuptojnë. Prandaj thirrja, patjetër, duhet bërë në përshtatje me kapacitetet intelektuale të njerëzve.

Në të njëjtën kohë, ka persona që nuk priren as prej tregimeve, as prej fjalëve të urta, as prej historive, por dëshirojnë shpalosjen e mendjes së kërkuesit, megjithëse nuk priren as kah logjika e qëllimeve që mbartin këto tregime, njoftime e fjalë të urta. Kjo shtresë nuk ka mundësi t'i trajtojë këto çështje me një mënyrë të ngjashme me mënyrën si i ka trajtuar ato shtresa e parë.

Disa zemra janë të atilla që ndikohen vetëm nga gjuha e kërcënimit dhe e frikësimit. Për të gjitha këto, ne shohim se Kur'ani u bën thirrje njerëzve me mënyra të ndryshme dhe përdor rrugë të shumta, që dallojnë qartë nga njëra-tjetra. Përsëritja në Kur'anin Famëlartë është një punë e domosdoshme, sepse thirrje të këshilla dalin jashtë cakut të oratorisë, kur mungon përsëritja e degëzimi në shpalosjen e çështjeve, megjithëkëtë ndodh që objektivi i kërkuar nuk mund të realizohet, domethënë shpirti nuk ndikohet nga ajo që thuhet. Veç kësaj, çështjet e shtruara në këtë Libër hyjnor, edhe pse kanë ardhur me rrugë të ndryshme, te njeriu nuk shkaktojnë zemërim, për shkak të përsëritjes së çështjeve. Çdo herë që Kur'ani përmend një çështje, në të vërtetë, me përsëritjen përmend një anë tjetër të historisë; çdo herë që flet për një fjalë të mençur prej diturive të shumta, ose për njërën prej sjelljeve, moraleve të rëndësishme, e bën atë bosht rreth të cilit vërtitet biseda që shpjegon atë çështje. Në të vërtetë, shpjegimi i kësaj çështjeje kërkon



një ekzaminim të plotë të tregimeve kur'anore. Për shkak të vendit, ky shpjegim nuk mund të futet në këtë kumtesë të shkurtër. Ai që dëshiron më shumë rreth kësaj çështjeje, unë, i pafuqishmi, i them: "S'kam fuqi të shkruaj një libër në lidhje me tregimet kur'anore dhe zgjidhjen e sekreteve që përmbajnë këto tregime, prandaj mbarësinë e kërkoj vetëm prej Allahut, që të më japë mundësi sa të vë theksin mbi rrugët që përmbajnë këto tregime në fushën e mësimdhënies e të edukimit. Patjetër, aq sa është e mundur, edhe pse kjo punë mund të jetë thjesht një shpresë foshnjarake dhe iluzion i gabuar për cilindo që është i ngjashëm me mua".

Në të gjitha gjendjet, përmendja e tregimeve rreth profetëve, përmendja e ecurisë së tyre për të kumtuar mesazhin që mbartnin, përmendja e moraleve të tyre dhe e metodave që ata kanë përdorur për të edukuar robtë e Allahut, si dhe tregimet rreth gjykimeve që ata kanë dhënë, apo këshillat e tyre dhe diskutimet e polemikat që ata kanë zhvilluar, të gjitha këto ata i kanë shprehur me fjalët më të bukura, sepse ato janë një portë prej portave të gjera të diturive e të gjykimit. Gjithashtu, janë hyrja më e madhe e lumturisë dhe e direktivave që i Vërteti Fuqplotë ka hapur para robëve të Vet. S'ka asnjë problem, që në këtë portë e në këtë lumturi të ketë pjesë të madhe edhe për njerëzit e zakonshëm, përveç pjesës që kanë dijetarët e mëdhenj, rrugëtarët në udhën e Allahut dhe ata që praktikojnë ushtrime shpirtërore.

Në të njëjtën kohë, ata që kanë arritur gradën e njohjes (marifetit), kuptojnë prej ajetit të nderuar: "كُوْبًا فَلَمَّا جُرِّ عَلَيْهِ اللَّيْلُ رَأَى" - "Felem'mà xhen'ne alejhi-l'lejleu reà keukeben..." - **"Kur ra nata, ai pa një yll..."**<sup>1</sup>, se duhet të ndjekin rrugën e metodën e punës së

<sup>1</sup>Sure "El En'am", ajeti 76.



Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) në rrugëtimin e në udhëtimin e tij për tek Allahu Fuqplotë. Gjithashtu, prej këtij ajeti ata mësojnë jo vetëm rrugën që do të marrin në udhëtimin e tyre për tek Allahu dhe ecjen drejt Tij, por kuptojnë të vërtetën e ecjes shpirtërore dhe rrugëtimin moral prej fundit të errësirës së natyrës, e shprehur në rrugëtimin e tyre, me frazën e ajetit të mësipërm: “جَنَّ عَلَيْهِ اللَّيْلُ” - “*xhen’ne alejhi-l’lejleu*” - “**kur ra nata**” deri në hedhjen tutje, në mënyrë absolute, të tanishmes, egoizmit, heqjes dorë prej vetes, heqjes dorë prej vetëpëlqimit. Me rrugëtimin e tij ai synon arritjen e pozitës së pastër dhe hyrjen në panelin e kënaqësisë. Kjo pozitë e pastër, në rrugëtimin e tyre, theksohet në ajetin:

“وَجِئْتُ وَنَجِي لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ” - “...*vexh’xhehtu vexh’hiq lil’ledhiq fetare-s’semàvati...*” - “**Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën...**”<sup>1</sup>

Ne shohim se të tjerë kuptojnë prej këtij rrugëtimi “udhëtimin në horizont” dhe metodën që përdori miku i të Gjithëmëshirshmit, Ibrahim, për edukimin dhe për mësimin e popullit të tij.

Në këtë mënyrë, edhe përfitimet e përpjekjet e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të praktikueseve të ushtrimeve shpirtërore janë të ndryshme nga përfitimet që arrijnë të tjerët nga leximi i tregimeve e historive, siç janë tregimet rreth Ademit, Ibrahim, Musait, Jusufit e Isait (*Paqja qoftë mbi ta!*) apo tregimi i takimit të Musait me Hidrin, tregim që, në të vërtetë, formon një kapitull të pavarur nga ana e urtësisë dhe e këshillave, që i Vërteti i Lartësuar shpalos në këtë tregim, ku fton robtë e Tij t’i

---

<sup>1</sup>Sure “El En’àm”, ajeti 79.



përvetësojnë këto këshilla e mësimi, sa herë që u jepet rasti. Por, në radhë të parë, bën thirrje që njerëzit të pajisen me diturinë hyjnore kryesore: Njëtimi i Allahut dhe pastrimi i të Vërtetit prej çdo të mete e prej çdo nevoje, siç tregohet në suren “Et Teuhid”, “ElIkhlàs”, në fillimin e sures “El Hashr” dhe në fillim të sures “El Hadid”, pa përmendur suret e ajetet e tjera të Librit hyjnor, që flasin për këtë çështje.

Zotëruesit e mëparshëm, zemra e të cilëve ishte e mbushur me mirësi, janë shembuj të këtyre përfitimeve të panumërta.

Për shembull, dijetarët përfitojnë e mësojnë prej ajetit të nderuar:

“وَمَنْ يَخْرُجْ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكُهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ”

“...ue men jakhruxh min bejtihî muhàxhiren ile-ll'làhi ue resùlihi thum'me judrikhul-meutu fekad veka'a exhruhù ale-ll'làhi...” -“**Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë...**”<sup>1</sup>se do të shpërblehenpër kryerjen e adhurimeve të vullnetshme (nafile) ose për kryerjen e adhurimeve të detyrueshme (farz). Të tjerë, prej këtij ajeti kuptojnë largimin dhe emigrimin për në Mekë ose për në Medine.

Ose prej ajetit: “أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَاقَدْ” - “**Kad efelha men zek'kàhà. Ue kad khàbe men des'sàhà**” - “**Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë,ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë**”<sup>2</sup>, përfitohet e mësohet një thirrje për

<sup>1</sup>Sure “En - Nisà”, ajeti 100.

<sup>2</sup>Sure “Esh - Shems”, ajetet 9-10.



edukimin e shpirttrave dhe për praktikimin e ushtrimeve shpirtërore, për punë të mirë, ashtu siç dihet zakonisht, ose si paralajmërim për gjithçka që ndodh kundrejt këtyre punëve.

Në këtë kapitull bën pjesë urtësia e Lukmanit, e dijetarëve të mëdhenj dhe e besimtarëve. Të gjitha këto tregime përmenden në këto “fletë hyjnore”, të shpërndara në jetët e ndryshme, siç është tregimi për djemtë e shpellës dhe gjithçka që ndodhi me ta.

Prej temave të tjera të shumta të këtyre fletëdrite, është edhe shpjegimi i gjendjeve të mohuesve e mosbesimtarëve, i gjendjeve të armiqve të të Vërtetit dhe kundërshtarëve të së vërtetës, të cilët kundërshtuan profetët dhe eulijatë. Gjithashtu, tregohet qartë edhe përfundimi i punëve të mohuesve. Në tregimet e Librit fisnik njoftohet se si u shkatërruan e u asgjësuan krerët e mohuesve, siç është tregimi që flet për shkatërrimin e faraonit, Nemrudit, ushtrisë së elefantit dhe e tiranëve e mizorëve të mëdhenj. Në secilën prej këtyre tregimeve, përveç përshkrimit të ndodhisë, ka shumë këshilla e urtësi, madje edhe për dijetarët ka aq shumë dituri, sa nuk mund të numërohen.

Ndër këto tregime janë edhe tregimet në lidhje me Iblisin e mallkuar. Po kështu, pjesë e këtyre tregimeve janë edhe fushatat ku ka marrë pjesë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Këto fushata, në të vërtetë, përbëjnë një kapitull më vete dhe natyrisht, përmbajnë kërkesa të larta. Njëra prej këtyre kërkesave është shpалosja e metodave që përdorën sahabët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në luftën në rrugën e Allahut. Kjo shpалosje bëhet, me qëllim që të zgjohen prej gjumit të shkujdesjes të gjithë myslimanët dhe të nxiten të dalin në luftë në rrugën e Allahut, për



të gjallëruar fjalën e të Vërtetit dhe për të asgjësuar të gabuarën e mashtrimin.

Prej temave të tjera që Kur'ani Famëlartë u bën jehonë, është edhe shpjegimi i dispozitave të veçanta i anëve të dukshme të ligjit të fesë islame. Gjithashtu, është edhe shpjegimi sa më qartë i edukatës hyjnore dhe i rrugës hyjnore. Kur'ani Famëlartë, ky libër drite, u bën jehonë bazave të edukatës e të rrugës hyjnore. Bazë e kësaj jehone është përmendja e thirrjes për t'iu përmbajtur origjinës së kërkesave e disiplinave, siç janë: falja e namazit, dhënia e zekatit, dhënia e një të pestës së fitimit, kryerja e Haxhit, agjërimi i Ramazanit, lufta në rrugën e Allahut, martesja, trashëgimia, zbatimi i vendimit të gjykatës për ekzekutim kapital (elkisàs), zbatimi i vendimit të gjykatës për zbatimin e ndëshkimeve fizike (hudùd), tregtia dhe punë të tjera të ngjashme prej të cilave pritet përfitim.

Prej kësaj pjesë tregimesh është edhe thirrja për t'iu pajisur me dituritë e ligjit të fesë dhe kjo dituri i përfshin të gjithë, sepse ky ligj është vënë për jetën në këtë botë dhe për jetën në Botën Tjetër, është vënë për të gjitha shtresat e shoqërisë dhe, me këtë kam qëllim realizimin e përfitimit prej të gjithëve dhe secilit, sipas punës. Kjo thirrje, në Librin Allahut, ka ardhur shumë herë. Gjithashtu, shpeshherë, në hadithet e nderuara, në transmetime dhe në njoftime janë shpalosur shumë prej veçorive e hollësive të Librit hyjnor, që kanë rezultuar në shkrimin e vëllimeve të shumta e të veçanta prej dijetarëve të fushës së jurisprudencës islame, të cilët, kanë shkruar edhe rreth kapitujve të tjerë të ligjit të fesë.

Prej temave të tjera, që janë shpalosur në Kur'anin Famëlartë, është edhe tema e ringjalljes, shoqëruar me argumentet përkatëse, si dhe format e ndëshkimit e të dënimit në Botën Tjetër,



ashtu siç janë treguar edhe format e shpërblimit në përputhje me punët, janë dhënë edhe hollësi që kanë të bëjnë me Xhenetin e me zjarrin, me ndëshkimin dhe me dhënien e mirësive.

Në këtë kapitull i bëhet jehonë përmendjes së gradëve dhe gjendjeve të të lumturuarve, prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të afruarve, prej praktikuesve të ushtrimeve shpirtërore dhe rrugëtarëve në udhën e Allahut, prej atyre që kryejnë adhurim e të gjitha ritualet e adhurimeve. Në këto “fletë hyjnore” përmenden edhe gjendjet e gradët që kanë njerëzit e këqij: mohuesit, të mbuluarit, hipokritët, jobesimtarët dhe gjynahqarët. Të gjitha këto janë dhënë me dy mënyra: çështjet, në të cilat ka dobi për gjithë masën e njerëzve, janë përmendur shumë dhe me një gjuhë të lartë e të kuptueshme, kurse çështjet, nga të cilat përfiton vetëm një shtresë, janë përmendur me simbole dhe me aludim.

Për shembull, ajeti i nderuar: “الله أكبر وضواؤ من” - “*ue ridvànun mine-ll’lilàhi ekberu*” - “**Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh**”.<sup>1</sup> Ajete të tjera flasin për takimin me Allahun prej kësaj shtrese, në një kohë që fjala tjetër e Allahut: “كلّا إثم عن يومئذ لمخجوبون” - “*Kel’là in’nehum an rab’bihim jeumeidhin lemahxhùbùne*” - “**Në të vërtetë, atë ditë një vel do t’i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre...**”<sup>2</sup>, i drejtohet një shtrese tjetër.

Në këtë kapitull flitet për ringjalljen dhe kthimin tek Allahu Fuqiplotë. Gjithashtu, janë përmendur dituri të panumërta dhe sekrete shumë të fshehura dhe patjetër që këto sekrete arrihen

---

<sup>1</sup>Sure, “Et Teube”, ajeti 72.

<sup>2</sup>Sure “El Mutaffifin” ajeti 15.





vetëm me rrugën e udhëtimit të argumentuar për tek Allahu, ose me dritën e njohjes.

Prej temave të tjera që kanë ardhur në këto “fletë hyjnore”, janë edhe mënyrat e mbulimeve dhe argumentet që sjell i Vërteti i Gjithëfuqishëm, për të vërtetuar kërkesat, dituritë hyjnore dhe të gjitha cilësitë e Tij të plotësuar. Gjithashtu, në këto “fletë hyjnore”, herë-herë, shtrohen argumente të hollësishme, prej të cilave përfitojnë në mënyrë të plotë vetëm ata që kanë arritur gradën e njohjes, ashtu siç thuhet në këto ajete: “هُوَ شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا” - *“shehidel-l'llàhu en'nehù là ilàhe il'là huve...”* - **“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij...”**<sup>1</sup>

“لَوْ كَانُ فِيهَا عَالِمَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا” - *“Leu kàne fijhimà àlihetun il'le-ll'llàhu lefesedetà...”* - **“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin”**.<sup>2</sup>

“لَذَهَبَ كُلُّ إِلَهٍ بِمَا خَلَقْنَا” - *“...idhen ledhehebe kul'lu ilàhin bimà khaleka...”* - **“përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar...”**<sup>3</sup>

I njëjti kuptim shprehet edhe në fillim të sures “El Hadid” dhe në ajetet e sures “EtTeuhid” - “El Ikhlàs”, si dhe në sure të tjera të Kur’anit Famëlartë.

Në këtë libër sqarohet e argumentohet ringjallja, kthimi i shpirtave dhe krijimi në një formë tjetër; sillen argumente që vërtetojnë ekzistencën e engjëjve të Allahut, profetësinë e profetëve

<sup>1</sup>Sure “Àli Imràn”, ajeti 18.

<sup>2</sup>Sure “El Enbijà”, ajeti 22.

<sup>3</sup>Sure “El Muminùn”, ajeti 91.



të Tij të mëdhenj. Të gjitha këto ajete-argumente kanë ardhur në vende të ndryshme të këtij Libri Fisnik.

Kjo ishte në lidhje me argumentet që Allahu i Lartësuar ka sjellë për të vërtetuar Qenien e Tij. Megjithëkëtë, i Gjithëdituri, disa herë, në kapitullin e diturive, citon si argumente profetët dhe dijetarët, siç ishin argumentet e mikut të Allahut, Ibrahimit. Patjetër që ka edhe shumë argumente të tjera.

Të gjitha këto janë “nënat” e temave që kanë ardhur në këtë Libër hyjnor. Por, në këtë Libër madhor ka edhe tema të tjera, të cilat këtu nuk i përmendim dot për shkak se do të zgjateshim shumë, duke i numëruar një e nga një.



## Ndarja e tretë

Tani që u njohe me objektivat e këtyre “fletëve hyjnore” dhe me temat që trajtohen, detyra jote është të mbash parasysh se me këtë punë madhore para teje shtrohet rruga shumë e rëndësishme, që ti të përfitosh prej këtij Libri hyjnor. Para teje hapen portat e diturive dhe të urtësisë. Ky Libër hyjnor duhet shikuar me syrin e marrjes mësim prej tij dhe ta konsiderosh atë libër mësimdhënës dhe informues, njëkohësisht edhe veten tënde ta konsiderosh se je i ngarkuar me detyrën për të mësuar e për të përfituar prej tij.

Këtu patjetër duhet vënë në dukje se me mësimdhënien e me mësimin, me informimin e me përfitimin nuk kemi qëllim të theksojmë anët edukative apo anët e gramatikës, sintaksës, rrjedhshmërisë së fjalëve, retorikës, shprehjeve të bukura shpjeguese dhe fjalëve të mrekullueshme që kanë ardhur në Kur’anin Famëlartë. Gjithashtu, nuk kemi qëllim të themi se tregimet e Kur’anit Famëlartë dhe informacionet e tij përfaqësojnë një histori, ose qëllimi me ato është që të tregohet si ishin gjendjet e popujve që kanë jetuar në shekujt e largët të historisë. Asnjëra prej këtyre punëve nuk numërohet prej qëllimeve të Kur’anit Famëlartë, madje ato janë një largim prej qëllimit kryesor të Librit hyjnor. Një shikim i tillë mbi këtë Libër është pakësim i dobisë që ne kemi prej tij, domethënë se ne nuk e shikojmë atë me qëllimin e mësimdhënies e të mëimit, ashtu siç është gjendja jonë në shumicën e herëve, kur ne e lexojmë Kur’anin, me qëllim që të arrijmë shpërblimin, prandaj ne interesohemi shumë që, gjatë



këndimit të Kur'anit, të respektojmë rregullat e "texhvidit" – "rregullat e këndimit të Kur'anit" dhe mundohemi ta këndojmë atë sa më mirë, me qëllim që edhe ne të na përfshijë shpërblimi. Por qëndrojmë në këtë cak e mjaftohemi vetëm me kaq. Prandaj nuk është aspak çudi që ne vazhdojmë, për shembull, ta këndojmë Kur'anin për dyzet vjet me radhë pa arritur asnjë shpërblim tjetër përveç shpërblimit që ka këndimi i Kur'anit.

Ne mund ta shikojmë Kur'anin edhe me syrin e mësimdhënies e të mësimin, njëkohësisht mund të shqetësohemi për mrekullitë e përmendura në Kur'anin Famëlartë, ose për anët shpjeguese të tij, ose për oratorinë e lartë të Kur'anit, e shprehur me fjalë të pakta, ose mund të shqetësohemi për anë të tjera të Kur'anit, që shikojnë edhe më lart, siç janë anët historike të Kur'anit, shkaqet e zbritjes së ajeteve. Ne shqetësohemi të dimë, nëse ky ajet ose ajo sure është zbritur në Mekë apo në Medine, në të njëjtën kohë i kushtojmë kujdes ndryshimit të mënyrave të leximit të Kur'anit (elkira'at), ose mendojmë sa të ndryshëm janë interpretuesit e Kur'anit, interpretuesit prej masës dhe interpretuesit prej të veçantëve, përfshirë në këtë ndryshim edhe të gjitha çështjet e tjera anësore që dalin jashtë kuadrit të qëllimeve origjinale të Kur'anit Famëlartë, por që, në vetvete, çojnë në vetëmbulim dhe në shkujdesjen ndaj përmendjes së Allahut. Krerët e interpretuesve të Kur'anit janë orientuar që hulumtimin e tyre ta derdhnin në më shumë se njërën nga këto anë, prandaj nuk e hapin për njerëzit portën nga e cila ata do të merrnin mësim prej Kur'anit Famëlartë.

Unë besoj se deri tani nuk është shkruar ndonjë interpretim (tefsir) për Librin e Allahut, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës tefsir, që do të thotë: shpjegim i qëllimeve të këtij Libri, në të cilin sipërfaqja bazë të jetë e zotëruar prej dritës zbuluese të shpjegimit



e të kuptimit, ashtu siç është qëllimi i Zotëruesit të këtij Libri, për të cilin Allahu Fuqiplotë dëshmon se ky është libër i udhëzimit në rrugën e drejtë, është libër mësimi dhe pishtar në rrugën e ecurisë njerëzore. Për të gjitha këto, interpretuesit kanë për detyrë ta orientojnë çdo person që ka dëshirë të mësojë – prej çdo tregimi prej tregimeve të Kur'anit Famëlartë, ose edhe prej çdo ajeti të tij, drejt botës së padukshme, ta drejtojnë aty ku janë shenjat që çojnë në rrugën e lumturisë dhe të rrugëtimit në Udhën e diturisë së njerëzimit.

Interpretuesi është interpretues i mirëfilltë, kur na bën ne të kuptojmë qëllimin për të cilin është zbritur Ku'ani dhe jo shkakun e zbritjes së tij – ashtu siç veprohet zakonisht me librat e tefsirit. Le të marrim për shembull vetëm njërin prej tregimeve të Kur'anit Famëlartë, tregimin e Ademit e të Havasë. Sa shumë dituri e këshilla të vyera janë të fshehura në brendësi të këtij tregimi dhe të ngjarjeve që ndodhën mes atyre të dyve me Iblisin, që në fillim të krijimit të atyre të dyve dhe deri në zbritjen e tyre në tokë, ngjarje të cilat, i Vërteti, i ka përmendur shpeshherë në Librin e Tij. Sa të qarta janë për ne mangësitë e personit e të mendjes, sa dimë ne për veprimet djallëzore, ose për plotësimet shpirtërore e për dituritë njerëzore?! Por, gjendja rezulton se ne jemi krejtësisht të shkujdesur ndaj çështjeve të lartpërmendura.

Në përgjithësi, Libri i Allahut, është libër i diturisë, i moraleve, është libër i thirrjes për në lumturi e në plotësim, prandaj edhe libri i tefsirit patjetër duhet të jetë libër i diturisë e i informimit, duhet të jetë libër i moraleve dhe të shpjegojë anët e diturisë e të moraleve, si dhe të gjitha anët e thirrjes për në lumturi. Kurse interpretuesi që anashkalon këto anë, ose është krejtësisht i shkujdesur ndaj këtyre anëve, ose nuk interesohet fare për këto anë.



Pa dyshim që një interpretues i tillë është i shkujdesur edhe ndaj objektivave të Kur'anit dhe ndaj qëllimeve të tij themelore, duke filluar që nga zbritja e librave dhe dërgimi i profetëve, por kjo shkujdesje, në vetvete, është një gabim shumë i rëndë, që çoi në privimin e këtij umeti – për shekuj me radhë – që jo vetëm të mos përfitonte prej Kur'anit Famëlartë, por ka mbyllur për umetin islam edhe rrugën e udhëzimit.

Atëherë, për ne, përveç studimit logjik të argumentuar, që na çon të kuptojmë qëllimin e zbritjes, mbetet detyrë ta nxjerrim këtë objektiv prej vetë Librit, pasi Autori i këtij Libri i di më mirë objektivat e qëllimet e Librit të zbritur. Tani le të mendojmë pak për fjalën e autorit të librit që kemi në dorë, për punët që kanë lidhje me çështjet e Kur'anit Famëlartë:

Allahu i Lartësuar thotë: *“الْمُتَّبِعِينَ كِتَابَ لَا رَيْبَ فِيهِذَاكَ”* - *“dhàlikel-kitàbu là rejbe fijihi huden lilmut'tekijne”* - **“Në këtë libër s'ka dyshim, ai është udhëzues për të devotshmit”**.<sup>1</sup> Siç shihet, Allahu i Lartësuar e përshkruan Kur'anin si libër i udhëzimit në rrugën e drejtë. Në një sure të shkurtër, Allahu i Lartësuar thotë:

*“وَلَقَدْ يَمُرْنَا الشَّرْعَانَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَكِّرٍ”* - *“Ue lekad jes'sernel-Kur'âne lidh'dhikri fehel min mudek'kirin”* - **“Ne e bëmë Kur'anin të lehtë për ta mësuar, por a ka ndonjë që do të marrë mësime?!”**<sup>2</sup>

Në një sure tjetër, Allahu i Plotfuqishëm thotë:

*“وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ”* - *“...ue enzelnà ilejke-dh'dhikre litubej'jine lin'nàsi mà nuz'zile ilejhim ue leal'lehum jetefek'kerùne”* -

<sup>1</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 2.

<sup>2</sup>Sure “El Kamer”, ajeti 17.



**“Ne ta shpallëm ty Kur’anin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është zbritur atyre, mbase ata do të mendojnë”<sup>1</sup>**

Gjithashtu, në një sure tjetër, thotë:

“كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ” - “*Kitàbun enzelnàhu ilejke mubàrekun lejdeb’berù àjàtihi ue lijetedhek’kere ulul-elbabi*” - **“Libër që Ne ta shpallëm ty të begatshëm, që ata të studiojnë ajetet e tij dhe të mençurit të marrin këshillë prej tij”<sup>2</sup>** Ka edhe shumë ajete të tjera, që flasin për këtë çështje, por do të zgjateshim shumë, nëse këtu do t’i përmendim të gjitha.

Me këto fjalë, nuk kemi për qëllim të bëjmë një ekspozë, për të kritikuar librat e tefsireve, sepse çdonjëri prej interpretuesve të Kur’anit, pa dyshim që përballon vështirësi të shumta dhe forma të ndryshme të kujdesit për të shkruar një libër të vlefshëm. Gjithçka që ka rrjedhur prej penës së tyre, është për hir të Allahut dhe Allahu është garantues për shpërbelimin e tyre. Me këto fjalë, në të vërtetë, duam të vëmë theksin mbi domosdoshmërinë e shtrimit të rrugëve që mundësojnë përfitimin prej këtij Libri Famëlartë për të gjithë njerëzit, sepse Kur’ani Famëlartë është i vetmi libër që mëson rrugëtimin për tek Allahu, është i vetmi libër që mundëson edukimin e shpirtave, është i vetmi libër prej të cilit mësohet edukata, është i vetmi libër që tregon rrugët hyjnore, është mjeti më madhor për ndërlidhjen mes Krijuesit dhe njerëzve, është veriga e pashkëputshme dhe litari i fortë për t’u kapur me madhësinë e Krijuesit.

---

<sup>1</sup>Sure “En Neml”, ajeti 44.

<sup>2</sup>Sure “El Sad”, ajeti 29.



Për të gjitha këto, është detyrë e interpretuesve të Kur'anit që të shkruajnë tefsire të Kur'anit në gjuhën arabe dhe në gjuhën perse dhe qëllimi i tyre në tefsiret që shkruajnë, të jetë shpjegimi i mësimëve, i direktivave e i rrugëve të diturisë e të moraleve, si dhe shpjegimi i rrugëve të lidhjes mes të krijuarit dhe Krijuesit, të shpjegojnë qartë qëllimin e emigrimit prej “shtëpisë së mashtrimit” për në “shtëpinë e gëzimit, për në shtëpinë e përjetshme” dhe, sipas këtij shembulli, unë lë për ruajtje këtë Libër Famëlartë.

Autori i këtij Libri nuk është “udhëheqës”, ose shejh, qëllimi i të cilit është oratoria dhe gjuha e arritur; autori i këtij Libri nuk është as “Sijbujeh” e as “Khalijli”, që të ketë qëllim sintaksën e gramatikën; gjithashtu, autori i këtij Libri nuk është “El-Mes’ûdij’ji” ose “Ibn Khadûni”, që studimi i tij të jetë historia e botës.

Ky Libër nuk është shkopi i Musait dhe dora e tij e bardhë; nuk është as fryma e Isait, e cila ngjallte të vdekurit. Ky libër nuk ka zbritur, që të jetë mrekullia që tregon vetëm të vërtetën e të Dërguarit më të nderuar. Jo. Ky është libër për të gjallëruar zemrat me gjallërinë e diturisë dhe të njohurive të përjetshme hyjnore, ky është Libri i Allahut Fuqiplotë, është Libri që bën thirrje për punë hyjnore. Detyra e interpretuesit të Kur'anit është të mësojë çështjet hyjnore, që të realizohet përfitimi prej këtij Libri.

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَنَزَّلُ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً حَمِيمًا ۖ وَرَحْمَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ۗ وَلَا يَزِيدُ الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا” - “*Ue nunez'zilu minel-Kur'ani mà huve shifâun ue rahmetun lilmuëminijne, ue là jezijdu-dh'dhàlimijne il'là khasàren*” - “**Ne shpallim prej Kur'anit atë që**





**është shërim e mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve kjo (shpallja) nuk i shton gjë tjetër përveçse humbje”.<sup>1</sup>**

A ka humbje më të madhe, se sa, kur njeriu vazhdon ta lexojë këtë libër hyjnor gjatë tridhjetë ose dyzet vjetëve, duke iu referuar edhe librave të tefsireve, por pa u ndalur në objektivat e tij të larta?!

“ **وَمَا ظَلَمْنَا أَفْسَسًا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ** ” - “ **...ra'benà dhalemna enfusenà ue in lem tagfir læà ue terhamnà læekune'ne minel-khàsirijne** ” - “**...ne i bëmë padrejtësi vetes sonë dhe, nëse Ti nuk na e fal (gjynahun) e nuk na mëshiron, me siguri që jemi prej atyre që pësojnë humbje**”.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>Sure “El Isrà”, ajeti 82.

<sup>2</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 23.



## Ndarja e katërt

# ZHDUKJA E MBULESAVE QË PENGOJNË MARRJEN E MËSIMIT

Tani që u shpjegua qartë madhështia e Librit të Allahut nga të gjitha anët dhe u shtrua rruga e përfitimit prej kërkesave të këtij Libri, për cilindo që ka dëshirë të mësojë dhe të përfitojë prej Librit të Allahut dhe me qëllim që të realizohet përfitimi prej mësimave të Librit të Allahut, mbetet detyrë të stoliset me një edukatë tjetër prej edukatave të rëndësishme që kemi trajtuar në këtë kapitull. Kjo edukatë e rëndësishme është: heqja e pengesave para përfitimit, të cilat ne i shprehim me fjalën “mbulesat” ndarëse mes përfituesit dhe Kur’anit Famëlartë. Këto mbulesa-pengesa janë të shumta, prandaj këtu do të theksojmë vetëm disa prej tyre: Njëra prej mbulesave të mëdha, e cila e pengon personin të mësojë, është kur ai mendon se nuk ka nevojë të mësojë. Kjo është mbulesa e vetëpëlqimit, e cila numërohet prej kurtheve të rrezikshme të shejtanit. Nën këtë mbulesë, njeriu gjithmonë përfytyron plotësim iluzionare dhe është i kënaqur me ato që janë tek Ai. Kjo mbulesë e bën njeriun të mos i japë rëndësi asgjëje tjetër veç asaj që ai mendon dhe është i bindur në atë që mendon. Mbulesa e vetëpëlqimit bën që ai të jetë prej atyre që i respektojnë me përpikëri rregullat e këndimit të Kur’anit (ehlu-’t’tehxviyd) dhe ndihen të kënaqur me këtë art të thjeshtë. Njëkohësisht, bën që atyre, kjo dituri i duket një



mirësi kaq e madhe, sa në mendimin e tyre ajo dituri qëndron mbi të gjitha dituritë e tjera. Por jo vetëm kaq, mbulesa e vetëpëlqimit, gjithashtu, bën që ata të mendojnë e të besojnë se përfaqësojnë kriterin e “mbajtësve të Kur’anit”, për rrjedhojë ata mbeten të privuar që ta kuptojnë Librin hyjnor dritëdhënës dhe të përfitojnë prej tij.

Kështu ndodh edhe me ata që merakosen për anët edukative të trajtuara në Kur’anin Famëlartë. Edhe kjo mbulesë boshe bën që ata të jenë të kënaqur, të mendojnë e të besojnë se të gjitha çështjet e Kur’anit reduktohen vetëm në këto anë dhe s’ka asgjë tjetër. Gjithashtu, edhe interpretuesit më në zë të Kur’anit Famëlartë shqetësohen për anët gramatikore e të sintaksës së Kur’anit, për mënyrat e këndimit të Kur’anit, për mendimet e ndryshme të gjuhëtarëve, për kohët e zbritjes së ajeteve, nëse ajeti është zbritur në periudhën e Mekës apo është zbritur gjatë periudhës së Medines, madje ata shqetësohen deri edhe për numrin e ajeteve e të shkronjave të Kur’anit Famëlartë, si dhe për çështje të tjera të ngjashme me këto që thanë.

Edhe dijetarët janë të kënaqur e mjaftohen me diturinë që kanë dijeni për argumentet, për ekzistencën e mbulesave dhe për çështje të tjera të ngjashme, por vetëm kaq. Gjithashtu, edhe filozofët, të urtët dhe dijetarët - në kuptimin e terminologjisë që përdoret për këtë kategori - e mbyllin veten nën mbulesat e dendura të termave, të fjalëve e të ngjashme me këto.

Edhe rrugëtari që udhëton për tek Allahu, patjetër që përfiton prej këtyre fletëve hyjnore, duke grisur të gjitha këto mbulesa, prandaj ai e shikon Kur’anin edhe prapa këtyre mbulesave. Megjithëkëtë, ai ka për detyrë, që të mos qëndrojë në



asnjërën prej mbulesave, ndryshe nuk bashkohet dot me karvanin e udhëtarëve për tek Allahu. Në të njëjtën kohë, rrugëtari për tek Allahu nuk e privon veten prej thirrjeve të mrekullueshme që atij i bën Allahu Fuqiplotë.

Urdhri për të mos qëndruar në një kufi të caktuar dhe mbetja i kënaqur vetëm me atë që u arrit, mësohet prej vetë Kur'anit Famëlartë. Janë të shumta shenjat në këtë kuptim në tregimet kur'anore. Musai, biseduesi me Allahun, ishte në pozitën e lartë të profetësisë, por ai nuk qëndroi në pozitën e diturisë së tij tepër të lartë, deri sa u takua me një person të plotësuar si Hidri, të cilit i parashtroui me kryeultësi e nënshtrim kërkesën e tij:

“هَلْ أَتَيْتَكَ عَلَىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عَلَّمْتَ رُسُلَنَا” - “...hel et'tebiuke alà en tual'limeni mim'mà ul'limte rushden” - **“A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?”**<sup>1</sup> Musai e shoqëroi Hidrin, deri sa arriti të marrë dituritë që i duheshin, përfitoi prej diturive të marra.

Edhe Ibrahim, nuk qëndroi në pozitën e besimit e të diturisë së madhe, të veçantë për profetët, por tha: “رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَىٰ” - “...rab'bi erinij kejfe tuh'jil-meutà...” - **“O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!”**<sup>2</sup>Me këtë kërkesë, ai kishte për qëllim të lartësohej prej pozitës së besimit në pozitën e sigurisë, për ta parë me sytë e tij.

Edhe njeriun më të ditur, Vulën e gradëve, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*),

---

<sup>1</sup>Sure “El Kehf”, ajeti 66.

<sup>2</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 260.



Allahu i Lartësuar e urdhëron: “رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا وَرَبِّ”- “ue kul rab'bi zidnij ilmen” -“...dhe thuaj: **Zoti im, më shto diturinë**”<sup>1</sup>

Të gjitha urdhrat e ardhura në Librin hyjnor dhe tregimet e profetëve, të përmendura në Librin e Allahut, të gjitha, kanë si objektiv ndërgjegjësimin tonë, të gjitha, synojnë të na zgjojnë prej gjumit të shkujdesjes dhe të marrim këshillë prej këtij Libri.

Prej mbulesave të tjera, është mbulesa e mendimeve të këqija, mbulesa e rrugëve dhe e medh'hebeve të gabuara. Kjo mbulesë, disa herë e ka zanafillën e saj në përgatitjen e keqe të vetë personit, por, në shumicën e herëve, kjo mbulesë buron prej ndjekjes së traditës. Kjo mbulesë është prej mbulesave që na pengon të shohim veçantitë e diturive të Kur'anit Famëlartë. Patjetër që kjo pengesë ndodh, kur në zemrat tona ngulitet besimi i gabuar, si rezultat i asaj që kemi marrë prej babës, ose prej nënës, ose prej disa injorantëve, që mund të jenë edhe prej atyre që predikojnë në shkallaret e minbereve të xhamive. Ky lloj besimi, i trashëguar nga ndjekja e traditës, bëhet mbulesë mes nesh e mes ajeteve të nderuara të Kur'anit Famëlartë. Edhe pse kanë ardhur mijëra ajete e hadithe të nderuara, që e kundërshtojnë këtë lloj besimi, ne ngulmojmë t'i largojmë ajetet e hadithet nga kuptimi që ato shprehin, ose nuk i shikojmë ato me syrin që t'i kuptojmë. Shembujt për të tilla besime e dituri të gabuara janë të shumta, por unë do t'i lë mënjanë e nuk do t'i përmend, sepse e di që kjo mbulesë nuk çahet e nuk griset me fjalët e të ngjashmëve me mua, megjithëkëtë do të theksoj vetëm një model, që, në përgjithësi, kuptohet me lehtësi.

---

<sup>1</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 114.



Sikur ti të shikosh ajetet e Kur'anit Famëlartë, që flasin për takimin me Allahun, për diturinë e Tij dhe hadithet e ardhura për këto çështje, me siguri do të gjesh se ato janë me të vërtetë shumë, duke shtuar edhe shenjat, aludimet dhe deklarimet e shumta, të ardhura në duatë e në mendimet e imamëve. Megjithëkëtë, ti shikon se disa, si rezultat i disa doktrinave të stisura prej disa injorantëve, të cilët i përhapin ato me zell shumë të madh, por, që, në të vërtetë, si rezultat i krahasimit të diturisë së Allahut dhe shikimit të bukuri së me mendimin në Qenien hyjnore në atë formë që është e ndaluar të mendohet, madje kategorikisht e ndaluar, këto doktrina mbyllin plotësisht rrugën e njohjes së Allahut, sepse ata, të gjitha këto ajete e transmetime, i shpjegojnë ose i minimizojnë, duke mos hyrë fare në këtë fushë. Është e qartë se me këtë punë ata privojnë njerëzit prej diturive që kanë pohuar profetët dhe eulijatë.

Por ajo që shkakton një keqardhje të thellë te ata që thirren njerëz të Allahut, është se kjo shtresë dijetarësh jo vetëm që ka mbyllur njëren portë të diturisë, dituri për të cilën mund të thuhet se përfaqëson qëllimin më të lartë për të cilin u dërguan profetët dhe kërkesën më të largët të eulijave, por këmbëngulin në këtë punë deri në atë kufi sa edhe bisedimin rreth kësaj çështjeje e shpallin mohim të mirëfilltë dhe ateizëm të pastër. Autorë të kësaj shtrese vënë dituritë e profetëve e të eulijave që kanë lidhje me Qenien e pastër të të Vërtetit, me emrat e Tij dhe me cilësitë e Tij, të gjitha këto dituri ata i vënë në të njëjtin nivel me dituritë e masës së burrave e grave, madje herë-herë peshorja e tyre anon kah dituria e këtyre të fundit, kur thonë: "Filani ka doktrina të mira!" Eh, si mund të jenë të mira doktrinat vulgare!

Sa korrekt është ky i varfër në fjalët që thotë, kur vetë ai, nga njëra anë, i ka humbur besimet e përgjithshme dhe, nga ana tjetër,



kur vështron në dituritë e të tjerëve, në dituritë e të veçantëve e në dituritë e njerëzve të Allahut, deklarën për dituritë e tyre, se janë dituri të gabuara. Dëshirat e një njeriu të tillë janë si dëshirat e mohuesit, të pohuara qartë në ajetin e nderuar:

“وَيَسْأَلُ الْكَافِرُ يَا لَيْتَنِي كُنْتُ مُرَابِّا” - “...ue jekûlu-kâfiru jà lejtenij kuntu turâben” - **“kur jobesimtari do të thotë: ‘Ah, sikur të isha pluhur!’”**<sup>1</sup>

Sikur të duam të shqyrtojmë ajetet e transmetimet e ardhura në lidhje me çështjen e takimit me Allahun, për të sqaruar absurditetin e kësaj doktrine të dekompozuar, e dalë prej injorancës dhe prej mashtrimeve të shejtanit, patjetër që për këtë çështje duhet të shkruhet një libër më vete, pa folur për ato që kërkon trajtimi i hollësive të çështjes për të shpjeguar dituritë e rrethuara prej perdeve të harrimit, si rezultat i kësaj mbulese të dendur djallëzore. E gjitha kjo ka çuar jo vetëm në një largim të madh prej Kur’anit Famëlartë, por edhe në braktisjen e tij, madje shumica e punëve është bërë një motiv për keqardhje, ashtu siç e shpreh këtë të vërtetë ajeti i nderuar: “وَقَالَ الرَّسُولُ يَا رَبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا” - “*Ue kale-rr’rresûlu jà rab’bi in’ne kaumi-t’tekhadhù hadhel-kur’âne mehzhûren*” - **“Dhe i Dërguari do të thotë: ‘O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kur’anin, si (diçka) të urryer’”**.<sup>2</sup>

Edhe për braktisjen e Kur’anit Famëlartë ka gradë e pozicione të panumërta. Ne shpresojmë të cilësohemi me disa prej këtyre gradëve bazë, ndryshe jemi të dështuar dhe do të jemi prej atyre që e kanë braktisur Kur’anin Famëlartë, pikërisht atëherë kur kujdesemi ta veshim me kapakë prej lëkure të kushtueshme, ose kur e puthim dhe e vëmë në ballë, vetëm atëherë kur kemi nevojë

<sup>1</sup>Sure “En Nebe”, ajeti 40.

<sup>2</sup>Sure “El Furkân”, ajeti 30.



të kërkojmë të gjejmë zgjidhjen për problemet që kemi (istihàreh). Vallë, a do ta nxjerrim këtë libër të nderuar prej gjendjes së braktisjes, në një kohë që e kalojmë pjesën më të madhe të jetës sonë duke u merakosur për këndimin e tij sipas rregullave të veçanta (texhvid) për këndimin e Librit të Allahut Fuqplotë dhe për anët e tij gjuhësore, shpjeguese e oratorisë së tij mahnitëse?! Mos vallë do të shpëtojmë prej turpit të largimit prej Kur'anit Famëlartë, kur mësojmë mënyrat (kirà'âtet) e ndryshme të këndimit të këtij Libri hyjnor dhe me të tjera punë të ngjashme që kanë të bëjnë me Kur'anin Famëlartë?

Vallë, a na shpëton ne mësimi i formave të gojëtarisë së Kur'anit dhe i mirësive të tij prej ankimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Eh, është shumë larg që në këto punë të ketë diçka që përfaqëson qëllimin e Kur'anit dhe qëllimin e Zbritësit të Kur'anit, Madhështorit të Lartësuar.

Pa dyshim, Kur'ani, si Libër hyjnor, përmbledh punët hyjnore dhe është kablli bashkues ndërmjet Krijuesit e të krijuarit, prandaj vetëm me mësimin e Kur'anit duhet të ndërtohet lidhja dhe ndërlidhja e fshehtë mes robëve të Allahut dhe Edukuesit të tyre. Vetëkuptohehtë që, për lidhjen Krijues - i krijuar, dituritë hyjnore dhe dituritë mistike patjetër duhet të merren prej Kur'anit Famëlartë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Dituria është tri kategori: argument hermetik, detyrim i drejtë dhe rrugë veprimi"*.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>"El Usùlu minel-Kàfi", Libri "Mirësia e diturisë", K. "Cilësia e diturisë dhe mirësia e saj", Hadithi 1.





Kur'ani Famëlartë është mbartësi i këtyre diturive dhe, kur ne i mësojmë këto dituri prej tij, kjo do të thotë që ne nuk e konsiderojmë Kur'anin të braktisur; kur ne pranojmë thirrjet e Kur'anit Famëlartë, në fakt, prej tregimeve të profetëve kemi marrë atë që duhet të merret prej këtyre tregimeve të mbushura me këshilla, me dituri e me urtësi; kur ne këshillohemi me këshillat e Allahut të Lartësuar, me këshillat e profetëve të Tij dhe me këshillat e të urtëve, të përmendur në Ku'anin Famëlartë, atëherë këto këshilla nuk janë mure që na ndajnë prej tij; kurse thellimi vetëm në anën e jashtme të Kur'anit, është kërkimi i përjetshmërisë në tokë, por kjo kërkese, në vetvete, është prej cytjeve të shejtanit, prandaj patjetër duhet të kërkohet mbrojtja e Allahut prej cytjeve të shejtanit (duhet thënë: “Eùdhu bil'làhi mine-sh'shejtàni-rr'rrexhijm”).

Prej ndarësve të tjerë që na pengojnë të përfitojmë prej kësaj flete hyjnore të pastër, është besimi për moslejimin e tejkalimit të asaj që kanë shkruar autorët e librave të tefsireve dhe çfarë ata kanë kuptuar prej Kur'anit Famëlartë, por dihet se në këtë besim, nga njëra anë, ka përzierje mes mendimit e studimit mbi ajetet e nderuara dhe, nga ana tjetër, ka përzierje mes përmbajtjes së Kur'anit dhe tefsirit të shkruar sipas mendjes që është i ndaluar të shkruhet.

Me këtë mendim të prishur dhe me këtë doktrinë të gabuar, Kur'ani Famëlartë zhvishet prej të gjitha formave të përfitimit dhe bëhet plotësisht i braktisur, megjithëse në këtë gjendje përfitimet morale, përfitimet në besim dhe në dituri, si bazë s'kanë lidhje me interpretimin, pa përmendur interpretimin e shkruar sipas mendjes (et' tefsijru birra' rreëji).



Sikur një person të lexojë dhe të mendojë rreth dialogut të zhvilluar mes Musait e Hidrit, sikur ai person të mendonte rreth mënyrës së bashkëpunimit mes atyre të dyve, dhe sikur ai të mendonte se Musai, i cili, pavarësisht nga pozita e lartë e profetësisë që kishte, mori rrugën në kërkim të një diturie që nuk e kishte; sikur ai të mendonte rreth mënyrës si ia shtroi Musai nevojën e tij Hidrit, ashtu siç tregohet në ajetin e nderuar:

“هَلْ أَتَيْتُكَ عَلَىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عُلِّمْتُ رُشْدًا” - “...hel et'tebiuke alà en tual'limeni mim'mà ul'limte rushden” - **“A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?”**<sup>1</sup> Sikur ai të mendonte rreth përgjigjes së Hidrit dhe ndjesave të përsëritura të Musait, pastaj prej kësaj të mësonte madhështinë e pozitës së diturisë, me siguri që do të mësonte disa prej rregullave të bashkëpunimit mes nxënësit e mësuesit, duke theksuar se disa prej atyre rregullave kanë ardhur në këto ajete të nderuara dhe janë afro njëzet të tilla, me kusht që këto përfitime të mos kenë lidhje me atë që quhet “interpretim i Kur'anit sipas mendjes” (et' tefsijru birr' rreëji). Kështu është gjendja edhe me shumë prej përfitimeve të arritura prej Kur'anit Famëlartë.

E tillë është gjendja edhe në fushën e diturive. Le të supozojmë se një person përfitoi prej fjalës së Allahut të Lartësuar: “الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ” - “elhamdu lil'làhi rab'bil-àlemijn” - **“Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun Zotin e botëve”**<sup>2</sup>, fjalë në të cilën përfshihen të gjitha falënderimet dhe veçohen të gjitha format e lavdërimeve për të Vërtetin e Lartësuar. Kjo do të thotë se, me këtë përfitim, është realizuar ajo që quhet teuhidi i punëve (Et' teuhijdul-

---

<sup>1</sup>Sure “El Kehf”, ajeti 66.

<sup>2</sup>Sure “El Fatiha”, ajeti 1.



ef'âlij). Prej këtij ajeti të nderuar mësohet se çdo bukuri, çdo fuqi e çdo madhështi në botë, nga ato qenie që i kap menjëherë syri dhe zemra e mbuluar, pa dyshim që është prej të Vërtetit të Lartësuar dhe asnjë qenie s'ka asgjë nga vetvetja, prandaj falënderimi e lavdërimi i dedikohen vetëm Allahut dhe në këtë falënderim e lavdërim s'ka pjesë askush tjetër përveç Atij.

Në origjinë, cila është lidhja e këtyre punëve, qoftë me interpretimin sipas mendjes, qoftë me interpretimin sipas punëve?

Duhet të shtojmë edhe punë të tjera që mësohen prej kuptimit të fjalës, që s'ka lidhje me interpretimin, në asnjërën anë. Por këtu, ka edhe fjalë prej interpretimit sipas mendjes, që mund të mos jenë të lidhura me ajetet që flasin për dituritë logjike, të cilat janë në përputhje me kriteret argumentuese dhe me ajetet që flasin për moralin. Është e qartë se në të gjitha këto, mendja ka një rol të caktuar. Atëherë këto interpretime përputhen me argumentin logjik, ose me konsideratat e qarta logjike, në atë mënyrë sikur të jenë në kundërshtim me anën e jashtme të ajetit, prandaj mbetet detyrë që ajetet e Kur'anit Famëlartë të mos merren vetëm në anën e tyre të jashtme.

Për shembull, kuptimi i këtyre dy ajeteve: “وَجَاءَ رَبُّكَ” - “*Ue xhàe rab'buke...*” - “**kur të vijë Zoti yt** (për të ndarë gjykimin) **me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe**”<sup>1</sup>dhe “الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى” - “*Err'rrahnànu alev-arshis-tevâ*” - “**I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit** (si i takon Madhërisë së Tij)”<sup>2</sup>, është në kundërshtim me rrugën e argumentimit, prandaj kthimi i anës së jashtme dhe interpretimi i

<sup>1</sup>Sure “El Fexhr”, ajeti 22.

<sup>2</sup>Sure “Tâ Hà”, ajeti 5.



ajeteve rezulton jo në përputhje me argumentin dhe nuk është interpretim sipas mendjes, për rrjedhojë, kjo nuk është një punë e ndaluar.

Nisur nga sa u tha më sipër, është e mundur, madje supozohet se interpretimi sipas mendjes ka lidhje me ajetet e dispozitave, me të cilat s'kanë fare lidhje as mendimet e as logjika, pasi dispozita është detyrim të merret si gjendje adhurimi i mirëfilltë, si orientim i plotë prej depozituesve të revelatës dhe venduljes së engjëjve të Allahut. Po kështu është gjendja edhe me transmetimet e nderuara, të ardhura në lidhje më këtë çështje dhe për t'iu kundërvënë juristëve të fesë (fukahave) të masës, të cilët kanë dashur të kuptojnë fenë e Allahut me mendjet e tyre, me krahasim e me analogji.

Gjithashtu, në hadithet e nderuara thuhet "s'ka asgjë më larg prej mendjeve të burrave se interpretimi i Kur'anit<sup>1</sup> dhe "feja e Allahut nuk arrihet me mendjet"<sup>2</sup>. Këto hadithe janë një argument i qartë, që tregojnë se qëllimi me shprehjen "feja e Allahut" është për "dispozitat që kanë të bëjnë me adhurimet" për fenë, kurse studimi në lidhje me vërtetimin e Krijuesit, besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), dëlirja e Allahut prej nevojave e mangësive, si dhe vërtetimi i ringjalljes e i profetësisë, madje edhe të gjitha dituritë, të gjitha këto janë e drejtë dhe prej specialiteteve të mendjes, ashtu siç ka ardhur në fjalët e disa dijetarëve të mëdhenj në fushën e hadithit (muhad' dithijn): "Vërtetimi i besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) është detyrë të jetë i mbështetur në argumentin tekst". Në të vërtetë, dyshimi në Njëtimin e Allahut është humbje, madje është prej pësimeve të rënda, për të cilat

---

<sup>1</sup>"Bihàrul Enuàr," vëll. 89, f. 95; tefsiri i El-Ijâshij'jit, vëll. 1, f. 17.

<sup>2</sup>"Bihàrul Enuàr," vëll. 2, f. 303.



patjetër duhet kërkuar mbrojtja e Allahut, sepse është një fjalë, për të cilën s'është nevoja të thuhet se është e ulët apo e dobët dhe, për këtë vetëm Allahut i ankohe.

Prej mbulesave të tjera penguese për të kuptuar Kur'anin dhe për të përfituar prej diturive të këtij Libri qiellor e prej këshillave të tij, është edhe mbulesa e gjynaheve, mbulesa e ndyrësive të grumbulluara njëra mbi tjetrën si rezultat i padrejtësisë e i rebelimit kundër Zotit të botëve. Janë këto ndyrësi që e mbulojnë zemrën dhe e pengojnë atë të kuptojë të vërtetat.

Tashmë dihet se për të gjitha punët, të mira e të këqija, kanë formësimin e tyre në mbretërinë e shpirtit; gjithashtu, ky formësim i punëve është në përshtatje me brendësinë e vetes së njeriut. Kur punët e pastrojnë zemrën dhe, kur ato "ndriçojnë" në këtë gjendje, shpirti bëhet si një pasqyrë e lëmuar, i pastër dhe i aftë për shkëlqimet e panjohura, për nxjerrjen në shesh të të vërtetave dhe diturive mbi faqen e kësaj pasqyre; gjithashtu, punët mund të çojnë deri aty sa mbretëritë e shpirtit të bëhen të errëta e të turbullta. Në këtë gjendje, zemra është si një pasqyrë prej ndryshku, e errët, në të cilën nuk pasqyrohen dituritë hyjnore dhe të vërtetat e fshehura, për rrjedhojë, zemra bëhet pre e pushtetit të shejtanit dhe shejtani bëhet veprues në mbretërinë e shpirtit. Jo vetëm kaq, por edhe dëgjimi, shikimi e të gjitha fuqitë e tjera të njeriut i nënshtrohen pushtetit të shejtanit. Por, kur veshi shurdhohet plotësisht, ai vesh nuk i dëgjon dituritë e këshillat hyjnore; kur syri nuk i sheh argumentet hyjnore, kaq të ndritshme, patjetër që ai sy do të jetë i verbër edhe për të parë të Vërtetin, shenjat dhe argumentet e Tij. Në këtë gjendje, zemra e humb aftësinë për të mësuar çështjet e fesë, prandaj ajo zemër është e privuar prej argumenteve dhe prej shpjegimeve, ajo zemër nuk e përmend të Vërtetin, nuk përmend



as emrat e as cilësitë e Tij, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Allahu të Lartësuar:

"لَهُمْ قُلُوبٌ لَا يَفْقَهُونَ بِهَا وَلَهُمْ أَعْيُنٌ لَا يُبْصِرُونَ بِهَا وَلَهُمْ آذَانٌ لَا يَسْمَعُونَ بِهَا أُولَئِكَ كَالْأَنْعَامِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ"

"...lehum kulùbun là jefkahùne bihà ue lehum aëjunun là jubsirùne bihà ue lehum àdhànun là jesmeùne bihà ulàike kel-en'ami bel hum edal'lu..."

"...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit".<sup>1</sup>

Ata e shikojnë botën ashtu siç e shikon bagëtia e kafshët, pa marrë asnjë mësim dhe pa bërë asnjë studim; zemrat e tyre bëhen si zemrat e kafshëve, nuk përfitojnë as prej mendimit e as prej këshillës, madje gjendja e tyre e shkujdesjes dhe e mendjemadhësisë acarohet prej mendimit te argumentet, te shenjat dhe për të dëgjuar këshillat e dituritë që janë në brendësi të argumenteve e të shenjave. Vetëkuptohet se në këtë gjendje, ata janë edhe më zi se kafshët dhe kanë rënë plotësisht në rrugën e humbjes.

Prej mbulesave të tjera të dendura është edhe **mbulesa e dashurisë për këtë botë**. Kjo mbulesë është një perde e rëndë mes nesh e mes diturive dhe këshillave të Kur'anit. Si rezultat i ekzistencës së këtyre mbulesave, zemra e harxhon të gjithë vullnetin e saj vetëm për këtë botë. Pikëpamja e zemrës bëhet plotësisht për këtë botë dhe, për shkak të kësaj shkujdesjeje, kjo zemër nuk e përmend Allahun, madje i largohet përmendjes së të Përmendurit. Sa më shumë që shtohet varësia e tij prej kësaj bote e prej dukurive të saj, aq më shumë shtohet edhe mbulesa e zemrës dhe dendësia e kësaj mbulesë, deri sa kjo varësi e lidhje me këtë

---

<sup>1</sup>Sure "El A'râf", ajeti 179.



botë bëhet sunduese mbi zemrën, për rrjedhojë atë zemër e qeveris pushteti i dashurisë për nderim e për pozitë. Në atë zemër shuhet plotësisht drita e cilësisë së pastër, me të cilën e ka krijuar Allahu dhe para njeriut mbyllen portat e lumturisë. Pikërisht këto mbulesa, mbase, janë bravat për të cilat tregon ajeti i nderuar:

“أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا” - “Efelà jetedeb'berùnel-kur'âne em alàel-kulùbi akfàlun” - **“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!”**<sup>1</sup>

Qëllimi i përdorimit të mbiemrit “të kyçura”, është të tregojë prangat e vargonjtë e varësisë ndaj kësaj bote.

Ai që ka qëllim të mësojë prej diturive të Kur'anit dhe të përfitojë prej këshillave hyjnore, në radhë të parë, duhet të pastrojë zemrën prej këtyre papastërtive dhe ta zbrazë atë prej gjynaheve të zemrës, të përfaqësuara me merakun për diçka tjetër përveç Allahut, pasi personi që nuk e ka pastruar zemrën, nuk është i siguruar prej sekreteve, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar:

“إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ فِي كِتَابٍ مَكْنُونٍ لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ” - “In'nehu lekur'anun krijmun fij kitàbin meknùnin là jemes'suhù il'lel-mutah'herùne” - **“se ky është vërtet një Kur'an i nderuar, në Librin e ruajtur. Atë (Kur'anin) e prekin vetëm të pastërtit”**.<sup>2</sup>

Gjithashtu, është e ndaluar rreptësisht prekja e këtij Libri hyjnor, ligjërisht e me detyrim, prej atyre që nuk janë të pastruar nga ana e jashtme. Po kështu, dituritë e Kur'anit, këshillat e tij, e brendshmja e tij dhe sekretet e tij janë të ndaluara për atë që e ka zemrën të ndotur me ndyrësitë e lidhjeve me këtë botë. Për këtë

<sup>1</sup>Sure “Muhammed”, ajeti 24.

<sup>2</sup>Sure “El Uàkia”, ajetet 77 - 79.



çështje, Allahu i Lartësuar njofton: “الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ” - “*Dhàl-kitàbu là rejbe fijhi, huden lilmut’tekijne*” - “**Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit**”.<sup>1</sup> Kjo do të thotë se jo i devotshmi dhe jo besimtari, sipas devotshmërisë e besimit të masës, janë të ndaluar prej dritave të formësuar të këshillave të Kur’anit dhe prej mësimëve të tij të vërteta, në një kohë që jo i devotshmi dhe jo besimtari, sipas gradëve të tjera të devotshmërisë, të devotshmërisë të të veçantëve dhe të veçantëve të veçantëve, si dhe e devotshmërisë së më të veçantëve prej të veçantëve, janë të ndaluar prej gradëve të tjera të diturive të Kur’anit e prej këshillave të tij.

Zgjerimi në anët e kësaj çështjeje dhe përmendja e ajeteve që tregojnë qëllimin, çon në zgjatje të shumta, prandaj do ta mbylлим këtë ndarje me ajetin hyjnor, i cili është më se i mjaftueshëm për të ndërgjegjësuarit, me kusht që të meditohej e të reflektohet për këtë ajet:

“يَأْهَلِ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِّمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ ۖ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ”

“*Ja Ehlel kitabi kad xhàekum resùlun jubej’jину lekum kethijren mim’mà kuntum tukhfùne ninel-kitàbi ue jaëfù an kethijrin, kad xhàekum mine-ll’làhi nùrun ue kitàbun mubijun. Jehdij bihi-l’làhu meni-t’tebea ridvòànehu subule-s’selàmi ue jukhrixhuhum mine-dh’dhulùmàti ile-n’nùri bi’idhnihî ue jehdijehum ilà siràtin mustekijmin*” - “**O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe**

<sup>1</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 2.





**Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë”.<sup>1</sup>**

Veçoritë e këtij ajeti të nderuar janë të shumta dhe shqyrtimi i këtyre veçorive kërkon të shkruhet një kumtesë e pavarur, por në këtë nxitim nuk është rasti që këto veçori të përvetësohen.

---

<sup>1</sup>Sure “El Mâide”, ajetet 15-16.



## Ndarja e pestë

### MENDIMI

Prej rregullave dhe prej edukatave të këndimit të Kur'anit Famëlartë është edhe prania e zemrës. Prania e zemrës, në këtë kumtesë, është përmendur me rastin e trajtimit të rregullave të përgjithshme për kryerjen e adhurimeve, prandaj nuk është e nevojshme t'i rikthehemi kësaj çështjeje, por bisedën do ta vazhdojmë me një rregull-edukatë tjetër prej edukatave të këndimit të Kur'anit Famëlartë, do të flasim për edukatën e mendimit në ato që lexojmë në Kur'anin Famëlartë.

Qëllimi me "mendimin" është studimi rreth qëllimit dhe rreth asaj që është qëllim në ajetet e nderuara të Kur'anit Famëlartë. Vetë kjo Fletë hyjnore e tregon qartë se qëllimi i leximit është udhëzimi në rrugët e shpëtimit, dalja prej të gjitha shkallëve të errësirave. Hyrja në botën e dritës e të udhëzimit, është hyrja dhe ecja në rrugën e drejtë, prandaj njeriu ka për detyrë të mendojë për ajetet e nderuara, që të mësojë shkallët e shpëtimit, duke filluar me shkallët e kësaj bote, të lidhura me fuqitë e brendshme të njeriut dhe duke përfunduar me të vërtetën e zemrës së shëndoshë. Në interpretimin e ardhur prej Ehli Bejtit tregohet se kjo e vërtetë është takimi me Allahun, kur në zemrën e takuesit s'ka asgjë e asnjë tjetër përveç Atij.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Lexo "El-usûlu minel-Kâfij", Libri "El-Imanu uelkufru", K. "El-Ikhlâsu", Hadithi 5



Gjithashtu, është detyrë që fuqitë e njeriut dhe pushtetet e tij të brendshme të jenë të shëndosha, prandaj për kënduesin e Kur'anit Famëlartë mbetet detyrë që këto kërkesa ai t'i studiojë në këtë Libër qiellor dhe t'i shikojë ajetet e tij me syrin e të "menduarit". Kur fuqitë e njerëzimit janë të shpëtuaara prej pushtetit të shejtanit, kur njeriu studion rrugët e shpëtimit dhe punon sipas kërkesave të Kur'anit, atëherë në çdo gradë të njërës prej errësirave ai është i shpëtuar, te ai shkëlqen një dritë hyjnore e shndritshme dhe vetëm pas kësaj grade ai shpëton prej të gjitha llojeve të errësirave, duke filluar me shpëtimin prej errësirave të botës së natyrës dhe prej errësirave të punës së kësaj bote dhe duke përfunduar me shpëtimin prej errësirës së orientimit kah shumica, me të gjitha punët e saj. Në këtë pozitë, ai e kupton qartë ajetin e nderuar: "صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ رَبِّي عَلَى" - "...in'ne rab'bij alà siràtin mustekijmin" - "...Zoti im është për rrugën e drejtë".<sup>1</sup>

Kur'ani Famëlartë e përsërit shumë herë thirrjen për të menduar, e lavdëron mendimin dhe e nxit të menduarit. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: "وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ" - "...ue enzelna ilejke-dh'dhikre litubej'jine lin'nàsi mà nuz'zile ilejhim ue leal'lehum jetefek'kerùne" - "Ne të zbritëm ty Kur'anin, që t'u shpjegosh njerëzve atë çka u është zbritur atyre, mbase ata do të mendojnë (mbi Kur'anin)".<sup>2</sup>

Në këtë ajet të nderuar kemi një lavdërim shumë të madh për të menduarit, pasi në këtë ajet mundësia për të menduar bëhet qëllimi më i lartë i zbritjes së këtij Libri qiellor madhështor. Gjithashtu, ky ajet është një argument që vërteton rëndësinë e

<sup>1</sup>Sure "Hùd", ajeti 56.

<sup>2</sup>Sure "En Nahl", ajeti 44.



madhe të mendimit, madje ajeti, mundësinë e të menduarit e ka numëruar detyrë për një nderim të madh të këtillë.

Përsëri Allahu i Lartësuar thotë: “فَأَقْصِرْ الْقَصَصَ لَعَلَّهُمْ يَشْكُرُونَ” - “...faksusil-kasasa leal’lehum jetefek’kerùne” - “...ti këndoji tregimet që ata të mendojnë”.<sup>1</sup>

Ka edhe shumë ajete të tjera që, në këtë kuptim, e ngrenë shumë lart mendimin, ose që i afrohen këtij kuptimi, përveç vlerësimeve të shumta që lexojmë në hadithet e nderuara rreth çështjes së mendimit.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur zbriti ajeti i nderuar:

“إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْخِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ” - “...in’ne fij khalki-s’semàvati uel-edi uakhtilàfi-l’lejli uen’nehàri...” - “...Në krijimin e qiejve e të tokës dhe në ndryshimin e natës e të ditës...”<sup>2</sup>tha: “Mjerim për mua, e lexova ajetin dhe nuk mendova për të”<sup>3</sup>.

Në të gjitha gjendjet, nuk ka asnjë dyshim se mendimi lavdërohet në Kur’an dhe në hadithet profetike, por këtu është shumë e rëndësishme që njeriu të dijë llojin e mendimit të lavdëruar. Fjala më e bukur, që e qartëson këtë kuptim, është fjala e Khavàxheh Abdullah El-Ensàrij (*Allahu e pastroftë sekretin e tij!*), i

---

<sup>1</sup>Sure “El Aràf”, ajeti 176.

<sup>2</sup>Sure “Àli Imràn”, ajeti 190.

<sup>3</sup>Një kuptim i njëjtë gjendet edhe në hadithin “Nùru-Th’thekalejni”, vëll 1, f. 350, me pak ndryshim në fjalë.



cili ka thënë: “Mëso se mendimi është lëmimi i ekzaminimit për të kuptuar qëllimin e lartë”.<sup>1</sup>

Domethënë, vëzhgimi është syri i zemrës dhe ky vëzhgim nxiton të arrijë në atë që është objektiv. Rezultati është qëllimi për plotësimin e njeriut. Dihet se ajo që është objektiv dhe vetë qëllimi, është lumturia absolute, e cila arrihet me plotësimin në dituritë dhe në punët.

Vetëkuptohet se njeriu ka për detyrë të arrijë lumturinë, e cila është rezultatja e njerëzores, sepse ky qëllim është nxjerrë prej ajeteve të Librit hyjnor, prej tregimeve e prej rrëfenjave të tij.

Meqenëse lumturia realizohet me arritjen e gjendjes pa gjynahe, me botën e dritës dhe me rrugën e drejtë, njeriu ka për detyrë që rrugët e shpëtimit, mademin absolut të dritës dhe rrugën e drejtë t'i studiojë prej Kur'anit Famëlartë, ashtu siç e theksonte këtë të vërtetë ajeti i lartpërmendur.

Kur kënduesi i Kur'anit e zbulon objektivin dhe, kur ai punon që ta arrijë atë me syrin vëzhgues, për atë shtohen rrugët e marrjes së njohurive prej Kur'anit Famëlartë dhe për atë hapen portat e mëshirës së të Vërtetit, prandaj njeriu të mos e humbë jetën e tij të shkurtër e të vyer dhe kapitalin e tij duke e kërkuar lumturinë në punët që jo vetëm nuk janë objektiv i mesazhit, por edhe e largojnë atë prej studimit të tekstit dhe prej fjalës së lartë në të tilla punë të rëndësishme.

Kur njeriun, për një farë kohe, e rrethon ky qëllim nga të gjitha anët, me ekzaminimin e syrit të zemrës së tij dhe nuk e hedh

---

<sup>1</sup>“Menâzilu-S'âirijne”, Pjesa “Fillimet”, K. “Mendimi”.



syryn e zemrës së tij në asgjë tjetër, përveç qëllimit që ka, atëherë atij i hapet vëzhgimi i zemrës e në të njëjtën kohë, për të shtrohen rrugët e përfitimit dhe hapen portat, që më parë nuk ishin të hapura. Atëherë njeriu e kupton se si Kur'ni Famëlartë është shërues për sëmundjet e zemrës; gjithashtu, kupton edhe qëllimin e ajetit të nderuar: “وَأَنْزَلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ۗ وَلَا يَرْيَدُ الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا” - “Ue nunez'zilu minel-Kur'ani mà huve shifâun ue rahmetun lilmuëminijne ue là jezijdul-dh'dhàlimijne il'là khasàren” - **“Prej Kur'anit Ne të kemi zbritur atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk i shton gjë tjetër përveç humbjes”**.<sup>1</sup> Gjithashtu, ai mëson edhe kuptimin e fjalës së Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Mësojeni Kur'anin, sepse ai është pranvera e zemrave dhe mjekohuni me dritën e tij, sepse ai, pa dyshim, është shërues për zemrat”.<sup>2</sup> Pas kësaj, te Kur'ani Famëlartë mos studio vetëm shërimin prej sëmundjeve trupore, por studio atë që përfaqëson qëllimin kryesor të Kur'anit, shërimi i sëmundjeve të shpirtit. Kur'ani Famëlartë nuk është zbritur për të shëruar sëmundjet trupore, edhe pse shërimi i këtyre sëmundjeve arrihet me të, ashtu si profetët arritën të shërojnë sëmundjet trupore. Por, pavarësisht se ata e bënë edhe këtë lloj shërimi, në radhë të parë, ata ishin mjekët e shpirtave dhe shërues të zemrave.

---

<sup>1</sup>Sure “Àli Imràn”, ajeti 82.

<sup>2</sup>“Nehxhul-Belâga” (Fejdu-l-islâm), Hytbeja 109, f. 330. Në këtë hytbe thuhet: “Mësojeni Kur'anin, sepse Kur'ani është fjala më e bukur; mësoni prej Kur'anit ligjin e fesë, sepse Kur'ani është pranvera e zemrave dhe mjekohuni me dritën e Kur'anit, sepse Kur'ani, pa dyshim, është shëruesi i zemrave”. (hytbeja vijon)



## Ndarja e gjashtë

### PËRPUTHJA

Prej edukatave të rëndësishme të këndimit të Kur'anit Famëlartë, që i mundësojnë njeriut të arrijë rezultate të shumta dhe të përfitojë mirësi të panumërta, është ajo që quhet “edukata e përputhjes”, domethënë: përputhja e njeriut me atë çka ai arriti, duke menduar çdo ajet që lexon. Gjithashtu, ai duhet të nxitojë të plotësojë të gjitha mangësitë e dukshme dhe të mjekojë çdo sëmundje që sheh në veten e tij.

Për shembull, sikur njeriu të shikojë me vëmendje në tregimin e Ademit dhe në këtë tregim të gjejë shkakun për të cilin shejtani u përzu prej pranisë së të Pastrit, pavarësisht seriozitetit të tij, sexhdeve të gjata që bënte dhe adhurimit që kryente. Në saje të mendimit, njeriu ka për detyrë ta pastrojë veten prej mendjemadhësisë, sepse pozita e afrimit tek Allahu është pozita e të pastruarve dhe është e pamundur të hyhet në portën e Allahut, kur te njeriu gjenden cilësi e sjellje të shejtanit. Ajetet e nderuara tregojnë se shkakun që e ndaloi shejtanin të zbatojë urdhrin e Allahut për t'i bërë sexhde Ademit, kishte si bazë vetëpëlqimin e mendjemadhësinë. Pikërisht, vetëpëlqimi e mendjemadhësia bënë që Iblisi të kundërshtojë me këmbëngulje:



“أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ خَلَقْتَنِي مِنْ نَارٍ وَخَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ” - “...ene khajrun minhu, khalaktenij min nàrin ue khalaktehù min tijnin” - “...unë jam më i mirë se ky (me më shumë vlera), mua më krijove prej zjarrit dhe këtë e krijove nga balta”.<sup>1</sup> Ky vetëpëlqim e çoi atë të dashurojë veten e të krenohet me veten e tij, duke u bërë mendjemadh. Të gjitha këto e çuan atë në despotizëm, në mendime kundërshtuese, duke ngritur krye. Rezultati i gjithë këtyre veprimeve qe përzënia e Iblisit prej pranisë së të Pastrit.

Qëkur jemi fëmijë, ne e mallkojmë shejtanin dhe e numërojmë atë prej të përzënëve, prej pranisë së të Pastrit, në një kohë që ne vetë kemi cilësitë e shejtanit dhe manifestojmë cilësitë e liga të tij. Ne nuk interesohemi fare për punët që çuan në përzënie e Iblisit prej pranisë së të Pastrit. Por ato punë çojnë në përzënie edhe të çdo qenieje tjetër që ka cilësitë e shejtanit, pasi nuk ka asnjë kusht, që ato cilësi të liga të përfshijnë vetëm shejtanin dhe të mos përfshijnë të tjerë veç tij. S’ka dyshim se ato punë që çuan në largimin e shejtanit prej pranisë së afrimit, shumë shpjet do të na çojnë deri aty, sa të na ndalojnë ta arrijmë këtë afrim. Unë kam shumë frikë se jemi bërë ortakë me Iblisin në mallkimet që ne derdhim mbi të.

Sikur të mendojmë anën tjetër të këtij tregimi të nderuar dhe të studiojmë rreth shkakut se pse Ademi u lartësua mbi engjëjt e Allahut, me aq sa është mundësia jonë ta përshkruajmë këtë nderim, me të gjitha cilësitë që lejon ky përshkrim, shumë shpejt do të shohim se shkakut i këtij lartësimi qëndron në “mësimin e emrave”, ashtu siç njofton Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij:

---

<sup>1</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 12.





“وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا” - “Ue al'leme Àdemel-esmàe kul'lehà...” - “**Ai** (Allahu) i mësoi Ademit të gjitha emrat (emrat e sendeve)”<sup>1</sup>

Grada më e lartë e mësimi të emrave, është vërtetimi me pozitën e emrave të Allahut. Gjithashtu, edhe grada më e lartë e numërimit të emrave bëhet realitet me të vërtetën e emrave. Kur kjo gjë realizohet për njeriun, atëherë ai meriton të fitojë Xhenetin e emrave, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar: “Për Allahun ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Kush i numëron ato, hyn në Xhenet”<sup>2</sup>.

Njeriu, me anën e ushtrimeve të zemrës, ka mundësi të bëhet një panoramë për emrat e Allahut dhe një argument hyjnor shumë i madh. Ekzistenca e tij bëhet ekzistencë hyjnore; është dora e bukurisë dhe e madhështisë hyjnore; bëhet ushtrues i pushtetit në mbretërinë e ekzistencës së tij. Hadithi i nderuar: “Pa dyshim, shpirti i besimtarit është shumë më i lidhur me shpirtin e Allahut nga sa është lidhja e rrezes së diellit me shpirtin”<sup>3</sup>, tregon pikërisht këtë kuptim.

Në një hadith të gradës “Sahijh” thuhet: “Robi më afrohet Mua me adhurimet nafîle, deri sa Unë e dua atë dhe, kur Unë e dua atë, Unë jam veshi i tij, me të cilin ai dëgjon; Unë jam syri i tij, me të cilin ai shikon; Unë jam gjuha e tij, me të cilën ai flet...”<sup>4</sup>

Në tërësi, kur personi dëshiron që për atë të bëhet realitet dobia e mjaftueshme dhe ai të arrijë një pjesë të mirë prej kësaj dobie prej Kur’anit Famëlartë, në radhë të parë, kërkohet që çdo ajet i

<sup>1</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 31.

<sup>2</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 4, f. 186-187.

<sup>3</sup>“El-Usùlu minel-Kâfi”, Libri “Besimi dhe mohimi”, K. “Besimtarët janë vëllezër të njëri-tjetrit”, Hadithi 4.

<sup>4</sup>“El-Usùlu minel-Kâfi”, Libri “Besimi dhe mohimi”, K. “Ai që i fyen e i urren myslimanët”, Hadithi 7.



Kur'anit Famëlartë të jetë në përputhje me lexuesin; për shembull, kur ai këndon fjalën e Allahut të Lartësuar:

“إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَّتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تَلَّيْتُمْ عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ”

- *“In'nemel-muëminùne-l'ledhijne idhà dhukire-llàhu vexhilet kulùbuhum ue idhà tulijet alejhim àjàtuhù zàdethum imanen ue alà rab'buhim jetevek'kelùne”* -**“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten”**.<sup>1</sup>

Besimtari si rrugëtar në Udhën e Allahut ka për detyrë të shikojë, nëse përputhet me të tri cilësitë e përmendura në këtë ajet:

A fërgëllon dhe a frikësohet zemra e tij, kur përmendet Allahu?

A shtohet drita e besimit në zemrën e tij, kur atij i këndohen ajetet e nderuara hyjnore?

Dhe a është besueshmëria dhe mbështetja e tij vetëm në të Vërtetin e Lartësuar apo ai ka mbetur prapa në çdonjërin prej këtyre tri gradëve dhe ka mbetur i privuar prej këtyre cilësive të larta?

Por, që njeriu të mësojë, nëse vetë ai e ka frikë të Vërtetin e Lartësuar dhe, nëse zemra e tij frikësohet prej të Vërtetit të Lartësuar, për këtë, ai ka për detyrë të vështrojë në brendësinë e vet. I frikësuar në praninë e madhështisë nuk guxon të bëjë nga ato punë që janë punë e sjellje të këqija. Gjithashtu, as nuk guxon të

---

<sup>1</sup>Sure “El Enfâl”, ajeti 2.



shkelë ndalesat hyjnore. Nëse ai është njeri me besim dhe forcohet me ajetet hyjnore, drita e besimit është rrjedhëse në mbretërinë e cilësive të tij të jashtme dhe, kur zemra të jetë e mbushur me dritë, është e pamundur të mos jetë dritë gjuha, fjala, syri, shikimi, veshi e dëgjimi i tij. Njeriu dritë është personi te i cili të gjitha fuqitë e mbretërisë së cilësive të tij rrezatojnë dritë, përveç rolit që ato kanë në orientimin e njeriut drejt lumturisë dhe rrugës së drejtë. Të gjitha këto fuqi, gjithashtu, rrezatojnë dritë edhe mbi të tjerët e i udhëzojnë ata në rrugën e humanizmit.

E njëjta gjë është edhe për atë person që mbështetet te Allahu i Lartësuar: ai person ndien keqardhje për të tjerët. Të gjithë barrën e nevojave që ka dhe varfërinë e tij, ai e parashtron vetëm në prani të të Pasurit absolut. Në të njëjtën kohë, ai beson se të varfrit e ngjashëm me të ndihen ngushtë, ngaqë s'kanë mundësi t'i plotësojnë atij nevojat që ai ka dhe të mbyllin mangësitë e tij.

Atëherë rrugëtari për tek Allahu ka për detyrë ta shtrojë gjendjen e tij në Kur'anin Famëlartë, sepse Kur'ani Famëlartë është kriteri dallues i haditheve e i transmetimeve. Me Kur'anin Famëlartë dallohen transmetimet që janë të vërteta nga ato të pavërteta, dallohen ato që merren në konsideratë nga ato që nuk merren në konsideratë. Kriteri është: çdo hadith që është në kundërshtim me Librin e Allahut, është i gabuar dhe ornament. Gjithashtu, Kur'ani Famëlartë është kriter për diagnostifikimin e vërtetimit të asaj që është e drejtë nga ajo që është e shtrembëruar, ashtu siç është kriter dallues për lumturinë, ose vështirësinë. Hadithi i vërtetë (sahijh) dhe i drejtë, është në përputhje me Librin e Allahut. Kur'ani Famëlartë ishte morali i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), prandaj edhe rrugëtari në udhën për tek Allahu ka për detyrë që moralin e



tij ta këtë në përputhje të plotë me Kur'anin, me qëllim që morali i tij të jetë në përputhje me moralin e kujdestarit të plotësuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë të dhe mbi familjen e tij!*), kurse morali që është në kundërshtim me Librin e Allahut, është zbukurim dhe i gabuar, është pa vlerë.

Në të gjitha gjendjet, vetëm puna është ajo vërteton të gjitha dituritë dhe të gjitha gjendjet e zemrave e të vetë punëve, të brendshme dhe të jashtme.

Rrugëtari për tek Allahu ka për detyrë që të gjitha këto t'i vërë në përputhje me Librin e Allahut dhe t'i shpalosë ato para Librit të Allahut, me qëllim që realiteti i tij të shikohet nën prizmin e të vërtetës së Kur'anit Famëlartë, deri sa ky Libër qiellor të bëhet fytyra e tij e brendshme.

*“Ti je Libri i qartë,  
që me shkronjat e tij nxjerr në shesh sekretin”.<sup>1</sup>*

Në këtë pozitë ka edhe shumë rregulla-edukata të tjera, por që të mënjanojmë zgjatjen, nuk do t'i shpalosim këtu. Vetëm Allahu e di më mirë.

---

<sup>1</sup>Dy vargjet e para të një poeme, që i dedikohet Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).



## Mbyllje

Në vijim do të sjellim disa hadithe të nderuara, me qëllim që të rritim përfitimin e dobive dhe t'i kemi bekim fjalët e familjes profetike.

Në Librin “El-Kàfi”, El-Kelebij’ji deri te Saedi, kanë transmetuar se Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “O Saed, mësojeni Kur’anin, sepse në Ditën e Kiametit ai do të vijë në fytyrën më të bukur që do të shikojnë njerëzit. Në atë ditë njerëzit janë të rreshtuar në njëqind e njëzet mijë radhë: tetëdhjetë mijë radhë janë të umetit të Muhamedit dhe dyzet mijë radhë janë të umeteve të tjera. Në radhën e myslimanëve, Kur’ani vjen me fytyrën e një burri, i cili përshëndet me selam; njerëzit e shikojnë atë dhe pastaj thonë: ‘S’ka Zot tjetër përveç Allahut, të Butit, Bujarit! Ky burrë është prej myslimanëve! Ne e njohim atë me cilësitë e tij...’

Pastaj ai kalon dhe shkon në radhën e profetëve dhe të dërguarve, me fytyrën e një profeti të dërguar. Profetët dhe të dërguarit e shikojnë, çuditen shumë dhe thonë: ‘S’ka Zot tjetër përveç Allahut, të Butit, Bujarit! Ky është profet i dërguar! Ne e njohim atë nga shenjat e nga cilësitë e tij, por atij i janë dhënë mirësi të shumta’. Ata mblidhen dhe shkojnë tek i Dërguari i Allahut dhe e pyesin: ‘O Muhamed, cili është ky?’ Ai u thotë atyre: ‘A nuk e njihni cili është?’ Ata thonë: ‘Këtë nuk e njohim, por njohim atë ndaj të cilit Allahu kurrë nuk është zemëruar’. Atëherë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i*



Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u thotë atyre: 'Ky është argumenti i Allahut ndaj robërive të Tij...''<sup>1</sup>

Hadithet me këtë përmbajtje janë të shumta dhe të gjitha argumentojnë e shpjegojnë saktësinë e fjalës së atyre që kanë arritur gradën e njohjes: të gjitha qeniet e kësaj bote kanë forma të tjera në botën e ardhshme.

Gjithashtu, në librin "El-Kâfi", Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "Unë jam i pari që do të mbërrij në Ditën e Kiametit te Fuqiploti, i Gjithëfuqishmi, Libri i Tij, pastaj umeti im. Më pas, unë do t'i pyes ata: 'Si vepruat me Librin e Allahut dhe me Ehli Bejtin tim?'"<sup>2</sup>

Në një hadith tjetër, i ardhur prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë: "Kur Allahu, Madhështori, do të mbledhë të mëparshmit e të mëvonshmit, do të bëjë përpara një person. Ata kurrë s'kanë parë fytyrë më të bukur se ai dhe besimtarët nuk i heqin sytë prej tij. Ai është Kur'ani. Ata thonë: 'Ky është prej nesh, ky është sendi më i bukur që kemi parë...!'"

Ai do të vazhdojë të ecë, deri sa të arrijë në të djathtën e Arshit, atëherë i Gjithëfuqishmi, do të thotë: 'Pasha madhështinë Time dhe pasha lartësinë e vendit Tim! Sot, Unë do të respektoj e do të nderoj vetëm atë që të ka nderuar e të ka respektuar ty dhe do të poshtëroj atë që të ka fyer ty!'"<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> "El-Usùlu minel-Kâfi", Libri "Fadlul-Kur'ani", K. 1, Hadithi 1.

<sup>2</sup> "El-Usùlu minel-Kâfi", Libri "Fadlul-Kur'ani", K. 1, Hadithi 4.

<sup>3</sup> "El-Usùlu minel-Kâfi", Libri "Fadlul-Kur'ani", K. 1, Hadithi 14.



Nuk është e panjohur që ne nuk kujdesemi as për dispozitat e Kur'anit, as për dituritë e Kur'anit, as nuk punojmë me dispozitat e Kur'anit, as nuk e studiojmë vërtetësinë që përmbajnë dispozitat e Kur'anit, prandaj shumë shpejt, në atë ditë nuk do të jemi në gjendje t'i japim përgjigjen e përshtatshme të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Cila fyerje është më e madhe për Kur'anin Famëlartë se kundërshtimi i qëllimeve dhe i thirrjes që bën Kur'ani Famëlartë?

Nderimi e respektimi i Kur'anit Famëlartë prej të pastërve të Ehli Bejtit nuk realizohet vetëm duke puthur kapakët e Librit të Kur'anit (mus'haf), ose duke puthur mezarët e pastra të të ruajturve prej gjynaheve të Ehli Bejtit, pasi ky veprim është vetëm njëra gradë personale, që tregon respekt, kurse nderimi do të jetë i pranueshëm vetëm nëse ne jemi korrekt me urdhrat, që ata kanë dhënë dhe me orientimet që na kanë lënë, ndryshe veprimi ynë do të jetë i ngjashëm me talljen e me vënien në lojë. Hadithet e nderuara kanë paralajmëruar me forcë në lidhje me këndimin e Kur'anit dhe me gjendjen, kur nuk punohet sipas Kur'anit.

Në librin "Ikâbul-Amâli", autori, shejhu Es'Sadûk (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) ka shkruar hadithin e ardhur prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "Ai që e mëson Kur'anin, por nuk punon sipas Kur'anit dhe respekton e pëlqen më shumë dashurinë për këtë botë e bukuritë e saj, meriton zemërimin e Allahut. Ai është në të njëjtën shkallë me jehuditët e kristianët, të cilët e kanë flakur Librin e Allahut prapa krahëve.

Ai që e këndon Kur'anin, me qëllim që të bëhet i dëgjuar dhe me Kur'anin e kërkon këtë botë, në Ditën e Kiametit, kur do të takohet me Allahun, në fytyrën e tij do të ketë një kockë pa mish. Kur'ani do t'i ngjeshë



*nofullat e tij, deri sa në gojën e tij të hyjë zjarri dhe ai rrëzohet me ata që do të rrëzohen.*

*Ai që e këndon Kur'anin dhe nuk mëson me Kur'anin, në Ditën e Kiametit, Allahu do ta tubojë atë të verbër. Ai do të thotë: 'O Zot, përse më tubove të verbër?! Unë më parë shikoja'. Dhe Allahu do t'i përgjigjet: 'Ty të erdhën argumentet Tona dhe ti i harrove ato, kështu edhe Ne të harrojmë ty!' Pastaj urdhërohet që ai të çohet në zjarr.*

*Ai që e këndon Kur'anin për hir të Allahut dhe prej Kur'anit mëson çështjet e ligjit të fesë, shpërblimi për të do të jetë i ngjashëm me gjithçka u është dhënë engjëjve, profetëve dhe të dërguarve.*

*Ai që e mëson Kur'anin, me qëllim hipokrizinë dhe famën, që me Kur'anin të mburret para mendjelehtëve e të lavdërohet me të te dijetarët dhe që me Kur'anin të kërkojë këtë botë, në Ditën e Kiametit, Allahu Fuqiplotë do t'i shpërndajë kockat e tij andej-këndej dhe në zjarr nuk do të ketë dikë tjetër që të ndëshkohet më shumë se ai dhe nuk do të mbetet asnjë lloj ndëshkimi, që ai të mos ndëshkohet, për shkak të zemërimit të Allahut e të mërisë së Tij.*

*Ai që e mëson Kur'anin dhe është kryeulët në dituri, ua mëson Kur'anin robëve të Allahut dhe ka qëllim të arrijë ato që janë te Allahu, në Xhenet, nuk do të ketë shpërblim më të madh se shpërblimi që i jepet atij; gjithashtu, nuk do të ketë pozitë më të lartë se pozita e tij; në Xhenet nuk do të ketë as banesë, as gradë të lartë e as vlerë, që ai të mos e ketë me bollëk dhe banesën më të nderuar''<sup>1</sup>.*

---

<sup>1</sup>"Ikàbul-Amàl", f. 332-346, fragmentet që sollëm prej hadithit.





Ka edhe shumë hadithe të tjera, që nxitin të menduarit rreth fakteve që jep Kur'ani Famëlartë, marrjen e këshillave prej tij dhe ecjes me udhëzimet që jep Kur'ani.

Gjithashtu, në librin "El-Kâfi", është transmetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Në këtë Kur'an janë ndriçuesit e udhëzimit në rrugën e drejtë dhe pishtarët e errësirës. Shkëlqyesi le të shndrisë shikimin e tij dhe le të hapë syrin e tij për dritën. Pa dyshim, të menduarit është jeta e zemrës vëzhguese dhe ai ecën ashtu siç ecën ai që është ndriçuar me dritë në errësirë".<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thekson se njeriu ka për detyrë, ashtu siç vazhdon të ecë në errësirë me dritën e llambës, që të jetë i sigurt se nuk do të rrëzohet dhe nuk do të rrëshqasë nëpër gropa, po kështu ai ka për detyrë të ndriçohet me Kur'anin Famëlartë, kur ecën në rrugën e errët që e çon atë në Botën Tjetër, që të mos rrëzohet prej të njëjtave gropa e vendeve të rrëshqitshme.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Juristi i ligjit të fesë islame nuk heq dorë me dëshirë prej Kur'anint, që të orientohet kah ndonjë tjetër, sepse s'ka të mirë në një dituri, në të cilën nuk mendohet dhe s'ka lexim, në të cilin mungon studimi; gjithashtu, s'ka të mirë as në adhurim pa u kuptuar adhurimi i bërë".<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>"El-Usûlu minel-Kâfi", Libri "Fadlul-Kur'ani", K. 1, Hadithi 5.

<sup>2</sup>"Meâni El-Akhbâr", K. "Maënel-fekijhi hak'kan", Hadithi i parë, f. 226.



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mbajtësit e Kur’anit janë dijetarët e banorëve të Xhenetit”.<sup>1</sup>

Dihet se qëllimi dhe me këtë “mbajtje”, është mbajtja e diturive të Kur’anit, domethënë se mbajtja e Kur’anit e bën njeriun në Botën Tjetër prej dijetarëve dhe prej zotëruesve të zemrave. Por, nëse ai mban vetëm anën e jashtme të Kur’anit, pa marrë këshilla prej predikimeve të Kur’anit dhe pa i kuptuar dituritë e gjykimin e Kur’anit, dhe nuk vepron sipas dispozitave të Kur’anit e nuk ecën sipas rrugës së tij, atëherë njeriu do të jetë njëri prej kritereve të ajetit të nderuar: “مَثَلُ الَّذِينَ حُمِلُوا الثَّوْرَةَ كَمَثَلِ الْجَمَلِ يَحْمِلُ أَثْقَالًا”-“*Methulu-l’ledhijne hum’milu-t’teuràte thum’me lem jahmilùhà kemethelil-himàri jahmilu esfàren...*”-“**Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat**”.<sup>2</sup>

Hadithet më në zë që flasin për çështjet e Kur’anit Famëlartë dhe për edukatën e rregullat e këndimit të Kur’anit janë të shumta, prandaj është e pamundur të përfshihen në këtë temë. Paqe e shpëtim për Muhamedin dhe për familjen e tij!

---

<sup>1</sup>“Meànj El-Akhbàr”, K. “Maèna urefài ehlul-Xhen’neti”, f. 323; “El-Khisàl”, vëll. 1, K. 1, Hadithi 100, f. 28.

<sup>2</sup>Sure “El Xhumu’a”, ajeti 5.



## Llamba e dytë

# EDUKATA E KËNDIMIT TË KUR'ANIT

## Ndarja e parë

### EDUKATA E KËNDIMIT NË NAMAZ

Mëso se për këndimin e Kur'anit, në këtë udhëtim shpirtëror dhe në këtë miraxh hyjnor, ka disa gradë e disa shkallë, në bazë të të cilave njerëzit janë të ndarë në grupe të ndryshme. Në këtë kumtesë do të përmendim vetëm grupet që janë në harmoni me këtë kumtesë, prej të cilave:

*Grupi i parë*, kënduesi i Kur'anit bën kujdes vetëm të këndojë Kur'anin sipas rregullave të texhvidit, për nxjerrjen e saktë të germave dhe asgjë më shumë se kaq, domethënë se më e rëndësishme për të është vetëm shqiptimi i saktë i fjalëve të ajeteve të Kur'anit dhe nxjerrja e germave në venddaljen e tyre dhe, kjo, me qëllim që të plotësohet kryerja e detyrimit dhe rrëzimi i detyrimit.

Dihet sa e gjatë është ajo që i bashkon detyrimet dhe sa të mëdha janë vështirësitë e pengesat në njerëz të tillë. Gjithashtu, nuk është e panjohur kujdesi që i rrethon zemrat e tyre dhe të



brendshmen e tyre për shkak të frikës prej detyrimeve. Pa dyshim që persona të tillë nuk kanë pjesë në shpërblimin për adhurimin, përveç rrëzimit të dënimit, i vendosur për atë që nuk e plotëson detyrimin, ose kur ata i përfshin mirësia prej depozitave të së padukshmes, domethënë se ata janë bërë objekt për bamirësi dhe për dhënie mirësish, thjesht për shkak të lakimeve të gjuhës së tyre.

Për individë të këtij grupi ndodh që disa herë gjuhët e tyre janë të pasionuara të përmendin të Vërtetin Fuqiplotë, në një kohë që zemrat e tyre janë të shkujdesura dhe janë bosh prej përmendjes që e shqiptojnë me aq pasion gjuhët e tyre, madje zemrat e tyre jo vetëm që janë të varura me shumicat e kësaj bote, por janë edhe të shqetësuara me cilësitë shpirtërore. Është e vërtetë se, nga ana e jashtme, ata merakosen për namazin, por, në të njëjtën kohë, shqetësohen për këtë botë e për të mirat e saj, kurse nga brenda merakosen për realizmin e punëve të kësaj bote.

Herë tjetër, ndodh që zemrat e tyre të jepen tërësisht pas mendimit rreth përmirësimit të formës së namazit. Kur ata janë të shqetësuar për formën e namazit – me zemër e me gjuhë, atëherë forma e namazit do të jetë e miratuar dhe e pranueshme prej tyre.

*Grupi i dytë*, janë personat që nuk ndihen të kënaqur me këtë cak, prandaj ata e kapërcejnë këtë kufi dhe arrijnë në gradën e njohjes, se namazi është rrugë për të përmendur të Vërtetin dhe këndimi i Kur'anit është falënderim e lavdërim për të Vërtetin.

Individët e këtij grupi janë në gradë të shumta dhe fjala do të tirrej gjatë, nëse do t'i përmendnim të gjitha gradët e tyre. Grada më e rëndësishme është ajo që theksohet në hadithin kudsij vijues. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka transmetuar



nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Allahu, i Gjithëfuqishmi, njofton se suren “El Fatiha” e ka ndarë mes Tij dhe mes robit, gjysma është për Allahun dhe gjysma tjetër është për robin e Tij. Për robin e Tij ka ato që ai kërkon. Kur robi i Tij thotë: ‘بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ’ – ‘Bismil’lâhirr’rrahmâni-rr’rrahijm’ – **‘Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!’**, Allahu Fuqiplotë thotë: ‘Robi Im filloi me emrin Tim dhe Unë e marr përsipër të plotësoj për të punët e tij. Unë e bekoj atë në të gjitha gjendjet e tij’. Kur robi thotë: ‘الحمد لله رب العالمین’ – ‘Elhamdu lil’lâhi rab’bil-âlemijn’ – **‘Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve!’**, Allahu i Madhëruar thotë: ‘Robi Im më falënderoi Mua. Ai e di se mirësitë që ka, janë prej Meje dhe se pësimet sprapsen me fuqinë Time. Unë dëshmoj para jush se atij do t’ia shumëfishoj mirësitë në këtë botë e në Botën Tjetër dhe do të spraps prej tij sprovat e rënda të Botës Tjetër, ashtu siç i sprapsa për të sprovat e rënda në këtë botë’. Kur robi Im thotë:

(الرحم الرحيم) - ‘Err’rrahmâni-rr’rrahijm’ – **‘Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!’**, Allahu Fuqiplotë thotë: ‘Ai dëshmoi se Unë jam i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë. Unë dëshmoj para jush se pjesën e tij prej mëshirës Sime do ta derdh mbi të me bollëk dhe patjetër që ai do të ketë edhe pjesën e tij prej dhuntive të Mia’.

Kur robi Im thotë: ‘مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ’ – ‘Mâliki jeumi-d’dijn’ – **‘Zotëruesit të Ditës së Gjykimit!’**, Allahu Fuqiplotë thotë: ‘Dëshmoj para jush, se ashtu siç pohoi robi Im për Mua se Unë jam Zotëruesi i Ditës së Gjykimit, patjetër që atij Unë do t’ia bëj të lehtë ditën e llogaridhënies, do t’i pranoj atij punët e mira dhe do t’i shlyej punët e këqija që ka bërë’.

Kur robi Im thotë: ‘إِيَّاكَ نَعْبُدُ’ – ‘Ij’jâke naëbudu’ – **‘Vetëm Ty të adhurojmë!’**, Allahu i Lartësuar thotë: ‘Robi Im vërtetoi se më adhuron vetëm Mua. Unë dëshmoj para jush se do ta shpërblej atë për adhurimin e



tij, me një shpërblim të atillë, që do ta ketë zili cilido që e ka kundërshtuar atë në adhurimin që ka bërë për Mua’.

Kur robi Im thotë: ‘واياك نستعين’ – ‘**Ue ij’jake nesteijn’ – ‘Vetëm Ty të kërkojmë ndihmë!’**, Allahu Fuqiptotë thotë: ‘*Mua më kërkoj ndihmë dhe te Unë u strehua. Dëshmoj para jush se atë do ta ndihmoj në punën e tij, do ta ndihmoj atë materialisht në gjendjet e tij të vështira dhe patjetër do ta marr atë për dorë në ditën e tij tmerruese’.*

Kur robi thotë: ‘إهدنا الصراط المستقيم’ – ‘**Thdina-s’siratal-mustekijm’ – ‘Na udhëzo në rrugën Tënde të drejtë – deri në fundin e sures’**, Allahu, i Gjithëpushtetshmi, thotë: ‘*Kjo është për robin Tim dhe për robin Tim ka ato që ai kërkon. Unë iu përgjigja robit Tim dhe i dhashë atij gjithçka që ai shpresonte dhe e sigurova atë prej çdo gjëje që i vinte nga vetvetja*’<sup>1</sup>

Bazuar në hadithin e mësipërm u bë e qartë se namazi ndahet mes të Vërtetit dhe robit, por kjo ndarje e vë robin para detyrimit, që të punojë me ngulm për të kryer detyrimin ndaj të Vërtetit, Kujdestarit, Ndihmuesit. Robi e mësoi se i Vërteti ka të drejtën e Tij në namaz; gjithashtu, robi ka detyrim të stoliset me edukatën e robërisë ndaj të Vërtetit Fuqiptotë. Në hadithin e nderuar, u tregua se rruga e robërisë ndaj të Vërtetit është shkaku që i Vërteti Fuqiptotë do ta trajtojë robin me butësitë hyjnore, ashtu siç pohohet në fjalën e Allahut të Lartësuar: “وَأَوْفُوا بِعَهْدِي أُوفِ بِعَهْدِكُمْ” - “...ue eufû biahdij ufi biahdikum...” - “...zbatoni premtimin që më keni dhënë dhe Unë do të zbatoj atë çka ju kam premtuar...”<sup>2</sup>

<sup>1</sup>“Emâlij Es’sadûk”, f. 105; “Bihârul Enuâr”, vëll. 92, f. 226.

<sup>2</sup>Sure “El Xhumu’a”, ajeti 40.



Në përgjithësi, ky hadith kudsî thekson praktikimin e edukatës së robërisë gjatë këndimit të Kur'anit dhe e vë atë në katër kolona:

*Kolona e parë:* përmendja e Allahut, që patjetër duhet të arrihet në “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ” – “*bismil'lâhîrr'rrahmâni-rr'rrahîjm*” – **“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”**

Rrugëtari për te Allahu ka për detyrë që të gjithë “shtëpinë e vërtetimit” ta shikojë si një emër i asgjësuar në të emëruarin. Gjithashtu, ai ka për detyrë t'ia bëjë zakon zemrës studimin rreth të Vërtetit dhe të ecë drejt Tij në të gjitha grimcat e krijesave. Prej fuqisë ai transporton cilësinë e pastër të krijimit, të mësimit të emrave, të depozituara në tharmin e vetes së tij, sipas kërkesave universale të krijimit e të shfaqjes prej shkëlqimit të emrit më të madh të Allahut, ashtu siç njoftohet në ajetin 31 të sures “El Bekare”: “وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا” - “*Ue al'leme Âdemel-esmâe...*” - **“Dhe (Allahu) i mësoi Ademit emrat (e të gjitha sendeve)...”**.

Kjo gradë arrihet me rrugën e qëndrimit në vetmi me Allahun, duke e përmendur sa më shumë Atë, duke i kryer me përqendrim punët hyjnore, deri sa zemra të bëhet hyjnore dhe të mos ketë asgjë tjetër përveç të Vërtetit Fuqiplotë. Kjo është grada e njëjtësimit me hyjnoren. Nisur nga ajo që u shpjegua më sipër, e kanë të pamundur të mohojnë. O Allah, na ruaj, nëse ato zemra janë djallëzore, pasi zemra të këtilla, nga vetë brumi i tyre, kanë zët prej emrave të Allahut, për rrjedhojë, atyre zemrave nuk ua tërheq vëmendjen asgjë tjetër përveçse plotësimi i dëshirave, ngopja e barkut dhe gratë.



Disa individë prej këtij grupi besojnë vetëm pozitativ dhe në Xhenetin trupor të profetëve e të eulijave, domethënë ata besojnë vetëm në instinktin kafshëror. Në të vërtetë, ata i krahasojnë mirësitë e Xhenetit me madhësinë e kopshteve, me gjerësinë e lumenjve që rrjedhin, me hyritë, me pallatet e shumta. Sikur në veshin e tyre të trokasë ndonjë fjalë rreth dashurisë hyjnore dhe forcës tërheqëse hyjnore, ata hidhen menjëherë kundër atij që e tha një fjalë të tillë, me shprehjet më të këqija e më të ulëta, sikur të jenë duke sprapsur një keqe të madhe, që po vjen drejt tyre.

Ata janë pengesë në rrugën e njerëzimit, janë ferra në rrugën e njohjes së Allahut, janë shejtanë, njerëz mashtrues; zënë pusi, grupe-grupe, njëri pas tjetrit në rrugën e robëve të Allahut, me qëllim që t'i ndalojnë ata prej të Vërtetit, prej emrave të Tij dhe prej përmendjes së Tij. Gjithashtu, këta shejtanë - njerëz mundohen t'i drejtojnë robtë e Allahut drejt kafshërisë, drejt ngopjes së barkut e kënaqjes së instinkteve dhe, si ushtarë të Iblisit ata bëjnë punën e Iblisit, ashtu siç theksohet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“لَا تُقْنُوا لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ” - “..leak'udune siràtakel-mustekijm” - “...atyre (njerëzve) **do t'u zë pusi në rrugën Tënde të drejtë**”<sup>1</sup>. Ata rrinë në anë të rrugës së drejtë hyjnore dhe bëjnë çmos që asnjë njeri të mos arrijë te Zoti dhe askush të mos çlirohet prej errësirave të varësisë, prej instinkteve kafshërore, ndër të cilat edhe varësisë prej hyrive e pallateve.

Ata i nxjerrin argumentet prej lutjeve (duave) të profetëve e të eulijave, të cilët gjithashtu, në lutjen e tyre, kanë kërkuar hyritë e pallatet.

---

<sup>1</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 16.





Pikërisht kjo mënyrë nxjerrje argumenti, vërteton sa i shkurtër e sa i ngushtë është horizonti i tyre. Ata nuk e dallojnë diferencën mes dashurisë e nderimit të Allahut, e përfaqësuar me shikimin mbi të Dashurin e mbi dhuntitë e Tij. Nuk bëjnë dallim mes kësaj dashurie, e cila numërohet prej shenjave të dashurisë e të kujdestarisë, nuk bëjnë dallim mes kësaj dashurie dhe dashurisë për hyritë, për pallatet e për të tjera të ngjashme të kësaj dashurie, e depozituar në brumin e dëshirave kafshërore.

Dashuria e nderimit të Allahut, është dashuria e Allahut, që rrjedh prej nderimit e prej mëshirës së Tij.

*“Unë e dua të gjithë botën  
dhe e gjithë bota është prej Tij”.<sup>1</sup>*

Ose në një mënyrë tjetër:

*“Sa shumë e ka shtyrë zemrën time dashuria për shtëpitë.  
Por, është dashuria e atyre që banojnë në ato shtëpi”.<sup>2</sup>*

Po, si është marrëdhënia e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), me hyritë e me pallatet? Si është e vërteta e lidhjes mes këtij të madhi dhe mes dëshirave e prirjeve shpirtërore e instinkteve kafshërore? Kur adhurimi i tij është adhurim i njerëzve të lirë, shpërblimi i tij nuk është shpërblimi i tregtarëve... lapsi rrëshqet lirshëm, boja rrjedh dhe unë ngadalësohem prej thelbit të bisedës.

---

<sup>1</sup>Brendia e shkurtër e vargjeve të një poezie, e poetit Sadi Shirazi.

<sup>2</sup>Disa vargje të poetit arab, Kajs bin Elmeluh el-arebi.



Në të gjitha gjendjet, kush ia bën zakon vetes këndimin e ajeteve dhe përmendjen e emrave hyjnorë prej Librit të krijimit dhe prej shkrimit hyjnor, patjetër që zemra e tij dalëngadalë merr fytyrën e përmendjes së Allahut (dhikrit) dhe ajetit që përsëritet. Gjithashtu, edhe e brendshmja e tij realizohet me përmendjen e Allahut, me emrin e Tij dhe me ajetin e Tij të lartë. Për të gjitha këto, përmendja interpretohet me përmendjen e të Dërguarit më të nderuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me përmendjen e emrave të bukur dhe me argumentin e Allahut.

Këto janë argumente hyjnore, emrat e bukur. Më e rëndësishme është përmendja e Allahut.

Pozita e përmendjes (dhikrit) është prej pozitave të larta madhore. Është pozita që nuk arrihet të shpjegohet dhe fjalët e shprehjet e kanë të pamundur të japin njoftim për ato pozita. Por, për ata që kanë arritur gradën e njohjes, për ata që gëzojnë forcën tërheqëse hyjnore dhe për të dashuruarit (në Allahun), do të mjaftohemi duke sjellë ajetet dhe transmetimet vijuese:

Allahu i Lartësuar thotë: **“فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ”** - *“Fedhkurùnij edhkurkum...”* - **“Më përmendni Mua, që edhe Unë t’ju përmend ju...”**<sup>1</sup>

Allahu Fuqiptotë, duke biseduar me Musain (*Paqja qoftë mbi të!*), i tha: *“Unë bashkëbisedoj me atë që më përmend Mua”*.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 152.

<sup>2</sup>“El-Usûlu minel-Kâfi”, Libri “Duatë”, K. “Detyrat që rrjedhin nga përmendja e Allahut”, Hadithi 4. Ebu Xhafert (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Në Teurat është shkruar dhe nuk është ndryshuar se Musai (Paqja qoftë mbi të!) e pyeti Zotin e tij: ‘O*



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ai që e përmend shumë Allahun, Allahu e do atë”.<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Gjithëfuqishmi, Madhështori ka thënë: ‘O bir i Ademit, më përmend Mua, kur je vetëm, që Unë të të përmend ty! O bir i Ademit, më përmend Mua para të tjerëve, që Unë të të përmend ty para një grupi shumë më të mirë nga grupi yt!’ Ai që e përmend Allahun para një grupi njerëzish, patjetër që atë njeri Allahu e përmend para engjëjve”.<sup>2</sup>

*Kolona e dytë:* falënderimi që bën personi, kur fal namaz, që theksohet në frazën: “**الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ**” - “**Elhamdu lil'lâhi rab'bil-âlemijne**” - **“Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve!”**.

Le të dihet se, kur personi fal namaz, ai ka arritur pozitën e përmendjes (dhikrit). Ai ndërgjegjësohet, se të gjitha grimcat e qenieve të larta e të ulëta janë emra hyjnorë. Kur ai e ka nxjerrë prej zemrës së tij çdo lloj besimi, se nuk ekzistojnë qenie të pavarura dhe, kur ai shikon me ngulm në qeniet e botës së padukshme e të dukshme se edhe ato s’kanë pavarësi, atëherë te ai person bëhet realitet grada e falënderimit (el hamdu). Zemra e tij pohon veçantinë e të gjitha falënderimeve e lavdërimeve vetëm për Qenien Një e të Vetme, pa i shoqëruar në këtë falënderim asnjërin

---

Zot, Ti a je afër meje, që unë të flas me Ty në vetmi apo je larg dhe unë të afrohem te Ti? Allahu, i Gjithëfuqishmi, i shpalli atij: ‘O Musa, Unë bashkëbisedoj me atë që më përmend Mua...’”

<sup>1</sup>Burimi i mësipërm, Libri “Duatë”, K. “Përmendja shpesh e Allahut të Gjithëfuqishëm”, Hadithi 3.

<sup>2</sup>Vesâilu-Sh’shij’a”, Libri “Namazi”, K. “Është veprim i pëlqyer, që Allahu të përmendet para një grupi njerëzish”, Hadithi 4.



prej qenieve, në një kohë që të gjitha qeniet, në vetvete, kanë nevojë për plotësim, për rrjedhje për asnjërën prej qenieve nuk mund të këtë as falënderim e as lavdërim.

Me lejen e me dashjen e Allahut të Lartësuar, rreth kësaj fraze të këndshme hyjnore, do të flasim në mënyrë të detajuar, kur do të trajtojmë interpretimin e sures “El Hamd” (El Fàtiha).

*Kolona e tretë:* madhërimi që arrihet me përmendjen e emrave të Allahut: “الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ” - “Err’rrahmàni-rr’rrahijm” - **“të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”**.

Kur robi rrugëtar te Allahu i përqendron falënderimet, në kolonën e falënderimit, për të Vërtetin e Lartësuar dhe ka hequr prej shumicave ekzistuese çdo lloj plotësimi ose falënderimi, atëherë ai është afruar në horizontet e Njëshit, prandaj, dalëngadalë, sytë e tij nuk shikojnë shumicat, atëherë në zemrën e tij shkëlqen fytyra e mëshirës, e cila përfaqëson shtrirjen e ekzistencës dhe, kur ai e përshkruan Fuqiplotin me këta dy emra gjithëpërfshirës, ai shikon edhe mëshirën, që përfaqësohet në plotësimin e ekzistencës. Gjithashtu, në këta dy emra, shumicat bëhen të padukshme dhe zemra e tij, në saje të veprimit të shkëlqimit e të plotësimit, hyn në madhështinë që rrjedh prej bukurisë. Më pas, te ai rrugëtar shkëlqen madhështia e të Vërtetit.

Kur mundësohet kjo gjendje, ai kalon në kolonën e katërt.

*Kolona e katërt:* është pozita e shenjtërimit, që përfaqëson të vërtetën e madhërimit, ose me fjalë të tjera, përfaqëson delegimin e kompetencës së punës vetëm Allahut Fuqiplotë. Kjo pozitë realizohet në saje të vënies në konsideratë të pozitës sunduese e të pozitës mposhtëse të së Vërtetit; atëherë te rrugëtari për te Allahu



fillon fshirja e pluhurit të shumicës, fillon shembja e idhujve të “qabes së zemrës”, fillon nxjerrja në dukje e Sunduesit të shtëpisë së zemrës e të ushtrimit të pushtetit të Tij, pa asnjë përzierje djallëzore.

Në këtë gjendje, rrugëtari për te Allahu, patjetër që ka arritur pozitën e qëndrimit në vetmi. Në këtë gjendje, s’ka më mbulesë mes të Vërtetit e mes robit; në këtë çast ndodh: “إِيَّاكَ تَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ” - “*Ij’jâke naëbudu ue ij’jâke nesteijnû*” - “**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë**”. Në këtë gjendje, ai ka arritur në vetminë e veçantë dhe në vendbashkimin e shoqërimit. Pikërisht për këtë, në hadithin kudsî që pamë më sipër, Allahu i Lartësuar thotë: “*Kjo është mes Meje e mes robit Tim*”.

Më pas, rrugëtarin e kanë përfshirë butësitë e përhershme dhe e kanë bërë atë të ndërgjegjësohet. Në këtë pozitë, rrugëtari kërkon ecjen në udhën e drejtë dhe i lyp të Vërtetit, që t’ia mundësojë ecjen në rrugën e drejtë me fjalën e Tij: “هُدًىٰ الصِّرَاطِ الْمُسْتَقِيمِ” - “*Ihdina-s’ sirâtal-mustekijm*” - “**na udhëzo në rrugën Tënde të drejtë**”, prandaj fjala “هُدًىٰ” - “*Ihdinâ*” - “**na udhëzo**” është interpretuar në kuptimin: “na e bëj detyrë, bëj që të jemi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm”.

Padyshim që këto ndodhin te ata që kanë dalë prej mbulesave dhe kanë arritur te i Kërkuari i përjetshëm. Kurse ne dhe të ngjashmëve me ne, që jemi të mbuluar, patjetër që kemi për detyrë që udhëzimin, në kuptimin e plotë të kësaj fjale, ta kërkojmë vetëm prej të Vërtetit Fuqiplotë. Me dashjen e Allahut e me lejen e Tij, shpresojmë të kthehemi për të vijuar bisedën rreth kësaj çështjeje gjatë shpalosjes së interpretimit të sures “El Hamd” (El Fatihâ).



## Plotësim

Në hadithin kudsî, me të cilën e hapëm këtë ndarje, pamë se i gjithë namazi është ndarë mes të Vërtetit e mes robit dhe surja “El Hamd” (El Fatiha) e përmend këtë fakt si shembull.

Bazuar mbi këtë shpjegim, mund të thuhet se, për shembull, tekbiret e namazit, përveç tekbirit të fillimit ose tekbireve të tjerë, që thuhën gjatë pjesëve ndarëse të namazit, janë prej ruajtjes hyjnore dhe pjesë e mirësisë prej Qenies së pastër. Le të supozojmë se robi rrugëtar te Allahu e kreu këtë detyrim robërie. Me adhurimin që ai bëri, ky njeri, me aq sa mundi, e plotësoi të drejtën që i takon Allahut, atëherë i Vërteti i Lartësuar, kundrejt plotësimit të detyrës nga ana e rrugëtarit, i jep robit të drejtën që i takon. Kjo që u tha, tregohet në hadhithin e nderuar, i transmetuar në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, në të cilin Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur thua: ‘Allahu Ekber’ konsideroje të vogël ç’ka mes qiejve të lartë e thellësisë së tokës, por jo madhështinë e Allahut. Kur Allahu i Lartësuar e informon zemrën e robit, ai thotë ‘Allahu Ekber’. Por, nëse në zemrën e tij ka diçka që është në kundërshtim me të vërtetën e madhërimin që ai bëri, i Vërteti thotë: ‘O gënjeshtar, Mua do të më mashtrosh?! Beto hem në madhërinë e në madhështinë Time, patjetër që do të të privoj nga kënaqësia e përmendjes Sime dhe Unë nuk të mbuloova prej afrimit te Unë e prej kënaqësisë së bisedimit në vetmi me Mua...”*<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>“Mustedreku-Vesàili”, Libri “Namazi”, K. 2 - “Punët e namazit”, Hadithi 9.



“Kur fal namaz, mbaje parasysh se ti je me zemrën tënde. Nëse ti gjen ëmbëlsinë e namazit dhe ndihesh i gëzuar që bashkëbisedove në intimitet dhe shijove ëmbëlsinë e bashkëbisedimit, atëherë mëso se Allahu e ka vërtetuar madhërimin që bërë, ndryshe dije se të është hequr shija e bukur e bashkëbisedimit në fshehtësi dhe je privuar prej ëmbëlsisë së adhurimit. Pikërisht ky është argumenti që tregon se Allahu të përgënjeshton dhe ti je i dëbuar prej portës së Tij”.<sup>1</sup>

Bazuar mbi këtë që u tha, bëhet e qartë se në çdo gjendje e në çdo punë të namazit ka një të drejtë që i takon të Vërtetit të Lartësuar dhe robi ka detyrim ta plotësojë këtë të drejtë, pasi në këtë pozitë, kryerja e kësaj të drejte është prej edukatave të robërisë ndaj të Vërtetit Fuqiplotë. Por në namaz, edhe robi ka pjesën e vet si mirësi e dhënë prej të Vërtetit, që robi ta falë namazin. Patjetër që kjo mirësi e të Lartit është e padukshme dhe është prej shkëlqimeve të mëshirës së Tij për atë rob që stoliset me edukatën e robërisë ndaj të Vërtetit Fuqiplotë.

Kur robi, gjatë këtyre kohëve hyjnore, e sheh veten të privuar prej butësive të veçanta hyjnore, le të dijë se ai nuk është stolitur me edukatën e robërisë ndaj të Vërtetit Fuqiplotë dhe, shenja e për këtë mospajisje te mesatarët është se zemra nuk e shijon as kënaqësinë e bisedimit intim me të Vërtetin Fuqiplotë dhe as ëmbëlsinë e adhurimeve, e për rrjedhojë, ata janë të privuar prej gëzimit e janë të shkëputur prej të Vërtetit Fuqiplotë.

---

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 13 - “Mbyllja e namazit”.



S'ka dyshim se, kur adhurimi është i zhveshur prej kënaqësisë e prej ëmbëlsisë, ai adhurim ka mbetur pa shpirt dhe zemra është e shkëputur prej atij adhurimi.

Atëherë, i dashur, bëje zemrën tënde të ndiejë kënaqësi nga edukata e robërisë ndaj të Vërtetit Fuqiplotë dhe shpirti yt le të shijojë ëmbëlsinë e përmendjes së Allahut. Por, që kjo mirësi hyjnore të bëhet realitet për ty, që në fillim ndiq rrugën e të menduarit intensiv dhe duke përmendur të Vërtetin, do të ndiesh kënaqësi, me kusht që zemra jote të mos jetë e vdekur gjatë kohës që ti përmend Allahun. Gjithashtu, në asnjë rast, mbi zemrën tënde të mos sundojë shkujdesja. Kur ti qëndron, kërkon ta bësh zemrën, që ajo të ndiejë kënaqësi nga përmendja e Allahut, atëherë, dalëngadalë, ty të përfshijnë butësitë e përjetshme, në zemrën tënde hapen portat e mbretërive. Shenja dalluese për këtë është "braktisja e shtëpisë së mashtrimit dhe afrimi për te shtëpia e përjetshme, si dhe përgatitja për vdekjen, para se të vijë koha e vdekjes".<sup>1</sup>

O Zoti ynë, mos na privo prej kënaqësisë së bisedimit në intimitet me madhërinë Tënde, mos na privo nga ëmbëlsia e bashkëbisedimit me Ty! O i madhi Allah, na bëj prej atyre që të përmendin Ty dhe kanë qëllim të përfundojnë në madhështinë e pastërtisë Tënde! O Zoti ynë, gjallëroi zemrat tona të vdekura me Jetën e Përherëshme! Na bëj që të drejtohem vetëm Ty dhe askujt tjetër! Në dorën Tënde janë virtyti e mirësitë materiale!

---

<sup>1</sup>Pjesë nga lutja e Imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*).





## Ndarja e dytë

### EDUKATA E KËRKIMIT TË MBROJTJES (EL-ISTIÂDHEH)

Allahu i Lartësuar urdhëron:

“فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ. إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ. إِنَّمَا سُلْطَانُهُ عَلَى الَّذِينَ يَتَوَلَّوْنَهُ وَالَّذِينَ هُمْ بِهِ مُشْرِكُونَ”

*“Feidhà kareëtel - Kur’âne festeidh bil’lâhi mine-sh’shejtâni-rr’rrexhijm. In’nehù lejse lehù sultânun ale - l’ledhijne àmenù ue alà rab’bihim jetevek’kelùne. In’nemà sultânuhù alel - l’ledhijne jetevel’leunehù uel’ledhijne hum bihi mushrikùne” - “Kur dëshiron të lexosh Kur’anin, kërkohet mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar, sepse, në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre. Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut”.*<sup>1</sup>

Prej edukatave më të rëndësishme të këndimit të Kur’anit, sidomos këndimit të Kur’anit në namaz, është udhëtimi moral për te Allahu e një ngjitje e vërtetë në lartësitë e pastra dhe një shkallare që u mundëson njerëzve të Allahut të arrijnë edukatën e kërkimit të mbrojtjes prej shejtanit të përzënë prej mëshirës. Tani e pamë se shejtani është një ferrë në rrugën e diturisë dhe një pengesë e lartë në rrugën e ecjes për te Allahu, madje është vetë shejtani ai që e

<sup>1</sup>Sure “En’Nahl”, ajetet 98-100.



pohon këtë rol, për të cilin na njofton Allahu Fuqiptotë në suren e nderuar “El Arâf”, për betimin e shejtanit, kur thotë:

“فِيمَا أُغْوَيْتَنِي لِأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ” - “...febima agvejtenij leak’uden’ne lehum sirâtakel-mustekijme” - **“Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë”**.<sup>1</sup>

Shejtani u betua se do t’u presë rrugën bijve të Ademit, që t’i nxjerrë ata prej rrugës së drejtë dhe pikërisht për këtë, nuk ka mundësi të jemi të sigurt prej të keqes së këtij pusizënësi, pa kërkuar mbrojtjen e Allahut e pa u strehuar në fortifikatën hyjnore, edhe gjatë faljes së namazit, që, siç u tha, është rruga e drejtë e njerëzimit dhe shkallarja që mundëson arritjen te Allahu i Lartësuar.

Është e qartë se ky kërkim i mbrojtjes dhe ky strehim në fortifikatën hyjnore, nuk realizohet thjesht me lakimin e gjuhës dhe me shqiptimin e frazës: “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ” - “eùdu bil’lâhi mine-sh’shejtâni-rr’rrexhijm” - **“i lutem Allahut të më mbrojë prej shejtanit të dëbuar”**, të zhveshur prej shpirtit dhe duke pasur në mendje këtë botë e jo Botën e Ardshme. Ka të atillë që e përsërisin shpesh frazën e kërkimit të mbrojtjes, madje e përsërisin këtë frazë për dyzet apo për pesëdhjetë vjet radhazi, por pa realizuar për veten e tyre shpëtimin prej këtij rrugëprerësi. Në të kundërt, janë bërë të atillë që e ndjekin dhe e kopjojnë shejtanin në moral e në punë, madje e ndjekin shejtanin deri edhe në besimet e zemrës.

Sikur të jemi të sinqertë në kërkimin e mbrojtjes prej Allahut nga e keqja e të ligut, patjetër që i Vërteti i Lartësuar, i Dëliri, i Pastërti, Bujari absolut dhe Zotëruesi i mëshirës së gjerë, Zotëruesi

---

<sup>1</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 16.



i fuqisë së plotë, i Gjithëdituri dhe Bujari gjithëpërfshirës, do të na mbrojë e do të na ruajë për të mirën e besimit tonë. Ai i lartëson moralet e punët tona.

Atëherë, duhet ta kthejmë kokën për të parë se ç'është kjo mbetje prapa, që na ka prekur në këtë ecje mbretërore dhe në këtë rrugëtim hyjnor? Në të vërtetë, kjo prapambetje është rezultat i mashtrimit të shejtanit, është rezultat i rënies nën pushtetin e shejtanit dhe, kjo për shkak të mangësive tona, ngaqë ne nuk i kemi të plota edukatat tona morale. Po kështu, në këtë rrugëtim mbretëror kemi lënë mangët edhe kushtet e zemrës. Në të vërtetë, kjo prapambetje është rezultat i një sëmundjeje të fshehtë, është pasojë e mosarritjes së rezultateve morale nga ana jonë dhe, se te ne nuk ndikon asnjë prej kuptimeve të dukshme e të brendshme të frazave e shprehjeve të dhikreve e adhurimeve.

Për kërkimin e mbrojtjes ka edukata të shumta që mësohen prej ajeteve të nderuara të Kur'anit Famëlartë dhe prej haditheve të nderuara, të ardhura prej të ruajturve nga mëkatet. Por, që të numërohen të gjitha këto ajete e hadithe dhe të vërtetohen plotësisht, do të zgjateshim shumë, prandaj do të përmendim vetëm disa prej këtyre ajeteve kur'anore dhe haditheve të nderuara.

Njëra prej edukatave më të rëndësishme për kërkimin e mbrojtjes së Allahut të Lartësuar, është sinqeriteti. Në Librin e Tij, Allahu i Lartësuar citon fjalën e shejtanit:

“فَبِعَاثِكَ لَاغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ. إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ” - “...febi'iz'zetike leugvijen'nehum exhmeijne. Il'la ibàdeke minhuml-mukhlesijne” - “...pasha madhërinë



**Tënde, unë patjetër do t'i shmang ata të gjithë prej rrugës së drejtë. Me përjashtim të sinqertëve prej robëve Tuaj”.<sup>1</sup>**

Siç shihet qartë prej këtij ajeti të nderuar, sinqeriteti për të cilin bëhet fjalë, është më i lartë se sinqeriteti i punëve, në mënyrë të barabartë i punëve të zemrës e i punëve të gjymtyrëve, për faktin se fjala “sinqeritet”, sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe, në këtë ajet, ka ardhur në formën pasive të emrit (ismi mef’ül). Sikur qëllimi i përdorimit i fjalës “sinqeritet” të ishte sinqeriteti i punëve, atëherë patjetër që emri do të vinte në formën aktive të emrit (ismi fàili).

Qëllimi me këtë sinqeritet është sinqeriteti i identitetit njerëzor, me të gjitha punët e tij, të padukshme e të dukshme, pasi sinqeriteti në punë është prej rezultateve të këtij identiteti.

Këtë të vërtetë hyjnore kaq domethënëse, edhe nëse nuk e arrijnë njerëzit e zakonshëm, në fillim të rrugëtimit të tyre, ose e arrijnë me ushtrime praktike, intensive dhe në mënyrë të veçantë me ushtrime të zemrës, të cilat janë baza e ushtrimeve, ashtu siç theksohet në hadithin vijues: *“Kush i fal me sinqeritet për Allahun dyzet namaze sabahu, burimet e urtësisë rrjedhin nga zemra e tij për në gjuhën e tij”*.<sup>2</sup> Kush i fal me sinqeritet për Allahun dyzet namaze sabahu, kjo është koha e mbrujtjes së baltës së Ademit. Te ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe te zotëruesit e zemrave, lidhja mes namazeve të sabahut dhe dyzet ditëve është e qartë se punët e tij të zemrës dhe punët shabllone janë bërë vetëm hir të të Vërtetit. Gjithashtu, te ata është e qartë se zemra e tij bëhet hyjnore dhe prej asaj zemre shpërthejnë vetëm burimet e urtësisë, për rrjedhojë

---

<sup>1</sup>Sure “Sàad”, ajetet 82-83.

<sup>2</sup>Lexo anësoren 3, f. 254.



gjuha e tij, e cila është përkthyesi i zemrës, shumë shpejt, gjithashtu, do të flasë vetëm me urtësi.

Sinqueriteti i punëve, në fillim, çon në sinqueritetin e zemrës dhe, kur zemra pastrohet plotësisht, në pasqyrën e asaj zemre shkëlqejnë dritat e madhështisë e të bukurisë, të depozituara në baltën hyjnore me mbrujtjen hyjnore dhe, pas kësaj, prej brendësisë së zemrës deri në të jashtmen e mbretërimit.

Në përgjithësi, ky pastrim i plotë është i detyrueshëm, për të dalë prej pushtetit të shejtanit. Pikërisht, ky pastrim është sinqueriteti i identitetit të shpirtit e i të brendshmes së zemrës vetëm për hir të Allahut Fuqiplotë.

Në fjalën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), në tekstet e “El Munàxhàtu-Sh’shaëbànij’jeh” tregohet për këtë gradë. Midis të tjerash, ai thotë: “O Zoti im, më dhuro mua ndalesën e plotë pranë Teje!”<sup>1</sup> Kur zemra arrin në këtë gradë sinqueriteti dhe ndalimi të plotë vetëm tek Allahu, nuk ka asnjë rrugë që, në mbretërinë e ekzistencës së tij, të hyjë diçka a dikush tjetër përveç të Vërtetit Fuqiplotë, atëherë për shejtanin, i cili hyn te njeriu, kurrë nuk do të ketë rrugë për të hyrë në atë zemër. Këtë njeri, i Vërteti i Lartësuar e mbron dhe ai njeri hyn nën mbrojtjen e sigurisë hyjnore, për të cilën Allahu i Lartësuar, në hadithin kudsi, thotë: “Fjala: “لا إله إلا الله” - “Là ilàhe il’le-ll’làh” - “S’ka Zot tjetër përveç Allahut”, është kështjella Ime dhe, kush hyn në kështjellën Time, është i siguruar prej ndëshkimit Tim”.<sup>2</sup>

<sup>1</sup>“El Munàxhàtu-Sh’shaëbànij’jeh”, lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 91, f. 99.

<sup>2</sup>Lexo “Kitàbu-T’teuhijdi” e autorit Es’sadük, f, 25; “Bihàrul Enuàr”, vëll. 3, f. 13 dhe vëll. 90, f. 192.



Hyrja në kështjellën “Là ilàhe il’le-ll’làh” ka gradë, ashtu siç ka gradë edhe ndëshkimi.

Ai që kërkon mbrojtjen e Allahut dhe hyn në kështjellën e Tij, me të brendshmen e me të jashtmen e vet, me zemër e me trup, është i siguruar prej të gjitha shkallëve të ndëshkimit, të cilat përfaqësojnë ndëshkimin e mbulimit prej bukurisë së të Vërtetit dhe ndarjen për të arritur te i Dashuri, te Madhështori. Kjo është grada më e lartë dhe, kush arrin në këtë gradë, bëhet rob i vërtetë ndaj Allahut, hyn nën mbrojtjen hyjnore dhe i Vërteti bëhet ushtruesi i pushtetit në mbretërinë e ekzistencës së këtij robi. Me këtë arritje, robi e ka nxjerrë jashtë sundimin e shejtanit. Kjo është prej pozitave më të nderuara të eulijave dhe nga lartësimet e veçanta për të zgjedhurit e pastruar, është një gradë, në të cilën nuk kanë pjesë të gjithë njerëzit. Mbase ata me zemra të ashpra mohuese dhe shpirtrat e ngurtë debatues, prej atyre që në këtë gradë janë në ndarje e në ndarje të dyta, i mohojnë këto pozita. Bisedën rreh kësaj teme e konsiderojnë të gabuar dhe, jo vetëm kaq, Allahu të na mbrojë, këto punë ata i konsiderojnë përralla e legjenda sufiste dhe thashetheme të kota.

Edhe ne që flasim për këto pozita, të cilat, në të vërtetë, janë pozitat e të plotësuarve, nuk është se kemi pjesë në to apo shpresojmë t’i arrijmë. Jo, ne thjesht mendojmë se nuk është e përshtatshme, që këto pozita të mohohen. Ne besojmë se përmendja e Allahut që bëjnë eulijatë dhe pozitat e tyre, kanë rol në pastrimin e në gjallërimin e zemrave. Gjithashtu, ne besojmë se edhe përmendja e Allahut, nga ana e eulijave dhe dijetarëve, si dhe lutja e tyre për të mirë, çon në lindjen e dashurisë, lidhjeve dhe afrimit, por këto, nga ana e tyre, çojnë në arritjen e tërheqjes dhe pastaj të ndërmjetësimit, i cili, nga ana e jashtme, është nxjerrje prej



errësirave të injorancës e orientim drejt dritave të udhëzimit në rrugën e drejtë e drejt diturisë. E brendshmjia e kësaj tërheqjeje është dalja sheshit e ndërmjetësimit në Botën Tjetër, megjithëkëtë, duhet të theksohet se ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve nuk vjen kot së koti dhe as nuk bëhet realitet pa ekzistencën e këtij afrimi.

Në përgjithësi, sinqeriteti në këtë gradë të plotë, edhe pse nuk realizohet për ata që nuk janë të plotësuar si eulijatë e të pastruarit, madje plotësimi i kësaj grade është prej veçantive të vulës së profetëve dhe zemrës dritë e të pastër të Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe, në origjinë, janë edhe prej veçantive të të plotësuarve e të pastërve të Ehli Bejtit të tij. Megjithëkëtë besimtarët dhe të sinqertët e pastër nuk duhet të jenë të shkujdesur ndaj gradëve të sinqeritetit dhe të kënaqen vetëm me sinqeritetin formal të punëve, ose në sinqeritetin e në thjeshtësinë e jashtme, të pastër të ligjit të fesë, sepse qëndrimi në njërin pozicion është prej kurtheve më të rrezikshme që shejtani ngre në rrugën e njeriut e të njerëzimit, me qëllim që t'i pengojë ata, me të gjitha mjetet e mënyrat, që njerëzit të mos ngjiten deri te plotësimet dhe të arrijnë te gradët.

Për të gjitha këto, mbetet detyrë të mbrohet e të forcohet vullneti, me shpresën se kjo dritë hyjnore dhe kjo butësi e amshueme do të shkojë nga e jashtnja në të brendshmen dhe prej mbretërisë në cilësitë. Kur njeriu hyn në kështjellën e të Vërtetit, te ai realizohet e vërteta e kërkimit të mbrojtjes prej pushtetit të shejtanit, të këtij xhindi të lig kryengritës, por njeriu duhet të dijë se pushteti i shejtanit mbi njeriun rrudhet në proporcion me gradën e sinqeritetit të tij.



Duke kërkuar mbrojtjen e Allahut, me këtë kërkesë ti e ke bërë formën e mbretërisë njerëzore të pastër, për hir të Allahut. Me këtë pastrim, ti i strehove ushtritë vetjake, të dukshme të kësaj bote, që janë fuqitë e shpërndara në mbretërinë e trupit, të gjitha këto ti i strehove në kështjellën e të Vërtetit dhe i pastrove shtatë rajonet e tokës, që janë: syri, veshi, gjuha, barku, organi gjenital, dora dhe këmba. Por, prej këtyre shtatë rajoneve dalin edhe mëkatet më të ndyra. Me këtë pastrim, të gjitha këto rajone ti i vure nën veprimin e engjëjve të Allahut, që janë ushtria hyjnore, për rrjedhojë këto rajone, dalëngadalë, bëhen hyjnore dhe fillojnë të lëvizin në ndjekje të pushtetit të të Vërtetit, deri sa, në vetvete, edhe ato, gjithashtu, bëhen prej engjëjve të Allahut, ose bëhen si engjëjt e Allahut, për të cilët Allahu i Lartësuar njofton: “لَا يَضُورُ اللَّهُ مَا أَمَرَهُمْ وَيَنْهَوْنَ مَا يُؤْمَرُونَ” - “...là jaësùne-llàhe mà emerehum ue jef'alùne mà juëmerùne” -“...nuk e kundërshtojnë Allahun në asgjë që Ai i urdhëron dhe bëjnë atë që janë urdhëruar të bëjnë”.<sup>1</sup>

Këtu realizohet grada e parë e kërkimit të mbrojtjes, për rrjedhojë, shejtani, me ushtritë e tij, menjëherë e braktisin mbretërinë e jashtme dhe drejtohen për në mbretërinë e brendshme, që të përballen me fuqitë shpirtërore. Pikërisht këtu bëhet edhe më i vështirë misioni i rrugëtarit për te Allahu, udhëtimi i tij bëhet shumë i ndjeshëm, prandaj mbi rrugëtarin mbetet detyrë, që të hedhë hapat me më shumë vendosmëri, të kontrollojë veten, në mënyrë sa më të plotë dhe të kërkojë mbrojtjen e Allahut prej punëve vetjake shkatërruese, siç janë: vetëpëlqimi, hipokrizia, mendjemadhësia, krekosja etj. Gjithashtu, ai, patjetër, duhet të

---

<sup>1</sup>Sure “Et Tahrim”, ajeti 6.





punojë dhe të merret me pastrimin e të brendshmes së tij prej turbullirave morale dhe prej ndyrësive.

Në këtë pozitë, madje në të gjitha pozitat, prej punëve të rëndësishme të rrugëtimit për te Allahu dhe prej punëve më të rëndësishme të lartësimit, është kujdesi për realizimin e asaj që quhet “teuhidi i punëve” dhe në këtë kujdes kërkohet t’i kujtohet zemrës kjo butësi e mëshirës hyjnore dhe kjo tryezë qiellore, të mësohet zemra të shijojë të vërtetën e mbretërimit të të Vërtetit të Lartësuar në qiej e në tokë, në brendësi e në të jashtmen, në fuqitë e në cilësitë. E gjitha kjo, me qëllim që zemra të mbetet plotësisht e kënaqur me besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, me hedhjen poshtë të idhujtarisë në veprimet dhe të mbruhet me majanë hyjnore e të edukohet me edukatën e (teuhijes), me edukatën e besimit se i Vërtetit është Zoti Një e i Vetëm. Në këtë gjendje, ai as nuk shikon e as nuk njeh frikësues e strehues të caktuar përveç të Vërtetit Fuqiplotë. Ai e kërkon dhe e gjen mbrojtjen vetëm te i Vërteti. Duke kërkuar mbrojtje në mënyrë të vullnetshme, ai gjen pozitë e pastërti hyjnore të vërtetë.

Përderisa zemra nuk del jashtë pushtetit të të tjerëve dhe, përderisa zemra dëshpërohet prej qenieve, njeriu me zemër të këtitllë, nuk numërohet se ka kërkuar strehim te i Vërteti, madje konsiderohet gënjeshtar në pretendimin e tij, madje te ata që kanë arritur gradën e njohjes, ai është mashtrues e kurthngritës dhe është në grupin e hipokritëve.

Në këtë luginë të thepisur e në këtë det të thellë, të mbushur me rreziqe, kërkimi i mbrojtjes me një të urtë hyjnor ose me një dijetar të ndriçuar me dritën hyjnore, puna e tij bashkohet me punën e eulijave të plotësuar, që të përfitojë prej diturisë së tij, në



kuptimin e tri teuhideve: një urdhër, me rol veprues në dhënien e ndihmës për të brendshmen e zemrës, me kusht që merakun me atë ndihmë të jetë ndërtuar mbi bazën e konsiderimit të asaj ndihme argument e shenjë, ecuri dhe rrugëtim për te Allahu, ndryshe, ato bëhen ferra në rrugë dhe një mbulesë për të mos parë fytyrën e të Përrjetshmit.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) këtë dituri e ka cilësuar se është “argument dallues”, ashtu siç ka ardhur në hadithin e nderuar të transmetuar në librin “El-Kâfi”.<sup>1</sup>

Si përmbledhje, kur në zemër forcohen rrënjët e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, në të gjitha punët që bën njeriu, është i vaditur me ujin e diturisë, krahas punës së mirë. Dy cilësi këto që trokasin në portën e zemrës, shumë shpejt, rezultat i këtij veprimi, është kujtimi i pozitës hyjnore të kësaj zemre të pastruar, në të cilën punët e bëra për hir të Allahut fillojnë të shkëlqejnë dalëngadalë. Kur shtëpia është pa grabitësin që kishte hyrë në atë shtëpi, kur shtëpia është pastruar nga prania e të huajit që kishte

---

<sup>1</sup>I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) hyri në xhami. Aty, një grup ishte mbledhur rreth një burri. Ai pyeti se cili ishte. Iu përgjigjën se ishte një dijetar i madh.

- Çfarë dijetari? - pyeti Profeti Muhamed.
- Është njeriu më i ditur për trungjet gjenealogjike të arabëve, - thanë ata, - dhe të ndodhive që kanë ngjarë mes fiseve arabe, gjatë kohës së injorancës, para Islamit dhe për poezitë e arabëve.
- *Kjo është një dituri, nga e cila as nuk i vjen dëm atij që nuk e njeh këtë dituri dhe as nuk i vjen ndonjë dobi atij që e di, - tha Profeti Muhamed. - Në të vërtetë, dituria është tri: argument dallues ose detyrim i formës së prerë, ose një rrugë që ndiqet, kurse të tjerat janë tepriçë.*

Lexo “Usûlul-Kâfi”, Libri “Mirësia e i diturisë”, K. “Cilësia dhe mirësia e diturisë dhe virtyti i dijetarëve”, Hadithi 1.



hyrë në të, atëherë pronari i kësaj shtëpie bëhet ushtrues i pushtetit në këtë shtëpi. Edhe kujdestaria e të Vërtetit Fuqiplotë bëhet mbizotëruese mbi fuqitë e brendshme e të jashtme të pronarit të shtëpisë, përfshirë edhe fuqitë e mbretërisë së zemrës dhe të të gjithë trupit, atëherë shejtanët dëbohen plotësisht dhe mbretëria e brendshme rikthehet në pavarësinë e saj, e përfaqësuar me qëndrimin nën pushtetin e të Vërtetit. Kjo është grada e dytë prej gradëve të kërkimit të mbrojtjes hyjnore.

Pas kësaj grade vjen kërkimi i mbrojtjes shpirtërore, kërkimi i mbrojtjes sekret dhe gradë të tjera të mbrojtjes. Studimi i këtyre gradëve del jashtë kuadrin të kësaj kumtese, madje shpresoj se ajo që kemi shkruar deri tani, në lidhje me këtë çështje, ishte e gjitha prej lëshimit të frerit të lapsit të këtij robi të varfër, ose prej rrjedhjes së lapsit të Kujdestarit të Gjithëfuqishëm, te i Cili kërkojmë strehim.

Gjithashtu, prej etikave dhe kushteve të kërkimit të mbrojtjes, është besimi për të cilin flet ajeti i nderuar, me të cilin hapëm këtë ndarje: “إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ” - “*in'nehù lejse lehù sultànun alel-l'ledhijne àmenù ue alà rab'bihim jetevek'kelùne*” - **“Në të vërtetë ai (shejtani) s’ka asnjë pushtet mbi ata që besojnë dhe janë mbështetur në Zotin e tyre”**.<sup>1</sup>

Besimi që tregohet në këtë ajet, nuk është dituria, edhe nëse besimi është arritur me argument, sepse “dërrasë është këmba e atyre që kërkojnë argumente”.<sup>2</sup> Shejtani, i përzënë prej mëshirës hyjnore, pavarësisht se ka shumë dituri për fillimin e krijimit dhe

<sup>1</sup>Sure “En Nahl”, ajeti 99.

<sup>2</sup>Përmbajtja e fillimit të vargjeve të një poezie, e dijetarit, poetit të njohur, Xheludin Rumi.



për ringjalljen, ashtu siç shprehet për këtë Kur'ani Famëlartë, numërohet prej grupit të mohuesve.

Sikur besimi të ishte një shprehje e kësaj diturie të argumentuar, dijetarët e kësaj fushe do të ishin jashtë pushtetit të shejtanit dhe në zemrat e tyre do të vezullonte drita e udhëzimit të Kur'anit. Por, ne shikojmë që këto shenja nuk arrihen me rrugën e besimit të argumentuar, prandaj mbi ne mbetet detyrë, që të dalim jashtë pushtetit të shejtanit dhe të hyjmë në kështjellën e të Vërtetit Fuqiplotë. Vetëkuptohet se kjo mbrojtje arrihet duke çuar të vërtetat e besimit në zemër, me qëllim që zemra të bëhet hyjnore dhe zemra bëhet hyjnore me rrugën e intensifikimit të ushtrimeve të zemrës, duke e orientuar vazhdimisht atë, duke kënduar frazat e caktuara të përmendjes së Allahut (virde) dhe me rrugën e meditimit në vetmi.

Kur zemra bëhet hyjnore, ai njeri del prej pushtetit të shejtanit. Për këtë, Allahu i Lartësuar njofton:

“**اللَّهُ وَرَى الدِّينِ ءَامَنُوا يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ**” - “*All'llàhu velij'ju-l'ledhijne àmenù jukhrìxhuhum mine-dh'dhulumàti ile-n'nùr...*” - “**Allahu është ndihmësi i atyre që besuan dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë...**”<sup>1</sup>

Kur te besimtarët bëhet sundues i Vërteti Fuqiplotë, atëherë është Ai që e drejton të jashtmen e të brendshmen e tyre, të fshehtën e tyre dhe ato që i bëjnë sheshit. Në këtë gjendje, këta njerëz kanë dalë jashtë pushtetit të shejtanit dhe kanë hyrë nën pushtetin e Mëshirëplotit. Në këtë gjendje, Allahu i Lartësuar është garantues

---

<sup>1</sup>Sure “ El Bekare “, ajeti 257.



për t'i nxjerrë ata jashtë të gjitha shkallëve të errësirave dhe i drejton drejt dritës absolute. Ai i nxjerr ata prej errësirës së mëkatit, rebelimit, errësirave të sjelljeve të ulëta, prej errësirës së injorancës, mohimit, idhujtarisë, vetëpëlqimit, egoizmit e kënaqjes me vetveten dhe i drejton kah moralet e lavdëruara, i drejton kah drita e bindjes, adhurimit e diturisë; i drejton kah besimi i plotësuar; i drejton kah besimi i plotë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe kah dëshira për të përfunduar te Allahu.

Edukatë tjetër e kërkimit të mbrojtjes është mbështetja te Allahu i Lartësuar (Ef' tevek' kul). Mbështetja, gjithashtu, është prej degëve të besimit dhe prej dritave të mëshirës së vërtetë të besimit. Në të njëjtën kohë, mbështetja shpreh delegimin e punëve Allahut të Lartësuar dhe, me këtë kalohet prej besimit të zemrës në teuhidin e punëve.

Shkoqitja e kësaj çështjeje del jashtë kuadrin të këtij studimi.

Kur rrugëtari për te Allahu shikon se për të s'ka vendstrehim tjetër përvese te i Vërteti Fuqiplotë, ai e kupton se veprimi me punët është i kufizuar brenda kësaj pastërtie. Në zemrën e tij del në shesh gjendja e përfundimit, strehimit dhe mbështetja vetëm te i Vërteti Fuqiplotë. Edhe kërkimi i mbrojtjes vishet me rrobën e të vërtetës dhe, kur kërkimi i mbrojtjes bëhet me kështjellën hyjnore, kështjellën mbrojtëse të vërtetë, atëherë i Vërteti Fuqiplotë e mbron atë, e rrethon me mirësitë e Tij të mëdha dhe me mëshirën e Tij bujare. Padyshim Ai është Zotëruesi i mirësisë më të madhe.



## Plotësim e rezultat

Nga sa u tha në këtë ndarje, bëhet e qartë se kërkimi i mbrojtjes në të vërtetën e saj është një mënyrë e një gjendje shpirtërore, që arrihet si rezultat i diturisë së argumentuar e të plotë në pozitën e besimit, se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm në punët dhe prej besimit në këtë pozitë.

Domethënë, sapo njeriu arrin të kuptojë, me anën rrugës së mendjes së ndriçuar me argumente të fuqishme e të dëshmime njoftuese, të nxjerra prej teksteve kur'anore dhe prej thënieve e fjalëve kuptimplota, të shpërndara në Librin hyjnor dhe në hadithet e nderuara, sapo ai të kuptojë se pushteti e fuqia krijuese dhe pavarësia në ndikim, madje vetë origjina e ndikimit, i takojnë vetëm Qenies së pastër hyjnore dhe në këto punë s'ka fare pjesë asnjëra prej qenieve, siç e pamë edhe më sipër, atëherë ai ka për detyrë të ngutshme të informojë zemrën e vet për këtë të vërtetë dhe me lapsin e logjikës të shkruajë mbi sipërfaqen e zemrës të vërtetën e frazës: "S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe në të gjithë botën e ekzistencës s'ka ndikues tjetër përveç Allahut!"

Sapo zemra të besojë në këtë frazë të këndshme kuptimplote dhe në këtë të vërtetë të argumentuar, te ai njeri arrihet gjendja e kërkimit të përfundimit dhe strehimit. Më pas, ai e kupton se shejtani është ai që i zë rrugën njerëzimit dhe është armiku më i egër për njerëzimin, ndryshe te ai nuk arrihet gjendja e "domosdoshmërisë". Pikërisht kjo gjendje e zemrës është e vërteta e kërkimit të mbrojtjes.



Më sipër u shpjegua se gjuha është përkthyesi i zemrës. Në këtë gjendje të zemrës dhe me të gjithë nevojën e ngutshme e të madhe, gjuha shqipton me sinqeritet frazën: “أعوذ بالله من الشيطان الرجيم” - “*eûdu bil'lâhi mine-sh'shejtâni-rr'rrexhijm*” - **“i lutem Allahut të më mbrojë prej shejtanit të dëbuar”**.

Por, nëse në zemrën e njeriut, këto të vërteta s'kanë ndikim, atëherë në zemrën e atij njeriu dhe në të gjithë mbretërinë e trupit të tij bëhet veprues shejtani. Gjithashtu, edhe kërkimi i mbrojtjes është i mbështetur në pushtetin e shejtanit e me sistemin e tij. Në këtë gjendje, njeriu e kërkon mbrojtjen vetëm me gjuhën e tij, sepse, në të vërtetë, ai është nën pushtetin e shejtanit. Kjo do të thotë se njeriu, në këtë gjendje, në fakt, i kërkon djallit ta mbrojë atë prej Allahut. Për rrjedhojë, mbrojtja realizohet në të kundërtën e saj dhe shejtani fillon të tallet me këtë person që kërkon mbrojtje. Është e qartë se kjo tallje e shejtanit do të dalë sheshit ditën kur do të hiqen kapakët, ditën në të cilën do të asgjësohen mbulesat e perdet e natyrës.



## Ndarja e tretë

### KOLONATE KËRKIMIT TË MBROJTJES (EL-ISTIADHEH)

Kërkimi i mbrojtjes ka katër kolona kryesore: kërkuesi i mbrojtjes (elmusteijdhu), personi prej të cilit kërkohet mbrojtje (elmusteàdhu minhu), atij që i kërkohet mbrojtja (elmusteàdhu bihi) dhe qëllimi i kërkimit të mbrojtjes (elmusteàdhu liexhlihi).

Mëso se kjo çështje është shumë e gjerë dhe me degëzime, mbase do të dalim jashtë kufijve që kemi vënë në këtë kumtesë, nëse do të flasim rreth ndarjeve të ndryshme të kësaj çështjeje, prandaj do të mjaftohemi ta trajtojmë çështjen shkurtimisht.

#### *1- Kërkuesi i mbrojtjes (emusteijdhu)*

Kjo është e vërteta njerëzore, që fillon me vendin e parë të rrugëtimit për te Allahu deri sa përfundon në asgjësimin vetjak (vdekje). Kur plotësohet asgjësimi absolut, atëherë shejtani shkatërrohet dhe realizohet kërkimi i mbrojtjes.

Për ta bërë të qartë këtë, themi: Për aq kohë sa njeriu qëndron në shtëpinë e vetes dhe të natyrës, ai nuk e ka filluar akoma udhëtimin shpirtëror dhe rrugëtimin për te Allahu; për aq kohë sa njeriu është i nënshtruar ndaj pushtetit të shejtanit, me të gjitha punët e shkallët e pushtetit të shejtanit, ai vazhdon të jetë i paveshur





me të vërtetën e kërkimit të mbrojtjes dhe prej lakimeve të gjuhës së tij nuk mund të shpresohet asnjë dobi, përveç forcimit e rrënjësjes së pushtetit të shejtanit, me përjashtim të rastit kur njeriun e përfshijnë butësitë e mëshirës dhe dhuntitë hyjnore.

Kur njeriu përgatitet për rrugëtimin për te Allahu, sapo ai fillon këtë udhëtim, atij i zë rrugën shejtani i tij, qoftë ky shejtan prej fuqive të shpirtit djallëzor, qoftë prej xhindeve, qoftë prej njerëzve. Duhet të theksojmë se as xhindet e as njerëzit nuk bëhen pengesë e nuk e zënë rrugën për te Allahu, nëse nuk janë të shtyrë prej shejtanit, ose nuk veprojnë si rezultat i pushtetit të shejtanit mbi ta. Ky kuptim tregohet qartë në suren e bekuar “En Nàs”, ku Allahu i Lartësuar thotë:

“...min sherr'rril-vesvâsil-khan'naâsi. El'ledhij juvesvisu fij sudûri-n'nâsi. Minel-xhind'neti uen'nâsi” -“i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!”<sup>1</sup>

Prej këtyre ajeteve të nderuara mësohet se, kur shejtani është prej xhindeve, atëherë cytësi që fshihet, është vetë shejtani, xhind në origjinë dhe njeri, nëse ndjek shejtanin, por, kur shejtani është i një natyre tjetër, i ngjashëm me xhindet, prej këtyre ajeteve mësohet se dy llojet e shejtanëve, shejtani xhind dhe shejtani njeri, në të vërtetë, janë dukuri që përfaqësojnë djallëzinë. Për këtë kuptim tregohet edhe në fjalën tjetër të Allahut të Lartësuar: “شَيَاطِينِ الْإِنْسِ وَالْجِنِّ”

<sup>1</sup>Sure “En Nàs”, ajetet 4-6.



- "...shejàtijnul-insi uelxhind'ni..." - "armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve".<sup>1</sup>

Surja "En Nàs" tregon qartë për kolonat e kërkimit të mbrojtjes që ne paraqitëm në fillim të kësaj bisede.

Gjithsesi, njeriu nuk është se kërkon mbrojtjen në dy gjendje: *e para*, para se ai të fillojë rrugëtimin dhe ecjen për te Allahu dhe, *e dyta*, pasi ai e plotëson ecjen e tij, kur shuhen plotësisht shenjat e robërisë dhe njeriu triumfon në shuarjen **vetjake** absolute, atëherë kurrë nuk do të mbetet shenjë as për kërkimin e mbrojtjes dhe as për personin prej të cilit kërkohet mbrojtje, sepse zemra e njohësit do të jetë e zbrazur plotësisht prej çdo gjëje tjetër, përveç të Vërtetit dhe pushtetit hyjnor, madje vetë njohësi në këtë pozitë bëhet i atillë që nuk ka dijeni për gjendjen e zemrës e të vetes së tij. Pikërisht këtu fshihet edhe kuptimi i frazës: "kërkoj mbrojtje me Ty prej Teje".

Më pas, sapo të arrihet gjendja e zgjimit, prehja dhe kthimi, atëherë kërkimi i mbrojtjes kthehet për t'u ribërë e vërtetë, por kësaj here, kërkimi i mbrojtjes ndryshon nga kërkimi i mbrojtjes së rrugëtarit për te Allahu, për të cilin ka urdhëruar i Dërguari i fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ky është kërkimi i fundit i mbrojtjes, ashtu siç njofton Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij: "قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْقَلْقُ" - "Kul eùdhu birab'bil-feleki" - "**Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit**"<sup>2</sup>; "قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْكَائِبِ" - "Kul eùdhu birab'bin'nàsi" - "**Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve**"<sup>3</sup>;

---

<sup>1</sup>Sure "El En'àm", ajeti 112.

<sup>2</sup>Sure "El Felek", ajeti 1.

<sup>3</sup>Sure "En Nàs", ajeti 1.



“ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ وَقُلْ رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ ” - “*Ue kul rab'bi eùdhu bike min hemezàti-sh'shejàtijni. Ue eùdhu bike rab'bi en jahdurùni*” -**“Dhe thuaj: ‘O Zoti im, kërkuj të më mbrosh nga nxitjet e djajve, dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos i kem pranë meje”**”<sup>1</sup>

Atëherë njeriu nuk kërkon mbrojtje në dy pozita: *e para*, para fillimit të rrugëtimit, kur ai është në gjendjen e mbulimit, gjendje, në të cilën njeriu ndodhet nën veprimin e shejtanit e nën pushtetin e tij; *e dyta*, pas plotësimit të rrugëtimit, kur është arritur shuarja absolute dhe është shuar kërkuesi i mbrojtjes, personi prej të cilit kërkohet mbrojtje, vetë kërkimi i mbrojtjes dhe qëllimi për të cilin kërkohet mbrojtja.

Domethënë, njeriu kërkon mbrojtje në dy pozita: *e para*, gjatë rrugëtimit për te Allahu. Në këtë pozitë, ai kërkon mbrojtjen e Tij prej atyre që i kanë zënë rrugën e drejtë të njerëzimit. Këta rrugëzënës përfaqësojnë ferrat që ndalojnë arritjen dhe shejtanin, i cili përmendet në tekstin e Kur'anit: “فَبِمَا أُعُوذْتَنِي لِأَقْفَعَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ” -**“...febimà abvejtenij leak'uden'ne lehum siràtakel-mustekijme”** -**“Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë”**”<sup>2</sup>

## 2- Ai prej të cilit kërkohet mbrojtje

Ai është Iblisi, shejtani i përzënë, i cili përfiton prej kurtheve që ngre e prej rrjetave që enden, me të cilat hyn mes njeriut e qëllimit të tij. Shejtani punon që njeriu të mos e arrijë qëllimin që ka. Unë besoj në atë që kanë thënë disa prej krerëve të atyre që kanë arritur gradën e njohjes: “E vërteta e shejtanit është interpretimi, se

<sup>1</sup>Sure “El Muminùn”, ajetet 97-98.

<sup>2</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 16.



të gjitha anët e botës janë të këqija”. Ky është një përkufizim jo i plotë, sepse ana e të keqes është figura iluzionare, pa asnjë të vërtetë dhe e zhveshur prej studimit të realitetit, është litari i Iblisit, për të cilat merakoset njeriu dhe Allahu i Lartësuar thotë:

“أَلْهَامُ الْكَافِرِ حَتَّىٰ زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ” - “*Elhàkumu-t’tekàthuru. Hat’tà zurtumul-mekàbire*”  
-“**Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar, derisa të shkoni në varre**”.<sup>1</sup>

Ky ajet e tregon këtë kuptim, në një kohë që vetë Iblisi është një e vërtetë. Kjo e vërtetë që merret si shembull, është vetë Iblisi dhe të gjithë iblisët, është kreu i të gjithë Iblisëve, plotësisht ashtu siç është e vërteta e mendjes në tërësinë e saj, që në fakt, është Ademi i parë. Në këtë këndvështrim është e gjithë mendja.

Gjithashtu, edhe të gjitha format iluzionare dytësore të cilësive, janë prej punëve e prej dukurive të mendjes së përgjithshme. Shkoqitja e hollësishme e kësaj çështjeje del jashtë kuadrin të kësaj kumtese.

Në përgjithësi, ndarësi në këtë udhëtim hyjnor, pusizënësi në rrugën për te Allahu dhe ferra në këtë rrugë, është shejtani, ose dukuritë e shejtanit dhe përfaqësitë e tij, por edhe roli i të gjitha këtyre përsëri është rol i shejtanit.

Gjithçka që është prej botës së padukshme e prej botës së dukshme dhe çdo pengesë që krijohet para njeriut, si dhe të gjitha gjendjet në të cilat kalon njeriu, të gjitha janë një mbulesë për të mos e parë të Përrjetshmin, qoftë kjo mbulesë prej botëve të dukurive të kësaj bote, si: varfëria, pasuria, shëndeti, sëmundja, fuqia, pafuqia, dituria, injoranca, lëngimet, gjendjet e rënduara etj, ose është prej botëve të panjohura, të zhveshura, si: Xheneti, zjarri, dituria në

---

<sup>1</sup>Sure “Et Tekàthur”, ajetet 1-2.



lidhje me Xhenetin e zjarrin, deri në arritjen e diturive logjike, të argumentuara, që kanë lidhje me besimin se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm, si dhe me dëlirjen e Tij prej nevojave e mangësive. Të gjitha këto janë prej rrjetave të Iblisit, që e shqetësojnë njeriun dhe i zënë atij rrugën, që të mos arrijë te i Vërteti, te kënaqësia dhe qëndrimi në vetmi me Atë. Jo vetëm kaq, por edhe shqetësimi për pozitën morale dhe ndalimi në një nga gradët shpirtërore, e jashtëmja e të cilave përfaqëson ndalimin në rrugën e njerëzores, kurse e brendshmja e saj përfaqëson qëndrimin në rrugën e të Vërtetit, që është një interpretim i urës së hedhur mbi Xhehenemim dhe ndarjen e largësinë shpirtërore, që është një urë e veçantë për një pakicë prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe zotërimin e zemrës, urë që përfundon në Xhenetin e takimit. Të gjitha këto janë prej litarëve që ka nder Iblisi i Iblisëve të mëdhenj, prej të cilëve duhet të kërkohet mbrojtja me Qenien e pastër të të Vërtetit Fuqiplotë.

Në përgjithësi, gjithçka që të pengon e të ndan prej të Vërtetit Fuqiplotë dhe të mbulon ty, që të mos shikosh bukurinë më të bukur të të Dashurit të Madhëruar, është shejtani yt, qoftë ky shejtani me fytyrë njeriu, qoftë me fytyrë xhindi. Gjithashtu, çdo send e çdo gjë që numërohet mjet për të të zënë ty rrugën në arritjen e këtij qëllimi e të objektivit që do të arrish, përsëri, të gjitha këto janë prej rrjetave të shejtanit, nëse kjo është prej pozitave, gradëve, diturive, plotësimeve, mjeshtërive, industrive, lodrave, pushimit, vështirësisë, poshtërimit e të tjera forma që ato kanë marrë.

Të gjitha këto që shpjegojnë këtë botë të ulët, janë kurthi i shejtanit, janë punë prej të cilave është detyrë të kërkohet mbrojtje. Mbase ky është edhe qëllimi i fjalës së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*):



«أعوذ بوجه الله الكريم وبكلمات الله التي لا يجاوزهن بر ولا فاجر من شرّ ما ينزل من السماء وما يعرج فيها، وشرّ ما ينزل من الأرض وما يخرج منها، ومن شرّ فتن الليل والنهار، ومن شرّ طوارق الليل والنهار الا طارقا يطرق بخير»

*“Eùdhu bivexh’hi-l’làhil-kerijm ue bikelimàti-l’làhi-l’letij là juxhàvizuhun’ne birr’rrun ue là fâxhirun min sherr’rri mà jenzilu mine-s’semài ue mà jaëruxhu fjhà; ue sherr’rri mà jenzilu minel-erdi ue mà jakhruxhu minhà, ue min sherr’rri fiteni-l’lejli uen’nehàri, ue min sherr’rri tavàriki-l’lejli uen’nehàri il’là tàrikan jatruku bikhajrin” - “Kërkoj mbrojtje me fytyrën e Allahut, Bujarit dhe me fjalët e Allahut, të cilat nuk i tejkalon dot as i miri e as mëkatari; kërkoj mbrojtje prej të keqes së asaj që zbret prej qiellit dhe prej asaj që ngjitet lart në qiell, prej të keqes së asaj që zbret mbi tokë dhe të asaj të del prej tokës; prej të keqes së ngatërresave të natës e të ditës dhe prej të keqes së vizitorëve të natës e të ditës, përveç një vizitori që troket për të mirë”<sup>1</sup>.*

Kërkimi i mbrojtjes me “fytyrën e Allahut” dhe me “fjalët e Allahut”, është zhytje në detin e bukurisë e të madhështisë. Nëse ka diçka që e pengon njeriun prej kësaj bukurie e prej kësaj madhështie, ato janë të këqijat që kanë lidhje me botën e shejtanit e me kurthet e tij. Prandaj është detyrë të kërkohet mbrojtje me fytyrën e Allahut, që të na ruajë prej kurtheve të shejtanit, nëse kjo është prej të vërtetave të plota qiellore, ose prej të vërtetave të mangësive tokësore, me përjashtim të rastit, kur vizitori troket për të mirë. Në këtë gjendje, ai patjetër duhet të jetë vizitor hyjnor, sepse ky vizitor bën thirrje për të mirën absolute. Ky vizitor është vetë i Vërteti i Lartësuar.

---

<sup>1</sup>Bihàrul Enuàr”, vëll. 91, f. 215.



3- *Atij që i kërkohet mbrojtja (elmusteàdhu bihi)*

Ky kërkim mbrojtje, në të vërtetë, është si kërkimi i mbrojtjes në përgjithësi dhe realizohet te rrugëtari për te Allahu. Arrihet gjatë ecjes për te i Vërteti, në kuptimin se kërkimi i mbrojtjes është i veçantë për rrugëtarin në gradët e rrugëtimit.

Atëherë, e vërteta e kërkimit të mbrojtjes, kërkuesit të mbrojtjes, personit prej të cilit kërkohet mbrojtje dhe Atij që i kërkohet mbrojtja (elmusteàdhu bihi) ndryshojnë në varësi të pozitive e gradëve të udhëtarëve dhe në varësi të shkallëve e të pozicioneve të rrugëtarëve. Mbase në fjalën e Allahut të Lartësuar: “إِلَهِ النَّاسِ. مَلِكِ النَّاسِ خُلُوعُودُ يَرْبِ النَّاسِ” - “Kul eùdhu birab’bi-n’nàsi. Meliki-n’nàs. Ilàhi-n’nàs” - “**Thuj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve**”<sup>1</sup>, tregohet për këtë kuptim, domethënë, tregohet për kërkimin e mbrojtjes në pozitën e Zotit krijues, duke filluar me nisjen e rrugëtimit dhe duke përfunduar me kufijtë e pozitës së zemrës. Kjo natyrë krijuese hyjnore, për të cilën bëhet fjalë në fillim të sures, ka mundësi të jetë natyra krijuese hyjnore e punëve, koha e të cilave përputhet me: “أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَاتِ” - “Eùdhu bikelimàti-l’lâhi-t’tàm’màti” - “Kërkoj mbrojtje me fjalët e plota të Allahut”.<sup>2</sup>

Kur ecja e rrugëtarit arrin pozitën e zemrës, patjetër që pozita e pushtetit hyjnor shumë shpjet do të shfaqet në zemrën e tij. Pikërisht, në këtë kohë, ai kërkon mbrojtje me pozitën e “Sunduesit të njerëzve”, kërkon mbrojtje nga e keqja e Iblisit, në veprimet e zemrës dhe kërkon mbrojtje prej pushtetit veprues të Iblisit, në

<sup>1</sup>Sure “En Nàs”, ajetet 1-3.

<sup>2</sup>Lutja e ditës së parë të muajit rexheb; lexo “Ikbàlul-Amàli” i autorit Es’sej’jid bin Tàùs, f. 640.



brendësinë e tij. Ky kërkim mbrojtje është i ngjashëm me kërkimin e mbrojtjes në pozitën e parë prej të keqes së Iblisit, në veprimet e zemrës. Ka mundësi që fjala e Allahut të Lartësuar:

“الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ” *“El’ledhij juvesvisu fij sudùri-n’nàs”* - **“që hedh dyshime në gjokset e njerëzve”**<sup>1</sup>, ka të bëjë në veçanti me cytjet e hedhura në zemër dhe me cytësin e fshehur, megjithëse edhe cytja që bie në zemër e në shpirt, gjithashtu është prej cytësit të fshehur, prandaj ky përkufizim, në përgjithësi, edhe nga ana e cilësisë së jashtme, është në përshtatje me të gjithë.

Kur rrugëtari e kapërcen pozitën e zemrës dhe kalon në pozitën e shpirtit, kjo pozitë është prej frymës hyjnore, prandaj edhe lidhja në këtë pozitë me të Vërtetin është më e fuqishme se lidhja e rrezeve të diellit me vetë diellin. Më pas, në këtë pozitë fillon të shfaqet hutimi, dashuria e dalldisur, tërheqja, dashuria e zjarrtë dhe dëshira. Pikërisht këtu, kërkimi i mbrojtjes, nga ana e rrugëtarit, do të jetë në pozitën e “إله الناس” - *“Ilàhi-n’nàs”* - **“të Adhuruarit të njerëzve”** dhe, kur ai ngrihet mbi këtë pozitë, atëherë do të shohë veten, pa pasqyrën e punëve, në kuptimin se ka arritur pozitën e fshehtë, në të cilën ai është bërë i përshtatshëm për “أعوذ بك منك” - *“Eùdhu bike minke”* - *“Kërkoj mbrojtje me Ty prej Teje”*.<sup>2</sup> Në këto pozita, ka shkoqitje dhe, nëse do të futeshim në to, patjetër që do të na nxirrin jashtë kuadrit të kësaj kumtese.

Por ti duhet të mësosh, se kërkimi i mbrojtjes me emrin “Allah” është në përshtatje me të gjitha pozitat, për shkak se emri “Allah” është gjithëpërfshirës dhe kërkimi i mbrojtjes me këtë emër

---

<sup>1</sup>Sure “En Nàs”, ajeti 5.

<sup>2</sup>Lexo anësoren 2, f. 232.





është kërkim mbrojtje absolute, në një kohë që kërkimi i mbrojtjes me fjalë të tjera, është i kushtëzuar.

#### 4- Qëllimi i kërkimit të mbrojtjes (elmusteàdhu liexhlihi)

Mëso se ajo që kërkohet prej njeriut, kur ai kërkon mbrojtje, është forcimi e lartësimi i plotësimit, lumturisë e mirësisë. Por kjo kërkesë ndryshon shumë sipas ndryshimit të gradëve të rrugëtarëve dhe të pozitave të tyre.

Për aq kohë që rrugëtari për te Allahu vazhdon të jetë i mbyllur në shtëpinë e vetvetes dhe është nën mbulesën e natyrës, qëllimi më i lartë i udhëtimit të tij është: të arrijë plotësimet **vetjake** dhe lumturitë natyrale të ulëta e pa vlerë. Kjo është gjendja në fillimin e rrugëtimit, por, sapo ai del prej shtëpisë së vetvetes dhe shijon diçka prej pozitave shpirtërore e plotësimeve të zhveshura nga gjërat materiale, ato bëhen qëllimi i tij më i lartë dhe objektivi i tij më i plotësuar. Në këtë gjendje, ai menjëherë i kthen shpinën pozitave **vetjake**, zemra e tij uron, qëllimi i tij bëhet arritja e plotësimeve të zemrës dhe e lumturive të brendshme.

Më pas, rrugëtari e shpejton ecjen duke u lartësuar prej kësaj pozite dhe arrin në pozicionin e sekretit të shpirtit, për rrjedhojë, në të brendshmen e tij shfaqen fillimet e shkëlqimeve hyjnore dhe pas kësaj vjen “e kam kthyer fytyrën time për emrat e Allahut ose për Allahun”, pastaj “e kam kthyer fytyrën time për Atë”. Fjala e Allahut të Lartësuar: “وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ” - “...vexh'xhehtu vexh'hij lil'ledhij fetare - s'semàvàti uel-erda...” - “Unë e kthej fytyrën



**time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”<sup>1</sup>, është e posaçme me pozitën e parë dhe kjo si rezultat i “i cilësisë së pastër të krijimit”.**

Në të gjitha gjendjet, qëllimi më i lartë i rrugëtarit, në çdo pozitë, është arritja e vetë plotësimit dhe lumturisë. Por, kur lumturia e plotësimet, në çdo pozitë, janë të shoqëruara nga një shejtan i ngjashëm, ose me një kurth prej kurtheve të shejtanit, kjo bën që të mos realizohen as lumturia e as plotësimet, prandaj rrugëtari që synon të arrijë qëllimin e tij origjinal dhe kërkesën e tij personale, patjetër duhet të kërkojë mbrojtjen e të Vërtetit Fuqiplotë prej shejtanit, prej ligësive të shejtanit dhe prej litarëve të tij.

Atëherë, qëllimi më i lartë me kërkimin e mbrojtjes, në raport me rrugëtarin, është: arritja e plotësimit të mundshëm dhe e lumturisë së kërkuar, kurse qëllimi i qëllimeve më të larta dhe i kërkesave më të largëta, është: i Vërteti i Lartësuar. Në ndjekje të këtij qëllimi të lartë mbetet kërkimi i mbrojtjes prej shejtanit. Fillim e mbarim, falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun.

---

<sup>1</sup>Sure “El En’àm”, ajeti 79.



## Ndarja e katërt

### ETIKA E FJALËS “BISMIL’LÀHI” (ET’TESMIJETU)

Kur Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për interpretimin e fjalës “besmeleh”, është përgjigjur: *“Fjala e atij që thotë emrin e Allahut “bismil’lâhi”, domethënë: unë shënoj veten me njërën prej shenjave dalluese të Allahut dhe kjo vënie shenje është adhurim”*.

- Si është kjo shenjë dalluese? - e pyeti përcjellësi i transmetimit.
- *Shenjë*, - u përgjigj Imam Rizai.<sup>1</sup>

Allahu të bëftë ty dhe ne prej të cilësuarve me shenjat dalluese të Allahut! Mëso, se për të hyrë në pozicionin e “et’tesmijes” – “bismil’lâhi”, për rrugëtarin bëhet e lehtë vetëm pas hyrjes në pozicionin e “istiadheh – “kërkimit të mbrojtjes dhe marrjes së pjesës së tij prej këtij pozicioni”. Por, deri sa njeriu është i ndrydhur nën pushtetin e shejtanit dhe është nën veprimin e shejtanit të tij, ai është i damkosur me shenjat dalluese të shejtanit. Kur shejtani sundon plotësisht të brendshmen e të jashtmen e njeriut, ai bën për njeriun një shenjë dalluese në të gjitha gradët, prandaj edhe kur njeriu, në këtë pozitë, thotë “bismil’lâh”, përsëri njeriu flet me fuqinë e ardhur prej shejtanit dhe me gjuhën e

---

<sup>1</sup>“Et’Teuhid”, K. 31, Hadithi 1, f. 229; “Meâniy-El-akbâr”, f. 3.



shejtanit, për rrjedhojë edhe kërkimi i mbrojtjes dhe shqiptimi i fjalës “bismil’läh” – “me emrin e Allahut”, nga ana e këtij njeriu nuk jep asnjë fryt përveç forcimit të pushtetit të shejtanit.

Por, kur njeriu, me mirësinë hyjnore, zgjohej prej gjumit të shkujdesjes dhe për të bëhet realitet gjendja e “zgjimit”, atëherë ai e kupton domosdoshmërinë e udhëtimit e të rrugëtimit për te Allahu në pozicionin e zgjimit, me dritën e cilësisë së pastër hyjnore të krijimit, me dritat e mësimëve kur’anore dhe me orientimet e udhëzuesve në rrugën e besimit se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm. Në këtë gjendje, zemra e tij i mëson e i njeh pengesat gjatë ecjes, atëherë te ai, dalëngadalë, arrihet gjendja e kërkimit të mbrojtjes. Pas kësaj, me mbarësinë hyjnore, ai hyn në pozicionin e kërkimit të mbrojtjes.

Më pas, sapo njeriu pastrohet prej ndyrësive të shejtanit, në pasqyrën e zemrës së tij shkëlqejnë dritat hyjnore, në përputhje me masën e pastrimit të brendshëm e të jashtëm prej ndyrësive të shejtanit, duke theksuar se ato drita, në fillim, ishin të turbulluara nga errësitat, madje ka mundësi që këto errësira, të jenë vetë shejtani, ashtu siç njofton për këtë ajeti nderuar i Kur’anit Famëlartë: “خَطُّوا عَمَلًا صَالِحًا وَاحْتَرِ سَيِّئًا” - “...khaletù amelen sàlihan ue àkhare sej’ji’en...” - “...ata përziën një punë të mirë me një tjetër të keqe...”<sup>1</sup> Por puna e mirë fuqizohet më shumë, sa herë fuqizohet rrugëtimi dhe dalin sipër errësirës. Në këtë gjendje, dalëngadalë, mbi rrugëtarin fillojnë të dalin sheshit shenjzat e hyjnores dhe fjala e tij “bismil’läh” – “me emrin e Allahut” fiton një të vërtetë, deri në atë kufi sa, në mbretërinë e brendshme e të jashtme të rrugëtarit, nuk mbetet e panjohur asgjë prej shenjave të shejtanit, të

---

<sup>1</sup> Sure “Et Teube”, ajeti 102.



përfaqësuar nga jashtë me prishjen e sistemeve të qytetit të virtyteve dhe nga brenda me vetëpëlqimin, mendjemadhësinë dhe të ngjashme me këto dy të fundit dhe, në brendësi të brendësisë, me egoizmin e me dashurinë për veten e me të ngjashme të tjera si këto. Në këtë gjendje, vendin e këtyre veseve e zënë shenjat e Allahut, të përfaqësuar, nga ana e jashtme, me ruajtjen e sistemit të qytetit të virtyteve dhe, në brendësi, përfaqësohen me robërinë dhe me uljen e vetes, kurse në brendësi të brendësisë, përfaqësohen me shenjën e besimit në Zotin krijues dhe në urtësinë e Tij.

Kur mbretëria e trupit të rrugëtarit bëhet hyjnore dhe është zbrazur plotësisht prej shejtanëve xhind e njerëz, në mbretërinë e tij shfaqen shenjat hyjnore dhe rrugëtari realizon për veten e tij pozitën e “përshtatshmërisë”.

Atëherë “bismil’lâhi” - “me emrin e Allahut”, që thotë rrugëtari, është fillimi që shpreh përshkrimin me shenjat dalluese hyjnore. Kur rrugëtari lartësohet mbi këtë shkallë, ai arrin në pozitën e “përshtatshmërisë”. Pikërisht kjo shkallë është pararoja “afër karvanit” dhe më pas, kur ai e realizon afrimin te karvani, atëherë ai ka fituar plotësisht “përshtatshmërinë”, në atë mënyrë që është shuar çdo ndikim prej robit dhe robërisë. Ai që arrin deri në këtë pozitë, namazi i tij, me tërësinë e tij, është me gjuhën e Allahut. Kjo punë realizohet vetëm për një grup të vogël eulijash, kurse për mesatarët dhe të ngjashmit me ne, që jemi me mangësi, patjetër që, kur themi “bismil’lâh” - “me emrin e Allahut”, edukata e kësaj fale të lartë do të jetë puna për të gdhendur shenjën e robërisë e dukuritë e robërisë mbi zemrën, si dhe mësimi i zemrës për shenjat e argumentet hyjnore, që ajo të mos mjaftohet vetëm me lakimet e gjuhës, duke shpresuar se kjo do ta çojë në përfshirjen e të gjithave, përfshirë edhe veten tonë në mëshirën hyjnore, të ndreqim të



kaluarat dhe të shtrojmë për zemrat tona rrugën e drejtë të mësimin të emrave dhe hapjen e një rruge drejt qëllimit.

Por, qëllimi me “një shenjë prej shenjave të Allahut”, që përmendet në hadithin e mësipërm, ka mundësi të jetë shenjë dalluese e mëshirës “gjithëpërfshirëse” dhe “mëshira e plotë”.

Në përgjithësi, rrugëtari që synon të bëhet realitet “bismil’lâhi” i tij, ka për detyrë t’i bëjë të njohur zemrës së tij format e mëshirës së të Vërtetit dhe të realizohet mëshira “gjithëpërfshirëse” dhe mëshira e “plotë”.

Shenja dalluese se në zemër ka arritur një thëngjill i ndezur për kësaj mëshire, është dalja në shesh e shikimit mbi robtë e Allahut me syrin e mëshirës, shoqërimit, kërkimit të së mirës dhe përmirësimin për të gjithë. Ky është shikimi i profetëve të mëdhenj dhe i eulijave të plotësuar. Qëllimi më i lartë në këtë punë është se ata shikojnë në dy punë: nga njëra anë, shikojnë në lumturinë e shoqërisë, në sistemin familjar dhe në sistemin e qytetit të virtytshëm, kurse, nga ana tjetër, shikojnë në lumturinë e individit. Por ata dëshirojnë t’i realizojnë të dyja lumturitë, në mënyrë të plotë, prandaj ligjet hyjnore, tanimë të rrënjësura, të praktikuar, të përcaktuara dhe të zbatuara me duart e profetëve, të cilët kanë kujdesin më të madh për t’i ruajtur këto dy lumturi dhe për këtë nuk ngurrojnë të zbatohen edhe vendimet për ekzekutim kapital apo për ndëshkime trupore, përfshirë edhe diskreditimet e të ngjashme masa të tjera edukuese. Të gjitha këto janë vënë me qëllimin e vetëm, për t’i prerë rrugën ngatërresave dhe për të ruajtur sistemin e qytetit të virtytshëm, gjithashtu, me synimin për realizimin e këtyre dy lloje lumturish. Në shumicën e rasteve, punë të tilla kanë një ndikim shumë veprues në përmirësimin e fajtorit



dhe çuarjen e tij drejt lumturisë, deri sa nuk ka kaluar në krimin e vrasjes, krim që e bën kriminelin të humbë dritën e besimit e të lumturisë dhe kjo, - sipas dispozitës së luftës në rrugën e Allahut dhe të ngjashme me këtë luftë – siç qe rasti me jehuditët e fisit Beni Kurejdha, të cilët thyen kushtet e paqes, madje mund të thuhet se ekzekutimi i burrave të këtij fisi, në të vërtetë, përfaqëson një dukuri prej dukurive të mëshirës së plotë të Profetit të fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Pjesëtarët e këtij fisi, duke qëndruar edhe një ditë tjetër në këtë botë, do ta vinin veten para formave të ndëshkimeve të shumta, ndëshkim që i pret ata në Botën Tjetër, pa harruar se ndëshkimi vetëm i një dite në Botën Tjetër, nuk mund të krahasohet me ndëshkimin në këtë botë, ndëshkim që vazhdon gjatë gjithë ekzistencës së tij. Kjo është prej çështjeve të qarta te ata që e njohin ashpërsinë e ndëshkimit në Botën Tjetër, si dhe dënimin, shkaqet e dënimit dhe pasojat e dënimit. Prandaj, pa tjetër që shpata që ra mbi qafat e jehudive të fisit Beni Kurejdha dhe të ngjashmëve me ta, është më afër mëshirës se sa zemërimit e urrejtjes. Gjithashtu, largimi i tyre përfaqëson një kapitull të “urdhërimit për punë të mirë dhe ndalimit të punës së keqe”, shikuar me syrin e mëshirës së përgjithshme, duke bërë kujdes që objektivi i rrugëtarit për te Allahu, në çështjen e urdhërimit e të ndalimit, të mos jetë dëshira për t’u dukur, mendjemadhësia dhe imponimi i urdhrave e i ndalesave. Nëse ai niset nga kjo shkallë, atëherë synimi me urdhërimit e punës së mirë dhe ndalimin e punës së keqe, që punon për realizimin e lumturisë për robtë dhe vënien në zbatim të dispozitave të Allahut në të gjithë vendin, kurrë nuk mund të bëhet realitet, madje herë-herë do të ndodhë e kundërta, për shkak se injoranti do të marrë përsipër çështjen e urdhërimit për punë të mirë dhe ndalimin e punës së keqe; njëkohësisht, herë-herë, do të shtohen punët e urryera, për



shkak të procesit të një urdhri për veprim ose për shkak të një urdhri për ndalim, që nxjerr një injorant, duke menduar se po urdhëron për punë të mirë, në një kohë kur burimi i kësaj injorance është dëshira vetjake dhe pushteti i shejtanit.

Por, kur ndjenja e mëshirës, dashamirësisë dhe ndjenja e vëllazërimit ndër njerëzit është motivi për orientimin e injorantëve dhe për t'u tërhequr vëmendjen të shkujdesurve, në të vërtetë metoda e shpjegimit dhe e orientimit nga një zemër e mëshirshme, bën që të kërkohet strehim te ajo zemër, sipas kushteve që mund të vijnë. Kjo gjë ka një ndikim të fuqishëm e të padiskutueshëm, aq sa i zbut shumë edhe zemrat e ashpra e të ngurta dhe i zbret ata nga kryeneçësia e nga trillet.

Çfarë humbje e madhe, që ne i kemi kthyer shpinën Kur'anit Famëlartë dhe nuk shikojmë të mendojmë e të mësojmë prej kësaj kujtese, e mbushur me urtësi, prandaj ne përfitojmë kaq pak prej këtij Libri hyjnor, madje përfitojmë aq pak, sa përfitimi thujse nuk ekziston.

Sikur ne të mendojmë në ajetet e Kur'anit Famëlartë, që flasin për Musain e Faraonin, si mendon, çfarë do të gjejmë në këto ajete? Kjo rrugë mendimi mbi ajetet e Kur'anit Famëlartë do të hapte për zemrën e njeriut një rrugë drejt diturisë dhe disa porta shprese.

Ja Faraoni, tirania e mendjemadhësia e të cilit kishte arritur deri aty sa të thoshte: “**أَنَا رَبُّكُمْ الْأَعْلَى**” - “...ene rab'bukumul-a'elà” - “**Unë jam zoti juaj më i lartë!**”<sup>1</sup> Si pasojë e tiranisë e padrejtësisë, ai kishte arritur deri aty sa u vriste djemtë. Për mizorinë e tij, na njofton

---

<sup>1</sup>Sure “En Nàziàt”, ajeti 24.





Allahu i Lartësuar: “أَبْنَاؤُهُمْ وَيَسْعَىٰ نِسَاءَهُمْ يَدْبَحُ” - “...judheb'bihu ebnàehum ue jestahjij nisàehum...” - “**ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë**”.<sup>1</sup>Këtë mizori ai e bënte duke u nisur vetëm nga një ëndërr që kishte parë, që falltarët e magjistarët ia shpjeguan me lindjen e një fëmije mashkull në Beni Israilët (fjala është për lindjen e Musa bin Imranit). Me këtë mizori, Faraoni kishte arritur deri aty sa të ndante të martuarit dhe të therte fëmijët meshkuj, krejtësisht të pafajshëm.

Kundrejt kësaj gjendjeje, shikojmë se i Gjithëmëshirshmi shkëlqeu me mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse mbi gjithçka që është mbi tokë dhe për ta shfaqur këtë mëshirë, i Vërteti zgjodhi të dërgojë profet, te ky tiran mizor, njeriun më kryeulët e më të plotësuar, profetin e madh dhe të dërguarin e respektuar Musa bin Imranin (*Paqja e shpëtimit i qoftë mbi të!*). Këtë profet të madh Allahu e edukoi, e mësoi dhe e ruajti. Për të, Allahu i Lartësuar thotë:

“وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَاسْتَوَىٰ ءَاتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا وَكَذَٰلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ” - “**Ue lem'mà belega eshud' dehu uestevà àtejnahù hukmen ue ilmen, ue kedhàlike nexhzil-muhsinijne**” - “**Dhe, kur ai arriti moshën madhore dhe pjekurinë e duhur, Ne i dhamë atij mençuri dhe dituri. Kështu, i shpërblejmë Ne ata, që bëjnë punë të mira**”.<sup>2</sup>

Madje e përforcoi në misionin e tij me vëllain e madh, Harunin.

Po, Filluesi i krijimit i zgjodhi ata dy të mëdhenj, të cilët përfaqësonin njerëzit më të pastër të kohës së tyre dhe për të cilin i Lartësuar njofton: “وَأَنَا اخْرَجْتُكَ” - “**uene-khtartuke**” - “**Unë të kam zgjedhur ty...**”<sup>3</sup>, “وَلِنُصْنِعَ عَلَىٰ عَيْنِي” - “...ue litasnaë alà ajnik” - “**që të rritesh nën Syrin**

<sup>1</sup>Sure “El Kasas”, ajeti 4.

<sup>2</sup>Sure “El Kasas”, ajeti 14.

<sup>3</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 13.



(kujdesin) **Tim**<sup>1</sup> dhe “وَاصْطَلِّتَكَ لِنَفْسِي إِذْ هَبْ أَنْتَ وَأَخُوكَ بِمَا يَآتِي وَلَا تَلِينَا فِي ذِكْرِي” - “uastanaëtuke linefsij. Idh’heb ente ue ekhùke biàjàtij ue là tenijà fij dhikrij” - **“Unë të kam zgjedhur ty për Vete. Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së përmenduri Mua!”**<sup>2</sup>

Ka edhe shumë ajete të tjera, por këtu vendi është i vogël për t’i shpjeguar. Gjithsesi, duhet të theksojmë se zemra e dijetarit arrin të ketë pjesë në kuptimin e këtyre ajeteve, megjithëkëtë s’ka mundësi të flasë në lidhje me ato, në mënyrë të veçantë me këto dy fraza të nderuara: “وَقَتَّأَكَ فُتُونَا” - “ue feten’nàke futùnen” - **“të vumë në prova të shumta”**<sup>3</sup>dhe “فَلَيْتَ سِينِينَ فِي أَهْلِ مَدْيَنَ ثُمَّ جِئْتَ عَلَى قَدَرٍ يَا مُوسَى” - “felebithte sinijne fij ehli Medjen thum’me xhiëte alà kaderin jà Mùsà” - **“Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit, pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!”**<sup>4</sup>

Allahu e dërgoi Musain, që të kalonte vite të tëra në shërbim të plakut të madh, Shujabit, këtij udhëzuesi në rrugën e drejtë, këtij njohësi të thellë e këtij dijetari të madh të njerëzimit, për të cilin, Allahu i Lartësuar njofton: **“Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit, pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!”**

Më pas, i Lartësuari e dërgoi atë në shkretëtirë, në rrugën e Shamit, ku do të vihej para një provimi e një sprove tepër të lartë dhe për këtë qëllim bëri që Musai të humbë rrugën, lëshoi mbi ta shira të rrëmbyeshëm dhe e rrethoi nga të gjitha anët me errësirë. Për më tepër, në ato çaste, gruas së tij i erdhën dhimbjet e lindjes. Kur iu duk se para tij ishin mbyllur të gjitha portat e natyrës, zemra

<sup>1</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 39.

<sup>2</sup>Sure “Tà Hà”, ajetet 41-42.

<sup>3</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 40.

<sup>4</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 40.



e tij bujare shpreh pakënaqësi ndaj manisë për të pasur sa më shumë në këtë botë dhe, në saje të cilësisë së pastër të krijimit, zemra e tij fisnike ndalon te i Vërteti dhe e plotëson udhëtimin hyjnor në atë shkretëtirë armiqësore:

“عَائِسٌ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ نَارًا قَالِ لِأَهْلِهِ امْكُثُوا إِنِّي آنَسْتُ نَارًا لَعَلِّي آتِيكُمْ مِنْهَا بِخَبَرٍ أَوْ جَذْوَةٍ مِنَ النَّارِ لَعَلَّكُمْ تَصْطَلُونَ. فَلَمَّا أَتَاهَا نُودِيَ مِنْ شَاطِئِ الْوَادِي الْأَيْمَنِ فِي الْبُقْعَةِ الْمُبَارَكَةِ مِنَ الشَّجَرَةِ أَنْ يَا مُوسَى إِنِّي أَنَا اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ”

“...ànese min xhànibi-t'tùri nàren, kàle liehlihi-mkuthù in'nij ànestu nàren leal'lij àtijkum minhà bikhaberin eu xhedhvetin mine-n' nàri leal'lekum tastalùne. Felem'mà etàhà nùdije min shàti'il-vàdil-ejmeni fil-buk'ati-mubàreketi mine-sh'shexhereti en jà Mùsà in'nij ene-ll'llàhu rab'bul-àlemijne” - “Kur Musai e plotësoi afatin e caktuar dhe u nis me familjen e vet, vuri re nga larg një zjarr në anën e (malit të) Turit. I tha familjes së vet: ‘Pritni, sepse kam parë një zjarr. Ndoshta mund t’ju sjell prej tij ndonjë lajm ose një urë zjarri për t’u nxehur’. Kur erdhi afër, një zë e thirri nga ana e djathtë e luginës, nga një pemë në një vend të bekuar: ‘O Musa, në të vërtetë, Unë jam Allahu, Zoti i botëve!’”<sup>1</sup>

Përse gjithë këto provime dhe këto forma të larmishme edukative - morale? Të gjitha këto për t’i bërë thirrje, për të orientuar dhe për të shpëtuar vetëm një individ tiran keqberës, që kishte arritur deri aty sa të thoshte: “Unë jam zoti juaj më i lartë!” dhe nuk ngurronte të bënte shumë shkatërrime në këtë tokë. A nuk ishte e mundur që Allahu i Lartësuar ta digjte atë me rrufenë e zemërimit të Tij? Jo, i Lartësuari, me mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse, dërgoi te ai tiran mizor dy profetë të mëdhenj, me porosinë që atij t’i flisnin me fjalë të buta:

<sup>1</sup> Sure “El Kasas”, ajetet 29-30.



“ قُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيْنَا لَعَلَّهٗ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَىٰ. اذْهَبَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ” - *“Idhheba ilà fir'aune in'nehù tagà. Fekùlà lehù kaulen lenjinen leal'lehù jetedhek'keru eu jakhshà”* - **“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë! Flitni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!”**<sup>1</sup>

Mbase ai do të merrte këshillën, ose do të frikësohej prej përfundimit të urdhrit e të punës së tij!

Po, ky është programi i urdhërimit për punë të mirë, ndalimi i punës së urryer dhe rruga e orientimit edhe të një personi tiran mizor si Faraoni.

Ti që ke qëllim urdhërimin për punë të mirë, ndalimin e punës së ligë dhe orientimin e krijesave të Allahut, këto ajete të nderura, të cilat kanë zbritur këshillë dhe për të mësuar, ke për detyrë t'i konsiderosh këto ajete, se edhe për ty ato janë këshillë dhe të mësosh prej tyre rrugën se si të dalësh para robëve të Allahut, me zemër të mbushur me dashuri e me ndjenja simpatie. Gjithashtu, të mësosh edhe mënyrën si të punosh për të mirën e tyre, nga thellësia e zemrës tënde.

Kur ti ndërgjegjësohesh se zemra jote është bërë mëshiruese gjithëpërfshirëse dhe mëshiruese e plotë, atëherë fillo punën e urdhërimit, ndalimit e orientimit, që zemrat e ngurta të zbuten me ngrohtësinë e me butësinë e zemrës tënde dhe të shkrijë hekuri i shpirtrave, me këshillën tënde të dyzuar me zjarrin e dashurisë.

Kjo luginë nuk është lugina e zemërimit dhe e dashurisë për hir të Allahut, çka bën detyrim të jesh armik ndaj armiqve të fesë, ashtu siç theksohet në ajetet e Kur'anit Famëlartë dhe në hadithet e nderuara, që kanë ardhur në vendin e në rastin e duhur. Por, për të trajtuar këtë çështje këtu, vendi është tepër i ngushtë.

---

<sup>1</sup>Sure “Tà Hà”, ajetet 43-44.



## Ndarja e pestë

# ESENCA E SHPJEGIMIT TË SURES SË BEKUAR “EL HAMD” (EL FÀTIHA) DHE NJË PËRMBLEDHJE PREJ EDUKATAVE TË FALËNDERIMIT DHE TË KËNDIMIT

Mëso se dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth lidhjes së shkronjës “ب” - “b” në fjalinë: “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “Bismil'lâhi-rr'rrahmâni-rr'rrahijm” - “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!” Secili dijetar e shpjegon këtë lidhje sipas asaj që ai ka pirë prej diturisë e prej njohjes, plotësisht ashtu siç ndodh edhe me gjuhëtarët e gjuhës arabe, të cilët kanë mendime të ndryshme në lidhje me etimologjinë e germës “ب” - “b” në gjuhën arabe, duke vlerësuar germën “ب” - “b” si shembull prej lëndës “el - ibtidâe” “الابتداء” - “fillim” ose “el-istiâneh” “الاستعانة” - “kërkim ndihme”.

Në disa transmetime ka ardhur se “بِسْمِ اللّٰهِ” - “bismil'lâhi” - “me emrin e Allahut” - është në kuptimin “أستعين” - “esteijnu” - “kërkoj ndihmë”. Por kjo është vetëm njëra mundësi e bazuar mbi shpjegimin, që shkon në harmoni me sensin e masës dhe është përmendur shpesh në transmetime. Por kundërshtimi konkret, në shumë hadithe, ka mundësi të jetë bazuar pikërisht mbi këtë kuptim. Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) fjalën “بِسْمِ اللّٰهِ” - “bismil'lâhi”



e interpreton: “e përshkruaj veten me një shenjë dalluese prej shenjave të Allahut”.<sup>1</sup>

Është e qartë se fjala “الإستعانة” - “el istiàneh” - “kërkim ndihme”, përfshin një kuptim më të hollësishëm se kuptimi qarkullues në mendjet e masës së njerëzve. Disa prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes, janë shprehur se shkronja “ب” - “b” i referohet foljes së supozuar “ظهر” - “dhahere” - “u shfaq”, prandaj vlerësimi do të jetë: “ekzistenca u shfaq me emrin e Allahut”.<sup>2</sup> Ky mendim është bazuar në rrugën e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të atyre dijetarëve, që thonë se të gjitha qeniet dhe të gjitha grimcat e qenieve, si dhe botët e padukshme e të dukshme janë shfaqur me shkëlqimin e emrit hyjnor përgjithësues, domethënë “të emrit më të madh” (el ismul aëdham).

Bazuar mbi këtë shpjegim, “emri” është në kuptimin e shenjës, ose lartësisë, ose ngritjes lart dhe shpreh shkëlqimin e shtrirjen e punëve të të Vërtetit. Bazuar mbi këtë rrugë, e gjithë shtëpia e vërtetimit, duke filluar me mendjet e zhveshura deri në gradën e fundit të ekzistencës, të gjitha shprehin cilësitë e kësaj bujarie dhe tërheqjet e kësaj fjale të bukur.

Në ajetet e nderuara hyjnore dhe në hadithet e ardhura prej të pastërve të Ehli Bejtit ka shumë tekste që e mbështesin këtë rrugë.

---

<sup>1</sup>Shejhu Es' sadük, “Kitàbu-T'teuhijd”, K. 31, Hadithi 1, f. 229; “Meànil-Akhbàr”, f. 3.

<sup>2</sup>Këtë interpretim e ka thënë shejhu Muhjid' dijn bin Arebij; lexo “El Futühàtul-Mek'kijeh”, vëll. 1, f. 102.



Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu krijoi vetë dëshirën dhe pastaj me dëshirën krijoi sendet”.<sup>1</sup>

Ky hadith është shpjeguar me disa mënyra, sipas rrugëve të ndryshme, por shpjegimi më i përhapur dhe që është në përputhje me këtë rrugë, është shpjegimi që thotë: qëllimi me dëshirën, është dëshira e punëve, e cila shpreh “dhënien e madhe”, kurse qëllimi me “sendet” është në gradët e ekzistencës, të cilat përfaqësojnë cilësitë dhe tërheqjet e kësaj fjale të bukur. Me këtë shpjegim, kuptimi i hadithit është: Allahu i Lartësuar krijoi dëshirën e punëve efektive, e cila është hija e dëshirës personale të hershme, pa ndonjë ndërmjetës. Më pas Ai krijoi të gjitha qeniet e botës së padukshme dhe në ndjekje të kësaj bote, krijoi botën e dukshme.

Studiuesi i nderuar Damad (*Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!*), edhe pse ishte në një gradë të lartë të studimit të hollësishëm, për këtë hadith të nderuar, ka përmendur një shpjegim në gjuhën arabe.<sup>2</sup> Edhe interpretimi i studiuesit El Fejd (*Allahu e mëshiroftë!*), i është afruar më shumë së vërtetës.<sup>3</sup>

Në përgjithësi, “emri” shpreh të njëjtin shkëlqim të punëve, me të cilin bëhet realitet e gjithë shtëpia e vërtetimit, kurse emërtimi me këtë emër është për punë të përsëritura shumë herë në fjalët e Allahut, në fjalët e të Dërguarit të Tij dhe në fjalët e imamëve të

---

<sup>1</sup>“El-Usûlu minel-Kâfi”, Libri “Et’teuhid”, K. “El-Irâdetu min sifâtil-fi’li”, Hadithi 4; “Bihârul Enuâr”, vëll. 4, f. 145.

<sup>2</sup>Lexo shpjegimin e autorit të librit “Mir’âtul-Ukûli”, vëll. 2. f. 19 dhe “El Vâfij”, vëll. 1, f. 100.

<sup>3</sup>Po aty.



ruajtur prej gjynaheve, siç ka ardhur shpesh në duatë e tyre: “me emrin Tënd, me të cilin Ti shkëlqeve mbi...”<sup>1</sup>

Ka mundësi që fjalìa: “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*” - “Me emrine Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”, që ka ardhur në krye të çdonjëres prej sureve të Kur'anit Famëlartë të ketë lidhje me suren përkatëse; për shembull: “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*” në fillim të sures së bekuar “El Hamd” (El Fàtiha) ka lidhje me vetë këtë sure dhe kjo është në harmoni me shijen e diturisë dhe me rrugën e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, për faktin se tregon falënderimin e lavdërimin e falënderuesve. Por, në të vërtetë, mund të jetë edhe me përjetshmërinë e emrit “Allah”. Bazuar mbi këtë shpjegim, shqiptimi i fjalisë “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*”, në ligjin e fesë është veprim i pëlqyer, që kjo frazë të thuhet në fillim të çdo bisede e në fillim të çdo pune, me qëllim që të kihet në mendje se çdo fjalë e çdo punë që del prej njeriut, pa dyshim që plotësohet vetëm me përjetshmërinë e emrit “Allah”. Në bazë të këtij shpjegimi, rezulton se kuptimi i fjalisë: “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*” ndryshon nga njëra sure në suren tjetër, prandaj dijetarët e fesë kanë thënë se është detyrim që për çdo sure të Kur'anit të caktohet “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*”. Kur pranohet kjo fjali për një sure të caktuar, nuk lejohet që pas kësaj të lexohet një sure tjetër dhe jo surja që ishte qëllim.

Fjalìa: “بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ” - “*bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*” është në harmoni me orientimin juridik të ligjit të fesë, prandaj nuk

---

<sup>1</sup>Lexo librin “Duàu-S’ simàt”, për shembull “Misbàhun bilmuxhtehidi”, f. 374.





është fjali pa prestigj dhe, ashtu siç u tha më sipër, padyshim është fjali serioze e logjike.

Nga ana tjetër, zhdukja e shumicës në praninë e emrit më të madh të Allahut, na bën të shprehemi për një kuptim të vetëm për të gjitha emërtimet. Këto dy modele të analizës, nga njëra anë, shumica dhe, nga ana tjetër, analiza me zhdukjen e shumicës që përputhen në shkallët e ekzistencës dhe me pozicionet e të panjohurës dhe të njohurës, përputhen edhe në thelbësoret e qenieve të shumta, në shkallët e ekzistencës dhe të thelbësoreve të botës së emrave të ndryshëm, mëshirën gjithëpërfshirëse, mëshirën e plotë, imponimin, butësinë dhe fjalën e mirë.

Të dyja këto mënyra analize ecin së bashku mbi emrat e cilësitë hyjnore dhe me analizimin e parë do të jetë prania e Vetme në pozitën e shumicës së emrave e të cilësive dhe të gjitha shumicat do të jenë prej kësaj pranie.

Kur marrin në konsideratë analizën e dytë, atëherë s'ka as emër e as figurë përveç emrit më të madh të Allahut, pasi të dyja analizat janë logjike dhe të dyja mbështeten mbi bazën e mendimit.

Kur analiza bëhet njohëse dhe mbështetet në hapjen e portave të zemrës, rrugëtimit për te Allahu, shoqëruar me ushtrime të zemrës, atëherë i Vërteti Fuqplotë shkëlqen për zemrat e ndjekësve të këtij kursi me shkëlqimet e punëve, me shkëlqimet e cilësive dhe me shkëlqimet personale, herë lindin shumicat dhe herë tjetër lind Njëshi.

Këto shkëlqime Kur'ani Famëlartë herë i shpalos qartë, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:



“...felem'màtexhel'là lilxhebeli xhealehù dek'ken ue harr'rre Mùsà saikan...” - “E kur Zoti i tij iu shfaq malit, e thërrmoi atë dhe e bëri pluhur, ndërsa Musait i ra të fikët”.<sup>1</sup> Herë tjetër i shpalos me shenjë të fshehur, ashtu siç tregon i Gjithëfuqishmi në dy suret e nderuara “El En’àm” dhe “En Nexhm” për vëzhgimet e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për vëzhgimet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi atë e mbi familjen e tij!*).

Edhe në transmetimet e në duatë e imamëve të ruajtur prej gjynaheve ka shenja të shumta në lidhje me këtë çështje, sidomos në lutjen “Es’simàtul-Adhijm” - “Rruga e qartë e të madhit”, lutje që kundërshtuesit nuk guxojnë ta mohojnë, as përcjellësit e as brendinë e saj. Ajo është pranuar te masa dhe te të veçantët, është pranuar te dijetari dhe te i zakonshmi, sepse ajo është lutje me përmbajtje të lartë e me dituri të mëdha. Zemra e dijetarit trulloset prej kësaj lutjeje, filladi i saj freskon shpirtin e rrugëtarit për te Allahu: “...me dritën e fytyrës Tënde, që Ti shkëlqeve mbi malin, të cilin Ti e bëre pluhur dhe Musai humbi ndjenjat; me madhështinë Tënde, që u shfaq në Turi Sijnà, kur Ti i fole robit e të dërguarit Tënd, Musa bin Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shpërthimin e dritës Tënde në ndriçimin e në shfaqjen Tënde në malin Faran...”<sup>2</sup>

Në përgjithësi, kur rrugëtarit thotë: “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ” - “*bismil'lâhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm*”, ka për detyrë ta bëjë zemrën e tij, që ajo të kuptojë se të gjitha qeniet e jashtme e të brendshme dhe të gjitha botët e padukshme e të dukshme, janë të nënshtruara nën drejtimin e emrave të Allahut, madje ato bëhen të dukshme me

<sup>1</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 143.

<sup>2</sup>“Misbàhul-Muxhtehidi”, f. 376.



shfaqjen e emrave të Allahut dhe të gjitha lëvizjet e gjendjet e qetësisë së qenieve dhe të gjitha botët janë të nënshtruara nën përjetshmërinë e emrit më të madh të Allahut, domethënë se të gjitha falënderimet e rrugëtarit janë vetëm për të Vërtetin. Gjithashtu, nën përjetshmërinë e emrit “Allah” janë të gjitha adhurimet që ai bën, bindja e tij, besimi i tij se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe patjetër edhe sinqeriteti i tij.

Kur kjo dhuratë hyjnore dhe kjo pozitë forcohet në zemrën e rrugëtarit nëpërmjet kujtimit e mësimi të vazhdueshëm, duke theksuar se kujtimi është qëllimi më i lartë i adhurimeve, Krijuesi Fuqiplotë i flet bashkëbiseduesit të Tij, Musa bin Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*) në kënaqësinë e vetmisë dhe në panelin e pastër me fjalën Tij: “لَيْلَىٰ أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي” - “*In’nij ene-ll’lלהu là ilàhe il’là ene faëbudni ue ekimi-s’salàte lidhikrij*” - “**Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s’ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!**”<sup>1</sup>

Allahu i Lartësuar e ka bërë kujtimin e Tij (dhikrin) qëllimin më të lartë të faljes së namazit. Veç kësaj, me namazin, për zemrën e dijetarit hapet një rrugë tjetër prej diturive. Ai tërhiqet drejt botës së unitetit dhe gjuha e gjendjes dhe e zemrës së tij bëhet: “بِاللَّهِ الْحَمْدُ اللَّهُ” - “*bil’làhi elhamdu lil’làhi*” - “me Allahun, falënderimi është vetëm për Allahun” dhe “أنت كما اتيت على نفسك” - “*ente kemà ethnejte alà nefsike*” - “Ti

<sup>1</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 14.



je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën Tënde”<sup>1</sup>, dhe “اعوذ بك منك” - “eùdhu bike minke” - “me Ty kërkoh mbrojtje prej Teje”.<sup>2</sup>

Kjo ishte një paraqitje e përgjithshme rreth varësisë dhe kthimit të shkronjës “ب” - “b”, në fjalinë “بِسْمِ اللّٰهِ...” - “bismil’lâhi...”, si dhe një fllad njohurish që përfitohen prej kësaj paraqitjeje.

Për sa u përket sekreteve të shkronjës “ب” - “b” dhe pikës poshtë shkronjës “ب” - “b”, kjo futet në brendësinë e pozitës së kujdestarisë së lartë dhe në pozitën e shumësit të shumësit të Kur’anit. Futja në hollësitë e kësaj çështjeje ka nevojë për një hapësirë shumë të gjerë.

Edhe për të vërtetën e emrit, ka pozitë të padukshme dhe të padukshmes së të padukshmes, ka sekret dhe sekret të sekretit, ka pozitë të dukshme dhe të dukshmes së të dukshmes.

Duke qenë se emri është shenjë që tregon të Vërtetin dhe asgjësimin në Qenien e pastër, prandaj, sa herë emri është afër horizontit të unitetit, aq më larg ai është prej shumicës dhe aq më i plotë është në emërtim. Por më i plotë është emri i pastruar prej shumicës, madje i pastruar edhe prej shumicës së diturisë. Ky është shkëlqimi i padukshëm unik i Muhamedit, në prani të Qenies, me pozitën “bujarisë më të pastër”, për të cilën flet ajeti i nderuar: “أُوذِيَّ” - “...eu ednà” - “...ose edhe më afër”.<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Nga duaaja e të Dërguarit më të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në sexhde; lexo “Avàlij El’leàlij”, vëll. 1, Hadithi 21, f. 389.

<sup>2</sup>Gjithashtu, nga duaaja e të Dërguarit më të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në sexhde; lexo “Misbàhul-Muxhtehidi”, f. 308.

<sup>3</sup>“مَكَانَ قَابِ قَوْسَيْنِ أَوْ أُنْفَىٰ” - “fekàne kàbe kausejni eu ednà” - “Ishte afër sa dy harqe, ose edhe më afër”; sure “En Nexhm”, ajeti 9.



Më pas vjen shkëlqimi i emrit më të madh të Allahut, në praninë e Njëshit, pastaj vjen shkëlqimi me “bujarinë e pastër”, që e pasojnë shkëlqimet e cilësuar me shumicë në praninë e personaliteteve deri në fundin e gradëve të shtëpisë së vërtetimit.

Këtë bisedë, në tërësi, e kam trajtuar të detajuar në dy kumtesat e mia “Misbàul-Hidàjeti” - “Llamba e udhëzimit në rrugën e drejtë” dhe “Sherhu duàsu-s’sihri” - “Shpjegim i lutjes së mëngjesit”.<sup>1</sup>

Allahu është pozita e shfaqjes me “bujarinë e pastër”, kur qëllimi me emrin janë cilësitë fizike.

Emërtimi “Allah”, në të vërtetë, është si rezultat i bashkimit të së jashtmes së dukshme dhe lejimit të asgjësimit të emrit në të emërtuarin. Mbase ajetet: “السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ إِنَّهُ نُورٌ” - “Allàhu nùru-s’semàvati uel-erdi...” - “Allahu është dritë e qiejve dhe e tokës...”<sup>2</sup> dhe “وَفِي الْأَرْضِ وَإِلَٰهُهُمُ الَّذِي فِي السَّمَاءِ إِلَٰهٌ” - “Ue huve-l’ledhij fi-s’semài ilàhun ue fil-erdi ilàhun...” - “Ai që në qiell është i adhuruar, është i adhuruar edhe në tokë...”<sup>3</sup> theksojnë këtë pozitë, përforcojnë emërtimin dhe pozitën e njëjësit e të shumësit të emrave.

Me fjalë të tjera, pozita e emrit më të madh, kur qëllimi me emrin është pozita e shkëlqimit me “bujarinë e pastër”, ka mundësi të jetë më e qarta e të gjitha mundësive, ose është pozita me vetë Qenien e pastër, ose pozita e “bujarisë së pastër”, kur qëllimi me

<sup>1</sup>Kumtesë e shkruar në gjuhën arabe, prej imanit El-Akhmejnij (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*). Në këtë kumtesë ai shpjegon ekzistencën e duasë së mubahesë. Kumtesa është botuar në vitin 1349 hixhri.

<sup>2</sup>Sure “En Nùr”, ajeti 35.

<sup>3</sup>Sure “Ez Zukhruf”, ajeti 84.



emrin është vetë emri më i madh. Kjo është e qartë, kurse pozita i **“Gjithëmëshirshëm”** - *“Err’rrahmàn”* dhe **“Mëshirëploti”** - *“Err’rrahijm”* ndryshon sipas ndryshimit të këtyre mundësive.

Gjithashtu, ka mundësi që fjalët *“Err’rrahmàn”* dhe *“Err’rrahijm”* të jenë dy cilësi për emrin, ose janë dy cilësorë të fjalës së lartë Allah, por është më afër që këto dy fjalë të konsiderohen dy cilësorë për emrin, sepse të dyja këto fjalë, në suren *“El Hamd”* (El Fātiha) janë cilësorë për fjalën e lartë Allah. Pikërisht ky fakt, e mohon mundësinë e përsëritjes, pavarësisht se është e mundur që kjo të interpretohet edhe me një rrugë tjetër, domethënë, kur interpretimi bëhet duke i konsideruar këta emra cilësorë për fjalën e madhe Allah, me orientimin e përsëritjes nga ana retorike.

Kur këto dy fjalë i konsiderojmë cilësorë për emrin, kjo përforcon mendimin se qëllimi me emrin është emër konkret, sepse i cilësuarit me cilësinë e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe të mëshirës së plotë, nuk mund të jetë gjë tjetër përveç emrave konkretë.

Atëherë, kur qëllimi me emrin është emri vetjak dhe shkëlqimi me pozitën e shumësit, mëshira gjithëpërfshirëse dhe mëshira e plotë janë prej cilësive personale të vërtetuara për *“emrin e Allahut”*, në pozitën e njëjësit, kurse mëshira gjithëpërfshirëse dhe mëshira e plotë është te punët, prej fillimit dhe dukurive të punëve.

Kur qëllimi me *“emrin”* është shkëlqimi i të gjitha punëve, kjo është pozita e dëshirës, atëherë mëshira gjithëpërfshirëse dhe mëshira e plotë janë prej cilësive të punës.

Mëshira gjithëpërfshirëse është origjina e ekzistencës dhe është e përgjithshme për të gjitha qeniet, por është edhe prej cilësive



të veçanta të të Vërtetit të Lartësuar, sepse s'ka asnjë shok ose ortak për të Vërtetin Fuqiplotë në shtrirjen e origjinës së ekzistencës, kurse të gjitha qeniet nuk e kanë mëshirën krijuese dhe nuk kanë ndikim në ekzistencën, pasi ndikim ka vetëm Allahu. Kjo do të thotë se në shtëpinë e vërtetimit s'ka të adhuroar tjetër përveç Allahut.

Për sa i përket mëshirës së plotë, që numërohet udhëzim i udhëzuesve në rrugën e drejtë dhe prej filtrimeve të saj, kjo është e veçantë për të lumturit dhe për ata që janë krijuar me cilësinë "il'lij'jijn" - "e lartë", që, në të vërtetë, është prej cilësive të përgjithshme, në të cilën, edhe qeniet e tjera kanë pjesën e vet prej asaj mëshire. Më sipër e kemi theksuar përgjithshmërinë e mëshirës së plotë dhe kemi thënë se në këtë mëshirë nuk përfshihen të këqijtë dhe kjo është për shkak të mangësisë që ata kanë dhe nuk është rezultat se mëshira është e kufizuar.

Për këtë shkak, edhe udhëzimi në rrugën e drejtë, edhe thirrja për në besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), përfshijnë të gjithë bijtë e Ademit, ashtu siç e tregon vetë Kur'ani Famëlartë.

Gjithashtu, mund të merret në konsideratë se mëshira e plotë është e veçantë vetëm për të Vërtetin e Lartësuar dhe në këtë mëshirë Ai s'ka as shok e as ortak. Shpjegimi i mëshirës së plotë në hadithet e nderuara ka ardhur me ndryshime sipas ndryshimit të këndvështrimit dhe të konsideratës. Imamët e ruajtur prej mëkateve kanë thënë se "Err'rrahmàn" - "**i Gjithëmëshirshmi**" është emër i veçantë për një cilësi të përgjithshme, kurse



“Err’rrahijm” - “Mëshirëploti” është emër i përgjithshëm për një cilësi të veçantë.<sup>1</sup>

Gjithashtu, prej atyre transmetohet se “Err’rrahmàn” - “i Gjithëmëshirshmi” është mëshirë për të gjitha krijesat e Tij, kurse “Err’rrahijm” - “Mëshirëploti”, është mëshirë vetëm për besimtarët.<sup>2</sup>

Ata kanë thënë: “O i Gjithëmëshirshmi në këtë botë dhe Mëshirëploti në Botën Tjetër”.<sup>3</sup>

Gjithashtu, ata kanë thënë: “O i Gjithëmëshirshmi në këtë botë e në Botën Tjetër dhe Mëshirëploti në të dyja botët”.

---

<sup>1</sup>“Muxhmeul-Bejàn”, vëll. 1, f. 21, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm.

<sup>3</sup>Burimi i mësipërm, prej Profetit të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!*).





## Përfundim gnostik

Gjuhëtarët dhe letrarët thonë se dy cilësorët “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”** dhe “الرحيم” - “Err’rrahijmu” - **“Mëshirëploti”** janë nxjerrë nga rrënja “الرحمة” - “Err’rrahmetu” - **“mëshirë”** dhe shtojnë se me këta dy cilësorë qëllimi është mëshira në shkallën më të lartë. Por mëshira në shkallën më e lartë është shumë më e përforcuar në cilësorin “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”** se sa në cilësorin “الرحيم” - “Err’rrahijm” - **“Mëshirëploti”**. Krahasimi kërkon përparësinë e cilësorit “الرحيم” - “Err’rrahijm” - **“Mëshirëploti”**, mbi cilësorin “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”**, por, meqenëse cilësori “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”** është në pozitën e emrit të përveçëm të personit, ashtu siç është shpjeguar edhe më parë, ky cilësor nuk mund të thuhet për të gjitha qeniet.

Disa të tjerë kanë thënë se dy cilësorët kanë një kuptim të vetëm dhe konsiderojnë se përsëritja është thjeshtë për përforsim.

Megjithëkëtë, shija njohëse dhe Kur’ani ka zbritur më gradën më të lartë të shijes, kërkon që “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”** të jetë përpara “الرحيم” - “Err’rrahijm” - **“Mëshirëploti”**, sepse te zotëruesit e zemrave, Kur’ani është: zbritja e shkëlqimeve hyjnore dhe e formës së shkruar të emrave të bukur të Allahut dhe, meqenëse emri “الرحمن” - “Err’rrahmàn” - **“i Gjithëmëshirshmi”** është emri më gjithëpërfshirës, pas emrit më të



madh të Allahut, te ata që kanë arritur gradën e njohjes vërtetohet se shkëlqimi me emrat gjithëpërfshirës është përpara shkëlqimit me emrat e përfshirë; gjithashtu, te emrat më shumë gjithëpërfshirës shkëlqimi me atë emër është më përpara. Ky është edhe shkaku që shkëlqimi në fillim ishte në prani të Njëshit, që është shkëlqimi me emrin më të madh të Allahut. Pas tij vjen shkëlqimi me pozitën e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe pastaj vjen shkëlqimi me mëshirën e plotë.

Kështu është gjendja edhe me shkëlqimin e jashtëm të punëve, ku shkëlqimi është në pozitën e dashjes dhe është emri më i madh në këtë panoramë, domethënë shfaqja e emrit më të madh personal është përpara të gjitha shkëlqimeve të tjera dhe vetë shkëlqimi është në pozitën e mëshirës gjithëpërfshirëse, e cila ka rrethuar të gjitha qeniet e botës së padukshme dhe të dukshme, ashtu siç tregon për këtë ajeti: “وَرَحْمَتِي وَسِعَتْ كُلَّ شَيْءٍ” - “...ue rahmetij vesiat kul’le shej’in...” - “...dhe mëshira Ime ka përfshirë çdo send...”<sup>1</sup>, domethënë se ky shkëlqim është para të gjitha shkëlqimeve të tjera.

Këtë kuptim e jep, gjithashtu, edhe fraza: “سبقت رحمته غضبه” - “sebekat rahmetuhù gadabehù” - “mëshira e Tij është para zemërimit të Tij”.<sup>2</sup>

Si përmbledhje, meqenëse “بِسْمِ اللّٰهِ...” - “Bismil’lâhi...” - “**me emrin e Allahut...**”, sipas të brendshmes dhe shpirtit, është figura e shkëlqimeve të punëve dhe, sipas sekretit e sekretit të sekretit, është figura e shkëlqimeve të emrave, madje edhe të shkëlqimeve personale. Më pas, këto shkëlqime, së pari, plotësohen me pozitën

---

<sup>1</sup>Sure “El Arâf”, ajeti 156.

<sup>2</sup>Lexo “Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 57.



“الله” - “Allah”, pastaj me pozitën “الرحمن” - “Err’rrahmàn” dhe pastaj me pozitën “الرحيم” - “Err’rrahijm”, prandaj është detyrë që edhe forma gjuhësore e shkruar sipas këtij shembulli, duhet të jetë në përputhje me sistemin hyjnor të Zotit krijues.

Fakti që “الرحمن” - “Err’rrahmàn” dhe “الرحيم” - “Err’rrahijm”, në suren e uruar “El Hamd” (El Fàtiha) kanë ardhur pas frazës: “رب العالمين” - “rab’bil-àlemijne” - “Zoti i botëve”, ka shumë mundësi që sekreti në këtë renditje qëndron në atë se qëllimi me “بسم الله...” - “bismil’lâhi...” - “**me emrin e Allahut...**”, është shfaqja e ekzistencës prej të brendshmes së panjohur të ekzistencës, kurse qëllimi në këtë sure të uruar është kthimi dhe e brendshmja, pavarësisht se për këtë mundësi ka disa forma.

Mbase me këtë vënie prapa, qëllimi është të tregohet rrethimi me mëshirën gjithëpërfshirëse dhe me mëshirën e plotë, por këtu mund të ketë edhe një mundësi tjetër.

Në të gjitha gjendjet, fjala kuptimplote, e përmendur në frazën: “بسم الله...” - “bismil’lâhi...” - “**me emrin e Allahut**”, patjetër që duhet të miratohet dhe ky miratim është prej begative të mëshirës së plotë në zemrën e këtij të mjeri.

Falënderimi është vetëm për Allahun, për të gjitha mirësitë që na ka dhënë!



## Studim dhe informacion

Dijetarët dhahiri (dijetarët që studiojnë vetëm anëne jashtme të çështjes, ose të sendit) thonë se fjalët “الرحمن” - “*Err’rrahmàn*” dhe “الرحيم” - “*Err’rrahijmu*” janë marrë prej rrënjës “الرحمة” - “**Err’rrahmetu**”. Qëllimi i përdorimit të këtyre dy cilësorëve është të tregojë butësi, e dhembshuri. Prej Ibn Abasit (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) është transmetuar: “Ata janë dy emra tepër të lartë. Njëri prej këtyre dy emrave është më i lartë se tjetri. Kuptimi i fjalës “*Err’rrahmàn*” - “**i Gjithëmëshirshmi**”, është i Buti; kurse kuptimi i fjalës “*Err’rrahijmu*” - “**Mëshirëploti**”, është butësia ndaj robëve të Tij me furnizimin me ushqim e me dhënien e mirësive”.<sup>1</sup>

Fraza “*bismil’lâhi...*”, kur thuhet për Qenien e pastër nga mangësitë e nga nevojat, është interpretuar dhe është konsideruar metaforë, që shpreh butësinë e dhembshurinë prej ndikimit dhe emocionit.

Disa dijetarë të tjerë këtë frazë e interpretojnë duke u nisur nga rregulli: “marrja e qëllimeve dhe lënia e parimeve” dhe janë shprehur për shqiptimin e këtyre cilësive. Gjithashtu, ata marrin në konsideratë se këta dy cilësorë thuhën vetëm për të Vërtetin. Në të vërtetë, ky interpretim bazohet në anën e shikimit në ndikimet e punëve dhe jo duke shikuar te parimet e te cilësitë. Nga ky këndvështrim, dy cilësorët “*Err’rrahman*” dhe “*Err’rrahijmu*”, në

---

<sup>1</sup>Es’Sujütij, “Ed’ durr’rrul-Menthûr fi-t’ tfsijri bil-me’t’hûr”, vëll. 1 , f. 9.



lidhje me të Vërtetin, kanë këtë kuptim: është Ai që i trajton robtë e Tij me mëshirë.

Edhe mutezilet këto cilësi i kanë konsideruar sipas këtij shembulli, ose afër tij dhe, sipas këtij mendimi, kur të dy cilësorët thuhën për të Vërtetin, gjithashtu, është metaforë.

Në të gjitha gjendjet, përdorimi i metaforës këtu është prej punëve të përjashtuara, veçanërisht me cilësorin "*Err'rrahmàn*" - "**i Gjithëmëshirshmi**" dhe konsiderohet punë e çuditshme, kur qëllimi me këtë fjalë është metafora, sepse kjo fjalë është vënë për një kuptim që nuk lejohet, madje është e pamundur përdorimi i metaforës për këtë fjalë. Për më tepër, kjo metaforë do të ishte pa asnjë të vërtetë. Mendo!

Për t'u dhënë përgjigje këtyre çështjeve, studiuesit thonë se fjalët janë vënë për kuptime të përgjithshme dhe për të vërteta absolute dhe, kushtëzimi me butësinë e me dhembshurinë nuk hyn te ato që janë vënë për fjalën "*Err'rrahmetu*", sepse janë thjesht mendjet e masës ato që i kanë shpikur këto kuptime, edhe pse ato s'ka asnjë rol në vënien e fjalës.

Kjo analizë, siç duket, është larg që të miratohet, pasi dihet se vënësi i fjalës ishte prej mesit të personave të zakonshëm dhe, kur ai e ka vënë këtë fjalë, nuk ka marrë parasysh kuptimet e zhveshura dhe të vërtetat absolute.

Po, sikur vënësi të ishte i Vërteti Fuqiptotë, ose profetët me rrugën e shpalljes dhe të frymëzimit hyjnor, patjetër që kjo analizë do të ishte e pranueshme, por kjo çështje nuk është vërtetuar.



Pavarësisht nga gjendja, ana e jashtme e kësaj analize është gërvishtur, por nuk dihet, nëse te studiuesit qëllimi është ana e jashtme. Në shpjegim të kësaj teme mund të thuhet: vënësi i fjalëve e i shprehjeve në kohën e vënies, edhe nëse nuk ka shikuar kuptimet e pakushtëzuara, në të vërtetë, këto fjalë janë vënë konkretisht në kuptime absolutisht të thjeshta. Për shembull, kur vënësi kishte qëllim të vinte fjalën “dritë”, në të vërtetë, qëllimi i tij ishte të tregonte ndriçimin dhe jo përzierjen e dritës me errësirën, megjithëse ajo që ai pa prej dritave, ishin drita ndijimesh pjesore, sepse ai nuk njuh tjetër përveç këtyre dritave, edhe sikur ai të pyesë për pyetjen vijuese:

Këto drita pjesore, të kufizuara, nuk janë drita të mirëfillta, por të përziera me errësirë e me pafuqi, atëherë vënësi me fjalën “dritë” që vuri, a kishte qëllim, thjesht, ndriçimin apo ndriçimin e përzier me errësirën?

Nga nevoja, ai patjetër do të përgjigjej se e kam vënë për të treguar ndriçimin dhe s’ka rol as nga ndonjë anë për errësirën, në kuptimin për të cilin është vënë fjala.

Gjithashtu, ne dimë se ai që e ka vënë fjalën “zjarr”, ka parasysh vetëm zjarrin e kësaj bote dhe s’ka fare dijeni për zjarrin e Botës Tjetër, për të cilin flasin ajetet e nderuara:

“الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ نَارُ اللَّهِ الْمَوْجِدَةُ” - “*nàru-ll’lilàhil-mùkadeti. El’letij tet’taliu alel-efideti*” - **“Ai është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut”**.<sup>1</sup> Ky është edhe shkaku që supozimi ynë bëhet edhe më i fortë, kur vënësi ishte prej atyre që nuk besojnë në Botën Tjetër, megjithëkëtë, kjo nuk çon në mbartjen e kushtëzimit deri në

---

<sup>1</sup>Sure “El Humeze”, ajetet 6-7.



të vërtetën e thjeshtë, pasi në fjalën “zjarr” shihet kjo anë e zjarrit të ndezur, prandaj ne nuk themi që vënësi është person që i ka zhveshur kuptimet dhe çështja të mbetej e tillë, që shkakton çudi, ose është e përjashtuar. Por ne themi se fjalët, në të vërtetë, janë ndodhur në të njëjtën anë të kuptimeve, pa asnjë kushtëzim. Me këtë shpjegim, nuk mbetet rrugë as për çudi e as për përjashtim.

Sa më shumë që kuptimi s’ka çudira dhe kuptime të futura, aq më afër të vërtetës është dhe aq më larg metaforës është. Për shembull: fjala “zjarr” është vënë për “ndriçimin” e jashtëm të zjarrit dhe të dukshëm për tjetrin, pavarësisht se kjo fjalë thuhet për dritat e pjesshme të kësaj bote dhe nuk është zhveshur nga e vërteta, për shkak të mos shikimit të anës së kufizimit dhe të përzierjes me errësirën, kur thuhet, por, e shikuar nga ana e shfaqjes dhe e dukurisë vetjake, është shumë më afër të vërtetës, kur kjo fjalë thuhet për dritat e mbretërisë, kur shfaqja e tyre është më e plotë dhe më afër identitetit. Gjithashtu, edhe dukuria e saj është më e fuqishme si sasi e si formë, përveç përzierjes së saj me errësirën e me mangësi pak ose shumë.

E këtillë është gjendja edhe me dritat e madhësisë, shqiptimi i të cilave këtu, gjithashtu, është më afër të vërtetës, sipas argumentimit të mëparshëm, deri sa arrihet në shqiptimin e kësaj fjale për Qenien e lartë e të pastër nga mangësitë e nevojat dhe për të Cilën, ky shqiptim përfaqëson të vërtetën e thjeshtë e të pastër, sepse i Gjithëfuqishmi, Madhështori, i Larti është drita e dritave dhe plotësisht i pastër prej çdo kuptimi të errësirës. Ai është vetë drita dhe drita e pastër, madje mund të thuhet se fjala “dritë”, është vënë sipas parullës “i dukshëm me qenien e Tij dhe për të tjerët”; kurse shqiptimi i kësaj fjale për dikë tjetër dhe jo për të Vërtetin, është vetëm për mendjengushtët dhe është metaforë te



mendjehapurit, si dhe te ata që kanë arritur gradën e njohjes. Por e vërteta absolute është se kjo fjalë thuhet vetëm për të Vërtetin.

Kështu qëndron puna edhe me të gjitha fjalët e vëna për kuptimet e plotësuara, domethënë, për punët që janë prej bazave të ekzistencës e të plotësimit.

Bazuar mbi këto që u thanë, ne themi: fjalët: “الرحمن” - “Err’rrahmànu” - “**i Gjithëmëshirshmi**”, “الرحيم” - “Err’rrahijmu” - “**Mëshirëploti**”, “العطوف” - “El-atùfu” - “**i Dashuri**”, “الرؤوف” - “Err’rreùfu” - “**i Dhembshuri**” dhe të ngjashme, janë njëra anë e plotësimit dhe plotësim i drejtimit të ndikimit e mangësisë. Fjalët e mësipërme janë vënë për këtë anë të plotësimit, e cila përfaqëson origjinën e asaj të vërtetë, kurse anët ndikuese janë prej kërkesave të zhvillimit të punëve të hyra e të huaja për këtë të vërtetë, por ato punë janë të lidhura ngushtë dhe janë të përziera me ato të vërteta, pas zbritjes që ata bënë në mjediset e mundësisë dhe të diturive të kësaj bote zbritëse, siç është përzierja e errësirës me dritën në zhvillimin zbritës, pa pasur futje në kuptimin për të cilin janë vënë fjalët.

Shqiptimi i fjalës dritë për të Ekzistuarin, të Pasurin, thjesht nga ana e plotësimit të pastër prej anëve të ndikimit e mangësisë, është vetë e vërteta, është e vërteta e pastër.

Ky mendim është i afërt me shijen e atyre dijetarëve që studiojnë anën e jashtme të sendeve dhe të çështjeve (ehludh’dhàhir), përveç afërsisë me shijen e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul-maërifeh).





Bazuar mbi këtë shpjegim, është shumë e qartë se shqiptimi i cilësive të plotësimit dhe i cilësive të tjera të ngjashme, të cilat janë të përziera e të lidhura ngushtë nëpërmjet disa zhvillimeve, krahas punëve të tjera prej të cilave Qenia e pastër e të Vërtetit është krejtësisht e dëlirë, prandaj, kur fjala dritë thuhet për të Vërtetin e Gjithëfuqishëm, nuk është thënë si metaforë. Vetëm Allahu është Udhëzuesi në rrugën e drejtë.

الحمد لله - "Elhamdu lil'lâh" - **"Falënderimi është vetëm për Allahun!"**

Fjala e të Lartit "الحمد لله" - "elhamdu lil'lâhi" - **"Falënderimi është vetëm për Allahun"**, do të thotë: të gjitha llojet e falënderimeve janë të posaçme për Qenien e pastër hyjnore. Ti, i dashur, mëso se kjo frazë e nderuar ka në brendinë e vet sekretin e teuhidit (besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm), të veçantëve, madje ka sekretin e teuhidit e më të veçantëve.

E veçanta e të gjitha falënderimeve të falënderuesve për të Vërtetin e Lartësuar te të urtët dhe te prijësit e filozofisë së lartë, është çështje qartësisht e dallueshme dhe e mbështetur në argument. Është vërtetuar me argument se e gjithë shtëpia e vërtetimit është hija e shtrirë e lartësisë së të Vërtetit dhe e bujarisë së Tij të pallogaritshme, si dhe të gjitha mirësitë e dukshme e të padukshme, cilido qoftë mirësidhënësi, në këndvështrimin e masës sipas anës së jashtme të mirësive, të gjitha mirësitë janë prej të Vërtetit Fuqiplotë dhe asnjëra prej qenieve nuk merr pjesë bashkërisht me Atë, qoftë edhe "pjesëmarrje e përbashkët përgatitore", ashtu siç thonë ndjekësit e filozofisë së masës, pa folur për filozofinë e lartë.



Atëherë, kur falënderimi është për mirësinë, mirësidhenien e për bamirësinë, por në shtëpinë e vërtetimit s'ka mirësidhënës tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar, prandaj të gjitha falënderimet janë të veçanta vetëm për të Vërtetin Fuqiplotë.

Përderisa s'ka bukuri më të bukur përveç bukurisë së Tij dhe s'ka më të bukur se Ai, atëherë të gjitha falënderimet, gjithashtu, janë vetëm për Atë.

Me fjalë të tjera, ne themi: çdo falënderim e çdo lavdërim, prej cilido falënderuesi e prej cilido lavdëruesi që të kenë dalë, në të vërtetë, janë drejtuar nga ajo anë e mirësisë dhe e plotësimit, të cilat nuk e kufizon asnjë pjesë prej falënderimit e lavdërimit nga asnjëra anë për anëve të falënderimit e lavdërimit, në të kundërt, kufizimi e mohon dhe e kundërshton falënderimin e lavdërimin.

Atëherë, të gjitha falënderimet e lavdërimet i takojnë vetëm Zotit krijues, i Cili është plotësimi e bukuria, në të cilat nuk kanë pjesë të krijuarit, të cilët janë me mangësi e të kufizuar prej Tij.

Thënë me një mënyrë tjetër, lavdërimi për të Plotësuarin dhe falënderimi për Mirësidhënësin, janë prej punëve të natyrës së pastër të krijimit hyjnor, cilësi, me të cilën Ai krijoi të gjithë njerëzit, ashtu siç është prej punëve të cilësisë së pastër të krijimit edhe neveria ndaj mangësisë e ndaj mangësuesit dhe pakësuesit të mirësive. Në të vërtetë, mirësia është e pastër prej çdo turbullire dhe mangësie të bukurisë e plotësimit më të plotësuar e të pastër nga çdo mangësi, prandaj mirësia e pastër është e veçantë vetëm për të Vërtetin e Lartësuar. Në një kohë kur të gjitha qeniet, në përgjithësi, i pakësojnë mirësitë, gjithashtu, qeniet janë të kufizuara në mangësitë e bukurisë absolute, të cilat as nuk i shtojnë e as nuk



i forcojnë, prandaj cilësia e pastër e krijimit e të gjithë njerëzve është falënderimi e lavdërimi vetëm për Qenien e Tij të pastër dhe neveri prej të gjitha qenieve, me përjashtim kur qeniet shpresojnë prej Madhështorit dhe sipas ecjes së tyre nëpër mbretëritë e plotësisht dhe nëpër qytetet e dashurisë, atëherë dashuria, falënderimi e lavdërimi i tyre është esenca e dashurisë për të Vërtetin e Madhëruar dhe falënderimi e lavdërimi për Atë është “dashuri e veçantë e Allahut dhe dashuria e Allahut”.

Vlen të theksohet se kjo që kemi thënë deri tani, është brenda kuadrit të pozitive të mesatarëve, të cilët vazhdojnë të jenë nën mbulesa të shumta dhe deri tani nuk kanë shpëtuar plotësisht prej të gjitha shkallëve të idhujtarisë (shirkut) së fshehtë e prej idhujtarisë (shirkut) shumë më të fshehtë dhe kanë tjetërsuar plotësimin e gradëve të pastërtisë e të sinqeritetit.

Kur ne duam ta shpalojmë këtë çështje, ashtu siç është në përshtatje me diturinë e zotëruesve të zemrave të asgjësuar, themi: mirësitë dhe çdo plotësim e çdo bukuri në disa gjendje të veçanta janë forma të shkëlqimit personal, prandaj të gjitha falënderimet e lavdërimet kanë lidhje me Qenien e pastër të të Vërtetit të Lartësuar, për më tepër, falënderimi e lavdërimi janë prej Tij dhe për Atë.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Nuk duhet të jetë e panjohur e veçanta e çdo falënderimi, ose e çdo lloj falënderimi. Nga ana e analizës gjuhësore, sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, kuptimi qëndron në dy mundësi në shkronjën e parë “e” dhe në shkronjën e dytë “l” të fjalës “**falënderim**” - “*el hamd*”, që kundërshton shkakësorin, edhe nëse është në kuptimin më të hollë, prandaj nuk është e mundur që kërkesa të drejtohet ndryshe nga gjuha e Kur’anit dhe e diturisë së eulijave të Allahut. (autori)



Këto janë ato që theksohen për lidhjen e “بِسْمِ اللَّهِ...” – “*bismil'lâhi...*” – “**me emrin e Allahut...**” me “الْحَمْدُ لِلَّهِ” – “*elhamdu lil'lâhi*” – “**Falënderimi është vetëm për Allahun**”, por ti duhet të dish se për rrugëtarin për te Allahu dhe për luftëtarin në rrugën e Tij, mbetet detyrë që ata nuk duhet të kënaqen me njohuritë që kanë për këto dituri dhe ta kalojnë të gjithë jetën e tyre vetëm në kërkimin e argumenteve, punë që numërohet një mbulesë, madje mbulesa më e madhe. Por kjo etapë nuk mund të kalohet me këmbë druri<sup>1</sup>, madje nuk mund të kalohet as me shpendin e Sulejmanit<sup>2</sup>, sepse ajo është lugina e njerëzve të pastër, është etapa e njerëzve të lirë dhe, derisa nuk është hequr këpuca e dashurisë për jetën, për nderet, gruan e fëmijët dhe ai e hedh shkopin mbi të cilin mbështetet e orientohet kah tjetri me dorën e djathtë, ky njeri s’ka mundësi të bëjë përpara as edhe një hap të vetëm në këtë luginë të pastër, e cila është vendi i të sinqertëve dhe banesa e të pastërve.

Sikur rrugëtari për te Allahu të afrohet në këtë luginë me të vërtetat e sinqeritetit, duke iu larguar shumicave dhe kësaj bote, e cila është shqetësim në iluzion, atëherë ndihma për atë do të arrijë prej botës së panjohur. Gjithashtu, kur mbetjet e egoizmit të ai kanë mbetur prapa, atëherë edhe mali i të “tashmes” do të thërrmohet me shkëlqimet hyjnore, për rrjedhojë atë e mbulon një gjendje “humbje ndjenjash” dhe “asgjësimi”.

---

<sup>1</sup> Fjalë e një poezie, e poetit Xhelaludin Rumi, përkthimi i të cilave është: “këmba e mëkuesëve të argumentit është prej druri dhe këmba e drurit është e pafuqishme”.

<sup>2</sup> Fjalë e një poezie, e poetit Hafiz Shirazi, përkthimi i të cilave është: “unë kurrë nuk e kam arritur pozitën e të përqaftuarve, por iu futa shtegut, së bashku me shpendin e Sulejmanit”.



Për sa u përket zemërngurtëve, atyre që s'kanë shqetësim tjetër përveç arritjes së kësaj bote dhe hapat e saj, si dhe atyre që nuk kanë zakon tjetër e nuk dinë gjë tjetër përveç mashtrimit djallëzor, këto pozita janë të atilla që kurrë nuk kapërdihen lehtë, sepse kanë lidhje vetëm me fjalë të kota. Në këtë gjendje, asgjësimi ynë në natyrën dhe në këtë botë, si dhe shkujdesja jonë e plotë ndaj të gjitha botëve të panjohura, megjithëse ato janë kaq shumë të dukshme nga të gjitha anët dhe bazuar mbi të gjitha konsideratat, madje shkujdesja jonë arrin deri aty, sa të mos shfaqin interes as ndaj Qenies e as ndaj cilësive të të Vërtetit të Lartësuar, i Cili, me veten e Tij, është kaq i dukshëm, duke shtuar këtu edhe këmbënguljen tonë për t'u kapur pas bishtave të argumenteve dhe nxjerrjes së argumenteve, për të vërtetuar ekzistencën e atyre botëve, deri edhe ekzistencën e Qenies së pastër të të Vërtetit të Lartësuar, të gjitha këto janë shumë të huaja e shumë të çuditshme me gradët e asgjësimit, që pretendojnë dijetarët dhe rrugëtarët për te Allahu.

*"Mpirje në gjendje të vështirë, tregimet flasin përçarë.*

*Si do t'i mbulojë të veçantët prej memecit?!"<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e vargjeve e një poeme, e poetit Xhelaludin Rumi. Në këtë poemë, autori tregon ndodhinë, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kërkoi Xhibrilit, që t'i shfaqej në formën e tij të vërtetë. Pasi Xhibrili iu shfaq në formën e tij të vërtetë, figura e tij mbushi lindjen e perëndimin dhe të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i ra të fikët. Këto vargje kanë ardhur në disa kopje të divanit të poetit, në të cilin fjala "memec" është shkruar me shkronjën "s" të fortë, por imami (*Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!*) i është mënjeluar këtij lloj shkrimi dhe ka anuar nga shkrimi i fjalës "memec" me shkronjën "s" të butë, duke pasur parasysh se të dyja fjalët, me "s" të butë dhe me "s" të fortë, në gjuhën perse, kanë të njëjtin, kuptim siç e kanë edhe në gjuhën arabe. (përkthyesi)



Padyshim që fjala e fundit e vargut “memec”, sipas rregullave të shkrimit të gjuhës arabe, rezulton: sikur shkronja “s” në fjalën “memec” në gjuhën arabe “اخرس” – “akhres” të ishte shkruar me një “s” të fortë, në gjuhën arabe me shkronjën “ص” – “sad”, kuptimi do të ishte: pretenduesit e kësaj mase të mpirjes e të deziluzionit, atëherë dhe asgjësimi i të mangëtimit në të plotësuarin është diçka natyrale dhe në përputhje me rrugën hyjnore, në një kohë që humbja e ndjenjave dhe asgjësimi në zbritjen është i vërtetuar te të gjithë. Por, në të vërtetë, dëgjimi e shikimi ynë janë mbuluar e janë asgjësuar në botën e natyrës, përderisa nuk jemi në gjendje të mos e dëgjojmë këtë gjësim, që na vjen prej botës së panjohur.



## Citim dhe hulumtim

Mësoje se gjuhëtarët dhe dijetarët që studiojnë vetëm anën e jashtme të çështjeve e të sendeve (dhähiri), thonë se fjala *“el hamdu”* është lavdërim vullnetar me gjuhë për të Bukurin. Gjithashtu, fjalën *“el hamdu”*, ata e kanë shpjeguar me dëlirjen e të Vërtetit të Lartësuar prej mangësive e prej nevojave (tesbijh) dhe me falënderimin për Atë’ ose fjala *“el hamdu”* është shqiptimi i fjalës së Madhështorit, në një lloj metafore, për shkak të shkujdesjes së njerëzve, përveç lakimit që bën organi i gjuhës, e cila e përcjell nga njëra gjuhë në tjetrën. Gjithashtu, fjalët *“dëlirje nga mangësitë e nevojat (tesbijh)”* dhe *“falënderim”* – *“el hamdu”* të qenieve, ata e kanë bartur në një lloj metafore, sepse e llogarisin që e folura, në raport me të Vërtetin e Lartësuar, shpreh bërjen e fjalës, kurse te qeniet e tjera fjala *“el hamdu”* shpreh dëlirjen prej mangësive e nevojave dhe falënderimin e lavdërimin personal gjenetik.

Në të vërtetë, ata e reduktojnë shqiptimin e fjalës *“el hamdu”* me mënyrën e tyre, ngaqë hamendësojnë se Qenia e pastër e të Vërtetit të Lartësuar dhe të gjitha qeniet e tjera nuk flasin, madje, ata thonë se të gjitha qeniet janë plotësisht të heshtura. Ata përfytyrojnë se në këtë heshtje të plotë ka një dëlirje të Qenies së pastër, në një kohë që ky mendim i tyre është kufizim e gabim i madh. I Vërteti i Lartësuar është i pastër dhe s’ka nevojë për këtë pastrim të tyre. Veç kësaj, edhe pastrimet e masës së njerëzve, në pjesën më të madhe, janë kufizim e përngjasim. Më sipër, pamë mënyrën e vënies së fjalëve për kuptime të përgjithshme, të



pakushtëzuara, prandaj këtu shtojmë: Ne jemi kufizues deri në atë cak sa të jetë detyrim arritja e vërtetimit gjuhësor, ose e të vërtetës gjuhësore, në lidhje me të vërtetat hyjnore, sepse saktësia e shqiptimit dhe e vërteta logjike është kriteri në këto studime, edhe nëse e vërteta gjuhësore është plotësisht e vërtetuar, ashtu siç e thamë në studimin e mëparshëm. Prandaj themi: gjuha, të folurit, fjala, shkrimi, libri, falënderimi e lavdërimi janë me gradë, që ndryshojnë me ndryshimin e zhvillimeve ekzistenciale. Çdonjëra prej këtyre gradëve është në përshtatje me njërin zhvillim prej zhvillimeve, ose me njëren gradë prej gradëve të ekzistencës.

Meqenëse fjala *“el hamdu”* – *“falënderim”* thuhet për një gjë të bukur, atëherë edhe fjala *“thenàë”* – *“lavdërim”* thuhet për një bukuri të caktuar e për një plotësim të caktuar, atëherë i Vërteti i Lartësuar, padyshim, që ka parë bukurinë e Tij mahnitëse, sipas diturisë së Tij personale në prezencën e panjohur të identitetit dhe plotësohet me gradët e diturisë e të dëshmisë, gëzohet me personin e Tij të bukur, në gradët më të fuqishme të gëzimit. Ai shkëlqen për veten e Tij, me shkëlqimin e përjetshëm, në gradët më të larta të shkëlqimeve. Ky shkëlqim, shfaqja në brendësinë e panjohur dhe ndeshja personale është *“fjala personale”*, që ndodh me gjuhën personale në prezencën e panjohur. Gjithashtu, edhe shikimi i këtij shkëlqimi është *“dëgjimi personal”*<sup>1</sup>, që është lavdërimi i Qenies së pastër për

---

<sup>1</sup>Fjala jonë *“i gëzuar me personin e Tij”*, në asnjë mënyrë nuk duhet ta shtyjë lexuesin të arrijë deri aty sa të lëshojë fjalën *“gëzim”* për të Vërtetin e Lartësuar. Kështu qëndron puna edhe me fjalët *“i dashuruar”*, *“dashuri”* dhe të tjera fjalë të ngjashme, që, në vetvete, kanë një lloj kufizimi, ndodhie, emocioni e mundësie, sipas kuptimeve të përgjithshme, të njohura të këtyre fjalëve, sepse ato janë fjalë të vëna, që shprehin thjesht kuptimet dhe lëshimi i këtyre fjalëve për të Vërtetin e Lartësuar është në kuptimin: i Buti, i Dashuri, i Gjithëmëshirshmi dhe fjalë të tjera të ngjashme. Kjo kërkesë nuk është nga ato punë që zënë vend në mendjet e njerëzve të zakonshëm, prandaj ata kanë nevojë për një studim filozofik të imët





personin e të Vërtetit, por të gjitha qeniet e kanë të pamundur ta kuptojnë këtë lavdërim. Ja, Vula e profetëve, me qenien e tij të pastër, më i nderuari dhe më i afërmi i të gjitha krijesave të Vërteti i Lartësuar, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e pohon këtë pamundësi dhe thotë: “Nuk i numëroj dot lavdërimet për Ty! Ti je ashtu siç e ke lavdëruar veten Tënde!”<sup>1</sup> Frazja: “nuk i numëroj dot lavdërimet”, është njëra degë prej degëve të njohjes me plotësimin e me bukurinë, sepse lavdërimi i vërtetë nuk realizohet, deri sa nuk është arritur njohja e plotë me bukurinë absolute. Qëllimi më i lartë i diturisë të ata që kanë arritur gradën e njohjes, është pohimi i pamundësisë.

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se i Vërteti i Lartësuar e falënderon dhe e lavdëron Vetën me pesë gjuhët, që janë: gjuha e personit, në kuptimin se ajo është gjuha unike e panjohur, gjuha e Njëshit përmbledhës, gjuha unike, gjuha e emrave të shkoqitur dhe gjuha e personaliteteve.

Por kjo nuk është gjuha e shfaqjes, që filloi me gjuhën e dëshirës dhe arrin në gjuhën e shumicës ekzistenciale, gjuhë e cila përfaqëson një gjuhë tjetër në gradët e cilësive.

Ti duhet të dish se të gjitha qeniet kanë pjesën e tyre prej botës së panjohur, madje kanë disa pjesë prej asaj bote dhe kjo është vetë jeta, si pjesë prej jetës qarkulluese në të gjitha anët e ekzistencës. Kjo është një punë e vërtetuar me argument të krerët e

---

e për një estetikë njohëse të ndezur. Allahu na e mundësoftë këtë ne dhe ju të gjithëve! (autori)

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 5; “Avàlij El’leàlij”, vëll. 1, f. 389.



filozofisë së lartë, kurse te zotëruesit e zemrave vërtetohet me shikimin me sy.

Edhe ajetet hyjnore fisnike, si dhe njoftimet e eulijave të revelatës tregojnë për këtë të vërtetë në mënyrë të plotë, por të mbuluarit prej filozofisë së përgjithshme dhe dijetarët që studiojnë vetëm anën e jashtme të punëve e të sendeve, besojnë në fjalën e qenieve, madje janë mbështetur në interpretimin e në orientimin e kësaj fjale.

Është e çuditshme se dijetarët që studiojnë vetëm anën e jashtme të punëve, megjithëse nuk i dënojnë filozofët për interpretimin e tyre të Librit të Allahut sipas mendjes së tyre, edhe ata vetë bëjnë të njëjtën gjë me interpretimin e të gjitha këtyre ajeteve të qarta dhe haditheve të vërtetuara për saktësinë e origjinalitetit, thjesht, ngaqë nuk e kuptojnë të folurën e qenieve, megjithëse për këtë nuk disponojnë asnjë argument. Janë pikërisht këta që e interpretojnë Kur'anin Famëlartë pa asnjë argument, thjesht, nga moslargimi.

Në përgjithësi, bota e ekzistencës është origjina e jetës, është origjina e të vërtetës së diturisë e të ndjenjave. Por edhe “tesbijhu” - “pastrimi nga të metat e nga nevojat”, që bëjnë qeniet, është “tesbijh”, fjalësor, ndjenjësor dhe i vullnetshëm dhe nuk është struktural personal, siç thonë të mbuluarit. Për të gjitha qeniet, sipas pjesës që ka secila në ekzistencë, janë të njohura me pozitën e Krijuesit të Madhëruar, por njeriu është qenia që shqetësohet më shumë për natyrën, prandaj ai është i zhytur në shumicën, në tjetërsimin dhe mbështetet në shikimin e bukurisë më të bukur, pa mbulesë. Në këtë cak, falënderimi e lavdërimi i tij do të jenë më përgjithësues se të gjitha falënderimet e lavdërimet dhe ai shumë



shpejt do të lavdërojë të Vërtetin e Lartësuar e do ta adhurojë Atë me të gjitha punët hyjnore, me të gjitha emrat e me të gjitha cilësitë.



## Plotësim

Mësoje se fraza “الحمد لله” – “*elhamdu lil'lâhi*” – “**Falënderimi është vetëm për Allahun!**”, është prej frazave përgjithësuese, ashtu siç e shpjeguem. Sikur një person ta falënderojë të Vërtetin e Lartësuar me frazën “*el hamdu lil'lâh*”, kjo frazë përfshin të gjitha butësitë e të vërtetat e saj dhe ai e ka plotësuar të drejtën që i takon falënderimit në atë masë që ka mundësi të mbajë fuqia njerëzore. Hadithet e nderuara e theksojnë këtë kuptim. Transmetohet se Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) doli nga shtëpia dhe nuk e gjeti kafshën, që të hipte mbi të, prandaj tha: “*Sikur Allahu i Lartësuar të ma kthejë kafshën, patjetër që unë do ta falënderoja me falënderime të atilla, nga të cilat Ai do të mbetet i kënaqur*”. Vazhdoi ta falënderojë, deri sa kafsha erdhi. Kur ai u rehatua mbi kafshën dhe, pasi vuri edhe teshat e veta mbi të, tha: “*El hamdu lil'lâhi!*”<sup>1</sup>

Transmetohet se i Dërguari më i nderuar, (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka thënë: “*Là ilâhe il'lell'llâh' është gjysma e peshores dhe fraza 'el hamdu lil'lâhi' e plotëson atë*”.<sup>2</sup> Shkaku për këtë është se fraza “*El hamdu lil'lâhi*” përfshin, gjithashtu, edhe besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid).

---

<sup>1</sup>“Mustedrekul-Vesàili”, “Kitàbu-S’salàti”, K. “Përmendja e Allahut (dhikri)”, Çështja “Është veprim i pëlqyer të thuhet sa më shumë (*el hamdu lil'lâh*), kur shfaqen mirësitë”, Hadithi 18, me pak ndryshime.

<sup>2</sup>“Mustedrekul-Vesàili”, “Kitàbu-S’salàti”, K. “Përmendja e Allahut (dhikri)”, Çështja “Është veprim i pëlqyer të thuhet sa më shumë (*el hamdu lil'lâh*), kur shfaqen mirësitë”, Hadithi 1.



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fjala e robit ‘el hamdu lil’lâhi’, në peshoren e tij peshon më shumë se shtatë qiej e shtatë toka”.<sup>1</sup>

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Sikur Allahu t’i japë të gjithë botën njërit prej robëve të Vet dhe robi thotë ‘el hamdu lil’lâhi’, ajo që i vjen robit, patjetër që do të jetë shumë më e mirë nga ajo që iu dha”.<sup>2</sup>

Në një situatë tjetër, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “S’ka asnjë send më të dashur te Allahu se fjala ‘el hamdu lil’lâhi’, që thotë dikush, pasi me këtë frazë ka lavdëruar veten e Tij”.<sup>3</sup>

Hadithet që flasin për këtë çështje, janë të shumta.

### “رب العالمين” - Zoti i botëve

Fjala e Allahut të Lartësuar “رب العالمين” - “Rab’bil-àlemije” - “Zoti i botëve”, kur fjala “رب” - “Rab’bun” - “Zot” është në kuptimin “المتعالى” - “El muteàlij” - “i Gjithëhartësuar”, ose “الثابت” - “Eth’t’hàbitu” - “i Qëndrueshmi” dhe “السيد” - “Es’sej’jid” - “Zotëria”, të gjitha këto janë prej emrave të Personit.

<sup>1</sup>Mustedrekul-Vesàili”, “Kitàbu-S’ salàti’, K. “Përmendja e Allahut (dhikri)”, Çështja “Është veprim i pëlqyer të thuhet sa më shumë (el hamdu lil’lâh), kur shfaqen mirësitë”, Hadithi 26.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 24.

<sup>3</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 31.



Nëse fjala “رب” - “Rab’bun” - “Zot” është në kuptimin: “المالك” - “El mālīku” - “Sunduesi”, ose “الصاحب” - “Es’sāhibu” - “Shoqëruesi”, ose “الغالب” - “El gālību” - “Mbisunduesi”, ose “القاهر” - “El kāhiru” - “Mposhtësi”, këto janë prej emrave të cilësive.

Nëse fjala “رب” - “Rab’bun” - “Zot” është në kuptimin: “المربي” - “El mureb’bij” - “Edukuesi”, ose “المنعم” - “El mun’imu” - “Mirësidhënësi”, ose “المتيم” - “El mutim’mu” - “Plotësuesi”, këto janë prej emrave të punëve.

Por, kur fjala “العالم” - “el àlem” - “bota” është në kuptimin: “çdo gjë përveç Allahut”, kjo i përfshin të gjitha gradët e ekzistencës dhe të gjitha pozitat e padukshme e të dukshme. Bazuar mbi këtë shpjegim, fjala “رب” - “Rab’bun” - “Zot”, duhet konsideruar prej emrave të cilësive.

Kur qëllimi i përdorimit i fjalës “العالم” - “el àlem” - “bota”, është “bota e mbretërisë”, që dalëngadalë arrihet plotësimi, atëherë qëllimi i fjalës “رب” - “Rab’bun” - “Zot”, është emri i punës.

Në të gjitha gjendjet, qëllimi i përdorimit, këtu, është të tregojë “emrin e Personit”.

Mbase qëllimi i përdorimit i fjalës “رب” - “Rab’bun” - “Zot”, bazuar në faktin se fjala “العالمين” - “el àlemijn” - “botët”, është në kuptimin: botët e mbretërimit, që e arrijnë plotësimin e përshtatshëm, nën edukimin e sistemimin hyjnor, ku “رب” - “Rab’bun” - “Zot” është Edukuesi, prandaj këtu emri “رب” - “Rab’bun” - “Zot” është prej emrave që tregojnë punë.



Këtu duhet të theksohet se në këtë kumtesë nuk po flasim për anët përbërëse gjuhësore dhe letrare të ajeteve të nderuara, pasi me këtë punë janë marrë shpesh burra të tjerë, prandaj ne këtu përmendim vetëm atë çka nuk është përmendur fare, ose është përmendur në mënyrë të cunguar.

Duhet të dihet se ndarja e emrave të bukur të Allahut në emra “të personit”, “cilësive” dhe “punëve”, ashtu siç u tha më sipër, është në përputhje me terminologjinë që kanë vënë krerët e dijetarëve.

Disa shehë, ata që kanë arritur gradën e njohjes, kanë sjellë në librin “Inshàu-d’devàir” një ndarje të emrave, në: emra të personit, emra të cilësive dhe emra të punëve, si vijon:

Emrat e Personit janë: “هو الله” - “huvell’llàhu” - “Ai është Allahu”; “الرب” - “Err’rrab’bu” - “Zoti”; “الملك” - “El meliku” - “Sunduesi”; “القدوس” - “El kud’dûsu” - “i Pastërti”; “السلام” - “Es’selàmu” - “Paqëdhënësi”; “المؤمن” - “El muëminu” - “Siguruesi”; “المعجمن” - “El muhejminu” - “Mbizotëruesi”; “العزیز” - “El azijzu” - “Fuqiploti”; “الجبار” - “El xheb’bàru” - “i Gjithëfuqishmi”; “المتكبر” - “El mutekeb’biru” - “i Madhërishmi”; “العلی” - “El alij’ju” - “i Larti”; “العظیم” - “El adhijmu” - “Madhështori”; “الظاهر” - “Edh’dhàhiru” - “i Dukshmi (me krijimin)”; “الباطن” - “El bätinu” - “i Padukshmi”; “الاول” - “El ev’velu” - “i Pari (pa fillim)”; “الآخر” - “El àkhiru” - “i Fundit (pa mbarim)”; “الکبير” - “El kebijru” - “i Madhi”; “الجليل” - “El xhelijlu” - “Fisniku”; “المجيد” - “El mexhijdu” - “i Lavdishmi”; “الحق” - “El hak’ku” - “i Vërteti”; “المبين” - “El mubijnu” - “i Qarti”; “الواحد” - “El uàhidu” - “Njëshi”; “الماجد” - “El màxhidu” - “i Lavdëruari”; “الصمد” - “Es’samedu” - “i



Qëndrueshmi"; "المتعالى" - "El muteàlij" - "i Gjithëlartësuar"; "الغنى" - "El ganij'ju" - "i Pasuri"; "النور" - "En'nùru" "Dritë"; "الوارث" - "El uàrithu" - "Trashëguesi"; "ذوالجلال" - "Dhul xhelàli" - "Atij i takon madhështia"; "الرقيب" - "Err'rrekijbu" - "Vëzhguesi".

Emrat e cilësive janë: "الحى" - "El haj'ju" - "i Gjalli"; "الشکور" - "Esh'shekùru" "Mirënjohësi"; "القهار" - "El kah'hàru" - "Ngadhënjimtari"; "القاهر" - "El kàhiru" - "Mposhtësi"; "المقتدر" - "El muktediru" - "i Afti"; "القوى" - "El kauij'ju" - "i Forti"; "القادر" - "El kàdiru" - "i Fuqishmi"; "الرحمن" - "Err'rrahmànu" - "i Gjithëmëshirshmi"; "الرحيم" - "Err'rrahijmë" - "Mëshirëploti"; "الکریم" - "El kerijmu" - "Bujari"; "العقار" - "El gaffàru" - "Falësi"; "الغفور" - "El gafùru" - "Gjithëfalësi"; "الودود" - "El uedùdu" - "i Dashuri"; "الرووف" - "Err'rreùfu" - "i Dhembshuri"; "الحليم" - "El halijmu" - "i Buti"; "الصبور" - "Es'sabùru" - "Duruesi"; "البر" - "El berr'rru" - "Mirësidhënësi"; "العليم" - "El alijmu" - "i Gjithëdituri"; "الخبير" - "El khabijru" - "i Gjithinformuari"; "المحصى" - "El muhsij" - "Gjithënjohësi"; "الحکيم" - "El hakijmu" - "i Urti"; "الشهيد" - "Esh'shehijdu" - "Dëshmuesi"; "السميع" - "Es'semij'u" - "Gjithëdëgjuesi"; "البصير" - "El besijru" - "Gjithëshikuesi".

Emrat e punëve janë: "المبدئ" - "El mubdiu" - "Filluesi"; "الوكيل" - "El uekijlu" - "Përkujdesësi"; "الباعث" - "El bàithu" - "Ringjallësi"; "المجيب" - "El muxhijbu" - "Lutjepranuesi"; "الواسع" - "El uàsiu" - "Gjithëpërfshirësi"; "الحسب" - "El hasijbu" - "Llogarimarrësi"; "المقبت" - "El mukijtu" - "Ushqyesi"; "الحفيظ" - "El hafijdu" - "Ruajtësi";





“الخالق” - “El khàliku” - “Krijuesi”; “البارئ” - “El bàriu” - “Krijuesi (nga e para)”; “المصوّر” - “El musau’uiru” - “Formëdhënësi”; “الوهاب” - “El ueh’hàbu” - “Dhuruesi”; “الرزاق” - “Err’rrez’zàku” - “Furnizuesi (i të gjitha qenieve)”; “الفتاح” - “El fet’tàhu” - “Zgjidhësi (i çështjeve)”; “القابض” - “El kàbidu” - “Shtrënguesi”; “الباسط” - “El bàsitu” - “Gjithëdhënësi”; “الخافض” - “El khàfidu” - “Përlësi”; “الرافع” - “Err’rràfiu” - “Lartësuesi”; “المعزّ” - “El muiz’zu” - “Ngritësi”; “المذلّ” - “El mudhil’lu” - “Ulësi”; “الحكيم” - “El hakijmu” - “i Urti”; “العدول” - “El adùlu” - “Drejtësidhënësi”; “اللّطيف” - “El letijfu” - “i Buti”; “المعيد” - “El muijdu” - “Rikrijuesi”; “الهيحي” - “El muhijj” - “Jetëdhënësi”; “المميت” - “El mumijtu” - “Jetëmarrësi”; “الوالى” - “El uàlij” - “Udhëheqësi”; “التّوّاب” - “Et’teu’uàbu” - “Pendimpranuesi”; “المنتقم” - “El muntekimu” - “Ndëshkuesi (i të padrejtëve)”; “المقسط” - “El muksitu” - “Drejtësidhënësi”; “الجامع” - “El xhàmiu” - “Mbledhësi (i krijesave)”; “المغنى” - “El mugnij” - “Pasuridhënësi”; “المانع” - “El màniu” - “Privuesi”; “الضّارّ” - “Ed’dàrr’rru” - “Krijuesi i dëmit”; “النافع” - “En’nàfiu” - “Krijuesi i të mirës”; “الهادى” - “El hàdij” - “Udhëzuesi”; “البديع” - “El bedij’u” - “Shpikësi (nga asgjëja)”; “الرشيد” - “Err’rreshijdu” - “Frymëzuesi”.<sup>1</sup>

Në lidhje me kriterin e kësaj ndarjeje, thuhet: emrat e grupit të parë janë emërtuar emra të Personit, ngaqë shfaqin Personin dhe quhen emra të cilësive e të punëve, ngaqë shfaqin cilësitë e punët.

<sup>1</sup>Ibn Arebij, “Inshàu-d’ devàiri”, f. 28.



Domethënë: emri ndjek tiparin, që është më i dukshëm, prandaj ndodh që në disa emra të jenë bashkë dy ose më shumë tipare, për rrjedhojë, një emër mund të jetë emër personi, emër cilësie dhe emër pune, ose mund të jetë i të dy llojeve, ashtu siç u tha më sipër, për gjendjen e emrit “الربُّ” - “Err’rrab’bu” - “Zoti”.

Personalisht, kjo ndarje, nuk më duket e drejtë. Ky mendim nuk është në përputhje me shijen e njohjes. Ajo që mund të thuhet, në lidhje me këtë ndarje, është: kriteri i ndarjes së këtyre emrave bazohet në bërjen realitet të punëve sipas masës së diturisë e njohjes që ka rrugëtari. I Vërteti i Lartësuar shumë shpejt do të shkëlqejë në zemrën e tij me shkëlqimet e emrave të punëve.

Gjithashtu, pas shkrirjes me cilësitë, i Vërteti i Lartësuar shumë shpejt do të shkëlqejë për atë me shkëlqimet e cilësive.

Po kështu, i Vërteti i Lartësuar shumë shpejt do të shkëlqejë te ai me shkëlqimet e emrave personalë, pas shkrirjes me personin.

Nëse zemra e tij është e fuqishme që të ruajë në kujtesë, informacioni që ajo zemër do të marrë, pas zgjimit prej pamjeve të punëve, janë pikërisht emrat e punëve, kurse informacioni që do të marrë prej pamjeve të cilësive, janë vetë emrat e cilësive; e njëjta gjendje është edhe me emrat e personit. Hollësitë për këtë çështje dalin jashtë kuadrit të kësaj kumtese dhe këto faqe janë të ngushta për t’i trajtuar këtu.

Ne kemi mundësi të themi: ajo që është përmendur në librin “Inshàu-d’devàiri” nuk është e saktë. Këtë e themi duke u bazuar mbi të njëjtin kriter që ka vënë vetë autori i librit në fjalë. Veç kësaj, kjo shpjegohet qartë edhe nëpërmjet vështrimit të vëmendshëm të emrave.



Mund të thuhet se Kur'ani Famëlartë e ka theksuar qartë këtë ndarje të emrave në “tri kategori”, në ajetet e fundit të sures së “El Hashr”, në të cilat, Allahu i Lartësuar thotë:

“هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۖ عَالِمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ ۚ هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ” ...

- “Huve-ll'lähu-l'ledhij lâ ilâhe il'lâ huve, àlimul-gajbi uesh'shehâdeti, huve-rr'rrahmânu-rr'rrahijmu” –“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti”.<sup>1</sup>

Duket që ajeti 22 tregon emrat e personit, ajeti 23 tregon emrat e cilësive dhe ajeti 24 tregon emrat e punëve.

Vënia përpara e emrave të personit, pastaj emrat e cilësive dhe pastaj emrat e punëve, në të vërtetë, kjo renditje është sipas të vërtetave të ekzistencës e të shkëlqimeve hyjnore dhe nuk është as sipas renditjes së pamjeve të atyre që dinë të vështrojnë dhe as sipas shkëlqimeve të arritura në zemrat e krerëve të zotëruesve të zemrave.

<sup>1</sup>Sure “El Hashr”, ajetet 22-24.



Meriton të theksohet se në këto ajete të nderura ka edhe sekrete të tjera, por këtu nuk është vendi i përshtatshëm të përmenden.

Ajeti i parafundit i sures së lartpërmendur tregon për emrat e cilësive dhe ajeti i fundit tregon për emrat e punëve, kjo është fare e qartë.

Për sa i përket faktit që emrat e përmendur në ajetin e sipërm: “عالم الغيب والشهادة” - “*Àlimul-gajbi uesh’shehàdeti*” - “**Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes**”, “الرحمن” - “*Err’rrahmànu*” - “**iGjithëmëshirshmi**” dhe “الرحيم” - “*Err’rrahijmu*” - “**Mëshirëploti**”, janë emra të personit dhe, kjo bazuar te fakti se fjalët “**së dukshmes**” e “**të padukshmes**” shprehin emrat e brendshëm e të jashtëm; gjithashtu, edhe mëshira “gjithëpërfshirëse” dhe mëshira “e plotë” janë prej shkëlqimeve të “bujarisë më të pastër” dhe jo prej shkëlqimeve të “bujarisë së pastër”.

Këta emra janë veçuar për dhikrin, megjithëse emrat: “الحَيُّ” - “*El haj’ju*” - “i Gjalli”, “الباعثُ” - “*El bàithu*” - “Ringjallësi”, “الرَّبُّ” - “*Err’rrab’bu*” - “Zoti” dhe emra të tjerë të ngjashëm, duken se janë më afër emrave të personit dhe ka mundësi që kanë dalë prej gjithëpërfshirjes së tyre dhe ngaqë janë konsideruar gurra e emrave.

Vetëm Allahu e di më mirë!



## Vërejtje

Për togfjalëshin “رب العالمين” - “*rab'bil àlemijne*” - “**Zoti i botëve**” ka mendime të ndryshme për mënyrën e interpretimit, rrënjën nga është marrë dhe për kuptimin e saj.

Disa kanë thënë se fjala “botë” është në numrin shumës dhe përfshin të gjitha llojet lëndore e abstrakte të krijimit dhe se çdo lloj, në vetvete, përfaqëson një “botë” më vete. Ky shumës s’ka njëjës prej llojit të vet. Kjo është fjala më e përhapur dhe më e njohur.

Të tjerë kanë thënë se fjala “العالم” - “*el àlem*” - “bota”, nëse shkronja “l” e kësaj fjale lexohet me zanoren “e”, pra “le”, sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, është “*ismi mef’ûl*” (emër mbi të cilin është vepruar) dhe, nëse shkronja “l” lexohet me zanoren “i”, pra “العالم” - “*el àlimu*” - “dijetari”, gjithnjë sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, është “*ismi fail*” (emër veprues), për rrjedhojë fjala “العالمين” - “*el àlemijne*” - “botët” është në kuptimin “المعلمين” - “*el mèlùmijne*” - “të njohurit”. Por kjo mënyrë interpretimi jo vetëm që është larg kuptimit të vërtetë, por i mungojnë edhe dëshmitarët, sepse të përshkruhet i Vërteti me fjalën “رب المعلمين” - “*rab'bul maèlùmijne*” - “Zoti i të njohurve”, është tepër e ftohtë dhe nuk mund të jetë në këtë vend.

Të tjerë janë nisur nga fakti se kjo fjalë është marrë nga rrënja “العلامة” - “*el àlâmetu*” - “shenjë” dhe në këtë gjendje, kjo fjalë thuhet për të gjitha qeniet, sepse të gjitha qeniet janë shenja, argumente e



gjurmë të Qenies së pastër. Gjithashtu, sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, përdorimi i shkronjës “و” – “v” dhe i shkronjës “ن” – “n”, në fjalën “المعلومين” – “el maëlùmijne” – “të njohurit” tregon qeniet me logjikë dhe epërsinë e këtyre qenieve mbi të gjitha qeniet e tjera.

Disa të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është marrë prej rrënjës “العلم” – “el ilmu” – “dituri”. Në të gjitha gjendjet, kjo fjalë thuhet për të gjitha qeniet dhe patjetër që për qeniet me logjikë lëshimi i kësaj fjalë është me më shumë autoritet.

Njëjësi i fjalës “العالم” – “el àlemu” – “bota” thuhet për çdo gjë, përveç Allahut, madje herë-herë thuhet për çdo lloj e për çdo individ. Kur kjo fjalë thuhet prej ndjekësve të traditës dhe prej gjuhëtarëve, thuhet duke vënë në konsideratë se çdo individ është një shenjë që tregon Personin e Filluesit të çdo krijese: “për Atë në çdo send ka një shenjë”.<sup>1</sup>

Kur thënësi i kësaj fjalë është individ që ka njohuri hyjnore, fjala është thënë në kuptimin që çdo qenie është shfaqje e emrit universal, që përfshin të gjitha të vërtetat me rrugën e shfaqjes së Njëshit të shumësit dhe sekretit të ekzistencës.

Bazuar mbi këto shpjegime, e gjithë bota dhe çdo pjesëz e pjesëve të botës është emri më i madh (el ismul aëdham) dhe “të gjithë emrat janë në çdo send, po kështu edhe shenjat”.

Bazuar mbi ato që u thanë më sipër, problemi i filozofit të madh, kreu i popullit e i fesë, është një problem i ardhur sipas të

---

<sup>1</sup> “Dhe në çdo send për Atë ka një shenjë, që tregon se ai është Një”, -Vargjet e një poezie e poetit Ebù El-Atàhijeh; lexo librin “Keshful-Esràr”, vëll. 1, f. 436.



ngjashmëve me Bejdâvij'jin, të cilët kanë pirë prej vrullit të shpërthimit të kësaj pije.

Por në rrugën e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, problemi nuk është i saktë. Ne këtu nuk cituam në tërësi as fjalët e Bejdavij'jit e as fjalët e filozofit, prandaj ai që dëshiron të dijë më shumë, le të lexojë tefsirin e sures "El Fàtiha", shkruar prej të ndjerit filozof.

Kur emri "الرَّبُّ" - "Err'rrab'bu" - "Zoti" është në kuptimin "المَالِكُ" - "El mālīku" - "Sunduesi", "الصَّاحِبُ" - "Es'sāhibu" - "Shoqëruesi" dhe me emra të tjerë të ngjashëm, ka mundësi që qëllimi i përdorimit të fjalës "العَالَمِينَ" - "el àlemijne" - "botët", të jetë: gjithçka, përveç Allahut, në mënyrë të barabartë, si për qeniet e botës së lëndore, ashtu edhe për qeniet e panjohura abstrakte.

Kur emri "الرَّبُّ" - "Err'rrab'bu" - "Zoti", është prej emrave të punëve - dhe kjo është më e dukshme, atëherë qëllimi i përdorimit i fjalës "العَالَمِينَ" - "el àlemijne" - "botët" është të tregojë vetëm botën lëndore, sepse në këtë gjendje, fjala "الرَّبُّ" - "Err'rrab'bu" - "Zoti", është në kuptimin "المُرَبِّي" - "El mureb'bij" - "Edukuesi". Ky kuptim kërkon zhvillimin gradual, por botët abstrakte janë të pastra nga shkallëzimi kohor, pavarësisht se unë mendoj se "ngritja e shpirtit" është i realizuar në një anë tjetër në "botën e kohës".

Me këtë aspekt, ne kemi vërtetuar zhvillim kohor, në kuptimin: shpirti i kohës dhe kohën shkallë-shkallë në botët abstrakte, por ndodhja e kohës në rrugën e njohjes konsiderohet e vërtetuar për të gjitha botët, por jo në kuptimin që e kuptojnë teologët dhe dijetarët e fushës së hadithit.



## Vërejtje tjetër

Pamë se fjala “الحمد” - “*el hamdu*” -“**falënderimi**” qëndron kundrejt fjalës “الجميل” - “*El xhemijlu*” - “i Bukuri”; gjithashtu, prej ajeteve të nderuara mësohet dhe vërtetohet se fjala “الحمد” - “*el hamdu*” -“**falënderimi**” është në pozitën e emrit më të madh (el ismul aëdham), që është emër universal dhe ka pozitën e Zotit krijues (rubùbij’jeh) të botëve, të “mëshirës gjithëpërfshirëse” (rahmànij’jeh), të “mëshirës së plotë” (rahijmij’jeh) dhe se vetëm Ai është “مالك يوم الدين” - “*Màliki jeumid’ dijni*” -“**Sunduesi në Ditën e Gjykimit**”, prandaj për emrat e bukur - “الرب” - “*err’rrab’bu*” - “Zoti”, “الرحمن” - “*Err’rrahmànu*” - “i Gjithëmëshirshmi”, “الرحيم” - “*Err’rrahijmu*” - “Mëshirëploti”, “المالك” - “*El màliku*” - “Sunduesi”, detyrimisht ka një rol kryesor në falënderimin. Shumë shpjegime mbi këtë çështje do të trokasim në mënyrë të detajuar, kur të flasim për interpretimin e fjalës së Allahut të Lartësuar: “مالك يوم الدين” - “*Màliki jeumid’ dijni*” -“**Sunduesi në Ditën e Gjykimit**”.

Domethënë, do të flasim rreth lidhjes së pozitës, Zoti krijues i botëve, së bashku me falënderimin, pasi të dyja janë të lidhura nga dy anë:

*E para:* Falënderuesi është prej botëve, ai ka dijeni për veten e tij, madje ata që kanë arritur gradën e njohjes, mendojnë se çdo njëra prej qenieve ka dijeni për veten, prandaj ai falënderon të Vërtetin, i Cili e nxjerr atë, me dorën e pozitës së Zotit krijues, prej





pafuqisë së mos ekzistencës lëndore, e nxjerr prej mangësisë, prej barbarisë e prej errësirës së tij; Ai e nxjerr atë në botën e njerëzores, në botën e plotësimit të tij; e nxjerr në botën e sigurisë së tij e dritës së tij. Gjithashtu, Ai bën që njeriu të kalojë nëpër pozicionet e trupores, elementeve, mineralit, bimës e kafshës dhe, të gjitha këto, nëpërmjet një sistemi të renditur së bashku me lëvizjet vetjake esenciale dhe me modele prej dashurisë së cilësisë së pastër të krijimit e të natyrës njerëzore, pastaj e çon atë deri në pozicionin e njerëzores, që është pozicioni më i nderuar i qenieve. Më pas Ai vazhdon me edukimin e njeriut, me qëllim që ta çojë atë drejt:

*“Unë arrij aty ku s’ të ka shkuar në mendje.*

*Duro, kur të prishen mirësitë.*

*Dhe them: ‘Ne te ai do të kthehem!’”<sup>1</sup>*

*E dyta:* Zhvillimi i sistemit të botës lëndore përbëhet prej trupave qiellorë, elementeve, esencave dhe dukurive që janë parathënia e plotë e trupit të njeriut, i cili, në të vërtetë, është bir i lëngut të botës së vërtetimit dhe qëllimi më i lartë për botët. Gjithashtu, mbi këtë bazë, njeriu është biri më i fundit i botës.

Bota lëndore lëviz në saje të lëvizjes vetjake esenciale, por kjo lëvizje e integruar përfaqëson edhe mbarimin e saj, përfaqëson qëllimin më të lartë të krijimit dhe fundin e udhëtimit. Sikur ne të shikojmë, në përgjithësi, në trupin e përgjithshëm, në karakterin e përgjithshëm, në qëndrueshmërinë e përgjithshme, në kafshën e përgjithshme dhe në njeriun e përgjithshëm, do të shikojmë se

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e një fragmenti nga poezia e dijetarit Xhelaludin Rumi.



njeriu është biri i fundit që u shfaq në ekzistencë, pas lëvizjeve vetjake esenciale të botës dhe përfundon te ato.

Atëherë, dora edukuese e të Vërtetit të Lartësuar qëndron në edukimin e njeriut në të gjithë shtëpinë e vërtetimit dhe kështu njeriu është edhe i pari, edhe i fundit.

Kjo që u tha më sipër, vërteton punët e pjesshme, duke vështruar në gradët e ekzistencës, ndryshe, sipas punës absolute, nuk mund të ketë qëllim të lartë për punën e të Vërtetit Fuqiptotë, me përjashtim të Qenies së Tij të pastër. Theksojmë se kjo është vërtetuar, kur është trajtuar kjo çështje.

Kur ne shikojmë në punët e pjesshme, kuptojmë se qëllimi i krijimit të njeriut është bota e padukshme absolute, ashtu siç theksohet në hadithin e nderuar: *“O bir i Ademit, sendet i krijova për ty dhe ty të krijova për veten Time”*.<sup>1</sup> Krijuesi i të gjitha sendeve e thekson qartë këtë të vërtetë në Kur’anin Famëlartë, kur i flet drejtpërdrejt Musa bin Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*):

“وَاصْطَنَعْتُكَ لِنَفْسِي” – *“Uestanaëtuke linefsij”* – **“Unë të kam zgjedhur ty për Vete”**.<sup>2</sup> “وَأَنَا اخْتَرْتُكَ” – *“Uena-khtartuke...”* – **“Unë të kam zgjedhur ty...”**.<sup>3</sup>

Pra, njeriu është krijuar për Allahun dhe është punuar për Qenien e Tij të pastër, është përzgjedhur prej mesit të të gjitha qenieve, prandaj qëllimi i ecurisë së njeriut është arritja në portën e Allahut, shkrirja në Qenien e Allahut, ngulitja në oborrin e Allahut dhe kthimi i tij është te Allahu, prej Allahut, në Allahun dhe me Allahun, ashtu siç njofton vetë i Larti me fjalën e Tij: “إِنَّا إِلَهُكُمْ وَإِلَهُكُمْ إِنَّا إِلَهُكُمْ” –

---

<sup>1</sup>“Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 381.

<sup>2</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 41.

<sup>3</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 13.



*“In’ne ilejnà ijàbehum” – “Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne”.*<sup>1</sup>

Për sa u përket qenieve të tjera, ato kthehen te i Vërteti i Lartësuar nëpërmjet njeriut, madje kthimi i atyre qenieve te njeriu theksohet edhe në *“Ez’zjaretul-xhàmiatul-kebijretu”* – *“Vizita e madhe universale”*, zbuluese e frymës së pozitive të kujdestarisë, kur thotë: *“Argumentet e krijesave janë te ju dhe llogaria e tyre është detyra juaj”*.<sup>2</sup> Në një vend tjetër, thuhet: *“Allahu me ju e hapi dhe me ju do ta mbyllë”*.<sup>3</sup>

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar, thotë: *“إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابَهُمْ. ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ”* – *“In’ne ilejnà ijàbehum. Thum’me in’ne alejnà hisabehum”* – ***“Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!”***<sup>4</sup>

Në frazën e sipërme, që sollëm prej *“Ez’zjaretul-xhàmiatul-kebijretu”*: *“Argumentet e krijesave janë te ju dhe llogaria e tyre është detyra juaj”*, ka një sekret prej sekreteve të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidit) dhe një shenjë e kthimit te njeriu i plotësuar, që është kthim te Allahu, sepse njeriu i plotësuar është i asgjësuar absolut dhe i qëndrueshëm me qëndrimin e Allahut, kurse nga vetja e tij njeriu s’ka as caktim, as të tashme e as kthim, madje ai është prej emrave të bukur dhe emri më i madh. Në Kur’anin Famëlartë dhe në hadithet e nderuara kanë ardhur shumë shenja, në lidhje me këtë kuptim.

<sup>1</sup>Sure “El Gàshije”, ajeti 25.

<sup>2</sup>Po aty.

<sup>3</sup>“Ujùnu akhbàru-rr’rridà”, vëll. 2, f. 272, *“Ez’zjaretul-xhàmiatul-kebijretu”*.

<sup>4</sup>Sure “El Gàshije”, ajetet 25-26.



Kur'ani Famëlartë është përmbledhësi i fjalëve të këndshme të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) dhe të sekreteve e të imtësive të këtij besimi deri në atë shkallë, në të cilën përshtaten mendjet e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe padyshim që kjo frazë është mrekullia më e madhe e kësaj flete qiellore ndriçuese, por mrekullia e tij nuk kufizohet në përbërjen e bukur, në shpjegimin e ëmbël, në gjuhën aq të qartë, sa s'ka më të qartë se gjuha e tij, duke shtuar se gjuha e tij qëndron në majat më të larta të oratorisë. Mrekullia e Kur'anit Famëlartë, gjithashtu, nuk kufizohet as në mënyrën e thirrjes dhe njoftimit për të panjohurat e as në përsosjen e dispozitave apo përsosjen e organizimit të familjes dhe të tjera punë si këto. Në fakt, secila nga këto që u përmendën, përfaqëson një mrekulli që e tejkalon fuqinë e njeriut, prandaj Kur'ani është i jashtëzakonshëm, është mrekulli.

Madje mund të thuhet: fama e Kur'anit Famëlartë për gjuhën e qartë dhe mrekullia e tij në këtë anë, pa folur për anët e tjera të mrekullive të tij, i referohen faktit se arabët e brezit të parë ishin mjeshtërit e retorikës. Ata e kuptuan këtë anë, por nuk kuptuan anët e tjera të tij. Nuk kuptuan anët e mrekullive të tjera të Kur'anit Famëlartë, anë që, në të vërtetë, kërkojnë më shumë interesim e lartësi dhe kanë nevojë për një nivel konceptues të shkallës më të ngritur nga sa kërkon ana e mrekullisë së retorikës së tij.

Në kohën e sotme ti shikon ata që kanë të përbashkët me arabët e kohës së injorancës para Islamit, në lidhje me horizontin e tyre konceptual dhe vë re se ata nuk arrijnë ta kuptojnë këtë shprehje të hollë hyjnore, me përjashtim të renditjes së fjalëve dhe bukurisë së mrekullive shpjeguese.



Për sa u përket atyre që kanë njohuri për sekretet e për hollësitë e diturive, ata që dinë shprehjen e këndshme të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe të zhveshjes, këndvështrimi i këtyre mbi këtë Libër hyjnor dhe Kiblen e shpresave të tyre, ata e gjejnë pikërisht në këtë shpallje qiellore dhe pikërisht në dituritë e kësaj shpalljeje hyjnore, prandaj ata nuk interesohen shumë për anët e tjera. Ata shikojnë çdo gjë te dituritë e Kur'anit dhe te dijetarët e Islamit, të cilët i kanë fituar dituritë që kanë prej Kur'anit dhe pastaj bëjnë krahasimin mes dijetarëve të Islamit dhe dijetarëve të të gjitha feve, botimeve të tyre e diturive të tyre dhe e kuptojnë origjinën në dituritë islame e kur'anore, të cilat përfaqësojnë themelin e themeleve të fesë, të medh'hebit dhe qëllimin më të lartë të dërgimit të profetëve dhe zbritjes së librave.

Në këtë cak nuk kërkohet ndonjë punë e madhe për të kuptuar se ky Libër është shpallje hyjnore dhe se këto dituri janë dituri hyjnore.



## Zgjim besimi

Mëso se cilësia e Zotit krijues e të Vërtetit të Lartësuar për botët është me dy mënyra:

*E para:* “kujdesi i përgjithshëm i Zotit krijues”. Në këtë kujdes kanë pjesë të gjitha qeniet e botës dhe ky kujdes formon llojin e edukimit struktural, në saje të të cilit çdo qenie kalon prej caktut të mangësisë në plotësimin e përshtatshëm. Kjo realizohet vetëm nën kujdesin e Zotit krijues.

Të gjitha lartësimet e shkallëzuara natyrale, të gjitha zhvillimet e përgjithshme, lëvizjet, zhvillimet vetjake e të rastësishme, të gjitha ndodhin nën veprimet e sistemimin e kujdesit të Zotit krijues.

Domethënë se kujdesi i Zotit krijues për rritjen e qenieve fillon nga pozicioni i lëndës së parë i kokrrizave të materies dhe përfundon me arritjen e pozicionit të kafshërisë e forcimit të fuqive trupore, shpirtërore e kafshërore. Kjo rritje është e përfshirë në kujdesin struktural (i përgjithshëm) të Zotit krijues. Çdo njëra prej këtyre pozicioneve dëshmon se Allahu i Lartësuar është Edukuesi e Rritësi.

*E dyta:* “kujdesi i përcaktuar i Zotit krijues” është i veçantë për specien njerëzore, kurse qeniet e tjera nuk kanë pjesë në këtë kujdes, që është kujdesi i udhëzimit në rrugën e shpëtimit e i orientimit në rrugën e lumturisë e të njerëzores, por është edhe paralajmërim për t’u ruajtur prej çdo pune që ndalon ecjen përpara drejt këtyre që u thanë më sipër. Padyshim që kjo punë plotësohet me dorën e profetëve.



Kushdo që i nënshtrohet edukimit e veprimit të Zotit të botëve me zgjedhjen e tij dhe edukohet me kujdesin e Zotit krijues, veprimet e gjymtyrëve të tij dhe fuqitë e tij të jashtme e të brendshme bëhen veprime hyjnore nën kujdesin e Zotit krijues dhe nuk janë vetjake të njeriut. Ky njeri arrin në gradën e plotësisimit të njerëzores, që është gradë e veçantë për specien njerëzore.

Për aq kohë sa njeriu është në pozicionin e kafshërores, ai lëviz ashtu siç lëvizin të gjitha kafshët, para njeriut janë dy rrugë dhe ai ka për detyrë të zgjedhë të ecë në njëren prej këtyre dy rrugëve:

*E para:* Pozicioni i lumturisë është rruga e drejtë e Zotit të botëve, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar e Fuqiplotë: “صِرَاطٍ مُسْتَقِيمًا رَبِّي عَلَى” - “...in'ne rab'bij alà siràtin mustekijmin” - **“Me të vërtetë, Zoti im, është në rrugë të drejtë”**.<sup>1</sup>

*E dyta:* Rruga e mjerimit, rruga e shejtanit të përzënë e i devijuar nga rruga e drejtë.

Kur fuqitë e trupit e të gjymtyrëve të njeriut janë nën veprimin e Zotit të botëve dhe janë zhvilluar e janë rritur me edukatën e Tij, atëherë zemra – ajo që përfaqëson pushtetin e kësaj mbretërie – shumë shpejt e dalëngadalë do t'i dorëzohet Zotit të botëve, sepse është edukuar prej Zotit të botëve, me udhëzimin e të Cilit ecin të gjitha ushtritë, për rrjedhojë e gjitha mbretëria e trupit është edukuar prej Zotit, Edukuesit. Në këtë gjendje, gjuhës së tij të brendshme, që është hija e zemrës, kur ai do të pyetet prej engjëjve

---

<sup>1</sup>Sure “Hùd”, ajeti 56.



se kush është Zoti yt, gjuhës së tij i mundësohet të përgjigjet lirshëm: “Zoti im është Allahu i Lartësuar!”

Patjetër që ky person është i bindur ndaj të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i orientuar prej mësimëve të Kur’anit Famëlartë, punon me Librin e Allahut dhe ndjek mësimet e imamëve udhëzues në rrugën e drejtë, prandaj gjuha e tij do të shqiptojë pa ngurrim: “Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është Profeti im dhe Kur’ani është libri im.

Kur njeriu e bën zemrën e tij hyjnore dhe në faqen e zemrës së tij nuk është fshirë fraza: “لا إله إلا الله محمد رسول الله” - “*lâ ilâhe il’lêll’lîh, Muhamedun resûlull’lîh*” - “S’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Allahut!”, zemra e jep këtë përgjigje, nëse nuk është bërë fotografi e të brendshmes së vetë njeriut. Por, kur zemra nuk ka lidhje me Kur’anin Famëlartë, domethënë, kur personi nuk punon sipas mësimëve të Kur’anit, nuk mendon mbi Kur’anin, nuk e mban Kur’anin vazhdimisht në mendje, patjetër që ky person nuk ka vënë themelet e një lidhjeje shpirtërore e morale me Kur’anin, për rrjedhojë, të gjitha dituritë që ai ka, do të fshihen prej kujtesës së tij në çastet e acarimit të sëmundjes, nga e cila do të vdesë dhe në çastet para humbjes së ndërgjegjes, në pragun e vdekjes, pikërisht kjo është ajo që në Kur’anin Famëlartë ka ardhur me frazën: “الطائفة الكبرى” - “*Et’tâm’metul-kubrâ*” - “Vala më e madhe (Kiameti)”.

I shtrenjti im, njeriu, për shkak të prekjes nga sëmundja dhe si rezultat i dobësimit të fuqisë së trurit, e harron të gjithë informacionin që ai ka dhe në çastet e vdekjes te ai nuk mbetet asgjë tjetër përveç atyre diturive, të cilat i ka përmendur shpesh dhe me





të cilat ka gjetur kënaqësi, për rrjedhojë, ato dituri janë bërë pjesë e dytë e cilësisë së pastër të krijimit të tij.

Njeriut, edhe kur i ndodh që vihet para një aksidenti tmerrues, të gjitha punët e tjera që ka, i dalin nga mendja dhe i gjithë informacioni që ai ka, fshihet me lapsin e harrimit. Pa mendo, si do të jetë gjendja e tij, kur t'i acarohen tmerret, vështirësitë nga trullosja e vdekjes?!

Kur veshi i zemrës së njeriut nuk është i mprehtë dhe, kur zemra e tij nuk dëgjon, mësimi i besimit (telkijni) që i këndohet njeriut, në kohën e vdekjes dhe pas vdekjes, nuk ndryshon asgjë në gjendjen e tij. Në të vërtetë, kujtimi i mësimëve (telkijni) u sjell dobi atyre personave, zemrat e të cilëve kanë njohur besimin e vërtetë, veshët e zemrave të tyre janë të hapura edhe kur atyre u vijnë turbullirat e vdekjes e gjendja e tij rëndohet aq shumë, sa shkakton te ai një lloj shkujdesje. Megjithëkëtë mësimi i besimit (telkijni) është i dobishëm për këta njerëz, ku engjëjt e Allahut çojnë në veshët e në zemrat e tyre jehonën e besimit të vërtetë (çojnë frazën: "là ilàhe il'lèll'làh, Muhamedun resùlull'làh"). Por, kur njeriu është i shurdhur dhe e ka humbur shqisën e dëgjimit, e përshtatshme për botën e Berzahut e të varrit, ai kurrë nuk e dëgjon mësimin që i këndohet dhe mësimi i besimit (telkijni) nuk ndryshon asgjë në gjendjen e tij. Në hadithet e nderuara ka shenja të shumta, që flasin për disa nga gjendjet që u përmendën më sipër.



## I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti- الرحمن الرحيم

Dije se për të gjithë emrat e të Vërtetit Fuqiplotë dhe për të gjitha cilësitë e Tij, në tërësi, ka dy pozita dhe dy gradë:

*E para:* Pozita e emrave dhe e cilësive personale të qëndrueshme në prezencën e të Vetmit, si dituria personale, që është prej punëve e prej shkëlqimeve personale, fuqia, vullneti personal dhe të gjitha punët e tjera personale.

*E dyta:* Pozita e emrave dhe e cilësive të punëve të qëndrueshme për të Vërtetin, me shkëlqimin e me bujarinë e pastër, si dituria e punëve, të cilën orientalistët e kanë konsideruar të lidhur me diturinë detajuese.

Eminenca e tij, më i preferuari i të urtëve, Khavàxheh Nesijru-d'dijn (*Allahu ia mbajttë fytyrën të re!*), ka paraqitur një argument për këtë çështje dhe duke ndjekur orientalistët thotë: "Dituria e punëve është peshorja në diturinë e detajuar".

Kjo kërkesë, edhe pse mund të jetë në kundërshtim me vërtetimin, dituria detajuese është e qëndrueshme në gradën e Personit, prandaj zbulimi i diturisë së Personit dhe shkoqitja e kësaj diturie përfaqëson një gradë më të lartë e më shumë se dituria e punëve, ashtu siç është vërtetuar në vendin përkatës dhe ashtu siç vërtetohet me argumente ndriçuese. Por origjina e kërkesës është: sistemi i ekzistencës përfaqëson një dituri të detajuar të punëve për të Vërtetin e Lartësuar, dituri e vërtetuar dhe e realizuar në



përputhje me rrugën e argumentit dhe të burimit, ku pinë ata që kanë arritur gradën e njohjes. Nëse udha e rrugëtimit është më e lartë dhe shija e njohjes është më e ëmbël, kjo është një rrugë ndryshe prej këtyre rrugëve, sipas frazës “shkolla juridike e të dashuruarit është e pavarur prej shkollave të tjera juridike”.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, për mëshirën gjithëpërfshirëse dhe për mëshirën e plotë, ka dy gradë dhe dy shkëlqime:

*E para:* Shkëlqimi me bujarinë më të pastër në vendshkëlqimin e Personit në praninë e të Vetmit.

*E dyta:* Shkëlqimi me bujarinë e pastër në vendshkëlqimin e gjithësisë.

Në suren e bekuar “El Hamd” – (El Fàtiha) ka mundësi që peshorja të anojë kah konsiderata për dy cilësitë: “الرحمن” – “*Err’rrahmànu*” – “**i Gjithëmëshirshmi**” dhe “الرحيم” – “*Err’rrahijmu*” – “**Mëshirëploti**”. Këto dy cilësi ndjekim emrin, për shkak se të dyja janë prej cilësive të punëve, por janë edhe prej cilësive të Personit, ashtu siç shfaqet fare qartë në ajetin e nderuar: “بسم الله الرحمن الرحيم” – “*Bismil’lâhi-rr’rrahmàni-rr’rrahijm*” – “**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**”

Bazuar mbi këtë ajet, padyshim që për këtë frazë nuk mund të ketë asnjë përsëritje, për të cilën mund të thuhet se është për theksim e përforcim.

Bazuar mbi këto mundësi interpretimi – dituria është vetëm te Allahu – kuptimi i ajetit të nderuar është: “me dashjen e mëshirës

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e një vargu poetik e poetit, dijetarit Xhelaludin Rumi.



gjithëpërfshirëse dhe mëshirës së plotë, falënderimi e lavdërimi është për të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin”.

Meqë pozita e “dashjes” është shfaqja e Qenies së pastër, atëherë pozita e “mëshirës gjithëpërfshirëse” dhe e “mëshirës së plotë” është prej qëllimeve të dashjes, e cila është shfaqje e mëshirës gjithëpërfshirës dhe e mëshirës së plotë Personale.

Ka edhe mundësi të tjera interpretimi, por ne nuk jemi futur në to, sepse mundësia më e qartë është mundësia që u përmend më sipër.

### Sunduesi i Ditës së Gjykimit- **مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ**

Shumë prej kënduesve të Kur’anit Famëlartë fjalën “مَالِكِ” - “Màliki” - “Sunduesi” e lexojnë “مَلِكٍ” - “Meliki”, pra, shkronjën “م” - “m” të kësaj fjale e lexojnë me zanoren “e”, kurse shkronjën “ل” - “l” e lexojnë me zanoren “i”. Nga zëra të caktuar janë përmendur dy mënyrat e leximit të fjalës “Sunduesi”: “مَالِكِ” - “Màliki” dhe “مَلِكٍ” - “Meliki”. Puna ka arritur deri aty, sa njëri prej dijetarëve të mëdhenj (Allahu e mëshiroftë!) ka shkruar një kumtesë, në të cilën anon më shumë nga mënyra e leximit “مَلِكٍ” - “Meliki”, në vend të mënyrës “مَالِكِ” - “Màliki”, por ajo që kanë thënë të dy palët e zërave anues nga njëra mënyrë leximi, ose nga mënyra tjetër e leximit, nuk janë të atilla që mund të ngjallin siguri.



Duket qartë se zërat për leximin e fjalës **“Sunduesi”** - “مَالِكٍ” - *“Màliki”*, jo vetëm që kanë më shumë peshë, por janë edhe të përcaktuar. Veç kësaj, duhet të theksohet se dy suret e urura “El Hamd”- (El Fàtiha) dhe “Et Teuhid” - (El Ikhlàs) nuk janë si të gjitha suret e tjera të Kur’anit, sepse myslimanët këto dy sure i këndojnë shpesh në namazet (farz) dhe në namazet (nafilë). Ky fakt tregon qartë se këto dy sure janë dëgjuar nga qindra milionë njerëz dhe nga qindra milionë prej të mëparshmëve të tyre. Ky fakt na vërteton se këto dy sure janë dëgjuar e janë përcjellë në mesin e myslimanëve në atë mënyrë që ngjall siguri të plotë, se këto dy sure janë dëgjuar e janë kënduar në këtë mënyrë prej Profetit më të nderuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe prej imamëve të ruajtur prej gjynaheve, pa shtuar e pa lënë mangët asgjë, qoftë edhe një germë të vetme. Është e qartë se mënyra e leximit të fjalës **“Sunduesi”** - “مَالِكٍ” - *“Meliki”* nuk ngjall ndonjë interes të veçantë, pavarësisht së këtë mënyrë këndimi e praktikojnë shumë këndues të Kur’anit Famëlartë dhe se nga kjo mënyrë leximi anojnë shumë zëra dijetarësh. Megjithëkëtë, mënyra e parë e leximit “مَالِكٍ” - *“Màliki”* mbetet e formës së prerë dhe e vërtetuar, në saje të dëgjimit brez pas brezi dhe askush nuk i ka ndjekur zërat që anojnë kah leximi i mënyrës së dytë. Megjithëkëtë dijetarët kanë lejuar të dyja mënyrat e leximit, me kusht që të ndiqet vetëm njëra mënyrë leximi, por nuk kanë këmbëngulur dhe nuk kanë thënë që patjetër duhet të lexohet “مَالِكٍ” - *“Meliki”* kundrejt leximit të mënyrës së parë, që ka përhapjen më të gjerë në të gjitha namazet. Madje, edhe kur dijetari i nderuar ka ndjekur mënyrën e dytë të leximit, këtë e ka bërë për rezervë dhe e ka shoqëruar me këndimin sipas mënyrës së parë “مَالِكٍ” - *“Màliki”*, ashtu siç ka vepruar edhe shehu ynë i nderuar, haxhi/shejh Abdul-



Kerijm El Jezedij (El Hàirij) (*Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!*), megjithëse këtë rezervë ai e bëri sipas kërkesës së njërit prej dijetarëve të mëdhenj bashkëkohorë. Gjithsesi, edhe kjo rezervë është shumë e dobët, madje, në këndvështrimin tim, është krejtësisht e kundërshtueshme.

Bazuar në shpjegimin e mësipërm, del qartë se sa e dobët është fjala që thuhet në lidhje me dyshimin që ka ndodhur mes fjalëve “مَلِكٍ” - “Meliki” dhe “مَالِكٍ” - “Màliki” në shkrimin kufi. Një pretendim i këtyllë, edhe mund të thuhet për suret jo aq shumë të qarkulluara në gojët e njerëzve, megjithëse edhe kjo fjalë, gjithashtu, mbart shumë probleme, kurse në lidhje me këtë sure, e vërtetuar nëpërmjet dëgjimit të leximit të njëri-tjetrit, pretendimi i mësipërm është fare pa vlerë dhe ashtu siç është fare e qartë është pretendim që nuk mund të merret në konsideratë.

Këto që u thanë, vërtetohen, gjithashtu, edhe në lidhje me fjalën “كُفُوًا” - “kufuven” - **“i ngjashëm, i barabartë”** e sures së nderuar “Et Teuhid” - (El Ikhàs), në të cilën shkronja “و” - “v” patjetër duhet të lexohet me zanoren “e”, kurse shkronja “ف” - “f” duhet të lexohet me zanoren “u”, pasi kjo mënyrë leximi është e vërtetuar nga dëgjimi i njëri-tjetrit, edhe pse është vetëm mënyrë e Asimit të këndimit të Kur’anit Famëlartë. Këtu duhet shtuar se mënyrat e tjera të këndimit nuk ndezin ndonjë interesim për këtë mënyrë këndimi, edhe pse disa pandehin se veprojnë për rezervë, kur ndjekin mënyrën e këndimit të shumicës, domethënë leximin e shkronjës “f” me zanoren “u”, përsëri rezerva nuk është në vendin e duhur.



Kur ne e sjellim diskutimin rreth kësaj çështjeje, kemi parasysh se hadithet e nderuara nxisin vazhdimin e leximit të Kur'anit, ashtu siç e lexojnë njerëzit.<sup>1</sup> Nga ky diskutim këtu arrijmë në përfundimin se qëllimi i këtyre transmetimeve është: Kur'ani këndohet ashtu siç e këndon masa e njerëzve dhe jo se, për shembull, ju mund të zgjidhni njërën prej shtatë mënyrave të këndimit. Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se është gabim leximi “مَلِكٍ” - “Meliki” dhe “كُفْرًا” - “kuf'en”, sepse kjo mënyrë leximi nuk është sipas mënyrës që këndohet Kur'ani në mesin e myslimanëve dhe ashtu siç është shkruar në faqet e nderuara të Kur'anit Famëlartë.

Në të gjitha gjendjet, rezerva është në këndimin e kësaj fjale në përputhje me mënyrën e këndimit qarkullues në mesin e njerëzve dhe ashtu siç lakohet prej gjuhëve e ashtu siç është shkruar në Kur'anin Famëlartë, sepse kjo mënyrë e këndimit është e saktë në çdo rrugë.<sup>2</sup> Vetëm Allahu është i Dituri!

## Këqyrje

Dije se pronësia e të Vërtetit të lartësuar është e ndryshme nga pronësia që kanë robtë mbi pronat e tyre apo pronësia e mbretërve mbi mbretëritë e tyre. Të gjitha këto janë anekse nominale, në një kohë që anekset e të Vërtetit nuk janë të këtij lloji,

---

<sup>1</sup>Kjo përmbajtje ka ardhur në shumë transmetime, prej të cilave: “...lexo, ashtu siç lexojnë njerëzit” dhe “lexoni, ashtu siç e keni mësuar”. Për këtë çështje, referoju librit “Vesàilu-Sh’shij’ati”, vëll. “Namazi”, K. 74 - “Leximi i Kur’ànit në namaz”.

<sup>2</sup> Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë është i lejuar këndimi i Kur’anit, në përputhje me njërën prej mënyrave të këndimit. (autori)



edhe pse shembulli i pronësisë të dijetarët e fushës së jurisprudencës islame është i vërtetuar për të Vërtetin e Lartësuar në mënyrë lineare, por kjo nuk e mohon që ky mendim edhe mund të rishikohet.

Gjithashtu, pronësia e të Vërtetit të Lartësuar nuk është prej llojit të pronësisë që ka njeriu mbi gjymtyrën e tij dhe as prej modeleve të pronësisë së fuqive të dukshme e të padukshme të njeriut, megjithëse ky model është shumë më afër pronësisë së të Vërtetit të Lartësuar ndër të gjitha modelet e pronësisë.

Gjithashtu, pronësia e të Vërtetit Fuqiplotë nuk është si pronësia e vetes së njeriut për punët që bën, për faktin se janë punë të vetë njeriut, siç është puna e tij në formimin e figurave e formave intelektuale, të cilat deri në një farë kufiri janë të nënshtruara ndaj vullnetit të vetë njeriut.

Pronësia e të Vërtetit të Lartësuar nuk është as si pronësia e botëve të mendjes e të botëve poshtë mendjes, edhe pse kjo pronësi është vepruese në këto botë me mosqenien dhe bërjen me qenë, sepse të gjitha qeniet e shtëpisë së vërtetimit janë të mundshme – mbi ballin e tyre është damkosur ulja prej varfërisë. Në të vërtetë, qeniet e mundshme janë të kufizuara me kufij dhe i janë nënshtruar paracaktimit, qoftë edhe me kufirin e esenciales natyrale. Por çdo gjë e kufizuar me një kufi, ka një ndarje izoluese, sipas masës së kufizimit, pa pasur për atë informim të përjetshëm prej të Vërtetit, prandaj të gjitha sendet janë të ndryshme dhe janë vënë përballë njëra-tjetrës, sipas vetë sendeve, së bashku me përshtypjet e vetë sendit. Ky është shkaku që një qenie s'ka informim vetjak të përjetshëm.





Kurse pronësia e të Vërtetit të Lartësuar – ajo është me shtesa dritëdhënëse dhe me informacion të përjetshëm - sepse ajo është pronësia Personale e vërtetë dhe s’ mund të ketë më të vërtetë se kjo. Gjithashtu, në pronësinë e të Vërtetit të Lartësuar s’ka mangësi të shkaktuar prej asnjë qenieve apo ndonjë çarje izoluese në veten e Tij e në cilësitë e Tij.

Pronësia e të Vërtetit të Lartësuar mbi të gjitha botët, është pronësi homogjene, në mënyrë të barabartë. Në pronësinë e të Vërtetit, në mënyrë absolute, s’ka dallim mes një qenie e një qenieje tjetër, më shumë e informuar ose më afër botëve të padukshme. Ai nuk mban anën e asnjërës prej qenieve, përfshirë edhe qeniet e botëve të tjera, ndryshe një gjë e këtillë e bën të domosdoshme kufizimin dhe ndarjen izoluese. Gjithashtu, kërkon që të thuhet se Allahu i Lartësuar ka nevoja dhe është i kufizuar në mundësi, por këto janë jashtë mendjes, që të mendohen për të Vërtetin Fuqiptotë.

Këtë kuptim e shpreh qartë fjala e të Lartit: “وَتَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْكُمْ” - “*Ue nahnu akrebu ilejhi minkum...*” - “**Ne jemi më afër te ai se ju...**”<sup>1</sup>

- “الْوَرِيدِ وَتَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ” - “*...ue nahnu akrebu ilejhi min hablil-verijd*” - “**Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij**”<sup>2</sup>
- “السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ نُورٌ” - “*Allahu nûru-s’semàvâtî uel-erdi...*” - “**Allahu është dritë e qiejve e i tokës...**”<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Sure “El Uàkia”, ajeti 85.

<sup>2</sup>Sure “Kâf”, ajeti 16.

<sup>3</sup>Sure “En Nûr”, ajeti 35.



- “*وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِلَّذِينَ يُرَوِّدُونَ الْأَرْضَ فِي السَّمَاوَاتِ*” – “*Ue huve-l’ledhij fi-s’semài ilàhun, ue fil-erdi ilàhun...*” – “**Ai, që është i adhurar në qiell, është i adhurar edhe në tokë...**”<sup>1</sup>
- “*وَالْأَرْضُ مَلَكُ السَّمَاوَاتِ*” – “*...lehù mulku-s’semàvati uel-erdi...*” – “**...vetëm Atij i takon sundimi i qiejve e i tokës...**”<sup>2</sup>

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Sikur ju të lëshoheshit me një litar në dy tokat më të ulëta, patjetër që do të zbritnit mbi Allahun*”.<sup>3</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*S’ka vend që Ai nuk është dhe s’ka vend që nuk është zënë me Të; Ai është më afër një vendi, aq sa është më afër një vendi tjetër*”.<sup>4</sup>

Imam Ali Neki (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Dije se, kur Ai është në qiellin e kësaj bote, është sikur është mbi Arshin dhe për të gjitha sendet Ai e ka të barabartë diturinë, fuqinë, sundimin dhe informacionin*”.<sup>5</sup>

Por pronësia e Qenies së pastër është në mënyrë të barabartë për të gjitha sendet dhe për të gjitha botët, ashtu siç njofton Allahu i Lartësuar në ajetin: “*مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ*” – “*màliki jeumi-d’dijn*” – “**Sunduesi i Ditës së Gjykimit**”. Përse ky veçim?

---

<sup>1</sup>Sure “Ez Zukhruf”, ajeti 84.

<sup>2</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 107.

<sup>3</sup>“Ilmul Jekijn”, vëll. 1, f. 54.

<sup>4</sup>“El-Usùlu minel-kàfi”, “Kitàbu-t’teuhijdi”, K. “El hareketu ue -intikàlu”, Hadithi 3.

<sup>5</sup>Burimi i mësipërm, hadithi 4.



Patjetër që kjo lidhet me faktin se “يوم الدين” – “jeumi-d’ dijn” – “Dita e Gjykimit” është “dita e tubimit”, për rrjedhojë Sunduesi i Ditës së Gjykimit – që siç u tha, është dita e tubimit – nuk mund të jetë askush tjetër përveç Sunduesit të ditëve të tjera, Sunduesit në të tjerat veç e veç. Gjithashtu, edhe zhvillimet e pronësisë janë tubime në zhvillimet mbretërore.

Ose kjo bazohet në atë se shfaqja e pronësisë së të Vërtetit të Lartësuar do të jetë në Ditën e Tubimit, që përfaqëson kthimin e të mundshmeve në portën e Allahut dhe ngjitjen lart të qenieve në oborrin e Tij.

Nëse të gjithë këtë çështje do ta shkoqisim në mënyrë të detajuar, ashtu siç është e përshtatshme për pozitën që ka, mund të thuhet se drita e ekzistencës dhe dielli i të vërtetës vazhdojnë të jenë në lëvizje apozicionale, prej pozicioneve të së panjohurës drejt botës së dukshme dhe e orientuar drejt mbulesës të së panjohurës. Me fjalë të tjera, në çdo pozicion të caktuar, në çdo model e në çdo lidhje, ka një mbulesë. Njeriu, në të cilin janë bashkuar modelet e lidhjet, ai është i mbuluar me shtatë mbulesa të errëta dhe me shtatë mbulesa drite, të cilat interpretohen me shtatë tokat e me shtatë qiejt, ka shumë mundësi që referimi në frazën e ajetit “أسفل السافلين” – “esfele-s’sâfilijne” – “i poshtri i të poshtërve”, është mbulimi me të gjitha llojet e mbulesave. Madje ky mbulim mund të thuhet edhe për diellin e ekzistencës, edhe për dritën e mirëfilltë në horizontet e modeleve me fjalën “الليل” “el’lejl” – “nata” dhe me “ليلة القدر” – “lejletul-kadri” – “Nata e kadrit”.

Përderisa njeriu vazhdon të jetë i mbuluar me këto mbulesa, padyshim që i mbuluar, nuk e shikon as bukurinë e as dritën e parë, por, kur të gjitha qeniet janë në një lëvizje ngjitëse në lartësi,



nisur prej pozicioneve të botës së natyrës së ulët, në saje të lëvizjeve të natyrshme të depozituara në specien njerëzore, lëvizje që dalin prej dritës tërheqëse të cilësisë hyjnore të krijimit, në përputhje të plotë me caktimin e “bujarisë së pastër” në “praninë e diturisë”, atëherë ajo kthehet në atdheun origjinal e në vendkthimin e vërtetë.

Kjo e vërtetë theksohet në shumë ajete të nderuara të Kur’anit Famëlartë. Nëpërmjet këtyre ajeteve ne do të shpëtojmë edhe një herë prej mbulesave dritë dhe mbulesave errësirë, atëherë do të shkëlqejë pronësia e fuqia mposhtëse e të Vërtetit të Lartësuar. I Vërteti Fuqplotë do të shkëlqejë, nga fakti se Ai është Një e i Vetëm dhe me fuqinë e Tij mposhtëse.

Kur në këtë periudhë realizohet kthimi i dytë në të parin dhe e dukshmja lidhet me të brendshmen, në këtë gjendje, bie sundimi i të jashtmes dhe shfaqet qeveria e të brendshmes. Në këtë kohë, biseda në mënyrë absolute, vjen vetëm prej pranisë së Sunduesit dhe atje s’ka ligjërues tjetër përveç Qenies së pastër, ashtu siç njofton ajeti: “لَعْنُ الْمَلَكِ الْيَوْمِ” – “...limenil-mulkul-jeume” – **Kujt i përket pushteti i asaj dite?**<sup>1</sup> Patjetër që s’ka asnjë që të japë përgjigje përveç të Vërtetit të Lartësuar, i Cili përgjigjet: “لَقَهَّارِلَّهِ الْوَاحِدِ” – “lil’lâhil-Vâhidil-Kah’hâr” – **Allahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!**<sup>2</sup>

Ajo është dita absolute, është dita e daljes së diellit të së vërtetës prej mbulesës së horizontit të modeleve. Në njërën prej kuptimeve, ajo është “يوم الدين” – “jeumu-d’dijn” – “dita e fesë”, ditën në të cilën çdo njëra prej qenieve asgjësohet në hijen e emrit që i përshtatet atij në të Vërtetin e Lartësuar.

<sup>1</sup>Sure “El Gàfir”, ajeti 16.

<sup>2</sup>Po aty.



Kur të nisë “fryrja e surit”, ajo fryrje do të dalë prej këtij emri dhe do të bashkohet me ndjekësit e këtij emri: “فَرِيْقٌ فِي الْجَنَّةِ وَفَرِيْقٌ فِي السَّعِيْرِ” - “...ferijkun fil-Xhen'neti ue ferijkun fi-s'seijri” - “...kur të gjithë njerëzit do të tubohen, disa në Xhenet e disa në Xhehenem”.<sup>1</sup>

Njeriu i plotë, në këtë botë, del prej kësaj mbulese, sipas rrugëtimit të tij për te Allahu, atëherë dalin në shesh dispozitat e Kiametit, të orës dhe për atë vërtetohet Dita e Gjykimit, dita e fesë.

Atë çast, i Vërteti i Lartësuar shumë shpejt do të shfaqet për zemrën e tij, së bashku me pronësinë e Tij në këtë miraxh-namaz, atëherë, edhe gjuha e tij do të jetë përkthyesë për zemrën e tij, kurse e jashtëmja e gjuhës së tij do të jetë panorama e të brendshmes së tij. Kjo është njëra prej sekreteve të veçanta të pronësisë në Ditën e Gjykimit.

## Frymëzim prej arshit të Allahut

Ka mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e fjalës “العرش” - “El Arshu” - “arshi” dhe frazës “حملة العرش” - “hameltul-arshi” - “mbajtësit e arshit”. Madje këto mendime të ndryshme shtrihen deri në hadithet e nderuara, edhe pse hadithet janë konvencionale sipas brendisë së tekstit.

---

<sup>1</sup>Sure “Esh Shùrà”, ajeti 7.



Në gjuhën arabe, fjala “العرش” - “*el arshu*” - “arshi”, në përputhje të plotë me këndvështrimin e njohjes dhe rrugës së argumentimit, është një fjalë që thuhet për disa kuptime:

Njëri prej kuptimeve - që nuk e kam gjetur në të folurën e popullit - është “الحضرة الواحدة” - “*El hadretul Vâhidij'jeh*” - “prania e Njëshit”, që është niveli i “الفيض الاقدس” - “*el fejdul akdesu*” - “bujarisë më të pastër”. Gjithashtu, edhe fraza “حمة العرش” - “*hameltul arshi*” - “mbartësit e arshit”, sipas këtij kuptimi, janë katër emrat që numërohen prej rrënjëve të emrave: “الأول” - “*el ev'ovelu*” - “i Pari (pa fillim)”, “الآخر” - “*el àkhiru*” - “i Fundit (pa mbarim)”, “الظاهر” - “*edh'dhàhiru*” - “i Dukshmi”, “الباطن” - “*el Bâtinu*” - “i Padukshmi”.

Një kuptim tjetër i fjalës “arsh”, që nuk e gjej në të folurën e popullit, është: “الفيض المقدس” - “*el fejdul mukad'des*” - “bujaria e pastër”, që është në nivelin e “الاسم الاعظم” - “*el ismul aëdham*” - “emrit më të madh” dhe mbartësit e tij janë emrat “الرحمن” - “*Err'rrahmànu*” - “i Gjithëmëshirshmi”, “الرحيم” - “*Err'rrahijmu*” - “Mëshirëploti”, “الرب” - “*Err'rrab'bu*” - “Drejtuesi”, “المالك” - “*el màliku*” - “Sunduesi”.

Kuptim tjetër i fjalës “arsh” është fraza: “ما سوى الله” - “*mà sivall'Ilàh*” - “gjithçka përveç Allahut”. Këtu, mbajtësit e arshit janë katër engjëj: Israfil, Xhebraili, Mikaili dhe Azraili.

Kuptim tjetër është fraza: “الجسم الكلّ” - “*el xhismul kul'lu*” - “i gjithë trupi”; mbajtësit këtu janë katër engjëjt e mëdhenj, të cilët janë



forma të “krerëve të llojeve”. Në librin “El Kâfi”, ka transmetime që e theksojnë këtë kuptim.<sup>1</sup>

Herë tjetër, fjala “arsh” thuhet për fjalën “العلم” - “*el ilmu*” - “dituria” dhe këtu qëllimi me diturinë mund të jetë dituria e punëve për të Vërtetin e Lartësuar, dituria e përfaqësuar në pozitën e kujdestarisë më të madhe. Mbartësit këtu janë katër miq të plotësuar të Allahut prej popujve të mëparshëm, që janë: Nuhu, Ibrahim, Musai dhe Isai (*Paqja qoftë mbi ta!*), ose edhe katër prej të plotësuarve të këtij umeti, që janë: i Dërguari i fundit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, Hasani dhe Husejni.<sup>2</sup>

Pasi u njohë me këtë parashtresë, mëso se veçimi i katër emrave të bukur: “الرب” - “*Err’rrab’bu*” - “Sistemuesi”, “الرحمن” - “*Err’rrahmànu*” - “i Gjithëmëshirshmi”, “الرحيم” - “*Err’rrahijmu*” - “Mëshirëploti”, “الرب” - “*Err’rrab’bu*” - “Drejtuesi”, “الملك” - “*El màliku*” “Sunduesi”, konsiderohen përmendje të emrit Allah; emër që në suren e nderuar “El Hamd” - (El Fàtiha) përmendet katër herë dhe tregon Personin e lartë të Allahut. Sipas të brendshmes së këtyre emrave të bukur, ato mund të jenë mbajtësit e arshit të “Njëshit” dhe dukuritë e Njëshit janë katër engjëjt e afërm te i Vërtetit, janë mbajtësit e arshit. Studimi i kësaj çështjeje është:

Emri i uruar: “الرب” - “*Err’rrab’bu*” - “Sistemuesi”, është e brendshmja e Mikailit, engjëlli i ngarkuar me detyrën e shfaqjes së

<sup>1</sup>Referoju “El-Usùlu minel-Kâfi”, vëll. “Kitàbu-t’teuhijdi”, K. “El-Arshu uel-Kursu”.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm.



Sistemuesit në shpërndarjen e furnizimeve dhe sistemimin e shtëpisë së ekzistencës.

Emri i uruar: "الرحمن" - "*Err'rrahmànu*" - "i Gjithëmëshirshmi", është e brendshmja e Israfilit, engjëlli i ngarkuar me shpërndarjen e shpirtave e të formave të jetës dhe me fryrjen e Surit. Gjithashtu, edhe shtrirja e ekzistencës është në emrin "الرحمن" - "*Err'rrahmànu*" - "i Gjithëmëshirshmi".

Emri i uruar: "الرحيم" - "*Err'rrahijmu'*" - "Mëshirëploti", është e brendshmja e Xhebrailit, engjëlli i ngarkuar me detyrën e mësimin e të plotësimit të të gjitha qenieve. Kurse emri i uruar: "المالك" - "*El màliku*" - "Sunduesi", është e brendshmja e Azrailit, engjëlli i ngarkuar me detyrën e marrjes së shpirtave, kapjes së figurave dhe kthimin e të dukshmes në të padukshmen.

Atëherë, 3 ajetet e para të sures "El Hamd" (El Fàtiha) deri në ajetin: "مالك يوم الدين" - "*Màliki jeumid' dijni*" - "**Sunduesit të Ditës së Gjykimit**", përfshijnë arshin e të qenit Një dhe arshin e Vërtetimit; gjithashtu, tregon edhe mbajtësit e arshit.

Bazuar mbi shpjegimin e mësipërm, i gjithë rrethi i ekzistencës dhe shkëlqimet e të panjohurës e të njohurës, për të cilat flet Kur'ani Famëllartë dhe përmenden në këtë pjesë të kësaj sureje të nderuar, si dhe kuptimin që gjendet i gjithi në "بِسْمِ اللَّهِ..." - "*bismil'làhi...*" - "**Me emrin e Allahut...**", është emri i bukur, më i madh (el ismul aëdham), që, gjithashtu, gjendet në germën "ب" - "*b*"





-“b”, e cila, në analizën morfologjike të fjalës, është në pozitën e shkakësore.<sup>1</sup>

## Vërejtje gnostike

Ka shumë mundësi që vënia përpara e emrit “الرب” - “Err’rrab’bu” - “Sistemuesi” dhe pas këtij emri përmendja e dy emrave “الرحمن” - “Err’rrahmànu” - “i Gjithëmëshirshmi” dhe “الرحيم” - “Err’rrahijmu” - “Mëshirëploti”, që ndiqen nga emri i bukur “المالك” - “El màliku” - “Sunduesi”, tregon ecurinë njerëzore, prej krijimit të mbretërisë në këtë botë të ulët, deri në asgjësimin e përgjithshëm, ose drejt pozitës së pranisë të Mbreti i mbretërve.

Kur rrugëtari është në fillim të rrugëtimit, ai është i nënshtruar ndaj edukimit gradual të “رب العالمين” - “rab’bil àlemijn” - “Sistemuesit të botëve”, pasi edhe ai vetë është prej botëve, për rrjedhojë edhe ecja e tij është e nënshtruar ndaj veprimit të kohës dhe përshkallëzimit.

Kur rrugëtari, me anë të ecjes, zhvishet krejtësisht prej botës së natyrës, në zemrën e tij shkëlqen grada e “emrave informues”, gradë që s’ka lidhje me botën në të cilën është zotëruese vetëm ana e saj e keqe.

<sup>1</sup>“El-Esfàrul-erbeah”, vëll. 7, f. 32 dhe “Esràrul-hukmi”, f. 559. - nuk është përcaktuar vendi i këtij shënimi.



Emri i bukur: “الرحمن” - “*Err'rrahànu*” - “i Gjithëmëshirshmi” është përmendur, ngaqë ka më shumë veçori në mesin e “emrave informues”.

Gjithashtu, ky emër, është shfaqja e mëshirës dhe grada e shtrirjes së Tij të pakushtëzuar, prandaj ka ardhur para emrit të bukur “الرحيم” - “*Err'rrahijm*” - “Mëshirëploti”, i cili është më afër horizontit të të brendshmeve.

Atëherë, në ecjen njohëse, në fillim shkëlqejnë emrat e dukshëm dhe pas tyre vijojnë emrat e të brendshmes, sepse ecja e rrugëtarit është prej shumicës drejt unitetit dhe vazhdon kështu, deri sa përfundon te emrat e të brendshmes së mirëfilltë, ndër të cilët është emri “المالك” - “*El māliku*” - “Sunduesi”. Në brendi të këtyre emrave, në shkëlqimin e pronësisë, shkëlqejnë shumicat e botës së panjohur e të botës së dukshme, deri sa arrin në asgjësimin e plotë dhe në praninë absolute. Kur rrugëtari shpëton prej mbulesave të shumicës dhe arrin te uniteti e te pushteti hyjnor, ai triumfon me shikimin e pranisë dhe pikërisht, në këtë prani, ai flet drejtpërdrejt për praninë dhe thotë: “اياك نعبد” - “*ij'jàke naëbudu*” - “**Vetëm Ty të adhurojmë**”.

Atëherë, me plotësimin e rrethit të ecjes së atyre që lëvizin në këtë drejtimin, e përmendur në këtë sure të nderuar, është edhe fillimi i fundit të mbulimit të botës së natyrës, që përfundon me ngritjen e të gjitha mbulesave të errëta dhe mbulesave dritë. Në këtë gjendje, arrihet prania absolute, e cila, për rrugëtarin, përfaqëson Kiametin e madh dhe orën e Kiametit të tij.

Ka mundësi që qëllimi me ata që i veçon ajeti i nderuar:



“فَصَبِّحْ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ” – “...fesaika men fis'semàvati ue men fil erdi il'là mà shàell'llàhu...” – “do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu...”<sup>1</sup> të jenë individë të kategorisë së rrugëtarëve për te Allahu, sepse vdekja e tyre ka ndodhur para fryrjes së surit.

Gjithashtu, ka mundësi që ky kuptim të jetë njëra prej mundësive të ardhura në hadithin e njohur të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Unë dhe Kiameti jemi afër si këta të dy (dhe bashkoi gishtin tregues me gishtin e madh të dorës së tij)”<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup>Sure “Ez Zumer”, ajeti 68.

<sup>2</sup>“Kitàbul-Eshkarij’jàt”, K. “Mà jùxhibu-s’ sabru”, f. 212 ; “Bihàrul Enuàr”, vëll. 2, f. 39.



## Vërejtje gjuhësore

Në librat e tefsireve që janë në qarkullim dhe në citatet e marra prej këtyre librave, shpjegohet kuptimi i fjalës “الدَّيْنِ” – “ed’ dijn” – “fesë”. Në këta libra shpjegohet se kjo fjalë është në kuptimin: shpërblim e llogaridhënie, por ky kuptim, gjithashtu, është përmendur edhe në librat e gjuhës. Gjuhëtarët kanë argumentuar saktësinë e interpretimit të bërë nga ana e tyre, duke u bazuar me dëshmitë e marra prej fjalëve të poetëve arabë, siç është fjala e poetit: “واعلم بانك ما تدين تدان” – “uaëlem bien’neke kemà tudijnu tudànu” – “dhe dije, se padyshim, do të bëhet ashtu siç ke bërë”. Po në këtë kuptim është edhe fjala që ka thënë Sehl bin Rebij’ah:

“ولم يبق سوى العدوان دناهم كما دانوا” – “ue lem jebka sivel-udvànì denàhum kemà dànù” – “dhe s’mbeti gjë tjetër përveç agresionit që u afrohej atyre, ashtu siç u afruan ata”.<sup>1</sup>

Duke u mbështetur në të gjitha këto shpjegime, ata kanë thënë se edhe emri: “الدَّيْنِ” – “Ed’dej’jàn” – “Gjykuesi”, që është prej emrave hyjnorë, është në këtë kuptim.

Ka shumë mundësi që qëllimi i përdorimit të fjalës: “الدَّيْنِ” – “ed’ dijn” – “fesë”, të jetë ligji i vërtetë i fesë. Meqenëse gjurmët e fesë do të bëhen të dukshme në Ditën e Kiametit, ditën, kur të vërtetat e fesë do të dalin jashtë mbulesave, është detyrë që për këtë ditë të themi se ajo është “يوم الدين” – “jeumud’ dijn” – “dita e fesë”, ashtu

---

<sup>1</sup>Sehl bin Shejbàn, “Xhàmiu-sh’ shevàhid”, K. “Germa -f-”, “Germa -l-”, f. 185.



siç thuhet “dita jonë” për ditën tonë në këtë botë, sepse është dita në të cilën janë të dukshme gjurmët e kësaj bote dhe mosdalja sheshit e të vërtetave të fesë.

Një shembull të ngjashëm e gjejmë edhe në fjalën e Allahut të Lartësuar: “وَذَكِّرْهُمْ بِأَيَّامِ اللَّهِ” - “...ue dhek'kirhum bie'jâmil'lâh...”- “...përkujtoju atyre ditët e Allahut!”<sup>1</sup>Kujtoju atyre ditët, kur i Vërteti i Lartësuar do t'i trajtojë me ashpërsi disa njerëz.

Por edhe Dita e Kiametit është ditë e Allahut, është “dita e fesë”, sepse është dita, në të cilën do të shfaqet hapur pushteti hyjnor, prandaj ajo është dita, në të cilën e vërteta e fesë do të dallohet qartë.

إِلَّاكَ نَسْتَعِينُ وَإِلَيْكَ نَسْتَعِينُ

**“Ij'jàke naëbudu ue ij'jàke nesteijnû” – ‘Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**

I dashur, dije se rrugëtari për te Allahu, pasi arrin në rrugën e njohjes, të gjitha falënderimet e lavdërimet e tij janë të veçanta vetëm për personin e pastër, të Vërtetin. Gjithashtu, pasi ai ndërgjegjësohet se ekzistenca dhe shtrirja e ekzistencës janë prej Tij, ai njih se gjendjet kritike të punëve, nga e para deri në të fundit dhe nga fillimi deri në mbarim, janë në dorën e sundimit të Tij dhe, pasi në zemrën e rrugëtarit për te Allahu shkëlqen besimi vetëm për Personin e të Vërtetit se Ai është Një e i Vetëm, njëkohësisht në

---

<sup>1</sup>Sure “Ibrâhim”, ajeti 5.



zemrën e tij shkëlqen edhe besimi se të gjitha punët janë vetëm prej Tij, në këtë cak të njohjes, ai adhurimin e kryen vetëm për të madhëruar Allahun dhe kërkon ndihmë vetëm prej të Vërtetit të Lartësuar, për rrjedhojë ai shumë shpejt do të shohë se e gjithë shtëpia e vërtetimit është e nënshtruar ndaj Personit të pastër të të Vërtetit – me dëshirë ose pa dëshirë – dhe se në shtëpinë e vërtetimit s’ka të fuqishëm tjetër, të cilit mund t’i kërkohet ndihmë.

Megjithëkëtë, disa prej atyre që shohin vetëm anën e jashtme të kuptimit të ajeteve të Kur’anit Famëlartë (dhahiritë), thonë se reduktimi i adhurimit vetëm për të Vërtetin është plotësisht i vërtetë, kurse reduktimi i kërkimit të ndihmës nuk është i vërtetë. Këtë thënie ata e mbështesnin në argumentin se kërkimi i ndihmës është i mundshëm edhe me diçka tjetër, pasi Kur’ani Famëlartë thotë: “تَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ” – “...teàvenù alel birr’rri uet’takvâ” – **“Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!”**<sup>1</sup> dhe “وَاسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ” – “...uesteijnù bis’sabri ues’salât” – **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz!”**<sup>2</sup>

Gjithashtu, ata shtojnë se nga domosdoshmëria, ashtu siç e lexojmë në jetëshkrimin e Profetit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose në jetëshkrimin e imamëve të udhëzuar në rrugën e drejtë, ose në jetëshkrimin e sahabëve dhe të gjithë myslimanëve, në shumicën e punëve të lejuara, përveç Allahut, kanë kërkuar ndihmë edhe prej të tjerëve,

---

<sup>1</sup>Sure “El Màide”, ajeti 2.

<sup>2</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 45.



siç është kërkimi i ndihmës prej kafshës, shërbyesit, gruas, shokut, korrierit, meditësit etj.

Dhe kjo është në përputhje me harkun e veprimit të atyre, që siç u shpjegua më sipër, quhet ehlu-dh'dhàhiri.

Në një kohë kur për individin që ka informacion, në lidhje me besimin se të gjitha punët janë vetëm prej të Vërtetit (e't'auhjdul ef'âlij), ai sheh se sistemi i ekzistencës është një kopje vepruese e të Vërtetit të Lartësuar, pasi ai ka arritur ta kuptojë të vërtetën e parullës: "S'ka ndikues në ekzistencë, përveç Allahut". Këtë ai e arrin ose me rrugën e argumentit, ose me rrugën e vëzhgimit. Vetëm atëherë, me anë të vëzhgimit dhe me dritën e zemrës, ai e përqendron kërkimin e ndihmës vetëm në të Vërtetin e Lartësuar. Ai sheh se ndihma e qenieve të tjera është vetëm një kopje e ndihmës së të Vërtetit.

Gjithnjë, bazuar mbi fjalën e dhahirive, mësohet veçoria e kuptimit të falënderimeve e lavdërimeve për të Vërtetin e Lartësuar, sepse të gjitha qeniet, mbështetur në këtë shtrirje të kuptimit, janë veprime, përzgjedhje, bukuri e plotësim, prandaj ato meritojnë falënderim e lavdërim, madje edhe jeta, vdekja, furnizimi me mjetet e jetesës, njerëzit dhe të tjera punë, do të jenë punë të përbashkëta ndërmjet të Vërtetit dhe njerëzve.

Por kjo, në besimin e njerëzve të Allahut, është idhujtari, e cila në transmetime është shprehur me termin "idhujtari e fshehtë", madje numërohet administrim i vulosjes për të mbajtur në mendje një punë që është prej idhujtarisë së fshehtë.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Idhujtaria e fshehtë është më e fshehtë se zhurma e këmbës së milingonës. Prej idhujtarisë së fshehtë është ndryshimi i unazës,



Në përgjithësi, ajeti: “إِيَّاكَ تَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ” – “Ij’jake naëbudu ue ij’jake nesteijnun” – **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**, është degëzim i frazës: “الحمد لله” – “el hamdu lil’läh” – **“Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun!”**, sepse kjo frazë tregon besimin e vërtetë, që Allahu është Zoti Një e i Vetëm (tregon et’teuhjduh-hakikij).

Në zemrën e atij individ që nuk shkëlqen e vërteta e besimit, që Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe zemra e tij nuk është e pastruar prej idhujtarisë së të gjitha ngjyrave, fjala: “إِيَّاكَ نَعْبُدُ” – “Ij’jake naëbudu” – **“Vetëm Ty të adhurojmë”** nuk do të jetë e vërtetë. Ai nuk do të ketë mundësi të përqendrojë adhurimin dhe kërkimin e ndihmës vetëm në të Vërtetin, për rrjedhojë, ai kurrë nuk do të orientohet kah Allahu dhe kurrë nuk do të kërkojë të Vërtetin e Lartësuar.

Por, kur në zemrën e tij shkëlqen besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe, sipas sasisë së këtij shkëlqimi, ai largohet prej qenieve dhe lidhet me pastërtinë e të Vërtetit, deri sa sheh se

“إِيَّاكَ تَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ” – “Ij’jake naëbudu ue ij’jake nesteijnun” – **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**, ndodh me emrin e Allahut, për rrjedhojë në zemrën e tij shkëlqejnë disa prej të vërtetave të “انت كما اثبتت على نفسك” – “Ente kemà ethmejte alà nefsike” – **“Ti je ashtu siç e ke lavdëruar veten Tënde”**.<sup>1</sup>

---

për të kujtuar diçka dhe të ngjashme me këtë”. Lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 12, f. 96 dhe “Meànij El’akhbàr”, f. 379.

<sup>1</sup>Nga duaaja e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!) në sexhde; lexo “Auàlij El-Lealij”, vëll. 1, f. 389.





## Vërejtje ndriçuese

Nga ajo që u tha më sipër, në këtë sure sure të bekuar bëhet i qartë sekreti i heqjes dorë prej kalimit në bisedë prej të panjohurës në të njohurën.

Kjo mënyrë të foluri, edhe pse është prej përmirësuesve të fjalës dhe prej karakteristikave të oratorisë, qarkullon dendur në bisedat e oratorëve, sepse kjo mënyrë të foluri çon në përmirësimin e në zbulimin e fjalës. Veç kësaj, kalimi nga njëra gjendje në një gjendje tjetër heq prej bashkëbiseduesit ndjenjën e mërzitjes dhe në shpirtin e tij shkakton përtëritjen e aktivitetit. Por, meqenëse namazi është miraxhi i arritjes në praninë e pastër dhe shkalla ngjitëse për të arritur pozitën e njerëzores, atëherë qëllimi në këtë sure të nderuar është urdhri për ngritjen shpirtërore dhe për udhëtimin njohës.

Por robi, në fillimin e udhëtimit për te Allahu, është i burgosur e i mbuluar me mbulesat e errësirës së botës së natyrës dhe me mbulesa drite të botës së panjohur. Gjithashtu, edhe udhëtimi për te Allahu, në të vërtetë, është dalje jashtë këtyre mbulesave, me anën e mënyrës së sjelljes shpirtërore, kurse emigrimi për te Allahu, në të vërtetën e Tij, është kthim te Allahu prej shtëpisë së vetes, prej shtëpisë së njerëzve, heqje dorë prej shumicave, shkundje e pluhurit të altruizmit dhe arritja e besimit në Njëshin, paraqitja pranë Sistemuesit. Kur ky rrugëtar mendon mbi ajetin e nderuar: “مالك يوم الدين” - “*Màliki jeumid'dijn*” - “**Sunduesit të Ditës së Gjykimit**”, ai shikon një pështjellje për shumicat nën shkëlqimin e dritës së sundimit e të shtypjes, atëherë te ai arrihet



gjendja e shuarjes prej shumicave dhe për të realizohet paraqitja e tij në praninë e pastër. Pikërisht në këtë prani, ai, me anën e bashkëbisedimit dhe shikimit të bukurisë e madhështisë, shpalos robërinë. Në këtë gjendje, ai arrin vendmbledhjen e pastër, arrin edhe panelin e njerëzores, me anën e orientimit të tij kah Allahu dhe mundit të tij në kërkimin e të Lartit.

Edhe nga analiza gjuhësore, ka shumë mundësi që plotësimi i këtij qëllimi të arrihet në saje të ardhjes së përemrit “إيالة” - “Ij’jake” - “Ty”. Plotësimi i këtij qëllimi është i realizueshëm me këtë përemër, pasi vetë përemri ka lidhje me Personin e të Vërtetit të Lartësuar dhe, në të cilin, shumicat janë në brendësi të Tij, prandaj, në këtë pozitë, është e mundur që për rrugëtarin të arrihet gjendja e besimit se vetëm Personi i të Vërtetit është Një e i Vetëm, si dhe largimi i zemrës së tij prej shumicës së emrave e cilësive, atëherë vetë faqja e zemrës bëhet prania e Personit të dëlirë, pa mbulesat e shumicave.

Pikërisht kjo gjendje është “plotësimi i besimit se Allahut është Zoti Një e i Vetëm”, besim për të cilin imami i atyre që besojnë vetëm Allahun, Zotin Një e të Vetëm, zotëria i njohësve, prijësi i të dashuruarve, pionieri i të tërhequrve e i dashamirëve, prijësi i besimtarëve (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij dhe prej fëmijëve të tij!*), thotë: “Plotësimi i teuhidit (besimi që Allahu është Zoti Një e i Vetëm), është mohimi i cilësive prej Tij”,<sup>1</sup> sepse cilësia është njëra anë e altruizmit dhe e shumicës.

Ky orientin ndaj shumicës, madje edhe ndaj emrave të shumicës, është shumë larg prej sekreteve të besimit, që Allahu

---

<sup>1</sup>“El-usùlu minel-kàfij”, Libri “Et’teuhijdu”, K. “Xhevàmîu-t’teuhijdi”, Hadithi 6.



është Zoti Një e i Vetëm dhe prej të vërtetave të zhveshjes, prandaj ka shumë mundësi që këtu qëndron edhe sekreti në gabimin e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ai u orientua kah shumica e emrave, të përfaqësuar në shpirtin e pemës, nga e cila ai ishte ndaluar.



## Hulumtim gnostik

Mëso se dhahiritë (ata që marrin vetëm anën e jashtme të ajeteve të Kur'anit) kanë përmendur disa lejime, në lidhje me shpjegimin e foljeve: “تعبد” - “*nabudu*” - “**adhurojmë**” dhe “نستعين” - “*nesteijnu*” - “**kërkojmë**”, që në këtë sure kanë ardhur në numrin shumë të vetës së parë, megjithëse adhuruesi është një individ i vetëm.

Prej këtyre lejimeve është edhe fjala e tyre: në këto folje, adhuruesi ka parë një rrugëdalje ligjore, me anë të së cilës sigurohet se adhurimi i tij është bërë në vendin e pranimit pranë të Vërtetit të Lartësuar. Patjetër që kjo ndodh, kur ai e paraqet adhurimin e tij në kuadrin e adhurimit të të gjitha krijesave, përfshirë edhe eulijatë e plotësuar, të cilëve, i Vërteti Fuqplotë, ua pranon adhurimin, deri te prezenca e pastër dhe te burimi i mëshirës. Vetëkuptohet se adhurimi i tij është i pranuar, pasi nuk është në zakonin e Bujarit të ndajë një marrëveshje të vetme në disa pjesë.

Prej atyre lejimeve është se kryerja e adhurimit, e përmendur në numrin shumë, ka ardhur për shkak se namazi, në fillim, është vënë në ligjin e fesë të kryhet me xhemat.

Më përpara, në kapitullin “Sekreti i përgjithshëm për ezanin dhe për ikametin” ne kemi përmendur një kërkesë, e cila deri në një farë caku zbulon sekretin e ardhjes së foljeve të mësipërme në numrin shumë. Ne kemi thënë se ezani është shpallja e fuqive hyjnore dhe të pushtetit të rrugëtarit për te Allahu, për të qenë i pranishëm në atë vendmbledhje dhe se ikameti është ndalimi i këtyre fuqive, për të qenë në gatishmëri në atë vendqëndrim. Kur



rrugëtari për te Allahu, e realizon të plotë sjelljen e fuqive të tij hyjnore e të pushtetit në atë vendmbledhje, ai e vë zemrën e tij, e cila është udhëheqësi i të gjitha fuqive të tij, që ajo të jetë prijëse për të gjitha fuqitë e tij, atëherë, në të vërtetë, namazi është kryer dhe “besimtari i vetëm është një grup i vetëm”<sup>1</sup>. Bazuar mbi këtë shpjegim, të gjitha foljet e ardhura në këtë sure në numrin shumë: “نعبد” - “nabudu” - “adhurojmë”, “نستعين” - “nesteijnu” - “kërkojmë” dhe “اهدنا” - “ihdinà” - “udhëzo”, tregojnë këtë xhemat të mbledhur pranë të Pastrit.

Transmetimet dhe lutjet e njohura, të ardhura prej Ehli Bejtit, prej të ruajturve prej mëkatit, prej të pastërve, të cilët janë burimi i diturisë e i dëshmisë, të gjitha tregojnë këtë kuptim.

Ana tjetër që unë shikoj në këtë çështje, është si më poshtë: Kur rrugëtari për te Allahu i ka bërë të veçanta të gjitha falënderimet e të gjitha asgjësimet vetëm në të Vërtetin e Lartësuar dhe ka lënë jashtë nga çdo falënderim e nga çdo lavdërim gjithçka tjetër në gjithësi, në fuqitë e në pushtetin e tij, këtë ai e realizon, kur thotë: “الحمد لله” - “el hamdu lil'lâh” - “Falënderimi është vetëm për Allahun”. Për më tepër, është vërtetuar qartë në argumentet e imamëve, të atyre që kanë arritur gradën e njohjes, se rrethi i gjithë ekzistencës, me sundimin e me cilësitë e saj, me gjithçka që ka në të e me të gjitha grimcat e saj, të gjitha, kanë një jetë me ndijime dalluese kafshërore, madje edhe njerëzore. Këto ndijime janë falënderim dhe dëlirje për të Vërtetin e Lartësuar nga të kuptuarit dhe nga ndijimet, për faktin se ndjenja e nënshtrimit në praninë e pastër të të Plotit e të Bukurit absolut, është e gdhendur në cilësinë

<sup>1</sup>“Vesàilu-Sh’shij’ah”, Libri “Es’salàtu”, K. “Namazi me xhemat”, Ndarja “En’ne ekal’lu ma tenakidu-xhamàatu”, Hadithi 2 dhe 5.



e pastër të krijimit të të gjitha qenieve, sidomos në specien njerëzore, balli i të cilëve bie në sexhde, në pragun e pranisë së Tij të pastër. Këtë argument të fuqishëm e forcon edhe fjala e të Lartit: “مَنْ شَىءَ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ وَأَنْ” - “...ue in min shej'in il'là juseb'bihu bihamdihî ue lakin lâ tefkahûne tesbijhahum...” - **“Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata”**.<sup>1</sup>

Gjithashtu, këtë kuptim e mbështesin edhe ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë, si dhe njoftimet e shumta, të ardhura prej të ruajturve nga mëkatet.

Kur rrugëtari për te Allahu e kupton këtë të vërtetë me anën e nxjerrjes së argumentit, ose me anën e ndijimit të besimit dhe të shikimit të drejtpërdrejtë të njohjes, atëherë në çdo pozitë që të jetë, ai ka kuptuar se të gjitha grimcat e ekzistencës dhe të gjithë banorët e botës së panjohur dhe të botës që shihet, të gjithë adhurojnë të Adhuruarin absolut, të gjithë kërkojnë Atë që i bëri ata të ekzistojnë. Pikërisht në këtë cak, ai shpall në numrin shumës, se të gjitha qeniet adhurojnë Personin e pastër të të Vërtetit të Lartësuar dhe pohojnë se ata vetëm prej Tij kërkojnë ndihmë, në të gjitha gjendjet, qoftë kur janë në lëvizje, qoftë kur janë në gjendje qetësie.

---

<sup>1</sup>Sure “El Isrà”, ajeti 44.



## Vërejtje dhe fjalë e hollë

Mëso se ata (dhahiritë) janë shprehur në lidhje me lejimin e vënies të frazës “إياك نعبد” - “ij’jà naëbudu” - **“vetëm Ty të adhurojmë”** para frazës “إياك نستعين” - “ij’jàke nesteijnu” - **“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**, megjithëse rregulli në adhurim kërkon vënien përpara të kërkimit të ndihmës, pasi kjo ndihmë kërkohet në vetë adhurimin. Për këtë, ata kanë shprehur disa lejime, prej të cilave:

- Padyshim që adhurimi ka përparësi ndaj kërkimit të ndihmës, por jo ndaj dhënies së ndihmës, sepse dhënia e ndihmës mund të ndodhë, edhe pa kërkuar ndihmë.

- Ata kanë thënë se, meqenëse adhurimi dhe kërkimi i ndihmës janë të lidhura mes tyre, atëherë s’ka dallim, nëse njëra prej këtyre dy fjalëve vihet përpara ose prapa tjetrës. Është njëlloj, si kur thua: “Ti e kreve detyrimin ndaj meje dhe mua më bëre mirësi”, ose: “Ti më bëre mirë mua dhe detyrimin ndaj meje e kreve”.

- Gjithashtu ata kanë thënë se vënia e kërkimit të ndihmës në vijim të tekstit, është për adhurimin vijues dhe jo për adhurimin aktual.

Ndër dijetarët e mirëfilltë nuk është e panjohur ftohtësia e këtyre justifikimeve dhe lejimeve.

Mbase sekreti në këtë vënie përpara qëndron në faktin se kërkimi i ndihmës përqendrohet vetëm në të Vërtetin e Lartësuar, sipas pozitës së ecjes për te Allahu dhe është më prapa në



përqendrimin e adhurimit vetëm për të Vërtetin. Kjo është fare e qartë. Gjithashtu, dihet se shumë prej të quajturve muveh'hid' dijn (ata që besojnë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm) - të cilët e përqendrojnë adhurimin vetëm për të Vërtetin e Lartësuar, janë pjesëtarë në kërkimin e ndihmës dhe nuk e përqendrojnë kërkimin e ndihmës vetëm në të Lartin - një shprehje të ngjashme e kemi cituar prej disa krerëve të interpretuesve të Kur'anit, të cilët kanë thënë: "Përqendrimi i kërkimit të ndihmës nuk është i vërtetë".

Atëherë, përqendrimi i adhurimit vetëm për të Vërtetin, në kuptimin qarkullues të kësaj fjale, është prej fillimeve të pozitive të atyre që besojnë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (muveh'hid' dijn), në një kohë që përqendrimi i kërkimit të ndihmës do të thotë: heqje dorë në mënyrë absolute prej çdo gjëje tjetër, përveç të Vërtetit. Nuk është e panjohur se qëllimi me "kërkimin e ndihmës", është kërkimi i ndihmës në punët në përgjithësi dhe jo "kërkimi i ndihmës" vetëm në adhurim. Por e gjitha kjo do të jetë vetëm pas mospranimit të shkaqeve, pas heqjes dorë prej shumicave dhe pas drejtimit për te Allahu, në mënyrën më të plotë.

Me fjalë të tjera, përqendrimi i adhurimit është kthimi drejt të Vërtetit dhe kërkimi i Tij, si dhe heqja dorë nga kërkimi i të tjerëve, përveç Atij; kurse përqendrimi i kërkimit të ndihmës është shikimi altruist i të Vërtetit të Lartësuar. Heqja dorë nga shikimi i të tjerëve - në pozitat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (arifjn) dhe në pozitat e rrugëtarëve për te Allahu - është pas heqjes dorë prej kërkimit të një tjetri.





## Dobi njohëse

Ti rrugëtar për te Allahu mëso se përqendrimi i adhurimit dhe kërkimi i ndihmës në të Vërtetin e Lartësuar, nuk janë prej pozitave të plota të atyre që besojnë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (muveh'hid' dijn), nuk janë as shkallët ngjitëse të rrugëtarëve për te Allahu, sepse në to ka pretendime që e mohojnë besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) dhe zhveshjen (texhrid), madje shikimi i adhurimit, adhuruesit, i Adhuruari, Kërkuesit të ndihmës, ndihma që kërkohet me Atë dhe vetë kërkimi i ndihmës, është mohim i besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid). Por besimi i vërtetë që Allahu është Zoti Një e i Vetëm, besim që shkëlqen në zemrën e rrugëtarit për te Allahu i shuan këto shumica dhe në atë zemër këto punë nuk shihen.

Po, shumica nuk është mbulesë për ata persona, në të cilët është realizuar pozita e zgjimit prej tërheqjes së panjohur dhe prej saj ata janë kthyer në veten e tyre. Në këtë çështje, njerëzit janë në disa grupe:

Njëri grup është “i mbuluar”, që janë të ngjashmit me ne, të zhyturit në mbulesat errësuese të natyrës.

Grupi tjetër janë ata që quhen “salikun”, të cilët janë udhëtarët për te Allahu, ata që marrin rrugën e emigrimit për të qenë pranë Allahut.

Një grup tjetër janë ata që quhen “vasilun”, të cilët janë ata që kanë dalë jashtë mbulesave të shumicës dhe merakosen me të Vërtetin. Ata janë të shkujdesur ndaj njerëzve dhe janë të mbuluar



ndaj tyre. Te këta individë është arritur humbja e përgjithshme e ndjenjave dhe shuarja absolute.

Ka dhe prej atyre që quhen “të kthyerit te njerëzit”, të cilët kanë shenjën dalluese “të të plotësuarve dhe të udhëzuesve në rrugën e drejtë”, siç janë profetët e mëdhenj dhe të porositurit e tyre, të cilët, edhe pse faktikisht janë brenda shumicës, merakosen vetëm për udhëzimin e njerëzve, pasi perdet e shumicës kurrë nuk i mbulojnë ata dhe ata janë në pozitën e Berzahut.

Bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti: “إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ” - “*Ij’jake naëbudu ue ij’jake nesteijnnu*” - “**vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë**” ndryshon me ndryshimin e gjendjeve të këtyre grupeve.

Këto grupe prej nesh, të mbuluarve, është thjesht pretendim e formë e jashtme. Kur ne shikojmë me vërejtje mbulimin tonë, atëherë e kuptojmë mangësinë tonë dhe adhurimi ynë ka fituar ndriçimin, sipas masës së njohurisë në lidhje me mangësinë që kemi dhe ne na kanë përfshirë butësitë e të Vërtetit të Lartësuar.

Këto grupe të rrugëtarëve për te Allahu janë të afërta me të vërtetët, sipas masës së rrugëtimit që ata bëjnë.

Këto grupe janë edhe prej atyre që u quajtën “vasilin”, në raport me shikimin e vërtetë të të Vërtetit dhe në raport me shikimin e shumicës, në mënyrë figurative që ndodh zakonisht.

Këto grupe janë edhe prej të plotësuarve, që janë e vërteta e mirëfilltë. Ata nuk janë të mbuluar as me mbulesë hyjnore, as me mbulesë të krijuar.



## Zgjim nga besimi

I nderuar, mëso se, për aq kohë sa ne vazhdojmë të jemi nën mbulesat e errëta të natyrës, duke e harxhuar jetën tonë për të populluar këtë botë e për të arritur kënaqësitë e saj, krejtësisht të shkujdesur ndaj të Vërtetit të Lartësuar, pa e përmendur Atë dhe pa menduar rreth të Lartit, në këtë gjendje, patjetër që të gjitha adhurimet tona, përmendjet e Allahut që bëjmë dhe këndimi i Kur'anit, të gjitha këto janë të zhveshura nga e vërteta dhe nuk mundësojnë përqendrimin e falënderimeve për të Vërtetin e Lartësuar nëpërmjet fjalës "الحمد لله" - "El hamdu lil'làh" - "**Falënderimi është vetëm për Allahun**", ose dhurimin në njërën rrugë të së vërtetës, e shprehur me ajetin: "إياك نعبد وإياك نستعين" - "Ij'jàke naëbudu ue ij'jàke nesteijn" - "**vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**". Me të tilla pretendime boshe, në praninë e të Vërtetit të Lartësuar, engjëjve të Tij të afërm, profetëve e të dërguarve të Tij dhe eulijave të Tij të ruajtur prej gjynaheve, ne jemi kokulur dhe të mbuluar me turp.

Është e çuditshme! Si është e mundur që dikush, me punën e me fjalën e tij, vazhdon të falënderojë banorët e kësaj bote dhe në të njëjtën kohë thotë: "الحمد لله" - "El hamdu lil'làh" - "**Falënderimi është vetëm për Allahun**"? Me ç'gjuhë ka mundur ta shqiptojë këtë frazë, kur zemra e tij është e lidhur me këtë botë të zbrazur? Në të njëjtën gjendje është edhe personi që pohon se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, ndërkaq ai mbështetet te njerëzit dhe beson njerëzit, megjithëkëtë ai vazhdon të deklarojë: "إياك نعبد وإياك نستعين" - "Ij'jàke



*na'ebudu ue ij'jàke nesteijn*" –“**vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë**”?!

Atëherë, kur ti je i aftë për këtë sfidë, patjetër që ti duhet të përforcosh vendosmërinë dhe në fillim le të jesh më i hapur në arritjen e këtyre të vërtetave e butësive që ne përmendëm më sipër, në kuadrin e kësaj kumtese. Vetëm forcimi i vendosmërisë mundëson që këto mirësi të arrijnë në zemrën tënde nëpërmjet përmendjes së shpeshtë të të Vërtetit dhe mendimit të përqendruar rreth madhësisë së të Vërtetit të Lartësuar, njëkohësisht duke u ndërgjegjësuar se sa të ulëta janë krijesat, sa të pafuqishme e sa shumë nevojë kanë ato për të Vërtetin e Lartësuar. Për të gjitha këto, zemra jote, patjetër, duhet të gjallërohet me përmendjen e të Vërtetit të Lartësuar, pasi kështu shpresohet që një fllad prej besimit që Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), të arrijë në brendësi të zemrës tënde. Atëherë, mbase do të gjesh një rrugë që çon në lutjet e atyre që kanë arritur gradën e njohjes.

Por, nëse ti nuk je i përshtatshëm për këtë përballje, më e pakta le të marrim parasysh mangësinë tënde, le të kthejmë kokën kah ultësia jote e kah pamundësia jote, prandaj adhurimin tënd kryejë me ndjenjën e turpit dhe bëj shumë kujdes, kur të pretendosh robërinë, sepse krahas mangësisë tënde, edhe këndimi i këtyre ajeteve të nderuara nga ty, nuk është realizuar me butësinë e gjuhës së eulijave të plotësuar, prandaj bëje këndimin tënd të Kur'anit të atillë, që të mos i largohet formës së Kur'anit, me qëllim që pretendimi yt të mos jetë i gabuar, ose më e pakta, pretendimi yt të mos jetë i rremë.



## Degëzim juridik

Mëso se disa juristë të ligjit të fesë nuk e pranojnë që qëllimi i ajetit: “إياك نعبد وإياك نستعين” – “*Ij'jàke nabudu ue ij'jàke nesteijnû*” – **“vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkujmë”**, është rëndësishja e besimit duke përmendur Allahun. Këtë gjë ata konsiderojnë në kundërshtim me Kur'anin dhe me këndimin e Kur'anit, duke vënë parasysh se këndimi është citim i fjalës së një tjetri.

Por kjo fjalë nuk gëzon autoritet, pasi njeriu ka mundësi ta lavdërojë një person me fjalët e tij, ose edhe me fjalët e të tjerëve. Për shembull, ne mund ta lavdërojmë një person me një poezi të Hafizit, për ne vërtetohet se e kemi lavdëruar atë; gjithashtu, vërtetohet se ne kemi lexuar një poezi të Hafizit. Bazuar mbi këtë retorikë, me fjalën tonë: “الحمد لله رب العالمين” – “*El hamdu lil'làhi rabbil àlemijne*” – **“Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Sunduesin e botëve”**, në të vërtetë ne i kemi përqendruar të gjitha lavdërimet me të Vërtetin e Lartësuar; gjithashtu, me fjalën tonë: “إياك نعبد” – “*Ij'jàke naëbudu*” – **“vetëm Ty të adhurojmë”**, ne e kemi përqendruar adhurimin vetëm për të Lartin, për rrjedhojë, për ne vërtetohet se e kemi falënderuar Allahun me fjalën e Tij të lartë dhe e kemi përqendruar adhurimin e të Lartit me fjalën e Tij. Madje, sikur dikush ta zhveshë fjalën prej kuptimit të rëndësishjes së besimit dhe përmendjes së Allahut, atëherë puna e tij do të jetë në kundërshtim me rezervën, pasi ne kurrë nuk kemi thënë që këndimi i tij është i gabuar.



Le të supozojmë se një person nuk e di kuptimin e asaj pjese që lexon, atëherë ai ka detyrë të menjëhershme ta mësojë kuptimin e saj, madje për atë është e mjaftueshme që t'i lexojë pjesët që ua di kuptimin.

Në transmetimet e nderuara, theksohet gjendja e rrënjës së besimit dhe përmendja e Allahut te lexuesi, bazuar në shembullin e fjalëve të hadithit kudsi: *“Kur çdo rob thotë në namazin e tij: ‘Bismil’lâhi rr’rrahmâni-rr’rrahijm’, Allahu thotë: ‘Robi Im, më përmendi Mua!’ Kur robi thotë: ‘El hamdu lil’lâh’, Allahu i Lartësuar thotë: ‘Robi Im më falënderoi Mua...’”*.<sup>1</sup>

Për aq kohë sa për robin nuk është bërë realitet emërtimi: *“التسمية”* - *“e’tesmijetu”* - *“Bismil’lâhi-rr’rrahmani-rr’rrahijm”* dhe *“الحمد”* - *“el hambu”* - *“falënderimi”*, nuk ka kuptim për fjalën e të Lartit: *“ذكري”* - *“dhekerenij”* - *“më përmendi Mua”* dhe *“حمدي”* - *“hamidenij”* - *“më falënderoi Mua”*.

Ose fjala e Tij, e ngjashme në hadithin e Miraxhit:

*“الآن وصلت فستم باسمي”* - *“El-àne vesalte fesem’mi bi’ismij”* - *“tani arrite dhe emërto me emrin Tim (thuj bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm)”*.<sup>2</sup>

Prej gjendjeve, kur imamët e udhëzuar në rrugën e drejtë kërkonin ndjesë gjatë faljes së namazit, kur thoshin: *“مالك يوم الدين”* - *“Màliki jeumid’dijn”* - *“Sunduesi i Ditës së Gjykimit”* dhe *“إياك نعبد”* - *“ij’jâke naëbudu”* - *“vetëm Ty të adhurojmë”*, si dhe kur disa prej

<sup>1</sup>El Mehaxh’xhetul-bejdâe”, vëll. 1, f. 388; “Sahijhu” i Muslimit, vëll. 2, f. 92, me ndryshime të vogla, kurse hadithin e plotë e kemi parë gjatë studimit “Etika e këndimit”.

<sup>2</sup>Ilelu-Sh’sherâ’i”, Hadithi “Namazi i Miraxhit”, f. 315.



tyre i përsëritnin këto ajete, arrijmë në përfundimin se ata rrënjoshnin besimin dhe përmendnin Allahun. Veç kësaj, edhe këndimi i tyre nuk ishte thjesht këndim, ose prej mënyrës së shprehjes: *“Ismaili dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”*.<sup>1</sup>

Ndryshimi në gradët e namazit të atyre që quhen njerëz të Allahut, në origjinë, kthehet në ndryshueshmërinë e gradëve të këndimit të tyre, ashtu siç kemi thënë më përpara, kur e kemi trajtuar përciptas këtë çështje. Por, kjo realizohet vetëm nëse kënduesi, me këndimin e tij, ka për qëllim rrënjosjen e besimit dhe përmendjen e Allahut. Dëshmitë për këtë çështje janë shumë.

Në këtë gjendje, s’ka problem për lejimin e qëllimit të rrënjosjes së besimit dhe përmendjes së Allahut me kuptimin e fjalës hyjnore.

## Dobi

Gjuhëtarët vënë në konsideratë se fjala “العبادة” – “*el’ibàdetu*” – “**adhurimi**” do të thotë: nënshtrim e përluje në shkallën më të lartë. Gjithashtu, ata thonë se, përderisa adhurimi përfaqëson gradën më të lartë të nënshtrimit, rezulton se nënshtrimi nuk është i përshtatshëm për asnjë tjetër përveç Atij që është në gradën më të lartë të ekzistencës e të plotësimit dhe në shkallën më të lartë të

---

<sup>1</sup>Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e shkroi këtë frazë mbi qefinin e djalit të tij, Ismailit. Lexo: “Vesàilu-Sh’shij’ah”, Libri “Et’tahàretu”, K. 29 – “Qefinosja”, Hadithi 2.



mirësive e të bamirësive, prandaj adhurimi për ndonjë tjetër, përveç Allahut, është idhujtari (shirk).

Por, është e pamundur që qëllimi i vërtetë me fjalën “adhurim” të jetë në një kuptim më të gjerë nga qëllimi i përmendur më sipër, natyrisht nëse merret parasysh se nënshtrimi është vetëm për Krijuesin, për Sunduesin. Nga ana tjetër, ky nënshtrim e bën detyrim që i Adhuruari të jetë Zot, Sistemues, ose me cilësi të ngjashme. Gjithashtu, nga ky përshkrim rezulton se adhurimi i ndonjë tjetri, përveç Allahut, është idhujtari dhe mohim. Duhet të theksohet se vetëm nënshtrimi, pa qenë i shoqëruar me këtë besim, ose pa qenë i rrethuar me këtë kuptim, qoftë edhe si barrë, nuk bëhet shkak as për mohim e as për idhujtari, edhe nëse e arrin qëllimin e tij, pavarësisht se disa lloje të nënshtrimit e të përuljes janë të ndaluara, siç është vënia e ballit në tokë në shenjë përulje për ndonjë tjetër, megjithëse ky nënshtrim, në pamje të parë, nuk quhet adhurim, përsëri sipas ligjit të fesë, është veprim haram, veprim i ndaluar në formë të prerë.

Ndjekësit e feve demonstrojnë dukuri të madhërimit e të respektit që ata tregojnë ndaj të mëdhenjve të tyre, për të cilët besojnë se edhe ata janë rob që kanë nevojë për të Vërtetin e Lartësuar në të gjitha gjërat, në origjinën e ekzistencës dhe në plotësimin e Tij. Megjithëse ata, nga vetë qenia e tyre rob të mirë, në asnjë mënyrë, nuk kanë mundësi që nga vetja e tyre të sjellin dobi, ose të dëmtojnë. Ata s’kanë fuqi të bëjnë që të tjerët të vdesin, ose të japin jetë, por ata janë prej të afërmeve të të Vërtetit të Lartësuar dhe janë të përfshirë prej butësive të Tij. Pas kësaj, ata janë mjet për të tërhequr dhëniet e Tij dhe në këtë s’ka asnjë shenjë, që të tregojë idhujtari ose mohim, sepse madhërimi i të zgjedhurve të Allahut, është adhurim për vetë Allahun e Lartësuar. Gjithashtu,





edhe dashuria për të zgjedhurit e Allahut, është dashuri për Allahun.

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

*"Ihdinas 'siràtal mustekijme. Siràtal'ledhijne en'ante alejhim Gajril magdùbi alejhim ue led'dàlijne"* – **"Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!"**

I dashur, mëso, ashtu siç kemi thënë më përpara, surja "El Hamd" - (El Fàtiha), në brendinë e saj, tregon programin e ecjes së krerëve të atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe të atyre që praktikojnë ushtrime shpirtërore. Në ajetet e kësaj sureje, duke filluar që nga "bismil'làhi" deri në frazën "إِيَّاكَ نَعْبُدُ" – "ij'jàke naëbudu" – **"vetëm Ty të adhurojmë"**, gjendet shpjegimi për të gjitha etapat e rrugëtimit prej njerëzve deri te i Vërteti. Kur rrugëtari për te Allahu lartësohet prej shkëlqimeve të punëve deri në shkëlqimin e cilësive dhe nga këto të fundit, në shkëlqimet e Personit, ai ka dalë prej mbulesave të dritës dhe ka arritur pozitën e pranisë e të shikimit, atëherë për atë është arritur grada e asgjësimit të plotë dhe e konsumimit të përgjithshëm.

Kur ecja për te Allahu përfundon, deri në perëndimet e horizonteve të robërisë dhe zbardhjes së pushtetit të sundimit, në frazën e ajetit: "مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ" – *"Màliki jeumid'dijn"* – **"Sunduesi i Ditës së Gjykimit"**, në përfundim të këtij rrugëtimi, është arritur gjendja e mundësisë dhe e qëndrueshmërisë, kurse vetë rrugëtari kthehet



në veten e tij, duke realizuar pozitën e zgjimit, atëherë rrugëtari bëhet i vëmendshëm për pozitën e tij, ndjek orientimin për te i Vërteti, kurse e kundërta, është gjendja e kthimit te Allahu, gjendje në të cilën orientimi kah i Vërteti është në vijim të orientimit drejt njerëzve.

Me fjalë të tjera, rrugëtari për te Allahu, gjatë këtij rrugëtimi, sheh të Vërtetin dhe në mbulesën morale ai shikon njerëzit pas kthimit prej gradës së asgjësimit të përgjithshëm, që arrihet nën mbulesën e të Vërtetit, me frazën: “مالك يوم الدين” - “*Mâlîki jeumid’ dijn*” - **“Sunduesi i Ditës së Gjykimit”**.

Pas kësaj fraze, robi thotë: “إياك نعبد” - “*ij’jâke naëbudu*” - **“vetëm Ty të adhurojmë”**, në të cilën, sipas rregullave gjuhësore të gjuhës arabe, është vënë përpara këpuja “أيا” - “*ij’jâ*” - **“vetëm”**, së bashku me germën “ك” - “*k*”, që tregon se ai, me adhurimin e tij, i drejtohet si bashkëbisedues vetëm të Vërtetit të Lartësuar.

Përderisa kjo gjendje është në mundësitë e asgjësimit, gjithashtu, është e mundur edhe rrëshqitja në këtë pozitë, prandaj rrugëtari kërkon për veten e tij, prej të Vërtetit të Lartësuar, qëndrueshmëri e angazhim. Këtë ai e bën, kur thotë: “إهدنا” - “*ihdinà*” - **“na udhëzo”**, që do të thotë, ashtu siç e kemi shpjeguar më sipër: “na angazho”.

Meriton të theksohet se pozita që ne e përmendën dhe interpretimi që ne bëmë, është i veçantë për të plotësuarit, prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes, për të cilët i Vërteti i Lartësuar bëhet perde, e cila i mbulon ata prej njerëzve në pozitën e parë, pozitën e kthimit nga ecja për te Allahu, në një kohë që pozita e tyre është si vetë gjendja e tyre, është si gjendja e madhe e Berzahut,



gjendje në të cilën njerëzit nuk janë për ata mbulesë, që të mos shikojnë Allahun, ashtu siç është gjendja jonë, e të mbuluarve. Gjithashtu, as i Vërteti nuk i mbulon ata që të mos shikojnë njerëzit, ashtu siç është gjendja e tyre, që më sipër i kemi emërtuar “väsiliijn” (ata që arritën), të dashuruarve, të asgjësuarve dhe të tërhequrve. Atëherë fraza e ajetit: “الصراط المستقيم” – “*es'siratal mustekijm*” – “**rrugë e drejtë**”, në raport me ata, shpreh gjendjen e Berzahut ndërmjet dy krijimeve. Pikërisht, kjo gjendje është rruga e të Vërtetit.

Bazuar mbi këtë shpjegim, qëllimi me frazën e ajetit:

“الذين أنعمت عليهم” – “*el'ledhijne en'amte alejhim*” – “**Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi**”, është për ata persona që i Vërteti i Lartësuar ka caktuar shkëlqimin me bujarinë e pastër në audiencën e diturisë, i ka ngarkuar ata me barrën e përgatitjes e të përshtatshmërisë dhe pas vdekjes së tyre, i kthen ata në mbretërinë e Tij.

Për sa i përket frazës së ajetit: “المغضوب عليهم” – “*el magdûbi alejhim*” – “**jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd**”, bazuar në të njëjtin interpretim, tregon të mbuluarit, para arritjes, kurse “الضالون” – “*ed'dâl'lûne*” – “të humburit”, janë të zhdukur, të shkatërruar.

Për sa u përket jo të plotësuarve, që nuk janë prej rrugëtarëve për te Allahu, këto kuptime nuk mund të vërtetohen. “الصراط” – “*es'sirata*” – “**rruga**”, në raport me ta, është rruga e jashtme e ligjit të fesë. Këtu qëndron edhe shkaku që fraza: “الصراط المستقيم” – “*es'siratal mustekijm*” – “**rruga e drejtë**”, është interpretuar: rruga e fesë, rruga e Islamit dhe me fraza të ngjashme me këto dy kuptime.

Kur ata janë prej rrugëtarëve për te Allahu, atëherë qëllimi me “udhëzimin”, në raport me ta, është udhëzimi, kurse qëllimi me



togfjalëshin: “الصراط المستقيم” - “*es’siràtal mustekijm*” - “**rrugën e drejtë**”, është rruga më e afërt për arrijten te Allahu, që është përfaqësuar me rrugën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të Ehli Bejtit të tij.

Gjithashtu, togfjalëshi i ajetit: “الصراط المستقيم” - “*es’siràtal mustekijm*” - “**rruga e drejtë**”, interpretohet me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), me imamët udhëzues në rrugën e drejtë dhe me Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bëri një vijë të drejtë dhe rreth saj bëri vija të tjera, pastaj bëri shenjë më të shkurtër për nga vija e drejtë, e cila përfaqëson vetë atë dhe familjen e tij.<sup>1</sup> Ka shumë mundësi, që fjala: “الأمة الوسط” - “*el um’metu vesetu*” - “**bashkësi të drejtë**” në fjalën e Allahut të Lartësuar: “جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا” - “...*xhealnàkum um’meten vesetan...*” - “**Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë**”<sup>2</sup>, në përgjithësi, është drejtësia, me të gjitha kuptimet që ka kjo fjalë. Prej këtyre kuptimeve, kemi drejtësinë në dituri e në plotësimet shpirtërore, që përfaqëson pozitën e Berzahut të madh dhe të drejtësisë më të madhe. Për të gjitha këto, kjo pozitë është e veçantë për të plotësuarit, prej eulijave të Allahut. Në interpretimin e këtij ajeti, transmetimet shpjegojnë se qëllimi në këtë ajet, janë imamët udhëzues në rrugën e drejtë. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë për Jezijd bin Muavije El-Axheli: “*Ne jemi populli i drejtë dhe ne jemi dëshmitarët e Allahut kudër njerëzve të Tij.*”<sup>3</sup> *Te ne kthehet më e shtrenjta*

<sup>1</sup>Lexo “El- ilmul-jekijn”, vëll. 2, f. 967.

<sup>2</sup>Sure “El Bekare”, ajeti 143.

<sup>3</sup>“El-usùlu minel-Kâfi”, Libri “El-huxh’xhetu”, K. “El-eim’metu shuhedàu-ll’lâhi alà khalkihi”, Hadithi 2.



*dhe me ne fluturon mangësia*".<sup>1</sup> Në këtë fjalë të imamit ka një shenjë të qartë, për atë që thamë më sipër.

## Vërejte ndriçuese dhe ndriçim gnostik

Ti kërkues i të Vërtetit dhe i së vërtetës, mëso se i Vërteti i Lartësuar ka depozituar dhe ka krijuar në cilësinë e pastër të krijimit të të gjitha qenieve, dashurinë për veten dhe dashurinë për specien. Me këtë tërheqje hyjnore e me zjarrin e dashurisë hyjnore, të gjitha qeniet orientohen e shkojnë drejt plotësimit absolut dhe drejt kërkimit të të Bukurit absolut, duke e dashuruar Atë, për faktin se i Larti është Krijuesi i sistemit të ekzistencës dhe i dukurive të botës së panjohur e i botës së njohur, mbi bazën e dashurisë për veten dhe të diturisë, në praninë e emrave e të cilësive, ashtu siç ka ardhur në hadithin kudsî: *"Isha thesar i fshehur dhe desha që të njihem, prandaj njerëzit i krijova që të njihem"*.<sup>2</sup>

Allahu i Lartësuar, në cilësinë e pastër të krijimit, në çdo njërën prej qenieve ka bërë një dritë hyjnore, me të cilën ajo qenie kupton rrugën e arritjes së qëllimit dhe objektivin që synon. Zjarri e drita, njëri prej këtyre të dyjave është "valëvitja e arritjes", si dhe "buraku i Miraxhit". Ka mundësi që "buraku" dhe "valëvitja" e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin xhami fotografik për këtë gjë të rrallë dhe një

<sup>1</sup>"Tefsijrul-Ijâshij", vëll. 1, Hadithi 111, f. 63.

<sup>2</sup>"Esrarul Hikem", f. 20.



formë e pronësisë, e përfaqësuar në këtë të vërtetë. Pikërisht për këtë, “buraku” zbriti prej Xhenetit, që është e brendshmja e kësaj bote.

Meqenëse qeniet kanë zbritur në gradën e cilësive dhe janë mbuluar prej bukurisë së të Bukurit, me bukurinë e të Dashurit të Madhëruar, i Vërteti i Lartësuar, me këtë zjarr e me këtë dritë, i nxjerr qeniet prej mbulesave të errëta të cilësive dhe i çon në “gjendjet ndriçuese aktuale” dhe, me emrin e udhëzuesit të bekuar, i cili përfaqëson të vërtetën e këtyre hollësive, i orienton qeniet sa më afër rrugës që çon në qëllimin e vërtetë dhe në fqinjësi me të Dashurin e të gjitha qenieve. Kjo “dritë” është udhëzim i të Vërtetit të Lartësuar dhe ky “zjarr” është mbarësia hyjnore, është ecja në rrugën më të afërme me rrugën e drejtë, rruga në të cilën është i Vërteti i Lartësuar. Mbase fjala e Allahut të Lartësuar:

“صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ رَبِّيَ عَلَّمَانِي دَابَّةً مِنْ دَابَّةٍ إِلَّا هُوَ عَاجِدٌ بِمَاصِيئِهِ” - “...mà min dâb’betin il’lâ huve àkhdhun binâsijetihâ, in’ne rab’bij alâ sirâtin mustekijm” - **“S’ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij. Me të vërtetë, Zoti im, është në rrugë të drejtë”**<sup>1</sup>, tregon këtë udhëtim, tregon këtë ecje dhe këtë qëllim, ashtu siç është fare e qartë për ata që kanë arritur gradën e njohjes.

I nderuar, ti patjetër duhet të dish se për çdo njëerën prej qenieve ka një rrugë të veçantë, një dritë e një udhëzim të caktuar: **“rrugët për te Allahu janë sa është numri i individëve të krijesave”**. Meqenëse në çdo cilësi ka një mbulesë të errët, për rrjedhojë, në çdo qenie ka një gjendje aktuale mbulesë drite dhe, meqë njeriu është mbledhësi i cilësive dhe bashkuesi i qenieve, patjetër që njeriu është qenia më shumë e mbuluar ndaj të Vërtetit

---

<sup>1</sup>Sure “Hûd”, ajeti 56.



të Lartësuar. Mbase ajeti i nderuar: “*ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ*” - “*Thum'me redednâhu esfeles'sâfilijne*” -“**pastaj e çuam atë** (kur nuk beson) **në gjendjen më të ulët**”<sup>1</sup>, thekson pikërisht këtë kuptim.

Nisur nga ky nivel, rruga e njerëzimit është më e gjata dhe më e errëta se rrugët e tjera.

Gjithashtu, meqenëse “Sistemuesi” i njeriut është prania e emrit më të madh, i cili mund të jetë në të gjithë emrat që qëndrojnë kundrejt njëri-tjetrit, siç janë emrat “*Ed'dâhiru*” - “i Dukshmi”; “*El Bâtinu*” - “i Padukshmi”; “*El Ev'velu*” - “i Pari pa fillim”; “*El Âkhiru*” - “i fundit pa mbarim”; mëshira, zemërimi dhe të gjithë emrat, të gjithë këta emra, në raport me të Vërtetin, janë të barabartë, prandaj njeriu, në fundin e ecjes së tij, ka për detyrë të arrijë në pozitën e Berzahut të madh. Gjithashtu, njeriu ka për detyrë që rruga e tij të jetë më e hollësishmja nga të gjitha rrugët.

---

<sup>1</sup>Sure “Et Tin”, ajeti 5.



## Vërejtje besimi

Nga sa u tha më sipër, bëhet e qartë se për udhëzimin në rrugën e drejtë ka pozita që janë në përshtatje me hullitë mbi të cilën ecin rrugëtarët për te Allahu dhe me gradat e sjelljeve që ata shfaqin. Këtu do të flasim, në përgjithësi, për disa nga këto gradë e pozita, me qëllim që të bëhet e qartë brendia e çdo grade, në kuptimin e frazës së ajetit: “الصراط المستقيم” - “*Es’siràtal mustekijm*” - “**Rruga e drejtë**” dhe të frazës: “المفريطينصراط” - “*siràtal mufritijn*” - “**rruga e atyre që e tejkalojnë**”, si dhe të frazës: “الصراط المفريطين” - “*siràtal muferr’rritijn*” - “**rruga e neglizhuesve** (atyre që lënë mangët)”. Në këto dy fraza përfshihen: “المغضوب عليهم” - “*el magdùbi alejhim*” - “**ata që kanë merituar zemërimin**” dhe “الضالين” - “*ed’dàl’lijn*” - “**të humburit**”, si më poshtë vijon:

*Grada e parë*: drita udhëzuese e cilësisë së krijimit. Për këtë gradë është folur në studimin e kaluar. “الصراط المستقيم” - “*es’siràtal mustekijm*” - “**rruga e drejtë**”, është në këtë gradë të udhëzimit dhe tregon rrugëtimin për te Allahu, kur rrugëtari nuk është i mbuluar as nga mbulesat e aftësive, as nga dhuntitë hyjnore. Gjithashtu, nuk është i mbuluar as nga mbulesat e gjynaheve formale dhe as nga mbulesat e gjynaheve të zemrës; ose është pa mbulimin e mbulesave të atij që e tejkalon kufirin, ose të atij që i neglizhon e i le mangët punët, ose është pa mbulimin me mbulesat e dritës, ose të errësirës; ose është i pambuluar me mbulesat e njëshit e të shumicës. Mbase ajeti i nderuar: “وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ يُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ” - “...judil’lu men





*jeshàu ue jehdij men jeshàu...*” – “**Ai shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë**”<sup>1</sup>, tregon për këtë gradë të udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të mbulimit, që u theksua në këtë pjesë. Por, qoftë udhëzimi në rrugën e drejtë, qoftë mbulimi, që të dyja, janë të caktuara me shkëlqimin në praninë e shikuesve të qëndrueshëm në “audiencën e kaderit”, e cila te ne është “grada e të qenit një”. Shkoqitja me detaje e kësaj çështjeje, del jashtë rrethit të kësaj kumtese, madje është e atillë që as nuk mund të shkruhet e as nuk mund të shpjegohet, sepse është një “sekret prej sekreteve të Allahut dhe një mbulesë prej mbulesave të Allahut”.<sup>2</sup>

*Grada e dytë*: udhëzimi në rrugën e drejtë me dritën e Kur’anit. Përballë këtij udhëzimit qëndron tejkalimi i kufirit dhe mosrealizimi e neglizhimi në fushën e njohjes së kësaj drite, ose qëndrimi në anën e dukshme të dritës, ose qëndrimi në të brendshmen e dritës, ashtu siç është gjendja me disa prej atyre që marrin vetëm anën e dukshme të kuptimeve të ajeteve të Kur’anit Famëlartë (dhâhiritë) dhe mendojnë se dituritë e Kur’anit Famëlartë janë vetëm thjesht kuptime të zakonshme, të përgjithshme dhe koncepte vijuese pozitive. Me këtë koncept, në të vërtetë, ata nuk mendojnë për Kur’anin Famëlartë dhe nuk i studiojnë ajetet e tij, por mjaftohen të përfitojnë prej këtij Libri dritë, që ka ardhur me misionin për të siguruar lumturinë shpirtërore, trupore, lumturinë e zemrës e lumturinë e përfytyruar. Po kështu mendojnë edhe për urdhrat formalë, që ata i nxjerrin nga forma e jashtme e ajeteve të Kur’anit. Me këtë mënyrë të menduari, ata i

<sup>1</sup>Sure “En Nahl”, ajeti 93 dhe sure “Fâtir”, ajeti 8.

<sup>2</sup>Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kaderi është një sekret prej sekreteve të Allahut dhe një mbulesë prej mbulesave të Allahut”. Lexo në librin “Et’teuhij”, K. “El kadàu uel kaderu”, Haditi 32, f. 383.



largohen të gjitha ajeteve që urdhërojnë detyrimet, ose ajeteve që tregojnë se peshorja anon kah mendimi mbi Kur'anin Famëlartë e kah studimi i ajeteve të tij. Ata nuk i hedhin sytë e tyre, që duke studiuar Kur'anit Famëlartë, të përfitojnë e të ndriçohen me dritën e tij. Pa dyshim që studimi i këtij Libri hyjnor, me të vërtetat që ai kumton, hap portat e diturisë. Mirëpo, në këndvështrimin e tyre, Kur'ani Famëlartë është sikur ka zbritur për t'i nxitur ata që të jepen pas kësaj bote dhe pas shijimeve kafshërore, si dhe për të forcuar pozitën e tyre në plotësimin e dëshirave kafshërore.

Gjithashtu, edhe disa prej atyre që quhen Ehli Batin (ata që marrin vetëm anën e brendshme të Kur'anit), janë larg prej Kur'anit Famëlartë, për shkak se edhe këta e përfytyrojnë Kur'anin vetëm nga kuptimi i anës së jashtme të tij dhe nga lutjet shabllone që shpreh ana e jashtme e ajeteve të tij. Në të vërtetë, në kuptimet që shprehin ajetet e Kur'anit Famëlartë, gjendet programi e rruga e vetedukimit me etikën hyjnore. Njëkohësisht, prej ajeteve të Kur'anit mësohet edhe mënyra e rrugëtimit për te Allahu. Por ata janë të shkujdesur nga të gjitha këto, si rezultat i mveshjes që i bën shejtani i mallkuar dhe vetja e tyre, e prirur nga lakmia e nga e keqja. Të gjitha këto bëjnë që ata të devijojnë prej rrugës së Kur'anit, megjithëse ata, sipas iluzioneve që kanë, pretendojnë se u përmbahen diturive të brendshme të Kur'anit, mirëpo gjendja dikton se rruga për të arritur në të brendshmen e Kur'anit kalon nëpërmjet edukimit, me kuptimin e jashtëm të ajeteve të këtij Libri madhor.

Të dy këto grupe janë jashtë seriozitetit që dikton maturaia, prandaj janë të privuara prej dritës së udhëzimit në rrugën e drejtë të Kur'anit dhe kanë kaluar në teprime e shpërdorime, ose në lënien



mangët e në shkujdesjen ndaj kuptimeve të ajeteve të Kur'anit Famëlartë.

Dijetari studiues i hollësive të Kur'anit Famëlartë ka për detyrë të jetë i përkushtuar në studimin e të jashtmes dhe të brendshmes së ajeteve të Kur'anit. Gjithashtu, ka për detyrë të edukohet me etikën formale e morale të Kur'anit. Dijetari studiues, ashtu siç e ndriçon të jashtmen e tij me dritën e Kur'anit, po kështu ka për detyrë që, edhe të brendshmen e tij, ta ndriçojë me dritën e diturive të Kur'anit Famëlartë dhe, mbi të gjitha, ta ndriçojë me dritën e besimit, që Allahu është Zoti Një i Vetëm (teuhid) dhe me rrugën e zhveshjes.

Le të dinë ata që quhen Ehli Dhâhir (marrin vetëm kuptimin e jashtëm të ajeteve të Kur'anit), se me mendimet e tyre zvogëlojnë kuptimet që shprehin ajetet e Kur'anit dhe dituritë e Kur'anit Famëlartë i reduktojnë vetëm në etikën formale të jashtme dhe në një tubë urdhrash praktike, morale e doktrinare të përshkruara në kapitullin e teuhidit, në besimin që Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe në emrat e në cilësitë. Ky qëndrim është injorancë në të drejtën që i takon Kur'anit. Gjithashtu, ata e shkurtojnë shumë edhe legjislacionin e fundit, për të cilin nuk mund të mendohet e të përfytyrohet një legjislacion më i plotë se ai, ndryshe konsiderimi i këtij legjislacioni si legjislacion, vula e të gjitha legjislacioneve të tjera në rrugën e drejtësisë, do të ishte një punë që nuk mund të ndodhë e nuk mund të ekzistojë.

Përderisa ky legjislacion është vula e të gjitha legjislacioneve dhe përderisa Kur'ani Famëlartë është vula e librave të zbritur dhe lidhësi i fundit mes Krijuesit e të krijuarve, patjetër që do të jetë në gradën më të lartë dhe në majën e plotësimit, nga ana e shpjegimit



e të vërtetave të besimit që Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe të zhveshjes, përfshirë të gjitha dituritë hyjnore, të cilat konsiderohen qëllimi origjinal dhe qëllimi më i lartë i feve, legjislacioneve dhe librave hyjnorë të zbritur. Ndryshe, legjislacioni do të ishte me mangësi. Por kjo është në kundërshtim me drejtësinë hyjnore e me butësinë e Edukuesit, çka është e pamundur, në lidhje me Personin e Tij. Veç kësaj, është një turp skandaloz e shumë i keq, madje aq i ndyrë, sa nuk do të pastrohej prej feve të vërteta, edhe sikur të laheshin me ujërat e shtatë deteve. Allahu na ruajtë!

Gjithashtu, edhe ata që quhen Ehli Batin, të cilët pretendojnë se kanë arritur në qëllimin origjinal dhe në qëllimin më të lartë e të vërtetë, nuk e kanë kujdesin të mësojnë se arritja e këtij qëllimi nuk mund të ndodhë pa pastrimin e të jashtmes e të brendshmes. Gjithashtu, edhe arritja në thelbin e të brendshmes nuk mund të realizohet ndryshe, veçse duke u kapur pas formës së jashtme të kuptimeve të Kur'anit Famëlartë. Është e pamundur zhytja në të brendshmen e legjislacionit, pa veshur rrobën e tij të jashtme.

Në heqjen dorë nga e jashtmjia, qëndron bërja pa vlerë e të jashtmes dhe e të brendshmes së ligjit të fesë, në një kohë që kjo heqje dorë është prej veshjeve të shejtanëve, xhind e njerëz. Këtë temë e kemi trajtuar në librin tonë “Sherhul-erbeijne hadijthen” – “Shpjegimi i dyzet haditheve”.

*Grada e tretë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e ligjit të fesë (shariatit);

*Grada e katërt:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e Islamit;



*Grada e pestë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e besimit;

*Grada e gjashtë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, më dritën e vetëbindjes;

*Grada e shtatë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e njohjes;

*Grada e tetë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e dashurisë;

*Grada e nëntë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e kujdestarisë;

*Grada e dhjetë:* udhëzimi në rrugën e drejtë, me dritën e zhveshjes dhe teuhidit - besimi që Allahu është Zoti Një e i Vetëm.

Për çdonjëren prej këtyre gradëve ka dy anë, ana e teprimit dhe ana e lënies mangët, ekstremizmit dhe shkurtimit. Por shkoqitja e kësaj çështjeje patjetër do të zgjatej shumë, prandaj do të mjaftohemi të themi, që këtu bëhet fjalë për disa gradë dhe për të gjitha gradët që kanë ardhur në hadithin e nderuar, i transmetuar në librin "El-Kâfi", në të cilin lexojmë fjalën e Imam Rizait: "*Ne, familja e Muhamedit, jemi tipi i mesatares. Tipin tonë nuk e arrin ekstremisti dhe nuk del para nesh vijuesi*".<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>"El-usûlu minel-Kâfi", Libri "Et'teuhijdu", K. "Ndalimi i cilësimit me diçka ndryshe nga ata që i Larti ka përshkruar Vetën", Hadithi 3.



I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Më i miri i këtij umeti është tipi i mesëm, me atë bashkohet ai që vjen më pas dhe ekstremisti kthehet te ai”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Lexo “Lisànul-areb”, Lënda “Nemetun”.



## Vërejtje gnostike

Në librin tonë “Misbâhul-Hidajeti” kemi shpjeguar se fillimi e burimi është Qenia e Tij e pastër nga ana e mbulimit të emrave. Por emri, në të njëjtën kohë, përfaqëson të emërtuarin, që gjithashtu, është mbulimi i Tij. Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se shkëlqimi në botët e panjohura dhe në botët e njohura, është sipas emrave, me mbulesën e tyre.

Nga sa u tha më sipër, në lidhje me Qenien e pastër, rezulton se në të jashtmen e emrave dhe në të jashtmen e cilësive ka shkëlqime në praninë e diturisë dhe, ata që kanë arritur gradën e njohjes, i emërtojnë ato shkëlqime me shprehjen “inspektorët e qëndrueshëm”, që do të thotë se çdo shkëlqim i emrave në prezencën e diturisë ka një inspektor të qëndrueshëm, për rrjedhojë çdo emër shkencor, është një dukuri në zhvillimin e jashtëm, në atë mënyrë që fillimi i kësaj dukurie dhe kthimi i saj është vetë emri, i cili është në përshtatje me atë dukuri. Gjithashtu, edhe kthimi i çdo qenieje prej botës së shumicës deri në të panjohurën e emrit, që nga burimi e fillimi i tij, shpreh rrugën e tij të drejtë. Bazuar mbi këtë rregull, rezulton se çdo qenie ka një ecuri e një rrugë të posaçme. Gjithashtu, ka edhe një fillim e kthim të caktuar në prezencën e diturisë, me dëshirë ose pa dëshirë, çka tregon se ndryshueshmëria e dukurive, si dhe llojet e rrugëve, janë sipas ndryshimit të së jashtmes dhe pranisë së emrave.

Meriton të theksohet se “تقويم” - “*takvim*” - “**rregullimi**” i njeriut në më të lartët e të afruarve, është “shumësi i emrave”. Për



këtë, njeriu është kthyer në “سافلینأسفل” - “esfele sàfilijn” - “në më të ulëtën e të ulëtëve”, domethënë që rruga e njeriut fillon nga më e ulëta dhe përfundon në më të lartin e të afruarve. Kjo është rruga e atyre personave, mbi të cilët i Vërtetit ka derdhur mirësitë e Tij të pakushtëzuara. Kjo është mirësia e plotësimit të shumësit të emrave, që është mirësia më e lartë hyjnore.

Me këtë bëhet e qartë se llojet e tjera të rrugës, qoftë rruga e të lumturve, “të cilëve u është dhënë mirësia”, qoftë rruga e të këqijve, rruga e atyre që kanë hyrë në njërën prej anëve të kalimit të masës e shpërdorimit, ose të lënies mangët e shkujes, shkon sipas përshtatjes dhe krahas mangësisë në vërshimin e mirësive absolute.

Mbështetur mbi këtë shpjegim, “rruga e njeriut të plotësuar”, është rruga e atyre që u është dhënë vetëm mirësi pa kushte, por dhënia e këtyre mirësive, në origjinë, është e veçantë vetëm për personin e pastër të vulës së Profetëve, të gjithë profetëve dhe euljiave me rrugën e ndjekjes.

Për të kuptuar fjalët që u thanë më sipër dhe lidhjen e këtyre fjalëve me të vërtetën se Profeti më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është vula e profetëve, kërkon praninë e “emrave” dhe të “krerëve”. Kjo temë është shpjeguar qartë në kumtesën “Misbàhul-Hidàjeti”. Vetëm Allahu udhëzon në rrugën e drejtë!





## Shpjegim

Shehu i nderuar, El Behajj, në kumtesën “El-Urvetul-Vuthkà”, midis të tjerash, thotë: “Mirësitë e Allahut të Madhëruar shkëlqejnë, edhe nëse do të jenë të rrethuara në kuadrin e numërimit, ashtu siç thotë vetë i Larti: “نِعْمَتُ اللَّهِ لَا تُحْصَوْنَ وَأَنْ تَعُدُّوا” - “... ue in teud’dù niëmetell’llàhi là tuhsùhà...” -“...edhe nëse ju do t’i numëroni mirësitë e Allahut, nuk do të arrini që ato t’i numëroni...”<sup>1</sup>

Mirësitë e Allahut janë dy llojesh, mirësi të kësaj bote dhe mirësi të Botës Tjetër. Çdo njëra prej mirësive ose është e dhuruar, ose është e fituar. Gjithashtu, çdo njëra prej dy llojeve të mirësive është ose shpirtërore, ose lëndore. Këto mirësi klasifikohen në tetë pjesë:

*E para:* mirësi e kësaj bote, e dhuruar, shpirtërore, si fryrja e shpirtit, plus mendja dhe kuptimi.

*E dyta:* mirësi e kësaj bote, e dhuruar, lëndore, si krijimi i gjymtyrëve dhe fuqia që ato kanë.

*E treta:* mirësi e kësaj bote, e fituar, shpirtërore, si përmbajtja e vetes prej punëve të ulëta dhe stolisja e vetes me moralet e pastra e me cilësi të larta.

---

<sup>1</sup>Sure “Ibràhim”, ajeti 34 dhe sure “En Nahl”, ajeti 18.



*E katërta:* mirësi e kësaj bote, e fituar, lëndore, si zbukurimi i trupit me forma të fiksuara dhe i stolitur me aftësi punëmira.

*E pesta:* mirësi e Botës Tjetër, e dhuruar, shpirtërore, si falja e gjynaheve dhe kënaqësia e Tij me ne, edhe pa bërë më përpara teube.

*E gjashta:* mirësi e Botës Tjetër, e dhuruar, lëndore, si lumenjtë prej qumështi e prej mjalti.

*E shtata:* mirësi e Botës Tjetër, e fituar, shpirtërore, si kërkimi për faljen e gjynaheve dhe kënaqësitë, krahas bërjes teube më përpara, si kënaqësitë shpirtërore, të ardhura me punën e adhurimeve.

*E teta:* mirësi e Botës Tjetër, e fituar, lëndore, si kënaqësitë trupore, të ardhura me punën e përmendur.

Qëllimi këtu është për katër mirësitë e fundit, përfshirë edhe punën e bërë për të arritur katër të parat<sup>1</sup>.

Këto ndarje të shehut, edhe pse janë të këndshme, në të vërtetë, nuk numërohen të plotësuara dhe prej mirësive hyjnore më të rëndësishme, pasi qëllimet më të mëdha të Librit hyjnor Famëlartë nuk kanë rrjedhur prej lapsit të shehut të nderuar, i cili është mjaftuar të përmendë mirësitë e të mangëtëve dhe të mesatarëve, edhe pse në ndarjet e tij është përmendur kënaqësia shpirtërore e morale, por kënaqësia shpirtërore në Botën Tjetër, kënaqësi që arrihet në saje të plotësimit të adhurimeve, përsëri

---

<sup>1</sup>Kumtesa "El-Urvetul-Vuthkà", autori: shehu El Behàij, në tefsirin e sures "El Hamd", f. 128-129, botim i shtëpisë botuese "Dàrul-Kur' ànil-Hakijm", Kum, viti i botimit 1412 hixhri.



është pjesa e mesatarëve, për të mos thënë se është pjesa e atyre që lënë punët mangët.

Në të gjitha gjendjet, në Botën Tjetër, mirësitë nuk janë si mirësitë e lidhura me kënaqësitë kafshërore dhe me pjesët që i dëshiron shpirti, ashtu siç i ka përmendur shehu i nderuar. Jo, ato janë të tjera mirësi, tri nga të cilat janë më të rëndësishmet:

*E para:* mirësia e njohjes së Personit dhe besimi se Personi i të Lartit është i Adhuruari Një e i Vetëm. Origjina e kësaj njohjeje është rrugëtimi për te Allahu, kurse rezultati i kësaj mirësie është “Xheneti i takimit”. Sikur rrugëtari të ketë qëllim që ky rezultat të realizohet, rrugëtimi i tij është me mangësi, sepse pozita e njohjes është pozita e heqjes dorë nga vetja e nga gjërat që i sjellin vetes kënaqësi, prandaj orientimi kah arritja e rezultatit, është orientim kah vetja, për rrjedhojë, kjo bindje e tij është adhurim për vetveten dhe nuk është adhurim për Allahun, është shumë pa njëjësin, pa besimin që Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe është veshje e jo zhveshje.

*E dyta:* mirësia e njohjes së emrave, është mirësi që degëzohet sipas shumicës së emrave, sikur të numërosh vetëm njëjësin e këtyre mirësive, ato arrijnë në një mijë, domethënë se del jashtë kufirit të mundësisë së numërimit, domethënë se ti i numëron ato së bashku me përbërësit: “يَعْمَتُ اللَّهُ لَا تُحْصَوْنَ وَإِنْ تَعُدُّوا” – “...ue in teud'dù niëmetell'llàhi là tuhsùhà...” – “...edhe nëse ju do t'i numëroni mirësitë e Allahut, nuk do të arrini t'i numëroni...”<sup>1</sup>

Në këtë pozitë, teuhidi i emrave, është mirësia e njohjes së emrit më të madh, që është pozita e njëjësit të shumësit të emrave.

<sup>1</sup>Sure “Ibrahim”, ajeti 34.



Rezultati i kësaj mirësie është “Xheneti i emrave” dhe është në përshtatje me njohjen që ai ka për një emër, ose për disa emra, njohja e tij është njohja e njëjësit dhe e shumësive që ai di.

*E treta:* mirësia njohjes së punëve. Edhe kjo mirësi degëzohet në degë që s’kanë fund. Pozita e teuhidit – besimi që Allahu është Zoti Një e i Vetëm - në këtë gradë është njëjësi i shumësive të shkëlqimeve të punëve, është pozita e “bujarisë së pastër” dhe pozita e “kujdestarisë absolute”. Rezultati i kësaj mirësie është “Xheneti i punëve”, domethënë arritja e shkëlqimit të punëve të të Vërtetit në zemrën e rrugëtarit për te Allahu. Ka shumë mundësi që shkëlqimi për Musa bin Imranin, në fillim të punës, ishte shkëlqim i punëve, kur ai tha: “ءَأَنْتُمْ نَارًا” – “...ànestu nàren...” – “...unë pashë një zjarr...”<sup>1</sup> Kurse shkëlqimi që tregon fjala e Allahut të Lartësuar: “فَلَمَّا نَجَّى رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكًا وَكَرَّ مُوسَىٰ ضَوْبًا” – “...felem'mà texhel'là rab'buhù lilxhebeli xhealehù dek'ken ue harr'rre Mùsà saikan...” – “E kur Zoti i tij iu shfaq malit, e thërrmoi atë dhe e bëri pluhur, ndërsa Musait i ra të fikët”<sup>2</sup>, ishte prej shkëlqimit të emrave, ose prej shkëlqimeve të Personit të pastër.

Atëherë, rruga e “Dhënësive të mirësive për ata” është në pozitën e parë, që është rrugëtimi drejt Personit të Allahut dhe mirësia në këtë pozitë, është shkëlqimi Personal.

Në pozitën e dytë, rrugëtarit është në udhëtimin e tij drejt emrave të Allahut. Mirësia në këtë pozitë janë shkëlqimet e emrave.

<sup>1</sup>Sure “Tà Hà”, ajeti 10; sure “En Nahl”, ajeti 7; sure “El Kasas”, ajeti 29.

<sup>2</sup>Sure “El Aràf”, ajeti 143.



Në pozitën e tretë, rrugëtari është në udhëtimin e tij drejt punëve të Allahut. Mirësia në këtë pozitë janë shkëlqimet e punëve.

Ata që janë në këto pozita, nuk shikojnë as Xhenetin e as kënaqësitë e njohura. Për ata është e barabartë si kënaqësitë morale, ashtu edhe kënaqësitë trupore. Në shumë hadithe të nderuara flitet për këtë pozitë, që është pozita e shumë besimtarëve.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Lexo "Bihàrul Enuàr", vëll. 77, f. 23.



## Mbyllje

Dije se surja e bekuar “El Hamd” - (El Fàtiha), përfshin jo vetëm të gjitha gradët e ekzistencës, por të gjitha gradët e veprimeve, si dhe të gjitha qëllimet e Kur’anit Famëlartë, sipas shembullit që tregon.

Thellimi në këto kërkesa, kërkon patjetër një shkoqitje të plotë dhe një logjikë ndryshe nga kjo logjikë dhe, në përgjithësi, këto kërkesa të hollësishme tregojnë se ato nuk janë pa dobi, madje te ato ka dobi të shumta për ata që kanë arritur gradën e njohjes e vetëbindjes.

Së pari, themi: “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ” - “*bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm*” - “**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**”, ka mundësi të tregojë rrethin e plotë të ekzistencës dhe dy kurbat, kurbën zbritëse dhe kurbën ngjitëse, për rrjedhojë emri “الله” - “*Allah*” tregon pozitën se Allahu është i Vetëm në mosdhënie e në dhënie.

Emri: “الرحمن” - “*Err’rrahmân*” - “**i Gjithëmëshirshmi**”, është pozita e dhënies dhe e shfaqjes. Kjo është kurba zbritëse.

Emri: “الرحيم” - “*err’rrahijm*” - “**Mëshirëploti**”, është pozita e mosdhënies dhe e të padukshmes. Kjo është kurba ngjitëse.

Fraza: “الْحَمْدُ لِلَّهِ” - “*El hamdu lil’lâh*” - “**Çdo lavdërim i përket vetëm Allahut**”, ka mundësi të tregojë botët e fuqisë dhe cilësitë e larta, të vërtetat e të cilave janë falënderimet e lavdërimet në përgjithësi.



Fraza: “رب العالمين” - “*Rab’bil àlemijn*” - “**Zotit të botëve**”, është pozita e barazimit, pozita e sheshimit dhe tregon botët e natyrës së lëvizshme, fundi i të cilave vjen me thelbësoren e Personit, nën hijen e rritjes e të zhvillimit.

Fraza: “مالك يوم الدين” - “*Màliki jeumid’dijn*” - “**Sunduesit të Ditës së Gjykimit**”, tregon pozitën e unitetit dhe mposhtjes, si dhe kthimin e rrethit të ekzistencës. Me këtë ajet, këtu mbyllet rrethi i ekzistencës zbritje-ngjitje.

Së dyti, themi: fjala: “الاستعاذة” - “*El istiàdheh*” - “**kërkimi i mbrojtjes**” - (Eùdhu bil’làhi mines’h’shejtànirr’rrexhijm) - është veprim i lavdërueshëm dhe tregon heqjen dorë nga çdo gjë tjetër, përveç të Vërtetit. Gjithashtu, tregon edhe largimin e menjëhershëm prej pushtetit të shejtanit. Në të vërtetë, kërkimi i mbrojtjes nuk është pjesë e pozitive, por është parathënia për hyrjen në mbrojtjen e Allahut, ashtu siç është boshatisja parathënie për stolisjen, por, në vetvete, është prej pozitive të plotësuar. Bazuar mbi këto që u thanë, kërkimi i mbrojtjes nuk është pjesë e sures, por është preambula e hyrjes në sure.

Ka shumë mundësi, që: “بسم الله الرحمن الرحيم” - “*bismil’làhi-rr’rrahmàni-rr’rrahijm*” - “**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**”, të tregojë pozitën e teuhidit të punëve dhe të teuhidit të Personit - besimin se vetëm i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm - si dhe bashkimi i këtyre dy teuhideve me frazën: “الحمد لله” - “*el hamdu lil’làhi*” - “**Çdo lavdërim është vetëm për Allahun**”, deri në fundin e ajetit: “رب العالمين” - “*Rab’bil àlemijn*” - “**Zotit të botëve**”, tregon teuhidin e punëve - besimin se vetëm i Vërtetit është Ai që i bën punët; kurse ajeti: “مالك يوم الدين” - “*Màliki jeumid’dijn*”



–“**Sunduesi i Ditës së Gjykimit**”, tregon asgjësimin e plotë dhe teuhidin Dhatij – besimin se vetëm i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm. Më pas vjen gjendja e zgjimit dhe e kthimit, duke filluar me frazën: “إياك نعبد” - “*Ij’jake naëbudu*” –“**vetëm Ty të adhurojmë**”.

Me fjalë të tjera, kërkimi i mbrojtjes është udhëtimi prej krijesave drejt të Vërtetit dhe dalja jashtë prej shtëpisë së vetvetes; ndërsa “bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm”, tregon realizimin e të vërtetës, pas krijimit të krijesave dhe botës së shumicës. Kurse fraza: “الحمد لله” - “*el hamdu lil’lâhi*” –“**Çdo lavdërim është vetëm për Allahun**”, deri në fundin e ajetit: “رب العالمين” - “*Rab’bil-âlemijn*” –“**Zotit të botëve**”, tregon udhëtimin prej të Vërtetit “me të Vërtetin në të Vërtetin”, derisa ky udhëtim përfundon me ajetin: “مالك يوم الدين” - “*Mâliki jeumid’dijn*” –“**Sunduesit të Ditës së Gjykimit**”. Pastaj fillon udhëtimi prej të Vërtetit për te krijesat dhe fraza: “إياك نعبد” - “*Ij’jake naëbudu*” –“**vetëm Ty të adhurojmë**”, tregon arritjen e zgjimit e kthimit, derisa ky udhëtim përfundon me ajetin:

“إهدنا الصراط المستقيم” - “*Ihdinas’sirâtal mustekijm*” –“**udhëzona në rrugën e drejtë**”.

Së treti, *themi*: kjo sure e nderuar ka në brendinë e saj bazat e qëllimeve hyjnore të Kur’anit Famëlartë, sepse origjina e qëllimeve të Kur’anit është realizimi i njohjes së Allahut, në mënyrën më të plotë dhe arritja e tri teuhideve, si dhe realizmi i lidhjes mes të Vërtetit e mes njerëzve, mësimi i mënyrës së ecjes për te Allahu, mësimi i mënyrës së kthimit të hollësive në të vërtetën e të vërtetave, shpjegimi i shkëlqimeve hyjnore të tërësisë e në mënyrë të shkoqitur, një e nga një dhe në mënyrë të përbërë, orientimi i njerëzve në ecjen dhe realizimin e ecjes, pastaj mësimin e njerëzve





me dituri, me punë, me anën e diturive dhe me anë të shikimit me sy.

Të gjitha këto të vërteta gjenden në këtë sure të nderuar, të shprehura në mënyrën më të shkurtër të mundshme.

Kjo sure e nderuar quhet “فاتحة الكتاب” - “Fâtihatul-kitâbi” - “Hapësja e librit” dhe “أم الكتاب” - “Um'mul-kitâbi” - “Nëna e librit”. Me fjalë të tjera, surja “El Hamd” - (El Fâtîha) është një sure gjithëpërmbledhëse e qëllimeve të Kur'anit Famëlartë.

Të gjitha qëllimet e Librit hyjnor kthehen në një qëllim të vetëm, kthehen në të vërtetën e besimit, që i Vërteti është i Adhuruari Një e i Vetëm, besim që përfaqëson qëllimin më të lartë të të gjitha profetësive dhe fundin e qëllimeve të gjithë profetëve të mëdhenj. Gjithashtu, kjo sure përmbledh të gjitha të vërtetat e besimit, që i Vërteti është i Adhuruari Një e i Vetëm, kurse sekretet e këtij besimi janë në brendinë e ajetit të nderuar: “بسم الله الرحمن الرحيم” - “Bismil'lâhi-rr'rrahmâni-rr'rrahijm” - **“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”**. Ky është ajeti më i madh i ajeteve hyjnore dhe përfshin të gjitha qëllimet e Librit hyjnor. Kjo e vërtetë theksohet qartë edhe në transmetimet e nderuara.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 92, f. 238.



## Plotësim ~ Mirësia e sures “El Hamd” ~ (El Fàtiha)

Transmetohet se më i nderuari i profetëve, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i tha Xhabir bin Abdullah El Ensarit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!):

- O Xhabir, a dëshiron të të mësoj suren me më shumë mirësi, që Allahu ka zbritur në Librin e Tij?
- Posi jo! – i tha Xhabiri. - Babai e nëna ime t’u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut! Ma mëso atë sure!

Ai i mësoi atij suren “El Hamd”, “nënën e Librit”.

- O Xhabir, a dëshiron të të sqaroj rreth saj? – e pyeti Profeti Muhamed.
- Posi jo, o Dërguari i Allahut! Babai e nëna ime kurban t’u bëfshim, më njofto mua për këtë sure!
- Kjo sure shëron çdo sëmundje, me përjashtim të vdekjes.<sup>1</sup>

Ibn Abasi ka transmetuar prej të Dërguarit më të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Çdo send ka një bazë dhe baza e Kur’anit është surja “El Fatiha”, kurse baza e sures “El Fatiha” është ‘bismil’lâhi-rr’rrahmânir’rrahijm’”.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>Tefsiri “El-ljâshij”, vëll. 1, Hadithi 20, f. 20.

<sup>2</sup>“Mexhmaul Bejan”, vëll. 1, f. 17.



Gjithashtu, transmetohet se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fâtihatul-Kitabi i shëron të gjitha sëmundjet”.<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Atë që nuk shëron surja “El Hamd”, atë s’ka gjë që e shëron”.<sup>2</sup>

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Allahu i Lartësuar më tha mua: ‘O Muhamed, **Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kur’anin e madhërishëm**”.<sup>3</sup>

Allahu e veçoi këtë mirësi për mua me Fâtihatul-Kitab, të cilën e vuri përballë Kur’anit. Në të vërtetë, surja “El Fatiha” është më e nderuara në thesaret e Arshit dhe Allahu i Lartësuar e ka veçuar Muhamedin, duke e nderuar me këtë sure dhe në këtë nderim nuk i ka bërë atij asnjë shok, me përjashtim të Sulejmanit, të cilit Allahu ia ka dhënë prej saj “bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm”.

**“Mbretëresha (e Shebës) tha: ‘O paria ime! Mua më ka ardhur një letër fisnike. Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”**”<sup>4</sup>

Bëni kujdes, kush e këndon këtë sure, duke besuar në kujdestarinë e Muhamedit dhe familjes së tij, duke u orientuar me urdhrat e kësaj sureje dhe duke besuar në të jashtmen e në të

---

<sup>1</sup>Burim i mësipërm.

<sup>2</sup>Tefsiri “El-Ijâshi”, vëll. 1, Hadithi 10, f. 20; “Bihârul Enuâr”, vëll. 89, Hadithi 34, f. 237.

<sup>3</sup>Sure “El Hixhr”, ajeti 87.

<sup>4</sup>Sure “En Neml”, ajetet 29-30.



brendshmen e saj, Allahu i Lartësuar për çdo germë të saj i jep atij një të mirë, e cila është më e mirë se kjo botë dhe çka në këtë botë prej llojeve të pasurive e prej gjërave të mira të saj.

Kush dëgjon dikë, duke e kënduar këtë sure, ai ka shpërblim një të tretën e shpërblimit që ka kënduesi.

Çdonjëri prej jush le të marrë sa më shumë prej kësaj mirësie, që atij i vihet përpara. Kjo mirësi është fitim dhe nuk duhet lënë që këtij fitimi t'i kalojë koha, pastaj në zemrat tuaja do të mbetet humbja".<sup>1</sup>

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*Sikur surja "El Hamd" t'i këndohet një të vdekuri shtatëdhjetë herë dhe pastaj atij t'i kthehej shpirti, kjo nuk do të ishte çudi"*.<sup>2</sup>

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "*Çdo mysliman që këndon "Fâtihatul-Kitâb", atij i jepet shpërblimi sikur ka kënduar një të tretën e Kur'anit"*.<sup>3</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet: "*Sikur ai e ka kënduar të gjithë Kur'anin"*.<sup>4</sup>

Ebu Kabi ka thënë: "*Lexova Fâtihatul-Kitabi para të Dërguarit të Allahut dhe ai tha: 'Betohem për atë, që shpirti im është në dorën e Tij, se Allahu nuk ka zbritur as në Teurat, as në Inxhil (Ungjilli), as në Zebur e as në Kur'an një të ngjashme me këtë. Kjo është "nëna" e*

---

<sup>1</sup> "Ujûnu Akhbâru Ridâ", vëll. 1, f. 301. Në lidhje me njoftimet e ardhura rreth Imamit Ali bin Musait, të mbledhura prej njoftimeve të shpërndara, Hadithi 60; "Bihârul Enuâr", vëll. 89, Hadithi 5, f. 227.

<sup>2</sup>Tefsiri "Nûruth Thekalejn", vëll1, f. 4, tefsiri i sures "El Hamd", Hadithi 8.

<sup>3</sup>"Bihârul Enuâr", vëll 89, f. 259; "Mexhmeul Bejan", vëll. 1, f. 17.

<sup>4</sup>Burimi i mësipërm.



*Librit, shtatë ajetet e të cilës përsëriten në çdo rekat namazi. Gjithashtu, kjo sure është e ndarë mes Allahut e robit të Tij dhe për robin e Tij ka atë që ai kërkon”.*<sup>1</sup>

Hudhejfeh bin El Jemani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Është vendosur në formë të prerë, që mbi një popull do të lëshojë një ndëshkim, por një fëmijë prej fëmijëve të atij populli lexoi në librin “**El hamdu lil’lâhi Rab’bil âlemijne**”. Fëmijën e dëgjon Allahu i Lartësuar dhe menjëherë e largoi ndëshkimin prej tyre dyzet vjet”.

Ibni Abasi tregon: “Ishin te Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ndërkaq atij i erdhi një engjëll, i cili i tha: ‘Përgëzime për dy dritat, që t’u dhanë. Drita të këtilla nuk i janë dhënë asnjë profeti para teje: Fâtihatul-Kitâbi dhe ajetet e fundit të sures “El-Bekare”. Për çdo germë që ti këndon, patjetër Unë atij ia kam dhënë”.

Në “Muxhmeul Bejân”, ka një hadith të ngjashëm me këtë të fundit.

<sup>1</sup>“Muxhmeul Bejân”, vëll. 1, f. 17.

<sup>2</sup>Fakhru-Rr’ rrâzij, “Et’ tefsijrul-Kebijr”, vëll. 1, f. 178.

<sup>3</sup>“Mustedrekul-Vesâili”, Libri “Namazi”, K. 44 – Këndimi i Kur’anit”, Hadithi 3.

<sup>4</sup>“Muxhmeul Bejân”, vëll. 1, f. 18.



## Ndarja e gjashtë

### FLLAD NGA INTERPRETIMI I SURES SË BEKUAR

#### “ET TEUHID” - (EL IKHLÀS)

Në suren e bekuar “Et Teuhid” - (El Ikhlàs) përshkruhet i Vërteti i Lartësuar. Në hadithet e nderuara, të përcjella prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë: “Jehuditët erdhën te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që ta pyesnin për shumë gjëra. Midis tyre ishte kërkesa: ‘Na e përshkruaj Zotin tënd!’

Tri herë me radhë nuk iu përgjigj pyetjes së tyre, deri sa zbriti surja “Et Teuhid”: **“Kul hu uall’lillahu ehad. All’lillahus’samed. Lem jelim ue lem juled. Ue lem jekun(l) lehu kufuuen ehad.”**<sup>1</sup>

Mendjet e njerëzve s’kanë mundësi të kuptojnë të vërtetat, hollësitë dhe sekretet e kësaj sureje. Ajo që kuptojnë ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe nga njoftimet që marrin zemrat e atyre që quhen njerëz të Allahut, janë të atilla, që nuk i mat peshorja e mendjes së zhveshur.

---

<sup>1</sup>“El-Usùlu minel-Kâfi”, “Kitàbu-t’teuhijdi”, K. “En’nisbetu”, Hadithi 1.



I dashur, kjo sure e nderuar është prej amaneteve të atilla, që e kanë të pamundur t'i mbajnë qiejt e shpirtrave e tokat e atyre që bëjnë hije dhe malet e vonesave. Askush nuk i mban këto amanete përveç njeriut të plotësuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i kapërceu kufijtë e mundësisë dhe u zhvesh nga vetja e tij.

Në këtë sure ka një përgëzim, me të cilin kënaqen sytë e njerëzve, që do të jetojnë kohën e fundit dhe me këtë përgëzim sigurohen zemrat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes. Është përgëzimi që përshkruhet në hadithin e transmetuar në librin "El-Kâfi", në të cilin përcjellësi tregon: "Kur Imam Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për (teuhidin), ka thënë: 'Padyschim që Allahu i Gjithëfuqishëm e dinte që në kohën e fundit do të kishte të atillë, që do thelloheshin deri në imtësitë më të vogla, prandaj Allahu i Lartësuar zbriti suren "Et Teuhid" (**Kul hu uall-llahu ehad**); gjithashtu, edhe ajetet e sures "El Hadid" deri në fjalën e Tij: "**ue huve alijmun bidhâtis'sudûr**" - vetëm Ai di çka në zemrat - prandaj kushdo që synon përtej kësaj, në të vërtetë është i shkatërruar".<sup>1</sup>

Prej këtij hadithi të nderuar bëhet e qartë se kuptimi i këtyre ajeteve dhe i kësaj sureje të bekuar, janë nga e drejta që u takon atyre që mendohen deri në hollësitë dhe atyre që shikojnë imtësitë.

Me të vërtetë, jo vetëm hollësitë e teuhidit (besimi që Allahu është Një e i Vetëm), por edhe dhe sekretet e tij janë në brendinë e kësaj sureje. Në këtë sure të nderuar, i Vërteti i Lartësuar ka dërguar ëmbëlsinë e diturive hyjnore për dijetarët e kësaj fushe, prandaj ai që s'ka fatin të ketë njohuri rreth sekreteve të teuhidit dhe diturive hyjnore, s'ka asnjë të drejtë të shprehë i pari mendimin e tij rreth

<sup>1</sup>"El-Usûlu minel-Kâfi", Libri "Et Teuhid", Hadithi 4.



këtyre ajeteve. Gjithashtu, s'ka të drejtë as t'i reduktojë ato në kuptimet e përgjithshme qarkulluese, të cilat ai i kupton.

Edhe në ajetet e para të sures "El Hadid" ka hollësi prej diturive të fushës së teuhidit, por te ato ka edhe dituri të larta prej sekreteve hyjnore dhe zhveshjes. Ajetet e kësaj sureje nuk kanë të ngjashëm me asnjërin prej librave të tjerë hyjnorë, ose në botimet e dijetarëve dhe në veprat e zotëruesve të zemrave.

Sikur këtu të mos kishte argument tjetër që vërteton profetësinë e Profetit të fundit dhe plotësimin e ligjit të fesë, me të cilën ai erdhi, patjetër që për mendimtarët e dijetarët e mirëfilltë, këto ajete do të ishin të mjaftueshme.

Ai që ka argumente më të fuqishme për të vërtetuar se këto dituri dalin jashtë fuqisë njerëzore dhe jashtë rrethit të mendimit njerëzor, argumenti i tij vërteton se këto dituri nuk kanë ekzistuar te njerëzit, para zbritjes së këtyre ajeteve të nderuara apo ajeteve të ngjashme që flasin për këto dituri. Në Kur'anin Famëlartë janë të shumta ajetet që tregojnë qartë pamundësinë e tyre, për të arritur ato sekrete.

Librat e filozofëve të mëdhenj të botës dhe botimet e tyre, që gjenden në kohën e sotme, pavarësisht se janë marrë prej burimeve të shpalljes hyjnore, nuk përmbajnë të këtilla njohuri e dituri si të ajeteve të Kur'anit Famëlartë. Padyshim që më i larti e më i hollësishmi i këtyre librave është libri "Teologjia", botim me vlera, i shkruar prej filozofit e të urtit, Aristoteli. Në këtë libër, Aristoteli trajton logjikën dhe ka dhënë sistemin e rregullave të logjikës. Para këtij dijetari kanë kërrusur kokën e janë përulur me nderim të veçantë dijetarë e filozofë të kalibrit të shehut Ebu Ali ibn Sina,





pavarësisht se ky i fundit ishte një mrekulli e shekullit dhe nga një nga dukuritë e rralla të kohës, i cili, pavarësisht nga pozita e lartë që gëzonte, për Aristotelin dhe për librin e tij, thotë: “Që nga koha kur ky i madh vuri rregullat e logjikës, askush nuk ka mundur ta qortojë atë, ose të shtojë diçka mbi ato rregulla”

Në të vërtetë, libri “Teologjia” është botuar e është përpunuar për njohjen e Zotit, Sistemuesit, por studiuesi i mirëfilltë, që mendon dhe studion me kujdesin më të madh këtë libër, nuk gjen në faqet e tij - nga e para deri në të fundit - një shembull të ngjashëm me ajetin e parë të sures “El Hadid”, në përshtetësinë që ky ajet i bën Krijuesit, madje nuk gjen edhe diçka të përafërt me atë që mësohet për fjalëve të ajetit, nuk gjen qoftë edhe një thëngjill prej sekreteve të teuhidit që përmban ky ajet i nderuar.

Kur studiuesi mediton mbi këtë libër të Aristotelit, vallë, a do të gjejë në të ndonjë fjalë të ngjashme me fjalën e të Lartit:

“هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ” - “*Ue huvel-ev'velu uel-Àkhiru, uedh'dhàhiru uel-Bàtinu...*” - “**Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i Dijshëm për çdo gjë!**”<sup>1</sup>?

Vallë, a do të gjejë ky dijetar studiues, në të gjitha fjalët e të urtëve e filozofëve, një fjalë të ngjashme me fjalën e të Lartit:

“أَيْنَ مَا كُنْتُمْ هُوَ مَعَكُمْ” - “*...ue huve meakum ejnmà kuntum...*” - “**Ai është me ju, kudo që të gjendeni**”<sup>2</sup>?

<sup>1</sup>Sure “El Hadid”, ajeti 3.

<sup>2</sup>Sure “El Hadid”, ajeti 4.



Dhe kjo në një kohë, kur dijetarët që thellohen në studimet e tyre dhe mendimtarët e dijetarët e tjerë, e kuptojnë çdo sekret që ka në brendinë e këtyre ajeteve. Gjithashtu, ata dinë dhe njohin çdo fjalë e çdo sekret të madh, me të cilat Allahu i Gjithëfuqishëm ka nderuar me mirësinë e Tij njerëzit e kohës së fundit (àkhiri-z' zemàn).

Ai që ka njohuri për gjërat që kanë lidhje me fillimin e me ringjalljen dhe për dituritë që i kanë shpalosur fetë që qarkullojnë në të gjithë botën, gjithashtu, ka njohuri edhe për dituritë që kanë shkruar filozofët e mëdhenj dhe t'i krahasojë këto dituri me dituritë që gjenden në fenë islame, do të gjejë se dituritë islame janë të larguara krejtësisht nga e gabuara, siç janë çështjet që shpalosin filozofët e mëdhenj të Islamit dhe dijetarët e ndritur të këtij umeti, atëherë ky studiues do të kuptojë plotësisht se dituritë islame janë prej dritës së diturive të Kur'anit Famëlartë dhe prej haditheve të ardhura prej vulës së profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Padyshim që hadithet e nderuara burojnë prej gurrës së dritës bujare të Kur'anit Famëlartë. Në këto hadithe, studiuesi shumë shpejt do të kuptojë se filozofia islame dhe dituritë islame nuk janë as prej Greqisë e as prej grekëve, pasi në origjinë, mes diturive të grekëve dhe diturive islame s'ka asnjë anë që dy dituritë të krahasohen apo të ngjajnë me njëra-tjetrën.

Është e vërtetë, janë disa filozofë myslimanë, si shehu Reis, i cili ecën në harkun e filozofisë greke, por filozofia e shehut Reis nuk konsiderohet prej prodhimeve qarkulluese në tregun e dijetarëve dhe në portën e njohurive që lidhen me Zotin Krijues apo të diturive që trajtojnë fillimin e ringjalljen. Në fakt, dituritë e shehut Reis, te dijetarët e mirëfilltë islamë, nuk kanë asnjë lloj vlere.



Në përgjithësi, pretendimi se rrënjët e filozofisë të filozofëve myslimanë në ditët e sotme dhe dituritë e çmuara të atyre që kanë arritur gradën e njohjes gjenden në filozofinë e grekëve, në fakt, argumenton mospasjen dijëni për librat e umetit islam dhe për veprat e tyre, siç janë botimet e filozofit të madh islam, i cilësuar si kreu i teologëve apo profesori i tij i dëgjuar, studiuesi Damad, ose nxënësi i tij i lavdishëm, El Fejd El Kashani, nxënësi i shquar i El Fejdit dhe dijetari i shquar në fushën e besimit, El Kadij Seijjd El Kumi.

Mospasja dijëni rreth diturive teologjike dhe rreth transmetimeve të ardhura prej imamëve të ruajtur prej gjynaheve, ka çuar në pretendimin e rremë se të gjitha filozofitë islame i kanë rrënjët në filozofinë greke. Sipas këtij pretendimi të rremë, filozofët myslimanë konsiderohen ndjekës të filozofisë së grekëve të vjetër.

Ne shpjeguam njërën anë prej punëve të hollësishme në suren e nderuar “Et Teuhid” - (El Ikhlàs), por disa shenja që pasqyrojnë këto ajete të nderuara, i kemi theksuar në librin “Sherhu El-Erbeijne hadijthen” - “Shpjegimi i dyzet haditheve”. Gjithashtu, në lidhje me këtë sure të nderuar, kemi shkruar edhe një tefsir të shkurtër, në librin “Sirr’ rru-s’ salàti” - “Sekreti i namazit”. Këtu, për këtë sure të bekuar, do të shpalosim në mënyrë të përgjithshme një tefsir. Vetëm te Allahu jemi mbështetur.

Dije se ajeti: “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ” - *“Bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm”* - **“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”**, i përfytyruar si njëri prej ajeteve të kësaj sureje, ka lidhje me vetë suren, ashtu siç theksuam për mundësinë e atashimit të ajetit “Bismil’lâhi-rr’rrahmânir’rr-ahijm”, kur folën për suren e uruar “El Hamd”. Por këtu, në suren “Et Teuhid” - (El Ikhlàs), ka



një argument të qartë, që tregon pamundësinë që, për të Vërtetin e Lartësuar, të ketë një trung gjenealogjik. Gjithashtu, ajetet e kësaj sureje shpjegojnë qartë sekretet e teuhidit – besimit që i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm, por jo me egoizmin e vetes së rrugëtarit dhe me gjuhën e tij.

Përderisa rrugëtarit nuk ka dalë jashtë mbulesës së vetvetes, përderisa nuk e ka arritur pozitën e dëshirës absolute dhe praninë e bujarisë së pastër, përderisa nuk është asgjësuar në Substancën absolute, padyshim që ai kurrë nuk i ka kuptuar e nuk i kupton sekretet e teuhidit.

Fjala e ajetit “قل” - “Kul” - “**Thuj**”, është urdhër prej Njëshit të shumësit, në pozitën e Berzahut të madh, është një pasqyrë e shumësit dhe shkoqitjes së kuptimit: “O Muhamed - o pasqyrë e shfaqjes së Njëshit të shumësit, në pozitën zbritëse **vetjake**, ose pozitës së pastër, ose pozitës “më të ulët” (mbase kjo tregon pozitën e bujarisë së pastër) – thuj me gjuhën asgjësuese tënde dhe e qëndrueshme me vërtetësinë e qëndrimit të Allahut: “قل هو الله أحد” - “Kul huve'llàhu ehadun” - “**Thuj: Ai, Allahu është Një**”.

Ti që rrugëton në rrugën e diturisë e të teuhidit, ti që ngjitesh në lartësitë e pastrimit e të zhveshjes, dije se Personi i pastër i të Vërtetit të Lartësuar – nga ana e pastërtisë së Tij prej shkëlqimeve të dukshme e të padukshme, dije mirë se Ai është i dëlirë prej shenjës, vizatimit, cilësisë dhe emrit. Dije se edhe shpresat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, janë të shkurtra për të arritur qoftë edhe deri te fundi i madhështisë së Personit të dëlirë nga nevojat e nga mangësitë. Gjithashtu, dije se edhe hapat e rrugëtimit të zotëruesve të zemrave e kanë të pamundur të arrijnë në praninë e pastërtisë së të Vërtetit, prandaj qëllimi më i lartë i diturisë së



eulijave të plotësuar është: “Ne nuk të njohëm Ty”<sup>1</sup>, ashtu siç është fundi i ecjes i njohësve të sekreteve; “ne nuk të adhuruam Ty”<sup>2</sup>, - fjali e paplotë

Imami i dijetarëve dhe prijësi i atyre që besojnë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, në lidhje me këtë pozitë të lartë, ka thënë: “Sinqeriteti i plotë është mohimi i cilësive prej Tij”.<sup>3</sup> Udhëheqësi i rrugëtarëve për te Allahu, zotëria i atyre që bien në sexhde dhe udhëheqësi i dijetarëve, për këtë çështje, thotë: “Në Ty kanë humbur cilësitë dhe nën Ty anulohen cilësitë”.<sup>4</sup>

Për sa u takon atyre që ecin në rrugën e diturisë dhe në rrugën e terminologjisë, në lidhje me Personin e dëlirë nga të meta e nevojat, ata e cilësojnë Atë me termat: “e panjohura e ruajtur” (el gajbul mesûnu), “sekreti i mbyllur” (es’sirr’rrul meknûnu), “feniksi” (el unekàul mugribu), “injanca absolute” (el xhehlul mutlaku). Gjithashtu, ata thonë se Personi i dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, pa mbulesën e emrave e të cilësive, nuk shndrit në asnjë pasqyrë dhe për Atë s’ka shfaqje në asnjërën prej zhvillimeve të ekzistencës e të botëve të panjohura dhe të botëve të njohura. Ajeti i nderuar shpjegon qartë: “كُلُّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ” - “...kul’le jeumin huve fij sheënin” - “...në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e

<sup>1-2</sup> Tregon frazat e hadithit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “ما عرفناك حق معرفتك وما عبدناك حق عبادتك” - “ma arr’rrefnàke hak’ka maërifetike ue mà abednàke hak’ka ibàdetike” - “Ne nuk të njohëm Ty, ashtu siç e meriton Ti të njihesh dhe ne nuk të adhuruam Ty, ashtu siç e meriton Ti të adhurohesh”. Lexo librin “Mir’âtul-Ukûli” - “Pasqyra e mendjeve”, “El-ijmànu uelkufuru” - “Besimi dhe mohimi”, vëll. 8, K. “Esh’shukru” - “Falënderimi”, f. 146.

<sup>3</sup>“Nehxhul-Belàga”, Hytbeja e parë.

<sup>4</sup>“Es’sahijfetu-S’sexhàdij’jeh”, Lutja 32.



**gjithëmbarshe**".<sup>1</sup>Për Personin e Tij të dëlirë nga të metat e nga nevojat ka emra, cilësi dhe punë të bukurisë e të madhështisë. Gjithashtu, për të Lartin e madhëruar ka emra personalë në pozitën e Njëshit, që përfaqësojnë pozitën e të panjohurës.

Këtu patjetër duhet thënë se këta emra tregojnë Personin e Gjithëfuqishëm dhe Ai, i Lartësuar, shkëlqen me bujarinë më të pastër. Prej këtij shkëlqimi të emrave personalë shfaqet qartë pozita e Njëshit dhe prania e emrave e cilësive, si dhe pozita që vetëm Ai është i Adhuruari.

Atëherë, është e qartë se pas Personit të dëlirë nga mangësitë e nga nevojat - nga çdo anë që ta shikosh çështjen - ka edhe tri pozita e tri dukuri të tjera, që janë:

- Pozita e të panjohurës "Një" (El ehadi).

- Pozita e shkëlqimit me "bujarinë më të pastër" - "El fejdul akdesu". Të shpresojmë se fjala "ءء" - "amàë" - "errësirë" e hadithit të nderuar profetik<sup>2</sup> tregon këtë kuptim.

- Pozita e të "Vetmit" (el vâhidij'jeh), është pozita e emrit më të madh me njëjësin e shumësit, si dhe pozita e emrave dhe e cilësive me shumicën e shkoqitur.

Të flitet për këto pozita, patjetër kërkohet një shkoqitje që nuk arrihet dot në këtë nxitim.

---

<sup>1</sup>Sure "Er Rrahmân", ajeti 29.

<sup>2</sup>I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është pyetur: "Ku ishte Zoti ynë, para krijimit të qiejve e të tokës?" Ai tha: "Ishte në turbullirë". Lexo "Avâlij El'leâlij", vëll. 1, K. 4, Hadithi 79, f.54.



Dhe tani, pasi u shpjegua kjo parathënie, themi: Ka mundësi që përemri “هو” - “huve” - “Ai”, në ajetin e parë të sures “Et Teuhid” - (El Ikhîlâs) të tregojë pozitën e “bujarisë më të pastër” (El fejdul akdesu), që është shkëlqimi i Personit të të Vërtetit me emërtimin e emrave Personalë, kurse fjala “الله” - “All'llàhu” - “Allahu” tregon pozitën e Njëshit të shumësit të emrave, që është prania e emrit më të madh. Edhe fjala “أحد” - “ehad” - “Një” tregon pozitën e të qenit Një. Bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti vërteton këto tri pozita, pavarësisht se për ato ka shumë pozita në shumicën e emrave dhe është fundi i të qenit unik, kurse shkëlqimi me bujarinë e pastër, është vetë Allahu i Lartësuar sipas pozitës së dukshme. Fjala “أحد” - “ehad” - “Një” tregon pozitën e padukshme.

Gjithashtu, ka mundësi që përemri “هو” - “huve” - “Ai” të tregojë pozitën e Personit, por është një shenjë e padukshme, në të vërtetë, është një shenjë drejt të panjohurës.

Fjalët: “الله” - “All'llàhu” - “Allahu” dhe “أحد” - “ehad” - “Një”, tregojnë dy pozita, pozita “Një” dhe “i Vetmi”, domethënë që ky ajet i nderuar bën të njohur Personin e dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, që është absolutisht i panjohur me emrat personalë dhe me emrat e Njëshit si cilësi.

Realisht, këtu kemi një shenjë treguese që Personi i pastër është i panjohur dhe Atë nuk e arrijnë dot shpresat, edhe nëse jeta kalohet e gjitha duke menduar rreh Personit të dëlirë nga nevojat e të metat, por duhet të theksohet se kjo mënyrë e të menduarit zakonisht çon në shkarje, drejt rrugës së humbjes.



Ajo çka dinë ata që quhen njerëz të Allahut dhe dituria që kanë dijetarët për Allahun, reduktohet në pozitën e “Një” dhe në pozitën e “të Vetmit”. Pozita “Një” dhe pozita “i Vetmi” janë për masën e njerëzve të Allahut, kurse pozita e “Njëshit” është për të zgjedhurit prej njerëzve të Allahut.





## Vërejtje e domosdoshme

Dije se filozofët dhe të urtët mendojnë se për të Vërtetin e Lartësuar ka cilësi të qëndrueshme (thubûtij'jeh) dhe cilësi pasive (selbij'jeh). Ata shpjegojnë se cilësi pasive do të thotë heqja e mangësisë.

Disa prej tyre thonë se cilësitë e qëndrueshme janë cilësitë e bukurisë, kurse cilësitë pasive janë cilësitë e madhësisë, prandaj fraza: “ذو الجلال والإكرام” - “*Dhul xhelàli uel Ikràm*” - “**Atij i takon madhështia dhe nderimi**”, është shprehje bashkuese e të gjitha cilësive pasive dhe e cilësive të qëndrueshme.

Kjo frazë, me të dyja pjesët e saj, është në kundërshtim me vërtetimin. Në fjalën e parë, nëse Ai është ashtu siç kanë thënë, rezulton se cilësitë pasive nuk do të jenë cilësi nën vërtetim, sepse në Personin e të Vërtetit të Lartësuar s'ka heqje pasiviteti, për shkak se i Vërteti i Lartësuar nuk mund të cilësohet me cilësi pasive, për faktin se cilësimi me pasivitet, është i njëjtë me cilësimin me negativitet. Mbase kjo çështje mund të jetë prej çështjeve të drejtësisë, për të nxjerrë të drejtën, por çështjet e nxjerrjes së të drejtës nuk lejohen të lidhen me të Vërtetin e Lartësuar. Veç kësaj, kjo logjikë vërteton anët e mundësisë, të cilat e bëjnë të domosdoshme që Qenia e pastër të jetë përbërje, në një kohë kur cilësitë pasive vërtetohen me rrugën e heqjes së cilësive pasive dhe jo me vërtetimin e heqjes së pasivitetit.



Me fjalë të tjera, të gjitha mangësitë janë të hequra prej të Vërtetit të Lartësuar, me heqjen e thjeshtë dhe jo se heqja e mangësive vërtetohet për të Lartin me rrugën e pozivitetit juridik. Në të vërtetë, cilësitë që e dëlirin Atë nga nevojat e nga mangësitë nuk janë cilësi, për rrjedhojë, rezultojnë që i Vërteti i Lartësuar është i cilësuar vetëm me cilësi të qëndrueshme (sifati thubütij'jeh).

Edhe fjala e dytë, gjithashtu, nuk i qëndron vërtetimit, sepse cilësitë e bukurisë - te ata që kanë arritur gradën e njohjes - janë cilësi që e tërheqin njeriun dhe e lidhin atë, kurse cilësitë e madhësisë janë cilësitë që sjellin frikësim, hutim e trallisje.

Bazuar mbi këtë shpjegim, rezultojnë se gjithçka që lidhet me butësinë e me mëshirën, janë prej cilësive të bukurisë, siç janë emrat: "الرحمن" - "Err'rrahmànu" - "i Gjithëmëshirshmi"; "الرحيم" - "Err'rrahijmu" - "Mëshirëploti"; "اللطيف" - "El'letijfu" - "i Buti"; "العطوف" - "El atùfu" - "i Dashuri"; "الرب" - "Err'rrabu" - "Sistemuesi" dhe të ngjashme me këto.

Kurse cilësitë që kanë lidhje me detyrimin, janë prej cilësive të madhësisë, siç janë emrat e bukur "المالك" - "El màliku" - "Sunduesi"; "التهار" - "El Kah'hàru" - "Detyruesi"; "المنتقم" - "El muntekimu" - "Ndëshkuesi" dhe të ngjashme me këta emra. Këta emra janë në sekretin e çdo bukurie dhe në sekretin e çdo madhësitie, sepse për çdo bukuri, në brendësinë e saj, ka një hutim e një trallisje, që shfaqet në zemër me sekretin e madhërisë dhe të fuqisë; gjithashtu, edhe për çdo madhësi, në brendësinë e saj ka mëshirë, me të cilën kënaqet zemra në brendinë e saj, por zemra, nga cilësia e pastër e krijimit, tërhiqet kah bukuria e kah më e



bukura. Gjithashtu, zemra tërhiqet edhe kah fuqia dhe e madhja, tërhiqet kah i Fuqishmi dhe kah i Madhi.

Këto dy lloje cilësish janë cilësi të qëndrueshme dhe nuk janë cilësi pasive, ose cilësi negative.

Kur për ty kjo kërkesë bëhet e qartë, atëherë dije se fjala: “الله” - “**Allahu**”, nëse është emri më i madh, përfshin cilësitë e bukurisë, madhësisë dhe rrethimin e gjithçkaje me diturinë e Tij. Por emri “Allah” disa herë thuhet edhe për cilësinë e bukurisë kundrejt cilësive të madhësisë, ashtu siç kuptohet nga dy fjalët: hyjnore (ilâhijeh) dhe qenia, Zoti krijues (uluûhij'jeh), që, në përgjithësi, lidhen me cilësitë e bukurisë, sidomos kur këto cilësi vihen përballë cilësisë së madhësisë.

Bazuar në atë që u tha më sipër, ka mundësi që fjala “أحدٌ” - “*ehad*” - “**Një**”, në ajetin

“قُلْ هُوَ اللهُ أَحَدٌ” - “*Kul huvell'llàhu ehad*” - “**Thuaj: Ai, Allahu është Një**”, tregon njërin prej rrënjëve të cilësive të madhësisë. Kjo është pozita e plotësimit të thjeshtësisë së Personit të dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, kurse fjala “الله” - “*All'llàhu*” - “**Allah**” tregon emrin e bukurisë.

Atëherë, lidhja e të Vërtetit të Lartësuar në ajetin e nderuar mësohet sipas pozitës që Ai është “Një” e i “Vetëm” dhe të shkëlqimit me bujarinë e pastër, tri cilësi këto që përfaqësojnë punët hyjnore.

Nëse mbështetemi mbi mundësinë e parë, të cilën ne e përmendëm para kësaj vërejtjeje, rezulton se përshkrimi i lidhjes së



të Vërtetit të Lartësuar, shkon sipas pozitës së emrave që tregojnë bukurinë dhe madhështinë gjithërrethuese në të gjitha emrat. Vetëm Allahu është i Gjithëdituri!

### Vërejtje gnostike

Dije se fjala e çdo teologu është një shkëlqim për Personin e dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, sipas pozitës së dukjes dhe daljes në shesh e pozitës së tij të brendshme në pasqyrën e fjalëve, në masën e përgatitjes së endjes së fjalëve. Kur zemra është ndriçuese dhe e pastër prej papastërtive të botës së natyrës dhe pa turbullirat e saj, fjala e tij është dritë, madje është shumë dritë. Kjo dritë e zemrës shkëlqen në veshjen e jashtme të fjalëve, ashtu siç ka ardhur për fjalët e imamëve udhëzues në rrugën e drejtë: “fjala e tyre është dritë”<sup>1</sup>. Gjithashtu, në transmetime ka ardhur: “Padyshim, Allahu shkëlqeu në fjalën e Tij për robtë e Vet”.<sup>2</sup> Në veprën “Nehxhul Belàga”, lexojmë fjalën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Padyshim që fjala e Tij është puna e Tij”.<sup>3</sup> Fjala “shkëlqen” është në kuptimin e Vepruesit, pa fjalë.

---

<sup>1</sup>Pjesë nga “Ez’ zijaertul-Xhàmiatul-Kebijretu”; Lexo “Ujünü Akhbàru-Rr’rridà”, vëll. 2, f. 277.

<sup>2</sup>Lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 89, f. 107.

<sup>3</sup>“Nehxhul Belàga”, Hytbeja 228, f. 737, Botim i “Fejdu-l-Islàm”.



Por, kur zemra është e errët dhe e turbullt, patjetër që edhe puna, edhe fjala e tij janë të errëta e të turbullta, ashtu siç ka ardhur në ajetet e nderuara: “مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ” - “...methelen kelimeten taj'jibeten keshexheretin taj'jibetin” - “...e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë”<sup>1</sup>dhe “وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ” - “ue methelu kelimetin khabijthetin keshexheretin khabijthetin...” -“fjala e keqe është si pema e keqe”.<sup>2</sup>

Personi i pastër e i dëlirë nga nevojat e nga të metat shkëlqen vazhdimisht dhe kjo bazuar në ajetin e nderuar “كُلُّ نَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ” - “...kul'le jeumin huve fij sheënin” -“në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme”.<sup>3</sup>Ai shkëlqen në veshjen e emrave e të cilësive në zemrat e profetëve dhe të eulijave, por këto shkëlqime janë të ndryshme sipas ndryshimit të zemrave të tyre. Është fakt se të ndryshme janë edhe librat qiellorë, të zbritura në zemrat e tyre me anën engjellit kumtues të revelatës, Xhebrailit; të ndryshme janë edhe shkëlqimet, të cilat ndryshojnë sipas ndryshimit të emrave, që janë parimi i atyre librave; të ndryshëm janë edhe profetët e ligjet e fesë, me të cilën ata erdhën. Kjo, në të vërtetë, është sipas ndryshimit të gradës së informacionit dhe gjithëpërfshirjes së emrave.

Nuk është qëllimi të thuhet se Kur'ani Famëlartë ose fjala e të Dërguarit më të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) është prej “xhevâmiul-kelem”<sup>4</sup> - “fjalëve universale”, fjalë që shpjegojnë të përgjithshmet dhe rregullat

<sup>1</sup>Sure “Ibrâhim”, ajeti 24.

<sup>2</sup>Sure “Ibrâhim”, ajeti 26.

<sup>3</sup>Sure “Er Rrahmân”, ajeti 29.

<sup>4</sup>Tregon për hadithin e nderuar profetik: “dhe iu dha xhevâmiul-kelem” - “fjalëve universale” Lexo “El-Khisâl”, K. 5, Hadithi 56.



universale, edhe nëse hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë në përputhje me këtë kuptim, por edhe ato janë prej fjalëve universale e rregullave, siç dihet, prej shkencës së jurisprudencës islame. Në të vërtetë, qëllimi me cilësitë gjithëpërfshirëse të Kur'anit është kuptimi vijues: Kur'ani Famëlartë, pa dyshim, që ka zbritur për të gjitha shtresat e njerëzimit gjatë gjithë periudhave të jetës së njeriut dhe që t'u përgjigjet të gjitha nevojave të njerëzve. Gjithashtu, edhe specia njerëzore është një e vërtetë universale e vetme për të gjitha pozicionet, duke filluar nga pozicioni më i ulët i pronës deri në gradët më të larta shpirtërore dhe të cilësive e fuqisë. Meqenëse kjo specie, bazuar mbi ato që u thanë më sipër, është e ndryshme në këtë botë lëndore të poshtme deri në atë shkallë sa është e pamundur të jetë një tjetër si ajo në mesin e individëve të çdo lloji prej qenieve të tjera, prandaj te njerëzit ka vend e keqja deri në atë shkallë sa nuk mund të ketë shkallë tjetër më të keqe; gjithashtu, në specien njerëzore ka edhe të lumtur deri në atë shkallë sa nuk mund të ketë më të lumtur; ka njerëz që janë më të këqij se kafsha, në të njëjtën kohë ka njerëz që janë edhe më të nderuar se të gjithë engjëjt që janë afër të Lartit; gjithashtu, individët e species njerëzore janë të ndryshëm edhe nga ana e kuptimit, edhe nga ana e diturive, prandaj Kur'ani Famëlartë ka zbritur në atë mënyrë, që të realizohet dobia për të gjithë njerëzit dhe për çdo njërin, sipas plotësimit të kuptimit të tij e të diturive të tij dhe sipas gradës së tij në fushën e diturisë.

Ajeti i nderuar: "لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا..." - "*Leu kanë fijhimà àlihetun il'lell'illàhu lefesedetà...*" - "**Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të**



**shkatërroreshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!”<sup>1</sup>**

Ky ajet i nderuar u jep dijetarëve dhe gjuhëtarëve të kuptojnë njërën anë, e cila është e ndryshme nga ana prej së cilës mund të përfitojnë prej tij teologët, nga ana prej së cilës mund të përfitojnë prej tij filozofët e të urtët, dijetarët dhe eulijatë, çdo njëri prej tyre kupton prej diturive të Kur’anit një punë të caktuar.

Ndjekësit e traditës kuptojnë prej këtij ajeti – sipas shijeve të tyre - një shpjegim fjalësh dhe, për shembull, thonë: një mbretëri e vetme nuk mund të jetë për dy sulltanë, ose ekzistenca e dy kryetarëve në një tribu të vetme çon në shkatërrim, madje edhe prania e dy kryepelqve në një fshat të vetëm çon në kundërshtime, në grindje të ndërsjella, në konflikte e në armiqësi.

Në zhvillim të kësaj logjike, sikur në botë të ishin dy zota, patjetër që kjo gjendje do të çonte në grindje, në diferencime dhe në armiqësi të ndërsjella, por realisht këto diferencime nuk ekzistojnë në botë. Gjithashtu, edhe sistemi i qiejve e i tokës është i ruajtur, prandaj Sistemuesi i botës, patjetër duhet të jetë Një e i Vetëm, pa ortak.

Teologët mësojnë prej këtij ajeti të nderuar, me argumentin e “pengimit të njëri-tjetrit”, por edhe filozofët dhe të urtët, bazuar mbi këtë ajet, ndërtojnë një argument legal të fuqishëm dhe thonë: “prej njëshit nuk del gjë tjetër përveç njëshit dhe se njëshi del vetëm prej njëshit”.<sup>2</sup> Në një kohë, kur ata që kanë arritur gradën e njohjes

---

<sup>1</sup>Sure “El Enbijà”, ajeti 22.

<sup>2</sup>“Rregulli në filozofi”, lexo shpjegimin e Khavâxheh Nesijru-d’ dijn Et’ tûsij, në librin “El-Ishârâtu uet’ tenbijhâtu”, vëll. 3, f. 122; “El Esfâru El erbeah”, vëll. 2, Ndarja 13, f. 204.



prej këtij ajeti të nderuar, mësojnë “Njëshin” dhe këtë mësim e bazojnë në faktin që bota është pasqyra e shfaqjes së të Vërtetit dhe vendi ku Ai shkëlqen.

Ka edhe shumë mësimë të tjera, që mund të nxirren prej këtij ajeti, por do të rezultonte një varg shumë i gjatë, nëse do t’i përmendim ato një e nga një.

Tani që u qartësove me këtë parathënie, dije se surja “Et Teuhid” - (El Ikhlàs), si njëra prej sureve të Kur’anit Famëlartë, patjetër që edhe kjo sure është prej “xhevàmiul-kelem” - “fjalëve universale” dhe çdo individ kupton prej kësaj sureje në një masë të caktuar, për shembull, gjuhëtarët dhe dijetarët që marrin vetëm kuptimin e jashtëm të fjalëve (dhàhiritë), mendojnë se përemri “هو” - “huve” - “**Ai**”, është përemër që tregon Personin e dëlirë nga nevojat e nga të metat dhe fjala “الله” - “All’llàh” - “**Allahu**”, është emri i Personit të pastër, kurse fjala “أحد” - “ehad” - “**Një**” është në kuptimin “një”, në shkallën sipërore të njëshit, domethënë që Allahu është Një dhe s’ mund të jetë ndryshe, ose për Allahun s’ka ortak dhe Ai është i Adhuruari i vetëm, ose në kuptimin “أليس كئلهي شيء” - “...lejse kemithlihi shej’un” - “**Asgjë nuk i shëmbëllen Atij**”,<sup>1</sup> domethënë se për Allahun s’ka ortak dhe vetëm Ai është Zoti, i Adhuruari, ose punët e Tij janë unike, domethënë që punët e Tij janë përmirësim e bamirësi, megjithëse punët nuk i sjellin ndonjë dobi të Lartit.

Ajeti “الله الصمد” - “All’llàhus’samedu” - “**Allahut i drejtohet çdo krijesë**”, do të thotë: Zotëria i madh, të Cilit i drejtohen njerëzit për nevojat e tyre, ose fjala “الصمد” - “es’samed” - “**i drejtohen**”, do të thotë:

---

<sup>1</sup>Sure “Esh Shùrà”, ajeti 11.





personi që s'ka boshllëk, çka nënkupton se prej tij nuk lind asnjë send; gjithashtu as Ai nuk është i lindur prej ndonjë sendi; për Atë s'ka as të ngjashëm e as të barabartë. Ky interpretim është interpretim tradicional, i përgjithshëm kundrejt mohuesve, të cilët kishin shumë zota, por zotat e tyre përshkruheshin me cilësinë e mundësisë. Për të gjitha këto, i Dërguari më i nderuar, urdhëroi që atyre t'u thuhej se Zoti ynë nuk është si zotat e tyre dhe cilësitë e Zotit tonë janë këto e këto.

Ky interpretim i sures është në përputhje me rrugën e traditës së zakonshme dhe është interpretimi i njërit prej grupeve. Ky interpretim nuk është në kontradiktë me kuptimin, ose me kuptimet e hollësishme të kësaj sureje, disa prej të cilave ne i përmendëm më sipër.



## Interpretim i domosdoshëm

Interpretimi i sures “Et Teuhid” - (El Iklàs) ka ardhur për njerëzit e kohës së fundit, të cilët thellohen në imtësitë, prandaj është e mundur të jetë një interpretim i domosdoshëm, në përputhje të plotë me peshoret përfundimtare dhe me argumentet filozofike, siç do ta shohim më poshtë. Unë e kam mësuar këtë prej shehut të madh, dijetarit Shah Abadij.

Fjala e ajetit “هو” - “huve” -“Ai”, në përgjithësi, tregon një qenie, tregon një substancë që nuk është e pranishme. Në këtë përemër ka një argument, i bazuar mbi gjashtë çështje legale të larta, të cilat i vërteton kjo sure për të Vërtetin e Lartësuar. Këto çështje janë:

*E para:* pozita e të qenit Zoti krijues (El ulùhij’jeh), është pozita e përqendrimit të të gjitha plotësimeve dhe pozita e Njëshit, në të gjithë bukurinë e madhështinë. Është vërtetuar me argument, në supozimin prej botimeve të filozofëve, se, thjesht, ekzistenca e substancës, në përgjithësi, është vetë plotësimi dhe domosdoshmëria për pastrimin e vetë ekzistencës.

Këtu është e mjaftueshme të theksohet se këto tema dhe shpjegimi i tyre, kërkon një zgjatje të madhe dhe ka nevojë për disa parathënie.



*E dyta:* pozita e Njëshit (El Ehadij'jeh). Kjo pozitë tregon thjeshtësinë e plotë (domethënë se Ai nuk është i përbërë), tregon thjeshtësinë logjike, ose thjeshtësinë e jashtme dhe substancën e ekzistencës së Tij, tregon edhe dëlirjen e Tij prej çdo lloj përbërjeje logjike dhe, është e barabartë qoftë kjo përbërje lloj, qoftë ndarje, qoftë lëndë, ose figurë logjike prej përbërësve të jashtëm; në mënyrë të barabartë qoftë lënda dhe figura e jashtme, ose pjesët e caktuara.

Argumenti për këtë kërkesë është i njëjti argument për ekzistencën e mirëfilltë dhe substancën Absolute. Sikur Ekzistuesi të mos ishte Një e i Vetëm, patjetër do të kërkonte daljen e Tij jashtë kuadrit të ndërrimit; gjithashtu, do të kërkonte edhe zhveshjen e Tij prej Personit të Tij.

*E treta:* pozita që “i drejtohen njerëzit” (Es' samedij'jeh). Kjo pozitë tregon se ai nuk është materie dhe se ai s'ka të brendshme. Gjithashtu, tregon edhe mungesën e mundësisë në Atë, sepse të gjithë mundësitë mbliidhen në një gradë prej personit që është në pozitën e thjeshtësisë dhe të brendshmes së tij që është bosh, domethënë se Ai s'ka të brendshme. Por Personi i dëlirë nga nevojat e nga mangësitë është vetë ekzistenca dhe substanca absolute, pikërisht për këtë, në këtë trup e në këtë substancë, s'ka mundësi. Ai është substancë, origjinë dhe esencë, por esenca është e zhveshur prej kufijve të ekzistencës dhe konsiderohet prej caktimit të ekzistencës, në një kohë kur vetë ekzistenca është e pastër e s'ka asnjë përgjegjësi prej kufirit e prej caktimit, për faktin se çdo i kufizuar është identiteti i kushtëzuar dhe një trup i përbërë dhe jo vetëm ndryshim.

*E katërta:* mosndarja e ndonjë sendi prej Tij. Ndarja e një diçkaje prej sendit, kërkon domosdoshmëri praninë e grimcave



të materies, madje do të kërkonte pjesët e caktuara të materies, por kjo është në kundërshtim me identitetin absolut dhe me vetë ekzistencën.

Për sa i përket ekzistencës së shkaqeve e pasojës, kjo nuk mund të plotësohet me rrugën e ndarjes, por plotësohet me rrugën e shkëlqimit, shfaqjes, personalitetit dhe daljes, në atë mënyrë që kjo dalje nuk çon në pakësimin e sendit prej pasojës dhe as i shtohet ndonjë sendi me kthimin e pasojës.

*E pesta:* mosndarja e Tij prej sendit, duke shtuar renditjen e moskalimit të prishësve të mëparshëm mbi Të. Nëse e supozojmë këtë ndarje, ajo është në kundërshtim me vetë ekzistencën dhe me dhënien e identitetit, për më tepër, kërkon ekzistencën e një sendi paraprak mbi vetë ekzistencën, në një kohë kur filozofia e lartë vërteton se ekzistenca e mirëfilltë është sendi më i mëparshëm, kurse të caktuarit janë pas Absolutit.

*E gjashta:* nuk ekziston asnjë i ngjashëm e asnjë i barabartë me Allahun. Gjithashtu, mohohet shembulli e përngjasimit me Të. Kjo vërtetohet me argumentin e “ekzistencës së mirëfilltë”, sepse nuk mund të përfytyrohet ekzistenca e dy identiteteve absolute, ashtu siç nuk janë “absoluti” dhe i “kushtëzuar” as të ngjashëm e as të barabartë.

Për çdo njërën prej këtyre çështje, ka përparësi e baza të shumta, por vendi këtu nuk është i mjaftueshëm për t’i shpalosur.



## Urtësi ndriçuese

Mëso se kjo sure e bekuar, edhe pse është kaq e shkurtër, përmbledh të gjitha çështjet hyjnore në gradët e madhërimit e të dëlirjes së të Vërtetit nga nevojat e nga mangësitë. Padyshim që kjo sure ka lidhje vetëm me të Vërtetin e Lartësuar dhe mundëson përgjigjen në formën e fjalëve dhe endjen e shprehjeve e frazave.

Ajeti “قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ” - “kul huvell'llâhu ehadun” - **“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!’”**, ka në brendinë e tij të gjitha të vërtetat e cilësive të plotësuara dhe përfshin të gjitha cilësitë e qëndrueshme. Ajeti vijues i kësaj sureje “اللَّهُ الصَّمَدُ” - “All'llâhus'samedu” - **“Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim”** dhe ajetet vijuese deri në fundin e sures, shpalosin cilësitë pastruese dhe tregojnë heqjen absolute të mangësive. Në këtë sure të nderuar vërtetohet dalja jashtë prej dy kufijve: kufirit të lënies pa punë dhe kufirit të përngjasimit. Të dy këta kufij janë dalje jashtë kufirit të maturisë dhe jashtë të vërtetës së besimit, që i Vërteti është Një e i Vetëm (teuhid). Ajeti i parë e mohon “lënien pa punë”, kurse pjesa tjetër e sures mohon “përngjasimin”. Kjo sure përfshin jo vetëm Personin e dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, por flet edhe për pozitën se Ai është Një, pozitë që është shkëlqimi me emrat vetjakë. Përfshin edhe pozitën se Ai është i Vetmi. Kjo është pozita e shkëlqimit me emrat e me cilësitë. Në lidhje më këtë çështje, më sipër kemi dhënë shkoqitje në një masë të përshtatshme.



## Plotësim

Shehu Saduk (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*) ka transmetuar prej Ubej El Bakhterijit, prej Vehib bin Vehb El Kurshijit, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), domethënien e këtij ajeti: “قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ” - “Kul huvevell’llàhu ehadun” - **“Thujaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!’”**: *Shpalle sheshit atë çka të kemi zbritur dhe të kemi njoftuar ty, se, me kombinimin e shkronjave, të kemi zbritur një Kur’an, me të cilin udhëzohet në rrugën e drejtë kushdo që e dëgjon, si dhe ai që e sheh vetë me sytë e ballit”*.

Me përemrin “هو” - “huve” - “Ai” tregohet personi që nuk është i pranishëm dhe shkronja “ه” - “hu” - “h” tërheq vëmendjen për një kuptim të vërtetuar, kurse shkronja “و” - “ve” - “v” e këtij përemri tregon për diçka që nuk e kapin shqisat. Kjo është e njëjtë, kur ti thua “ky”, kur dëshiron të tregosh dikë që është i pranishëm dhe e kapin shqisat.

Shenja që jep ky përemër për personin që nuk është i pranishëm, ka ardhur për shkak se mohuesit u tërhiqnin vëmendjen ndaj zotave të tyre, duke treguar diçka që shihej me sy dhe thoshin se zotat e tyre ndihen dhe i shohin sytë, prandaj o Muhamed, edhe ti na e trego zotin tënd, të cilit i lutesh; na e trego që edhe ne ta shohim atë e ta kuptojmë dhe të mos e marrim kot si perëndi. Atëherë Allahu i Lartësuar zbriti: “قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ...” - “Kul huvevell’llàhu ehadun....” - **“Thujaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!’”**



Në përemrin “هو” - “huve” - “Ai”, shkronja “ه” - “h” vërteton se Ai është i qëndrueshëm dhe kjo s’ka nevojë të vërtetohet, kurse shkronja “و” - “v” tregon diçka që nuk është i pranishëm, tregon send që është larg dhe, për rrjedhojë, as nuk mund të shikohet e as shqisat nuk arrijnë ta perceptojnë. Allahu i Lartësuar, padyshim që është larg çdo hamendësimi të këtillë, sepse Ai di çka në zemrat e njerëzve dhe Ai është Krijuesi i shqisave.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Fjala ‘الله’ - ‘All’lâhu’ - ‘Allahu’ është i Adhuruari që e adhurojnë njerëzit dhe krijesat e tjera, por ata nuk arrijnë ta kuptojnë identitetin e Tij dhe nuk dinë si është Ai”.

Arabët përdorin foljen “الله” - “el’lehe” - “hyjnzoi”, kur burri mbetet i hutuar prej një sendi dhe nuk ka dijeni si është ai send, ndërkohë përdorin foljen “ولله” - “vel’lehe” - “e humb mendjen”, kur burri tmerrohet prej një sendi prej të cilit ruhet, ose e ka frikë atë. Atëherë rezulton se Allahu është i mbuluar prej shqisave.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Fjala e ajetit ‘الأحد’ - ‘el ehad’ - ‘një’ do të thotë një individ i vetëm. Fjala ‘الأحد’ - ‘el ehad’ dhe fjala ‘الواحد’ - ‘el vâhidu’, të dyja janë në kuptimin: Një i Vetëm, për të Cilin s’ka të barabartë”.

Termi “التوحيد” - “et’teuhid” - besimi që Allahu është Zoti Një e i Vetëm, do të thotë: pohimi se Ai është Një e i Vetëm. Kur themi Një, kuptojmë se ky Një është krejtësisht i ndryshëm nga sendet që ne njohim. Ai as nuk ka dalë prej ndonjë sendi dhe as nuk bashkohet me ndonjë send. Nisur nga këtu, kanë thënë: fillimi i numrave me njëshin, është njëshi i numrave, sepse numrat nuk



mund të bien mbi njëshin, por bien mbi dyshin dhe kuptimi i fjalës së Allahut të Lartësuar: “الله أحد” - “All’lלהu ehadun” - “**Allahu është Një**”, do të thotë: i Adhuruari, të Cilin njerëzit e adhurojnë, ngaqë e kuptojnë Atë dhe kanë dijeni se si është Ai; ata e adhurojnë Atë për cilësinë e Tij krijuese dhe Ai është i Gjithëfuqishmi.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Babai im, Zejnel Abedini më ka treguar se çfarë ka thënë babai i tij, Hysen bin Aliu (Paqja qoftë mbi të!): ‘Fjala ‘Es’samed’ tregon Personin që s’ka boshllëk në brendësi. Personi, sundimi e prestigji i të cilit nuk kanë fund; është Personi që nuk ha e nuk pi; është Personi që nuk fle, është i Përjetshmi, që ka qenë dhe vazhdon të jetë”.

Gjithashtu, Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Muhamed bin El Hanefij’jeh thoshte: ‘Es’samed është Personi që qëndron me vetveten e Tij, pa pasur nevojë për ndonjë tjetër’”. Dikush tjetër ka thënë: “(Es’samed) është i Lartësuar mbi gjithësinë e mbi shkatërrimin; është Personi, që nuk mund të cilësohet për ndryshueshmëri”.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Es’samed është Zotëria, para të Cilit nënshtrohen të gjithë dhe mbi Atë s’ka asnjë që të urdhërojë apo ta ndalojë”.

Gjithashtu, Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur Ali bin Hysen Zejnel Abedini (Paqja qoftë mbi të!) është pyetur për fjalën ‘es’samed’, ka thënë: ‘Është Personi për të cilin s’ka ortak. Atij nuk i rëndohet të ruajë një send dhe për Atë nuk mbetet i fshehur asnjë send”.

Vehib bin Vehibi ka transmetuar nga Zejd bin Aliu (Paqja qoftë mbi të!): “(Es’samed) është Ai që, kur dëshiron një send, i thotë atij sendi: “Bëhu!” dhe ai send menjëherë bëhet; (Es’samed) është Ai që i shpiku sendet dhe i krijoi ato, Ai i bëri sendet konkurruese me njëra-





*tjetrën, u dha sendeve forma dhe i bëri çift; Ai u veçua se është Një, pa të kundërt; Ai s'ka formë dhe për Atë s'ka shembull e të ngjashëm".*

Vehib bin Vehibi citon edhe një fjalë prej Imamit Ali bin Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me interpretimin e fjalës "es'samed". Ai citon edhe një fjalë prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me sekretet e fjalës "es'samed": "*Sikur të gjeja një hamla prej diturisë që më ka dhënë Allahu i Gjithëfuqishëm, patjetër që prej 'es'samed' do të përhapja teuhidin, Islamin, imanin, fenë dhe ligjin e fesë. Por, si jam unë me këtë?! As gjyshi im, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), kurrë nuk gjeti një hamle\* prej diturisë tij dhe për këtë, kur ngjitej mbi minber, thoshte: 'Më pyesni, para se të më humbni, sepse mes anëve të mia ka shumë dituri. Ah, ah! Por nuk gjej atë që do ta mbajë këtë dituri!'"<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup>"Et' teuhid", K. "Tefsiri 'Kul huvell'llàhu ehad'", f. 88. \* hamle, masë peshe e barabartë me 60 okë, ose baras me 74.88 kg.



## Mbyllje

E mbyllim këtë studim me përmendjen e disa haditheve të nderuara, që kanë ardhur në lidhje me mirësinë e kësaj sureje të bekuar, edhe pse hadithet që flasin për mirësinë e saj, janë më shumë nga sa mund të rreshtojmë në këtë përmbledhje.

Në librin “El-Kâfi”, me zinxhir transmetimi që përfundon deri te Imam Bakri (*Paqja qoftë mbi të!*), është transmetuar fjala e tij: *“Kush e këndon një herë ‘Kul huvell’llàhu ehad...’, bekohet; kush e këndon këtë sure dy herë, bekohet ai vetë dhe njerëzit e familjes së tij; kush e këndon këtë sure tri herë, bekohet ai dhe fqinjët e tij; kush e këndon këtë sure dymbëdhjetë herë, Allahu ndërton për të dymbëdhjetë pallate në Xhenet dhe, ruajtësit e Xhenetit thonë: ‘Ejani të shkojmë së bashku te pallatet e vëllait tonë, filanit dhe t’i shikojmë ato pallate’; kush e këndon këtë sure njëqind herë, atij i falen mëkatet e njëzet e pesë vjetëve, me përjashtim të mëkatit të vrasjes dhe vënies dorë mbi të drejtën e tjetrit; kush e këndon këtë sure katërqind herë, ai ka shpërblimin e katërqind dëshmorëve të rënë në rrugën e Allahut dhe çdo njërit prej tyre i është vrarë kali dhe atij i është derdhur gjaku”.<sup>1</sup>*

Gjithnjë, në librin “El-Kâfi” lexojmë: *“Kush e këndon suren ‘Kul huvell’llàhu ehad...’ njëqind herë, kur shtrihet në shtroje, Allahu i fal atij mëkatet e pesëdhjetë vjetëve”.<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup>“Usùlul-Kâfi”, vëll. 4, Libri “Fadlul-Kur’àn”, K. “Fadlul-Kur’àn”, Hadithi 1, f. 425.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 4.



Përsëri në këtë libër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar fjalën e babait të tij, Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kul huve-ll'lahu ehad...” është një e treta e Kur'anit dhe ‘Kul jà Ej'juheli kàfirûne...’ është një e katërta e Kur'anit”.<sup>1</sup>

Gjithnjë në librin lartpërmendur, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) fali namazin e xhenazes së Sad bin Muadhrit dhe menjëherë pas faljes, tha: ‘Erdhën të falin namazin e xhenazes së tij shtatëdhjetë mijë engjëj, ndër të cilët edhe Xhebraili (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilit i thashë: ‘O Xhebrail, me çfarë e ka merituar ai, që ju të luteni për të?’ Ai tha: ‘Me këndimin e ‘Kul huve-ll'lahu ehad...’, e ka kënduar më këmbë, ndenjtur, kur udhëtonte mbi kafshë, kur ecte më këmbë dhe kur shkante e kur vinte’”.<sup>2</sup>

Në librin “El-Vesàil”, citur prej “El Mexhaàlisu ue Meànij El Akhbar”, me përcjellës që përfundojnë te Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ky i fundit prej baballarëve të tij të mëdhenj, në kuadrin e një hadithi, i përcjellë prej Selmanit (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*), lexojmë se ky i fundit ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ka thënë: ‘Ai që e këndon suren “Kul huve-ll'lahu ehad...” një herë, ka lexuar një të tretën e Kur'anit; ai që e këndon këtë sure dy herë, ka kënduar dy të tretat e Kur'anit dhe ai që e këndon këtë sure tri herë, padyshim që ai ka këndur të gjithë Kur'anin’”.<sup>3</sup>

Në librin “Thevâbul-Amàli”, transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka

<sup>1</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 7.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, Hadithi 13.

<sup>3</sup>“Vesàilu-Sh'shij'ah”, Libri “Es'salâtu”, K. 31- “Këndimi i Kur'anit”, Hadithi 5; “Meànij El-Akhbâr”, f. 234.



thënë: *“Atij që i kalon një e xhuma dhe ai në atë ditë nuk ka kënduar “Kul huvell’lilàhu ehad...” dhe pastaj ai vdes, ai njeri ka vdekur në fenë e Ebù Lehebit”*.<sup>1</sup>

Autori i librit “El-Mustedrek” ka cituar shumë hadithe të gjata, që flasin për mirësinë e kësaj sureje të bekuar, prandaj ai që dëshiron, le të lexojë dy librat e mi, “El-Mustedrek” dhe “El-Vesàil”. El hamdu lil’läh! – Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun!

---

<sup>1</sup>“Thevàbul-Amàl”, f. 156.



## Ndarja e shtatë

# FLLAD NGA INTERPRETIMI I SURES SË BEKUAR “EL KADR”, DUKE IA PËRSHTATUR KËSAJ KUMTESE

Në fjalën e Allahut të Lartësuar: “إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ” - “In'nà enzelnàhu fij lejletil kadri” - “**Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në natën e Kadrit**” ka kërkesa të larta, disa prej të cilave duhet të theksohen për shkak të përfitimeve që mësohen prej kësaj sureje.

*Kërkesa e parë:* Njoftimi që jepet në këtë ajet dhe në disa ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë tregon se Allahu i Lartësuar zbritjen e Kur'anit ia ka ngarkuar Vetes së dëlirë nga nevojat e mangësitë, siç njofton me fjalën e Tij: “إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ مُبَارَكَةٍ” - “In'nà enzelnàhu fi lejletin mubàreketin...” - “**Ne e zbritëm Kur'anin në një natë të bekuar**”<sup>1</sup>; “إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ” - “In'nà nahnu nez'zelnedh'dhikre ue in'nà lehù hàfidhùne” - “**Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë**”<sup>2</sup>. Siç u tha edhe më sipër, marrja përsipër e detyrës për zbritjen e Kur'anit, nga ana e Allahut të Lartësuar, theksohet edhe në shumë ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë.

---

<sup>1</sup>Sure “Ed Duhàn”, ajeti 3.

<sup>2</sup>Sure “El Hixhr”, ajeti 9.



Në ajete të tjera, Allahu i Lartësuar ia dreson barrën e zbritjes së Kur'anit Famëlartë shpirtit besnik, Xhebrailit, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Tij: “تَنْزِيلَ بِهِ الرُّوحِ الْأَمِينِ” - “Nezele bihirr’rruhul emijn” - “**Atë e zbriti Shpirti i besueshëm** (Xhebraili)”.<sup>1</sup>

Dijetarët dhahiri (ata që marrin vetëm anën e jashtme të ajeteve të Kur'anit), në lidhje me këtë problem thonë se kjo çështje është prej llojit të fjalës së të Lartit: “يَا هَامَانَ ابْنِ لِي صَرْحًا” - “...jà Hāmānu bni lij sarhan...” - “**...O Haman, ndërtoma një kullë, që t’i arrij rrugët...**”,<sup>2</sup> domethënë që është metaforë, sepse vetëm Allahu i Lartësuar është shkaku i zbritjes dhe vetëm Ai është urdhëruesi për zbritjen e Kur'anit Famëlartë; ose ngarkimi i barrës për zbritjen e Kur'anit Famëlartë mbi të Vërtetin, do të thotë se kjo është vetë e vërteta, në një kohë që ngarkimi me detyrën për zbritjen, është metaforë, në raport me Shpirtin besnik, duke vënë në konsideratë se Xhebraili është ndërmjetësuesi i zbritjes.

Ky interpretim i atyre dijetarëve mbështetet në konsideratën e atyre që thonë se raporti i punës së të Vërtetit me krijesat, është si raporti i punës së njerëzve me njëri -tjetrin.

Për rrjedhojë (thonë ata) edhe detyra e ngarkuar mbi Xhebrailin dhe Azrailin, patjetër që është prej të Vërtetit, është si detyra që i ngarkoi Faraoni Hamanit, ose si detyra me të cilën Hamani ngarkoi ndërtuesit e arkitektët. Padyshim që ky është një krahasim i gabuar dhe është krahasim së bashku me dalluesin.

Në të vërtetë, të kuptuarit e lidhjes njerëz - i Vërteti dhe punëve të njerëzve e të Krijuesit, janë prej rrënjëve të diturive

---

<sup>1</sup>Sure “Esh Shu’arà”, ajeti 193.

<sup>2</sup>Sure “El Gàfir”, ajeti 36.



hyjnore dhe prej çështjeve filozofike, mbi të cilat mbështetet zgjidhja e shumë problemeve të vështira, si çështja e detyrimit dhe e delegimit të kompetencave, çështja, e cila në temën që kemi në trajtim, konsiderohet njëra prej degëve të saj.

Mëso se në dituritë e larta është vërtetuar që shtëpia e vërtetimit, në tërësi, si dhe gradët e ekzistencës janë një kopje e “bujarisë së pastër” dhe e shkëlqimit ndriçues të të Vërtetit të Lartësuar.

Meqenëse “shtimi i ndriçimit” është lidhja e pastër dhe varfëria e mirëfilltë, atëherë caktimi e format e caktimit, gjithashtu, janë lidhje e pastër, por vetë ato s’kanë as motiv e as pavarësi.

Me fjalë të tjera, padyshim që plotësimi i shtëpisë së vërtetimit është në të Vërtetin, në Personin e tij të dëlirë nga nevojat e nga mangësitë dhe në cilësitë e në punët. Sikur njëra prej qenieve të kishte pavarësi në ndonjërin prej punëve personale, qoftë në identitetin e ekzistencës, qoftë në punët të tjera, patjetër që ajo qenie do të dilte jashtë kufijve të mundësisë dhe do të shndërrohej në një person, ekzistenca e të cilit është domosdoshmëri, por kjo është një pamundësi pa asnjë vlerë dhe shumë e qartë.

Kur kjo mirësi hyjnore forcohet në zemër dhe atë e shijojnë zemrat aq sa është e mjaftueshme, për atë njeri zbulohet njëri prej sekreteve të kaderit dhe për atë do të dalë sheshit një butësi prej të vërtetës së asaj që quhet “puna ndërmjet dy punëve”<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup>Tregon atë që thuhet në hadithin e nderuar, i ardhur prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: “S’ka as detyrim e as delegim, por ka një punë në mes dy punëve...”; lexo “El-usûlu minel-Kâfi”, “Kitâbu- t’ teuhijdi”, K. “El-xhebru uel-kaderu uel-emru bejnel-emrejni”.



Atëherë shenjat dhe punët e plotësuar është e mundur të lidhen me të Vërtetin me të njëjtën lidhje që është me njerëzit, pa pasur në këtë punë asnjë ngjyrë të metaforës. Kjo që u tha, realizohet në idenë e njëshit e të shumicës dhe të bashkimit mes dy punëve.

Po, kur personi ka rënë në shumicën e mirëfilltë, ai është i mbuluar prej njëshit, për rrjedhojë ai e lidh punën me njerëzit dhe është i shkujdesur ndaj të Vërtetit, ashtu siç është gjendja e të mbuluarve. Por, kur në zemrën e tij shkëlqen Njëshi dhe është i mbuluar ndaj njerëzve, atëherë ai të gjitha punët i lidh me të Vërtetin e Lartësuar. Për sa i përket dijetarit studiues, ai bashkon njëshin me shumicën, në të njëjtën kohë ai e lidh punën me të Vërtetin, pa asnjë lloj aluzioni për alegori, sepse ajeti i nderuar:

“رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَوْا” - “...ue mà remejte idh remejte ue lakin' nell' llàhu remà...” - “**Sigurisht, nuk ishit ju që i vratë ata, por i vrau Allahu!**”<sup>1</sup> Siç shihet, ajeti i nderuar e mohon gjuajtjen në kuadrin e vërtetimit të gjuajtjes prej tij, por edhe vërtetimi i gjuajtjes bëhet në kuadrin e mohimit të gjuajtjes prej tij. Në këtë ajet ka një shenjë që tregon pijen më të ëmbël të njohjes dhe rrugën e hollësishtme të besimit.

Ajo që kemi thënë në lidhje me “punët e argumentet e plotësuar”, si dhe ajo që kemi shpjeguar në lidhje me nxjerrjen jashtë të mangësive, është për treguar që mangësitë kthehen në mosekzistencë; gjithashtu, është edhe prej caktimeve të ekzistencës dhe nuk ka lidhje me të Vërtetin. O Allah i Lartësuar, ky ishte vetëm një shëmbëllim i rastësishëm!

---

<sup>1</sup>Sure “El Enfâl”, ajeti 17.





Këtu nuk na mjafton vendi, që të zgjerohemi për shpjegimin e këtij problemi.

Në të gjitha gjendjet, kjo paraqitje shpjegon qartë lidhjen e zbritjes me të Vërtetin e Lartësuar. Gjithashtu, shpjegon qartë atë gjendje tërheqjeje, asgjësimi e vdekjeje. Padyshim që shpërblimin për zotëruesit e zemrave, e ka në dorë Allahu i Lartësuar. Ai është shpërblyesi i tyre dhe vetëm Ai, i Larti, i shpërblen ata.

Ata janë të dashuruarit e asgjësuar nën “kubetë e Allahut” dhe s’ka asnjë njeri që i njeh ata, ose që ka lidhje me ta. Gjithashtu, edhe ata nuk njohin ndonjë tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar, ashtu siç e lexojmë në hadithin kudsi: “*Miqtë e Mi janë nën kubetë e Mia dhe ata nuk i njeh askush përveç Meje*”.<sup>1</sup>

*Kërkesa e dytë:* Ata e meritojnë kthimin në veten e tyre dhe realizojnë gjendjen e zgjimit për veten e tyre vetëm pas plotësimit të ecjes për te Allahu, në kërkim të fitimit të kënaqësisë së Allahut.

Ata janë të atillë që u është plotësuar vlerësimi i përgatitjes së tyre, sipas shkëlqimit të bujarisë më të pastër dhe është sekreti i fuqisë. Ata janë të provuar nga ana e të Vërtetit të Lartësuar në kuadrin e plotësimit të robëve dhe për popullimin e vendit.

Për të këtillë njerëz, pas lidhjes me prezencën shkencore dhe kthimit në të vërtetat e shikimit me sy, zbulohet sekreti i shikimit me sy dhe lidhja e tyre me praninë e pastër në udhëtimin e tyre për te Allahu dhe lumturia. Ata janë të veshur me rrobën e profetësisë dhe, pikërisht ky është zbulimi i shpalljes hyjnore, para zbritjes në botën e shpalljes së Xhebrailit.

---

<sup>1</sup>Hadith kudsi. Lexo “*Thjàu ulùmu-d’ dijn*”, vëll. 4, f. 256.



Më pas, pas orientimit të tyre prej kësaj bote për në botët zbritëse, sipas masës së diturive që kanë dhe sipas cilësisë së krijimit të tyre të plotësuar dhe në ndjekje të pranisë së emrave, ata zbulojnë atë që është në lapsat e lartë dhe në tabelat e pastra. Nga këtu rezulton edhe ndryshimi e dallimi ndërmjet ligjeve të feve dhe profetësive, madje këtu është origjina e të gjitha dallimeve.

Në këtë pozitë, zbritja e kësaj të vërtete të panjohur dhe e këtij sekreti të pastër shihet në praninë e diturisë, në lapsat e në tabelat e larta me rrugën e mosnjohjes së vetes së tyre dhe me anën e sekretit të shpirtrave të tyre të nderuar, ata marrin njoftimet me ndërmjetësinë e engjëllit të ngarkuar për kumtimin e shpalljes, zotërisë së tij, Xhebrailit, i cili u paraqitet atyre me një “pamje shembullore”, ose u paraqitet si “engjëll” dhe me anën e të vërtetës shfaqet prej kthesave të së panjohurës në botën e dukshme dhe e zbret këtë fjalë të ëmbël e të bukur hyjnore, të cilën e kupton mbajtësi i shpalljes, të cilën ai e sheh në të gjithë zhvillimet në një mënyrë të veçantë.

Në praninë shkencore, e shikon me një mënyrë të caktuar.

Në praninë e shikimit me sy, e vështron me një mënyrë tjetër.

Në praninë e lapsave, e shikon me një mënyrë të tretë.

Në praninë e tabelave, e shikon në një mënyrë ndryshe.

Në praninë e shembullit, e shikon në një mënyrë tjetër.

Në ndijimet e përbashkëta të shqisave, e shikon në një mënyrë tjetër.



Në shikimet e pakushtëzuara, e vështron në një mënyrë tjetër.

Këto janë shtatë gradët e zbritjes. Ajo që ka ardhur nga transmetimet, në lidhje me zbritjen e Kur'anit Famëlartë mbi shtatë shkronja<sup>1</sup>, është pikërisht në këtë kuptim dhe është fare e qartë se ky pohim nuk është në kundërshtim me fjalën e të ruajturit prej gjynaheve, i cili, në lidhje me Kur'anin Famëlartë, ka thënë: "Një Kur'an nga ana e Njëshit"<sup>2</sup>. Padyshim që në këtë çështje ka shkoqitje të shumta që nuk kanë lidhje me temën që po trajtojmë.

Të shikohet se ku është kërkesa e tretë.

*Kërkesa e katërt* ka lidhje me sekretin e shkronjës "ه" - "hu" - "atë" në fjalën e ajetit "أَنْزَلْنَاهُ" - "enzelnàhu" - "Ne e zbritën atë". Kjo shkronjë në gjuhën arabe është përemër i vetës së tretë i gjinisë mashkullore.

Nga sa u tha më sipër, bëhet e qartë se Kur'ani Famëlartë, para zbritjes në këtë zhvillim, ka pozita dhe entitete:

Entiteti shkencor, në praninë e panjohur të së folurës Personale dhe krahasimit Personal me rrugën e Njëshit të shumësit. Ka të ngjarë që ky përemër i vetës së tretë të tregojë pikërisht këtë pozitë dhe të njoftojë këtë kuptim. Allahu i Lartësuar e ka përmendur foljen "enzelnà" - "Ne zbritëm" të bashkuar me përemrin "hu" - "atë" dhe kjo është sikur të thotë: Ky Kur'an i zbritur në natën e Kadrit, është i njëjti Kur'an i mbushur me dituri, që gjendet në sekretin e mbuluar e të panjohur në zhvillimin e

<sup>1</sup>Lexo "Bihàul Enuàr", vëll. 89, f. 83.

<sup>2</sup>Lexo "El-usùlu minel-Kâfi", K. "Fadlul-Kur'ani" dhe K. "En'nevàdir", Hadithi 12.



diturive. Ne e zbritën atë prej atyre gradëve, në të cilat ai ishte i bashkuar me Personin, në një pozitë të vetme, pozitë në të cilën janë shkëlqimet e emrave. Kjo e vërtetë është ajo që dihet prej këtij sekreti hyjnor. Ky libër u bë që të shihet me sy vetëm nën veshjen e shkronjave e të shprehjeve, prandaj ky libër është prej pozitës së Personit në formën e shkëlqimeve vetjake, si dhe në gradën e punës në vetë shkëlqimin e punës, ashtu siç thotë Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Padyshim që fjala e Allahut është puna e Tij*”.<sup>1</sup>

*Kërkesa e pestë:* në lidhje me shpjegimin e emërimit të natës së Kadrit me këtë emër, ka studime të shumta dhe dituri që nuk numërohen. Dijetarët e mëdhenj (*Allahu i mëshiroftë!*) kanë trokitur në këtë temë me studime e me analiza, secili sipas asaj që ka pirë nga dituria dhe sipas rrugës mbi të cilën ka ecur për te Allahu. Në vijim do të theksojmë disa prej këtyre studimeve. Gjithashtu, në kuadrin e disa kornizave, do ta vëmë theksin mbi disa çështje që nuk janë përmendur më parë.

Dijetarët kanë mendime të ndryshme në lidhje me emërtimin e kësaj nate “Nata e Kadrit”. Disa prej tyre kanë thënë se u emërtua me këtë emër, sepse ajo është një natë me rëndësi e me pozitë. Në këtë natë ka zbritur Kur’ani Famëlartë. Kjo natë është e rëndësishme e me pozitë të lartë, për faktin se është e zbritur me ndërmjetësinë e një engjëlli të një rëndësie të madhe, si dhe fakti që Xhebraili ia kumtoi Kur’anin një profeti me rëndësi të madhe. Xhebraili e zbriti Kur’anin Famëlartë për një umet të rëndësishëm.

---

<sup>1</sup>“Nehxhul Belàga”, Hytbeja 228, f. 737; Botim i “Fejdul-Islàm”.



Të tjerë kanë thënë se kjo natë u quajt “Nata e Kadrit”, për shkak se në atë natë caktohen punët e njerëzve, furnizimi i tyre dhe afati kur do të largohen nga kjo jetë.

Disa të tjerë kanë thënë se shkak i këtij emërtimi ka të bëjë me tokën që është aq e ngushtë për të gjetur vend mbi të engjëjt e shumtë që zbresin këtë natë në tokë. Ky emërtim është prej llojit të fjalës së të Lartit: “وَمَنْ قُورَ عَلَيْهِ رِزْقُهُ” - “...ue men kudire alejhi rizkühù...” - **“...sipas asaj që i ka dhënë Allahu...”**<sup>1</sup>

Këto janë fjalët e thëna në këtë pozitë dhe për çdo njëren prej këtyre fjalëve ka studime të shumta, të cilat nuk janë pa dobi, nëse do t'i shpalosnim në mënyrë të përgjithësuar.

Për sa i përket thënies së parë, rezulton se Nata e Kadrit është një natë me pozitë e me rëndësi të veçantë, prandaj mësoje se ç'është thënë në lidhje me këtë pozitë: Nëse në kohë, në përgjithësi dhe në vende në përgjithësi, gjejmë se disa njerëz janë të ndershëm dhe disa të tjerë nuk janë të ndershëm, disa janë të lumtur, disa të tjerë goditen nga fatkeqësitë, a është kjo në të njëjtën kohë prej specifikimeve vetjake të asaj kohe apo kohët e vendet kanë karakteristika kalimtare dhe punë gjatë të cilave ndodhin aksidente, por njëkohësisht në ato kohë e në ato vende ndodhin edhe punët e ndershme, edhe punët e poshtra?!

Kjo temë, edhe pse nuk është prej studimeve të rëndësishme, ose prej studimeve jetësore, ne do të bëjmë një shpalosje të shkurtër të kësaj teme:

---

<sup>1</sup>Sure “Et Talàk”, ajeti 7.



Ana nga anon më shumë peshorja, në mundësinë e parë, është se e jashtëmja e transmetimeve dhe e ajeteve që flasin për ndershmërinë ose fatkeqësinë e kohës e të vendit, tregojnë se kjo gjendje konsiderohet cilësi e atyre kohëve dhe e vendeve dhe jo cilësi e gjendjes që ka lidhje me kohët e vendet dhe, përderisa nuk ka asnjë pengesë logjike, patjetër që ata duhet të merren ashtu siç kanë ardhur në transmetime e në ajetet e Kur'anit Famëlartë.

Për sa i përket animit kah mundësia e dytë, është fakt që e vërteta e kohës dhe e vendit është një. Gjithashtu, një është edhe personaliteti i të dyjave (kohës dhe vendit), prandaj është e pamundur që për vetëm një person të ketë një dispozitë të pjesëtuar dhe të ndryshme. Bazuar mbi këtë arsytim, rezulton se s'ka përse t'i largohemi faktit, prandaj ta marrim atë të plotë, ashtu siç thuhet në tekstet, në lidhje me nderimin e fatkeqësinë, në të gjitha ndodhitë e problemet që u bashkëngjiten atyre.

Ky përfundim nuk është i saktë, sepse koha, edhe nëse është me personalitet të vetëm, shkallëzohet e shtrihet. Kjo është një e vërtetë sasiore, prandaj s'ka asnjë pengesë, që disa pjesë të kohës të mos jenë të ndryshme nga njëra-tjetra në gjykim dhe në ndikim. Gjithashtu, nuk është argument që ndalon që edhe për një person të vetëm - sido që të jetë ai - të mos ketë dy gjykime dhe dy ndikime, madje ajo që shikohet, është e kundërta e kësaj. Për shembull, individët e species njerëzore, pavarësisht se të gjithë kanë të përbashkët qenien e tyre një person i vetëm, përsëri në mes tyre ka ndryshime të shumta në formën e tyre trupore. Gjithashtu, shikojmë se membrana e syrit dhe zemra janë më të larta e më buta se të gjitha gjymtyrët e tjera. Po kështu është gjendja edhe me fuqitë e brendshme dhe të jashtme. Disa prej fuqive janë më të larta se disa të tjera dhe shkak i këtij ndryshimi është se njeriu nuk del në këtë



botë me një cilësi të vetme e të plotë, pavarësisht se është vetëm një person. Në të kundërt, njeriu del me cilësi të shumta dhe, për rrjedhojë, patjetër që edhe dispozitat për ato cilësi, duhet të jenë të ndryshme.

Për sa i përket animit kah mundësia e parë, themi se edhe kjo, gjithashtu, nuk është e lejueshme, për faktin se ajo fjalë është “origjina e shfaqjes” dhe “origjina e të vërtetës”. Për shembull, prej shkencës së bazave mësohet ndarja në origjinalitetin e të vërtetës dhe në origjinalitetin e dukjes. Në të vërtetë, me këtë ndarje synohet caktimi i qëllimit në vendet e dyshimit në atë send. Këtu s’ka vërtetim të së vërtetës, pasi qëllimi bëhet i ditur. Mendo!

Atëherë, të dy justifikimet janë të mundshme, megjithëse justifikimi i dytë duket se ka më shumë peshë se i pari. Bazuar mbi këtë shpjegim, Nata e Kadrit është bërë e rëndësishme, sepse ajo është nata e arritjes së Kur’anit Famëlartë me Vulën e profetëve. Gjithashtu, është nata e arritjes së të dashuruarit të vërtetë të i Dashuri i tij. Në studimet e mëparshme është shpjeguar qartë se zbritja e engjëjve dhe zbritja e shpalljes ka ndodhur pas arritjes së asgjësimit dhe afrimit të vërtetë.

Gjithashtu, prej transmetimeve të shumta dhe prej ajeteve kur’anore mësohet se nderimi i kohëve e i vendeve dhe e keqja e tyre, në të vërtetë, është për shkak të ngjarjeve që ndodhin dhe kjo mësohet fare qartë nëpërmjet leximit të haditheve, edhe pse disa prej transmetimeve e kushtëzojnë nderimin personal në disa kohë e në disa vende.

Për sa i përket çështjes së një mundësie tjetër, kjo mundësi shpjegon pohimin, që emërtimi kthehet në caktimin e punëve të



ditëve të atij viti, prandaj mëso se e vërteta e “vendimit” dhe e “caktimit”, si dhe gradët e këtyre dy të fundit, numërohen prej diturive hyjnore më të nderuara. Në transmetime ka ardhur ndalimi për masën e njerëzve, që të thellohen në çështjen e vendimit (kadà) dhe të caktimit (kader), për shkak se janë çështje tepër të hollësishme. Gjithashtu, edhe për shkak të ndijimeve të plotësuara të tyre. Pikërisht ky fakt, shkakton hutim dhe shkarje në rrugën e gabuar. Bazuar mbi këtë shpjegim, duhet vënë në konsideratë se kjo e vërtetë është prej sekreteve të ligjit të fesë dhe depozitave të profetësisë. Për të gjitha këto duhet qëndruar larg studimit të hollësishëm të vendimit e të caktimit.

Këtu do të përqipemi të vëmë theksin mbi njërin prej studimeve që kanë lidhje me vendimin e me caktimin. Natyrisht që studimi do të jetë në përshtatje me temën që po trajtojmë. Themi, se, meqenëse caktimi i punëve është plotësuar në diturinë e të Vërtetit të Lartësuar që në përhershmërinë e përjetshme dhe, meqenëse pozita e diturisë së Sistemuesit është e pastër prej punëve të shkallëzuara, atëherë shtrohet pyetja: Ç’kuptim ka caktimi i punëve për çdo vit dhe në një natë të caktuar?

Mëso se për vendimin e për caktimin ka gradë e dispozita, të cilat, gjithashtu, janë të ndryshme sipas atyre gradëve të zhvillimeve:

Grada e parë e vendimit është grada e të vërtetave, të cilat caktohen në praninë e diturisë, me shkëlqimin e bujarisë më të pastër. Kjo, në ndjekje të shfaqjes së emrave e cilësive. Pastaj ato caktohen e saktësohen në lapsat e në tabelat e larta, sipas shfaqjes në shkëlqimin e punëve, prandaj në këto gradë nuk ndodhin as ndryshime e shndërrime, pasi vendimi përfundimtar nuk i





ndryshon e nuk shndërron të vërtetat e zhveshura që gjenden në punët që shihen me sy dhe zhvillimeve shkencore të zbritura në lapsat e në tabelat e zhveshura.

Pas kësaj vjen “përfytyrimi i shkoqitur” dhe “përfytyrimi i përgjithshëm”, që filozofët iluministë e quajnë “bota e shembullit të varur”. Gjithashtu, ata thonë se në këtë botë ndryshimet e shndërrimet ndodhin te të vërtetat, madje patjetër duhet të ndodhin.

Pas kësaj vijnë caktimet e llogaritë, që janë nën administrimin e engjëjve të ngarkuar me botën e natyrës, prandaj për kaderin në këtë tabelë ka shndërrime të përhershme dhe ndryshime të vazhdueshme, madje ato shprehin një figurë rrjedhëse dhe një të vërtetë të përpiktë dhe të shkallëzuar. Të vërtetat në këtë tabelë janë të ekspozuara ndaj fuqisë dhe dobësisë, lëvizjeve të shpejta e të ngadalta dhe shtimit e pakësimit.

Megjithëkëtë, ana hyjnore e ana e panjohur e vetë sendeve, janë ana e lëshimit drejt të Vërtetit dhe formës së shfaqjes së bujarisë së shtuar në shesh e të hijes së zgjatur. Kjo është e vërteta e diturisë së punëve të të Vërtetit të Lartësuar, punë e cila patjetër është dituri e palëvizshme. Për më tepër, në këtë dituri kurrë s’ka vend që të ndodhin ndryshime e shndërrime.

Esenca e fjalës është: filozofët besojnë se të gjitha ndryshimet e shndërrimet, shtimi i jetëve dhe caktimi i furnizimeve gjenden në tabelën e “caktimit shkencor”, që është “bota e shembullit”. Unë mendoj se caktimi ndodh në tabelën e “caktimit esencial”, i cili përfaqëson një vend për të njëjtat caktime, edhe nëse në atë vend ndodhin ndryshime e shndërrime me dorën e engjëjve të ngarkuar.



Bazuar në këtë që u tha më sipër, rezulton se nuk ka pengesë që të ndodhin ndryshime e shndërrime në botën e natyrës edhe në vetë Natën e Kadrit, e cila është nata e orientimit të plotë kah Ndihmuesi i plotësuar dhe shfaqja e pushtetit të Tij, me anën e shpirtit të nderuar të kujdestarit të plotësuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Nëse ata duan, pjesët me lëvizje të ngadalta i bëjnë të lëvizin me shpejtësi, ose zgjerojnë çdo furnizim që dëshirojnë, ose e ngushtojnë atë furnizim që ata duan. Ky vullnet është vullneti i të Vërtetit, është hija e rrezja e vullnetit të përjetshëm dhe në ndjekje të urdhrave hyjnorë. Kështu është gjendja edhe me engjëjt, të cilët kurrë nuk veprojnë nga vetja e tyre, pasi të gjitha veprimet e tyre dhe të gjitha veprimet e grimcave të gjithësisë, të gjitha janë veprime hyjnore, janë prej fjalës së ëmbël hyjnore të padukshme: "فَأَسْتَقِيمُ كَمَا أُمِرْتُ" - "festekim kemà umirte" - "**Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar**".<sup>1</sup>

Për sa i përket mundësisë tjetër të emërtimit të Natës së Kadrit, mund të themi se niset nga dendësia e engjëjve të Allahut, që zbresin mbi tokë në atë natë. Kjo anë, edhe pse duket larg, i emërtuari, çudia e kohës, Halili prej Ahmedit (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!*)<sup>2</sup>, thotë: "Kjo çështje ka mundësi të ndikojë si pyetja vijuese:

---

<sup>1</sup>Sure "Hùd", ajeti 112.

<sup>2</sup>Ky është Halil bin Ahmed bin Umer bin Temimi, i quajtur Ebu Abdurrahman El Bâhilij El Basrij En'nahvij El Arudij. Nuk ka një vit të saktë lindjeje dhe vdekjeje. Ka lindur në Basra, ose në vitin 100, ose në vitin 105 hixhri dhe ka vdekur ose në vitin 160, ose në vitin 170 hixhri. Letrar dhe gjuhëtar i njohur, themeluesi i metrikës dhe imam i medh'hebit. Thuhet se ishte prej shokëve të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe njëri prej përcjellësve të haditheve të tij. Ka shkruar vepra të shumta në fusha të ndryshme të diturisë, prej të cilave përmendim: "Zibdetul-Urùd", "El-Ajnu", "Kitàbun fil-imàmeh", "El-Ijkàu", "En'niamu", "El-



Ç'kuptim ka ngushtica e tokës, kur engjëjt e Allahut nuk janë prej krijesave të botës së natyrës dhe nuk janë materie si materiet e tokës?!“

Por duhet të dish se të ngjashme me këtë punë kanë ardhur në hadithet e nderuara, siç është problemi i orientimit të Sad bin Muadhrit, në mbështetje të një personi<sup>1</sup>, ose si çështja e shtrirjes së krahëve të engjëjve për kërkuesin e diturisë.<sup>2</sup>

Kjo ose është prej kapitullit të përshkrimit të engjëjve me formë, si shembull dhe zbritjen e tyre prej botës së panjohur në botën e shembullit, si dhe ngushtimin e mbretërive të tokës, ose është nga kapitulli i përfaqësimit të tyre engjëllor në mbretërinë e tokës, edhe pse këtë përfaqësim nuk e shikojnë sytë kafshërorë të natyrës.

*Çështja e dytë* ka të bëjë me të vërtetën e Natës së Kadrit.

Dije se për çdo imtësi ka një të vërtetë dhe për çdo pamje ka një mbretëri të brendshme cilësore të padukshme. Ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se gradët zbritëse të së vërtetës së ekzistencës – në bazë të mbulimit të diellit të së vërtetës në horizontin e cilësive – janë “netët” dhe, për sa u përket gradëve të ngjitjes lart – në bazë të daljes së diellit të së vërtetës prej horizonteve të cilësive, janë “ditët”.

---

Xhemelu”, “Esh’shevâhidu”, “En’nukatu uesh’sheklu”, një libër i veçantë rreth “kuptimit të emrave e shkronjave”. Lexo librin “Ajànu-Sh’shijah”, vëll. 30, f. 5.

<sup>1</sup> Lexo “El furû’u minel-Kâfi”, Libri “El-Xhenâiz”, K. “Pyetja në varr”, Hadithi 6.

<sup>2</sup>Lexo “Meàlimul-Usûl”, f. 7.



Me këtë bëhet shumë i qartë kuptimi i nderimit e i fatkeqësive të “ditëve” e të “netëve”. Bazuar në konsideratën se kurba zbritëse është “Nata e Kadrit e Muhamedit” dhe kurba e ngjitjes në lartësi është “Dita e Kiametit e Ahmedit”, të dyja këto kurba janë zgjatje e bujarisë së gjerë, e cila është e vërteta e Muhamedit. Të gjitha cilësitë janë prej emërimit të parë të emrit më të madh, atëherë bota – e shikuar nga këndvështrimi i unitetit – është Nata e Kadrit dhe Dita e Kiametit, por që nuk numërohen natë e ditë, pasi të dyja janë Nata e Kadrit e Muhamedit, e cila përfaqëson plotësisht shtëpinë e vërtetimit dhe Ditën e Kiametit të Ahmedit.

Ai që realizohet me këtë të vërtetë, gjithmonë është në “Natën e Kadrit” dhe në “Ditën e Kiametit”, të cilat, që të dyja, janë të mbledhura së bashku.

Nëse e shohim botën nga këndvështrimi i shumicës, atëherë do të jenë netët e ditët dhe disa net do të jenë të rëndësishme, kurse disa net të tjera nuk do të jenë të rëndësishme. Në mes të gjitha netëve strukturuese të Ahmedit dhe të emërimit të Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), i cili është drita e të vërtetës së ekzistencës me të gjitha punët, emrat e cilësitë. Ajo natë perëndoi në horizontin e tyre me plotësimin e dritës dhe të vërtetës, ajo është Nata e Kadrit, nata absolute, ashtu siç është edhe Dita e Kiametit, dita absolute e Ahmedit.

Për sa u përket netëve e ditëve të tjera, ato janë net e dit të kushtëzuara, kurse zbritja e Kur’anit Famëlartë në këtë formësim të nderuar dhe në këtë zemër të pastër, është në Natën e Kadrit.



Shehu e dijetari njohës Shah Abadij (*Allahu e mëshiroftë!*) ka thënë: “Rrethi i Muhamedit është Nata e Kadrit”. Kjo thënie ka arritur në këtë formë, ose duke marrë në konsideratë se të gjitha rrathët e ekzistencës janë rrathët e Muhamedit, ose duke marrë në konsideratë personalitetet e plotësuara, ndjekës të Muhamedit, si dhe imamët e ruajtur prej gjynaheve, udhëzues në rrugën e drejtë. Në këtë rreth ata janë “Netët e Kadrit”.

*Çështja e tretë:* Mëso se për Natën e Kadrit ka një të vërtetë të jashtme dhe një të brendshme. Më sipër i kemi theksuar këto dy të vërteta, por Nata e Kadrit, në botën e natyrës, ka edhe një formë e një pamje, madje ka disa pamje.

Meqenëse në të jashtmet është e mundur të ketë diferenca në pakësimin e në plotësimin, gjithashtu, është e mundur edhe mbledhja në mes thënieve e njoftimeve të ardhura në lidhje me caktimin e Natës së Kadrit. Në të vërtetë, ky bashkim realizohet në saje të thënies se të gjitha netët e nderuara, të përmendura në transmetimet e ardhura, të gjitha janë prej dukurive të Natës së Kadrit, por ato ndryshojnë nga njëra-tjetra, nga ana e nderimit dhe e plotësimit të dukjes, pasi nata që përfaqëson dukjen e plotë, është vetëm Nata e Kadrit. Ajo është nata e vijimit përfundimtar, të plotë dhe e arritjes të i Plotësuari Vulë, Ajo natë është e fshehur në të gjitha netët e vitit, ose në netët e muajit të bekuar Ramazan, ose në netët e dhjetëditëshit të fundit të muajit Ramazan, ose në tri netët e fundit të këtij muaji.

Ndryshimi gjendet në transmetimet e përgjithshme dhe në transmetimet e veçanta. Në transmetimet e veçanta tregohet se Nata e Kadrit mund të jetë në natën e nëntëmbëdhjetë, njëzet e një dhe njëzet e tri të muajit të bekuar Ramazan.



Shihab bin Abd Rab'beh ka thënë: "I kërkova Ebu Abdullahut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) të më tregojë se kur është Nata e Kadrit. Ai tha: 'Ajo është nata njëzet e një, ose nata njëzet e tre'".<sup>1</sup>

Abdul-Vahid bin El-Mukhtâr El-Ensari ka pyetur Ebu Xhaferrin për Natën e Kadrit dhe ai është përgjigjur: "Ajo është në dy netët njëzet e një dhe njëzet e tri". Kur i ka kërkuar se në cilën prej këtyre netëve, ai është përgjigjur: "Ç'të rëndon ty, nëse do të punosh në dy net, njëra prej të cilave është ajo?!"<sup>2</sup>

Hasan bin ebu Aliu ka pyetur Ebu Abdullahun, se kur është Nata e Kadrit. Ebu Abdullahu i është përgjigjur: "Kërkoje atë në netët: nëntëmbëdhjetë, njëzet e një dhe njëzet e tri".<sup>3</sup>

Zotëria i nderuar, adhuresi e i përkori Ibn Taus, në librin "El-Ikbâl", ka thënë: "Dije se ajo është në natën e njëzetetretë të muajit të bekuar Ramazan".

Për këtë kanë ardhur njoftime të qarta, që tregojnë se ajo natë është Nata e Kadrit. Kjo çështje është studiuar e është shpjeguar qartë në transmetime. Prej këtyre transmetimeve, me varg përcjellësish, që shkojnë deri te Sufjan bin Esebti, lexojmë: "I kërkova Ebu Abdullahut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) të ma veçojë se cila natë është Nata e Kadrit. Ai tha: 'Ajo është nata e njëzet e tre'".

Prej këtyre njoftimeve është edhe hadithi që kemi sjellë më sipër, me përcjellës që shkojnë deri te Zerareh, prej Abdul-Vahid bin El-Mukhtar El-Ensari, i cili tregon: "E pyeta Ebu Xhaferrin

---

<sup>1</sup>"Muxhmeul Bejân", vëll. 10, f. 519; "Nûru-Th' thekalejn", vëll. 5, shpjegimi i sures "El Kadr", Hadithi 17, f. 628.

<sup>2</sup>"Biârul Enuâr", vëll. 95, f. 149.

<sup>3</sup>Muxhmeul Bejân", vëll. 10, Libri "Es'seumu", K. 32, Hadithi 21, f. 519.



(Paqja qoftë mbi të!) për Natën e Kadrit dhe ai tha: *'Pasha Allahun! Unë ty të njoftoj, që të mos mbetesh në errësirë për këtë. Ajo është nata e parë e shtatë ditëve të fundit'*.<sup>1</sup> Më pas tregohet prej Zerarehit se ai muaj ishte me njëzet e nëntë ditë.

Në disa transmetime të tjera thuhet se Nata e Kadrit është nata e njëzetetretë. Prej këtyre transmetimeve është edhe transmetimi që njihet me emrin "Çështja El-Xhuhenij"<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup>"Ikbâlul-Amâl", f. 206.

<sup>2</sup>Burimi i mësipërm, f. 207.



## Vërejtje gnostike

Është shumë e qartë, ashtu siç u tha në hadithin e mëparshëm, në lidhje me interpretimin e dy sureve të bekuara të mëparshme se, edhe pse “Bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm” thuhet në çdo sure, çdo sure ka lidhje me suren përkatëse.

Bazuar mbi këtë shpjegim, po japim kuptimin e ajeteve të sures së bekuar “El Kadr”: Ne e zbritëm të vërtetën e Kur’anit Famëlartë, këtë fjalë të bukur hyjnore, të pastër, me emrin e Allahut, i Cili është e vërteta e sintezës së emrave dhe emri më i madh i Sistemuesit, i cilësuar me mëshirën absolute gjithëpërfshirëse dhe me mëshirën e plotë në Natën e Kadrit të Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Kjo do të thotë se shfaqja e Kur’anit ndjek dukjen e përgjithshme të Zotit krijues dhe mbajtjen e shtrirjen e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe të mëshirës së plotë. Veç kësaj, e vërteta e Kur’anit është pozita e shfaqjes së emrit më të madh të Allahut, me shfaqjen e mëshirës gjithëpërfshirëse e të mëshirës së plotë dhe bashkuesi i shumësit dhe i shkoqitjes së detajuar. Për të gjitha këto, ky Libër Famëlartë është Kur’an. Gjithashtu, ky Libër është “Furkân” (ndarës), ashtu si shpirti i të Dërguarit të fundit dhe pozita e pastër e kujdestarisë së këtij zotërie. Këto dy pozita janë “Kur’an” e “Furkan” dhe pozita e Njëshit të shumësit dhe e shkoqitjes së detajuar.





Sipas kësaj mundësie, duket sikur i Vërteti i Lartësuar thotë se Ne e zbritëm Kur'anin në Natën e Kadrit të Muhamedit, me shkëlqimin e pozitës së emrit më të madh. Kjo është pozita e Njëshit të shumësit dhe shkoqitjes së detajuar me shfaqjen e “mëshirës gjithëpërfshirëse” dhe të “mëshirës së plotë”.

Meqenëse këtu jemi në botën e dallimit, madje në botën e dallimit të dallimeve, kjo ndarje, e cila arrihet në mes “dy Kur'aneve”, Kur'anit të shkruar, i zbritur dhe Kur'anit që iu zbrit atij, domethënë, Librit hyjnor dhe të vërtetës së Muhamedit. Ne kemi arritur në natën e lidhjes ndërmjet “dy Kur'aneve” dhe ne i kemi bashkuar ato.

Me këtë konsideratë, kjo natë është “Nata e Kadrit”, por rëndësia e saj është në një formë, të cilën nuk e njeh askush përveç zotërisë, Vulë e profetëve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili në origjinë, është “pronari” i Natës së Kadrit dhe, në ndjekje të tij, të porositurit e ruajtur prej gjynaheve.



## Plotësim

*Disa transmetime, që flasin për mirësinë e Natës së Kadrit*

Njohësi i Allahut, Esejid bin Taus (*Allahu e mëshiroftë!*) në librin e tij “El-Ikbal” thotë: “Në librin “Kenzul-Jevàkij” gjeta një shkrim të Ebu El Fadl bin Muhamed El Herevijit, në të cilin ai sjell njoftime në lidhje me mirësinë e Natës së Kadrit. Kanë përcjellë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

- O Zoti im, dua të jem afër Teje! - iu drejtua Musai Allahut.
- Afrimi te Unë është për atë që zgjohet në Natën e Kadrit, - iu përgjigj Allahu.
- O Zoti im, dua mëshirën Tënde! - iu lut Musai.
- Mëshira Ime është për atë që mëshiron të mjeruarit në Natën e Kadrit, - iu përgjigj Allahu.
- O Zoti im, dua kalimin mbi urën e Siratit!
- Kjo është për atë që beson në Natën e Kadrit.
- Dua prej pemëve e frutave të Xhenetit!
- Kjo është për atë që ka thënë një herë “Subhànell’lilàh!” në Natën e Kadrit.
- O Zoti im, dua shpëtimin!



- Shpëtimin prej zjarrit?
- Po.
- Kjo është për atë që kërkon faljen e gjynaheve në Natën e Kadrit.
- O Zoti im, dua kënaqësinë Tëndë!
- Kënaqësia Ime është për atë që fal dy rekate namaz në Natën e Kadrit.

Gjithashtu, në librin e sipërpërmendur, lexojmë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Në Natën e Kadrit hapen portat e qiellit dhe s’ka ndonjë rob që fal namaz në atë natë dhe Allahu i Lartësuar të mos shkruajë për të, për çdo sexhde, një pemë në Xhenet, hijen e të cilës ai nuk do ta përshkonte dot, edhe sikur të ecte kaluar njëqind vjet. Për çdo rekat namaz që ai fal, Allahu ndërton për të në Xhenet një shtëpi të zbukuruar me perla e me gurë të çmuar; për çdo ajet që ai këndon, i vë atij një kurorë prej kurorave të Xhenetit; për çdo ‘subhànell’Ilàh’, që ai thotë, i jep atij një shpend mahnitës; për çdo qëndrim që ai bën, i jep atij një gradë prej gradëve të Xhenetit; për çdo “Et’tehij’jàtu” që ai këndon, i jep një dhomë prej dhomave të Xhenetit; për çdo “Selam”, i jep atij një rrobë prej rrobave të Xhenetit dhe, kur shpërthen kolona e mëngjesit, Allahu i Lartësuar i jep atij vajza të bukura, shërbyes të përherëshëm, kasnecë fluturues, parfumues që e parfumojnë atë, lumenj që rrjedhin, i jep mirësitë e ardhura nga fitimi i kënaqësisë, i jep gjëra të rralla, dhurata, veshje e nderime që i dëshiron shpirti, që i kënaqin syrin dhe ai është përgjithmonë në ato mirësi”.

Gjithashtu, në po këtë libër, lexojmë fjalën e Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kush e kalon Natën e Kadrit me adhurim, Allahu i



*fal atij mëkatet, edhe sikur ato të jenë sa numri yjeve të qiellit, edhe sikur të peshojnë sa malet dhe të jenë sa uji i deteve”.<sup>1</sup>*

Njoftimet në lidhje me mirësinë e Natës së Kadrit janë më shumë nga sa mund të shkruhet në këto faqe.

**Fjala e Allahut të Lartësuar:** “وَمَا أُدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ” – “*Ue mà edràke mà lejletul kadri*” – “**Ë kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Nata e Kadrit?**”

Dije se ky është kompozim për madhërimin e kërkesës e për pompozitetin e saj, si dhe deklarimi për madhështinë e të vërtetës së shtruar, në mënyrë të veçantë, kur vihet në konsideratë pozita e folësit dhe e bashkëbiseduesit.

Meqenëse këtu folësi është i Vërteti i Lartësuar dhe bashkëbiseduesi është i Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ndodh që ndonjëherë çështja është në një gradë të madhështisë në atë mënyrë sa është e vështirë që ajo të shprehet në endjen e fjalëve dhe në kompozimin e shkronjave e të fjalive, prandaj në këtë ajet të nderuar është sikur i Vërteti i Lartësuar thotë: “Ti nuk e di sa e madhe është e vërteta e Natës së Kadrit! Në fakt, e vërteta e kësaj nate është e pamundur të

---

<sup>1</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 89, f. 168.



shpjegohet, pasi për këtë shpjegim nuk mjafton as renditja e shkronjave, as ujdisha e fjalëve dhe as vënia e fjalëve në vargje”.

Për të gjitha këto, ti shikon se, edhe pse në ajet është fjala “ما”- “mà” - “ç’të”, e cila shpjegon të vërtetën, ajeti nuk futet fare në shpjegim, prandaj Allahu i Lartësuar thotë: “كَيْلَاءُ الْقَدْرِ حَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ” - “Lejletul kadri khajrun min elfi shehrin” - **“Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj”**, prandaj ti mësoje atë me të veçantat e me ndikimet e saj, që të kërkosh ndjesë për shpjegimin e të vërtetës.

Nga këtu është e mundur të hamendësohet fuqishëm se e vërteta e Natës së Kadrit dhe e brendshmja e saj, nuk është kjo formë e kjo dukuri e jashtme, edhe pse dukuria e jashtme, gjithashtu, është shumë e rëndësishme, por nuk zëvendëson lidhjen me të Dërguarin e Allahut, i cili është kujdestari absolut dhe ka dijeni për të gjitha botët, prandaj ajeti është shprehur në këtë mënyrë.

Nëse ti thua: mundësia e lartpërmendur - e brendshmja e Natës së Kadrit është e vërteta dhe formësimi i vetë të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në të cilën mbulohet dielli i të vërtetës, me të gjitha punët që kanë lidhje me të vërtetën - kjo vështirëson edhe më shumë çështjen, pasi nuk mund t’i thuhet të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se ti nuk e di se si është Nata e Kadrit, sepse ajo është fytyra jote engjëllore.

Unë them: Në këtë mundësi ka një sekret, pasi edhe për fjalën e këndshme vijuese ka një të brendshme:



“لَمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ” – “...limen kàne lehù kalbun eu elka s’sem’a ue huve shehijdun” – “këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon”.<sup>1</sup>

I nderuar, mëso se në të brendshmen e të vërtetës së Natës së Kadrit – e cila është figura engjëlllore dhe syri vëzhgues i Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka një shfaqje të emrit më të madh e shkëlqim hyjnor të Njëshit të shumësit dhe robit që ka marrë rrugën për te Allahu, domethënë, se ky rob është i Dërguari, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por, përderisa ai është në mbulesën e vetes së tij, s’ka mundësi ta shikojë këtë të brendshme dhe këtë të vërtetë, ashtu siç ishte gjendja edhe për Musa bin Imranin (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), gjendje për të cilën njofton Kur’ani Famëlartë: “لَنْ يَرَانِي” – “...len terànij...” – “**Ti nuk mund të më shohësh!**”<sup>2</sup>, pavarësisht se shkëlqimi është vetjak, ose është shkëlqimi i cilësive. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: “فَلَمَّا تَجَلَّى رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكًّا وَخَرَّ مُوسَى صُوعًا” – “...felem’mà texhel’lâ lilxhebeli xhealehù dek’ken ue harr’rre Mùsà saikan...” – “**E kur Zoti i tij iu shfaq malit, e thërrmoi atë dhe e bëri pluhur, ndërsa Musait i ra të fikët**”<sup>3</sup>.

Gjithashtu, argument për këtë janë edhe pjesë prej lutjes madhore “Es’simàt”.

Kuptimi i sekretit në këtë tregim është: O Musa, nuk mund të më shohësh, përderisa je nën mbulesën e Musait, përderisa je nën mbulesën e vetes tënde, pasi shikimi i bukurisë së më të Bukurit,

<sup>1</sup> Sure “Kàf”, ajeti 37.

<sup>2</sup> - <sup>3</sup> Sure “El Aràf”, ajeti 143.



realizohet vetëm për atë që ka dalë jashtë vetes së tij dhe vetëm atëherë kur ai del jashtë vetes, ka mundësi të shohë me syrin e të Vërtetit. Pastaj shumë shpejt, për atë, syri i të Vërtetit, do të jetë shikim për të Vërtetin.

Bazuar mbi këtë shpjegim, shfaqja e emrit më të madh – që është figura e plotësuar e Natës së Kadrit – duhet të dihet mirë se nuk është e mundur shikimi i Tij krahas mbulimit me vetveten, prandaj mbështetur mbi këtë saktësim, kjo shprehje është e vërtetë në vendin e vet.

Ti thua se Nata e Kadrit është i njëjti konstrukt i Ahmedit, duke vënë në konsideratë mbulimin e diellit të së vërtetës, por nuk është në vetë diellin që ky interpretim të jetë i drejtë.

Unë kam thënë se, që një send të jetë send, është e mundur – ashtu siç thonë ata që dinë të shikojnë në fytyrën e plotë të atij sendi, pasi sendet kanë edhe shkaqe, në mënyrë të veçantë, shkakun hyjnor. Por, një e vërtetë e tillë njihet vetëm duke njohur shkaqet e saj. Gjithashtu, edhe ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë se lidhja mes të jashtmes e të brendshmes dhe mes shkëlqimit e të shkëlqyerit, nuk është lidhje mes dy punëve të ndryshme, por është një e vërtetë e vetme, e cila herë shkëlqen jashtë, herë shkëlqen brenda, ashtu siç thotë dijetari i njohur: “Ne jemi hiç pa dukurinë e ekzistencës... Ti je ekzistenca dhe Ti je ekzistenca jonë”.<sup>1</sup>

Kjo bisedë, ashtu siç thotë dijetari shpirtëror, nuk ka fund, prandaj është më mirë që të mos shikojmë fare në këtë çështje.

---

<sup>1</sup>Përkthim i një fraze prej një vargu të poezisë së poetit të njohur iranian Xhelaludin Rumi.



**Fjala e Allahut të Lartësuar:** “لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ” – “*Lejletul -Kadri khajrun min elfi shehrin*” – “**Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj**”.

Tani që pamë fytyrën e jashtme engjëllore të Natës së Kadrit, mund të themi kuptimin e ajetit: Nata e Kadrit është me më shumë mirësi se një mijë muaj, në të cilat nuk ka natë Kadri, ose adhurimi dhe bindja që bëhen në Natën e Kadrit, janë më të vlerësuara se adhurimi e bindja të bëra gjatë një mijë muajve; edhe Beni Israilët ngjishnin armët në këtë natë, ku luftonin në rrugën e Allahut.

Kur shikohet me kujdes në të vërtetën e Natës së Kadrit, ka mundësi që togfjalëshi “një mijë muaj” nënkupton të gjitha qeniet, duke pasur parasysh se numri një mijë është numër i plotë dhe qëllimi i përdorimit të shprehjes “fama e llojeve”, ka mundësi të jetë në kuptimin: formimi i Muhamedit - njeriu më i plotësuar – është më i mirë se një mijë lloje dhe, llojet janë të gjitha qeniet, ashtu siç thonë ata që kanë arritur gradën e njohjes për këtë çështje.

Në mendje më kalon edhe një mundësi tjetër që ka të bëjë me faktin se Nata e Kadrit është treguese për emrin më të madh, domethënë se kjo natë tregon pasqyrimin e plotë të Muhamedit, kurse një muaj shpreh shfaqjen e emrave të tjerë.

Meqenëse për të Vërtetin e Lartësuar ka një mijë e një emra unikë në botën e panjohur, kjo do të thotë se edhe Nata e Kadrit, gjithashtu, është unike. Por Nata e Kadrit është struktura e Muhamedit, që, gjithashtu, është një emër unik, prandaj për emrin më të madh, unik, s’ka dijeni askush, përveç personit të uruar të të Dërguarit të Allahut, vula e të gjithë profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi atë e mbi familjen e tij!*).





## Vërejtje njohëse

Mëso se kujdestari i plotësuar, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi atë e mbi familjen e tij!*) është “Nata e Kadrit”, duke vënë në konsideratë të brendshmet e emrit më të madh dhe mbulimin e të Vërtetit me të gjitha punët. Gjithashtu, Nata e Kadrit, duke shikuar shfaqjen e diellit të së vërtetës dhe daljen në shesh të emrit përgjithësues prej horizonteve të cilësive të tij, pikërisht për këtë, ky Profet i nderuar qëndron mbi të tjerët.

Në përgjithësi, ky personalitet i pastër është nata dhe dita e Kadrit, ashtu siç është edhe Dita e Kiametit dhe dita e Kadrit.

Nisur nga ky shpjegim, ka shumë mundësi që sekretit të jetë shpjegimi i të gjitha dukurive me muajin. Gjithashtu, nisur prej kësaj dukurie të plotë e të pastër, është e mundur që ky sekret të shpjegohet me natën, sepse fillimi i muajve e i viteve është dita e nata. Ashtu siç fillojnë numrat me “njëshin”, po kështu edhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e brendshmja e të vërtetës, e përfaqësuar në emrin më të madh, i cili është fillimi i të gjithë emrave të tjerë. Gjithashtu, ai, me cilësinë e tij dhe me syrin e tij të qëndrueshëm, përfaqëson origjinën e pemës së mirë dhe fillimin e cilësive.

Mendo, mëso dhe fito!



**Fjala e Allahut të Lartësuar:** “تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ” – “*tetenez zelul melàiketü uerr rrùhu fijhà bi'idhni rab'bihim min kul'li emrin*” – **“Engjëjt dhe shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet”**

Në këtë ajet të nderuar ka disa kërkesa, por ne do të përmendim vetëm disa dhe në mënyrë të përmbledhur:

*E para:* Përmendja e kategorive të engjëjve të Allahut të Lartësuar dhe shpjegimi i të vërtetës së engjëjve në përgjithësi.

Mëso se në mesin e dijetarëve të fushës së hadithit dhe studiuesve ka mendime të ndryshme në lidhje me trupëzimin e engjëjve. Të gjithë të urtët, studiuesit dhe shumë prej studiuesve të fushës së jurisprudencës islame janë shprehur se engjëjt s'kanë trup, ashtu siç nuk ka trup as shpirti folës. Për këtë pohim të tyre ata sjellin argumente të fuqishme. Përveç kësaj, mospasja trup për engjëjt mësohet prej ajeteve të Kur'anit Famëlartë dhe prej haditheve të nderuara.

Dijetari i madh në fushën e hadithit, zotëri Muhamed Teki El-Mexhlisi (babai i të ndjerit, të nderuarit Muhamed Bakir El-Mexhlisit, autor i librit “El-Bihàru”), në shpjegimin e tij për librin “Men là jahdurhul-fekijhu” dhe në fundin e disa transmetimeve, thotë se ato tregojnë që shpirti folës nuk ka trup.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Lexo librin “Reudatul-Mut'tekijne”, vëll. 1, f. 492.



Por disa dijetarë të mëdhenj në fushën e hadithit janë shprehur se engjëjt kanë trup. Fakti që ata sjellin si argument, është thënia e tyre se mospasja trup është në kundërshtim me ligjin e fesë. Pastaj shtojnë se pa trup është vetëm Personi i dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, i Vërteti i Lartësuar. Padyshim që mendimi i tyre është shumë i dobët. Pavarësisht kësaj, ata e mbështesin mendimin e tyre në dy çështje:

*Çështja e parë:* Problemi kohor i zhvillimit të botës. Ata shprehen se të thuhet për një qenie se ajo s'ka trup, është në kontradiktë me atë qenie.

*Çështja e dytë:* I Vërteti i Lartësuar është veprues e përzgjedhës i punës. Ata pandehin se kjo është në kundërshtim me mospasjen trup të botës së mendjes dhe të botës së engjëjve të Allahut.

Të dyja këto çështje janë studiuar në dituritë e larta dhe ky studim ka çuar në vërtetimin e mospasjes kontradiktë e të ngjashmëve me to, në lidhje me ekzistencën e një qenie pa trup, madje edhe pohimi për pasjen trup të shpirtave folës dhe botës së mendjes, si dhe engjëjt e Allahut, janë në kundërshtim me shumë prej çështjeve hyjnore e prej doktrinave të vërteta. Këtu vendi është i ngushtë për t'i shpjeguar këto çështje.

Ndodhja kohore për botën, sipas shembullit që e kuptojnë atë individët e kësaj shtrese, është në kundërshtim me origjinën e çështjes së ndodhjes kohore, përveç faktit që është në kundërshtim me shumë prej rregullave të tjera hyjnore.

Në mendimin tim, e vërteta është në përputhje të plotë me mendjen e me tekstin, për faktin se engjëjt e Allahut janë në kategori



të shumta. Shumë engjëj s'kanë trup, gjithashtu, shumë prej engjëjve janë me trup të Berzahut, ashtu siç njofton për këtë ajeti i nderuar: “جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ مَا يَتْلُمُ” - “...ue mà jaëlemu xhunùde rab'bike il'là huve...” - “Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd”.<sup>1</sup>

Sipas asaj që përmendet në njoftime, sipas ndarjes së përgjithshme si qenie shpirtërore, engjëjt kategorizohen në dy grupe:

*Grupi i parë:* Nuk ka lidhje me botën e trupave, qoftë lidhje fillimi, qoftë lidhje sistemimi.

*Grupi i dytë:* Ka lidhje me njërin prej dy lidhjeve që u përmenden.

Grupi i parë është në dy pjesë:

*Në pjesën e parë futen “engjëjt mbizotërues”, engjëjt e zhytur në bukurinë e më të Bukurit dhe të mahnitur në Personin e pastër. Ata nuk kanë asnjë interesim ndaj të gjitha krijesave dhe janë të shkujdesur ndaj krijesave të tjera.*

Edhe në mesin e eulijave të Allahut ka që janë si ky grup engjëjsh, kurse ne jemi të zhytur në detin e natyrës së errët, ne nuk interesohemi për botën e panjohur, madje jemi plotësisht të shkujdesur edhe ndaj Personit të dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, megjithëse Ai është i Dukshmi me Personin e Tij të pastër, me tërësinë e dukjes. Ai është hija e shfaqjes së Tij, prandaj eulijatë e Allahut janë të shkujdesur ndaj botës e ndaj çdo gjëje që

---

<sup>1</sup> Sure “El Muddeththir”, ajeti 31.



ka në këtë botë, ata shqetësohen vetëm për të Vërtetin dhe bukurinë e Tij.

Në hadithin e nderuar thuhet: *“Për Allahun, ka krijesa që nuk e dinë se Allahu ka krijuar Ademin e Iblisin”*.<sup>1</sup>

Në pjesën e dytë bëjnë pjesë ata engjëj, të cilët Allahu i Lartësuar i ka bërë ndërmjetës të mëshirës së ekzistencës së Tij. Ata janë kriteret e vargut të ekzistencës dhe qëllimi më i lartë i dëshirave të ekzistencës. Ky grup quhet “ehul-xheberût” - “të fuqishmit”. Kryetari i këtij grupi është “err’rruhul-adham” - “shpirti më i madh”. Ajeti: “تَزَلُّ الْعَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ” - “Tenez’zelul melàïketu uerr’rrùhu...” - **“Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë”**<sup>2</sup>, tregon për këtë grup engjëjsh. Shpirti (Xhebraili) përmendet veçmas, megjithëse edhe ai është prej engjëjve. Është e qartë se Shpirti (Xhebraili) përmendet i veçuar, me emër, për shkak të madhësisë së tij, ashtu siç tregohet në ajetin: “يَوْمَ يَأْتِي الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا” - “Jeume jekùmurr’rrùhu uelmelàïketu saf’fen...” - **“Në ditën, kur Shpirti (Xhebraili) dhe engjëjt do të jenë të rreshtuar...”**<sup>3</sup>

Bazuar mbi një konsideratë tjetër, disa e kanë quajtur Shpirtin (Xhebrailin) “lapsi më i lartë”, ashtu siç ka ardhur në fjalën e tij: “Allahu krijoi të parin lapsin”.<sup>4</sup>

<sup>1</sup>Lexo librin “Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 250; “Err’rreudatu minel-Kàfi”, f. 231, Hadithi 301.

<sup>2</sup>Sure “El Kadr” ajeti 4.

<sup>3</sup>Sure “En Nebe”, ajeti 38.

<sup>4</sup>Tefsiri “Nùru-Th’thekalejni”, vëll. 5, f. 389, Hadithi 9; “Ilmul-Jekijn”, vëll. 1, f. 154.



Ndërsa, bazuar mbi një fakt të dytë, Shpirtin (Xhebrailin) kanë quajtur “mendja e parë”, ashtu siç ka ardhur në fjalën e tij: “Allahu krijoi të parën mendjen”.<sup>1</sup>

Disa kanë thënë se “shpirti” është Xhebraili. Filozofët e konsiderojnë Xhebrailin një tjetër prej engjëjve të afërm të Allahut, gjithashtu kanë thënë se ai është “shpirti i shenjtë” dhe i pari i engjëjve të afruar.

Në disa transmetime thuhet se “Shpirti” është një krijesë më e madhe se Xhebraili. Ebu Besiri ka treguar bisedën e bërë me Profetin Muhamed: “E pyeta Ebu Abdullahun për fjalën e Allahut: *“أَمْرٌ رَبُّهُمُ الرَّوحُ مِنْوَيْسَأَلُونَكَ عَنِ الرَّوحِ”* – “ue jes’elùneke anir’rrùhi, kulir’rrùhu min emri rab’bij...” – **“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: ‘Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni’”**.<sup>2</sup>Ai tha: “Allahu ka krijuar më të mëdhenj se Xhebraili e Mikaili. Ai ishte së bashku me të Dërguarin e Allahut dhe ai është prej engjëjve”.<sup>3</sup>

Është e qartë se Kur’ani dhe njoftimet kanë përdorur dy lloje shprehjesh për fjalën “shpirt”, kurse dijetarët që përdorin terminologjinë për “shpirtin” kanë përdorur disa shprehje, prej të cilave përmendim:

Shpirti: është njëra prej kategorive të engjëjve, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Më sipër e kemi parë këtë fjalë, kur ai tha: “Ai është prej pushteteve”.

---

<sup>1</sup>“Bihàrul Enuàr”, vëll. 1, f. 97.

<sup>2</sup>Sure “El Isra”, ajeti 85.

<sup>3</sup>“El-Usùlu minel-Kâfi”, Libri “El Huxh’xhetu”, K. “Err’rrùhu-l’letij jused’ didu bihel-eim’metu”, Hadithi 3.



Shpirti: është shpirti i eulijave dhe nuk është prej engjëjve, por është më i madh se engjëjt.

Bazuar mbi këtë që u tha më sipër dhe duke pasur parasysh zbritjen në Natën e Kadrit, shpirti ka mundësi të jetë ai që përmendet në suren e nderuar “El Kadr”. Fjala “err’rrùhul-emijn” – “shpirti besnik”, ose fjala “ruh” shpreh “err’rrùhul-adham” – “shpirtin më të madh”. Në ajetin: “وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ” – “jes’elùneke anir’rrùhi....” – “të pyesin ty për shpirtin”, fjala “shpirt” shpreh “shpirtin njerëzor”, i cili në gradën e plotësimit të tij qëndron sipër Xhebrailit dhe sipër gjithë engjëjve të mëdhenj. Gjithashtu, “shpirti” është “bota e urdhrit”, madje ai bashkohet me “vullnetin” dhe përfaqëson “urdhrrin absolut”.

Pjesa tjetër e engjëjve të Allahut përfaqësohet me engjëjt e ngarkuar me qeniet trupore dhe janë rregullues të punëve të tyre. Edhe për këtë pjesë të engjëjve ka aq shumë kategori e grupe, sa nuk numërohen, pasi për çdo qenie të lartë, ose të ulët, ose planetare, ose materiale, ka një anë mbretërore, nëpërmjet të cilës lidhet me botën e engjëjve të Allahut dhe me ushtrinë e të Vërtetit, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“فَسُبْحَانَ الَّذِي يُبْدِي مَلَكُوتَ كُلِّ شَيْءٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ” – “Fesubhànel’ledhij bijedihi melekùtu kul’li shej’inue ilejhi turxheùne” – “Prandaj, qoftë lartësuar Ai, në Dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo gjë! Tek Ai do të ktheheni!”<sup>1</sup>

I Dërguari më i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në lidhje me numrin e shumtë të engjëjve, ka

<sup>1</sup>Sure “Jà Sin”, ajeti 83.



thënë: *“Rënkonte qielli dhe kishte të drejtë që rënkonte. Në qiell, në çdo vend sa një këmbë, kishte një engjëll, që ishte në sexhde ose në ruku”*.<sup>1</sup>

Në shumë hadithe të nderuara theksohet numri i madh i engjëjve dhe kategoritë e tyre.<sup>2</sup>

*Kërkesa e dytë*, ka të bëjë me shpjegimin e mënyrës së zbritjes së engjëjve te kujdestari i punës.

Mësoje se *“shpirti më i madh”* – *“err’rruhul adham”* është krijesa më e madhe prej engjëjve të Allahut, domethënë se ai është një realitet në gradën e parë në kuadrin e engjëjve të Allahut. Gjithashtu, ai është më i nderuari e më i madhi se të gjithë engjëjt e tjerë. Engjëjt e Allahut janë pa trup dhe janë *“kolonat”* mbi të cilat mbështetet tenda e botës së madhështisë. Ata nuk lëvizin prej vendit të tyre, në një kohë, kur zbritja poshtë e ngjitja në lartësi ka kuptim për qeniet me trup, prandaj është e pamundur të thuhet zbritje e ngjitje për engjëjt, sepse qenia pa trup dëshmon se engjëjt janë të pastër prej anekseve të domosdoshme të trupit. Bazuar mbi këtë gjykim, zbritja e engjëjve, qoftë në zemrën e kujdestarit, qoftë në gjoksin e tij, qoftë në mangësitë e tij të përbashkëta, ose në një cep të tokës, ose në Qabe, ose në varrin e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ose në *“Bejti Mamur”* – *“shëmbëllimi i Qabes në sferat e larta”*, të gjitha këto plotësohen sipas shembullit të përfaqësimit të pushtetit, ose përfaqësimit engjëllor. Kjo është e njëjtë me atë që ka përmendur Allahu i Lartësuar në kapitullin e zbritjes së *“shpirtit besnik”* te

---

<sup>1</sup>*“Ilmul-Jekijn”*, vëll.1, f. 259.

<sup>2</sup>*Lexo “Bihàrul Enuàr”*, vël. 56, f. 144 e në vijim. K. *“El-Melàiketun”*.





Merjemja (Paqja qoftë mbi të!): “فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا” - “...fetemeth' thele lehà besheren sevij'jen” - “...iu paraqit asaj si një njeri i plotë”.<sup>1</sup>

Ka mundësi të jetë, gjithashtu, edhe për eulijatë e plotësuar, një përfaqësim pushteti dhe një “fllad” i fuqishëm.

Engjëjt e Allahut kanë fuqi të futen në kanalet e holla dhe në kanalet e pushtetit, sipas shembullit të paraqitjes e përfaqësimit. Po kështu, edhe eulijatë e plotësuar kanë fuqi të futen në pushtetet e madhështisë, sipas shembullit të freskimit dhe kthimit prej të jashtmes në të brendshmen.

Vërtetimi i këtij kuptimi është një punë e lehtë dhe e thjeshtë për cilindo që i kupton të vërtetat e qenieve pa trup – në mënyrë të barabartë, qofshin engjëj, fuqi, ose shpirta folës – që janë prej qenieve të fuqishme, pa trup, ose janë engjëj – të gjitha këto janë një përfytyrim i etapave të ekzistencës e i shfaqjeve të saj, si dhe lidhja e hyrjes nga e jashtëmja në të brendshmen dhe nga e brendshmjia në të jashtmen.

Duhet të dihet se është i pamundur përfaqësimi i “të fuqishmëve” dhe i “engjëjve” në zemrën, në gjoksin e njeriut e në ndijimet e tij, pa dalë më parë njeriu prej veshjeve njerëzore dhe, vetëm pasi ai është përshtatur me ato botë, për aq kohë që do të jetë i shqetësuar për sistemimin e fuqive mbretërore të tij dhe njëkohësisht i shpërfill ato botë, është e pamundur të arrihen të këtilla pamje e përfaqësime.

Po, disa herë ndodh të arrihet largimi i vetes – me shenjë e ndonjërit prej eulijave – prej kësaj bote dhe atëherë, sipas masës së

---

<sup>1</sup>Sure “Merjem”, ajeti 17.



përshtatshmërisë së tij, ai kupton diçka prej botëve të panjohura, një kuptim moral ose figurativ. Herë tjetër ndodh që njeriu të largohet prej natyrës dhe atëherë ai kupton një model të botës së panjohur, por kjo ndodh pas disa punëve shumë të rëndësishme. Kjo gjendje është e njëjtë me rastin kur një njeri i zakonshëm arrin të marrë dëshminë e shpëtimit prej zjarrit të Xhehenemit, kur ai ka qenë për të kryer detyrën e Haxhit në Shtëpinë e shenjtë të Allahut. Një shembull të këtillë ka cituar shehu kryetar, si dhe shehu dijetar Muhjidin.

Kjo arrihet e plotësohet vetëm duke e larguar veten prej botës së pasurisë dhe duke e orientuar veten kah bota e mbretërive.

Ndonjëherë ndodh që të zgjohen shpirtat e eulijave të plotësuar – si rezultat i fuqisë së tyre - por kjo ndodh, pasi ata janë zhveshur prej botëve dhe shohin “shpirtin më të madh”, shohin të gjithë engjëjt dhe pastaj ruhen prezencat e panjohura e të njohura. Në këtë gjendje, shpirti, në të njëjtën kohë, shikon të vërtetat e madhështisë në të gjitha zhvillimet.

Herë tjetër ndodh që zbritja e engjëjve të jetë rezultat i kapacitetit të shpirtit të kujdestarit të plotësuar. Vetëm Allahu është i Dituri.

*Kërkesa e tretë:* Mëso se Nata e Kadrit, është nata e informimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atë natë, të gjitha punët mbretërore zbulohen për të, prej mbretërive të panjohura; atë natë, për të shfaqen e bëhen të dukshëm – në zhvillimin e të panjohurës dhe në botën e zemrës – engjëjt e ngarkuar me çdonjërin prej punëve, atëherë për atë të gjitha punët bëhen të qarta dhe për krijesat plotësohet vlerësimi i të



gjitha punëve. Gjithashtu, në tabelat e larta e në tabelat e poshtme shkruhet me rrugën e librave mbretërorë dhe të “mbulimit” të ekzistencës.

Ky zbulim e informacion mbretëror është i rrethuar me të gjitha grimcat e botës së natyrës. Në këtë gjendje, për kujdestarin e punëve nuk mbetet e panjohur asnjëra prej punëve të njerëzve, për të cilët ai kujdeset.

Për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) s'ka asnjë kontradiktë në zbulimin e punëve të një viti të plotë, vetëm brenda një nate, madje për atë s'ka kontradiktë as për zbulimin e punëve të të gjithë kohës brenda një çasti, ose zbulimi i të gjitha kapaciteteve pronësore e mbretërore, ose zbulimi i të gjitha punëve ditore për të gjitha ditët e vitit, në përgjithësi dhe në mënyrë të detajuar.

Për shembull, në hadithin e nderuar tregohet mënyra e zbritjes së Kur'anit: herë tregohet se Kur'ani ka zbritur i gjithi njëherësh në Bejti Mamur; herë tjetër tregohet se Kur'ani i ka zbritur të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë një periudhe kohore, që shtrihet në njëzet e tre vjet<sup>1</sup>, por zbritja në Bejti Mamur, gjithashtu, është zbritja e Kur'anit për të Dërguarin e Allahut.

Në përgjithësi, ndonjëherë ndodh që kujdestari i punës të jetë në lidhje me sferat më të larta, me lapsat e lartë dhe me tabelat e zhveshura, atëherë për atë arrihet zbulimi i plotë për të gjitha qeniet në përjetësi e përgjithmonë; herë tjetër ndodh që lidhja të jetë

---

<sup>1</sup>Lexo “El-Usûlu minel-Kâfi”, Libri “Fadlul-Kur’ani”, K. “En’nevâdir”, Hadithi 6.



me tabelat e poshtme, atëherë për atë zbulohet një kohë e caktuar dhe faqja e gjithësisë, në tërësinë e saj, do të jetë e gatshme në praninë e kreut të kujdestarisë dhe ai shikon të gjitha punët që do të ndodhin.

Njoftimet tregojnë se punët i paraqiten kujdestarit të punës, të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Duke lexuar librat e tefsireve, si tefsiri “El Burhàn” dhe tefsiri “Es’sàfij”, zbulohen hadithet e shumta që flasin për këtë çështje.<sup>1</sup>

**Fjala e Allahut të Lartësuar: “الْفَجْرُ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ” – “Selàmun hije hat’tà matleil fehxri” – “Paqe është ajo deri në lindjen e agimit”.<sup>2</sup>**

Kjo natë e bekuar është paqe e shpëtim prej ligësive, sprovave e sëmundjeve djallëzore deri në zbardhjen e agimit.

Ose do të thotë: Kjo natë e bekuar është paqe e shpëtim për miqtë e Allahut dhe për njerëzit e bindur ndaj urdhrave të Allahut.

Ose do të thotë: Engjëjt e Allahut takohen me eulijatë e Allahut dhe me njerëzit e bindur ndaj urdhrave të Allahut dhe u përcjellin atyre përshëndetjet me selam prej të Vërtetit të Lartësuar, deri sa të zbardhë agimi.

---

<sup>1</sup>Lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 23, f. 337, f. 346 - f. 347.

<sup>2</sup>Sure“El Kadr”, ajeti 5.



## Vërejtje gnostike

Gjatë shpjegimit të së vërtetës së Natës së Kadrit kemi thënë se shprehja për gradët e ekzistencës së caktimeve të padukshme dhe të dukshme, të gjitha këto janë me “natën”. Duke pasur parasysh mbulimin e diellit të së vërtetës në horizontin e këtyre gradëve dhe caktimeve, atëherë Nata e Kadrit është nata në të cilën i Vërteti i Lartësuar është i mbuluar sipas të gjitha punëve unike të shumësit të emrave e të cilësive, të cilat përfaqësojnë të vërtetën e emrit më të madh. Gjithashtu, kjo natë është caktimi e konstrukti i kujdestarit të plotësuar, i cili është i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Bazuar mbi këtë shpjegim, në të vërtetë “agimi” i Natës së Kadrit është koha kur shfaqet dielli i të vërtetës prapa mbulesave të caktimeve, kurse lindja e diellit prej horizontit të caktimeve, është “agimi” i Ditës së Kiametit.

Kjo natë e bekuar dhe e mbushur me mirësi shtrihet në mes kohës prej perëndimit e mbulimit të diellit të së vërtetës në horizontin e caktimeve të atyre miqve të plotësuar, deri në zbardhjen e agimit. Kjo është koha e Natës së Kadrit, natës, kur, në mënyrë absolute, s’ka turbullira të ardhura prej veprimeve të shejtanit.

Edhe dielli që u mbulua, lind pa asnjë turbullirë dhe i pastër prej veprimeve të shejtanit, prandaj, me të njëjtën rrugë, Allahu i



Lartësuar thotë: “الْفَجْرُ سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطْلَعِ” - “Selàmun hije hat’ tà matleil fexhri” - “Paqe është ajo deri në lindjen e agimit”. (sure “El Kadr”, ajeti 5).

Për sa u përket netëve të tjera, në këto net, shpëtimi nuk ka vend, si për shembull, për ata që e teprojnë në të gjitha drejtimet, ose në ato net nuk bashkohen të gjitha kuptimet e shpëtimit. Këto janë netët e të gjithë njerëzve.

## Mbyllje

Prej shpjegimeve njohëse dhe prej zbulësive të besimit, të cilat bëhen të dukshme me ndihmën e eulijave të mëdhenj për zemrat ndriçuese të atyre që kanë arritur gradën e njohjes, rezulton se surja e nderuar “El Kadr” ka lidhje me të mëdhenjtë e familjes profetike, ashtu siç ka lidhje surja “Et Teuhid” (El Ihlàs) me Personin e dëlirë nga nevojat e nga mangësitë e të Vërtetit të Lartësuar. Kjo theksohet në hadithet që flasin për namazin e “miraxhit” të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që ai e fali në qiell.

Në hadithin e Israsë, prej Muhamed bin Jakubit, me përcjellës që shkojnë deri te Ebu Abdullahu (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë njoftimin që flet për namazin që fali në qiell Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “...pastaj Allahu i Gjithëfuqishëm e urdhëroi: ‘Këndo o Muhamed, lidhjen gjenealogjike të Zotit tënd Fuqiplotë!’ Ai tha: ‘**All’lilàhu ehad,**



All'Ilàhus'samed, lem jelid ue lem jùled ue lem jekun lehù kufuven ehad'". Kjo ishte në rekatin e parë.

Pastaj Allahu Fuqiptotë e frymëzoi atë: *"Këndo 'Elhamdu lil'lâhi'".*

Dhe ai e këndoi, ashtu siç këndoi edhe herën e parë.

Pastaj Allahu e frymëzoi të këndojë: *"In'nà enzelnàhu"*. Kjo sure është lidhja jote dhe lidhja e Ehli Bejtit tënd deri në Ditën e Kiametit".<sup>1</sup>

Janë të shumta njoftimet e ardhura, që flasin për mirësinë e sures "El Kadr". Ndër këto njoftime kemi edhe njoftimin e cituar prej imam Sadikut: *"Kush e këndon "in'nà enzelnàhu fij lejletil kadri" me zë, zëri i tij është si ai që e zhvosh shpatën në rrugën e Allahut. Ai që e këndon këtë sure në fshehtësi, është si i përlyeri me gjakun e tij në rrugën e Allahut. Ai që e këndon këtë sure dhjetë herë, i falen më shumë se një mijë mëkate"*.<sup>2</sup>

Në librin "Khavàsul-Kur'àn" transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Ai që e këndon suren "El Kadr", i jepet shpërblim si shpërblimi i atij që ka agjëruar Ramazanin dhe e ka kaluar Natën e Kadrit me adhurime. Gjithashtu, për atë ka shpërblim si shpërblimi i atij që ka luftuar në rrugën e Allahut"*.<sup>3</sup>

Falënderimi e lavdërimi, fillim e mbarim, janë vetëm për Allahun e Lartësuar!

<sup>1</sup>Tefsiri "El-Burhàn", vëll. 4, f. 487; sure "El Kadr", Hadithi 22.

<sup>2</sup>"El-Usùlu minel-Kâfi", Libri "Fadlul-Kur'àni", Hadithi 6.

<sup>3</sup>Tefsiri "El-Burhàn", vëll. 4, f. 480; sure "El Kadr", Hadithi 1.



## Kërkim ndjese

Hartimi i kësaj kumtese ishte programuar të bëhej mbi bazën e lënies mënjane të hadithit, prej kërkesave njohëse, për shkak se masa e njerëzve nuk është familjarizuar me hollësitë e haditheve, prandaj duhet të mjaftoheshim duke shpalosur vetëm etikën e zemrës për faljen e namazit. Por unë shikoj se lapsi nuk është përmbajtur dhe ka kapërcyer kufijtë e subjektit që unë vetë i vura, veçanërisht në lidhje me interpretimin e sures së bekuar. Prandaj s'ka mbetur më vend për t'u kërkuar ndjesë vëllezërve besimtarë e miqve shpirtërorë. Nëse ata do të shikojnë në këtë kumtesë diçka që nuk është në përshtatje me shijet e tyre, të mos shpejtojnë ta shpallin të gabuar, pa u menduar mirë, sepse çdo dituri është një rrugë dhe në çdo rrugë ka një njeri që ecën. Allahu e mëshiroftë atë që e di vlerën e tij dhe nuk del jashtë stadi të vetvetes.

Disa të tjerë e shpërfillin të vërtetën e gjendjes dhe mendojnë se disa kërkesa të kësaj kumtese janë të kategorisë "interpretim sipas mendjes". Një pohim i këtillë, padyshim vjen si rezultat se ata nuk njohin as dituritë kur'anore e as bukurinë mahnitëse të ligjeve hyjnore. Nëse ky mendim arrihet, ai është thjesht gabim dhe një shpifje e ulët, e ardhur për disa shkaqe, prej të cilave rendisim:

*E para:* Të gjitha dituritë e të gjitha fjalët kuptimplota të shtruara në këtë kumtesë janë marrë prej Kur'anit Famëlartë dhe prej haditheve të nderuara. Gjithashtu, ka dëshmi të dëgjueshme, disa prej të cilave janë përmendur gjatë studimeve të mëparshme, por





pjesa më e madhe e kësaj kategorie hadithesh nuk është përmendur, për shkak se do të zgjatëshim shumë.

*E dyta:* Të gjitha këto dituri e këto fjalë kuptimplota, ose pjesa më e madhe e tyre janë në përputhje të plotë me argumentet logjike, ose janë në përputhje të plotë me argumentet e nxjerra nga dituritë njohëse, prandaj një interpretim i këtillë nuk është interpretim sipas mendjes.

*E treta:* Shpesh, punët që ne kemi përmendur në shpjegimin e ajeteve të nderuara, janë kritere të koncepteve, janë shpjegimi i parimit dhe i gradëve të së vërtetës, prandaj në origjinë nuk kanë lidhje me interpretimin, edhe nëse interpretimi është bërë sipas mendjes.

*E katërta:* Pas të gjitha këtyre etapave dhe me angazhim të plotë, për të qenë i ruajtur në punët e fesë, edhe nëse kjo ruajtje nuk ka qenë në vendin e vet, gjithsesi ne kemi shpjeguar qartë në disa studime jo të domosdoshme dhe kemi pohuar se edhe këto studime i kemi sjellë, thjesht, si mundësi. Bazuar mbi këtë, theksojmë se ajo që gjendet në këtë kumtesë, nuk është model i interpretimit sipas mendjes.



## KAPITULLI I PESTË

# PËRMBLEDHJE E ETIKAVE DHE E SEKRETEVE TË RUKUSË

### Ndarja e parë

## TEKBIRI PARA RUKUSË

Është e qartë se tekbiri para rukusë është prej veprimeve që lidhet me rukunë. Qëllimi me këtë tekbir është: ai që fal namaz, të përgatitet për pozitën e rukusë. Etika e këtij tekbiri ka mundësi të jetë në kuadrin e kujdesit të robit për pozitën e madhe të të Vërtetit Fuqplotë dhe për madhësinë e pushtetit të Zotit krijues. Në të njëjtën kohë, duhet të kemi parasysh pozitën e pafuqisë së robërisë dhe i gjithçkaje që lidhet me robërinë, si: pamundësinë, varfërinë e poshtërimin. Në këtë gjendje, adhuruesi e madhëron të Vërtetin e Lartësuar duke e përshkruar Atë sipas masës së diturisë që ai ka për madhësinë e Zotit krijues dhe për përuljen e robërisë.

Për robin rrugëtar për te Allahu mbetet detyrë e përhershme që ai ta përshkruajë të Vërtetin e Lartësuar me ato cilësi, me të cilat Ai e përshkruan veten e Tij. Robi ka për detyrë ta dëlirë të Vërtetin nga nevojat e nga të metat dhe ta madhërojë Atë dhe, kjo thjesht, në



kuadrin e bindjes ndaj urdhrit. Gjithashtu, robi, me lejen e të Vërtetit të Lartësuar, për atë kryen jo vetëm përshkrimin e madhërimit të të Vërtetit, me ato cilësi që u thanë, por ai kryen edhe adhurimin, përndryshe robi kurrë nuk do të guxojë. Kjo është e vërteta, që robi i pafuqishëm nuk e ka në dorë as t'i bëjë mirë e as ta dëmtojë veten e tij, pasi e gjitha që ai ka, është vetëm një i Adhuruar Fuqplotë, të Cilin e përshkruan dhe e madhëron. Ja si e përshkruan bindjen Ali bin Huseni, me gjuhën e kujdestarisë së mirë: *"Pse, me këtë gjuhën time të lodhur, do të të falënderoj unë Ty?"*<sup>1</sup> Çfarë vjen prej një mushkonje të Tij të pafuqishme?!

Atëherë, kur robi rrugëtar për te Allahu ka qëllim të hyjë në pozicionin e rukusë, padyshim që është një pozicion shumë i rëndësishëm, ai ka për detyrë ta përgatisë veten për këtë pozitë, duke shfaqur varfërinë e nevojën e tij, të cilën e ai e demonstroi duke shkundur duart. Me këtë veprim, robi përshkruan e madhëron të Vërtetin e Lartësuar në plotësim të adhurimit ndaj Tij dhe ecjes në rrugën e Tij, duke ditur se me këto veprime është takimi me krijesat e Tij. Për të kaluar në ruku, robi, kur këndon tekbirin, i ngre duart deri te fundi i majës së veshit, dy shputat e tij, pa asgjë në dorë, i kthen në drejtim të Kibles. Me këto veprime, robi hyn në pozicionin e rukusë pa asgjë në dorë dhe me zemrën e mbushur me frikë e me shpresë. Frikë nga lënia mangët në plotësimin e të drejtës që duhet të plotësohet në pozitën e robërisë. Njëkohësisht, shpresë e siguri me pozitën e pastër të të Vërtetit, i Cili e nderoi robin me këtë pozicion dhe i lejoi atij të hyjë në të

---

<sup>1</sup>Prej duasë që Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) bënte në kohën e syfyrit gjatë muajit të Ramazanit. Kjo lutje njihet me emrin "Duaja e Ebu Hamza Thumalij"; lexo librin "Misbâhul-Muxhtehid", f. 534.



këtilla pozita të larta, që janë të veçanta për më të sinqertët prej miqve të Allahut dhe të dashuruarve të plotësuar.

Ka mundësi që në ngritjen e duarve sipas kësaj mënyre, ka një shenjë që tregon lënien e pozitës së qëndrimit më këmbë deri në këtë kufi. Gjithashtu, tekbiri i rukusë është një shenjë që tregon mosmarrjen furnizim prej pozicionit të qëndrimit më këmbë.

Ka mundësi që ky tekbir të tregojë madhërimin e të Vërtetit të Lartësuar prej formave të përshkrimit që robi bëri në pozicionin e qëndrimit më këmbë.

Pozicioni i rukusë - te ata që kanë arritur gradën e njohjes, është pozicioni i "teuhijdu-s' sifât" - "i Vërteti me cilësitë e Tij është Zoti Një e i Vetëm", prandaj edhe tekbiri i rukusë te ata, është tekbir për të Vërtetin dhe tregon teuhidin e cilësive, kurse ngritja e duarve tregon mohimin e cilësive të njerëzve.



## Ndarja e dytë

### ETIKA E PËRKULJES NË RUKU

Mëso se gjendjet kryesore të namazit janë tri, kurse të gjitha punët e veprimet e tjera janë veprime paraprake dhe përgatitore për to. Gjendjet kryesore të namazit janë:

*E para:* qëndrimi më këmbë

*E dyta:* rukuja

*E treta:* sexhdja

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, i konsiderojnë këto tri gjendje të namazit sinjalizuese për tri teuhidet. Këto pozita ne i kemi trajtuar në librin me titull “Sirr’rru-s’ salàti” - “Sekreti i namazit”, por e kemi trajtuar sipas shijes në gradën e njohjes, kurse këtu do ta shpjegojmë çështjen me një gjuhë të qartë, të përshtatshme për njerëzit e zakonshëm.

Dimë që namazi, për besimtarin, është miraxhi i plotësuar dhe kurhani i të devotshmëve. Namazi përbëhet prej dy punëve, ku njëra prej tyre është parathënie për tjetrën.

*Puna e parë:* Heqja dorë nga shikimi i vetes e nga dashuria për veten, pasi në këtë heqje dorë qëndron e vërteta e devotshmërisë dhe e brendshmja e saj.



*Puna e dytë:* Dashuria për Allahun dhe kërkimi i Tij. Kjo është e vërteta e miraxhit dhe e afrimit, ashtu siç e lexojmë në hadithin e nderuar: *“Namazi është kurbani i çdo të devotshmi”*.<sup>1</sup> Gjithashtu Kur’ani Famëlartë është dritë e udhëzimit. Allahu i Lartësuar, për të devotshmit thotë: *“الْمَسْبُوحُ فِيهَا كِتَابٌ لَا يُؤْمَلُكَ”* – *“Dhàlikel kitàbu là rejbe fjji huden lilmut’tekijne”* – **“Ky është libri, për të cilin s’ka dyshim në të dhe është udhëzues për të devotshmit”**.<sup>2</sup>

Në përgjithësi, këto dy punë arrihen në mënyrë graduale, në të tri pozicionet e namazit: qëndrimi më këmbë, ruku dhe sexhde. Në qëndrimin në këmbë kemi heqjen dorë nga shikimi i vetes, sipas pozitës së ndikimit dhe shikimi vetëm nën ndikimin e të Vërtetit të Lartësuar dhe në përjetshmërinë e Tij absolute.

Në ruku, heqja dorë nga shikimi i vetes, sipas pozitës së cilësive dhe të emrave, si dhe shikimi i emrave të të Vërtetit e i cilësive të Tij.

Në sexhde, heqja dorë, në mënyrë absolute, nga shikimi i vetes, si dhe dashuri absolute për Allahun dhe kërkimin e Tij.

---

<sup>1</sup>“El furu’u minel-Kâfi”, kreu “Es’ salàtu”, K. “Fadul-S’ salàti”, Hadithi 6.

<sup>2</sup> Sure “Bekare”, ajeti 2.



## Ndarja e tretë

Në hadithin që flet për namazin e miraxhit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregohet se ai fali namaz dhe, pasi bëri rukunë, Zoti i tha: “Shiko në arshin tim!” I Dërguari i Allahut tha: “Pashë një madhështi dhe shpirti im u largua pas asaj që pa, ndërsa unë u alivanosa. Në këtë gjendje më erdhi frymëzimi dhe thashë: ‘Subhàne rab’bijel adhijm ue bihamdihi’ – ‘I Plotpushtetshëm e pa asnjë mangësi është Zoti im i madh! Falënderimi është vetëm për Atë!’ Unë e thashë këtë frazë për madhësinë që pashë. Kur unë e thashë këtë frazë, alivanosja u largua prej syve të mi dhe unë e thashë frazën e sipërme shtatë herë, pastaj menjëherë u ktheva në gjendjen që isha më parë”<sup>1</sup>.

I nderuar, mendo thellë për pozitën e madhësisë së rrugëtimit të zotërisë së të gjithëve dhe udhëzuesit; mendo edhe për rrugën që kumtoi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*); mendo për ato që ai pa, duke qenë në ruku, ishte shikimi nën arshin, por drita e arshit në sytë e eulijave, është një shfaqje e Personit të dëlirë nga mangësitë e nevojat, pa asnjë mjet shikimi. Pikërisht për këtë, zhduket ajo që quhet “përcaktimi vetjak” dhe arrihet gjendja e alivanisë. Këtu, Personi i dëlirë nga nevojat e nga mangësitë, me butësinë e Tij të përjetshme, e ndihmon trupin e nderuar të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i Vërteti i Lartësuar i mësoi atij “tesbihun” (dëlirjen nga nevojat e nga mangësitë), i mësoi

<sup>1</sup>“Ilelu-Sh’shera’i”, f. 315, fragment prej hadithit të namazit të Miraxhit.



“tadhijmin” (madhërimin), i mësoi edhe “tahmidin” (falënderimin). Këtë mësim e bëri me anën e “frymëzimit të dashurisë”, deri sa alivanosja u largua prej tij dhe ai u kthye në gjendjen normale, vetëm pasi ai e përsëriti shtatë herë frymëzimin që mori, aq sa është edhe numri i mbulesave dhe numri i gradëve të njeriut. Këto gjendje iu përsëritën Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë gjithë kohës, që ai fali namazin.

Dhe tani, kur për ne s’ka rrugë të arrijmë kënaqësinë e qëndrimit në vetmi me të Dashurin dhe, kur për ne s’ka vend të jemi në pozitën e pastërtisë, është më mirë për ne të pohojmë pamundësinë dhe të shfaqin përruljen e thellë, si mjet për të arritur qëllimin dhe të Kërkuarin. Ne nuk i zgjatim dot duart tona as deri te fundi i qëllimit, pa arritur më parë shpresën e zemrës dhe kënaqësinë e saj.

Nëse nuk e meritojmë këtë, atëherë mbi ne bie detyrimi, që së paku, të shtrijmë dorën e të kërkojmë ndihmë prej udhërrëfyesve, të kërkojmë ndihmë me shpirtëroren e të plotësuarve, deri sa të nuhasim një aromë prej diturive. Mbase kështu, mbi shpirtat tanë të vdekur do të fryjnë aromat e kënaqësive, sepse bamirësia është zakoni i Allahut dhe mirësia është prej cilësive të Tij.

I nderuar, duhet të dish se rukuja është e përfshirë në “tesbihun, tadhijmin dhe në tahmidin” - dëlirjen nga mangësitë e nga nevojat, madhërimin dhe falënderimin” për Sistemuesin Fuqiplotë. “Tesbih” është pastrimi i Allahut nga përsëkrimi dhe nga përkufizimi; “Tadhijm dhe tahmid”, është dalja jashtë kufirit të përngjasimit dhe bllokimit, sepse falënderimi (tahmid), tregon





shfaqjen hyjnore në sytë e krijesave; kurse madhërimi (tadhijm) vë në dukje heqjen e përkufizimit, atëherë Allahu është i Dukshmi dhe në botë s'ka e s'mund të ketë më të dukshëm se Ai; Ai nuk është i mveshur me veshjen e cilësive të krijesave.



## Ndarja e katërt

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, citohet fjala e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “S’ka ndonjë ruku që bën rob i Allahut, ashtu siç është e vërteta e rukusë dhe Allahu i Lartësuar të mos e zbukurojë atë rob me dritën e Tij të mrekullueshme, që të mos e fusë atë nën hijen e madhësisë së Tij dhe të mos i veshë atij rrobën e të porositurve të Tij.

*Rukuja është e para, kurse sexhdeja vjen e dyta. Kush e plotëson të parën në të vërtetën e saj, patjetër që ka bërë mirë edhe të dytën.*

*Në rukunë ka një edukatë, kurse në sexhdenë ka një afrim. Kush nuk e zbukuron edukatën, ajo nuk vlen për afrimin.*

*Prandaj bëje rukunë si rukuja e të nënshtruarit para Allahut, me zemër në dorë, i përlurur me përvojajturi e me nënshtrim të plotë ndaj pushtetit të Tij, i ulur poshtë para Tij me gjymtyrët e tua, ashtu siç ulet poshtë i frikësuari e i mjeruari për humbjen e dobisë që arrijnë ata që bëjnë ruku. (Tregohet se Rebi bin Khajthemi e gdhinte natën deri në agim, duke falur vetëm një rekat namaz. Kur vinte koha për faljen e namazit të sabahut, ngrihej dhe thoshte: “Ah, të sinqertët na parakaluan, kurse për ne u pre.)*

*Rukunë tënde bëje të plotë, duke e drejtuar mirë shpinën. Largoje shqetësimin tënd gjatë qëndrimit më këmbë, duke i shërbyer e duke i kërkuar ndihmë vetëm Allahut. Largoje zemrën prej cytjeve të shejtanit, prej mashtrimeve e kurtheve të tij. Allahu i lartëson robtë e Vet sipas masës së nënshtrimit të tyre ndaj madhërisë së Tij dhe i udhëzon ata deri në*



*origjinën e nënshtrimit e të përuljes sipas masës së diturisë që ata kanë për madhështinë e Tij*".<sup>1</sup>

Në këtë hadith sherifi ka shenja e përgëzime, ka edukata dhe detyra.

Kështu "zbukurimi i robit me dritën e mrekullueshme të Allahut", "futja e robit nën hijen e madhështisë së Allahut" dhe "veshja e robit me rrobën e të porositurve të Allahut", janë përgëzimet e arritjes së mësimit të emrave. Pozita e "وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا" - "Ue al'leme Âdemel esmâe...." - "**Ai** (Allahu) **i mësoi Ademit të gjithë emrat...**"<sup>2</sup>, bëri që robi të arrijë realizimin me pozitën e asgjësimit të cilësive dhe në këtë pozitë të arrijë edhe gjendjen e zgjimit. Zbukurimi që i bën Allahu robit me pozitën e dritës së bukurisë, është i atillë që e bën robin të realizuar me pozitën e emrave. Kjo është e vërteta "e mësimit të Ademit".

Gjithashtu, Allahu e çoi robin në hijen e "madhështisë" - madhështia është prej emrave imponues - dhe i dha atij një vend në oborrin e Tij, domethënë asgjësimi i robit prej vetes së tij. Pastaj veshja e robit me rrobën e të porositurve të Tij, është qëndrimi i përhershëm për robin, pas asgjësimit. Nga këtu bëhet e qartë se sexhdeja, ashtu siç thonë ata që kanë arritur gradën e njohjes, është asgjësim personal, pra, robi është në këto pozita, kurse sexhdeja vjen e dyta, prandaj në këtë gjendje nuk është gjë tjetër veçse asgjësim në vetveten.

<sup>1</sup>"Misbâhu-Sh'sherij'ati", f. 12 dhe "Bihârul Enuâr", vëll. 82, f. 108.

<sup>2</sup>Sure "El Bekare", ajeti 31.



Është e qartë se afrimi absolut që arrihet në sexhde, arrihet vetëm me “rukunë në të vërtetën e saj”.

Ai që synon ta arrijë këtë aftësi për herë të dytë, në radhë të parë, duhet patjetër të arrijë “afrimin e rukusë” dhe etikën e rukusë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) shpjegon qartë jo vetëm hollësitë dhe sekretet e rukusë e të sexhdes, por thekson dhe etikën e zemrës, me atë që është në përshtatje për mesatarët. Gjithashtu, Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) përmend disa punë dhe etika të përgjithshme, të cilat ne i kemi përmendur në veprimet paraprake. Disa të tjera janë të veçanta vetëm për rukunë, pjesën më të madhe të të cilave ne e kemi shpjeguar, prandaj nuk do të shikojmë në hollësitë e kësaj çështjeje.



## Ndarja e pestë

### NGRITJA E KOKËS PREJ RUKUSË

Sekreti i ngritjes së kokës prej rukusë është kthimi prej qëndrimit në shumicat e emrave. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për këtë thotë: *“Teuhidi i plotë është mohimi i cilësive prej Tij”*.<sup>1</sup> Pas arritjes së gjendjes së zgjimit prej asgjësimit në emrat, robi rrugëtar për te Allahu shikon mangësitë e veta dhe punët që nuk i ka kryer të plota, duke ditur se kjo gjendje i vjen njeriut që nga fillimi i gabimit të Ademit, gabim për të cilin bijtë e Ademit kanë për detyrë ta mohojnë, sepse ai është gabim i orientimit kah shumica e emrave të përfaqësuar në brendësi të pemës.

Kur robi rrugëtar për te Allahu e kupton gabimin e tij, për faktin se ai është prej pasardhësve dhe origjina e gabimit është gabimi i Ademit, në këtë gjendje, robi kupton pozitën sa poshtë është ai, njëkohësisht kupton edhe të metat e veta dhe për këtë përgatitet të largojë gabimin nëpërmjet përluljes në praninë e Madhështisë. Në këtë pozicion, robi e drejton shtatin, largon edhe shumicat e emrave, duke marrë tekbinin (duke thënë ‘Allahu ekber’) pas të cilit vjen rukuja. Në këtë pozicion, robi me duar bosh orientohet për të kaluar në pozicionin e përluljes së plotë, të mjerimit dhe origjinës së dheut.

---

<sup>1</sup>“El-Usûlu”, prej librit “Et’teuhid”, K. “Xhevàmîu-t’teuhijd”, Hadithi 6.



Etikat më të rëndësishme në këtë pozicion janë: kuptimi i madhështisë së rëndësisë së pozitës dhe bërja e zemrës që ajo të ndiejë nëpërmjet kujtimit të plotë, si dhe përqendrimi i të gjitha forcave për t'u orientuar kah Personi i dëlirë nga mangësitë e nga nevojat dhe heqja dorë plotësisht nga mbështetja në vetveten, madje edhe kah mbështetja në pozitën e pohimit sa poshtë është ai vetë.

I nderuar, duhet të dish se kujtimi i të Vërtetit, së bashku me dikë tjetër dhe orientimi absolut në të brendshmen e Personit të dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, çon në hapjen e aftësisë për të arsyetuar e për të parë në largësi. Në këtë gjendje, ai arrin “takimin me Allahun”, që është bebja e syrit të eulijave, ashtu siç njofton për këtë ajeti i nderuar: “كَلِّمِهِمْ سُبُلَنَا وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا” – “Uel’ledhijne xhàhedù fiijnà lenehdijen’nehum subulenà...” – **“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!”**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Sure “El Ankebût”, ajeti 69.



## KAPITULLI I GJASHTË

# KUJTESË E PËRGJITHSHME PËR SEKRETIN DHE ETIKËN E SEXHDES

### Ndarja e parë

## SEKRETI I SEXHDES

Te ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe te zotëruesit e zemrave, sexhdeja është: heqja dorë nga vetvetja dhe mbyllja e syve prej çdo gjëje, përveç prej të Vërtetit të Lartësuar dhe vërtetimi me miraxhin e Junusit – ky miraxh u arrit me hyrjen në barkun e peshkut – dhe kjo nëpërmjet orientimit të robit në origjinën e tij, pa e parë mbulesën.

Edhe në vënien e ballit në tokë kemi një kujtesë, që tregon shikimin e bukurisë së më të Bukurit, në brendësi të zemrës së dheut dhe në origjinën e botës së natyrës.

Etika e zemrës në sexhde përfaqëson njohjen, nga ana e robit, e të vërtetës së tij dhe e të vërtetës së origjinës së ekzistencës së tij. Gjithashtu, vënia e “nënës së trurit”, që është qendra e pushtetit të



vetes dhe froni i shpirtit, në pragun më të ulët prej pozitës së pastërtisë dhe shikimit të dheut në pragun e Mbretit të mbretërve.

Atëherë, sekreti i vënies së ballit në sexhde është ndalimi i syrit nga shikimi i vetvetes, kurse etika e vënies së ballit mbi tokë, është ulja poshtë e robit nga pozitat më të larta të vetes së tij dhe që syri i tij t' i shohë. Ai i konsideron pozitat e vetes së tij një gradë më poshtë se dheu dhe, kur në zemër ka diçka nga moskënaqësia për këto pretendime, të cilat janë në gjendjet e namazit - në këndvështrimin e atyre që kanë arritur gradën e njohjes - kjo është hipokrizi.

Në këtë pozitë, rreziku është më i madh e më i rëndë, prandaj mbi rrugëtarin për te Allahu mbetet detyrë - bazuar në fuqinë personale dhe në cilësinë e pastër të krijimit të zemrës - të kapet fuqishëm pas fundit të butësive të të Vërtetit Fuqiplotë dhe t' i kërkojë Atij falje për punët që ka kryer me mangësi dhe të shfaqë përruljen e mjerimin e tij, pasi kjo pozitë është e mbushur me rreziqe të atilla që i kapërcejnë fuqitë e të ngjashmëve me ne.

Në lidhje me këto pozita, ne kemi folur dhe i kemi trajtuar në mënyrë të detajuar në kumtesën me titull "Sirr'rru-S' salati" - "Sekreti i namazit", prandaj këtu do të mjaftohemi të sjellim transmetimin e cituar prej autorit të librit "Misbàhu-Sh'sherij'ati", që flet për etikën e sexhdes.





## Ndarja e dytë

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” lexojmë se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Pasha Allahun, nuk ka pësuar humbje ai që e bën sexhden me të vërtetën e saj, qoftë edhe vetëm një herë gjatë jetës, por as nuk ka shpëtuar ai që rri në vetmi me Zotin e tij në të tilla gjendje, duke e krahasuar me mashtrimet e vetes së tij dhe duke i shpërfillur mirësitë e mëdha e kënaqësitë e shumta në këtë botë dhe qetësinë në Botën Tjetër, që ka përgatitur Allahu për ata që bëjnë sexhde. Kurrë nuk është larg prej Allahut ai që e kërkon afrimin në mënyrën më të mirë, kur është në sexhde. Gjithashtu, për atë që bën sexhde, kurrë s’ka afrim, për shkak se nga edukata e keqe e humb shenjtërinë e sexhdes, duke e varur zemrën e vet në të tjerët, përveç Allahut”.

Prandaj bëje sexhden si sexhdeja e një të nënshtruarit e të përluruarit ndaj Allahut të Lartësuar, duke e ditur se robi është krijuar prej atij dheu që njerëzit e shkelin me këmbë, se ai është marrë prej një farëze, të cilën e jashtëqit çdo individ dhe ai u bë që të jetë, por më parë nuk ishte.

Allahu i Lartësuar, kuptimin e sexhdes, e ka bërë shkak për afrim te Ai, me zemër e me shpirt, prandaj kush i afrohet Atij, ai është larguar prej të tjerëve.

A nuk e sheh se gjendja e sexhdes, nga jashtë, nuk është e barabartë me asgjë tjetër përveçse me atë që është i padukshëm prej të gjitha sendeve dhe i mbuluar prej gjithçkaje që shikojnë sytë?! E këtillë është puna e të brendshmes.



Ai që në namazin e tij është i lidhur me një send tjetër, përveç Allahut të Lartësuar, ai është afër atij sendi dhe është larg nga e vërteta e asaj, që Allahu kishte qëllim të arrinte ai me namazin e tij. Allahu Fuqiptotë thotë: “جَوْفِيْهُمَا جَعَلَ اللهُ لِرَجُلٍ مِّنْ قَلْبَيْنِ” – “Mà xhealell’lilàhu lirexhulin min kalbejni fij xheùfihi...” – “Allahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor”.<sup>1</sup>

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Allahu i Lartësuar njofton: ‘Unë nuk shfaqem kot në zemrën e një robi, prandaj dije se dashuria e sinqertë, kush më bindet dhe kërkon kënaqësinë Time, Unë e marr përsipër ta drejtoj e ta udhëzoj atë njeri. Por, kush merret me dikë tjetër përveç Meje, ai është prej atyre që tallen me veten e tyre dhe emri i tij është shkruar në regjistrin e atyre që kanë pësuar humbje’”.<sup>2</sup>

Ky hadith sherifi ka mbledhur së bashku shpjegimin e sekreteve dhe të etikave, prandaj studimi i këtij hadithi për rrugëtarin për te Allahu hap rrugë prej diturisë, shkatërron e shemb refuzimin e mosbesimin e kundërshtarëve, përkrah e mbështet eulijatë që kanë arritur gradën e njohjes dhe të ndërgjegjësuarit. Të gjithëve u tërheq vëmendjen për të vërtetën e shoqërimit e të qëndrimit në vetmi me të Vërtetin dhe heqjen dorë prej gjithçkaje, me përjashtim të të Lartit, Fuqiptotit.

---

<sup>1</sup>Sure “El Ahzàb”, ajeti 4.

<sup>2</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 16 - “Sexhdeja”.



## Ndarja e tretë

Në hadithin e mëparshëm sherifi tregohet se, kur zbriti ajeti: “فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ” - “Feseb'bih bismi rab'bikel adhijm” - “...lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!”<sup>1</sup>, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Bëjeni këtë në rukunë tuaj!” Kur zbriti fjala e Allahut të Lartësuar: “سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى” - “Seb'bihisme rab'bikel aëla” - “Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit!”<sup>2</sup>, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Bëjeni këtë në sexhden tuaj!”<sup>3</sup>

Në një hadith tjetër, i transmetuar në librin “El-Kàfi”, thuhet: “...emrat e parë që Allahu zgjodhi për veten e Tij, janë: El Alij'ju (i Larti) dhe El Adhijmu (i madhi)”<sup>4</sup>

Duket që emri El Alij'ju është i pari prej emrave të Personit, kurse emri El Adhijmu është i pari prej emrave të cilësive.

Në përgjithësi, duhet të dihet se në sexhde, si dhe në të gjitha gjendjet e namazit, ka një mënyrë dhe një gjendje, ka një ziqër dhe një sekret. Në këtë kumtesë këto punë ne i kemi shpjeguar në formën e një kujtese, për të plotësuarit, sepse trajtimi në mënyrë të detajuar i kësaj çështjeje, del jashtë kuadrit të kumtesës sonë.

<sup>1</sup>Sure “El Uakí'a”, ajeti 74.

<sup>2</sup>Sure “El A'là”, ajeti 1.

<sup>3</sup>“Muxhmeul-Bejân”, fundi i komentimit të ajetit 74 të sures “El Uakí'a”, vëll. 9, f. 224.

<sup>4</sup>“El-Usùlu minel-Kàfi”, Libri “Et'teuhid”, K. “Hudùthul-Esmà'i”, Hadithi 2.



Për sa u përket mesatarëve, themi: Forma e sexhdes është vullneti i dheut të robit rrugëtar për te Allahu, heqja dorë prej mendjemadhësisë, vetëpëlqimit dhe përlyerja e hundës me dheun, e atij që fal namazin. Ky veprim është prej veprimeve “sun’neti muek’kedeh”, madje lënia është në kundërshtim me rezervën, sepse kjo përulje kaq e thellë në sexhde është shfaqja e nënshtrimit, përuljes, kryeultësisë së plotë, kthimi i vëmendjes në origjinën e vetes dhe theksimit të rëndësisë që ka përmendja e emrit të Allahut.

Edhe vënia e gjymtyrëve të dukshme, kryesore, që janë shtatë, ose tetë, këto gjymtyrë përfaqësojnë pamundësinë e kuptimit dhe demonstrojnë lëvizjet e fuqinë mbi tokën e poshtëritimit e të mjerimit. Këto veprime numërohen prej shenjave të dorëzimit të plotë nga ana e robit që ka rënë në sexhde dhe vënia në dispozicion të sexhdes e të gjitha fuqive të tij. Në të njëjtën kohë, në sexhde realizohet edhe dalja e robit prej gabimit të Ademit.

Kur këto kuptime përforcohen në zemër, pa ndonjë ndikim tjetër, për robin arrihet gjendja e largimit me vrap prej vetvetes, heqja dorë nga vetëpëlqimi me ato fruta që sjell gjendja e shoqërimit dhe më pas vjen gjendja e qëndrimit në vetmi dhe dalja sheshit e dashurisë së plotë.



## Ndarja e katërt

Bazuar mbi atë që ka ardhur në hadithin e namazit të miraxhit, sexhdeja është errësim dhe trullosje, që arrihen si rezultat i shikimit të dritave të madhështisë së të Vërtetit. Në sexhde, robi e humb mendjen dhe për atë realizohet një gjendje asgjësimi e shokimi, gjendje që e ka përfshirë robin, që nga koha e kujdesit të përjetshëm dhe i frymëzuar me diçka të panjohur.

Edhe dhikri në sexhde (subhàne rab'bijel aëlà), si dhe përsëritja e këtij dhikri është me qëllim që të arrihet gjendja e zgjimit, që robi të mbledhë veten dhe shpirti i robit të kthehet te i Vërteti i Lartësuar. Kur robi kthehet te Ai, në zemrën e robit ndizet zjarri i dashurisë për të parë dritën e të Vërtetit, atëherë robi ngre kokën prej sexhdes dhe, kur robi shikon në veten e tij mbeturina të egoizmit, bën shenjë me dorën e tij, që i refuzon këto mbetje të egoizmit. Në këtë gjendje, shkëlqen edhe një herë tjetër drita e madhështisë dhe është kjo dritë i djeg ato mbeturina të egoizmit, atëherë robi del prej hutimit dhe thotë: "Allahu ekber!". Pas tekbirit, për robin, arrihet gjendja e shuarjes së plotë e absolute dhe për atë vjen një gjendje zgjimi e vërtetë dhe e plotë. Më pas, në drejtim të robit shtrihet dora morale e padukshme e frymëzimit, me fjalët e dhikrit, të cilat i mundësojnë atij këtë pozitë, atëherë për robin arrihet gjendja e zgjimit, që është zgjimi i pozitës së eulijave, zgjim i pastër, pa asnjë mbulim e pa asnjë trazirë morale. Ky zgjim vjen pas shuarjes që arrihet në gjendjen e këndimit të "teshehudit" dhe dhënies "selam". Kjo gjendje numërohet, gjithashtu, prej dispozitave të shumicës, sepse pikërisht, në këtë gjendje, plotësohet krejtësisht rrethi i ecjes njerëzore.



## KAPITULLI I SHTATË

# KUJTESË E PËRGJITHSHME RRETH ETIKËS SË TESHEHUNIT

### Ndarja e parë

Mëso se dëshmia se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe dëshmia tjetër se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, që thuhet në këndimin e ezanit e të ikametit – të dyja (ezani e ikameti) janë prej lidhësve e veprimeve paraprake të namazit, dëshmia e dytë njofton hyrjen në namaz – po kështu edhe në “teshehunit”, që këndohet në fundin e namazit, realizohet dalja prej asgjësimit për në përjetshmërinë dhe prej njëshit në shumicën. Të gjitha këto së bashku i kujtojnë robët rrugëtar për te Allahu të vërtetën e namazit dhe kjo e vërtetë është arritja e teuhidit të plotë, sepse dëshmia: “S’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”, është prej veprimeve paraprake gjithëpërfshirëse, që e shoqërojnë rrugëtarin për te Allahu nga fillimi i namazit deri në fundin e tij.

Gjithashtu, në namaz ka një sekret “të parë” dhe të “fundit” dhe ky sekret është i Vërteti Fuqplotë. Gjithashtu, është edhe një sekret tjetër i madh, që reduktohet në faktin se udhëtimi i rrugëtarit



për te Allahu është prej Allahut dhe për te Allahu, ashtu siç njofton edhe ajeti: “تَعُوذُونَكَ بِدَائِمٍ” - “...kemà bede ekum teùdùne” - “Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t’ju ringjallë”.<sup>1</sup>

Atëherë, për rrugëtarin për te Allahu mbetet detyrë që ai të orientohet kah ky objektiv në të gjitha pozitat dhe të çojë në zemrën e tij të vërtetën se i Vërteti është Zoti Një e i vetëm dhe se vetëm Ai është Krijuesi e Sistemuesi. Gjithashtu, rrugëtari për te Allahu në këtë udhëtim, miraxh hyjnor, ka për detyrë ta bëjë zemrën e tij të atillë që te ai të rrënjoset se dëshmia e tij është plotësisht e vërtetë dhe plotësisht e pastër prej hipokrizisë dhe prej idhujtarisë.

Ka mundësi që në dëshminë për mesazhin të ketë një kujtesë se ndihma e kujdestarit absolut dhe e Profetit vulë në këtë miraxh moral, është prej pozitave gjithëpërfshirëse, drejt të cilave rrugëtari duhet të drejtohet në të gjitha pozitat, deri sa për të ngjashmit me të, bëhet i qartë sekreti i shfaqjes së të “parës” dhe të “fundit”, që janë prej pozitave të kujdestarisë.

Nuk është e panjohur se në namaz ka një dallim mes “dëshmisë” që këndohet në fillim të namazit dhe “dëshmisë” në fundin e namazit. Ky ndryshim qëndron në faktin se “dëshmia” e parë është para fillimit të rrugëtimit, që shpreh adhurimin dhe është dëshmi lidhëse, në një kohë që “dëshmia” e fundit, është dëshmi pas kthimit, është dëshmi “e realizuar” ose “e miratuar”.

Për këtë shkak, “dëshmia” në teshehudin ka një rrezik të madh, sepse në atë pretendohet vërtetimi dhe miratimi, si dhe pretendimi i kthimit të shumica, pa vetëmbulim.

---

<sup>1</sup>Sure “El A’ràf”, ajeti 29.



Është e qartë se kjo pozitë e lartë nuk mund të realizohet për të ngjashmit me ne, madje as që mund të mendohet se kjo pozitë të arrihet nga ana jonë, duke ditur gjendjen në të cilën ne jemi. Megjithëkëtë, patjetër që në praninë e Filluesit të gjithçkaje kërkohet një edukatë, e cila qëndron në vënien parasysh sa shumë mangësi kemi, sa poshtë jemi, sa punë lëmë mangët, sa të pafuqishëm jemi, pa harruar ndërprerjen e mashtrimeve dhe detyrën që kemi për t'u orientuar kah oborri i pastërtisë me turpin më të madh.

O Zoti im, ne s'kemi pjesë as në pozitat e eulijave, as në shkallët e të kulluarve, as në plotësimin e të sinqertëve e as në sjelljen e rrugëtarëve për te Allahu përveç fjalëve, sepse ne jemi mjaftuar prej të gjitha pozitave me "thashetheme", por kjo nuk çon në arritjen e përshtatjes dhe të lumturisë.

Ah, ne na ka mbuluar dashuria për këtë botë dhe na kanë mbërthyer lidhëset e saj, që të mos jemi pranë pastërtisë Tënde e në forumin e shoqërisë Tënde. Për ne, të humburit, s'ka rrugë tjetër përveçse që të na japësh prej butësisë Tënde të padukshme dhe të na orientosh drejt asaj që ne kemi humbur, duke shpresuar se do të dalim prej gjumit të shkujdesjes e të shpërfilljes dhe do të marrim rrugën që na çon drejt pastërtisë së plotë.





## Ndarja e dytë

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati” lexojmë se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Teshehudi është lavdërim për Allahun Fuqplotë, prandaj bëhu rob për Atë në fshehtësi dhe i nënshtruar ndaj Tij në punë, ashtu siç je rob i Atij me fjalë e me lutje. Vërtetësinë e gjuhës tënde bashkoje me pastërtinë e sekretit tënd, sepse Ai të krijoi ty rob dhe të urdhëroi ty ta adhurosh Atë me zemrën tënde, me gjuhën tënde, me gjymtyrët e tua dhe robërinë tënde ndaj Tij realizoje për të mirën tënde me cilësinë e Zotit krijues. Duhet të dish se kokat e njerëzve janë në dorën e Tij. Për njerëzit s’ka as shpirt e asgjë tjetër përveçse me fuqinë e Tij e me dashjen e Tij. Njerëzit s’kanë fuqi të sjellin as edhe sendin më të vogël në mbretërinë e Allahut, por ata mund ta sjellin atë send vetëm me lejen e me dëshirën e Tij. Në lidhje me këtë çështje, Allahu i Lartësuar thotë:

”وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَىٰ عَمَّا يُشْرِكُونَ”

“Ue rab’buke jakhluku ue jakhtàru ue mà kàne lehumul-khijeretu, subhànell’lilàhi ue tealà am’mà jushrikùne” –“Zoti yt krijon ç’të dojë dhe zgjedh lirisht, ndërsa ata (idhujt) nuk mund të zgjedhin. Qoftë i lavdëruar Allahu dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!”<sup>1</sup>

Prandaj bëhu rob falënderues me punë, ashtu siç je rob, kur e përmend Atë me fjalë e me lutje. Vërtetësinë e gjuhës tënde bashkoje me pastërtinë e sekretit tënd. Ai të krijoi dhe, i lartë e i madhëruar është vetëm Ai që bën, që askush të mos zotërojë dëshirë e vullnet pa vullnetin e pa

<sup>1</sup>Sure “El Kasas”, ajeti 68.



*dëshirën e Tij, prandaj ti përdore robërinë tënde në fitimin e kënaqësisë, me urtësinë e Tij dhe me adhurim, duke plotësuar urdhrat e Tij.*

*Ai të ka urdhëruar të këndosh salavat për Profetin e Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), prandaj edhe ti këndo salavat për të, me salavatën që ai ka kënduar, të jesh i bindur ndaj tij, ashtu si ai vetë ishte i bindur dhe të dëshmosh me dëshminë që ai ka dëshmuar. Bëj kujdes, që të mos të humbë begatia e njohjes së shenjtërisë së tij, ndryshe do të privohesh nga dobia e namazit të tij dhe e urdhrat të tij, për t'i kërkuar Allahut faljen e gjynaheve, do të jesh i privuar nga ndërmjetësimi i tij për ty, edhe nëse ti do ta kryesh detyrën duke plotësuar urdhrin për veprim e për ndalim, edhe nëse do të plotësosh veprimet sunet e mustehab dhe edukatën. Patjetër duhet të dish gradën e lartë e të nderuar që ai gëzon te Allahu Fuqiplotë”<sup>1</sup>*

Hadithi i nderuar na sjell në kujtesë etikën e adhurimeve të zemrës, të vërtetat dhe sekretet e adhurimeve. Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e përshekruan teshehudin si lavdërim për Allahun Fuqiplotë. Më përpara është theksuar se të gjitha adhurimet janë lavdërim për të Vërtetin, ose me një emër, ose me shumë emra, ose me një shkëlqim prej shkëlqimeve, ose me origjinën e identitetit.

Gjithashtu, hadithi e vë theksin mbi etikën më të rëndësishme, kur adhuruesit, rrugëtar për te Allahu, i flet drejtpërdrejtë dhe i thotë: Ke për detyrë të jesh adhurues në fshehtësi, ashtu siç je adhurues edhe kur adhurimin e kryen sheshit! Ti pretendon robërinë, që të lëviz robëria sekrete e zemrës, por robëria përfshin të gjitha punët e gjymtyrëve dhe puna me fjalën bëhen një figurë për të brendshmen e për sekretin, por që e vërteta

---

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 17 – “Teshehudi”.



e robërisë të rrjedhë në të gjitha pjesët e trupit, në pjesët e jashtme e të brendshme të trupit, në atë mënyrë që çdo njëra prej gjymtyrëve të marrë pjesën që i takon prej teuhidit. Gjithashtu, edhe gjuha e çon përmendjen e Allahut në zemër dhe, është kjo zemër e sinqertë që pohon se i Vërteti është Zoti Një, pastaj zemra këtë teuhid e këtë sinqeritet e lëshon me vrull mbi gjuhën.

Rrugëtari për tek Allahu ka për detyrë të kërkojë Zotin krijues në të vërtetën e robërisë, të dalë jashtë vetëpëlqimit, të çojë në zemër se i Vërteti është Krijuesi e Sistemuesi, të dijë se jetët e njerëzve janë në dorën e Allahut dhe krijesat, nga vetvetja, s'kanë fuqi as të marrin frymë e as të shohin, pa fuqinë e pa dëshirën e të Vërtetit të Lartësuar, sepse të gjithë s'kanë as mundësi e as fuqi të veprojnë në mbretërinë e të Vërtetit me zgjedhjen e tyre, me asnjë mënyrë apo punë, qoftë edhe prej punëve më të thjeshta, pa lejen e Personit të dëlirë nga të metat e nga nevojat dhe pa vullnetin e Tij. Këtë çështje Allahu i Madhëruar e përmend në ajetin 68 të sures "El Kasas":

"وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ"

*"Ue rab'buke jakhluku ue jakhtàru ue mà kàne lehumul-khijeretu, subhànell'llàhi ue tealà am'mà jushrikùne"* - **"Zoti yt krijon ç'të dojë dhe zgjedh lirisht, ndërsa ata (idhujt) nuk mund të zgjedhin. Qoftë i lavdëruar Allahu dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!"**

Asnjëri s'ka mundësi të zgjedhë me zgjedhjen e vet në mënyrë të pavarur. I Vërteti i Lartësuar është i dëlirë nga nevoja, që Ai të ketë një të ngjashëm e të barabartë me Të, ose të një ortak, për të vepruar në mbretërinë e ekzistencës.



Dhe, kur kjo butësi kaq e këndshme arrin në zemrën tënde, o i nderuar rrugëtar për te Allahu, falënderimi yt për të Vërtetin është i vërtetë. Mbage parasysh se në këtë falënderim përfshihen të gjitha gjymtyrët e tua e të gjitha punët e tua.

Gjithashtu, gjuha e zemra kanë për detyrë të jenë sinonime në robërinë, prandaj i nderuar adhurues, rrugëtar për te Allahu, sinqeriteti i gjuhës tënde duhet të jetë së bashku me kthjelltësinë e sekretit të zemrës tënde në teuhidin e punëve, sepse i Vërteti Fuqplotë është Krijuesi dhe s'ka ndikues tjetër përveç Atij. Gjithashtu, edhe çdo vullnet e çdo dëshirë është hija e vullnetit të Tij dhe e dëshirës së Tij të përjetshme.

Pas stolisjes me etikën e dëshmisë dhe me pohimin se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm dhe se Ai është Krijuesi e Sistemuesi, robi rrugëtar për te Allahu ka për detyrë të orientohet kah pozita e pastër e vulës së profetëve, të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nga ajo që u tha më përpara, në lidhje me pozitën e robërisë, bëj kujdes që “robërinë” ta vendosësh mbi pozitën e “mesazhit”, sepse robëria është parathënie për të gjitha pozitat e rrugëtarëve për te Allahu, kurse mesazhi është degë e robërisë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte një rob i vërtetë, që shkrihej në të Vërtetin, atëherë edhe bindja ndaj tij është bindje ndaj të Vërtetit. Edhe dëshmia për mesazhin, është e ngjitur me pohimin se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm, prandaj për robin rrugëtar për te Allahu mbetet detyrë ta mbajë veten nën kontroll, me qëllim që të mos lërë mangët edhe bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse bindja ndaj tij është bindje ndaj Allahut dhe, për të mos qenë i privuar nga begatitë e adhurimit, të përfaqësuara në arritjen e



pranisë së pastër, mbaje parasysh se kjo prani arrihet vetëm me ndihmën e Kujdestarit Absolut. Gjithashtu, rrugëtari për tek Allahu ka për detyrë të dijë se askujt nuk i jepet leje të hyjë në praninë e pastër e në forumin e shoqërimit, pa ndihmën e kujdestarit të mirësive, pa ndihmën e të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).



## KAPITULLI I TETË

### ETIKA E SELAMIT

#### Ndarja e parë

Mëso se, kur robi rrugëtar për tek Allahu kthehet në veten e tij prej pozitës së sexhdes, e cila e gëzoi atë me “asgjësimin” dhe për atë u arrit gjendja e zgjimit dhe e ndërgjegjësimit, ai u kthye prej gjendjes së panjohur prej njerëzve në gjendjen e pranisë. Në këtë gjendje, ai i përshëndet me selam të gjitha qeniet dhe selami i tij është selami i një adhuruesi që kthehet prej udhëtimit të panjohur. Në radhë të parë, ai përshëndet me selam Profetin më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse e vërteta e parë që shkëlqen për të, pas kthimit prej njëshit në shumicën, është e vërteta e kujdestarisë: “*Ne jemi të parët, të mëparshmit*”.<sup>1</sup>

Më pas tërheqin vëmendjen krerët e qenieve të tjera, në mënyrë të detajuar dhe të bashkuar.

---

<sup>1</sup>Lexo “Bihàrul Enuàr”, vëll. 15, f. 15. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “...ne jemi të parët dhe ne jemi të mbrapmit”. Në “Sahihun e Buhariut”, vëll. 1, f. 36, lexojmë: “...ne jemi të mbrapmit dhe ne jemi të mëparshmit”.



Ai që në namazin e tij është i pranishëm te njerëzit, kurrë nuk është udhëtar për te Allahu dhe, në raport me këtë person, pas namazit, për atë s'ka asnjë të vërtetë prej Islamit, për rrjedhojë edhe selami i tij s'është më shumë se dërdëllitje e gjuhës.

Etika e zemrës për selamin është e lidhur me të gjithë etikën e namazit, prandaj kur ai që fal namaz dhe, namazi përfaqëson të vërtetën e miraxhit, nuk ndien se është ngjitur në lartësi e nuk ka dalë jashtë shtëpisë së vetvetes, për atë s'ka selam.

Por, kur për atë që fal namaz, në këtë udhëtim bëhet realitet shpëtimi prej veprimeve të shejtanit dhe prej shpirtit lakmues në të keqen, përveç kësaj në zemrën e tij s'ka asnjë shmangie gjatë gjithë këtij miraxhi të vërtetë, atëherë edhe selami i tij është i vërtetë, ndryshe për atë s'ka selam.

Po, selami për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është i cilësuar në këtë udhëtim miraxh dhe në këtë ecje për te Allahu me siguri në ngjitje e në zbritje dhe ai, në miraxhin e tij, ishte krejtësisht i pastër prej veprimeve të tjera, përveç veprimeve të të Vërtetit Fuqiplotë, gjatë gjithë atij udhëtimi. Më sipër këtë çështje e kemi trajtuar në kuadrin e interpretimit të sures se bekuar "El Kadr".



## Ndarja e dytë

Në librin “Misbàhu-Sh’sherij’ati”, lexojmë se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Selami në fundin e çdo namazi është siguri, domethënë se ai që e ka kryer urdhrin e Allahut dhe sunetin e Profetit të Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) me frikë në zemër prej Tij, për atë ka siguri prej fatkeqësive të kësaj bote dhe një certifikatë pafajësie prej ndëshkimit në Botën Tjetër.

Selam, është njëri prej emrave të Allahut Fuqiplotë dhe këtë emër Ai e ka lënë te njerëzit e Tij, që ta përdorin kuptimin e këtij emri në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, në lënien e sendeve për ruajtje në mirëbesim, në shtesat, në vërtetimin e shoqërimit e të miqësisë ndërmjet tyre dhe për vlefshmërinë e marrëdhënieve të ndërsjella mes tyre.

Kur ti dëshiron ta vësh selamin në vendin e vet dhe të plotësosh kuptimin e selamit, atëherë kije frikë Allahun dhe prej teje të jenë të shpëtuar feja jote, zemra jote e mendja jote dhe këto jo vetëm të mos i ndotësh me errësirën e gjynaheve, por të jesh në paqe edhe me ruajtësit e tu, të mos i mërzisësh ata, të mos i shqetësosh ata dhe të mos i egërsosh ata me bashkëpunimin tënd me ta. Pastaj miku e shoku yt dhe pastaj armiku yt. Nëse nuk je i sigurt prej atij që je më afër tij, atëherë ai që është më larg, ka përparësi, kurse ai që nuk e vë selamin në vendin e vet, për atë s’ka as shpëtim e as dorëzim. Ai është gënjeshtar në selamin e tij, edhe pse njerëzit i përshëndet me selam”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>“Misbàhu-Sh’sherij’ati”, K. 18 – “Selami”; “Bihàrul Enuàr”, vëll. 82, f. 308.





Hadithi njofton se “selami” në fundin e namazit është siguri, në kuptimin se personi që i kryen urdhrat hyjnorë dhe sunetet profetike, me zemër të nënshtruar e të frikësuar, ky selam është për atë siguri prej fatkeqësive në këtë botë dhe prej ndëshkimit në Botën Tjetër, domethënë se ai është i siguar prej veprimeve të shejtanit në këtë botë, për shkak se kryerja e urdhrave hyjnorë me zemër të nënshtruar e me frikë çon në ndërprerjen e pushtetit të shejtanit. Këtë çështje e njofton ajeti i nderuar: “إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ” - “...in'nes'salâte tenhà anil fahshà uelmunkeri...” - **“Namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...”**<sup>1</sup>

Hadithi e vë theksin edhe mbi njërin prej sekreteve të “selamit” dhe njofton: Selami është njëri prej emrave të Allahut të Lartësuar dhe këtë emër Ai e ka depozituar te njerëzit e Tij. Kjo është një shenjë treguese e anës së jashtme të qenieve prej emrave hyjnorë, prandaj për robin rrugëtar për tek Allahu është detyrim ta bëjë të dukshme këtë bukuri të madhe hyjnore, e depozituar në brendësi të vetes së tij, por, në vetvete, kjo dhuratë hyjnore është e padukshme, megjithëse njeriu e përdor atë në të gjitha bashkëpunimet, në problemet e bashkëjetesës, në lënien e sendeve në ruajtje në mirëbesim, në marrëdhëniet e ndërsjella etj. Në të gjitha këto, Ai ka bërë që ky emër të rrjedhë në mbretërinë e tij të brendshme e të jashtme. Me këtë emër robi gjen strehim në marrëdhëniet e tij me të Vërtetin dhe me fenë e të Vërtetit Fuqiplotë, me qëllimin që robi të mos jetë tradhtar i kësaj dhurate hyjnore, e depozituar në brendësi të tij. Më pas, e vërteta e “selamit” kalon nëpër të gjitha fuqitë e cilësitë e tij, madje deri në zakonet e tij, në

<sup>1</sup>Sure “El Ankebût”, ajeti 45.



besimin e tij, në sjelljet e në moralin e tij dhe në punët e tij që ai vetë të jetë i shpëtuar prej të gjitha veprimeve.

Hadithi i nderuar thekson se rruga e arritjes së këtij shpëtimi është devotshmëria, është frika ndaj Allahut të Lartësuar, por duhet theksuar se për devotshmërinë ka gradë e pozicione, si vijon:

Devotshmëria e jashtme, është ruajtja e të jashtmes prej ndyrësirave të gjynaheve shabllone dhe prej errësirave të këtyre gjynaheve. Kjo është devotshmëria e masës së njerëzve.

Devotshmëria e brendshme, është ruajtja e të brendshmes dhe pastrimi i saj prej teprimit e prej lënies mangët, prej kapërcimit të kufirit të maturisë në moralet e instinktët shpirtërore. Kjo është devotshmëria e të veçantëve.

Devotshmëria e mendjes, është ruajtja e pastrimi i mendjes, që ajo të mos konsumohet në dituritë johyjnore dhe, qëllimi ynë me “dituritë hyjnore” është për dituritë që kanë lidhje me legjislacionin dhe me fetë hyjnore. Gjithashtu, edhe të gjitha dituritë natyrore, kur kanë për qëllim njohjen e shfaqjeve të të Vërtetit, janë dituri hyjnore. Por, nëse ato nuk janë dituri të këtilla, patjetër që ato nuk janë dituri hyjnore, qoftë edhe sikur të jenë studime që flasin për fillimin e për ringjalljen. Kjo është devotshmëria e më të veçantëve prej të veçantëve.

Devotshmëria e zemrës, është ruajta e saj prej shikimit e prej përmendjes së ndonjë tjetri përveç të Vërtetit. Kjo është devotshmëria e eulijave. Në këtë devotshmëri arrihet qëndrimi i zemrës në vetmi. Hadithi i nderuar kudsij njofton: *“Unë jam*



*bashkëbisedues me atë që ulet të rijë me Mua*".<sup>1</sup> Ky hadith kudsî tregon këtë qëndrim në vetmi të zemrës dhe numërohet qëndrimi në vetmi më i preferuar, sepse të gjitha qëndrimet e tjera në vetmi janë veprime paraprake, për të arritur këtë qëndrim të zemrës në vetmi.

Kur robi është i stolitur me të gjitha gradët e devotshmërisë, ka shpëtuar feja e tij, mendja e tij, shpirti i tij, zemra e tij të gjitha fuqitë e tij të jashtme e të brendshme; prej tij kanë shpëtuar edhe engjëjt e ngarkuar për të mbikëqyrur punët e tij, për rrjedhojë edhe ruajtësit nuk shqetësohen e nuk egërsohen prej tij, të gjitha bashkëpunimet e tij, si dhe bashkëjetesa e tij me mikun e me armikun do të jetë paqe e shpëtim, madje vetë rrënjët e armiqësisë, vetvetiu, do të shkulen prej zemrës së tij plotësisht, edhe sikur njerëzit të tregojnë armiqësi ndaj tij.

Për sa i përket personit në të cilin nuk realizohen të gjitha gradët e shpëtimit, ai person është i privuar prej bujarisë së "selamit" dhe shumë shpjet do të gjendet në horizontet e hipokrizisë. Allahu na ruajttë! Ai do të jetë më afër privimit prej shpëtimit.

---

<sup>1</sup>"El mevâhibu-S' senij'jetu", f. 77 dhe "El mehaxh'xhetul-Bejdâ", vëll. 8, f. 58.



## PËRBYLLJA E LIBRIT

# ETIKA E DISA PUNËVE QË HYJNË TE NAMAZI DHE JANË TË BASHKUARA ME TË

### Ndarja e parë

## DISA SEKRETE DHE ETIKA NË KATËR TESBIHATET, NË NAMAZET TRE DHE KATËR REKATËSH

**Baza e parë:** Tesbihi është pastrimi i Allahut prej përsëkrimit. Ky pastrim bëhet duke e falënderuar Atë me “tahmin” – duke thënë: “Elhamdu lil’lâh”. Gjithashtu, ky pastrim bëhet me “tehlilj” - duke thënë: “Là ilâhe il’lell’lâh”, duke pohuar se s’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. “Tesbihu” është prej pozitave gjithëpërfshirëse, të cilat robi rrugëtar për tek Allahu ka për detyrë t’i ketë në qendër të vëmendjes, në të gjitha adhurimet që kryen dhe të ruajë në zemrën e tij pohimin e frazave, me të cilat i Vërteti përsëkruan Personin e tij të pastër dhe të formulojë frazat e lavdërimit për Atë. Robi nuk duhet të pandehë se ai ka mundësi të plotësojë të drejtën që i takon robërisë, pa folur për të drejtën që i takon Zotit krijues. Veç kësaj, nuk janë ndërprerë prej Tij shpresat e eulijave të plotësuar dhe ata nuk kanë lënë gjë mangët që të arrijnë në fundin e dëshirave të dijetarëve të mëdhenj: “E mblodhi dritaren



dhe sfinks i kurrë s' do të jetë për ndonjë person".<sup>1</sup> Ky është edhe shkaku që ti i shikon eulijatë të thonë: "Plotësimi i diturisë te dijetarët është se ata e dinë pamundësinë e tyre".<sup>2</sup>

Po, mëshira e madhe e të Vërtetit Fuqiplotë është gjithëpërfshirëse për gjendjen tonë, robëve të pafuqishëm dhe në të vërtetë, për ne të mjeruarit, është lejuar të bëjmë shërbimin në saje të kësaj mëshire të gjerë. Gjithashtu, për ne është lejuar që të hyjmë në një pozitë të këtille të pastër, pozitë e cila ka kërrusur shpinat e engjëjve të afruar, si rezultat i afrimit pranë Tij. Ky afrim është prej mirësive më të mëdha e prej preferencave më të larta të Personit të dëlirë nga mangësitë e nga nevojat, sepse vetëm Ai i shpërndan të mirat për robtë e Vet.

Rëndësinë e kësaj mirësie e dinë vetëm ata që kanë arritur gradën e njohjes, eulijatë e plotësuar dhe njerëzit e Allahut dhe patjetër secili sipas diturisë që ka. Kurse ne, të mbuluarit, që kemi mbetur prapa të gjitha pozitave e pozicioneve, jemi si të internuarit që janë të privuar prej të gjitha plotësimeve e prej të gjitha diturive, prandaj ne jemi plotësisht të shkujdesur e shpërfillës ndaj kësaj mirësie. Për rrjedhojë, urdhrat hyjnorë ne i konsiderojmë barrë të rëndë e detyrim dhe i kryejmë me zhurmë e përtaci, në një kohë kur ajo është mirësia më e madhe që s'ka as fund e as anë.

Ne, të privuarit, jeni të mbuluar plotësisht prej ndriçimit të kësaj mirësie.

---

<sup>1</sup>Përmbajtja e fillimit të një poezie, e poetit të njohur Hafiz Shirazi.

<sup>2</sup>Kuptimi i kësaj thënie ka ardhur në librin "Munàxhàtul-Arifijn". Kjo është biseda intime e dymbëdhjetë prej pesëmbëdhjetë bisedave intime të ardhura prej Imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*); lexo librin "Bihàrul Enuar", vëll. 94, f. 150.



Meriton të theksohet se “tahmini” – “falënderimi i Allahut” dhe “tehlili” – “pohimi se s’ka të Adhurar tjetër përveç Allahut” janë të bashkëngjitur në teuhidin e punëve, pa asnjë të metë prej kufizimit e mangësisë, madje pa asnjë të metë prej përngjasimit e përzierjes, prandaj robi rrugëtar për tek Allahu, kur përgatitet për të ndërmarrë këtë rrugëtim, ka për detyrë të mbulohet me mbulesën e delirjes së Allahut prej mangësive e prej nevojave (tesbih), të mbrohet me (tenzih) pastrimin e të Vërtetit nga mangësitë e nga nevojat dhe të qëndrojë fuqishëm, deri sa të futet në brendësi të kësaj kështjelle të pamposhtur. Pastaj vjen hyrja në të. Gjithashtu, zemra e tij duhet të kuptojë se i Vërteti Fuqiplotë është i pastër nga cilësimet që u bëhen krijesave dhe Ai, gjithashtu, është i pastër nga veshja me rrobat e shumicës. E gjitha kjo, me qëllim që hyrja e robit në falënderim (tahmid) të jetë e pastër prej ferrave të mendjemadhësisë.

**Baza e dytë**, është “tahmin” – “falënderimi” është pozita e teuhidit të punëve, pozitë e cila është në përshtatje me gjendjen e qëndrimit më këmbë dhe me këndimin gjatë namazit dhe, prej këtu rezulton se këto “tesbihate” zënë vendin e sures “El Hamd” (El Fàtiha).

Më përpara, në interpretimin e sures “El Hamd” (El Fàtiha) kemi shpjeguar se ne përgatitemi për teuhidin e punëve, për shkak se falënderimin e kemi reduktuar plotësisht vetëm në të Vërtetin e Lartësuar, njëkohësisht kemi privuar robtë me formën më të plotë që ata të kenë pjesë në falënderim, prandaj patjetër duhet që ajetin: “هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ” – “huvel ev’velu uel àkhiru uedh’dhàhiru uel bàtinu” – “Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i Dijshëm për çdo



**gjë!**<sup>1</sup> ta çojmë në veshët e zemrës dhe t'i japim shpirtit të shijojë të vërtetën e “رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَوْا” - “...ue mà remejte idh remejte ue làkinell'llàhe remà...” - “**Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante...**”,<sup>2</sup> si dhe të shkelim me këmbë e të bëjmë pluhur vetëpëlqimin e dashurinë për vetveten, ta çojmë veten në pozitën e falënderimit dhe ta shpëtojmë zemrën prej nënshtrimit e përluljes para dhënieve të njerëzve.

**Baza e tretë** është “tehlili” - “s’ka të adhuroar tjetër përveç Allahu”. Kjo bazë ka disa pozita, prej të cilave: pozita e mohimit të hyjnisë së punëve, që në të vërtetë është një shprehje tjetër për: “s’ka ndikues tjetër në gjithësi përveç Allahut”. Kjo shprehje është një përforsim për reduktimin e falënderimit vetëm në të Vërtetin, madje është shkak i këtij reduktimi dhe pasoja e tij, sepse gradët e trupave të mundshme janë hije e të vërtetës së ekzistencës të të Vërtetit të Gjithëfuqishëm dhe e lidhjes së mirëfilltë me Të, pasi asnjëra prej trupave të mundshëm s’ka asnjë formë prej pavarësisë, gjithashtu, s’kanë asnjë fuqi që të qëndrojnë në vetvete, prandaj është e pamundur që atyre trupave t’u atribuohet ndikimi imponues në çdo formë qoftë, sepse ndikimi kërkon pavarësinë krijuese, por edhe pavarësia krijuese, nga ana e saj, kërkon që krijuesi të ekzistojë në mënyrë të pavarur.

Shprehur me fjalët e atyre që quhen (Ehludh’dheuk) - atyre që dinë të shijojnë - e vërteta e qenieve hije, është shfaqja e fuqisë së të Vërtetit në panoramën e krijimit. Kuptimi i frazës: “Là ilàhe il’lell’làh” - “S’ka të adhuroar tjetër përveç Allahut”, është shikimi aktiv dhe fuqia e të Vërtetit në krijim, është mohimi i cilësive

<sup>1</sup>Sure “El Hadid”, ajeti 3.

<sup>2</sup>Sure “El Enfâl”, ajeti 17.



krijuese për trupat hije, është asgjësimi i pozitës aktive për trupat hije dhe mohimi se trupat hije kanë ndikim mbi të Vërtetin.

Gjithashtu, në frazën: “Là ilàhe il’lell’llàh” - “S’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”, është pozita e mohimit e çdo të adhuruari tjetër përveç të Vërtetit. Por vetë pozita e “tehlilit” - pozita e frazës: “Là ilàhe il’lell’llàh” - është rezultat i pozitës së “tahminit” - “falënderimit”, sepse, kur falënderimet reduktohen vetëm për Personin e dëlirë nga të metat e nga nevojat, atëherë robëria e hedh mjetin e saj hipës në këtë pozitë të pastër dhe i mohon të gjitha format e robërisë së krijesave ndaj krijesave. Kjo gjendje i vjen robit, pasi shikon të Falënderuarin. Në këtë gjendje, i Vërteti i Lartësuar bëhet për atë i adhuruari i vetëm, njëkohësisht shkatërrohen e copëtohen të gjithë idhujt. Për “tehlilin” ka edhe pozita të tjera, por këtu nuk është vendi i përshtatshëm për t’i përmendur.

**Baza e katërt** është “tekbiri” - “madhërimi”, domethënë madhërimi i Allahut nga të përshkruarit. Kur robi, në fillim shqipton “tesbihun” - “dëlirjen e të Vërtetit nga mangësitë e nga nevojat” dhe “tehlilin” - “s’ka të adhuruar tjetër përveç të Allahut”, në të vërtetë, me këto të dyja, bën pastrimin e të Vërtetit prej përshkrimit. Pasi i mbaron këto, ai me “tekbirin” - “Allahu Ekber”, bën edhe një herë pastrimin e Tij prej përshkrimit. Ky pastrim ka filluar që me “tahminin” - “falënderimi” i Tij - dhe me “tehlilin” - “s’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”. Por këto dy ziqre (përmendje të Allahut) kanë në brendësinë e tyre edhe pohimin nga ana e robit se ai nuk plotëson punët, njëkohësisht kanë edhe pohimin e robit për gjendjen e poshtër në të cilën ndodhet robi.





Ka mundësi që “tekbiri” – “madhërimi”, në këtë pozitë të jetë tekbir për Allahun, për ta falënderuar dhe se “s’ka të adhuroar tjetër përveç Allahut” dhe, ashtu siç u tha më sipër, në këto të dyja s’ka asgjë prej ferrave të shumicës.

Gjithashtu, ka mundësi që në “tesbihun” të ketë një pastrim prej zmadhimit. Gjithashtu, në “tekbirin” ka mundësi të ketë një madhërim prej pastrimit dhe, të gjitha këto, me qëllim që të rrëzohen plotësisht pretendimet e robit dhe të forcohet teuhidi i punëve. Për rrjedhojë, pozita e qëndrimit më këmbë me të Vërtetin bëhet një cilësi në zemrën e robit, i cili, në këtë gjendje, del prej “ngjyrosjes” dhe për atë arrihet një gjendje e “mundësisë”.

Robi rrugëtar për tek Allahu ka për detyrë të nxitojë – në këto ziqre të nderuara (përmendje të Allahut), që janë shpirti i diturive, deri sa në zemrën e tij të arrihet një gjendje veçimi, nënshtrimi e përlulje. Veç kësaj, e brendshmja e zemrës së tij formësohet për të përmendur Allahun dhe kjo arrihet duke i thënë këto ziqre sa më shumë e vazhdimisht, atëherë e vërteta e dhikrit - nëpërmjet kësaj rruge – bëhet e mundshme të arrijë në brendësi të zemrës dhe kështu, edhe pjesa tjetër e saj do të veshë rrobën e dhikrit e do të heqë rrobën e tij, që është rroba e robit.

Në këtë gjendje, zemra bëhet hyjnore. Në atë zemër realizohet e vërteta e shpirtit: “لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ اشْتَرَى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنفُسَهُمْ” - *“In’nell’llàheshterà minel muëminijne enfusehum...”* - **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit”**.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Sure “Et Teube”, ajeti 111.



## Ndarja e dytë

### ETIKA SHPIRTËRORE E KUNUTIT

Mëso se “kunuti” është prej suneteve muek’kedehe dhe kërkohet që të mos lihet. Disa kanë thënë se “kunuti” duhet bërë, kurse disa sahabë kanë thënë se “kunuti” është vaxhib. Nga fjalët e disa transmetimeve rezulton se “kunuti” është vaxhib - pavarësisht se në terminologjinë e fik’hut - është më e fuqishme thënie se “kunuti” nuk është në gradën e vaxhibit. Kjo thënie ka gjetur përhapje në mesin e dijetarëve të mëdhenj.

“Kunuti”, sipas mënyrës së njohur, konsiston në ngritjen e dy duarve deri në afërsi të pjesës së sipërme të nofullave, pjesa e brendshme e duarve është e shtrirë në drejtim të qiellit dhe në këtë pozicion këndohen lutjet e njohura dhe jo të njohura. Lutja në kunut lejohet të këndohet në çdo gjuhë, në gjuhën arabe, ose në gjuhë tjetër, por më e pëlqyeshme është që lutja të këndohet në gjuhën arabe.

Fukahatë kanë thënë se duaaja “El Ferexh”<sup>1</sup> është duaaja më e mirë për kunutin, megjithëse unë nuk kam gjetur ndonjë argument të fik’hut, që të tregojë këtë përparësi. Por përmbajtja e duasë tregon

---

<sup>1</sup>Lexo “Uesàilu Sh’shi’ati”, “Kitàbu salàti”, K. 7 - “Kunuti”, Hadithi 4. Dhe “Mustedrek Vesàilu Sh’shi’ati”, “Kitàbu - salàti”, K. 6 - “Kunuti”, Hadithi 4 dhe 9.



se kjo përparësi është e plotë. Duaja e Kunutit përfshin “tehlilin” - (Là ilàhe il’lell’lâh) - “s’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut” dhe “tahminin” - (Elhamdu lil’lâh) - “falënderimi i takon Allahut”. Këto fraza dhikri janë shpirti i besimit se i Vërteti është Zoti Një e i Vetëm. Kjo çështje është shpjeguar më sipër. Gjithashtu, përfshin emrat e mëdha të Allahut, si: El-Halijmu (Përdëllimtari), El-Kerijmu (Bujari), El-Alij’ju (i Larti), El-Adhijmu (Madhështori), Err’rrabu (Zoti krijues).

Pas kunutit robi përfshihet në dhikrin e rukusë e në dhikrin e sexhdes, si dhe në përmendjen e emrave vetjakë e të cilësive e të punëve, së bashku me gradët e shkëlqimeve të të Vërtetit. Në Duanë e Kunutit është edhe përsëritja me selam e profetëve. Mbase për rezervë, kjo duhet lënë dhe argumenti për këtë lënie është shumë i fuqishëm, megjithëkëtë është e lejueshme të bëhet. Gjithashtu, në Duanë e Kunutit përfshihet këndimi i salavateve për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Në përgjithësi, kjo dua e nderuar duket se përfshin, në mënyrë të shkurtuar, të gjitha frazat e dhikrit që këndohen në namaz.

Përparësia e Duasë së Kunutit mund të vërtetohet me fjalët e dijetarëve (*Allahu i mëshiroftë!*), ose me ndërmjetësinë e “tolerancës së argumenteve e të suneteve”<sup>1</sup>, edhe nëse në këtë ka

---

<sup>1</sup>Kur vjen një njoftim i shkallës “dobët”, që nuk i përmbledh të gjitha kushtet e argumentimit dhe ai njoftim tregon për shkallëzimin e shpërblimit për njëren prej punëve, padyshim që s’ka problem për shkallëzimin e shpërblimit për atë punë, kur ajo punë është bërë me qëllim arritjen e këtij shpërblimi, ose duke e shpresuar mundësinë e arritjes së shpërblimit të kërkuar; “Istilahatul-Usûli ue Muëdham Ebhâthihâ”, f. 189; Lexo “Bihârul Enuâr”, vëll. 2, f. 256; “El-Usûlu



vend për të menduar – me rrugën e zbulimit të një argumenti, që merret në konsideratë, për të cilin mendojmë se ai argument ka arritur të jetë i pranueshëm te dijetarët e hadithit.

Prej lutjeve të nderuara, me mirësi të mëdha, janë edhe lutjet që përfshijnë etikën e bashkëbisedimit në vetmi mes robit e të Vërtetit dhe përgatitjen e dhuntive hyjnore të plota. Kjo mënyrë lutjeje ka lidhje të plotë me kunutin, për faktin se kunuti është një gjendje që përfundon te i Vërteti, është lutja që e ka kënduar pothuajse vazhdimisht njëri prej shehëve të mëdhenj (*Allahu e mëshiroftë!*), është lutja që fillon me fjalët: “O Ti që të bukurën e shfaqe dhe të keqen e mbulove...”. Kjo është prej thesareve të arshit, është një dhuratë e të Vërtetit të Lartësuar për të Dërguarin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ashtu siç ka thënë Imam Saduku në librin e tij “Kitàbu-T’teuhijd”<sup>1</sup>: “Për çdo paragraf të kësaj lutjeje, ka mirësi të shumta dhe një shpërblim të madh”.

Për robin rrugëtar për tek Allahu, edukata e robërisë në gjendjen e kunutit kërkon dhe është më e pëlqyeshme mbajtja në mendje e pozitës së natyrës krijuese të Allahut, sepse kjo është gjendja e bashkëbisedimit intim me të Vërtetin dhe gjendja e ndalimit te Ai, në kuadrin e veçantisë së namazit, i cili, në tërësinë e tij, numërohet demonstrim i robërisë dhe vendi më i pëlqyer për lavdërimin e të Vërtetit. Namazi është porta që i Vërteti i Lartësuar e ka hapur vetëm që robi të bisedojë në intimitet me Atë dhe për t’iu lutur Atij. Me këtë mirësi të madhe, robi rrugëtar për tek Allahu

---

minel-Kâfi”, Libri “El-ijmànu uelkufru”, K. “Kujt i arrin shpërblimi prej Allahut për punën e bërë?”.

<sup>1</sup>Es Sadùk, “Kitàbu-T’teuhijd”, K. 29 - “Emrat e Allahut të Lartësuar”, Hadithi 14.



është nderuar në shkallën më të lartë. Për të gjitha këto, robi ka për detyrë të kontrollojë lutjet që bën në namaz dhe të bëjë kujdes që lutja e tij të përfshijë dëlirjen e të Vërtetit nga mangësitë e nga nevojat, të jetë i vëmendshëm, që lutja e tij të përmbajë fjalë, me të cilat përmendet Allahu i Gjithëfuqishëm. Gjithashtu, edhe sendet që robi i kërkon të Vërtetit, në këtë gjendje të nderuar, të jenë me fraza të marra prej diturive hyjnore, sepse, në këtë gjendje, robi ka detyrë që, në lutjen e tij, të kërkojë për veten e vet hapjen e portës së bashkëbisedimit intim me Allahun dhe kënaqësinë e këtij shoqërimi, gëzimin e qëndrimit në vetmi me të Vërtetin dhe ndalimin vetëm te Ai. Në të njëjtën kohë, robi ka për detyrë që në lutjen e tij të kërkojë edhe këtë botë, së bashku me ruajtjen prej punëve të ulëta kafshërore dhe dëshirave të shpirtit, me qëllim që të mos e turpërojë veten në prezencën e të pastërve dhe të mos e poshtërojë veten në praninë e njerëzve të mirë.

Duhet të dish, i nderuar lexues, se kunuti është mosshtrirja e dorës për ndihmë ndonjë tjetri përveç Allahut, është nxitimi për të arritur afrimin e plotë pranë të Gjithëfuqishmit. Robi e shtrin dorën bosh, për të lypur vetëm prej të Pasurit absolut dhe, në ndonjë gjendje, kur gjatë lutjes fjala përfundon për çështje të barkut, ose përmend këtë botë, kjo është mangësi dhe humbje e plotë.

I nderuar, përderisa vazhdon të jesh larg atdheut tënd, përderisa vazhdon të jesh i mbyllur dhe nuk je në fqinjësi të njerëzve të lirë, tani që je rob lufte në qendrën e errësirave të mbushura me dhimbje e me sprova të rënda, mos mendo e mos parashiko për veten tënde një gjendje, ashtu siç bën krimi i mëndafshit.



I nderuar, i Gjithëmëshirshmi e ka mbrujtur natyrën e pastër të krijimit tënd me dritën e diturisë, me zjarrin e dashurisë së përforcuar me dritat e profetëve dhe me dritat e ulijave të përvëluar nga dashuria, prandaj, i nderuar, mos e fik këtë zjarr me dheun e me hirin e kësaj bote të ulët, mos e turbullo këtë dritë me turbullirat e errësirës së informacionit të kësaj bote, pasi kjo botë është botë mërgimi. Shpresohet se, kur ti do të drejtohesh kah ajo copë toke e atdheut tënd të origjinës dhe të kërkosh prej të Vërtetit të realizohet ndalimi yt pranë të Lartit dhe në audiencën e Tij të parashtrosh gjendjen tënde, me zemër të thyer, si i privuar dhe të shfaqësh para Tij mjerimin tënd e sprovat e rënda që kalon, shpresohet që edhe për ty do të vijnë furnizimet e panjohura dhe një ndihmë e brendshme, e cila i drejton të gjitha të metat e tua, sepse “zakoni i Tij është bamirësia dhe cilësia e Tij është bërja e ndereve”.

Ndodh shpesh që ti, në gjendje domosdoshmërie e nënshtrimi të plotë dhe jo me zemër të vdekur si puna ime, në kunutin tënd këndon paragrafë prej “Munàxhàti-Sh’shaëbàni’j’jeh”, prej bisedave intime të kënduara gjatë muajit Shaban, bashkëbisedimet intime të Prijësit të besimtarëve dhe të fëmijëve të tij dhe sidomos fjalën e tij: *“Mua më dhuro ndalimin e plotë te Ti...”*.

Në përgjithësi, pozitat e kunutit, sipas mendimit tim, janë si pozitat e sexhdes, në një kohë që sexhdeja përfaqëson një gjendje orientimi, afrimi në gjendjen poshtëruese të robërisë, që të kujton pozitën e Zotit krijues, atëherë pozita e kunutit përfaqëson afrim te madhështia e Zotit krijues dhe i kujton robit pamundësinë dhe sa e ulët është gjendja e robërisë. Kjo është sipas pozitës së mesatarëve.

Për sa i përket pozitës së të plotësuarve, kunuti është pozita e ndalimit te i Vërteti dhe heqja dorë nga mbështetja në ndonjë



tjetër, është shpirti i pozitës së mbështetjes te Allahu (Et' tevek'kul), ashtu siç është sexhdeja pozita e asgjësimit të robit dhe heqja dorë prej tjetrit dhe prej altruizmit.

Në përgjithësi, pozita “kijam” - qëndrimi më këmbë në namaz - është pozita e teuhidit të punëve dhe, derisa robi rrugëtar për tek Allahu do të fuqizohet prej këtij teuhidi, në rekatin e dytë, ky teuhid do të japë frytin e vet te kunuti. Në kunut, robi vë mbi kokë kësulën e shtrirjes së dorës, për të lypur në portën bujare të të Vërtetit, me bindjen e plotë që kurrë të mos u kërkojë njerëzve dhe të largohet me vrap prej tyre.



## Mbyllje dhe lutje

Do të ishte më e përshtatshme që kjo kumtesë të mbyllet me përmendjen e veseve që pengojnë namazin, siç janë: hipokrizia, vetëpëlqimi dhe të tjera vese të ngjashme, por unë kërkoj ndjesë, që të bëj këtë shërbim, duke e justifikuar ndjesën time me faktin se këto tema i kam shpjeguar në librin tim “Dyzet hadithe”, në të cilin kam shpjeguar disa hadithe, duke shtuar edhe shqetësimet e shumta dhe shpërndarjen e fuqive intelektuale.

Për të gjitha këto, po e mbyll këtë kumtesë, duke parashtruar ndjesën time për të metat e mia personale dhe për mangësitë që kanë dalë në trajtimin e çështjeve. Gjithashtu, u kërkoj falje për gabimet e mundshme të pastërve, që dinë të shikojnë, duke theksuar se kam shumë nevojë për fjalët e tyre bujare dhe që ata të luten për mua.

O Zoti ynë, Ti na ke veshur ne, robëve të pafuqishëm, rrobën e ekzistencës pa asnjë shërbim e bindje paraprake nga ana jonë, pa pasur Ti nevojë për adhurimin tonë, por si nder e butësi e mirëfilltë nga ana Jote dhe si mëshirë e bujari nga ana Jote. Ti na nderove me llojet e shumta të mirësive morale e trupore, na nderove me kategori të shumta mëshire të brendshme e të jashtme, megjithëse mosekzistenca jonë nuk sjell asnjë mangësi në fuqinë Tënde, po kështu edhe ekzistenca jonë nuk shton asgjë në madhërinë e në madhështinë Tënde.





Ti vazhdove të na bësh nder, ne na mbuluan burimet e mëshirës Tënde gjithëpërfshirëse dhe shkëlqimi i diellit të bukurisë së më të Bukurit, Ti na zhyte në detet e mëshirës, të ndriçuara me dritat e bukurisë... të lutemi, drejtoi të metat tona, shlyeji gabimet e mëkatet tona, pakësoi shkarjet e mangësitë tona me dritën e mbarësisë së brendshme dhe me ndihmën e me udhëzimin e fshehtë!

Çliroi zemrat tona të mbushura me këtë botë dhe të lidhura me këtë botë, zbukuroi zemrat tona me pastërtinë e lidhjes së madhështisë Tënde!

O Zoti ynë, ne nuk jemi asgjë, bindja jonë, nuk shton asnjë send në mbretërinë Tënde. Gjithashtu, edhe mëkatet tona nuk pakësojnë asnjë send në mbretërinë Tënde, as ndëshkimi i mëkatarëve Ty nuk të sjell ndonjë dobi, po kështu edhe falja e mëshira Jote e të dënuarve nuk pakësojnë asnjë send në fuqinë Tënde!

Pa dyshim që “syri i ngurtë” i të gabuarve kërkon mëshirën Tënde, cilësia e pastër e krijimit e të mangëtëve kërkon plotësimin! O Zoti ynë, na trajto me butësinë Tënde përgjithësuëse, bëj për ne ndere dhe mos e shiko përgatitjen tonë të keqe!

*“Zoti im, nëse unë nuk e meritoj mëshirën Tënde, Ti je Bujari që bën nder mua, me gjerësinë e pasurisë Tënde...”*



*Zoti im, bëj të mundur që të ndaloj te Ti! Ndriçoi sytë e zemrave tona me shkëlqimin e shikimit në Ty, deri sa sytë e zembrës të djegin mbulesat e dritës dhe të arrijnë në praninë e madhështisë Tënde!”<sup>1</sup>*

Në vijim, fjala jonë, me caktimin e Allahut të Gjithëfuqishëm, do të jetë lavdërim e falënderim për të Lartin, për të gjitha mirësitë që Ai na ka dhënë, duke kënduar salavate për Muhamedin dhe për familjen e tij të pastër.

Ditë e hënë, data dy e muajit Rebij’u Thànij, viti 1361 hixhri.

O Zoti im, vetëm Ty të falënderojmë për nderimin e madh që na bën, duke na dhënë mundësi të shohim këtë dritë hyjnore mëshirëplote!

بعون الله وتوفيقه تمت ترجمة هذا الكتاب من اللغة العربية إلى اللغة الألبانية يوم الأربعاء تاريخ 29 من شهر جمادى الأولى سنة 1437 هجري الموافق 09.03.2016 ميلادي

Me ndihmën e Allahut, përkthimi i këtij libri, nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, përfundoi ditën e mërkurë, më 29 Xhemadu Uula, viti 1437 – 09.03.2016.

---

<sup>1</sup>Pjesë prej “El munàxhàtu Shaëbànij’jeh”. Të plotë e gjen në librin “Bihàrul Enuàr”, vëll. 91, f. 99.



## PËRMBAJTJA

- FJALA E INSTITUTIT.....	5
- Letra e Imam Khomeinit,drejtuar djalit të tij, Sej'jid Ahmed Khomeinit.....	9
- Letra e Imam Khomeinit,drejtuar bashkëshortes së djalit të tij, Sej'jide Fàtime Et Tàbàtabàij.....	13
PARATHËNIE.....	19
<b>ARTIKULLI I PARË.....</b>	<b>26</b>
- Rregulla të domosdoshme për të gjitha gjendjet e namazit, për të gjitha ritualet dhe për të gjitha adhurimet.....	26
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>26</b>
- Madhështia e Zotit dhe përulja e robërisë.....	26
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>32</b>
- Gradët e pozitive të rrugëtarëve në udhën e Allahut.....	32
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>37</b>
- Nënshtrimi.....	37
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>45</b>
- Siguria e zemrës.....	45
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>51</b>
- Ruajtja e punëve prej veprimit të shejtanit.....	51
<b>Ndarja e gjashtë.....</b>	<b>58</b>
- Afrimi.....	58
<b>Ndarja e shtatë.....</b>	<b>68</b>



- Të kuptuarit.....	68
<b>Ndarja e tetë.....</b>	<b>74</b>
- Prania e zemrës.....	74
<b>Ndarja e nëntë.....</b>	<b>86</b>
- Hadithe të ardhura prej Ehli Bejtit, që shtojnë dëshirën për praninë e zemrës.....	86
<b>Ndarja e dhjetë.....</b>	<b>91</b>
- Forcimi i pranisë së zemrës.....	91
<b>Ndarja e njëmbëdhjetë.....</b>	<b>97</b>
- Ilaçi për shmangien e absurditetit të përfytyrimit, për të forcuar praninë e zemrës.....	97
<b>Ndarja e dymbëdhjetë.....</b>	<b>104</b>
- Dashuria për këtë botë i lëshon frerin fantazisë.....	104
- Parfumi (misku) i mbylljes.....	113
<b>ARTIKULLI I DYTË.....</b>	<b>116</b>
- Veprimet paraprake të namazit dhe disa etika zemre të namazit.....	116
<b>Qëllimi i parë - Pastrimi (tahàreti).....</b>	<b>116</b>
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>116</b>
- Pastrimi në përgjithësi.....	116
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>124</b>
- Gradat e pastrimit.....	124
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>128</b>
- Edukata e zemrës së rrugëtarit në udhën e Allahut, kur shkon të pastrohet me ujë.....	128
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>135</b>
- Pastrimi.....	135
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>139</b>
- Tubë rregullash për abdesin.....	139
<b>Ndarja e gjashtë.....</b>	<b>147</b>
- Gusuli dhe rregullat për gusulin.....	147



<b>Ndarja e shtatë.....</b>	<b>152</b>
- Disa rregulla të brendshme, që kanë lidhje me heqjen e papastërtive dhe me pastrimin prej ligësive.....	152
Vijim.....	162
<b>Qëllimi i dytë - Etika e veshjes.....</b>	<b>166</b>
- Pozita e parë.....	166
- Etika e veshjes, në përgjithësi.....	166
- Pozita e dytë.....	175
- Etika e veshjes së atij që fal namaz.....	175
<b>KAPITULLI PARË.....</b>	<b>175</b>
- Sekreti i pastërtisë së veshjes.....	175
<b>KAPITULLI I DYTË.....</b>	<b>183</b>
- Lidhjet e zemrës me mbulimin e pjesëve të trupit.....	183
- Vijim.....	189
<b>Qëllimi i tretë- Edukata e zemrës, në lidhje me vendin e atij që fal namaz.....</b>	<b>192</b>
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>192</b>
- Njohja e vendit.....	192
- Vijim.....	198
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>202</b>
- Etika e lejimit të vendit.....	202
<b>Qëllimi i katërt - Etika e zemrës për kohën.....</b>	<b>205</b>
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>205</b>
- Shtresat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, në lidhje me ruajtjen e kohëve të namazit.....	205
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>210</b>
- Kujdesi për ruajtjen e kohëve të namazit.....	215
<b>Qëllimi i pestë - Vështrim mbi etikën e kthimit në drejtim të Kibles.....</b>	<b>215</b>
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>215</b>
- Sekreti i kthimit kah një drejtim, në përgjithësi.....	215



<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>218</b>
- Disa rregulla të kthimit në drejtim të Kibles.....	218
- Vijim.....	223
<b>ATIKULLI I TRETË.....</b>	<b>225</b>
- Bashkëshoqëruesit e namazit.....	225
<b>Kapitulli i parë.....</b>	<b>225</b>
- Disa etika të ezanit dhe ikametit.....	225
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>232</b>
- Sekreti i ezanit e ikametit dhe disa rregulla të përgjithshme të ezanit e ikametit.....	232
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>240</b>
- Disa rregulla dhe sekretetë tekbireve të ezanit e të ikametit....	240
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>249</b>
- Disa nga rregullat e dëshmisë: “S’ka zot tjetër përveç Allahut!” - “لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ” - “Là ilàhe il’le-ll’lilàh” dhe shpjegimi i lidhjes së tyre me ezanin e ikametin.....	249
- Njoftim njohës.....	243
- Vijim.....	246
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>249</b>
- Disa nga etikatat që lidhen me dëshminë për mesazhin,tregojnë dëshminë për njëtimin e Allahut.....	249
- Shprehje e hollë njohëse.....	256
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>258</b>
- Disa nga etikatat e thirrjes: “Eja në namaz!” dhe “Eja në shpëtim!” ....	258
- Vijim e plotësim.....	262
<b>Kapitulli i dytë.....</b>	<b>264</b>
- Qëndrimi në këmbë.....	264
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>264</b>
- Sekreti i qëndrimit në këmbë.....	264
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>266</b>



- Etika e qëndrimit në këmbë.....	266
- Këshillë e mirë.....	272
<b>Kapitulli i tretë.....</b>	<b>278</b>
- Sekreti i nijetit dhe etika e nijetit.....	278
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>278</b>
- E vërteta e nijetit në adhurime.....	278
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>286</b>
- Disa etika të nijetit.....	286
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>292</b>
- Fragment sqarimi, në lidhje me gradët e sinqeritetit.....	292
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>297</b>
- Mohuesit e pozitive dhe grupet e tyre.....	297
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>308</b>
- Disa gradë të tjera të sinqeritetit.....	308
<b>KAPITULLI I KATËRT.....</b>	<b>317</b>
- Disa rregulla të leximit dhe një fllad prej sekreteve të leximit.....	317
<b>Llamba e parë.....</b>	<b>318</b>
- Rregulla të përgjithshme për këndimin e Kur'anit Fisnik.....	318
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>318</b>
- Etika e madhërimit.....	318
- <b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>324</b>
- Shpjegimi në vija të përgjithshme i qëllimeve, kërkesave dhe brendisë së Librit hyjnor.....	324
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>339</b>
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>346</b>
- Zhdukja e mbulesave që pengojnë marrjen e mësimi.....	346
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>362</b>
- Mendimi.....	362
<b>Ndarja e gjashtë.....</b>	<b>367</b>
- Përputhja.....	367
- Mbyllje.....	373
<b>Llamba e dytë.....</b>	<b>379</b>



- Edukata e këndimit të Kur'anit.....	379
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>379</b>
- Edukata e këndimit në namaz.....	379
- Plotësim.....	390
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>393</b>
- Edukata e kërkimit të mbrojtjes (el-istiädheh).....	393
- Plotësim e rezultat.....	406
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>408</b>
- Kolonat e kërkimit të mbrojtjes (el-istiädheh).....	408
1- Kërkuesi i mbrojtjes (emustejdhu).....	408
2- Personi prej të cilit kërkohet mbrojtje.....	411
3- Atij që i kërkohet mbrojtja (el musteädhu bihi).....	415
4- Qëllimi i kërkimit të mbrojtjes (el musteädhu liexhlihi).....	417
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>419</b>
- Etika e fjalës “bismil’lähi” (et’tesmijetu).....	419
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>429</b>
- Esenca e shpjegimit të sures së bekuar “El Hamd” (El Fätiha) dhe një përmbledhje prej edukatave të falënderimit dhe të këndimit...	429
- Përfundim gnostik.....	441
- Studim dhe informacion.....	444
- Citim dhe hulumtim.....	455
- Plotësim.....	460
- Vërejtje.....	469
- Vërejtje tjetër.....	472
- Zgjim besimi.....	478
- I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti - الرحمن الرحيم.....	482
- Sunduesi i Ditës së Gjykimit - مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ.....	484
- Këqyrje.....	487
- Frymëzim prej arshit të Allahut.....	493
- Vërejtje njohëse.....	497
- Vërejtje gjuhësore.....	500





- إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ – “Ij’jâke naëbudu ue ij’jâke nesteijnû” – “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë” .....	501
- Vërejtje ndriçuese.....	505
- Huluntim gnostik.....	508
- Vërejtje dhe fjalë e hollë.....	511
- Dobi njohëse.....	513
- Zgjim nga besimi.....	515
- Degëzim juridik.....	517
- Dobi.....	519
- “Udhëziona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd,as në të atyre që janë të humbur!” .....	521
- Vërejte ndriçuese dhe ndriçim njohës.....	525
- Vërejtje besimi.....	528
- Vërejtje gnostike.....	535
- Shpjegim.....	537
- Mbyllje.....	542
- Plotësim - Mirësia e sures “El Hamd” (El Fàtiha).....	546
<b>Ndarja e gjashtë.....</b>	<b>550</b>
- Dhuratë, interpretimi i sures së bekuar “Et Teuhid” (El Ihlàs).....	550
- Vërejtje e domosdoshme.....	561
- Vërejtje gnostike.....	564
- Interpretim i domosdoshëm.....	570
- Urtësi ndriçuese.....	573
- Plotësim.....	574
- Mbyllje.....	578
<b>Ndarja e shtatë.....</b>	<b>581</b>
- Fllad nga interpretimi i sures së bekuar “El Kadr”, duke ia përshtatur kësaj kumtese.....	581
- Vërejtje gnostike.....	600



- Plotësim.....	602
- Fjala e Allahut të Lartësuar: “ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ” – “Ue mà edràke mà lejletul kadri” – “E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Nata e Kadrit?” .....	604
- Fjala e Allahut të Lartësuar: “ لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ ” – “Lejletul Kadri khajrun min elfi shehrin” – “Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj” .....	608
- Vërejtje njohëse.....	609
- Fjala e Allahut të Lartësuar: “ تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ ” – “tetenez’zelul melâïketu uerr’rrùhu fîjhà bi’idhni rrab’bihim min kul’li emrin” – “Engjëjt dhe shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet” .....	610
- Fjala e Allahut të Lartësuar: “ الْفَجْرِ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ ” – “Selàmun hije hat’tà matleil fexhri” – “Paqe është ajo deri në lindjen e agimit” ...	620
- Vërejtje njohëse.....	621
- Mbyllje.....	622
- Kërkim ndjese.....	624
<b>KAPITULLI I PESTË.....</b>	<b>626</b>
- Përmbledhje e etikave dhe sekreteve të rukusë.....	626
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>626</b>
- Tekbiri i rukusë.....	626
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>629</b>
- Etika e rënies në ruku.....	629
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>631</b>
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>634</b>
<b>Ndarja e pestë.....</b>	<b>637</b>
- Ngritja e kokës prej rukusë.....	637



<b>KAPITULLI I GJASHTË.....</b>	<b>639</b>
- Kujtesë e përgjithshme për sekretin dhe etikën e sexhdes.....	639
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>639</b>
- Sekreti i sexhdes.....	639
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>641</b>
<b>Ndarja e tretë.....</b>	<b>643</b>
<b>Ndarja e katërt.....</b>	<b>645</b>
<b>KAPITULLI I SHTATË.....</b>	<b>646</b>
-Kujtesë e përgjithshme rreth etikës së teshehudit.....	646
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>646</b>
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>649</b>
<b>KAPITULLI I TETË.....</b>	<b>654</b>
- Etika e selamit.....	654
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>654</b>
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>656</b>
<b>PËRBYLLJA E LIBRIT.....</b>	<b>660</b>
- Etika e disa punëve që hyjnë te namazi dhe janë të bashkuara me të.....	660
<b>Ndarja e parë.....</b>	<b>660</b>
- Disa sekrete dhe etika në katër tesbihatet, në namazet tre dhe katër rekatësh.....	660
<b>Ndarja e dytë.....</b>	<b>666</b>
- Etika shpirtërore e kunutit.....	666
<b>MBYLLJE DHE LUTJE.....</b>	<b>672</b>



## آداب الصلاة

المؤلف: السيد روح الله الموسوي الخميني (قدس سره)

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2024



اسم الكتاب: آداب الصلاة

المؤلف: السيد روح الله الموسوي الخميني (قدس سره)

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

المشرف العام: الشيخ الحج ولئت وزيًا

التصحيح الأدبي: بيريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسم"

تيرانا: 2024